

KOMBET E
BASHKUARA



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje
të Rënda të së Drejtës Humanitare
Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-
Jugosllavisë prej Vitit 1991

Lënda Nr.: IT-04-84-T

Data: 3 prill 2008

Origjinali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE I

Para: Gjykatësit Alphons Orie, Presiding
Gjykatësit Frank Höpfel
Gjykatësit Ole Bjørn Støle

Sekretari: Z. Hans Holthuis

Aktgjykim: 3 April 2008

PROSECUTOR
kundër

RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT

PUBLIK

AKTGJYKIM

Zyrës së Prokurorit

Mr David Re
Mr Gramsci di Fazio
Mr Gilles Dutertre
Mr Philip Kearney

Avokatëve të Ramush Haradinajt

Z. Ben Emmerson, QC
Z. Rodney Dixon
Zj. Susan L. Park

Avokatëve të Idriz Balajt

Mr Gregor Guy-Smith
Ms Colleen Rohan

Avokatëve të Lahi Brahimajt

Mr Richard Harvey
Mr Paul Troop

Pasqyra e Lëndës

SHKURTESA TË PËRGJITHSHME	3
1. HYRJE	5
2. ÇËSHTJE TË PROVAVE	7
2.1 BURIMET DHE PËRDORIMI I PROVAVE	7
2.2 VËSHTIRËSITE E MARRJES SË DËSHMIVE PREJ DËSHMITARËVE.....	11
2.3 PROVAT IDENTIFIKUESE	14
3. ELEMENTE TË PËRGJITHSHME PËR NENIN 3 TË STATUTIT	17
3.1 LIGJI MBI ELEMENTE TË PËRGJITHSHME.....	17
3.2 PËRFUNDIME PËR EKZISTENCËN E NJË KONFLIKTI TË ARMATOSUR	29
3.2.1 Organizimi i UÇK-së	29
3.2.2 Ashpërsia.....	42
3.2.3 Përfundim.....	47
4. ELEMENTE TË PËRGJITHSHME DHE KUSHTI I JURIDIKSIONIT PËR NENIN 5 TË STATUTIT	49
4.1 LIGJI MBI ELEMENTE TË PËRGJITHSHME DHE KUSHTIN E JURISDIKSIONIT.....	49
4.2 PËRFUNDIME	51
5. LIGJI MBI KRIME SIPAS NENIT 3 TË STATUTIT DHE PËRGJEGJËSIA INDIVIDUALE.....	58
5.1 KRIME	58
5.1.1 Vrasje	58
5.1.2 Torturë dhe trajtim mizor	58
5.1.3 Përdhunim	59
5.1.4 Shkelje të dinjitetit njerëzor	61
5.2 PËRGJEGJËSIA PËR KRIMET	61
5.2.1 Ndërmarrja e përbashkët kriminale.....	61
5.2.2 Kryerja, planifikimi, nxitja, urdhërimi dhe ndihma e inkurajimi	65
6. PËRFUNDIME NË LIDHJE ME PIKAT	68
6.1 PËRFUNDIME TË PËRGJITHSHME LIDHUR ME RRETHINËN E KANALIT TË RADONIQIT	68
6.2 TRAJTIMI ÇNJERËZOR, TORTURA, DHE SHKELJA E DINJITETIT PERSONAL TË DËSHMITARES 38 DHE FAMILJES SË DËSHMITARES (PIKA 2)	76
6.3 TRAJTIMI MIZOR DHE TORTURIMI I DRAGOSLLAV STOJANOVIQIT DHE TË TJERËVE (PIKA 4)	81
6.4 TRAJTIMI MIZOR DHE TORTURIMI I STANISHA RADOSHEVIQIT DHE NOVAK STIJOVIQIT (PIKA 6).....	90
6.5 VRASJA E VUKOSAVA MARKOVIQIT DHE DARINKA KOVAÇIT (PIKA 8)	96
6.6 VRASJA E MILOVAN DHE MILKA VLLAHOVIQIT (PIKA 10).....	100
6.7 VRASJA E SLOBODAN RADOSHEVIQIT DHE MILLOSH RADUNOVIQIT (PIKA 12).....	103
6.8 TRAJTIMI MIZOR DHE VRASJA E TË AFËRMVE TË DËSHMITARIT 4 DHE DËSHMITARIT 19 (PIKA 14).....	110
6.9 TRAJTIMI MIZOR DHE VRASJA E HAJRULLAH GASHIT DHE ISUF HOXHËS (PIKA 16).....	122
6.10 TRAJTIMI MIZOR DHE VRASJA E ILIRA DHE TUSH FRROKAJT (PIKA 18)	125
6.11 TRAJTIMI MIZOR, TORTURIMI DHE VRASJA E ZENUN GASHIT, DHE MISIN DHE SALI BERISHËS (PIKA 20).....	130
6.12 VRASJET LIDHUR ME RRETHINËN E KANALIT TË RADONIQIT (PIKA 22)	135
6.12.1 Vrasja e Afrim Sylejmanit	135
6.12.2 Vrasja e Rade Popadiqit.....	137

6.12.3 Vrasja e Ilija Antiqit.....	142
6.12.4 Vrasja e Idriz Hotit.....	144
6.12.5 Vrasja e Kujtim Imerajt	146
6.12.6 Vrasja e Nuriye dhe Istref Krasniqit	149
6.12.7 Vrasja e Zdravko Radunoviqit	153
6.12.8 Vrasja e Velizar Stoshiqit	155
6.12.9 Vrasja e Malush Shefki Mehës	157
6.12.10 Vrasja e Xhevat Berishës	158
6.12.11 Vrasja e Kemajl Gashit	159
6.12.12 Vrasja e Sanije Balajt.....	161
6.12.13 Vrasja e Sejd Nocit	175
6.12.14 Vrasja e personave të paidentifikuar	177
6.13 TRAJTIMI MIZOR, TORTURIMI DHE VRASJA E IVAN ZARIQIT DHE TË TJERËVE (PIKA 24).....	179
6.14 TRAJTIMI MIZOR DHE VRASJA E UKË REXHEPAJT DHE NESRET ALIJAJT (PIKA 26)	182
6.15 TRAJTIMI MIZOR DHE TORTURIMI I DËSHMITARIT 6 (PIKA 28).....	183
6.16 TRAJTIMI MIZOR, TORTURIMI, DHE VRASJA E NENAD REMISHTARIT DHE KATËR PERSONAVE TË PAIDENTIFIKUAR (PIKA 30).....	192
6.17 SHTABI I UÇK-SË NË JABLLANICË (PIKA 32)	196
6.17.1 Trajtimi mizor, torturimi dhe vrasja e Pal Krasniqit.....	196
6.17.2 Trajtimi mizor, torturimi dhe vrasja e Skënder Kuqit.....	203
6.17.3 Trajtimi mizor dhe torturimi i Dëshmitarit 3 dhe dy burrave të tjerë	208
6.18 TRAJTIMI MIZOR DHE TORTURIMI I NASER LIKËS DHE TË TJERËVE (PIKA 34)	214
6.19 PËRDHUNIMI I DËSHMITARES 61 DHE TRAJTIMI MIZOR DHE TORTURIMI I DËSHMITARIT 1 DHE DËSHMITARES 61 (PIKAT 36 DHE 37)	216
7. PJESËMARRJA E TË AKUZUARVE NË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT KRIMINALE.....	224
8. FAJËSIA E SHUMËFISHTË.....	229
9. PËRCAKTIMI I DËNIMIT.....	230
9.1 KUADRI LIGJOR PËR PËRCAKTIMIN E DËNIMIT	230
9.2 QËLLIMI I DËNIMIT	231
9.3 FAKTORËT NË PËRCAKTIMIN E DËNIMIT	232
9.3.1 Sa të rënda janë veprat penale dhe tërësia e sjelljes së fajshme.....	232
9.3.2 Rrethanat individuale të Lahi Brahimajt.....	234
9.3.3 Praktika e përgjithshme e dënimeve me burgim të gjykatave të ish-Jugosllavisë.....	235
9.3.4 Përfitimi i kohës së paraburgimit	237
9.4 PËRCAKTIMI I DËNIMIT	237
10. VENDIM.....	238
11. MENDIMI PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYKATËSIT HÖPFEL PËR PIKËN 14.239	
SHTOJCA.....	241
A. HISTORIA PROEDURALE	241
B. TABELË E ÇËSHTJEVE* ME SHKURTIME.....	251

Shkurtesa të përgjithshme

APJ	<i>Jugoslovenska NaroADN Armija (JNA) – Armata Popullore Jugosllave</i>
DEM	<i>Deutsche Mark - Marka Gjermane</i>
ECMM	<i>European Community Monitoring Mission – Misioni Monitorues i Bashkësisë Evropiane</i>
FARK	<i>Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës</i>
HLC	<i>Humanitarian Law Center – Qendra e së Drejtës Humanitare</i>
JSO	<i>Jedinica za Specijalne Operacije – Njësitë për Operacione të Posaçme</i>
KNPZH	<i>Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur – International Commission for Missing Persons (ICMP)</i>
LDK	<i>Lidhja Demokratike e Kosovës</i>
MPB	<i>Ministarstvo Unutrašnjih Poslova (MUP) – Ministria e Punëve të Brendshme</i>
NATO	<i>North Atlantic Treaty Organisation – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut</i>
NJPKB	<i>United Nations Detention Unit (UNDU)– Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara</i>
NPK	<i>Joint Criminal Enterprise (JCE) - Ndërmarrje e Përbashkët Kriminale</i>
PJP	<i>Posebne Jedinice Policije – Njësi të Posaçme Policore</i>
RDB	<i>Resor Državne Bezbednosti – Dega e Sigurisë Shtetërore</i>
RFJ	<i>Republika Federale e Jugosllavisë</i>
RSFJ	<i>Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë</i>
SAJ	<i>Specijalna Antiteroristička Jedinica – Njësi të Posaçme Kundër Terrorit</i>
T	<i>Transkripte në Prokurorja kundër Ramush Haradinajt dhe të tjerëve</i>
TO	<i>Teritorialna Odbrana – Mbrojtja Territoriale</i>
TPNJ	<i>International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia (ICTY) – Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë</i>
TPNR	<i>International Criminal Tribunal for Rwanda (ICTR) – Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën</i>
UÇK	<i>Ushtria Çlirimtare e Kosovës</i>
UJ	<i>Vojska Jugoslavije (VJ) – Ushtria Jugosllave</i>

UNMIK	<i>United Nations Interim Administration Mission in Kosovo – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë</i>
ZPZHK	<i>Zyra për Persona të Zhdukur dhe Kriminalistikë - Office for Missing Persons and Forensics (OMPF)</i>

1. Hyrje

1. Të Akuzuarit, Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj akuzohen bashkërisht në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt (më tej përmendet “Aktakuza”) për krime që pretendohet se u kryen prej tyre prej 1 marsit 1998 deri më 30 shtator 1998 kundër civilëve serbë, civilëve romë/egjipianë të Kosovës si dhe civilëve shqiptarë kosovarë të cilët konsideroheshin si bashkëpunëtorë të forcave serbe, në zonën e Dukagjinit në Kosovë.¹ Pretendohet se gjatë kësaj periudhe, UÇK-ja përndoqi dhe rrëmbeu viktimat e përmendura në Aktakuzë për konsolidimin e kontrollit të plotë të saj në zonën e Dukagjinit. Aktakuza pretendon se, për këtë, UÇK-ja shfrytëzoi rrethinën e kanalit të Radoniqit për kryerjen e vrasjeve dhe hedhjen e kufomave të 30 viktimave të saj. Pretendohet gjithashtu se UÇK-ja ngriti një qendër burgimi të përkohshme në shtabin e Jabllanicës, komuna e Gjakovës, ku të burgosurit rriheshin rregullisht dhe vuajtën forma të tjera të keqtrajtimit fizik.

2. Prokuroria pretendon se të paktën nga 1 marsi 1998 deri në mes të qershorit 1998, Ramush Haradinaj ishte komandant *de facto* në UÇK dhe nga mesi i qershorit ishte bërë komandant *de jure*. Sipas Aktakuzës, çdo zonë operative e UÇK-së në Kosovë, si është zona e Dukagjinit në Kosovën perëndimore për të cilën pretendohet se komandohej nga Ramush Haradinaj, veproi në mënyrë të pavarur prej autoritetit të lartë komandues. Rrjedhimisht Ramush Haradinaj kishte komandën e përgjithshme mbi forcat e UÇK-së në zonën e Dukagjinit. Kjo zonë ishte e gjerë dhe përfshinte komunat e Pejës, Deçanit, Gjakovës dhe pjesa të komunave të Istogut dhe të Klinës.

3. Prokuroria pretendon se gjatë gjithë kohës që ka lidhje me Aktakuzën, Idriz Balaj komandoi një njësi të UÇK-së të njohur si Shqiponja të Zeza, e cila vepronte në krejt zonën e Dukagjinit si njësi speciale e ndërhyrjes së shpejtë. Sipas Aktakuzës, si Komandanti i Shqiponjave të Zeza, Idriz Balaj ishte vartës i drejtpërsëdrejtë i Ramush Haradinajt dhe bashkëpunonte ngushtë me të.

4. Prokuroria pretendon se gjatë gjithë kohës që ka lidhje me Aktakuzën, Lahi Brahimaj ishte anëtar i UÇK-së me bazë në shtabin e Jabllanicës. Sipas Aktakuzës më 23 qershor 1998 ai u emërua Zëvendëskomandanti i zonës së Dukagjinit, pozitë që e mbajti deri më 5 korrik 1998 kur u largua nga kjo detyrë. Pavarësisht heqjes së tij nga ky funksion, ai vazhdoi të shërbente si drejtori i financave në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së. Prokuroria pretendon se gjatë kohës që ka lidhje me Aktakuzën, Lahi Brahimaj ishte vartësi i Ramush Haradinajt dhe bashkëpunonte ngushtë me të.

5. Secili prej tre të Akuzuarve akuzohet si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për krimet e përmendura në të gjitha pikat e Aktakuzës. Qëllimi i pretenduar i përbashkët kriminal ishte konsolidimi i kontrollit të plotë i UÇK-së mbi zonën e Dukagjinit nëpërmjet largimit dhe keqtrajtimit të paligjshëm të grupeve të lartpërmendura të civilëve. Sipas Aktakuzës, këtu përfshiheshin kryerja e krimeve kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit dhe shkeljet e ligjeve dhe zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, ndër të cilat vrasje, tortura dhe trajtim mizor. Përndryshe të tre të Akuzuarit akuzohen për përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7(1) të Statutit në lidhje me disa prej këtyre krimeve, për kryerjen e tyre ose për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, ose ndihmesën dhe inkurajimin në kryerjen e tyre. Mbrojtja e të tre të Akuzuarve argumenton se të Akuzuarit janë të pafajshëm dhe rrjedhimisht duhet të shpallen të pafajshëm.

6. Dhoma Gjyqësore dëgjoi gjithsej 81 dëshmitarë *viva voce* dhe mori dëshmitë e 16 dëshmitarëve sipas Rregullës 92 *bis* dhe *quater* të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”). Mbrojtja vendosi të mos bënte parashtrime sipas Rregullës 98 *bis* dhe të mos ftonte dëshmitarë. Si pasojë gjatë shqyrtimit të çështjes kundër tre të Akuzuarve, Dhoma Gjyqësore ka shfrytëzuar provat e paraqitura nga Prokuroria dhe të nxjerra nga Mbrojtja gjatë kundërpvetjeve si dhe dëshminë e një dëshmitari të Dhomës Gjyqësore. Siç do të diskutohet më poshtë në pjesën 2.2, gjatë procesit, Dhoma Gjyqësore hasi në vështirësi të konsiderueshme për marrjen e dëshmive nga një numër i madh dëshmitarësh. Shumë dëshmitarë përmendën frikën si arsye parësore pse nuk dëshironin të paraqiteshin para Dhomës Gjyqësore për të dëshmuar. Dhoma Gjyqësore fitoi përshtypje të fortë se procesi po zhvillohej në një atmosferë ku dëshmitarët ndiheshin të pasigurtë. Shkak ishin një sërë faktorësh specifike për Kosovën, për shembull bashkësitë e vogla të Kosovës, lidhjet e ngushta familjare dhe fisnore që e bënë të vështirë ruajtjen e anonimitetit.² Palët vetë ishin dakord se në Kosovë ekzistonte një gjendje sigurie e paqëndrueshme e cila ishte veçanërisht e dëmshme për dëshmitarët.³ Duke marrë parasysh këto rrethana, Dhoma Gjyqësore shfrytëzoi të tërë kompetencat e saj sipas Rregullores për të siguruar kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit si dhe mbrojtjen dhe mirëqenien e dëshmitarëve të paraqitur.

¹ Në origjinalin anglisht të këtij Aktgjykimi, toponimet e Kosovës jepen në BKS (gjuha bosnjake/kroate/serbe) dhe në shqip.

² *Shih* Vendimin mbi Mocionin në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 20 korrik 2007.

³ T. 3955-3956.

2. Çështje të Provave

2.1 Burimet dhe përdorimi i provave

7. Sipas Nenit 21 (3) të Statutit, të Akuzuarit kanë të drejtën që të konsiderohen të pafajshëm. Sipas Rregullës 87 (A) të Rregullores, standardi për përcaktimin e fajësisë është vërtetimi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Rrjedhimisht, çdo element i shkeljeve për të cilat akuzohet i akuzuari, duhet të vërtetohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Detyrimi i vërtetimit qëndron gjatë gjithë procesit në anën e Prokurorisë.⁴ I akuzuari duhet të shpallet i pafajshëm nëse ekziston ndonjë interpretim i arsyeshëm i provave i ndryshëm prej fajësisë së të akuzuarit.⁵

8. Burimet e provave në këtë çështje përfshinë dëshmitë *viva voce* të dëshmitarëve faktualë dhe dëshmitarëve ekspertë të cilët u paraqitën para Dhomës Gjyqësore dhe u thirrën nga Prokuroria, ose në një rast nga Dhoma Gjyqësore,⁶ deklaratat me shkrim të dëshmitarëve të pranuar sipas Rregullave 92 *bis*, 92 *ter* dhe 92 *quater* të Rregullores, përfshirë transkriptet e dëshmive të dëshmitarëve të cilët u dëgjuan nga Dhoma të tjera Gjyqësore të këtij Tribunali, fakte të pranuar, dhe dokumenta, si raporte të zhvarrimit, urdhëresa, fotografi dhe harta të dorëzuara dhe të pranuar si prova materiale në lidhje me dëshmitë e dëshmitarëve ose të pranuar drejtpërsëdrejti sipas Rregullës 89 (C) të Rregullores.⁷

9. Sipas Rregullës 89 (C), një palë e cila paraqet prova duhet të tregojë se prova është relevante dhe ka vlerë provuese. Në përgjithësi, besueshmëria e provave është një faktor në lidhje me rëndësinë sesa me pranueshmërinë.

10. Dhoma Gjyqësore ka pranuar prova të dorëzuara sipas Rregullës 92 *ter* në lidhje me 38 dëshmitarë, nga gjithsej 81 dëshmitarësh *viva voce*. Dhoma Gjyqësore ka pranuar gjithashtu provat e 16 dëshmitarëve sipas Rregullës 92 *bis*. Rregulla 92 *ter* lejon pranimin e provave të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e veprimeve dhe të sjelljes të të akuzuarit.⁸ Mirëpo Dhoma Gjyqësore shprehu një parapëlqim të dukshëm që prova të tilla, së bashku me provat parësore dhe të domosdoshme për çështjen, të nxirren gojarisht prej dëshmitarit në sallën e gjyqit.⁹ Rregulla 92 *quater* lejon gjithashtu pranimin e provave të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e veprimeve dhe të sjelljes të të akuzuarit,

⁴ Aktgjykimi *Bërgjanin*, paragrafi 22.

⁵ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 458.

⁶ Dhoma Gjyqësore thirri një dëshmitar, Maklen Mishën, gjatë pyetjeve të Prokurorisë. Mbrojtja nuk thirri asnjë dëshmitar.

⁷ Shih Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Paraqitjen e Dokumentave në lidhje me Listën e saj të Provave Materiale sipas Rregullës 65 *ter*, 30 nëntor 2007.

⁸ Rregulla 92 *ter* (B).

⁹ T. 5085; Decision on the Admission of Zoran Stijović's Rule 92 *ter* Statement and Its Annexes, 29 November 2007, para. 11/Vendim për Pranimin e Deklaratës së Zoran Stijovićit sipas Rregullës 92 *ter* me Shtojcat, 29 nëntor 2007, paragrafi 11.

megjithëse kjo mund të jetë një faktor kundër pranimit të tyre.¹⁰ Në bazë të kësaj rregulle Dhoma Gjyqësore pranoi deklaratat e dy dëshmitarëve të vdekur.¹¹ Për sa u përket pjesave të deklaratave të cilat kishin të bënin me veprime dhe sjellje të një të Akuzuari apo të cilat ishin parësore për argumentin e Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore vendosi t'i pranonte vetëm nëse ishte e bindur se ishin të besueshme.¹² Në vlerësimin e saj, Dhoma Gjyqësore mori parasysh nëse deklaratat u konfirmuan nga prova të tjera dhe nëse deklaratat qëndronin në vetëvete.¹³

11. Për sa i përket pranimit të provave dokumentare, Dhoma Gjyqësore theksoi se ishte punë e Prokurorisë që të zgjidhte me kujdes provat për t'ia paraqitur Dhomës Gjyqësore në mënyrë sa më të kuptueshme dhe efikase.¹⁴ Kur tashmë ishin pranuar provat më të mira për një çështje, pati raste kur Dhoma Gjyqësore nuk pranoi prova përsëritëse të cilësisë më të ulët për të njëjtën çështje.¹⁵

12. Dhoma Gjyqësore shqyrtoi akuzat kundër të Akuzuarve duke u bazuar në të tëra provat e pranuar prej saj në gjyq. Ajo vlerësoi provat në përputhje me Statutin, Rregulloren dhe jurisprudencën e Tribunalit. Kur këto burime nuk ofronin udhëzime, Dhoma Gjyqësore vendosi në lidhje me provat në mënyrën që i shkonte më së miri për shtat një vendimi të drejtë në përputhje me frymën e Statutit dhe parimet e përgjithshme të së drejtës.¹⁶

13. Në vlerësimin e dëshmive të dhëna *viva voce*, Dhoma Gjyqësore mori parasysh sjelljen e dëshmitarëve si edhe rrethanat individuale të çdo dëshmitari, ndër të cilat përfshirjen e tij ose të saj të mundshme në ngjarjet si dhe frikën e vetëfajësimit, marrëdhëniet e dëshmitarit me të Akuzuarit dhe nëse dëshmitari mund të kishte një motiv themelor për të dhënë një rrëfim të caktuar të ngjarjeve. Dhoma Gjyqësore vlerësoi gjithashtu përputhshmërinë e brendshme të dëshmisë të secilit dëshmitar dhe tiparet e tjera të dëshmisë së tij ose të saj, si dhe nëse kishte dëshmi mbështetëse. Provat e paraqitura në këtë çështje lidhen me ngjarjet që ndodhën në vitin 1998, rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk i ka konsideruar si zhvleftësuese për provat, mospërputhjet e vogla midis dëshmive të dëshmitarëve, ose midis dëshmisë së një dëshmitari në gjyq dhe deklaratës së tij të mëparshme, kur në fund të fundit dëshmitarët kanë rrëfyer thelbin e ngjarjes së akuzuar në hollësi të

¹⁰ Rregulla 92 *quater* (B).

¹¹ Decision on Prosecution's Motion for Admission of Evidence pursuant to Rule 92 *quater* and 13th Motion for Trial-Related Protective Measures, 7 September 2007; Decision on Prosecution's Motion to Admit Five Statements of Witness 1 into Evidence Pursuant to Rule 92 *quater* with Confidential Annex, 28 November 2007/Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave sipas Rregullës 92 *quater* dhe Mocioni i Trembëdhjetë për Masa Mbrojtëse lidhur me Procesin Gjyqësor, 7 shtator 2007; Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin si Prova të Pesë Deklaratave të Dëshmitarit 1 sipas Rregullës 92 *quater* me Shtojcë Konfidenciale, 28 nëntor 2007.

¹² Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin si Prova të Pesë Deklaratave të Dëshmitarit 1 sipas Rregullës 92 *quater* me Shtojcë Konfidenciale, 29 nëntor 2007. 28 nëntor 2007, paragrafi 11.

¹³ Po aty, paragrafët 11-20.

¹⁴ Vendim për Pranimin si Prova të Dokumenteve të Dorëzuara gjatë Dhënies së Dëshmisë së Achilleas Pappas, 17 shtator 2007, paragrafi 6.

¹⁵ Vendim për Pranimin si Prova të Dokumenteve të Dorëzuara gjatë Dhënies së Dëshmisë së Bislim Zyrarit, 15 tetor 2007, paragrafi 12; Vendim për Pranimin si Prova të Dokumenteve të Dorëzuara gjatë Dhënies së Dëshmisë së Dëshmitarit 69, 28 nëntor 2007, paragrafi 9; Vendim për Pranimin e Deklaratës së Zoran Stijoviqit sipas Rregullës 92 *ter* me Shtojcat, 29 nëntor 2007, paragrafi 11.

¹⁶ Rregulla 89 (B) e Rregullores.

pranueshme, pa dobësuar aspektet thelbësore të dëshmisë së tyre.¹⁷ Disa dëshmitarë, ish-anëtarë të paleve luftuese, iu shmangën pyetjeve ose nuk kishin përgjigje krejtësisht të vërteta për rolin e tyre në ngjarjet e Kosovës në vitin 1998. Megjithëse e vetëdijshme për këtë Dhoma Gjyqësore i shfrytëzoi herë pas here disa aspekte të dëshmimeve të këtyre dëshmitarëve. Kjo përputhet me jurisprudencën e Tribunalit, sipas së cilës nuk është e paarsyeshme që Dhoma Gjyqësore të pranojë disa pjesë të dëshmisë së dëshmitarit dhe të hedhë poshtë disa të tjera.¹⁸

14. Në disa raste, vetëm një dëshmitar dëshmoi për një ngjarje për të cilën u akuzuan të Akuzuarit. Dhoma e Apelit vendosi se dëshmia e një dëshmitari të vetëm për një çështje faktuale nuk kërkon ligjërisht konfirmim.¹⁹ Në këto raste, Dhoma Gjyqësore tregoi një kujdes të veçantë dhe mori parasysh të gjitha rrethanat me rëndësi për dëshminë e dëshmitarit, përfshirë ndonjë motiv kyç për dëshminë e dëshmitarit dhe faktorë të tjerë të përmendur.

15. Dhoma Gjyqësore vendosi të mos merrte në konsideratë dëshminë e një dëshmitari, Dëshmitari 8. Ajo konkludoi se ky dëshmitar ishte kaq i pabesueshëm se nuk mund të përdorte dëshminë e tij për përfundimet e veta në lidhje me pretendimet e Aktakuzës.²⁰ Siç do të shpjegohet më poshtë, Dhoma Gjyqësore ishte e mendimit se dëshmia e Medin Gashit ishte kryesisht e pabesueshme dhe prandaj pranoi vetëm një pjesë të vogël të saj si të saktë. në aspektin faktual.

16. Gjatë vlerësimit dhe peshimit të dëshmisë së dëshmitarëve ekspertë, Dhoma Gjyqësore mori në konsideratë faktorë si kompetenca profesionale e ekspertit, metodologjia e përdorur, besueshmëria e përfundimeve të bëra në bazë të këtyre faktorëve dhe të provave të tjera, pozita apo pozitat e ekspertit, kufizimet e ekspertizës së çdo dëshmitari dhe rëndësia dhe besueshmëria e dëshmisë së tij ose të saj.

17. Palët dorëzuan mocione të përbashkëta për fakte të pranuar më 26 dhe 30 nëntor 2007, pasi dëgjuan dëshmitarin e fundit të Prokurorisë. Dhoma Gjyqësore i mori parasysh këto fakte të pranuar bashkë me të gjitha provat e tjera të çështjes.

18. Gjatë vlerësimit të provave dokumentare, Dhoma Gjyqësore mori parasysh origjinën e dokumentit, autorin dhe rolin e tij ose të saj në ngjarjet në fjalë, linjën e dorëzimit të dokumentit për aq sa dihej, burimin e informacionit në dokument, dhe nëse informacioni u konfirmua nga dëshmitarët dhe nga dokumentet e tjerë. Dhoma Gjyqësore nuk i konsideroi *a priori* pa vlerë

¹⁷ Shih Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 484-485, 496-498; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, paragrafi 31.

¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, paragrafi 333; Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq dhe Jokiq*, paragrafi 82.

¹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 65; Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, paragrafi 62; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 492; Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, paragrafi 33.

²⁰ Për hollësi të mëtejshme, shih Vendimin Nëse Duhet Rifilluar Dëgjimi i Dëshmisë së Dëshmitarit 8 dhe Thirrja e Dëshmitarit të Dhomës, 20 qershor 2007.

dokumente të panënshkruara, të padatuara apo të pavulosura. Kur Dhoma Gjyqësore ishte e bindur për vërtetësinë e një dokumenti të caktuar, ajo nuk pranoi automatikisht pohimet e bëra në të si pasqyrim të saktë të fakteve. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore mund të pranonte një dokument si provë sepse ai dukej i vërtetë dhe i rëndësishëm për çështjen, por në fund mund të konkludonte se rëndësia e dokumentit në kuadrin e provave në tërësi ishte e paqartë, dhe rrjedhimisht i kushtoi pak ose aspak peshë.²¹ Përgjithësisht, sa më pak të dinte Dhoma Gjyqësore për një dokument, për rrethanat e krijimit dhe të përdorimit të tij, aq më pak peshë i kushtohej dokumentit.²²

19. Përveç dëshmive të drejtpërdrejta, Dhoma Gjyqësore pranoi gjithashtu dëshmi të dorës së dytë dhe prova rrethanore. Gjatë vlerësimit të vlerës provuese të dëshmive të dorës së dytë, Dhoma Gjyqësore mori në konsideratë me kujdes të gjithë treguesit e besueshmërisë, ndër të cilët nëse dëshmia ishte e vërtetë, e besueshme dhe nëse vinte nga një burim i cili e dha vullnetarisht, qoftë i dorës së parë apo më larg, pamundësinë për t'i bërë pyetje dhënësit të deklaratës, dhe rrethanat e lindjes së dëshmisë së dorës së dytë.²³ Në përgjithësi, Dhoma Gjyqësore sqaroi se u dha pak ose aspak rëndësi mendimeve të pashpjeguara apo deklaratave të dorës së dytë të paverifikuara dhe se përsëritja e provave të tilla nuk i përforconte detyrimisht.²⁴ Dhoma Gjyqësore nuk pranoi shumë dokumenta të cilat përfshinin deklarata mbi veprime dhe sjelljen e të Akuzuarve, nga persona të cilët nuk ishin të disponueshëm për t'u pyetur prej Mbrojtjes.²⁵ Këto nuk ishin deklarata të dorëzuara sipas Rregullës 92 *bis*, 92 *ter* ose 92 *quarter* të Rregullores, por dokumenta si për shembull raporte të intervistave të zhvilluara nga policia apo nga shërbimet e zbulimit. Lidhur me këtë, Dhoma Gjyqësore mori prova se disa persona të marrë në pyetje nga policia serbe mund të jenë rrahur.²⁶ Dhoma Gjyqësore dëgjoi gjithashtu dëshmi se RDB-ja merrte informacion prej informatorëve të cilët shpërbleheshin sipas rëndësisë dhe llojit të informacionit të dhënë.²⁷ Motivet e informatorëve ishin paraja, politika, ose ndonjëherë shantazhi i RDB-së.²⁸ Një shembull i dokumentave të papranuara nga Dhoma Gjyqësore ishin dy deklarata të dhëna MPB-së serbe nga Krist dhe Lekë Pervorfi në tetor 1998, për të cilat Prokuroria kërkoi të pranoheshin nëpërmjet Zoran Stijoviqit/ Zoran Stijović/. Ato kishin të bënin me pjesëmarrjen e pretenduar të një dëshmitari në këtë çështje, Pjetër Shala, në zhdukjen e Zdravko Radunoviqit/ Zdravko Radunović/. Zoran Stijoviqi nuk ishte në gjendje të sqaronte rrethanat në të cilat u bënë deklaratat, dhe thjesht

²¹ Vendim për Pranimin si Prova të Dokumenteve të Dorëzuara gjatë Dhënies së Dëshmisë së Bislim Zyrapit, 15 tetor 2007, paragrafi 9;

²² Vendim për Pranimin si Prova të Dokumenteve të Dorëzuara gjatë Dhënies së Dëshmisë së Bislim Zyrapit, 15 tetor 2007, paragrafi 8;

²³ Shih *Prokurori k. Aleksovskit*, Vendim mbi Apelin e Prokurorit për Pranueshmërinë e Provave, 16 shkurt 1999, paragrafi 15.

²⁴ Vendim për Pranimin si Prova të Dokumenteve të Dorëzuara gjatë Dhënies së Dëshmisë së Achilleas Pappas-it, 17 shtator 2007, paragrafi 6;

²⁵ Shih, për shembull, Vendimin për Pranimin si Prova të Dokumenteve të Dorëzuara gjatë Dhënies së Dëshmisë së Dëshmitarit 69, 28 nëntor 2007, paragrafi 13; Vendim për Pranimin e Deklaratës së Zoran Stijoviqit sipas Rregullës 92 *ter* me Shtojcat, 29 nëntor 2007, paragrafi 11.

²⁶ Nebojsa Avramoviq, T. 6626-6627.

²⁷ Zoran Stijoviq, T. 8884, 8891, 8893-8894.

²⁸ Zoran Stijoviq, T. 8884-8886.

konfirmoi se të dy deklaratat iu dhanë MPB-së.²⁹ Pjetër Shala nuk u pyet për zhdukjen e Zdravko Radunoviçit. Për më tepër, Mbrojtja pretendoi dhe Prokuroria pranoi se më vonë Lekë Pervorfi e kishte mohuar të vërtetën e deklaratës, duke shtuar se deklarata nuk u dha me vullnet të lirë.³⁰ Për këto arsye Dhoma Gjyqësore nuk i pranoi duke qenë se gjykoj se dyshimet për sa i përket besueshmërisë së tyre ishin kaq të forta sa që dokumentave u mungonte vlera provuese.³¹

20. Lidhur me provat rrethore, Dhoma Gjyqësore gjykoj se prova të tilla në vetvete mund të ishin të mjaftueshme për një dënim apo vërtetim të fakteve jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.³² Mirëpo, përfundimi i nxjerrë nga provat rrethore duhej të ishte i vetmi përfundim i arsyeshëm.³³

21. Neni 21 (4) (g) i Statutit parashtron se asnjë i akuzuar nuk detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes. Në këtë çështje, të gjithë të Akuzuarit ushtruan të drejtën e tyre për të mos dëshmuar. Prej këtij fakti nuk u nxor asnjë interpretim kundër tyre.

2.2 Vështirësitë e marrjes së dëshmive prej dëshmitarëve

22. Shumë dëshmitarë të Prokurorisë në këtë çështje shprehën frikë për paraqitjen e tyre si dëshmitar para Dhomes Gjyqësore. U miratuan masa mbrojtëse për 34 dëshmitarë të Prokurorisë për fshehjen e identitetit të tyre nga publiku. Kriteri i përdorur nga Dhoma Gjyqësore për miratimin e masave mbrojtëse ishte ekzistenca e rrezikut të bazuar objektivisht për sigurinë apo mirëqenien e dëshmitarit apo të familjes së dëshmitarit nëse zbulohet se dëshmitari kishte dëshmuar para Tribunalit.³⁴ U lëshuan urdhërparaqitje për 18 dëshmitarë të Prokurorisë për të dëshmuar. Arsyeja kryesore e urdhërparaqitjeve ishte se masat mbrojtëse nuk mjaftuan për fashitjen e frikës së dëshmitarëve. Nga dëshmitarët e urdhëruar për paraqitje, 13 sish iu bindën fletëthirrjes dhe u paraqitën para Dhomes Gjyqësore për të dëshmuar. Deklarata e një dëshmitari u pranua me anë të Rregullës 92 *bis*.³⁵ Një prej dëshmitarëve të urdhëruar për paraqitje, Dëshmitari 55, filloi të dëshmonte, por pretendoi se vuante shumë nga stresi dhe nga frika për sigurinë e vetë kështu që nuk mund ta përfundonte dëshminë. Dhoma Gjyqësore pa qartë se dëshmitari nuk ishte me shëndet të

²⁹ T. 9093-9094.

³⁰ Shih Vendimin për Pranimin e Deklaratës së Zoran Stijoviçit sipas Rregullës 92 *ter* me Shtojcat, 29 nëntor 2007, paragrafi 13;

³¹ Vendim për Pranimin e Deklaratës së Zoran Stijoviçit sipas Rregullës 92 *ter* me Shtojcat, 29 nëntor 2007, paragrafi 13;

³² Shih Aktgjykimin e Apelit *Kupreshkiq*, paragrafi 303.

³³ Shih Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 458.

³⁴ Shih për shembull, T. 694-695; Decision on the Admission of a Prosecution Witness Statement under Rule 92 bis and Prosecution's 17th Motion for Protective Measures, 29 October 2007, para. 3; Decision on Prosecution's 30th and 31st Motions for Trial-Related Protective Measures, 6 November 2007, para. 2; Decision on Fourth Batch of 92 bis Witnesses and Protective Measures for One of These Witnesses, 6 November 2007./ Vendim Për Pranimin e Deklaratës së një Dëshmitari të Prokurorisë sipas Rregullës 92 *bis* dhe Mocioni i Shtatëmbëdhjetë i Prokurorisë për Masa Mbrojtëse, 29 tetor 2007, paragrafi 3; Vendim mbi Mocionet 30 dhe 31 të Prokurorisë për Masa Mbrojtëse lidhur me Procesin Gjyqësor, 6 nëntor 2007, paragrafi 2; Vendim për Grupin e Katërt të Dëshmitarëve të Rregullës 92 *bis* dhe Masave Mbrojtëse për Një prej Këtyre Dëshmitarëve, 6 nëntor 2007.

³⁵ Shih Vendimin Për Pranimin e Deklaratës së një Dëshmitari të Prokurorisë sipas Rregullës 92 *bis* dhe Mocionin e Shtatëmbëdhjetë i Prokurorisë për Masa Mbrojtëse, 29 tetor 2007

mirë dhe Seksioni i Viktimave dhe i Dëshmitarëve i Tribunalit e informoi Dhomën Gjyqësore se dëshmitari ishte çuar te mjeku dhe i ishin dhënë mjekime. Në atë kohë, dëshmitari nuk kishte mbaruar dëshminë e tij kështu që nuk u ballafaqua me pyetjet e Mbrojtjes. Dhoma Gjyqësore përfundoi se nuk do të ishte në interes të drejtësisë që të vazhdonte të dëgjonte dëshminë e Dëshmitarit 55.³⁶ Dëshmitari nuk u rithirr dhe dëshmia e tij u përjashtua nga provat.³⁷

23. Dy dëshmitarë të urdhëruar për paraqitje, Ramo Jollaj dhe Dëshmitari 65, deklaruan se nuk ishin të gatshëm të shkonin në Hagë për të dëshmuar për një sërë arsyes personale, familjare dhe të sigurisë. Dëshmitarët jetonin në kushtet ekonomike dhe sociale shumë të vështira në një kamp refugjatësh dhe familjet e tyre vareshin vetëm apo kryesisht prej tyre për mbijetesë dhe siguri. Dhoma Gjyqësore pranoi se disa probleme të shprehura nga dëshmitarët mund të zgjidheshin me anë të masave mbrojtëse, kurse probleme të tjera jo. Dhoma Gjyqësore vendosi se kushtet e përshkruara arsyetonin bindshëm mosgatishmërinë e dëshmitarëve për të udhëtuar në Hagë për të dëshmuar dhe vendosi të dëgjonte dëshminë e këtyre dëshmitarëve me videolidhje.³⁸

24. Pati mosbindje ndaj katër urdhërparaqitjeve të lëshuara nga Dhoma Gjyqësore.³⁹ Ato iu adresuan Naser Likës, Qerim Kuqit, Avni Krasniqit dhe Sadri Selcës. Për sa i përket Qerim Kuqit dhe Sadri Selcës, Dhoma Gjyqësore nuk nxori një urdhëresë si zëvendësuese të aktakuzës dhe nuk e procedoi penalisht çështjen, por ftoi Prokurorinë që të jepte mendimin e vet nëse Prokuroria duhej të ndërmernte hetime për shpërfillje. Për këtë çështje, Dhoma Gjyqësore ishte e mendimit se Prokuroria i kuptonte më mirë rrethanat e dëshmitarëve, ndër të cilat vlerën e dëshmisë së tyre, pasojat e mundshme të mosbindjes së tyre për ardhjen e dëshmitarëve të tjerë të mundshëm, dhe nevojat logjistike të hetimit të shpërfilljes.⁴⁰ Prokuroria rekomandoi për të dy dëshmitarët, që Dhoma Gjyqësore t'i adresonte një urdhër Prokurorisë për hetimin e çështjes për përgatitjen dhe dorëzimin e një aktakuzë për shpërfillje. Ajo rekomandoi gjithashtu që urdhëresa të lëshohej në lidhje me mosbindjen ndaj urdhërparaqitjes prej Avni Krasniqit. Dhoma Gjyqësore pranoi rekomandimet e Prokurorisë dhe udhëzoi Prokurorinë që të hetonte personat në fjalë për përgatitjen

³⁶ T. 9820-9822.

³⁷ T. 10118, 10652, 10655; Reasons for the Trial Chamber's Decision Not to Recall [Witness 55] to Complete His Testimony, 6 November 2007; Reasons for Trial Chamber's Decision to Exclude the Evidence of Witness 55 under Rule 89 (D) and Deny His Testimony Pursuant to Rule 92 quater, 14 December 2007/Arsyet e Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Mosrithirjen e [Dëshmitarit 55] për të Përfunduar Dhënien e Dëshmisë prej tij, 6 nëntor 2007; Arsyet e Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Përjashtimin e Dëshmisë së Dëshmitarit 55 sipas Rregullës 89 (D) dhe për Refuzimin e Dëshmisë së tij sipas Rregullës 92 quater, 14 dhjetor 2007.

³⁸ Vendim mbi Komunikimin me Video për Dëshmitarin 10, 28 gusht 2007; Vendim mbi Komunikimin me Video për Dëshmitarin 48 në Urdhëresën e Përkohshme për Dhënien e Dëshmisë, 28 gusht 2007.

³⁹ Historia e plotë procedurale për Naser Likën, Avni Krasniqin dhe Sadri Selcën jepet në Shtojcën A.

⁴⁰ Invitation to Prosecution to Consider Initiating Contempt Proceedings against Qerim Kuqi, 16 July 2007; Invitation to Prosecution to Consider Initiating Contempt Proceedings against Sadri Selca, 23 August 2007/Ftesë Prokurorisë për Nisjen e Procedimit të Qerim Kuqit për Shpërfillje ndaj Tribunalit, 16 korrik 2007; Ftesë Prokurorisë për Nisjen e Procedimit të Sadri Selcës për Shpërfillje ndaj Tribunalit, 23 gusht 2007. Dhoma Gjyqësore lëshoi ftesa të tillë në lidhje me dy dëshmitarë të tjerë (*shih* Ftesë Prokurorisë për Nisjen e Procedimit të [Dëshmitarit 55] për Shpërfillje ndaj Tribunalit, 20 korrik 2007; Ftesë Prokurorisë për Nisjen e Procedimit të [Dëshmitarit 69] për Shpërfillje ndaj Tribunalit,, 26 shtator 2007.

dhe dorëzimin e një aktakuze për shpërfillje.⁴¹ Më 31 tetor 2007, Qerim Kuqi dëshmoi me videolidhje. Ndaj tij nuk u ngrit aktakuzë për shpërfillje. Për sa u përket Avni Krasniqit dhe Sadri Selcës, Prokuroria paraqiti aktakuza për shpërfilljen e Tribunalit. Dhoma Gjyqësore i konfirmoi akuzat.⁴² Avni Krasniqi dhe Sadri Selca u arrestuan më vonë dhe u transferuan në Hagë. Të dy vendosën të dëshmonin para paraqitjes së tyre në proceset për shpërfillje. Avni Krasniqi dëshmoi më 14-15 nëntor 2007, kurse Sadri Selca dëshmoi më 15 nëntor 2007. Pas dhënies së dëshmive prej tyre, Prokuroria kërkoi leje për tërheqjen e aktakuzave për shpërfillje që u miratua nga Dhoma Gjyqësore e cila kishte trajtuar çështjet e shpërfilljes.⁴³

25. Në lidhje me dëshmitarin e katërt i cili nuk iu bind urdhërparaqitjes, Naser Lika, Dhoma Gjyqësore ndërmori masa të ndryshme për marrjen e dëshmisë së tij. Më 14 shtator 2007, ajo vendosi të dëgjonte dëshmitarin me videolidhje duke qenë se provat për shëndetin e dëshmitarit mbështetën përfundimin se ai nuk ishte në gjendje të udhëtonte në Hagë për të dëshmuar.⁴⁴ Mirëpo, dëshmitari nuk u paraqit para Dhomës Gjyqësore me videolidhje në ditën e caktuar të dëshmisë së tij. Dhoma Gjyqësore caktoi një datë tjetër për seancën, por në ditën në fjalë u informua se dëshmitari ishte shtruar në spital.⁴⁵ Dhoma Gjyqësore nuk mori dëshminë e Naser Likës.

26. U mohuan tri kërkesa të Prokurorisë për urdhërparaqitje. Në rastin e parë, Dhoma Gjyqësore ishte e mendimit se dëshmia që pritej prej dëshmitarit ishte me vlerë të pakët provuese kështu që e hodhi poshtë kërkesën për urdhërparaqitje.⁴⁶ Për Vera Kovačevićin/ Vera Kovačević/, Dhoma Gjyqësore përfundoi se dëshmia që pritej prej saj kishte rëndësi të kufizuar kështu që nuk ishte i nevojshëm lëshimi i urdhërparaqitjes. Mirëpo dëshmia e kësaj dëshmitareje u pranua sipas Rregullës 92 bis.⁴⁷ Kërkesa e tretë e mohuar kishte të bënte me një dëshmitar i cili përjetonte emocione të skajshme lidhur më paraqitjen e tij para Tribunalit. Seksioni i Viktimave dhe i Dëshmitarëve i Tribunalit e paralajmëroi Prokurorinë se ekzistonin rreziqe në shfrytëzimin e këtij personi si dëshmitar pa u bërë vlerësimi në lidhje me kërcënimet dhe vlerësime të tjera. Prokuroria

⁴¹ Urdhër për Hetim Drejtuar Prokurorisë me Synim Përgatitjen dhe Paraqitjen e Aktakuzën për Shpërfillje, 7 shtator 2007; Urdhër sipas Rregullës 77 (C) (i) në lidhje me Dëshmitarin 18, 31 tetor 2007; Urdhër për Hetim Drejtuar Prokurorisë me Synim Përgatitjen dhe Paraqitjen e Aktakuzën për Shpërfillje,, 31 tetor 2007.

⁴² Vendim për Shqyrtimin e Aktakuzës, 5 nëntor 2007; Vendim për Shqyrtimin e Aktakuzës, 7 nëntor 2007; Shfuqizimi i Konfidencialitetit, 9 nëntor 2007; Urdhëresë për Shfuqizimin e Konfidencialitetit, 13 nëntor 2007.

⁴³ T. 10850, 10891; Decision Granting the Prosecution's Application to Withdraw an Indictment for Contempt against Avni Krasniqi, 5 December 2007; Decision Granting the Prosecution's Application to Withdraw an Indictment for Contempt against Sadri Selca, 5 December 2007/Vendim që Miraton Kërkesën e Prokurorisë për Tërheqjen e Aktakuzën kundër Avni Krasniqit për Shpërfillje të Tribunalit, 5 dhjetor 2007; Vendim që Miraton Kërkesën e Prokurorisë për Tërheqjen e Aktakuzën kundër Sadri Selcës për Shpërfillje të Tribunalit,, 5 dhjetor 2007.

⁴⁴ Vendim mbi Mocionin për Videolidhje (Dëshmitari 30), 14 shtator 2007.

⁴⁵ T. 10621-10647, 10975.

⁴⁶ T. 4766-4767.

⁴⁷ Decision Denying Subpoena ad Testificandum for Witness 15 and Instead Conditionally Admitting the Witness's Statements Pursuant to Rule 92 bis, 2 November 2007/Vendim që Refuzon Lëshimin e një Urdhërparaqitjeje për të dëshmuar për Dëshmitaren 15 dhe që Pranon me Kushte, Deklaratat e Dëshmitares të Rregullës 92 bis, 2 nëntor 2007.

nuk kishte ndërmarrë hapa për kryerjen e vlerësimeve të tilla. Në këto rrethana, Dhoma Gjyqësore përfundoi se do të ishte pamatur i të detyronte dëshmitarin që të dëshmonte.⁴⁸

27. Dy dëshmitarë erdhën në Tribunal pa urdhërparaqitje, por ata refuzuan kërkesën për të dëshmuar. Një dëshmitar refuzoi të hynte në sallën e gjyqit. Pasi dëgjoi mendimin e përfaqësuesit të Seksionit të Viktimave dhe të Dëshmitarëve të Tribunalit, Dhoma Gjyqësore vendosi të mos vazhdonte me atë. Prokuroria e informoi Dhomën Gjyqësore se dëshmitari ishte praktikisht i përjashtuar nga lista e dëshmitarëve nëse nuk ndryshonte mendimin për të dëshmuar.⁴⁹ Një dëshmitar tjetër, Shefqet Kabashi, hyri në sallën e gjyqit. Pas konfirmimit të të dhënave personale të tij, ai refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve të Prokurorisë dhe të Dhomës Gjyqësore mbi thelbin e çështjes.⁵⁰ Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore lëshoi një Urdhëresë në Vend të Aktakuzës për Shpërfilljen e Tribunalit.⁵¹ Mirëpo para fillimit të procesit të tij për shpërfillje, Kabashi u largua prej Holandës dhe u kthye në vendbanimin e tij në Shtetet e Bashkuara. Dhoma Gjyqësore konsideroi dhe ndërmori hapa të ndryshme për marrjen e dëshmisë së tij.⁵² Më 1 nëntor 2007, Dhoma Gjyqësore vendosi të dëgjonte Shefqet Kabashin me videolidhje.⁵³ Më 20 nëntor 2007, dëshmitari refuzoi sërish që të dëshmonte. Më 18 shkurt 2008, Dhoma Gjyqësore miratoi lejen që Prokuroria të ndryshonte aktakuzën kundër Kabashit dhe urdhëroi Prokurorinë që të shpallte aktakuzën.⁵⁴ Çështja e shpërfilljes së Tribunalit kundër Shefqet Kabashit mbetet ende e hapur deri në arrestimin dhe transferimin e tij në Hagë.

28. Vështirësia në marrjen e dëshmimeve ishte një karakteristikë e dukshme e këtij procesi dhe disa dëshmitarë të cilët do të dëshmonin për aspekte thelbësore të çështjes, nuk dëshmuuan kurrë. Siç u përshkrua më lart, Dhoma Gjyqësore ushtroi tërë kompetencat e saj sipas Rregullores për të lehtësuar pranimin e provave, pa tejkuluar rolin e saj si gjyqësore asnjëherë e fakteve. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore mori dëshmi prej më shumë se 90 dëshmitarëve.

2.3 Provat identifikuese

29. Në disa raste, për të vërtetuar praninë e një të akuzuarit në një vend dhe një kohë të caktuar, Dhomës Gjyqësore iu desh të shfrytëzonte dëshminë identifikuese të një dëshmitari të vetëm.

⁴⁸ Decision on Prosecution's Motion to Have Witness 25 Subpoenaed to Testify, 30 October 2007/Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Lëshimin e një Urdhërparaqitjeje për të dëshmuar, për Dëshmitarin 25, 30 tetor 2007.

⁴⁹ T. 1810-1820.

⁵⁰ Historia e plote procedurale jepet në Shtojcën A.

⁵¹ Urdhër në Vend të Aktakuzës për Shpërfillje në Lidhje me Shefqet Kabashin, 5 qershor 2007.

⁵² *Shih* për një shpjegim T. 10977; Vendim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Leje për Apelimin e Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Shefqet Kabashin, 5 dhjetor 2007; Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Rihapjen e Procedimit të Çështjes së saj për Dëgjimin e Dëshmisë së Shefqet Kabashit dhe për Përfaqësim Juridik të Autoriteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, 21 dhjetor 2007.

⁵³ T. 10118.

Dhoma Gjyqësore kupton se provat identifikuese përfshijnë provat e identifikimit *stricto sensu* edhe provat e njohjes dhe ishte e vëmendshme në lidhje me dallimin midis tyre. Dëshmia identifikuese *stricto sensu* është identifikimi, në vendin dhe në kohën në fjalë, i një personi të cilin dëshmitari nuk e kishte njohur përpara. Provat e njohjes kanë të bëjnë me praninë, në vendin dhe në kohën në fjalë, të një personi të cilin dëshmitari e ka njohur më parë. Në të dy rastet, provat identifikuese duhet të trajtohen me kujdes sepse cilësia e tyre mund të varet nga shumë faktorë, ndër të cilët edhe pasaktësitë e perceptimit njerëzor dhe të kujtesës njerëzore. Dhoma Gjyqësore i ka vlerësuar me kujdes provat identifikuese, veçanërisht në rastin kur ishte e vetmja provë ose provë thelbësore për një ngjarje të përfshirë në një pikë të aktakuzës.⁵⁵ Në vlerësimin e saj, Dhoma Gjyqësore mori në konsideratë udhëzimet e Dhomës së Apelit në çështjen *Kupreshkiq dhe të tjerë/ Kupreškić et al.* Dhoma e Apelit nënvizoi disa faktorë për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit të provave identifikuese, si për shembull identifikimi nga dëshmitarët të cilët e kanë parë të akuzuarin shkarazi ose me një pamje të penguar; identifikimi në terr; identifikimi si pasojë e një ngjarjeje traumatike të përjetuar nga dëshmitari; dëshmia e pasaktë apo mospërputhëse në lidhje me tiparet fizike të të akuzuarit në kohën e ngjarjes; dhe kthimi i vonuar i kujtesës së dëshmitarit në lidhje me të akuzuarin bashkë me mundësinë e qartë prej rrethanave të ndikimit të sugjerimeve të të tjerëve ndaj dëshmitarit.⁵⁶ Kur u ballafaqua me provat e njohjes dhe jo me provat identifikuese *stricto sensu*, Dhoma Gjyqësore mori gjithashtu në konsideratë mundësinë e paragjykit, si dhe hapësirën kohore midis momentit kur dëshmitari e njohu personin dhe momentit kur e kishte parë për herë të fundit.

30. Disa herë, Prokuroria përdori fotokolazhë/tabela me fotografi si mjet për marrjen e provave identifikuese. Në përgjithësi, Dhoma Gjyqësore është e bindur se fotokolazhët u krijuan për të mos ndikuar dëshmitarë të cilëve iu treguan. Kjo u arrit nëpërmjet paraqitjes së fotografive të madhësive dhe të ngjyrave të ngjashme, të ndriçimit të ngjashëm të sfondit, dhe me individë të cilët u ngjanin të Akuzuarve.⁵⁷

31. Prokuroria ka lëshuar udhëzime për procedurën e identifikimit me fotokolazhë.⁵⁸ Provat tregojnë se udhëzimet shpesh nuk u respektuan. Për shembull, në disa raste, hetuesit e Prokurorisë harruan të pyesnin përpara nëse dëshmitari e kishte parë të dyshuarin në televizion apo në gazeta, ose nëse kujtesa e dëshmitarit mund të ishte ndikuar nga dëshmitarët e ndryshëm të cilët

⁵⁴ Vendim që Miraton Lejen për Ndryshimin e Aktakuzës, 18 janar 2008.

⁵⁵ Shih Aktgjykimin e Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, paragrafi 34.

⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kupreshkiq dhe të tjerë*, paragrafi 40; Aktgjykimi i Apelit *Limaj dhe të tjerë*, paragrafi 30.

⁵⁷ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5864-5865, 5909-5912; P375 (Pekka Haverinen, deklarata e dëshmitarit, 26 qershor 2007), paragrafi 3; Pekka Haverinen, T. 6314-6325, 6326-6327, 6251. Shih edhe D119 (TPNJ, Zyra e Prokurorisë, Udhëzime për identifikime me fotokolazhë, procedura fotografike).

⁵⁸ D119 (TPNJ, Zyra e Prokurorisë, Udhëzime për identifikime me fotokolazhë, procedura fotografike); D120 (TPNJ, Zyra e Prokurorisë, Raporti i identifikimit me fotokolazhë).

komunikonin me njëri tjetrin.⁵⁹ Në disa raste, dëshmitari nuk u informua nëse në fotokolazh përfshiheshin ose nuk përfshiheshin të Akuzuarit.⁶⁰ Përgjigjet fizike të dëshmitarit herë pas here nuk u shënuan nga hetuesit.⁶¹ Gjatë vlerësimit të rëndësisë së provave të tyre, Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se identifikimet me fotokolazhë shpesh nuk u kryen në përputhje të plotë me udhëzimet.

⁵⁹ Pekka Haverinen, T. 6327-6328, 6333-6334, 6351.

⁶⁰ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5948-5949; D120 (TPNJ, Zyra e Prokurorisë, Raporti i identifikimit me fotokolazhë), f. 1.

⁶¹ Pekka Haverinen, T. 6330; Barney Kelly T. 6101-6102.

3. Elemente të përgjithshme për Nenin 3 të Statutit

3.1 Ligji mbi elemente të përgjithshme

32. Aktakuza i ngarkon të Akuzuarit me 19 akuza për shkelje të ligjeve apo të zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit, prej të cilave 18 bazohen në Nenin e Përbashkët 3 të katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (“Neni i Përbashkët 3”).⁶² Neni 3 i Statutit përcakton: “Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të ndjekë penalisht persona që shkelin ligjet ose zakonet e luftës.” Më poshtë analizohen kushtet e jurisdiksionit dhe elemente të përgjithshme.

33. Neni 3 i Statutit është “klauzolë e mbetur” i cili i jep Tribunalit jurisdiksion mbi çdo shkelje të rëndë të së drejtës humanitare ndërkombëtare e cila nuk mbulohet nga Nenet 2, 4 apo 5 të Statutit.⁶³ Që të jetë brenda jurisdiksionit të mbetur, shkelja duhet të përmbushë katër kritere: (i) duhet të shkelë një rregullë të së drejtës humanitare ndërkombëtare, (ii) rregulla duhet të jetë detyruese për palët në kohën e shkeljes së pretenduar; (iii) rregulla duhet të mbrojë vlera të rëndësishme dhe shkelja e saj duhet të ketë pasojë të rënda për viktimën; dhe (iv) shkelja duhet të nënkuptojë përgjegjësinë penale të kryesit.⁶⁴

34. Në jurisprudencën e këtij Tribunali është provuar gjerësisht se shkeljet e Nenit të Përbashkët 3 trajtohen në kuadrin e Nenit 3 të Statutit.⁶⁵ Në këtë çështje, akuzat për vrasje, trajtim mizor, dhe tortura si shkelje të ligjeve ose të zakoneve të luftës, bazohen në Nenin e Përbashkët 3 (1) (a). Akuzat për sulme mbi dinjitetin personal bazohen në Nenin e Përbashkët 3 (1) (c). Të gjitha këto akuza përmbushin katër kushtet e jurisdiksionit të përcaktuara më lart. Rregullat e Nenit të Përbashkët 3 janë pjesë të së drejtës zakonore ndërkombëtare, e zbatueshme në konflikte të armatosura jondërkombëtare.⁶⁶ Krimet e ndaluara prej Nenit të Përbashkët 3 shkelin padyshim rregulla të cilat mbrojnë vlera të rëndësishme dhe kanë pasojë të rënda për viktimat. Ato përfshijnë edhe përgjegjësinë penale individuale.⁶⁷ Rrjedhimisht, Dhoma ka juridiksion mbi shkelje të tilla.

⁶² Pikat 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20, 22, 24, 26, 28, 30, 32, 34, 36 dhe 37 të Aktakuzës i akuzojnë të Akuzuarit për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës sipas Nenit 3 të Statutit; vetëm Pika 36 nuk bazohet mbi Nenin e Përbashkët 3.

⁶³ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafët 89-93; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 125, 131, 133.

⁶⁴ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafët 94, 143.

⁶⁵ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafi 89; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 125, 133-136; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 68.

⁶⁶ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafët 89, 98; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 138-139, 147.

⁶⁷ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafi 134; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 173-174.

35. Neni 3 i Statutit përfshin edhe rregulla të tjera të së drejtës zakonore ndërkombëtare në konflikte të armatosura jondërkombëtare.⁶⁸ Një rregullë e tillë arsyeton akuzën e përdhunimit në Pikën 36 të Aktakuzës. Dhoma e Apelit ka përcaktuar se përdhunimi përbën krim lufte sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare, e zbatueshme në konflikte të armatosura jondërkombëtare, dhe përfshihet në Nenin 3 të Statutit.⁶⁹

36. Pasi vërtetohet jurisdiksioni, ekzistojnë tre kushte që duhet të përmbushen për zbatueshmërinë e Nenit 3 të Statutit: së pari, duhet të ekzistojë një konflikt i armatosur; së dyti, duhet të ketë një lidhje midis shkeljes së pretenduar dhe konfliktit të armatosur,⁷⁰ dhe së treti, për akuzat e bazuara në Nenin e Përbashkët 3, viktimat nuk duhet të marrë pjesë aktivisht në luftime në kohën e shkeljes së pretenduar.⁷¹

37. *Konflikti i armatosur*. Kushti për të vërtetuar praninë e një konflikti të armatosur u përcaktua nga Dhoma e Apelit në Vendimin e Jurisdiksionit *Tadiq*:

[K]onflikt i armatosur ekziston sa herë që përdoret forca e armatosura midis shteteve ose dhunë e armatosur e zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti. E drejta humanitare ndërkombëtare zbatohet që prej fillimit të konfliktit të armatosur dhe vazhdon përtej mbarimit të luftimeve deri në arrijtjen e përgjithshme të paqes, ose, në rast konfliktesh të brendshme, deri në momentin kur arrihet një zgjidhje paqësore. Deri në atë moment, e drejta humanitare ndërkombëtare vazhdon të zbatohet në tërë territorin e palëve luftuese, ose në rast konfliktesh të brendshme, në tërë territorin nën kontrollin e një pale, pavarësisht nëse aty zhvillohen ose nuk zhvillohen luftime të vërteta.⁷²

38. Ky kusht shërben për të dalluar konfliktin e armatosur jondërkombëtar nga banditëria, trazirat, aktet e veçuara të terrorizmit, dhe situata të ngjashme.⁷³ Dhoma Gjyqësore duhet të përcaktojë nëse (i) dhuna e armatosur është e zgjatur dhe (ii) palet në konflikt janë të organizuara. Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë interpretimin e këtyre kritereve në çështje të mëparshme të Tribunalit.

⁶⁸ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafi 89; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafët 125, 133.

⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafët 187-195.

⁷⁰ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafi 70; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 55; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, paragrafi 342.

⁷¹ Neni i Përbashkët 3 (1); Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 420; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Krajishnik*, paragrafi 847.

⁷² Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafi 70; Shih edhe Aktgjykimin e Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafët 56-57; Aktgjykimin e Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafët 319, 336.

⁷³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 341; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 562; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafi 184; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 84, 89. Shih edhe Nenin 8 (2) (d) dhe (f) të Statutit të Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

39. Së pari, Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë praktikën e interpretimit të kriterit të “dhunës së armatosur të zgjatur”.

40. Në çështjen *Tadiq (Tadić)*, gjatë zbatimit të kushtit të vet, Dhoma e Apelit përfundoi se luftimet midis njësive të ndryshme të ish-Jugosllavisë që prej 1991 tejkaluan “kushtin e ashpërsisë” që zbatohet për konfliktin e armatosur.⁷⁴ Si pasojë, Dhoma Gjyqësore interpretoi togfjalëshin “dhunë e armatosur e zgjatur” për t’iu referuar “ashpërsisë së konfliktit”.⁷⁵ Ajo trajtoi çështjen nëse ekzistonte një konflikt i armatosur në Bosnje-Hercegovinë midis Qeverisë së Bosnje-Hercegovinës dhe forcave serbe bosnjake gjatë periudhës së Aktakuzës, prej 23 majit 1992 deri më 31 dhjetor 1992.⁷⁶ Më 23 maj 1992, forcat e armatosura serbe bosnjake sulmuan fshatin Hambarine, duke e granatuar për disa orë dhe pastaj duke hynë në zonë të mbështetur me tanke. Më pas ndodhën luftime të shkurtra të herëpashershme.⁷⁷ Shumë banorë ikën.⁷⁸ Më 24 maj 1992, forcat serbe bosnjake sulmuan qytetin e Kozaracit dhe fshatrat përreth.⁷⁹ Sulmi filloi me një granatim të rëndë i cili zgjati deri më 26 maj 1992, dhe pas kësaj hynë tanket dhe këmbësoria.⁸⁰ Deri më 28 maj 1992, ishin shkatërruar shumë banesa.⁸¹ Në sulmin e Kozaracit u vranë rreth 800 njerëz dhe u kapën 1,200; ndër sulmuesit u vranë katër dhe u plagosën pesëmbëdhjetë ushtarë.⁸² Këmbësoria serbe bosnjake detyroi banorët civilë që të braktisnin qytetin dhe fshatrat përreth.⁸³ Më 14 qershor 1992, serbë bosnjakë të armatosur sulmuan dy fshatra të tjera me pasoja të ngjashme.⁸⁴ Kozaraci u plaçkit dhe u shkatërrua sërish midis qershorit dhe gushtit 1992.⁸⁵ Dhoma Gjyqësore përfundoi se luftimet midis palëve vazhduan anembanë Bosnje-Hercegovinës deri në arritjen e marrëveshjes së paqes së Dejtonit (Dayton).⁸⁶ Dhoma Gjyqësore e konsideroi përfshirjen e vazhdueshme të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si tregues të ashpërsisë së konfliktit.⁸⁷ Dhoma Gjyqësore përfundoi se kushti i ashpërsisë ishte plotësuar.⁸⁸

41. Në çështjen *Çelebiqi (Čelebići)*, Dhoma Gjyqësore zbatoi kushtin *Tadiq* për të përcaktuar ekzistencën e konfliktit të armatosur në Bosnje-Hercegovinë i cili i përfshiu APJ-në, TO-në boshnjake, MPB-në bosnjake, Këshillin Kroat të Mbrojtjes, dhe ushtrinë serbe bosnjake, midis

⁷⁴ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafi 70.

⁷⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 562.

⁷⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 560, 563; Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë *Tadiq*, 14 dhjetor 1995, paragrafi 1.

⁷⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 140.

⁷⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 141.

⁷⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 143, 565.

⁸⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 143, 565.

⁸¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 143, 565.

⁸² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 143, 565.

⁸³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 143, 146, 565.

⁸⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 565.

⁸⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 143, 146.

⁸⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 566.

⁸⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 567.

⁸⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 568.

majit dhe dhjetorit 1992.⁸⁹ Ajo konkludoi se në tërë Bosnje-Hercegovinën kishte patur dhunë të armatosur të vazhduar, të paktën nga data e shpalljes së pavarësisë – 6 mars 1992 – deri në nënshkrimin e marrëveshjes së paqes të Dejtonit, në nëntor 1995.⁹⁰ Forcat serbe sulmuan dhe granatuan shumë fshatra në komunën e Konjicit(Konjic), kurse TO-ja bosnjake, MPB-ja bosnjake dhe Këshilli Kroat i Mbrojtjes filluan operacione ushtarake kundër fshatrave të tjera.⁹¹ Granatimi i qytetit të Konjicit, i cili filloi më 4 maj 1992, vazhdoi ditë për ditë për tre vjet, duke shkaktuar dëm të konsiderueshëm dhe duke rezultuar në shumë të vdekur.⁹² Konflikti detyroi shumë njerëz të braktisnin shëpitë e tyre.⁹³ Dhoma Gjyqësore përfundoi se luftimet në Bosnje-Hercegovinë në tërësi, si dhe në Konjic në veçanti, ishin “padyshim të ashpra” dhe si pasojë tërhoqën vëmendjen e organizatave ndërkombëtare, përfshirë Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, e cili veprimi sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.⁹⁴ Rrjedhimisht, ashpërsia e konfliktit e përmbushte kushtin *Tadiq*.⁹⁵

42. Në çështjen e Slobodan Millosheviqit (*Slobodan Milošević*), Dhoma Gjyqësore duhej të përcaktonte nëse ekzistonin prova të mjaftueshme, sipas Rregullës 98 *bis*, për një konflikt të armatosur në Kosovë midis 1 janarit 1999, data e fillimit të periudhës përkatëse të aktakuzës, dhe 24 marsi 1999, kur filloi fushata e bombardimit të NATO-s.⁹⁶ Duke shfrytëzuar kriterin *Tadiq* të “dhunës së armatosur të zgjatur“, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi “ashpërsinë” e konfliktit.⁹⁷ Së pari, duke marrë parasysh periudhën para aktakuzës, Dhoma Gjyqësore përfundoi se UÇK-ja ndërmoi shumë operacione kundër policisë gjatë viteve 1996 dhe 1997 dhe në vitin 1997 vrau rreth 20 persona të cilët kishin punuar për policinë apo kishin bashkëpunuar me të.⁹⁸ UÇK-ja ishte e pajisur me pushkë dhe mortaja, dhe deri në mars 1997 kishte marrë shumë armë nga Shqipëria.⁹⁹ Dhoma Gjyqësore konstatoi një “ofensivë të gjerë” të forcave serbe më 23 gusht 1998 kundër disa fshatrave, disa përleshje të armatosura në periudhën prej vitit 1998 deri në mars 1999, dhe një “sulm masiv” të forcave serbe rreth datës 10 janar 1999 kundër shumë fshatrave, të cilat u granatuan rëndë për dy ditë.¹⁰⁰ Dhoma gjithashtu konstatoi një ofensivë të madhe serbe midis 24 shtatorit 1998 dhe 4 tetorit 1998, e cila përfshiu forca serbe “masive” dhe grupe të veçanta ushtarake dhe paraushtarake.¹⁰¹ Pati përleshje në shumë komuna anembanë Kosovës.¹⁰² Dhoma

⁸⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafët 182-187; Aktakuza Fillestare *Çelebiqi*, 21 mars 1996, paragrafi 2.

⁹⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafi 186.

⁹¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafët 134, 138-139, 189.

⁹² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafi 134.

⁹³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafët 129-130, 133, 139.

⁹⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafi 190.

⁹⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafi 192.

⁹⁶ Vendimi i Rregullës 98 *bis* *Slobodan Millosheviq*, paragrafët 14, 22; Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë (për Kosovën) *Slobodan Millosheviq*, 29 tetor 2001, paragrafët 17, 53.

⁹⁷ Vendimi i Rregullës 98 *bis* *Slobodan Millosheviq*, paragrafi 17.

⁹⁸ Vendimi i Rregullës 98 *bis* *Slobodan Millosheviq*, paragrafi 28.

⁹⁹ Vendimi i Rregullës 98 *bis* *Slobodan Millosheviq*, paragrafi 31.

¹⁰⁰ Vendimi i Rregullës 98 *bis* *Slobodan Millosheviq*, paragrafi 28.

¹⁰¹ Vendimi i Rregullës 98 *bis* *Slobodan Millosheviq*, paragrafi 30.

Gjyqësore u bind se konflikti në Kosovë gjatë periudhës së përkthuar më lart përmbushi pjesën e kushtit *Tadiq* për ashpërsinë sipas Rregullës 98 bis.¹⁰³

43. Në çështjen *Kordiq dhe Çerkez (Kordić and Čerkez)*, për të cilën periudha e aktakuzës ishte nga nëntori 1991 deri në mars 1994, Dhoma e Apelit duhej të përcaktonte një arsye për apelim, sipas së cilës Dhoma Gjyqësore nuk kishte arritur në një përfundim faktual se para 15 prilli 1993 në Bosnjen qendrore kishte patur dhunë të armatosur të zgjatur midis Këshillit Kroat të Mbrojtjes dhe Ushtrisë Bosnjake.¹⁰⁴ Dhoma e Apelit vuri re se Këshilli Kroat i Mbrojtjes kishte hasur “kundërshtim të dukshëm” kur pushtoi qytetet e Novi Travnikut (Novi Travnik) dhe të Ahmiqit (Ahmići) në tetor 1992.¹⁰⁵ Gjatë javës së luftimeve në Novi Travnik, u dogjën dhe u shkatërruan ndërtesa civile.¹⁰⁶ Në janar 1993, Këshilli Kroat i Mbrojtjes sulmoi pjesën muslimane të qytetit të Busovaçës (Busovača), ndaj të cili u hap zjarr nga kodrat përreth, duke shkaktuar të paktën 27 të vdekur.¹⁰⁷ Luftimet u përhapën në tërë komunën, me pasojë shkatërrimin e ndërtesave të një fshati dhe evakuimin e popullatës së tij.¹⁰⁸ Luftimet në komunën e Busovaçës zgjatën të paktën tri ditë.¹⁰⁹ Duke konstatuar “luftime të rënda për një kohë të gjatë” që prej tetorit 1992, Dhoma e Apelit konfirmoi përfundimin e Dhomës Gjyqësore se konflikti i armatosur kishte ekzistuar para prillit 1993.¹¹⁰

44. Në çështjen *Halilović (Halilović)*, Dhoma Gjyqësore e zbatoi kushtin *Tadiq* për të vërtetuar nëse kishte patur një konflikt të armatosur midis Këshillit Kroat të Mbrojtjes, Ushtrisë Bosnjake dhe ushtrisë serbe bosnjake në territorin e Bosnje-Hercegovinës midis 8-14 shtatorit 1993.¹¹¹ Dhoma Gjyqësore shqyrtoi fakte në lidhje me ashpërsinë në zona të ndryshme të Bosnje-Hercegovinës. Ajo mori parasysh shumë përleshje të armatosura në pranverë dhe në verë të vitit 1993,¹¹² disa me granatime të rënda të qyteteve dhe me viktima civile,¹¹³ dhe me prerjen efektive të linjave të komunikimit ose të transportit.¹¹⁴ Gjithashtu u morën në konsideratë bllokada apo rrethime të qyteteve për muaj të tërë,¹¹⁵ dislokimi i dhjetra mijëra trupave,¹¹⁶ si dhe lëvizja e vijave të frontit.¹¹⁷

¹⁰² Vendimi i Rregullës 98 bis *Slobodan Millosheviq*, paragrafi 29.

¹⁰³ Vendimi i Rregullës 98 bis *Slobodan Millosheviq*, paragrafët 17, 27, 32-40.

¹⁰⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 334.

¹⁰⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 338.

¹⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafët 337-338.

¹⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 339.

¹⁰⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 340.

¹⁰⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafët 339-340.

¹¹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafët 336, 341.

¹¹¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 6, 8, 24, 160, 173.

¹¹² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 161, 163-166, 169.

¹¹³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 164-165, 168.

¹¹⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 164-165.

¹¹⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 166-168.

¹¹⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafi 168.

¹¹⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 161-162, 164-165, 169, 172.

Dhoma Gjyqësore përfundoi se ashpërsia e konfliktit ishte e mjaftueshme për përmbushjen e kushtit *Tadiq* dhe se në kohën në fjalë ekzistonte një konflikt i armatosur.¹¹⁸

45. Në çështjen *Limaj dhe të tjerë*, Dhomës Gjyqësore iu desh të shqyrtonte nëse nga maji 1998 deri në gusht 1998 ekzistoi në Kosovë një konflikt i armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së.¹¹⁹ Duke zbatuar kërkesën e “dhunës së armatosur të zgjatur” të kushtit *Tadiq*, Dhoma Gjyqësore mori në shqyrtim ashpërsinë e konfliktit.¹²⁰ Përfundimi i saj ishte se, prej fillimit të marsit deri në korrik 1998, në një zonë të gjerë gjeografike të Kosovës, kishte patur përleshje të shumta, operacione luftarake dhe ofensiva të mëdha me sulme kundër fshatrave dhe stacioneve të policisë, duke shkaktuar dhjetra viktima, me automjete të rënda ushtarake (si autobllinda dhe tanke) dhe armatim të rëndë (si mitralozë, mortaja, raketahedhës, artileri dhe mina), me pasojë shkatërrimin e shumë ndërtesave dhe largimin e mijëra civilëve.¹²¹ Dhoma Gjyqësore përfundoi se nga fundi i majit 1998 të paktën deri më 26 korrik 1998, ndodhën përleshje me armë mesatarisht çdo tri deri në shtatë ditë në një zonë gjeografike të gjerë që zmadhohej gjithnjë e më shumë.¹²² Kundrejt forcave serbe numerikisht më të shumta, më të stërvitura dhe të pajisura, UÇK-ja diti të ofronte qëndresë të fortë dhe të përdorte taktika efektive të tipit guerilje, duke shmangur beteja të përzgatura fikse me forcat serbe.¹²³ Duke përfunduar se niveli i ashpërsisë të duhur për vërtetimin e ekzistencës së një konflikti të armatosur ishte arritur para fundit të majit 1998, Dhoma Gjyqësore theksoi natyrën e zgjatur dhe gjeografikisht të përhapur të përleshjeve me armë, aftësinë ushtarake të forcave serbe, largimin me dhunë të civilëve dhe numrin e viktimave.¹²⁴

46. Në çështjen *Haxhihasanoviq dhe Kubura (Hadžihasanović and Kubura)*, Dhoma Gjyqësore e zbatoi kushtin *Tadiq* gjatë shqyrtimit nëse kishte prova të mjaftueshme për një konflikt të armatosur midis Këshillit Kroat të Mbrojtjes dhe Ushtrisë Bosnjake në Bosnje-Hercegovinën qendrore nga 1993 deri më 18 mars 1994, kur palët firmosën marrëveshjet e paqes së Uashingtonit (Washington).¹²⁵ Dhoma mori parasysh përleshje të shumta të të dy ushtrive në shumë komuna të Bosnje-Hercegovinës qendrore midis fundit të vitit 1992 dhe janarit 1993, përfshirë një “shpërthim luftimesh të hapur” në fund të janarit 1993.¹²⁶ Luftimet vazhduan në “shkallë të ndryshme të ashpërsisë” në disa komuna, të pasuara prej një përshkallëzimi në qershor 1993 dhe luftime që

¹¹⁸ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore *Haliloviq*, paragrafi 173.

¹¹⁹ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 83, 93; *Limaj dhe të tjerë*, Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë, 12 shkurt 2004, paragrafi 7.

¹²⁰ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 84, 93.

¹²¹ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 135-167.

¹²² Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafi 168.

¹²³ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 169-170.

¹²⁴ Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 134, 171-173.

¹²⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, paragrafët 7, 14, 25, Shtojca 1.

¹²⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, paragrafët 20-21.

vazhduan deri në vjeshtë të vitit 1993.¹²⁷ Dhoma Gjyqësore konkludoi se përmbushej kriteri i ashpërsisë dhe se një konflikt i armatosur ekzistoi deri në arritjen e marrëveshjeve të Uashingtonit.¹²⁸

47. Në çështjen *Martiq (Martić)*, Dhoma Gjyqësore e zbatoi kushtin *Tadiq* gjatë shqyrtimit nëse kishte ekzistuar një konflikt i armatosur midis forcave serbe dhe kroate në territorin e Kroacisë midis gushtit 1991 dhe gushtit 1995.¹²⁹ Lidhur me ashpërsinë, Dhoma Gjyqësore theksoi se që në prill 1991 shpërthyen përlëshje të armatosura me pjesëmarrjen e policisë dhe të popullatës lokale në të dyja anët, dhe si pasojë APJ-ja krijoi zona tamponi midis palëve.¹³⁰ Në gusht 1991, përlëshjet u ashpërsuan kur APJ-ja, TO-ja serbe dhe një njësi brenda MPB-së serbe filluan sulme të shumta mbi fshatra me shumicë kroate.¹³¹ Gjithashtu në luftime u përfshi edhe Korpusi i Gardës Kombëtare të Kroacisë.¹³² Konflikti vazhdoi përgjatë vitit 1995 me disa sulme dhe inkursione nga të dyja anët.¹³³ Dhoma Gjyqësore përfundoi se luftimet ishin mjaft të ashpra dhe se në kohën në fjalë ekzistonte konflikti i armatosur.¹³⁴

48. Në çështjen *Mërkshiq dhe të tjerë (Mrkšić et al)*, Dhoma Gjyqësore e zbatoi kushtin *Tadiq* për të vërtetuar nëse kishte një konflikt të armatosur në Vukovar midis forcave serbe, përfshirë APJ-në, TO-të serbe, njësitë vullnetare apo parashtarake, dhe forcave kroate, përfshirë MPB-në kroate, Korpusin e Gardës Kombëtare të Kroacisë, dhe grupe të tjera lokale të mbrojtjes vullnetare, më 18-21 nëntor 1991, apo rreth kësaj periudhe.¹³⁵ Dhoma Gjyqësore përfundoi se operacionet luftarake në zonën e Vukovarit u ashpërsuan në gusht dhe shtator 1991.¹³⁶ Gjatë periudhës 2 tetor - 18 nëntorit 1991 pati luftime të përditshme, zakonisht me artileri, mortaja, autoblanda, përfshirë tanke, armë si raketahedhës shumëtytësh dhe bateri kundërajrore, si dhe armë këmbësore, dhe herë pas here forca ajrore dhe detare.¹³⁷ Pas dorëzimit të përgjithshëm të forcave kroate më 18 nëntor 1991, më 19 dhe 20 nëntor 1991 vazhduan përlëshje të izoluara dhe më pak të ashpra.¹³⁸ Ngjarjet tërhoqën vëmendjen e organizatave ndërkombëtare përfshirë Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.¹³⁹ Dhoma Gjyqësore u bind se ashpërsia e konfliktit mjaftonte për të përmbushur kushtin *Tadiq*.¹⁴⁰

¹²⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanović dhe Kubura*, paragrafi 22.

¹²⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanović dhe Kubura*, paragrafët 20, 25.

¹²⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafët 41, 343; Dosja Përfundimare e Prokurorisë *Martiq*, 17 janar 2007, paragrafi 356.

¹³⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafi 344.

¹³¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafët 135, 344.

¹³² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafi 344.

¹³³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafi 345.

¹³⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafi 347.

¹³⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafët 1, 39-40, 407-408.

¹³⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 419.

¹³⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 419.

¹³⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 419.

¹³⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafët 420-421.

¹⁴⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 422.

49. Rrjedhimisht, kriteri i dhunës së armatosur të zgjatur u interpretua në praktikë edhe nga vetë Dhoma Gjyqësore *Tadiq* më shumë si kriter i ashpërsisë së dhunës së armatosur se sa i kohëzgjatjes së dhunës. Dhomat Gjyqësore kanë përdorur faktorë tregues për vlerësimin e kriterit të “ashpërsisë,” por asnjë prej tyre në veçanti nuk është thelbësor për vërtetimin e përmbushjes së kriterit. Ndër faktorët tregues përfshihen numri, kohëzgjatja dhe ashpërsia e përleshjeve të veçanta; llojet e armëve dhe të pajisjeve të tjera të përdorura; numri dhe kalibri i municionit të përdorur; numri i personave dhe llojet e forcave pjesëmarrëse në luftime; numri i viktimave; shkalla e dëmeve materiale; dhe numri i civilëve që ikin nga zonat e luftimeve. Edhe përfshirja e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mund të jetë një tregues i ashpërsisë së konfliktit.

50. Tani Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë interpretimin në praktikë të kriterit të organizimit të palëve.

51. Në çështjen *Tadiq*, Dhomës Gjyqësore iu desh të vlerësonte nëse Qeveria e Bosnje-Hercegovinës dhe forcat serbe të Bosnjes dispononin nivelin e duhur të organizimit.¹⁴¹ Ajo përfundoi se Republika e Bosnje-Hercegovinës ishte një njësi politike e organizuar, me institucionet përkatëse të mbrojtjes, dhe se ajo u bë shtet *de jure* më 22 maj 1992.¹⁴² Serbët e Bosnjes dispononin një “forcë ushtarake të organizuar,” ushtrinë serbe të Bosnjes, e cila përfshinte forca që më parë kishin qenë pjesë e APJ-së, dhe ishte nën komandën e administratës serbe të Bosnjes në Pale.¹⁴³ Ata pushtuan një pjesë të konsiderueshme të Bosnje-Hercegovinës.¹⁴⁴ Pasi shqyrtoi gjithashtu faktorët e ashpërsisë, Dhoma Gjyqësore përfundoi se ekzistonte një konflikt i armatosur.¹⁴⁵

52. Në çështjen *Çelebici* (*Čelebići*), Dhomës Gjyqësore iu desh të përcaktonte nëse APJ-ja, TO-ja boshnjake, MPB-ja bosnjake, Këshilli Kroat i Mbrojtjes dhe ushtria serbe e Bosnjes përmbushën kriterin e “organizimit” sipas kushtit *Tadiq*.¹⁴⁶ Dhoma Gjyqësore vuri në pah se APJ-ja ishte ushtria zyrtare e RSFJ-së, më vonë UJ nën RFJ-në, dhe e kontrolluar nga Beogradi.¹⁴⁷ Ushtria serbe e Bosnjes, e përbërë nga njësite të cilat kishin qenë pjesë të APJ-së, kontrollohej nga udhëheqja e administratës serbe të Bosnjes dhe pushtoi pjesë të konsiderueshme të Bosnje-Hercegovinës.¹⁴⁸ Po kështu edhe shteti i vetëshpallur kroat i Bosnjes krijoi si ushtri të tij Këshillin Kroat të Mbrojtjes, që vepronte në territorin e kontrolluar prej tij.¹⁴⁹ Këshilli Kroat i Mbrojtjes mori armë, trajnim dhe

¹⁴¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 562-563.

¹⁴² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 563.

¹⁴³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 564.

¹⁴⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafët 564, 566.

¹⁴⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Tadiq*, paragrafi 568.

¹⁴⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebici*, paragrafët 182-187.

¹⁴⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebici*, paragrafët 110, 112, 187.

¹⁴⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebici*, paragrafët 117, 187.

¹⁴⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebici*, paragrafët 118, 187.

personel nga ushtria e Kroacisë.¹⁵⁰ Për sa i përket TO-së dhe MPB-së boshnjake, Dhoma Gjyqësore konstatoi se ato u transformuan gradualisht në Ushtrinë Bosnjake, e cila u krijua zyrtarisht më 15 prill 1992, nën komandën e lartë të Kryetarit të Presidencës Shtetërore të Bosnjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm me bazë në Sarajevë.¹⁵¹ Në Konjic, Kuvendi i Komunës krijoi “Kryesinë e Luftës” përgjegjëse për organizimin e mbrojtjes lokale.¹⁵² Për më tepër, TO-ja lokale dhe Këshilli Kroat i Mbrojtjes krijuan një Komandë të Përbashkët.¹⁵³ Dhoma Gjyqësore përfundoi se palët në konflikt ishin “autoritete qeveritare” ose “grupe të armatosura të organizuara” në kuptimin e kushtit *Tadiq*.¹⁵⁴

53. Në çështjen *Sllobodan Millosheviq*, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi nëse UÇK-ja, që prej 1 janari 1999 apo rreth kësaj date, mund të quhej “grup i armatosur i organizuar.”¹⁵⁵ Ajo konkludoi se UÇK-ja ishte një forcë ushtarake e organizuar me një strukturë zyrtare komanduese të bashkuar, një shtab, zona të përcaktuara operative, dhe me aftësinë për të blerë, transportuar dhe shpërndarë armë.¹⁵⁶ Mbi këtë bazë, Dhoma Gjyqësore përfundoi se përmbushej kriteri i “organizimit” të kushtit *Tadiq* në përputhje me Rregullën 98 bis.¹⁵⁷

54. Në çështjen *Halilović (Halilović)*, Dhoma Gjyqësore shqyrtoi fakte të rëndësishme për të vërtetuar nëse Këshilli Kroat i Mbrojtjes, ushtria serbe e Bosnjes dhe Ushtria Bosnjake përmbushnin kriterin e “organizimit.” Palët disponinin struktura ushtarake.¹⁵⁸ Ato përdorën taktika ushtarake për arritjen e qëllimeve të tyre.¹⁵⁹ Githashtu ato kontrolluan pjesë të ndryshme të terrorit.¹⁶⁰ Ushtria serbe e Bosnjes dhe Këshilli Kroat i Mbrojtjes negociuan një armëpushim.¹⁶¹ Dhoma Gjyqësore mori gjithashtu në konsideratë faktin se Komanda e Ushtrisë së Republikës së Bosnje-Hercegovinës lëshoi urdhra, ristrukturoi ushtrinë dhe dislokoj oficerë dhe trupa.¹⁶² Duke marrë parasysh edhe faktorë në lidhje me ashpërsinë e konfliktit të armatosur, Dhoma Gjyqësore përfundoi se gjatë periudhës së aktakuzës, në Bosnje-Hercegovinë ekzistonte një konflikt të armatosur.¹⁶³

55. Në çështjen *Limaj dhe të tjerë*, Dhoma Gjyqësore përfundoi se forcat serbe që vepronin në Kosovë në vitin 1998 ishin “autoritete qeveritare” në kuptimin e kushtit *Tadiq*, dhe më tej shqyrtoi

¹⁵⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafi 118.

¹⁵¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafët 109, 136, 186-187.

¹⁵² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafët 125-126, 131, 188.

¹⁵³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafët 135, 137, 140, 191.

¹⁵⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi*, paragrafët 191-192.

¹⁵⁵ Vendim i Rregullës 98 bis *Sllobodan Millosheviq*, paragrafët 14, 22 në vijim.

¹⁵⁶ Vendim i Rregullës 98 bis *Sllobodan Millosheviq*, paragrafët 23-24.

¹⁵⁷ Vendim i Rregullës 98 bis *Sllobodan Millosheviq*, paragrafët 17, 25, 40.

¹⁵⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 162, 165-166, 168-172.

¹⁵⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 161, 163, 166, 168-169, 172.

¹⁶⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 162-164, 169.

¹⁶¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafi 164.

¹⁶² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafët 170-172.

¹⁶³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafi 173.

nëse UÇK-ja mund të përkufizohej si grup i armatosur i organizuar.¹⁶⁴ Duke përmbledhur përfundimet të cilat sipas asaj ishin më të rëndësishmet për këtë çështje, Dhoma Gjyqësore konkludoi se në fund të majit 1998:

[U]ÇK-ja kishte një Shtab të Përgjithshëm që emëronte komandantët e zonave, u jepte udhëzime njësisive të ndryshme të formuara ose në formim e sipër dhe nxirrte deklaratat publike në emër të organizatës. Komandantët e njësisive jepnin urdhra luftarakë dhe përgjithësisht njësitë vartëse dhe ushtarët vepronin në përputhje me këto urdhra. U morën masa për hartimin e rregullave disiplinore dhe krijimin e policisë ushtarake si edhe për rekrutimin, stërvitjen dhe pajisjen e anëtarëve të rinj. Megjithëse përgjithësisht më pak të pajisur se UJ-ja dhe MPB-ja, ushtarët e UÇK-së kishin armë, ndër të cilat, mortaja artilerike dhe granathedhësa. Deri në korrik 1998 UÇK-ja ishte pranuar si pjesëmarrës i nevojshëm dhe i vlefshëm në negociatat me qeveritë dhe organizmat ndërkombëtare për përcaktimin e një zgjidhjeje të krizës së Kosovës dhe për hartimin e kushteve në këto negociata për moskryerjen e operacioneve ushtarake.¹⁶⁵

56. Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore interpretoi aftësinë e UÇK-së për pjesëmarrje në përlëshje të armatosura kudo në Kosovë si tregues tjetër të nivelit të saj të organizimit.¹⁶⁶ Ajo interpretoi praninë e rregullave të disiplinës të UÇK-së dhe policinë ushtarake si provë të formalitetit dhe efektivitetit në rritje të strukturës organizative të saj dhe të përparimit në fushën e disiplinës dhe të bashkërendimit brenda UÇK-së, megjithëse ishte e paqartë nga provat se në çfarë masë u realizua zbatimi.¹⁶⁷ Dhoma Gjyqësore theksoi se Shtabi i Përgjithshëm mbledhëj jo rregullisht dhe në vende të ndryshme,¹⁶⁸ dhe se UÇK-ja dispononte kryesisht armë të lehta dhe pajisje të pamjaftueshme komunikimi.¹⁶⁹ Dhoma Gjyqësore zvogëloi rëndësinë e uniformave duke qenë se kishin “pak ndikim në funksionimin e UÇK-së.”¹⁷⁰ Gjithashtu ajo e konsideroi faktin se UÇK-ja u bë palë kyçe bashkëbiseduese me aftësinë e pranuar për të folur me një zë të respektuar në emër të anëtarëve të saj, si konfirmim të “qëndrueshmërisë dhe të efektivitetit organizativ.”¹⁷¹ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore gjeti prova për ekzistencën e një hierarkie të krijuar brenda UÇK-së.¹⁷² Përfundoi se UÇK-ja kishte aftësi të bashkërendonte planifikimin dhe veprimtarinë ushtarake dhe të përcaktonte një strategji ushtarake të njësuar, si edhe kishte aftësinë të ndërmerre operacione më të gjera

¹⁶⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 83, 93.

¹⁶⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafi 171 (duke lënë jashtë shënimet në fund të faqes të cilat lidhen me përfundimet e mëparshme të detajuara të çështjes).

¹⁶⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafi 172.

¹⁶⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 98, 110-117.

¹⁶⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 104, 132.

¹⁶⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 121-122, 124.

¹⁷⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafi 123.

¹⁷¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafi 129.

¹⁷² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafi 129.

ushtarake.¹⁷³ Dhoma Gjyqësore përfundoi se para fundit të majit 1998, “UÇK-ja kishte karakteristika të mjaftueshme të një grupi të armatosur të organizuar, e aftë të merrte pjesë në një konflikt të brendshëm të armatosur.”¹⁷⁴

57. Në çështjen *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, Dhoma Gjyqësore iu desh të vendoste nëse kishte prova të mjaftueshme se Këshilli Kroat i Mbrojtjes dhe Ushtria Bosnjake përmbushnin kriterin e “organizimit.”¹⁷⁵ Dhoma Gjyqësore shfrytëzoi urdhra e arpushimit të lëshuara nga shtabet e përgjithshme dhe nga prijësit politikë të palëve si dhe marrëveshje të arpushimit midis të dy palëve, të cilat përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare u përpoqën të ndërmjetësonin dhe zbatonin.¹⁷⁶ Një tregues tjetër të ekzistencës së një konflikti të armatosur Dhoma Gjyqësore e gjeti në “dështimet e përsëritura për krijimin e një komande të përbashkët” midis të dy palëve.¹⁷⁷ Duke u bazuar edhe në faktorët e lidhur me ashpërsinë, Dhoma Gjyqësore u bind se ishin përmbushur kushtet e ekzistencës së një konflikti të armatosur.¹⁷⁸

58. Në çështjen *Martiq*, Dhoma Gjyqësore iu desh të vendoste nëse palët kundërshtarë serbe dhe kroate ishin të organizuara sipas kushtit *Tadiq*.¹⁷⁹ Ajo mori në konsideratë se në gusht 1991, APJ-ja dhe forcat e armatosura të udhëheqjes e serbëve të Kroacisë, të përbëra prej TO-së serbe dhe një njësi brenda MPB-së serbe, morën pjesë drejtpërdrejtë në luftime dhe bashkëpunuan në organizimin e operacioneve në terren.¹⁸⁰ Udhëheqja e serbëve të Kroacisë mori ndihmë ushtarake prej Serbisë dhe ndihmoi në krijimin e një kampi stërvitor për njësitë të cilat më vonë morën pjesë në luftime.¹⁸¹ Autoritetet kroate organizuan gjithashtu Ushtrinë Kroate.¹⁸² Dhoma Gjyqësore mori në shqyrtim edhe miratimin e marrëveshjeve midis palëve.¹⁸³ Dhoma Gjyqësore përfundoi se u përmbush kriteri i “organizimit.”¹⁸⁴

59. Në çështjen *Mërkshiqi dhe të tjerë*, Dhoma Gjyqësore iu desh të vendoste nëse palët kundërshtarë serbe dhe kroate përmbushën kriterin e “organizimit” të kushtit *Tadiq*.¹⁸⁵ Forcat serbe perbëheshin nga APJ-ja, TO-ja serbe, dhe njësi vullnetare ose paraushtarake serbe.¹⁸⁶ Të gjithë ata vepruan në kuadrin e një strukture të përkohshme ushtarake të krijuar nga komanda e Rajonit të

¹⁷³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafi 129.

¹⁷⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Limaj dhe të tjerë*, paragrafët 134, 173.

¹⁷⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, paragrafët 14, 20.

¹⁷⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, paragrafët 20, 23.

¹⁷⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, paragrafi 23.

¹⁷⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Haxhihasanoviq dhe Kubura*, paragrafët 20, 25.

¹⁷⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafët 41, 343; Dosja Përfundimtare e Prokurorisë *Martiq*, 17 janar 2007, paragrafi 356.

¹⁸⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafët 135, 344.

¹⁸¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafi 344.

¹⁸² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafi 344.

¹⁸³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafi 345.

¹⁸⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Martiq*, paragrafi 347.

¹⁸⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiqi dhe të tjerë*, paragrafët 39-40, 407-408.

¹⁸⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiqi dhe të tjerë*, paragrafi 409.

Parë Ushtarake të APJ-së.¹⁸⁷ Dhoma Gjyqësore përfundoi se forcat serbe ishin autoritet qeveritar në kuptimin e kushtit *Tadiq*.¹⁸⁸ Forcat kroate përbëheshin nga MPB-ja kroate, Korpusi i Gardës Kombëtare dhe grupe lokale vullnetare të mbrojtjes.¹⁸⁹ MPB-ja kroate kishte forca policore të rregullta dhe rezervistee prej 20,000 vetësh në tërë Kroacinë.¹⁹⁰ Korpusi i Gardës Kombëtare u krijua më 28 maj 1991 dhe ishte pjesë e MPB-së.¹⁹¹ Në fillim, anëtarët e tij ishin kryesisht vullnetarë dhe anëtarë të forcave rezerviste të MPB-së.¹⁹² Ishin të armatosur, por në mënyrë të pamjaftueshme, me armë të MPB-së.¹⁹³ Para nëntorit të vitit 1991, Korpusi i Gardës Kombëtare në Kroaci përbëhej nga katër brigada me 8.000-9.000 luftëtarë.¹⁹⁴ Në Vukovar, në vjeshtë të vitit 1991, MBP-ja kroate dhe Korpusi i Gardës Kombëtare, bashkë me grupe lokale vullnetare të mbrojtjes kishin rreth 1.500-1.800 luftëtarë.¹⁹⁵ Ata ishin nën një komandë të përbashkët me seli të caktuar në Vukovar.¹⁹⁶ Dhoma Gjyqësore përfundoi se forcat kroate ishin grupe të armatosura të organizuara sipas kushtit *Tadiq*.¹⁹⁷

60. Këto çështje nënvizojnë parimin se një konflikt i armatosur mund të ekzistojë vetëm midis palëve të cilat janë të organizuara në masë të mjaftueshme për t'u ballafaquar me njëra tjetrën me mjete ushtarake. Autoritetet qeveritare supozohen të disponojnë forca të armatosura të cilat përmbushin kriterin. Për sa u përket grupeve të armatosura, Dhoma Gjyqësore ka përdorur disa faktorë tregues, asnjë prej të cilëve në veçanti nuk është thelbësor për vërtetimin e përmbushjes së kriterit të “organizimit”. Ndër faktorë të tillë tregues janë ekzistenca e një strukture komanduese, të rregullave disiplinore dhe të mekanizmave brenda grupit; ekzistenca e një selie; fakti se grupi kontrollon një territor të caktuar; aftësia e grupit për të patur armë, pajisje të tjera ushtarake, rekrutë dhe trajnim ushtarak, aftësia për planifikimin, bashkërendimin dhe zbatimin e operacione ushtarake, përfshirë lëvizje trupash dhe logjistikë; aftësia për përkufizimin e një strategjie të përbashkët ushtarake dhe përrdorimin e taktikave ushtarake; dhe aftësia e tij për të folur me një zë dhe për të negociim apo realizim të marrëveshjeve të tilla si armëpushime apo marrëveshje të paqes.

61. *Lidhja*. Jo domosdoshmërisht krimi i pretenduar duhet të jetë kryer në një kohë apo vend të caktuar ku ka patur luftime; duhet vetëm të ekzistojë një “lidhje e ngushtë” midis veprimeve të kryesve dhe luftimeve në territorin e kontrolluar nga palët në konflikt.¹⁹⁸ Ekzistenca e lidhjes së

¹⁸⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 409.

¹⁸⁸ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 409.

¹⁸⁹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 410.

¹⁹⁰ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 411.

¹⁹¹ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 413.

¹⁹² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafët 413-414.

¹⁹³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafët 413-414.

¹⁹⁴ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 414.

¹⁹⁵ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafët 410, 412, 414, 415.

¹⁹⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafët 410, 417.

¹⁹⁷ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Mërkshiq dhe të tjerë*, paragrafi 418.

¹⁹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 57; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, paragrafi 342.

ngushtë midis krimit dhe konfliktit të armatosur vërtetohet kur provohet se konflikti luajti një rol të rëndësishëm në aftësinë e keqbërësit për kryerjen e krimit, në vendimin e tij ose të saj për ta kryer, në mënyrën e kryerjes, dhe në synimin në lidhje me kryerjen.¹⁹⁹

62. *Statusi i viktimave.* Kushti i fundit për vlefshërinë e një akuze të Nenit 3, në bazë të Nenit të Përbashkët 3, është se në kohën e shkeljes, viktimat nuk merrte pjesë aktivisht në luftime.²⁰⁰ Ky kusht përfshin, ndër të tjerët, edhe anëtarë të forcave të armatosura të cilët dorëzojnë armët edhe luftëtarë të mbetur jashtë luftimit për shkak të sëmundjes, lëndimit ose të burgimit, apo për shkaqe të tjera.²⁰¹ Kryesi duhet të njohë apo duhet të ketë njohur statusin e viktimave si persona të cilët nuk marrin pjesë aktivisht në luftime.²⁰²

3.2 Përfundime për ekzistencën e një konflikti të armatosur

3.2.1 Organizimi i UÇK-së

63. Provat e disponuara prej Tribunalit vërtetojnë ekzistencën e një konflikti midis forcave të armatosura të Qeverisë së RFJ-së, të përbëra prej forcave të UJ-së, të PJP-së, të JSO-së, të SAJ-së dhe të MPB-së (“forcat serbe”), dhe UÇK-së në Kosovë në periudhën e përcaktuar në aktakuzë nga marsi në shtator 1998. Megjithëse shumica e provave të Tribunalit lidhet me ngjarjet që ndodhën në një zonë të përafërt midis qyteteve të Pejës, Gjakovës dhe Grabanicës në komunën e Klinës (“zona e Dukagjinit”), Dhoma Gjyqësore nuk e kufizon analizën e saj ligjore vetëm në këtë zonë të Kosovës. Për të vërtetuar ekzistencën dhe kohën e fillimit të konfliktit të armatosur në Kosovë, Dhoma Gjyqësore duhet të shqyrtojë nëse UÇK-ja ishte një “grup i armatosur i organizuar” dhe nëse konflikti arriti nivelin e ashpërsisë së duhur sipas kushtit *Tadiq*.

64. Duke marrë parasysh karakteristikat e veçanta të kësaj çështjeje, Dhoma Gjyqësore ka identifikuar dhe do të shqyrtojë faktorët tregues të mëposhtëm të nivelit të organizimit të UÇK-së: ekzistenca e shtabeve dhe strukturës komanduese të UÇK-së; ekzistenca e rregullave dhe mekanizmave disiplinore të UÇK-së; kontrolli i terrenit prej UÇK-ja; aftësia e UÇK-së për gjetjen e armëve dhe pajisjeve të tjera ushtarake; rekrutimi i anëtarëve, stërvitja e tyre ushtarake; zbatimi i operacioneve ushtarake dhe përdorimi i taktikave dhe strategjisë; dhe përfaqësimi i njëzëshëm.

65. *Shtabet dhe strukturat komanduese.* Shtabet e para të UÇK-së në zonën e Dukagjinit u themeluan në Jabllanicë, komuna e Gjakovës, dhe në Gllogjan, komuna e Deçanit. Në shkurt 1998,

¹⁹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 58.

²⁰⁰ Neni i Përbashkët 3 (1); Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 420, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Krajishnik*, paragrafi 847.

²⁰¹ Neni i Përbashkët 3 (1).

²⁰² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Halilović*, paragrafi 36, Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Krajishnik*, paragrafi 847.

Cufë Krasniqi dëshmoi se në shkurt 1998 UÇK-ja kishte shtabe në Jabllanicë dhe në Gllogjan.²⁰³ Jabllanica që, sipas dëshmitarit, ishte nën komandën e Lahi Brahimajt, ishte shtabi më i vjetër i UÇK-së në Kosovën Perëndimore.²⁰⁴ Pas sulmit mbi shtëpitë e familjes Haradinaj në Gllogjan në mars 1998, ky fshat, pas Jabllanicës, u bë qendra e shtabit më të rëndësishëm të UÇK-së²⁰⁵ Anëtarët e UÇK-së shkuan në Gllogjan për të marrë udhëzime se si të mbronin fshatrat e tyre dhe se si të merrnin armë.²⁰⁶ Zoran Stijoviqi dhe Dëshmitari 69 konfirmuan gjithashtu praninë e UÇK-së në fillim të vitit 1998, në Gllogjan dhe në Jabllanicë, si dhe rolin e Lahi Brahimajt si udhëheqës në Jabllanicë.²⁰⁷ Pjetër Shala dëshmoi se në fillim të pranverës 1998, ai dhe njëzet apo tridhjetë luftëtarë të armatosur hynë në Kosovë nga Shqipëria dhe shkuan në Jabllanicë.²⁰⁸ Dëshmitari dëshmoi se komandantët e UÇK-së takoheshin në shtëpinë e Lahi Brahimajt, në qendër të Jabllanicës.²⁰⁹ Ai dëshmoi gjithashtu se në hyrje të fshatit kishte kazerma.²¹⁰ Nazmi Brahimaj ishte komandanti i fshatit dhe jepte urdhra se kush grumbullonte armë dhe kush shkonte me detyra të caktuara.²¹¹

66. Në mars dhe prill 1998, fshatarët e shumë fshatrave në zonën e Dukagjinit filluan të vetorganizoheshin në përkrahje të UÇK-në. Rustem Tetaj dëshmoi se fshatarët e disa fshatrave rreth Gllogjanit, si Dubravë, Baballoq, Gramaqel, dhe Shaptej, të gjithë në komunën e Deçanit, kishin filluar të ngrinin shtabe të UÇK-së rreth fundit të marsit dhe fillimit të prillit 1998.²¹² Afërsisht në të njëjtën kohë, ai e pa shtabin e UÇK-së në Lumbardh të komunës së Deçanit.²¹³ Komandanti në Gramaqel asokohe ishte Ali Avdia, i njohur gjithashtu si Baraba, dhe komandanti në Lumbardh ishte Deli Lekaj.²¹⁴ Sipas Rustem Tetajt, fshatarët organizoheshin me nismën e vetë, gjë që rezultoi në zgjerimin e UÇK-së në zonën e Dukagjinit.²¹⁵ Organizata përbëhej kryesisht prej njerëzve të zakonshëm të cilët caktonin roje të natës dhe ngrinin postblloqe në hyrje të fshatrave.²¹⁶ Dhoma Gjyqësore mori prova të mëtijshme përputhëse për organizimin e UÇK-së në nivel fshati në zonën e Dukagjinit që prej fundit të marsit 1998 nga Ismet Kadrijaj,²¹⁷ Ahmet Ukaj,²¹⁸ Zymer Hasanaj,²¹⁹ Dëshmitari 29,²²⁰ dhe Shemsedin Cekaj.²²¹

²⁰³ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 33, 35; Cufë Krasniqi, T. 5756-5757.

²⁰⁴ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 33, 35, 62; Cufë Krasniqi, T. 5732, 5753-5754, 5846, 5855; P357 (Fotografia e ndërtesës së shtabit të UÇK-së në Jabllanicë në vitin 1998)

²⁰⁵ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 38, 40, 42; Cufë Krasniqi, T. 5706.

²⁰⁶ Cufë Krasniqi, T. 5708.

²⁰⁷ P931 (Zoran Stijoviqi, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafët 23, 49; Zoran Stijoviqi, T. 9000-9001; P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë dëshmitari, 20 qershor 2007), paragrafët 11, 27; Dëshmitari 69, T. 9846, 9850-9853.

²⁰⁸ Pjetër Shala, T. 9938-9939, 9943-9947.

²⁰⁹ Pjetër Shala, T. 9946-9948.

²¹⁰ Pjetër Shala, T. 9948-9950; P1185 (Skicë e kazermsë së Jabllanicës); P1186 (Fotografia e shënuar nga Pjetër Shala).

²¹¹ Pjetër Shala, T. 9947, 9954.

²¹² P265 (Rustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 20.

²¹³ P265 (Rustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 20.

²¹⁴ P265 (Rustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 20.

²¹⁵ Rustem Tetaj, T. 3625-3626, 3628, 3707, 3709, 3800-3801.

²¹⁶ Rustem Tetaj, T. 3626, 3707.

²¹⁷ P1233 (Ismet Kadrijaj, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2004), paragrafët 7-9.

67. Dhoma Gjyqësore dëgjoi gjithashtu dëshmi për rolin e Ramush Haradinajt në organizimin e UÇK-së që prej prillit 1998. Sipas Zoran Stijoviqit, në fund të marsit, prill dhe fillim të majit, Haradinaj me shokë vinin në një fshat dhe bënë një tubim të kryesisë së fshatit gjatë të cilit diskutonin për krijimin e një shtabi të UÇK-së në fshat dhe ndikonin zgjedhjen e drejtuesve dhe të personelit.²²² Haradinaj kërkonte që fshatarët të grumbullonin fonde për blerjen e armëve.²²³ Rreth mesit të prillit 1998, Rrustem Tetaj shkoi në Gllogjan për t'u anëtarësuar në UÇK dhe për të diskutuar organizimin dhe përgatitjen e fshatit Llukë e Poshtme, komuna e Deçanit.²²⁴ Ai e takoi Haradinajn i cili i kërkoi dëshmitarit të kthehej në fshatin e tij që të organizonte njerëzit atje, të mblidhte disa të rinj për të shkuar në Gllogjan, dhe prej aty për të shkuar në Shqipëri për blerjen e armëve.²²⁵ Zymer Hasanaj dëshmoi se në mes të prillit 1998, Haradinaj shkoi në Vranoc të Madh, komuna e Pejës, për të shpallur emërimin e Din Krasniqit në postin e komandantit të UÇK-së në një zonë me 25 fshatra, përfshirë Vranocin e Madh.²²⁶ Haradinaj ishte i armatosur dhe me uniformë të UÇK-së.²²⁷ Hasanaj deklaroi se “njerëzit” pranuan autoritetin e Haradinajt për këtë emërim, duke e konsideruar më të lartë se gjithë të tjerë në atë zonë.²²⁸ Cufë Krasniqi dëshmoi se pas përleshjes pranë shtëpive së familjes së Haradinajt, Haradinaj u bë “komandanti popullor” i forcave të UÇK-së në zonën e Dukagjinit.²²⁹ Megjithëse në prill 1998, Haradinaj nuk ishte zyrtarisht komandant, ushtarët e UÇK-së e konsideronin si komandant *de facto* të zonës.²³⁰

68. Në bazë të provave, duket se “Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së” thuajse nuk ishte i përfshirë në zhvillimet e lartpërmendura në terren në fillim të vitit 1998. Jakup Krasniqi, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së që prej fundit të vitit 1996 ose fillimit të vitit 1997,²³¹ konfirmoi se, duke filluar prej mars-prillit 1998, fshatarët, veçanërisht në zonat e Drenicës dhe të Dukagjinit, vetëorganizoheshin në mënyrë spontane në njësi mbrojtëse, shpesh duke zgjedhur një komandant fshati.²³² Ai dëshmoi se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së donte që këto fshatarë të bëheshin pjesë e një strukture më të organizuar nën udhëheqjen e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.²³³ Të paktën

²¹⁸ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 1 nëntor 2004), paragrafi 1.

²¹⁹ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2004), paragrafi 2; Zymer Hasanaj, T. 8720.

²²⁰ Dëshmitari 29, T. 3483-3484, 3586.

²²¹ P317 (Shemsedin Cekaj, deklaratë dëshmitari, 14 maj 2004), paragrafi 6; Shemsedin Cekaj, T. 4390, 4398-4399, 4401-4403.

²²² Zoran Stijoviq, T. 9073-9074.

²²³ Zoran Stijoviq, T. 9074-9076.

²²⁴ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafët 20, 22; Rrustem Tetaj, T. 3613, 3709-3710.

²²⁵ Rrustem Tetaj, T. 3621, 3840-3841.

²²⁶ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafët 4-6; Zymer Hasanaj, T. 8743.

²²⁷ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 5.

²²⁸ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 5.

²²⁹ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 43. Shih gjithashtu P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafët 45-46.

²³⁰ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 41, 61, 65.

²³¹ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 4; P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3296, 3298, 3307, 3427-3429; Jakup Krasniqi, T. 4989, 5022, 5024, 5075, 5078.

²³² P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 8; P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3330, 3378-3379, 3415, 3450-3452, 3470-3471; Jakup Krasniqi T. 5007-5009; 5046-5049.

²³³ Jakup Krasniqi, T. 5007-5008, 5047-5048.

deri në qershor 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk kishte ndërtesë kryesore, në një kohë që disa anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ndodheshin në Kosovë, disa në Shqipëri, dhe të tjerë në vendet e Evropës perëndimore.²³⁴ Sipas Jakup Krasniqit, deri në gusht 1998, UÇK-ja nuk kishte një strukturë hierarkike të ngurtë, por një strukturë komanduese horizontale, dhe komunikimi midis grupeve të UÇK-së ishte i kufizuar.²³⁵

69. *Rregullat dhe mekanizmat disiplinore.* Duket se disiplina e ushtarëve të UÇK-së nuk përbënte interes të konsiderueshëm për UÇK-në në muajt e parë të vitit 1998. Jakup Krasniqi dëshmoi se nga marsi deri në shtator 1998, UÇK-ja nuk kishte gjykata, gjyqtarë apo burgje.²³⁶ Gjatë vitit 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk kishte një sistem disiplinor për ushtarët e UÇK-së, dhe sipas Jakup Krasniqit, komandantët e zonave e kishin të vështirë apo të pamundur të ushtronin disiplinë për shkak të mungesës së organizimit dhe të komunikimit të rregullt.²³⁷ Më 29 prill 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së lëshoi një deklaratë politike sipas së cilës UÇK-ja njihte dhe respektonte marrëveshjet ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara dhe konventat e luftës.²³⁸ Gjithashtu UÇK-ja qarkulloi dokumente të cilët përfshinin këta konventa, të marra prej Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.²³⁹ Për shkak të problemave të organizimit, nuk ishte e mundur që dokumentet t'u dërgoheshin të gjithë ushtarëve të UÇK-së dhe rrjedhimisht qëllimi i kësaj deklarate politike ishte që të informonte ushtarët e UÇK-së.²⁴⁰

70. *Kontrolli i territorit.* Kontrolli serb i disa pjesëve të zonës së Dukagjinit u dobësua që para vitit 1998. Zoran Stijoviqi (Zoran Stijović) dëshmoi se, duke filluar prej vitit 1996, MPB-ja nuk hynte në disa zona të Kosovës, përfshirë rrethinën e Jabllanicës, për të shmangur përleshje me UÇK-në.²⁴¹ Nebojsa Avramoviqi (Nebojša Avramović) dëshmoi se edhe para konfliktit policia nuk mund të hynte në Jabllanicë sepse fshatarët ishin të armatosur, dhe policia dhe zyrtarët e shtetit sulmoheshin.²⁴² Në janar 1998, Branko Gajiqi (Branko Gajić) u informua se një zonë prej 90 kilometrash katrorë në komunën e Gjakovës nuk kishte qenë nën kontrollin serb për disa vjet dhe kishte rënë nën kontrollin e UÇK-së në fund të vitit 1997.²⁴³

²³⁴ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3306, 3311, 3401-3402; Jakup Krasniqi T. 4951, 4990, 5012, 5027-5029, 5072.

²³⁵ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3350-3351, 3454-3455.

²³⁶ Jakup Krasniqi, T. 5089, 5153.

²³⁷ Jakup Krasniqi, T. 4970-4971.

²³⁸ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), Shtojca 12 (deklarata politike e UÇK-së, 29 prill 1998), ff. 1, 2; P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3371.

²³⁹ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3387-3388.

²⁴⁰ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 6; P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3387-3388.

²⁴¹ P931 (Zoran Stijoviqi, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 23; Zoran Stijoviqi, T. 9000.

²⁴² P380 (Nebojsa Avramoviqi, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 10.

²⁴³ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 13; P1142 (Raporti i Komandës së Brigadës së Motorizuar 549 për Komunën e Gjakovës në fillim të vitit 1998, 23 shkurt 1998), f. 1.

71. UÇK-ja ushtroi kontroll territorial duke ngritur postbloqe në rrugët e zonës së Dukagjinit. Branko Gajiqi deklaroi se, pas operacionit të MBP-së kundër vendbanimit të Adem Jasharit më 5 mars 1998, u shtua numri i postbloqeve të UÇK-së.²⁴⁴ Dhoma Gjyqësore mori prova konkrete për ekzistencën e postbloqeve të UÇK-së në mars 1998. Dragosllav Stojanović (Dragoslav Stojanović) dëshmoi se, një mbrëmje, rreth fillimit të marsit 1998, katër ushtarë të UÇK-së e ndaluan në hyrje të Gllogjanit, i kërkuan dokumentat, e kontrolluan atë dhe makinën e tij.²⁴⁵ Xhon Krosland (John Crosland) dëshmoi se midis marsit dhe korrikut 1998, pa grupe të vogla prej rreth 10-15 ushtarësh, shumica prej tyre në uniforma me shenjë të UÇK-së, në zonat e Irzniqit, Prejlepit dhe në rrethinat e Gjakovës.²⁴⁶ Ishin të armatosur me pushkë, revole, disa mitralozë të lehtë dhe disa bomba.²⁴⁷ Këta ushtarë u orvatën herë pas here të pengonin kalimin e Kroslandit.²⁴⁸

72. Në fund të prillit 1998, në zonën e Dukagjinit kishte shumë postbloqe të UÇK-së. Shemsedin Cekaj dëshmoi se, rreth datës 20 prill 1998, ai udhëtoi drejt Irzniqit për të takuar Ramush Haradinajn për herë të parë.²⁴⁹ Ai kaloi përmes fshatrave Lybeniq, komuna e Pejës, Strelle i Poshtëm, Pozhar dhe të Kodrali, të gjithë në komunën e Deçanit.²⁵⁰ Në disa fshatra gjatë rrugës kishte postbloqe të ruajtura nga ushtarët e UÇK-së, disa me uniformë.²⁵¹ Duke qenë se Shemsedin Cekaj njihej prej rojeve të postbloqeve, ai nuk kishte nevojë për dokumenta për kalimin e tyre.²⁵² Në atë kohë, nuk kishte nevojë për leje nga shtabi vendor i UÇK-së për kalimin e postbloqeve të UÇK-së.²⁵³ Shemsedin Cekaj dëshmoi se, pas datës 22 prill 1998, UÇK-ja ngriti postbloqe në anën perëndimore të Irzniqit, në drejtim të Prejlepit.²⁵⁴ Shaban Balaj dëshmoi se në Rasiq, komuna e Pejës, kishte një postblok të UÇK-së në fund të prillit 1998.²⁵⁵ Nebojsja Avramović dëshmoi se deri më 21-22 prill 1998, UÇK-ja kishte postbloqe, bunkerë dhe llogore në të dy anët e rrugës Gjakovë-Pejë.²⁵⁶ Ekzistenca e llogoreve të UÇK-së në komunën e Deçanit brenda 22-24 prillit u konfirmua nga Miloica Vllahović (Miloica Vlahović)²⁵⁷ dhe Stanisha Radosheviqi (Staniša Radošević).²⁵⁸ Në pjesët 6.4 dhe 6.7 më poshtë, Dhoma Gjyqësore shqyrton prova të mëtejshme të postbloqeve të UÇK-së në komunën e Deçanit, rreth Dashinocit, Gllogjanit, Pozharit dhe Irzniqit, deri më 22 prill 1998.

²⁴⁴ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 17.

²⁴⁵ Dragosllav Stojanović, T. 1854-1857, 1880, 1941-1942, 1983.

²⁴⁶ John Crosland, T. 2949, 2951-2952.

²⁴⁷ John Crosland, T. 2951-2952.

²⁴⁸ John Crosland, T. 2951.

²⁴⁹ Shemsedin Cekaj, T. 4390, 4460-4461.

²⁵⁰ Shemsedin Cekaj, T. 4390-4391.

²⁵¹ Shemsedin Cekaj, T. 4391.

²⁵² Shemsedin Cekaj, T. 4392.

²⁵³ Shemsedin Cekaj, T. 4392.

²⁵⁴ Shemsedin Cekaj, T. 4404; P1156 (Raporti i zbulimit nga postkomanda pararojë e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1998), paragrafi 8.

²⁵⁵ P922 (Shaban Balaj, deklaratë dëshmitari, 2 qershor 2007), paragrafi 16; Shaban Balaj, T. 8648.

²⁵⁶ P380 (Nebojsja Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 13, 15; shih gjithashtu P385 (Harta e zonave të pasigurta për serbët sipas Nebojsja Avramovićit).

²⁵⁷ Miloica Vllahović, T. 1583-1584.

²⁵⁸ Shih pjesën 6.15 më poshtë.

73. Si pasojë, gjatë periudhës prill -fund i gushtit 1998, zona e Dukagjinit ishte, siç shpjegoi Cufë Krasniqi, kryesisht nën kontrollin e UÇK-së.²⁵⁹ Sipas dëshmitarit zona konsiderohej si “zonë e lirë” sepse ishte çliruar nga “pushtimi” serb dhe sepse UÇK-ja mund të lëvizte lirisht brenda zonës.²⁶⁰ Mirëpo, për shkak të epërsisë së tyre ushtarake, forcat serbe ende mund të hynin në zonë dhe këtë e bënë disa herë.²⁶¹ Kontrolli i zonës së Dukagjinit prej UÇK-së afërsisht që prej prillit 1998, megjithëse i cënuar nga sulmet serbe, u konfirmua më tej me dëshminë e Ylber Haskajt,²⁶² Shemsedin Cekajt,²⁶³ Zymer Hasanajt,²⁶⁴ Zharko Bajçetiçit (Žarko Bajčetić),²⁶⁵ dhe Dëshmitares 28.²⁶⁶ Provat e shqyrtuara në pjesët 6.5, 6.6 dhe 6.7 më poshtë tregojnë se UÇK-ja mori në kontroll Ratishën e Epërme dhe Dashinocin, të dy në komunën e Deçanit, më 21-22 prill 1998.

74. Me zgjerimin e kontrollit të zonës së Dukagjinit nga UÇK-ja, u tërhoqën pozicionet e përhershme serbe. Nebojsja Avramoviç dëshmoi se në prill 1998 u mbyllën stacionet e policisë në Irzniq dhe në Junik duke qenë se rrugët për në ato stacione ishin të bllokuara dhe se policët sulmoheshin vazhdimisht.²⁶⁷ Gjatë natës midis 21 dhe 22 prillit 1998, u evakua stacioni i policisë i Irzniqit.²⁶⁸ Zoran Stijoviç dëshmoi se kur u tërhoq policia nga stacioni i policisë së Irzniqit I cili ishte pika e fundit serbe në afërsi të Glllogjanit, kontrolli i territorit në të dy anët e rrugës kryesore iu lëshua efektivisht UÇK-së.²⁶⁹

75. Provat tregojnë se në fillim të vitit 1998, rrugët kryesore ishin kryesisht nën kontrollin serb i cili që prej prillit po sfidohej gjithmonë e më shumë prej UÇK-së. Dragan Zhivanoviç (Dragan Živanović) dëshmoi se pas shtimit të veprimtarisë së UÇK-së, MPB-ja kishte ngritur postblloqe të përhershme me roje përgjatë rrugëve kryesore të Kosovës perëndimore në gjysmën e parë të vitit 1998.²⁷⁰ Sulmet e UÇK-së mbi ato postblloqe u shtuan gjatë muajve deri në qershor 1998.²⁷¹ Nebojsja Avramoviç dëshmoi se një pjesë e rrugës Gjakovë-Prishtinë, midis Rakovinës në komunën e Gjakovës dhe Dollcit në komunën e Klinës ishte tërësisht e bllokuar nga UÇK-ja gjatë periudhës prill - shtator 1998.²⁷² Xhon Krosland dhe Cufë Krasniqi dëshmuan se që prej shkurtit

²⁵⁹ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 90; Cufë Krasniqi, T. 5815; P355 (Harta mbi të cilën dëshmitari shënoi pozicionet serbe dhe një zonë nën kontrollin e UÇK-së).

²⁶⁰ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 90; Cufë Krasniqi, T. 5751.

²⁶¹ Cufë Krasniqi, T. 5751, 5815, 5820.

²⁶² P1213 (Ylber Haskaj, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafi 34; Ylber Haskaj, T. 10330-10332.

²⁶³ Shemsedin Cekaj, T. 4403-4406, 4419-4422, 4427-4428, 4478-4481; P318 (Harta e shënuar nga Shemsedin Cekaj).

²⁶⁴ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 10 dhe Shtojca A e deklaratës, e cila tregon fshatrat e “zonës së lirë” sipas Hasanajt.”

²⁶⁵ P377 (Zharko Bajçetiç, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafët 19, 31-32; Zharko Bajçetiç, T. 6405-6406, 6408-6412, 6533-6534; P379 (Harta në të cilën Zharko Bajçetiç shënoi një zonë të padepërtueshme).

²⁶⁶ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 51, 72; Dëshmitarja 28, T. 10178-10179.

²⁶⁷ P380 (Nebojsja Avramoviç, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007) paragrafi 18.

²⁶⁸ P1156 (Raporti i zbulimit nga postkomanda pararojë e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1998), paragrafi 8. Shih gjithashtu P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 48; Cufë Krasniqi, T. 5814; P1213 (Ylber Haskaj, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafi 34; Shemsedin Cekaj, T. 4403, 4470.

²⁶⁹ P931 (Zoran Stijoviç, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafët 41-43; Zoran Stijoviç, T. 8992.

²⁷⁰ P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007) paragrafët 30-31.

²⁷¹ P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007) paragrafi 31.

²⁷² P380 (Nebojsja Avramoviç, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 17; P386 (Harta e cila tregon pjesën e sigurtë të rrugës Gjakovë-Prishtinë, skicuar nga Nebojsja Avramoviç).

apo marsit 1998, serbët kontrollonin rrugën kryesore Pejë-Gjakovë, megjithëse UÇK-ja e bllokoj afër Prejlepit për ca kohë rreth prillit 1998.²⁷³ Më 22 prill 1998, koloneli Vladimiri Llazareviq (Vladimir Lazarević) urdhëroi që të kërkohet miratim paraprak dhe masa maksimale të sigurisë për lëvizjen e automjeteve ushtarake në rrugën Gjakovë-Pejë.²⁷⁴ Dëshmitarja 28 dëshmoi se, në fund të prillit 1998, autobusët në rrugën Prishtinë-Pejë-Gjakovë nuk qarkullonin për shkak të përlëshjeve midis UÇK-së dhe forcave ushtarake serbe.²⁷⁵ Policët serbë i treguan dëshmitares se UÇK-ja po sulmonte policinë serbe përgjatë rrugës në përpjekje për ta marrë në kontroll.²⁷⁶ Dëshmitarja vuri re shtim të numrit të postbllloqeve dhe të pranisë së policisë përgjatë rrugës.²⁷⁷

76. *Armë dhe pajisje të tjera ushtarake.* Siç shpjegoi Jakup Krasniqi, UÇK-ja u mbështet financiarisht prej dy fondeve.²⁷⁸ Fondi Bukoshi, krijuar në fund të vitit 1991 apo në fillim të 1992, i dha UÇK-së rreth 4 milion marka gjermane gjatë viteve 1998 dhe 1999.²⁷⁹ Fondi Vendlindja Thërret, krijuar në vitin 1995, kontrollohej nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së.²⁸⁰ Ai përdorej për financimin e transportit të armëve dhe të pajisjeve nga Shqipëria për në Kosovë.²⁸¹ Kontributet erdhën nga diaspora shqiptare dhe u nxitën nga komunikatat e UÇK-së.²⁸² Dëshmitari 17 i konfirmoi këto prova.²⁸³ Cufë Krasniqi dhe Dragan Zhivanoviqi dëshmuan se UÇK-ja mori fonde për të blerë armë nga donacionet e diasporës shqiptare dhe fonde të mbledhura nëpër fshatrat.²⁸⁴

77. Megjithëse dy dëshmitarë dëshmuan se kontrabanda në masë të madhe e armëve nga ana e UÇK-së nisi në fillim të vitit 1997, Dhoma Gjyqësore mori prova konkrete që vërtetuan këtë pretendim vetëm që prej marsit 1998. Zoran Stijoviqi dëshmoi se në fillim të vitit 1997, ra qeveria shqiptare dhe u plaçkitën depot e armëve në Shqipëri.²⁸⁵ Sipas dëshmitarit, në fillim të pranverës 1997, UÇK-ja filloi të kontrabandonte sasi të mëdha të armëve dhe të pajisjeve të tjera ushtarake nga Shqipëria në Kosovë.²⁸⁶ Dragan Zhivanoviqi e konfirmoi këtë dëshmi.²⁸⁷ Bislim Zyrapi dëshmoi se ishte në Shqipëri prej gjysmës së dytë të marsit deri më 28 maj 1998.²⁸⁸ Anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së e takuan atë shpesh për t'i kërkuar këshilla në lidhje me blerjen

²⁷³ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 47-48; Cufë Krasniqi, T. 5746, 5813; John Crosland, T. 2961-2962.

²⁷⁴ P1017 (Dragan Zhivanoviqi, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafi 61; P1022 (Urdhër i kolonelit Vladimiri Llazareviq, 22 prill 1998).

²⁷⁵ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 55; Dëshmitarja 28, T. 10197.

²⁷⁶ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 57-58.

²⁷⁷ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 63; Dëshmitarja 28, T. 10197.

²⁷⁸ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 5.

²⁷⁹ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 5.

²⁸⁰ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 5, Shtojca 17 (intervista e Jakup Krasniqit në Kohën Ditore, 11 korrik 1998), f. 6, Shtojca 18 (intervista e Jakup Krasniqit në Kohën Ditore, 12 korrik 1998), f. 2.

²⁸¹ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 5.

²⁸² P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 5, Shtojca 12 (deklarata politike e UÇK-së, 29 prill 1998), f. 3; shih gjithashtu Shtojcën 14 (deklarata politike e UÇK-së në Bujkun, 12 qershor 1998), Shtojca 16 (komunikata e UÇK-së në Kohën Ditore, 13 korrik 1998).

²⁸³ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafët 2, 5-6.

²⁸⁴ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 45; Cufë Krasniqi, T. 5712, 5798; Dragan Zhivanoviqi, T. 9294.

²⁸⁵ P931 (Zoran Stijoviqi, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 24, Zoran Stijoviqi, T. 9009-9010.

²⁸⁶ P931 (Zoran Stijoviqi, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 24, Zoran Stijoviqi, T. 9010-9011.

²⁸⁷ Dragan Zhivanoviqi, T. 9294.

²⁸⁸ P118 (Bislim Zyrapi, deklaratë dëshmitari, 25 nëntor 2005), paragrafi 17; Bislim Zyrapi, T. 3186, 3188-3190, 3257, 3396.

e armëve dhe furnizimet me armë për në Kosovë.²⁸⁹ Dëshmitari vizitoi ndërtesa private për të parë armët të nxjerra në shitje dhe çdo herë pa rreth 50-100 armë, shumë prej të cilave ishin të amortizuara prej dhjetra vitesh dhe disa nuk funksiononin më.²⁹⁰ Armët e siguruar në këtë mënyrë u transportuan për në Kosovë nga UÇK-ja.²⁹¹

78. Në fillim të vitit 1998, u shtua numri i kalimeve të paligjshme të kufirit në zonën kufitare Kosovë, Mali i Zi, Shqipëri.²⁹² Sipas Branko Gajiqit, pas operacionit në bvendbanimin familjar të Adem Jasharit më 5 mars 1998, UÇK-ja intensifikoi operacionet e kontrabandës së armëve nga Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia.²⁹³ John Crosland dëshmoi se deri më 24 mars 1998 UÇK-ja merrte furnizime nga Shqipëria dhe më vonë edhe nga Maqedonia.²⁹⁴ Sipas Cufë Krasniqit, rreth marsit 1998, njerëzit sillnin armë nga Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi.²⁹⁵ Pas marsit 1998, komandantët e fshatrave dërgonin të rinj te Ramush Haradinaj i cili ua përcillte kontakteve në Shqipëri për të marrë armë.²⁹⁶ Këta të rinj të paarmatosur shoqëroheshin zakonisht prej dy-tre ushtarësh të armatosur të UÇK-së dhe sillnin armët në fshatrat e tyre duke kaluar përmes maleve.²⁹⁷ Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se, duke filluar në prill 1998, grupe prej deri 200 personash prunë armë kontrabandë në Kosovë për UÇK-në.²⁹⁸ Udhërrëfyes të cilët njihnin mirë sistemin e sigurisë së kufirit shtetëror, i prinë kolonave me këmbësorë apo mushka nga përtej kufirit.²⁹⁹

79. Dhoma Gjyqësore mori prova konkrete për ekspeditat e kontrabandës nga Shqipëria në mars dhe prill 1998. Në fillim të marsit, Avdullah Avdija shkoi në Tropojë, Shqipëri, me tre shokë për të marrë armë.³⁰⁰ Dëshmitari deklaroi se në atë kohë nuk ishte anëtar i UÇK-së, por vullnetar.³⁰¹ Avdija nuk i njihje njerëzit që kontrollonin shpërndarjen dhe dhënien e armëve në Shqipëri.³⁰² Disa netë më vonë, ai u kthye me rreth 420 persona të tjerë, duke transportuar kallashnikovë dhe armë të tjera të ngarkuara mbi kuaj.³⁰³ Disa prej tyre mbanin uniforma.³⁰⁴ Ismet Kadrijaj dëshmoi se pas sulmit serb mbi shtëpinë e familjes Haradinaj në mars 1998, ai udhëtoi në Shqipëri me disa bashkëfshatarë për të blerë armë.³⁰⁵ Ylber Haskaj shkoi në Shqipëri bashkë me një numër të madh

²⁸⁹ Bislim Zyrapi, T. 3188-3191, 3197, 3259, 3263.

²⁹⁰ Bislim Zyrapi, T. 3197, 3267-3271, 3427-3428.

²⁹¹ Bislim Zyrapi, T. 3198, 3415-3416.

²⁹² Dragan Zhivanoviq, T. 9293.

²⁹³ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 17.

²⁹⁴ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), f. 1960.

²⁹⁵ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 45; Cufë Krasniqi, T. 5711-5712.

²⁹⁶ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 45; Cufë Krasniqi, T. 5709.

²⁹⁷ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 45; Cufë Krasniqi, T. 5848-5849.

²⁹⁸ Dragan Zhivanoviq, T. 9293.

²⁹⁹ Dragan Zhivanoviq, T. 9294, 9296-9297.

³⁰⁰ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 1; Avdullah Avdija, T. 10572-10573.

³⁰¹ Avdullah Avdija, T. 10579-10580.

³⁰² P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 1; Avdullah Avdija, T. 10574.

³⁰³ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 1; Avdullah Avdija, T. 10572-10573.

³⁰⁴ Avdullah Avdija, T. 10573, 10580.

³⁰⁵ P1233 (Ismet Kadrijaj, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2004), paragrafët 7-8.

fshatarësh nga Irzniqi për të blerë armë në mes të prillit 1998³⁰⁶ Ata udhëtuan në këmbë dhe ai solli me vete armë, municion dhe një uniformë për veten.³⁰⁷ Në fund të prillit 1998, Shaban Balaj udhëtoi me një grup prej rreth 500 personash nga disa fshatra për në Tropojë për të marrë armë dhe pajisje.³⁰⁸ Gjatë kthimit për në Kosovë, grupi, i cili bartte armët e blera (mitralozë 15 milimetërsh mbi trekëmbësh, mortaja me rreze veprimi të gjatë, automatikë dhe pushkë), shoqërohej nga rreth pesë ushtarët e UÇK-së.³⁰⁹ Dëshmitari ishte në dijeni për kolona të shumta të mëdha të cilat shkonin nga Kosovë për në Shqipëri në këtë periudhë.³¹⁰

80. Armët transportoheshin nëpërmjet rrugëve të njohura. Sipas Zoran Stijoviqit, këto kalonin përmes Jabllanicës dhe Glllogjanit.³¹¹ Branko Gajiqi konfirmoi se në mars 1998 kishte kalime të paligjshme përmes të cilave importoheshin sasi të mëdha armësh nga Shqipëria.³¹² John Crosland dëshmoi se armët hynin në Kosovë përgjatë rrugëve që kalonin kufirin RFJ/Shqipëri dhe se shumë rrugë kalonin përmes zonës së Dukagjinit për në Drenicë apo Mitrovicë.³¹³ Afërsisht më 24 prill 1998, UÇK-ja u përpoq të krijonte një korrridor nga Shqipëria për në perëndimin e Kosovës, zonën e Jabllanicës dhe më tej për në zonën e Drenicës, përgjatë të cilit ndodheshin disa shtabe të rëndësishëm të UÇK-së.³¹⁴ Branko Gajiqi e konfirmoi këtë dëshmi.³¹⁵ Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se armët shkonin në shtabet e fshatrave të Kosovës, të cilët ua shpërndanin vullnetarëve të UÇK-së.³¹⁶

81. Në muajt e parë të vitit 1998, UÇK-ja mori armë të lehta në krahasim më armët e forcave serbe. Në gjysmën e parë të vitit 1998, UJ-ja kapi kryesisht armë kineze të cilat kishin qenë të Ushtrisë Shqiptare.³¹⁷ Armët në fjalë përfshinin pushkë automatike dhe gjysmëautomatike, mitralozë, granthedhës dore, mortaja, mina kundër këmbësorisë, topa të palëvizshëm dhe municion.³¹⁸ Branko Gajiqi dëshmoi se në atë periudhë, UJ-ja zbuloi 25,000 armë të kalibrave dhe të llojeve të ndryshme, 500,000 fishekë dhe predha të kalibrave të ndryshme, 10.000 bomba dore, sasi të mëdha granathedhësish dhe mortajash, dhe disa tonelata pajisjesh ushtarake, siç duket, të

³⁰⁶ P1213 (Ylber Haskaj, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafi 6.

³⁰⁷ P1213 (Ylber Haskaj, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafi 6.

³⁰⁸ P922 (Shaban Balaj, deklaratë dëshmitari, 2 qershor 2007), paragrafët 5-6; Shaban Balaj, T. 8648.

³⁰⁹ P922 (Shaban Balaj, deklaratë dëshmitari, 2 qershor 2007), paragrafët 6-7.

³¹⁰ P922 (Shaban Balaj, deklaratë dëshmitari, 2 qershor 2007), paragrafët 8-9.

³¹¹ P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 25; Zoran Stijoviq, T. 9004, 9011-9015, 9028.

³¹² P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 19; P1150 (Raporti i Komandës së Brigadës së Motorizuar 549, 5 mars 1998), ff. 2-3.

³¹³ John Crosland, T. 2953, 2955-2959; P71 (Harta e shënuar nga John Crosland e cila tregon shtigjet që kalojnë kufirin RFJ/Shqipëri).

³¹⁴ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), f. 1897; P829 (Raporti për gjendjen, 24 prill 1998), paragrafi 5.

³¹⁵ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 33; P1142 (Raporti i Komandës së Brigadës së Motorizuar 549 për Komunën e Gjakovës në fillim të vitit 1998, 23 shkurt 1998), f. 3; P1166 (Raporti i Rregullt për Luftimet i Komandës së Korpusit të Prishtinës, 13 maj 1998), ff. 2-3.

³¹⁶ Dragan Zhivanoviq, T. 9297.

³¹⁷ Dragan Zhivanoviq, T. 9295.

³¹⁸ Dragan Zhivanoviq, T. 9295-9296.

braktisura nga anëtarët e UÇK-së gjatë përpjekjeve për të kaluar kufirin Shqipëri/Kosovë.³¹⁹ Prova të mëtejshme dhe përgjithësisht përputhëse për kontrabandën e armëve prej UÇK-së nga Shqipëria, u morën edhe nga Zharko Bajçetiqi³²⁰ dhe Dëshmitari 69.³²¹

82. Si pasojë e transportit të armëve përtej kufirit, serbët morën kundërmasa në mars dhe prill 1998. Branko Gajiqi dëshmoi se në mars 1998, Koloneli Deliq kërkoi autorizim për operacione kundër kontrabandës së armëve nga UÇK-ja dhe për sigurimin e kufirit.³²² Sipas Dragan Zhivanoviqit, duke filluar rreth prillit 1998, UJ-ja përforcoi postat kufitare në përgjigje të numrit të shtuar të kalimeve të kufirit.³²³ Branko Gajiqi dëshmoi se, për të penguar kontrabandën e armëve, Qeveria e RFJ-së vendosi më 23 prill 1998 të zgjeronte brezin kufitar me Shqipërinë, duke i dhënë ushtrisë përgjegjësinë deri pesë kilometra nga kufiri shqiptar.³²⁴

83. *Rekrutimet.* Paraqitja e parë publike e UÇK-së ishte më 28 nëntor 1997, gjatë varrimit të Halit Gecit, kur tre persona me uniforma të UÇK-së, mbajtën një fjalim duke bërë i thirrje popullit të Kosovës që të luftonte.³²⁵ Bislim Zyrapi, oficer i kualifikuar në APJ,³²⁶ dëshmoi se, që prej fundit të vitit 1997, përfaqësuesit e UÇK-së vizituan shoqata shqiptare në Evropë për të mbledhur fonde dhe për të rekrutuar personel për UÇK-në.³²⁷ Në një takim të tillë, në fillim të vitit 1998, dy anëtarë të UÇK-së, të cilët dinin për kualifikimin e tij ushtarak, e ftuan Zyrapi që të anëtarësohej në UÇK.³²⁸ Bislim Zyrapi dëshmoi se ai u vendos në Shqipëri në gjysmën e dytë të vitit 1998.³²⁹ Që prej asaj kohe, deri më 28 maj 1998, kur dëshmitari hyri në Kosovë, ai jetoi në një banesë në Tiranë me tre anëtarë të tjerë të UÇK-së, përfshirë tre ish-oficerë të APJ-së³³⁰ Branko Gajiqi dëshmoi se ekzistonte një rrjet ndërkombëtar në mbështetje të UÇK-së, i cili bazohej kryesisht në Gjermani, Suedi, Zvicër dhe Shqipëri.³³¹ Ky rrjet i dha fonde UÇK-së, rekrutoi anëtarë të rinj, organizoi

³¹⁹ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 15; Branko Gajiq, T. 9699-9700; shih gjithashtu P1143 (Raporti i Komandës së Brigadës së Motorizuar 549 i nënshkruar nga Lubisha Lojanica, 2 mars 1998).

³²⁰ P377 Zharko Bajçetiq, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafët 23-26, 28; Zharko Bajçetiq, T6381, 6414.

³²¹ P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë dëshmitari, 20 qershor 2007), paragrafët 20-21, 27. Dëshmitari 69, T. 9846.

³²² P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 20; për shembull P1151 (Raporti i Komandës së Brigadës së Motorizuar 549, 17 mars 1998); P1152 (Raporti i Komandës së Brigadës së Motorizuar 549, 23 mars 1998).

³²³ P1017 (Dragan Zhivanoviq, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafët 28, 65, 70; Dragan Zhivanoviq, T. 9299-9302, 9328; P1021 (Urdhër i Gjeneral-Majorit Nebojsa Pavkoviç, 18 mars 1998); P1024 (Urdhër i Gjeneral-Majorit Nebojsa Pavkoviç, 25 prill 1998); P1026 (Urdhër i Kolonelit Dragan Zhivanoviq, 27 prill 1998); P1027 (Urdhër i Kolonelit Vladimir Llazareviç, 27 prill 1998); P1029 (Urdhër i Kolonelit Vladimit Llazareviç, 1 maj 1998); P1030 (Urdhër i Kolonelit Vladimir Llazareviç, 2 maj 1998).

³²⁴ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 28; Branko Gajiq, T. 9688-9689; P1174 (Shpallje për zgjerimin e zonës kufitare, 18 maj 1998).

³²⁵ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafet 5-6; P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 4; P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 28.

³²⁶ P118 (Bislim Zyrapi, deklaratë dëshmitari, 25 nëntor 2005), paragrafi 2; Bislim Zyrapi, T. 3187.

³²⁷ Bislim Zyrapi, T. 3181-3183, 3201.

³²⁸ Bislim Zyrapi, T. 3181, 3185, 3188, 3201.

³²⁹ Bislim Zyrapi, T. 3186.

³³⁰ P118 (Bislim Zyrapi, deklaratë dëshmitari, 25 nëntor 2005), paragrafi 17; Bislim Zyrapi, T. 3188-3190, 3257, 3396.

³³¹ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 16.

udhëtimin e tyre në Shqipëri dhe stërvitjen e tyre atje dhe i futi në Kosovë, duke kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme.³³²

84. Dhoma Gjyqësore mori vlerësime të ndryshme për numrin e rekrutëve të UÇK-së në muajt e parë të vitit 1998. Branko Gajiqi dëshmoi se, në bazë të diskutimeve me anëtarë të burgosur të UÇK-së dhe me njerëzit të cilët kishin kontakt me UÇK-në, në janar, shkurt, dhe mars 1998, në Kosovë, UÇK-ja kishte deri 3.000 anëtarë të armatosur dhe të organizuar në njësi dhe, përveç atyre, 6.000-8.000 anëtarë me armë të cilët herë pas here merrnin pjesë në operacione.³³³ Një raport i UJ-së me datën 23 shkurt 1998, vlerësonte se, në fund të vitit 1997 dhe në fillim të vitit 1998, në Gjakovë ishin 200 ushtarë të UÇK-së, dhe veç tyre një numër më i madh punonin si bujq gjatë ditës dhe ushtarë të UÇK-së gjatë natës.³³⁴ Zoran Stijoviqi dëshmoi se sipas vlerësimit të RDB-së, deri më 30 mars 1998 UÇK-ja kishte në zonën e Jabllanicës 50 - 150 anëtarë të stërvitur ushtarakisht dhe të pajisur mirë.³³⁵ Përveç kësaj bërthame anëtarësh, UÇK-ja ishte një organizatë popullore me përkrahës në fshatra ku ajo ishte aktive.³³⁶ Sipas Jakup Krasniqit, para marsi 1998, UÇK-ja kishte më pak se 1000 ushtarë.³³⁷ Në bazë të vëzhgimeve të tij në terren, John Crosland vlerësoi se në periudhën mars - maj 1998, UÇK-ja përbëhej prej një bërthame 400-500 luftëtarësh.³³⁸

85. Kategoria e dytë e rekrutëve të UÇK-së, fshatarë vullnetarë që ndihmonin UÇK-në, filloi të zgjerohej në mënyrë të dukshme në mars dhe prill 1998. Jakup Krasniqi dëshmoi se nga prilli deri në gusht 1998, UÇK-ja u bë “ushtria e popullit”, së cilës iu bashkuan masivisht vullnetarë.³³⁹ Numri i vullnetarëve ishte kaq i madh sa Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së nuk mund t’i armatoste dhe disiplinonte tërësisht.³⁴⁰ Branko Gajiqi, Zoran Stijoviqi dhe Dëshmitari 17, konfirmuan shtimin e madh të rekrutëve të UÇK-së, të cilët dëshmuuan se shtimi kishte filluar që prej 5 dhe 6 marsit 1998.³⁴¹ Dëshmitarja 28 dëshmoi se që prej fundit të prillit 1998, UÇK-ja po mobilizonte fshatarët.³⁴² Provat e shqyrtuara më lart në këtë pjesë të aktgjykimit vërtetojnë se Avdullah Avdija, Ylber Haskaj, Ismet Kadrijaj, Pjetër Shala, Rustem Tetaj dhe Bislim Zyrapi u anëtarësuan në UÇK-në në mars apo prill 1998. Dëshmitarë të tjerë të cilët u anëtarësuan në UÇK gjatë asaj

³³² P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 16; për shembull P1144 (Raporti i Grupit 14 të Kundërzbulimit, 6 mars 1998); P1145 (Raporti i Grupit 14 të Kundërzbulimit, 11 mars 1998); P1146 (Raporti i Grupit 14 të Kundërzbulimit, 18 mars 1998); P1147 (Raporti i Grupit 14 të Kundërzbulimit, 8 prill 1998).

³³³ Branko Gajiq, T. 9684-9685, 9746-9749, 9807-9808.

³³⁴ Branko Gajiq, T. 9750-9753, 9807-9810; P1142 (Raporti i Komandës së Brigadës së Motorizuar 549 në Komunën e Gjakovës në fillim të vitit 1998, 23 shkurt 1998), f. 2.

³³⁵ Zoran Stijoviqi, T. 9065-9068.

³³⁶ Zoran Stijoviqi, T. 9066.

³³⁷ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 8.

³³⁸ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), f. 1919; John Crosland, T. 2963-2964, 3016-3017; P115 (Raport i Posaçëm i ECMM-së, 9 prill 1998), paragrafi 3.

³³⁹ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 8; P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2007), ff. 3330, 3378-3379, 3415, 3450-3452, 3470-3471; Jakup Krasniqi, T. 5007-5009.

³⁴⁰ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 8, Shtojca 18 (Intervista e Jakupit Krasniqit në Kohën Ditore, 12 korrik 1998), f. 3.

³⁴¹ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 7; P931 (Zoran Stijoviqi, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 38; P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 17; P970 (shkresë zyrtare e RDB-së, 10 mars 1998).

periudhe ishin Zymer Hasanaj,³⁴³ Shaban Balaj,³⁴⁴ dhe Ahmet Ukaj.³⁴⁵ Provat e shqyrtuara në pjesën 6.4 më poshtë, tregojnë praninë e një numri të madh ushtarësh të UÇK-së në komunën e Deçanit më 22 prill 1998.

86. *Stërvitja ushtarake.* Ish-polici Cufë Krasniqi filloi të stërviste ushtarë të UÇK-së në Vranoc, komuna e Pejës, në shkurt 1998.³⁴⁶ Rreth asaj kohe, shumica e të rinjve të cilët kishin armë nuk ishin të stërvitur.³⁴⁷ Fillimisht ai stërviti 21 ushtarë, por me kalimin e kohës numri i tyre u rrit dukshëm.³⁴⁸ Cufë Krasniqi i mësoi se si të përdornin armë dhe se si të trajtonin robërit e luftës, persona që dorëzoheshin dhe civilë.³⁴⁹ Ylber Haskaj dëshmoi se rreth mesit të prillit 1998, ai kreu një stërvitje fillestare në Irzniq dhe pastaj shërbeu si roje fshati.³⁵⁰ Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se mësoi herë pas here nga burimet e UJ-së, të MBP-së dhe të RDB-së se, që prej 28 shkurtit 1998, profesionistë stërvitnin ushtarë të UÇK-së në disa fshatra të komunës së Deçanit.³⁵¹ Bislim Zyrapi, i cili ishte në Shqipëri, siç u tha më lart, gjatë periudhës prej gjysmës së dytë të marsit deri më 28 maj 1998, dëshmoi se u vizitua shpesh nga anëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së për këshilla në stërvitjen ushtarake.³⁵² Gjithashtu ai mori pjesë fshehurazi në stërvitjen e rreth 300 rekrutëve të UÇK-së për taktikat ushtarake dhe përdorimin e armëve.³⁵³ Rekrutët stërviteshin mesatarisht për dy javë.³⁵⁴ Shpenzimet mbuloheshin nga dega e logjistikës e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, nga fondet e mbledhura jashtë vendit.³⁵⁵

87. *Operacionet, strategjia dhe taktikat ushtarake.* Taktika e hershme e UÇK-së konsistonte në pritrat ndaj forcave serbe, si për shembull sulmi ndaj një kolone policore në Llaushë, komuna e Skënderajt, më 26 nëntor 1997.³⁵⁶ Një pritë tjetër ndodhi më 28 shkurt 1998 në Likoshan, komuna e Glllogocit, gjatë të cilës u vranë katër policë dhe u plagosën dy të tjerë.³⁵⁷ Sipas Zoran Stijoviqit, deri në janar-shkurt 1998, UÇK-ja sulmonte postbllloqet e policisë, duke përdorur taktikën e sulmit dhe të tërheqjes së shpejtë, dhe duke shmangur luftën e hapur me forcat serbe.³⁵⁸ Ata përpiqeshin të shpërndanin forcat serbe dhe të tërhiqnin vëmendjen e tyre diku tjetër, larg nga vendi ku do të

³⁴² P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 72.

³⁴³ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafët 1-2; Zymer Hasanaj, T. 8720.

³⁴⁴ P922 (Shaban Balaj, deklaratë dëshmitari, 2 qershor 2007), paragrafët 4, 17; Shaban Balaj, T. 8649, 8703.

³⁴⁵ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 1.

³⁴⁶ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 24, 30-31; Cufë Krasniqi, T. 5715, 5795, 5851.

³⁴⁷ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 28.

³⁴⁸ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 34; Cufë Krasniqi, T. 5715.

³⁴⁹ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 34; Cufë Krasniqi, T. 5715, 5721.

³⁵⁰ P1213 (Ylber Haskaj, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafët 1, 6.

³⁵¹ P1017 (Dragan Zhivanoviq, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafi 26; Dragan Zhivanoviq, T. 9318-9319, 9321-9323, 9414-9415.

³⁵² Bislim Zyrapi, T. 3188-3191, 3197, 3259, 3263.

³⁵³ Bislim Zyrapi, T. 3191-3193, 3411, 3430.

³⁵⁴ Bislim Zyrapi, T. 3194.

³⁵⁵ Bislim Zyrapi, T. 3193, 3265.

³⁵⁶ P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafët 27, 37; Zoran Stijoviq, T. 8939-8940, 9015-9016, 9054-9055.

³⁵⁷ P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 37; Zoran Stijoviq, T. 9031, 9054-9057; P1017 (Dragan Zhivanoviq, deklaratë, 9 gusht 2007), paragrafi 24, Dragan Zhivanoviq, T. 9314-9315.

³⁵⁸ P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 32; Zoran Stijoviq, T. 9020-9023, 9029-9030, 9055.

sulmonin.³⁵⁹ John Crosland dëshmoi se, pas sulmit mbi vendbanimin e familjes Jashari në mars 1998, ata mësuan që të mos luftonin me forcat serbe në terren të hapur, për shembull në terrenin e Drenicës, sepse ky terren u jepte përparësi forcave serbe të armatosura dhe të pajisura më mirë.³⁶⁰ Më 9 prill 1998, Crosland raportoi se ushtarët e UÇK-së ishin të shpërndarë gjithandej në krahinë me synim shpërhapjen e forcave policore në një dislokim të gjerë, duke mundësuar kështu disa objektiva të cënueshme që mund të sulmoheshin më lehtë.³⁶¹ Ai raportoi gjithashtu se UÇK-ja ndodhej në hapat e parë të një lëvizjeje kryengritëse, duke përdorur kryesisht taktikën e sulmit dhe të tërheqjes së shpejtë.³⁶² Sipas Jakup Krasniqit, rreth asaj kohe, UÇK-ja ishte një ushtri guerile, e cila vepronte në fshehtësi dhe përdorte taktikën e sulmit dhe të tërheqjes së shpejtë.³⁶³

88. *Aftësia për të folur me një zë.* Jakup Krasniqi dëshmoi se gjatë vitit 1997 dhe deri në vitin 1998, ishte marrë me lëshimin e komunikatave politike në emër të UÇK-së³⁶⁴ Deri më 11 qershor 1998, komunikatat e UÇK-së lëshoheshin nga njësitë e UÇK-së në emër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.³⁶⁵ Komunikatat e UÇK-së synonin të informonin publikun për veprimtarinë e UÇK-së, por përdorshin gjithashtu si propagandë, duke zmadhuar fitoret dhe nivelin organizativ të UÇK-së, dhe duke zvogëluar dështimet dhe humbjet e saj, për ngritjen e moralit dhe famës së UÇK-së dhe nxitjen e rekrutimeve.³⁶⁶ Dhoma Gjyqësore ka pranuar si provë komunikata të UÇK-së të datuara prej qershorit të vitit 1995 deri në gusht të vitit 1998.³⁶⁷

89. Provat e mësipërme tregojnë se, përveç qindra, në mos mijëra ushtarësh të kualifikuar të UÇK-së në fillim të vitit 1998, gjatë muajve mars dhe prill në UÇK u anëtarësuan shumë vullnetarë. Kjo rezultoi në zhvillimin e një organizate ushtarake kryesisht spontane dhe fillestare në nivel fshati. Provat tregojnë se në prill jemi në fazat fillestare të një strukture komanduese qendrore mbi nivelin e komandave të ndryshme në fshatra, në veçanti pas përpjekjeve të Ramush Haradinajt, i cili po përforconte pushtetin e tij faktik. Në këtë periudhë, UÇK-ja kontrollonte një pjesë të konsiderueshme të territorit të Dukagjinit me anë të postblloqëve dhe të ushtarëve të armatosur. Ajo kishte krijuar një bazë logjistike që mundësonte marrjen e armëve të shumta, megjithëse mund të mos kenë mjaftuar për armatosjen e të gjithë rekrutëve të rinj. Për më tepër, provat vërtetojnë se

³⁵⁹ Zoran Stijoviq, T. 9058-9059.

³⁶⁰ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1879, 1881; John Crosland, T. 2931-2932.

³⁶¹ John Crosland, T. 3016-3017; P115 (Raporti i Posaçëm i ECMM-së, 9 prill 1998), paragrafët 3-4.

³⁶² John Crosland, T. 3016-3017; P115 (Raport i Posaçëm i ECMM-së, 9 prill 1998), paragrafët 3-4.

³⁶³ P328 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 24 maj 2007), paragrafi 8; P340 Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3330, 3378, 3450-3451; Jakup Krasniqi, T. 4949, 5007.

³⁶⁴ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3230, 3430; Jakup Krasniqi, T. 4949, 4952, 5010-5011, 5015-5016, 5032-5033.

³⁶⁵ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3314-3315, 3317-3318, 3320, 3430; Jakup Krasniqi, T. 4948-4949, 4965, 5032-5034, 5122.

³⁶⁶ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 10-12 shkurt 2005), ff. 3321-3327, 3339-3341, 3346, 3350-3351, 3353-3354, 3377, 3419-3420; Jakup Krasniqi, T. 4953-4954, 4967-4968, 4978-4980, 5011-5012, 5035, 5038, 5044.

³⁶⁷ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), Shtojca 1-10, 13, 15-18; P937; P938; P940; P943; P944; P945; P947; P948; P951; P952; P953; P954; P958; P063; P964; P966.

ushtarët e UÇK-së së paku kryen stërvitje ushtarake fillestare dhe përdorën taktika guerilase. Së fundi, UÇK-ja lëshoi komunikata në emrin e vetë. Në bazë të këtyre provave, dhe duke marrë parasysh përfundimet e Dhomës Gjyqësore në pjesën e mëposhtme 3.2.2, Dhoma Gjyqësore është e bindur se më 22 prill 1998, UÇK-ja ishte një “grup i armatosur i organizuar” sipas kushtit *Tadiq*.

3.2.2 Ashpërsia

90. Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë kronologjikisht, provat në lidhje me ashpërsinë e konfliktit midis UÇK-së dhe forcave serbe në Kosovë, duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët tregues të përshkruar në paragrafin 49.

91. Dhoma Gjyqësore mori disa prova statistikore për sulmet e UÇK-së që prej periudhës fillim deri në mes të viteve ‘90, të cilat ajo i shfrytëzon vetëm si shenja të hershme të veprimtarisë së UÇK-së. Duke përdorur raportet e mediave dhe të dhëna të UJ-së dhe të MPB-së, Zoran Stijoviqi llogariti se numri i sulmeve të UÇK-së u rrit nga nëntë në vitin 1995 në 1,486 në vitin 1998 (pa përfshirë dhjetorin 1998).³⁶⁸ Me termin “sulm” Zoran Stijoviq identifikonte një ngjarje në të cilën përdorehin armë zjarri, bombë dore dhe lëndë të tjera shpërthyes kundër civilëve apo anëtarëve të MPB-së apo të UJ-së.³⁶⁹ Që prej fundit të vitit 1994, UÇK-ja lëshoi komunikata ku merrte përsipër përgjegjësinë për sulme të tilla.³⁷⁰ Branko Gajiqi dëshmoi se UÇK-së filloi të sulmonte UJ-në gjatë kufirit me Shqipërinë në vitin 1996.³⁷¹ Gajiqi përkufizoi “sulmin” si një grup i organizuar me të paktën tre persona dhe me një qëllim të caktuar.³⁷² Gajiqi dëshmoi se në vitin 1997 u kryen 55 sulme të UÇK-së kundër UJ-së gjatë kufirit shqiptar dhe 51 sulme të tjera në pjesën tjetër të Kosovës.³⁷³ Sipas Gajiqit, raporte të kundërzbulimit serb tregojnë se ky numër u shtua në vitin 1998 në 196 sulme përgjatë kufirit shqiptar dhe 191 sulme në pjesën tjetër të Kosovës.³⁷⁴

92. Dhoma Gjyqësore mori prova të dorës së dytë për dy përleshje të mëdha midis UÇK-së dhe forcave serbe në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit 1998, të cilat ajo i përdor vetëm për të përfunduar se këto përleshje ndodhën. John Crosland dëshmoi se më 28 shkurt dhe 1 apo 5 mars 1998, forcat serbe të sigurisë sulmuan vendbanimin e familjes Ahmeti në Likoshan dhe vendbanimin e familjes Jashari në Prekazin e Poshtëm, komuna e Skënderajt.³⁷⁵ Në këtë rast në

³⁶⁸ P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafët 20, 62; Zoran Stijoviq, T. 8933-8940, 8943-8947, 9058.

³⁶⁹ P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafët 20, 62; Zoran Stijoviq, T. 8934-8936.

³⁷⁰ P931 (Zoran Stijoviq, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafët 19-20, 33, 35; Zoran Stijoviq, T. 8940, 8987-8988.

³⁷¹ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 11.

³⁷² Branko Gajiq, T. 9683.

³⁷³ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 11; Branko Gajiq, T. 9681-9683.

³⁷⁴ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 11; Branko Gajiq, T. 9682-9684.

³⁷⁵ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1858-1860; John Crosland, T. 2932, 3098; P819 (Raport mbi gjendjen, 2 mars 1998), paragrafët 1, 3.

Likoshan u vranë 26 persona.³⁷⁶ Sulmi zgjati rreth 36 orë dhe ishte një reagim ndaj sulmit mbi stacionin e MPB-së në Runik, komuna e Skënderajt, ku u vranë tre apo katër policë serbë.³⁷⁷ Luftime të ashpra pati gjatë sulmit mbi vendbanimin e familjes Jasharit, në të cilin forcat serbe të sigurisë dispononin 1.500 deri 2.000 njerëz dhe përdorën autobllinda dhe armë të rënda.³⁷⁸ Sipas Crosland-it, forcat serbe përdorën forcë jashtëzakonisht të ashpër gjatë operacionit kryesisht të MBP-së.³⁷⁹ Vendbanimi i familjes Jashari u dëmtua rëndë, dhe pati 54 të vrarë në anën shqiptare kosovare.³⁸⁰ Crosland i pa kufomat e tyre dy-tre ditë pas përlëshjes dhe vuri re se ishin individë të moshave të ndryshme të aftë për të luftuar, por gjithashtu pleq, gra dhe fëmijë, asnjë prej tyre me uniformë, dhe se shumë prej tyre ishin qëlluar nga afër.³⁸¹ Dhoma Gjyqësore mori gjithashtu dëshmi përputhëse të dorës së dytë nga Rustem Tetaj,³⁸² Dëshmitarja 28,³⁸³ Dëshmitari 17³⁸⁴ dhe Zoran Stijoviqi³⁸⁵ për përlëshje në shtëpitë e familjeve Ahmeti dhe Jashari.

93. Zoran Stijoviqi dhe Branko Gajiqi dëshmuuan se pas operacionit kundër shtëpisë së Adem Jasharit më 5 mars 1998, UÇK-ja shtoi sulmet kundër forcave serbe.³⁸⁶ Prova konkrete të marra nga Dhoma Gjyqësore nuk e vërtetojnë këtë pretendim. Rrjedhimisht për periudhën midis 6 marsit dhe 23 marsit 1998, ajo preferon të përdorë dëshminë e John Crosland-it e cila përshkruan një periudhë relativisht të qetë dhe forcat serbe në gatishmëri të lartë. Më 8 mars 1998, ambasadori britanik Brian Donnelly, duke shfrytëzuar vëzhgimet në terren të John Crosland-it, raportoi se Prekazi ishte bërë i qetë, por se në disa pjesë të Drenicës mbetej një prani e dendur e policisë dhe postbllloqe rrugore të policisë.³⁸⁷ Për më tepër, ai informoi se nuk kishte shenja të përfshirjes së UJ-së, përveç vënies në dispozicion të automjeteve të transportit.³⁸⁸ Ai raportoi gjithashtu se shumë gra dhe fëmijë kishin ikur prej zonës.³⁸⁹ Më 9 mars 1998, Donnelly raportoi për operacione policore në vazhdim në zonën e Llaushës.³⁹⁰ Më 13 mars 1998, policia speciale mbeti e pozicionuar në Prekaz dhe zona e Drenicës mbeti përgjithësisht e qetë, por UJ-ja ishte në gatishmëri të lartë në zonën e Pejës dhe të Gjakovës.³⁹¹ Më 17 mars 1998, Crosland vizitoi zonën e Drenicës dhe vuri re praninë e dukshme të PJP-së në rrugën Llaushë-Klinë, duke përfshirë postbllloqet dhe pozicionet e PJP-së.³⁹² Ai deklaroi

³⁷⁶ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), f. 1863; John Crosland, T. 3098-3099.

³⁷⁷ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1861, 1863, 1865; John Crosland, T. 2931.

³⁷⁸ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1863, 1865; John Crosland, T. 2932-2933.

³⁷⁹ John Crosland, T. 2932, 2934-2935, 3100.

³⁸⁰ John Crosland, T. 2932-2933.

³⁸¹ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1863-1864; John Crosland, T. 2932-2933, 2935-2936.

³⁸² Rustem Tetaj, T. 3701.

³⁸³ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 17-20; Dëshmitarja 28, T. 10169-10170, 10172-10174, 10205, 10295; shih gjithashtu P6 (Spotlight Report, numrat 26 dhe 27).

³⁸⁴ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 7.

³⁸⁵ P931 (Zoran Stijoviqi, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 38; Zoran Stijoviqi, T. 9173-9174.

³⁸⁶ P931 (Zoran Stijoviqi, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafi 37; Zoran Stijoviqi, T. 9246; P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 17. Shih edhe P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 56.

³⁸⁷ John Crosland, T. 2928; P73 (Raport mbi gjendjen, 8 mars 1998), paragrafët 2-4.

³⁸⁸ P73 (Raport mbi gjendjen, 8 mars 1998), paragrafi 5.

³⁸⁹ P73 (Raport mbi gjendjen, 8 mars 1998), paragrafi 7.

³⁹⁰ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1864-1866; P820 (Raport mbi gjendjen, 9 mars 1998), paragrafi 2.

³⁹¹ P74 (Raport mbi gjendjen, 13 mars 1998), paragrafi 4.

³⁹² P76 (Raport mbi gjendjen, 18 mars 1998), paragrafi 3.

se prania e rreth 150 policëve të PJP-së dhe të 50 policëve të rregullt në një zonë prej dhjetë kilometrash katrore tregoi se operacioni vazhdonte.³⁹³ Më 23 mars 1998, Donnelly përmendi raportin e Crosland-it ku thuhej se policia speciale ndodhej ende në zonën e Drenicës, megjithëse me më pak forca, por po ndërtonte infrastrukturë për një qëndrim më të gjatë aty.³⁹⁴ Më 24 mars 1998, Donnelly raportoi se Crosland-i e kishte informuar se kishte ende shumë policë të pranishëm, 100-200 sish me autobllinda dhe postbllloqe në zonën e Drenicës, si dhe forca të posaçme të UJ-së në gjendje të gatishmërisë së lartë në zonat e Deçanit dhe të Gjakovës.³⁹⁵

94. Dhoma Gjyqësore dëgjoi shumë dëshmi për përleshjen në vendbanimin e familjes së Haradinajt më 24 mars 1998. Ajo shfrytëzoi në veçanti dëshminë e Radovan Zllatkoviqit, i cili, rreth orës 11:00 të datës 24 mars 1998, shkoi në Gllogjan për të hetuar vdekjen e një polici, Miodrag Otoviq, shefi i MPB-së së Irzniqit, në një shkëmbim zjarri.³⁹⁶ Kur dëshmitari erdhi në fshat, ende vazhdonin luftimet midis MPB-së dhe përkrahësve të UÇK-së.³⁹⁷ Zllatkoviqi dhe kolegët e tij kryen një hetim në vendin e ngjarjes në rrugën ku ra Otoviqi kur u qëllua, si dhe në oborrin e shtëpisë së Ramush Haradinajt që ndodhej afër.³⁹⁸ Brenda oborrit të shtëpisë së Haradinajt ata gjetën bombë dore, mina kundërtanke dhe një mitraloz të lehtë.³⁹⁹ Për shkak të ashpërsimit të luftimeve, ata u strehuan në një shtëpi rreth 150 metra nga shtëpia e Haradinajt, ku mbetën deri në fund të ditës.⁴⁰⁰ Prej aty, Zllatkoviqi pa luftime dhe dëgjoi zhurmën e të shtënave dhe shpërthimet e bombave në të gjitha drejtimet.⁴⁰¹ Sipas dëshmitarit, të dy palët përdorën bomba, pushkë automatike dhe gjysmëautomatike.⁴⁰² Ai vlerësoi se UÇK-ja këtu kishte rreth 40 luftëtarë.⁴⁰³ Gjatë ditës u përforcuan oficerët e MPB-së; së pari policët e Deçanit u nisën për në Gllogjan për të ndihmuar patrullën policore ku bënte pjesë Otoviqi; më pas erdhi policia e Gjakovës; dhe në fund erdhi njësia kundërterroriste e MPB-së e cila nuk mori pjesë në luftimet.⁴⁰⁴ Shkëmbimi i zjarrit vazhdoi deri rreth orës 20:00, kur forcat e MPB-së u tërhoqën nga Gllogjani.⁴⁰⁵ Përveç vrasjes së Otoviqit, sipas Zllatkoviqit u plagosën katër policë të MPB-së dhe u vranë dy të rinj të UÇK-së.⁴⁰⁶ Dhoma Gjyqësore mori gjithashtu prova pak a shumë përputhëse për këtë përleshje nga Ramo Jollaj,⁴⁰⁷ Rrustem Tetaj,⁴⁰⁸ Zoran Stijoviqi,⁴⁰⁹ Branko Gajiqi,⁴¹⁰ Dragoslav Stojanoviqi⁴¹¹ dhe Mijat

³⁹³ P76 (Raport mbi gjendjen, 18 mars 1998), paragrafi 3.

³⁹⁴ P77 (Raport mbi gjendjen, 23 mars 1998), paragrafët 3, 8.

³⁹⁵ John Crosland, T. 3000-3001; P78 (Raport mbi gjendjen, 24 mars 1998) paragrafi 3.

³⁹⁶ Radovan Zllatkoviq, T. 6865, 6867.

³⁹⁷ P854 (Radovan Zllatkoviq, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafi 23; Radovan Zllatkoviq, T. 6865.

³⁹⁸ Radovan Zllatkoviq, T. 6868, 6875.

³⁹⁹ P854 (Radovan Zllatkoviq, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafi 24.

⁴⁰⁰ Radovan Zllatkoviq, T. 6868-6869, 6900-6902, 7007; P818 (Fotografia ajrore e zonës rreth shtëpisë së Haradinajt me shënimet e dëshmitarit).

⁴⁰¹ Radovan Zllatkoviq, T. 6869-6870, 6879.

⁴⁰² Radovan Zllatkoviq, T. 6867-6868, 6877.

⁴⁰³ P854 (Radovan Zllatkoviq, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafi 23; Radovan Zllatkoviq, T. 6877, 6899-6900.

⁴⁰⁴ Radovan Zllatkoviq, T. 6866.

⁴⁰⁵ Radovan Zllatkoviq, T. 6865-6866.

⁴⁰⁶ P854 (Radovan Zllatkoviq, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafi 26-27; Radovan Zllatkoviq, T. 6867.

⁴⁰⁷ Ramo Jollaj, T. 8193-8194, 8197-8204, 8207, 8215-8218, 8222-8225, 8227-8229.

⁴⁰⁸ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafët 8-10, 13; Rrustem Tetaj, T. 3702-3704, 3797.

Stojanoviqi.⁴¹² Dy dëshmitarët e fundit dëshmuar gjithashtu se pas kësaj dite, ata e lëshuan shtëpinë e tyre në Dubravë për arsye sigurie.⁴¹³ Më 24 mars 1998, John Crosland raportoi për shkëmbime zjarri në disa fshatra midis Deçanit dhe Gjakovës, dhe në Jashanicë të Drenicës.⁴¹⁴ Në këtë zonë, policia speciale serbe kishte dislokuar armë të rënda, përfshirë sistemin kundërajror PRAGA dhe autobлиндë BOV-3 me një top tritytësh.⁴¹⁵

95. Dhoma Gjyqësore ka marrë pak prova konkrete për përleshje midis UÇK-së dhe forcave serbe prej 25 marsit deri më 21 prill 1998. Më 1 prill 1998, Donnelly raportoi se, sipas Crosland-it, gjendja ishte ende e qetë në tërë Kosovën dhe se numri i policëve speciale nuk kishte ndryshuar, megjithëse dukej se ishin në një gjendje gatishmërie më të ulët.⁴¹⁶ Më 9 prill 1998, Donnelly raportoi për incidente të vogla në zonat e Drenicës dhe të Deçanit, duke përfshirë një sulm mbi një postbllok policor nga persona të panjohur.⁴¹⁷ Më 13 prill 1998, persona të panjohur sulmuan dhe dëmtuan një stacion policor në një lagje në periferi të Prishtinës, dhe një polic u plagos.⁴¹⁸ Më 15 prill 1998, gjendja në Kosovë ishte relativisht e qetë, përveç pak incidenteve ku persona të panjohur qëlluan mbi policët.⁴¹⁹

96. Të paktën deri në fund të prillit, forcat serbe kishin granatuar zonën e Dukagjinit. Shemsedin Cekaj dëshmoi se jo më vonë se 21 prill 1998 deri në fund të majit 1998, ai dëgjoji prej shtëpisë në Pejë dhe nga Irzniqi, ku udhëtoi herë pas here, granatime thujse të përditshme të disa fshatrave në jug.⁴²⁰ Rustem Tetaj dëshmoi së Glllogjani u granatua vazhdimisht prej prillit deri në shtator 1998.⁴²¹ Cufë Krasniqi dëshmoi se nga prilli 1998 deri në fund të gushtit 1998, fshatrat e Dukagjinit u granatuan nga artileria serbe, gjë që detyroi njerësit të braktisnin fshatrat e tyre në maj 1998.⁴²² Dëshmitarja 28 dëshmoi se, deri më 22 prill 1998, ajo kishte dëgjuar nga refugjatët shqiptarë për granatime të zgjeruara në komunën e Deçanit prej policisë serbe.⁴²³ ECMM-ja raportoi se forcat serbe qëlluan mbi fshatra të komunës së Deçanit më 23 prill 1998.⁴²⁴

⁴⁰⁹ P931 (Zoran Stijoviç, deklaratë, 27 shtator 2007), paragrafi 41; Zoran Stijoviç, T. 8992, 9253-9254.

⁴¹⁰ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë, 2 tetor 2007), paragrafi 21; P1153 (Raporti i Brigadës së Motorizuar 549 nënshkruar nga Bozidar Deliq, 30 mars 1998), ff. 1-2.

⁴¹¹ Dragosllav Stojanoviç, T. 1858-1860, 1968-1973, 1977.

⁴¹² Mijat Stojanoviç, T. 2005-2010, 2103-2104.

⁴¹³ Dragoslav Stojanoviç, T. 1844-1845, 1860-1861, 1881-1882, 1940, 1973; Mijat Stojanoviç, T. 1985, 2011-2012.

⁴¹⁴ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1867, 1869-1873; John Crosland, T. 3001-3002, 3104-3106; P822 (Raport mbi gjendjen, 24 mars 1998), paragrafët 2-3.

⁴¹⁵ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1863; P822 (Raport mbi gjendjen, 24 mars 1998), paragrafi 4.

⁴¹⁶ P79 (Raport mbi gjendjen, 1 prill 1998), paragrafi 6.

⁴¹⁷ P81 (Raport mbi gjendjen, 9 prill 1998), paragrafi 6.

⁴¹⁸ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1882-1884; P826 (Raport mbi gjendjen, 15 prill 1998), paragrafi 2.

⁴¹⁹ P83 (Raport mbi gjendjen, 16 prill 1998), paragrafi 2.

⁴²⁰ Shemsedin Cekaj, T. 4387-4390, 4471-4474.

⁴²¹ Rustem Tetaj, T. 3624-3725, 3730, 3831-3832, 3844, 3847-3848; D38 (Harta e zonës së Dukagjinit, shënuar me të kaltër dhe të kuqe nga Rustem Tetaj); P268 (Harta e rrethinës së kanalit të Radoniqit, shënuar nga Rustem Tetaj).

⁴²² P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 56, 90.

⁴²³ Dëshmitarja 28, T. 10264-10265.

⁴²⁴ P290 (Raporti ditor për selinë qendror të ECMM-së, 24 prill 1998), f. 2.

97. Provat tregojnë se deri në fund të prillit, civilët po zhdukeshin apo po iknin nga zonat e luftimit në komunën e Deçanit. Dhoma Gjyqësore shqyrton prova të tilla në pjesët e mëposhtme 4.2, 6.5, 6.6, 6.7 dhe 6.12.3. Gjithashtu Zvonko Markoviqi dëshmoi se shqiptarët kalonin përmes Lumbardhës duke shtirë dhe si pasojë, rreth kësaj kohe të gjithë serbët nga rreth gjashtë shtëpi serbe të fshatit ikën për në Deçan.⁴²⁵ Cufë Krasniqi konfirmoi se familjet serbe u larguan nga komuna e Deçanit në prill dhe maj 1998.⁴²⁶

98. Dhoma Gjyqësore mori prova të besueshme bashkëkohëse që treguan se përlëshjet midis UÇK-së dhe forcave serbe rifilluan më 22 prill 1998. Në mëngjesin e datës 22 prill 1998, 20-30 persona sulmuan batalionin nr 52 e policisë ushtarake prej një kodre me emrin Suka e Vogël, dhe forcat serbe u përgjigjën me një top kundërajror dytytësh dhe një haubicë 155-milimetërshe.⁴²⁷ Gjatë pasditës së hershme, u krye një sulm tjetër kundër batalionit nr 52 të policisë ushtarake prej Sukës së Vogël.⁴²⁸ Gjithashtu në të njëjtën ditë, ndodhi një shkëmbim zjarri midis trupave të batalionit kufitar nr 53 dhe personave në një barrikadë në Baballoq, komuna e Deçanit.⁴²⁹ Koloneli Deliq urdhëroi dislokimin e forcave të gatishmërisë në përgjigje të veprimeve të UÇK-së.⁴³⁰ John Crosland vuri re se më 23 prill 1998, gjendja në Deçan dhe në Gjakovë ishte jashtëzakonisht e nderë pas të shtënave të shumta në atë zonë një ditë më parë, ku si pasojë, shumë civilë serbë dhe shqiptarë kosovarë, ikën prej zonave më të prekura.⁴³¹ Sipas tij, përlëshjet, të cilat kishin filluar në Drenicë, tani ishin zhvendosur në zonën e Deçanit.⁴³² Atë ditë, Crosland ishte në zonën e Deçanit ku vëzhgoi një prani “të paparë” trupash dhe materiali të UJ-së, përfshirë topa të rëndë të dislokuar në pozicione strategjike afër kufirit RFJ-Shqipëri, kolona me kamionë të mbushur me ushtarë, helikopterë të tipit Gazelle dhe një aeroplan bombardues Orao (“Shqiponjë”).⁴³³ Ai raportoi gjithashtu se qendra e refugjatëve serbë afër Baballoqit mbrohej prej rreth 100 anëtarësh të MBP-së,⁴³⁴ dhe se jeta në qytetet kryesore si Pejë dhe Gjakovë vazhdonte normalisht.⁴³⁵ Në të njëjtën ditë, UJ-ja nga postblloku kufitar i Koshares luftoi më UÇK-në në kufirin RFJ/Shqipëri, duke vrarë 16

⁴²⁵ Zvonko Markoviqi, T. 2327-2328, 2341-2343.

⁴²⁶ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 74.

⁴²⁷ P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafi 62; P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 23; P1022 (Urdhër i Kolonelit Vladimir Lazareviç, 22 prill 1998), paragrafi 1; P1091 (Raporti i Kolonelit Vladimir Lazareviç për sulmet e UÇK-së kundër UJ-së, 1 shtator 1998), f. 1; P1155 (Raporti i luftimit nga postkomanda pararojë e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1998), paragrafi 1-2; P1156 (Raporti i zbulimit nga postkomanda pararojë e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1998), paragrafi 8.

⁴²⁸ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 23; P1156 (Raporti i zbulimit nga postkomanda pararojë e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1998), paragrafi 8.

⁴²⁹ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 23; P1155 (Raporti i luftimit nga postkomanda pararojë e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1998), paragrafi 4; P1156 (Raporti i zbulimit nga postkomanda pararojë e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 22 prill 1998), paragrafi 8, Shih gjithashtu John Crosland, T. 3006-3007; P84 (Raporti mbi gjendjen, 22 prill 1998).

⁴³⁰ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 24; Branko Gajiq, T. 9702-9704; P1157 (Urdhër për dislokimin e forcave të gatishmërisë, 22 prill 1998), ff. 1-6.

⁴³¹ P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), f. 1887; P828 (Raport mbi gjendjen, 23 prill 1998), paragrafi 2.

⁴³² P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1887-1889; P828 (Raport mbi gjendjen, 23 prill 1998), paragrafi 3.

⁴³³ John Crosland, T. 3008-3009; P85 (Raport mbi gjendjen, 23 prill 1998), paragrafi 2.

⁴³⁴ P85 (Raport mbi gjendjen, 23 prill 1998), paragrafi 2.

⁴³⁵ P85 (Raport mbi gjendjen, 23 prill 1998), paragrafi 3.

prej tyre.⁴³⁶ Gjatë natës, batalioni 52 i policisë ushtarake u qëllua për një kohë të gjatë me automatikë dhe mortaja.⁴³⁷ Në mëngjesin e datës 24 prill 1998, persona të paidentifikuar sulmuan postbllokun policor në Turiçec, komuna e Skënderajt, duke vrarë një polic dhe duke plagosur rëndë një tjetër.⁴³⁸ Rreth mesditës, u sulmua stacioni policor në Kliqinë, komuna e Pejës.⁴³⁹ Në mbrëmjen e datës 25 prill 1998, UÇK-ja sulmoi me këmbësori batalionin 52 të policisë ushtarake në digën e Liqenit të Radoniqit.⁴⁴⁰ Më 27 prill 1998, ndodhën tri përlëshje të ndryshme midis UÇK-se dhe UJ-së në kufirin RFJ/Shqipëri.⁴⁴¹ Të nesërmen, Crosland vëzhgoi lëvizje të më shumë ushtarëve dhe të materialit të UJ-së, përfshirë artileri, të cilët ai i pa për herë të parë të përfshirë në operacione të përbashkëta me MPB-në.⁴⁴² Ai vlerësoi se numri i policëve dhe të UJ-së në Kosovë ishte më i lartë se më parë gjatë krizës, duke qenë se kishin ardhur përforcime nga jashtë krahinës.⁴⁴³

99. Sulmet mbi shtëpitë e Ahmetëve, Jasharëve dhe Haradinajve prej fundit të shkurtit deri në fund të marsit 1998 shënuan një shkallëzim të dukshëm të konfliktit midis UÇK-së dhe forcave serbe. Mirëpo këto ishin ngjarje të veçuara pasuar prej periudhave relativisht të qeta. Më 22 prill 1998 konflikti u ashpërsua. Duke marrë veçanërisht parasysh granatimet e shpeshta në komunën e Deçanit, ikjen e civilëve nga fshatrat, përlëshje të përditshme mes UÇK-së dhe forcave serbe dhe shkallën e paparë të dislokimit të forcave të UJ-së në terren dhe pjesëmarrjen e tyre në luftime, Dhoma Gjyqësore përfundon se, në bazë të provave në dispozicion, më 22 prill 1998 konflikti përmbushte kërkesën e ashpërsisë së kushtit *Tadiq*.

3.2.3 Përfundim

100. Duke marrë parasysh provat dhe përfundimet e Dhomës Gjyqësore në lidhje me të dy elementë e kushtit *Tadiq*, Dhoma Gjyqësore është e bindur se duke filluar nga data 22 prill 1998 dhe më tej në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur. Dhoma Gjyqësore mori një sasi shumë të madhe provash lidhur me konfliktin e armatosur nga maji deri një shtator 1998. UÇK-ja zhvilloi më tej organizimin e saj gjatë periudhës së përfshirë në Aktakuzë. Operacionet luftarake vazhduan dhe u ashpërsuan dukshëm gjatë ofensivave të mëdha të forcave serbe në zonën e Dukagjinit në fund të majit, në fillim deri në mes të gushtit dhe në fillim të shtatorit 1998.⁴⁴⁴ Mirëpo, meqenëse sipas

⁴³⁶ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 25; P1091 (Raport i kolonelit Vlladimir Llazareviq), 1 shtator 1998, f. 1; P1158 (Raporti i operacioneve nga Komanda e Korpusit të Prishtinës, 23 prill 1998), f. 1.

⁴³⁷ P1023 (Raporti i luftimit nga postkomanda pararoj e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 24 prill 1998), f. 2;

⁴³⁸ P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafi 31; P284 (Raporti ditor për shtabin qendror të ECMM-së, 25 prill 1998), f. 2; P1023 (Raporti i rregullt për luftimet nga postkomanda pararoj e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 24 prill 1998), f. 2;

⁴³⁹ P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafi 31; P284 (Raporti ditor për shtabin qendror të ECMM-së, 25 prill 1998), f. 2; P1023 (Raporti i rregullt për luftime nga postkomanda pararoj e Komandës së Korpusit të Prishtinës, 24 prill 1998), f. 2;

⁴⁴⁰ P1025 (Raport i Kolonelit Vlladimir Llazareviq, 26 prill 1998), f. 3; P1091 (Raport i kolonelit Vlladimir Llazareviq, 1 shtator 1998), f. 2.

⁴⁴¹ P1091 (Raport i Kolonelit Vlladimir Llazareviq, 1 shtator 1998), f. 2.

⁴⁴² P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1897, 1899-1900; P830 (Raport mbi gjendjen, 28 prill 1998), paragrafi 3.

⁴⁴³ John Crosland T. 3012-3013; P89 (Raport mbi gjendjen, 28 prill 1998), paragrafi 2.

⁴⁴⁴ Për periudhën fund maji, shih për shembull, P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1925-1927; John Crosland, T. 4608, 4611, 4616; P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafët 34, 81, 84-86; Rrustem Tetaj, T. 3661, 3714-3717; P94 (Telegrami i Mbretërisë së Bashkuar, 28 maj 1998); P836 (Telegrami i Mbretërisë së Bashkuar, 27 maj 2007), paragrafët 8-9; P1047 (Raport nga

kushtit *Tadiq*, një konflikt i armatosur i brendshëm vazhdon deri në arritjen e një zgjidhjeje paqësore, dhe duke qenë se nuk ka prova për një zgjidhje të tillë gjatë periudhës përkatëse të Aktakuzës, nuk është e nevojshme që Dhoma Gjyqësore të përqëndrohet në luhajtjet e ashpërsisë së konfliktit të armatosur gjatë pjesën tjetër të periudhës së përcaktuar në Aktakuzë.

Koloneli Vladimir Llazareviq, 22 maj 1998), ff. 2-3; P1049 (Raport nga Koloneli Vladimir Llazareviq, 23 maj 1998); P1091 (Raport nga Koloneli Vladimir Llazareviq, 1 shtator 1998); D71 (Telegrami i Mbretërisë së Bashkuar, 28 maj 1998). Për periudhën fillim deri mes të gushtit, shih për shembull, P69 (John Crosland, *Limaj dhe të tjerë*, transkript, 13 janar 2007), ff. 1966-1967; John Crosland, T. 4654-4655, 4735-4738; P317 (Shemsedin Cekaj, deklaratë, 14 maj 2007), paragrafi 28; Shemsedin Cekaj, T. 4427-4428, 4487, 4516, 4493-4496; P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafët 86-88, 90, 93-94; P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafët 96, 98-120; P324 (Hartë e shënuar nga John Crosland); D81 (Raport nga koloneli Milladen Qirkoviç, 7 gusht 1998). Për periudhën fillim shtatori, shih për shembull, P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 121; P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafët 130-138; John Crosland, T. 2970-2971; Shemsedin Cekaj, T. 4422, 4464-4465.

4. Elemente të përgjithshme dhe kushti i juridiksionit për Nenin 5 të Statutit

4.1 Ligji mbi elemente të përgjithshme dhe kushtin e juridiksionit

101. Aktakukza ngarkon të Akuzuarit me 18 akuza për krime kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit.⁴⁴⁵ Në Nenin 5 pohohet: “Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë përgjegjës për krimet e mëposhtme, kur kryhen gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm, dhe të drejtura kundër çfarëdo popullsie civile.” Kushtet juridiksionale dhe elementet e përgjithshme analizohen më poshtë.

102. *Kryhen gjatë një konflikti të armatosur.* Krimet duhet të kryhen gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm. Ky kusht nuk është pjesë e përkufizimit të së drejtës zakonore të krimeve kundër njerëzimit.⁴⁴⁶ Është një kusht juridiksional,⁴⁴⁷ i cili tregon nevojën e vërtetimit të ekzistencës së një konflikti të armatosur në një kohë dhe në një vend të caktuar.⁴⁴⁸ Përkufizimi i një konflikti të armatosur është dhënë më lart, në pjesën 3.1

103. *Sulm i gjerë ose sistematik i drejtuar kundër çfarëdo popullsie civile.* Elementet e përgjithshme për zbatimin e Nenit 5 të Statutit janë:

- (i) kishte një sulm;
- (ii) sulmi ishte i gjerë ose sistematik;
- (iii) sulmi ishte drejtuar kundër një popullsie civile;
- (iv) veprimet e kryesit ishin pjesë e sulmit;
- (v) në kohën e veprimeve të tij ose të saj, kryesi dinte se po kryhej një sulm i gjerë ose sistematik kundër një popullsie civile dhe se veprimet e tij ose të saj ishin pjesë e sulmit.⁴⁴⁹

104. *Sulmi.* Sulmi kundër një popullsie civile është një koncept i veçantë dhe i ndryshëm nga konflikti i armatosur.⁴⁵⁰ Sulmi nuk kufizohet në përdorimin e forcës, por përfshin çdo lloj keqtrajtimi të

⁴⁴⁵ Pikat 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29, 31, 33, dhe 35 të Aktakuzës akuzojnë të Akuzuarit për krime kundër njerëzimit sipas Nenit 5 të Statutit.

⁴⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 249.

⁴⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 249; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 83.

⁴⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafët 249, 251; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 83.

popullsisë civile, dhe mund t'i paraprijë konfliktit të armatosur, të zgjasë gjatë konfliktit të armatosur apo të vazhdojë pas tij.⁴⁵¹ Sulmi përbëhet prej veprimeve që shkaktojnë lëndime fizike apo mendore si dhe prej veprimeve përgatitore të veprimeve të lartpërmendura.⁴⁵²

105. *I gjerë ose sistematik.* “I gjerë” tregon natyrën e përhapur të sulmit dhe numrin e personave të shënjestruar.⁴⁵³ “Sistematik” lidhet me “natyrën e organizuar të veprimeve të dhunshme”.⁴⁵⁴ Ekzistenca e një plani apo një politike mund të tregojë karakterin sistematik të sulmit, por nuk është element ligjor i veçantë.⁴⁵⁵

106. *Drejtuar kundër një popullsie civile.* “Drejtuar kundër” tregon se popullsia civile është objektiv parësor i sulmit.⁴⁵⁶ Nuk kërkohet që sulmi të drejtohet kundër popullsisë civile të krejt zonës e cila lidhet me aktakuzën.⁴⁵⁷ Mjafton të vërtetohet se gjatë sulmit u shënjestruan mjaft njerëz apo se ata u shënjestruan në një mënyrë që e bind Dhomën Gjyqësore se sulmi ishte drejtuar kundër “popullsisë” civile, dhe jo kundër një numri të kufizuar dhe të papërcaktuar individësh.⁴⁵⁸

107. Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës të vitit 1949 dhe Neni 50 i Protokollit Shtesë I i këtyre Konventave japin udhëzime për përkufizimin e fjalës “civil” për qëllimet e Nenit 5 të Statutit. Protokollit Shtesë I përkufizon si “civil” “një individ i cili nuk është anëtar i forcave të armatosura apo ndryshe luftëtar.”⁴⁵⁹ Neni i Përbashkët 3 pasqyron të drejtën ndërkombëtare zakonore për nivelin minimal të mbrojtjes së personave që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime.⁴⁶⁰ Dhoma e Apelit ka përdorur një interpretim të gjerë të fjalës “civil” për qëllimet e Nenit 5, i cili tejkalon përkufizimin e përcaktuar në Protokollin Shtesë I.⁴⁶¹ Rrjedhimisht popullsia civile mund të përfshijë jo vetëm civilë në kuptimin e ngushtë të fjalës, por edhe persona të cilët nuk marrin pjesë aktivisht në luftime.

108. *Veprimet e kryesit janë pjesë e sulmit.* Veprimet të cilat nuk mund të interpretohen në mënyrë te arsyeshme si pjesë objektive të sulmit nuk përmbushin këtë kusht.⁴⁶²

⁴⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 85.

⁴⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 251.

⁴⁵¹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 251; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 86.

⁴⁵² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Krajishnik*, paragrafi 706.

⁴⁵³ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 94; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 101; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 94.

⁴⁵⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 94.

⁴⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 98; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 120.

⁴⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 91.

⁴⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 90.

⁴⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 90; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 105; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 95; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, paragrafi 247.

⁴⁵⁹ Protokollit Shtesë I, Neni 50 (2).

⁴⁶⁰ Vendimi i Jurisdiksionit *Tadiq*, paragrafi 102.

⁴⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafët 421, 570, 580.

⁴⁶² Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 100.

109. *Dijenja e kryesit.* Kryesi duhet të dijë se po kryhet një sulm i gjerë apo sistematik kundër një popullsise civile dhe se veprimet e tij ose të saj janë pjesë e sulmit.⁴⁶³ Nuk kërkohet që kryesi të ketë njohuri të hollësishme për sulmin apo të ketë të njëjtin qëllim si sulmi.⁴⁶⁴

4.2 Përfundime

110. Siç u konkludua në pjesën e mësipërme 3, Dhoma Gjyqësore është e bindur se që prej datën 22 prill 1998 dhe më tej në Kosovë ekzistonte një konflikt i armatosur. Rrjedhimisht përmbushet kushti juridiksional për krimet kundër njerëzimit të kryera që prej asaj date e më tej. Në vijim Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë elementet e përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit.

111. Prokuroria pretendon se kishte “një sulm të gjerë ose sistematik të UÇK-së drejtuar kundër pjesëve të popullatës civile në komunat e Deçanit, Pejës, Gjakovës, Istogut dhe Klinës në Kosovë.”⁴⁶⁵ Kjo pjesë e popullsisë, sipas Prokurorisë, përfshinte “popullatën civile serbe në këto komuna si edhe civilë të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së.”⁴⁶⁶ Sipas vlerësimeve të Prokurorisë, në vitin 1998, popullsia joshqiptare në komunat e lartpërmendura ishte rreth 60.000 persona (14% e popullsisë në tërësi).⁴⁶⁷ Prej këtyre, rreth 30.000 persona ishin serbë (7% e popullsisë në tërësi).⁴⁶⁸

112. Sulmi i pretenduar kundër popullsisë civile ishte “një fushatë ushtarake [...] për largimin e serbëve etnikë prej fshatrave ku banonin.”⁴⁶⁹ Sipas Prokurorisë, UÇK-ja kërcënoi psikologjikisht ose fizikisht, rrahu dhe vrau shumë civilë serbë dhe civilë romë/egjiptianë⁴⁷⁰ Së fundi, Prokuroria pretendon se UÇK-ja rrëmbeu më shumë se 60 civilë serbë dhe romë si dhe civilë shqiptarë kosovarë të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së në komunat e lartpërmendura, dhe vrau shumë prej tyre.⁴⁷¹ Këto viktime nuk përmenden

⁴⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 99; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 124; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafët 99-100.

⁴⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafët 248, 252; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafët 102-103; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 124; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 99.

⁴⁶⁵ Aktakuza, paragrafi 15.

⁴⁶⁶ Aktakuza, paragrafi 15.

⁴⁶⁷ Aktakuza, paragrafi 34.

⁴⁶⁸ Aktakuza, paragrafi 34.

⁴⁶⁹ Aktakuza, paragrafi 37.

⁴⁷⁰ Aktakuza, paragrafi 38.

⁴⁷¹ Aktakuza, paragrafi 40.

në pika të veçanta të Aktakuzës.⁴⁷² Pjesë e sulmit të pretenduar ishte edhe burgimi dhe keqtrajtimi i personave në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë.⁴⁷³

113. Përveç provave të cilat Dhoma Gjyqësore do t'i shqyrtojë më poshtë në këtë pjesë, provat mbi ngjarjet e pretenduara si akuza të veçanta në Aktakuzë kanë rëndësi për përfundimet mbi elementet e përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit. Provat e paraqitura prej Prokurorisë në lidhje me shqiptarë kosovarë të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së, përmendin vetëm incidentet të cilat janë përdour si pika të veçanta të aktakuzës. Incidentet në këto pika kanë të bëjnë me pretendime për vrasjen e 17 burrave dhe grave shqiptarë kosovarë, në tri komuna prej prillit deri në gusht 1998 dhe burgimin e keqtrajtimin e katër burrave në shtabin e Jabllanicës. Nuk u paraqit asnjë provë në lidhje me incidente përveç atyre të përmendura ku u shënjestruan shqiptarë të Kosovës të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së. Për sa i përket popullsisë civile joshqiptare, akuzat përmendin vrasjen e 21 serbëve, malazezëve dhe romëve, burra dhe gra, në katër komuna prej prillit deri në korrik 1998. Aty gjithashtu përmenden pretendimet për burgimin, keqtrajtimin dhe dëbimin e rreth 14 serbëve, malazezëve, bosnjakëve dhe romëve, burra dhe gra, përafërsisht gjatë të njëjtës periudhë.

114. Dhoma Gjyqësore do t'i shqyrtojë këto pika në hollësi në pjesën e mëposhtme 6. Këtu mjafton të thuhet se për shumë prej tyre, provat nuk mundësojnë që Dhoma Gjyqësore të konkludojë mbi kryerjen e një krimi ose pjesëmarrjen e UÇK-së në të, siç u pretendua. Provat për disa pika të tjera tregojnë se viktimat mund të jenë shënjestruar kryesisht për arsye personale dhe jo sepse ishin anëtarë të popullsisë civile të shënjestruar.⁴⁷⁴ Rrjedhimisht, këto pika nuk mund të merren parasysh në mënyrë të duhur në këtë pjesë gjatë shqyrtimit nëse u krye sulm kundër një popullsie civile.

115. Dhoma Gjyqësore dëgjoi disa dëshmi shtesë të cilat kishin të bënin me mundësinë e një sulmi kundër popullsisë civile në komunat e përmendura në Aktakuzë. Këto dëshmi përshkruajnë sulme të ndryshme mbi serbët, të cilat të marra së bashku me incidentet që përbëjnë akuza të veçanta, pretendohet se i detyruan civilë serbë të braktisnin shtëpitë e tyre. Nebojsa Avramoviqi, teknik krimi për MPB-në e Gjakovës,⁴⁷⁵ dëshmoi se gjatë janarit dhe shkurtit 1998 UÇK-ja sulmoi rreth dhjetë apo më shumë makina civile serbe të cilat udhëtonin gjatë natës në rrugën Gjakovë-

⁴⁷² Aktakuza, paragrafi 40.

⁴⁷³ Aktakuza, paragrafi 43.

⁴⁷⁴ Shih pjesët 6.4, 6.12.6 dhe 6.12.12 më poshtë.

⁴⁷⁵ P380 (Nebojsa Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 4.

Pejë.⁴⁷⁶ Ai gjithashtu dëshmoi se nga fundi i prillit apo nga fillimi i majit 1998 deri në shtator 1998, sulme të tilla u kryen më shpesh, edhe gjatë ditës.⁴⁷⁷ Avramoviqi dëgjoi prej kolegëve të tij se civilë shqiptarë linin dritën të ndezur brenda makinës kur udhëtonin natën si shenjë për UÇK-në se makina ishte e një shqiptari dhe jo një serbi.⁴⁷⁸ Makina në të cilën udhëtoi Avramoviqi në rrugën Gjakovë-Pejë dhe e cila nuk kishte asnjë shenjë të veçantë për ta identifikuar si makinë të MPB-së, u sulmua disa herë.⁴⁷⁹ Këto sulme të përshkruara nga Avramoviqi duhet të dallohen nga sulmet mbi policinë serbe, për të cilat u paraqitën dëshmi të shqyrtuara në pjesën 3.2 më lart.

116. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu prova për sulmin e pretenduar kundër vendbanimit të refugjatëve afër Baballoqit, në komunën e Deçanit. Dëshmitarja 28 dëshmoi se refugjatë serbë nga Shqipëria me banim në vendbanime refugjatësh e informuan dëshmitaren se, nga fundi i vitit 1997 dhe më tej, UÇK-ja e sulmoi here pas here vendbanimin, edhe me granathedhës.⁴⁸⁰ Këto sulme u ashpërsuan nga 18 prilli 1998 e më tej, kur forcat e UÇK-së shtinin përditë mbi vendbanimin nga fshati Baballoq dhe nga kodrat përreth.⁴⁸¹ Mirëpo, shqiptarët i treguan Dëshmitares 28 se, duke filluar me datën 20 prill 1998, policia serbe shtinte kundër tyre nga vendbanimi i refugjatëve të Baballoqit dhe nga kodrat përreth (Suka e Baballoqit, Cermjan) dhe rreth datës 22 prill 1998, granatoi fshatin Baballoq.⁴⁸² Në fund të prillit 1998, refugjatët serbë braktisën vendbanimin e refugjatëve dhe UJ-ja hyri, duke krijuar një front mbrojtës.⁴⁸³

117. Lidhur me sulmet ndaj shtëpive serbe, Marijana Angjelkoviq (Marijana Anđelković) dëshmoi se në fund të marsit 1998, ajo foli me Jela Qulafiqin (Jela Čulafić) dhe me gruan e tij Nastadin në Ratishë, të komunës së Deçanit.⁴⁸⁴ Çifti tregoi vrima në çatinë dhe në muret e shtëpisë së tyre, të cilët, sipas tyre, ishin shkaktuar nga granathedhësit dhe automatikët.⁴⁸⁵ Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi edhe nga dëshmitarët e tjerë për sulmin mbi shtëpinë e Qulafiqit⁴⁸⁶ Asnjë dëshmitar nuk dha të dhëna për autorin e sulmit apo arsyen, megjithëse Dëshmitari 60 dëshmoi se familja Qulafiq ishte e para që u largua nga zona, e pasuar nga të gjithë serbët e tjerë.⁴⁸⁷ Dhoma Gjyqësore dëgjoi gjithashtu prej Miloica Vllahoviqit (Miloica Vlahović) për një sulm tjetër mbi pronë serbe. Ai dëshmoi se kishte dëgjuar nga motra e vogël Natalia, e cila jetonte në fshatin Cermjan të Gjakovës, se në fund të shkurtit apo në fillim të marsit 1998, u sulmuan të tri shtëpitë e vëllezërve

⁴⁷⁶ P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 11; Nebojsa Avramović, T. 6597.

⁴⁷⁷ P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 11.

⁴⁷⁸ P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 11; Nebojsa Avramović, T. 6598.

⁴⁷⁹ P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 14.

⁴⁸⁰ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 37, 39; Dëshmitarja 28, T. 10181.

⁴⁸¹ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 40-42; Dëshmitarja 28, T. 10181-10183, 10243.

⁴⁸² P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 42; Dëshmitarja 28, T. 10182-10183, 10239-10241, 10244, 10264.

⁴⁸³ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 43; Dëshmitarja 28, T. 10179.

⁴⁸⁴ Marijana Angjelkoviq, T. 476, 479, 482, 484-486; P3 (Blloku i shënimeve të Angjelkoviqit, vëllimi 1), f. 32.

⁴⁸⁵ Marijana Angjelkoviq, T. 484; P3 (Blloku i shënimeve të Angjelkoviqit, vëllimi 1), f. 32.

⁴⁸⁶ Miloica Vllahović, T. 1550-1551, 1638; Dëshmitari 60, T. 2221-2222. Shih edhe P855 (Raporti i MPB-së për incidentin kriminal, 4 mars 1998).

Baboviq (Babović) në fshat prej disa njerëzve me armë automatike.⁴⁸⁸ Dëshmitari vetë i pa vrimat e fishekëve në muret e shtëpisë si dhe gëzhojat.⁴⁸⁹ Dhoma Gjyqësore ka marrë prova më pak të hollësishme për tetë deri dhjetë sulme të tjera në komunat e Gjakovës dhe të Klinës gjatë ditëve të para të marsit 1998.⁴⁹⁰

118. Si përfundim, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi në lidhje me një numër relativisht të pakët incidentesh. Për më tepër, dëshmitë shpeshherë nuk janë kaq të sakta sa të mund të përcaktohet se kush ishte apo ishin përgjegjës për incidentet dhe nëse incidentet në fjalë ishin pjesë të një sulmi më të madh kundër popullsisë civile. Provat e paraqitura lidhur me pretendimin në Aktakuzë se UÇK-ja rrëmbeu 60 civilë dhe më vonë vrau shumë prej tyre, nuk mjaftojnë për të vërtetuar se u rrëmbyen kaq civilës, se shumë prej tyre u vranë dhe se UÇK-ja mban përgjegjësinë për veprimet e pretenduara. Provat tregojnë se shumë njerëz në zonë kishin dëgjuar për incidente të veçanta të lartpërmendura, dhe me gjasë kjo do të ketë përhapur panik në popullsinë serbe, dhe si pasojë do të ketë ndikuar në ikjen e serbëve prej shtëpive të tyre. Dëshmitari 60 dëshmoi se në fillim të vitit 1998, ishin nëntë shtëpi serbe në Dashinoc në komunën e Deçanit por në fillim të marsit 1998, serbët e fshatit dhe të fshatrave përreth filluan të largoheshin nga frika prej UÇK-së.⁴⁹¹ Fqinjë serbë u përpoqën të bindnin dëshmitarin se ishte më e sigurtë që ai të shkonte në një vend tjetër dhe të mos rrinte aty.⁴⁹² Dëshmitari 60 dëshmoi se rreth datës 17-18 prill 1998, dëshmitari ndodhej në një makinë e cila udhëtonte në drejtim të Pejës, kur në Lumbardh të Deçanit, një burrë në një grup prej rreth dhjetë personash, i veshur në të zeza dhe duke qëndruar në një livadh në anën e majtë të rrugës, nxorri një armë dhe qëlloi në drejtim të makinës.⁴⁹³ Ky incident bëri që dëshmitari të ketë frikë për sigurinë e vetë dhe të familjes.⁴⁹⁴ Dëshmitari 60 dëshmoi më tej se si ai dhe familja u larguan prej fshatit me ndihmën e dy burrave të fshatit, njëri prej tyre ishte, sipas dëshmitarit, anëtar i UÇK-së.⁴⁹⁵ Familja u strehua në një pushimore afër Deçanit me serbë të tjerë të cilët kishin braktisur shtëpitë.⁴⁹⁶ Dëshmitari dëshmoi se ata ishin nga Prapaqani, Ratisha e Poshtme, Ratisha e Epërme, Dashinoci dhe Lumbardhi në komunën e Deçanit.⁴⁹⁷ Kur në shtator apo tetor 1998, dëshmitari u kthye në shtëpinë e vetë, ai e gjeti të zbrazët dhe të shkatërruar.⁴⁹⁸ Ai

⁴⁸⁷ Dëshmitari 60, T. 2223.

⁴⁸⁸ Miloica Vllahoviq, T. 1552-1553.

⁴⁸⁹ Miloica Vllahoviq, T. 1553.

⁴⁹⁰ Shih P857 (Raporti i MPB-së për incidentin kriminal, 10 mars 1998); P1143 (Raporti i Brigadës së Motorizuar 549, nënshkruar nga Lubisha Lojanica, 2 mars 1998); P967 (Notë Zyrtare e RDB-së, 3 mars 1998), P968 (Notë Zyrtare e RDB-së, 4 mars 1998).

⁴⁹¹ Dëshmitari 60, T. 2216, 2220, 2250-2255; P38 (Hartë në të cilën janë shënuar shtëpitë serbe në Dashinoc).

⁴⁹² Dëshmitari 60, T. 2223-2224.

⁴⁹³ Dëshmitari 60, T. 2225-2226.

⁴⁹⁴ Dëshmitari 60, T. 2228.

⁴⁹⁵ Dëshmitari 60, T. 2229-2237, 2247-2249, 2251, 2267-2268, 2272-2273, 2275-2277, 2288-2289.

⁴⁹⁶ Dëshmitari 60, T. 2237-2238, 2277-2278.

⁴⁹⁷ Dëshmitari 60, T. 2238.

⁴⁹⁸ Dëshmitari 60, T. 2238-2241.

vizitoi gjithashtu shtëpitë e Radun Dabetiqit dhe të Novak Stijoviqit, të cilat ishin të shkatërruara dhe thuajse të zbrazëta.⁴⁹⁹ Ai pa gjithashtu disa shtëpi shqiptare të djegura.⁵⁰⁰

119. Dëshmitarja 28, hulumtuese për një organizatë humanitare,⁵⁰¹ dëshmoi se në javën e fundit të prillit 1998, numëroheshin 34 familje serbe të cilat ishin larguar nga fshatrat e tyre në “zonën e Dukagjinit” dhe të cilat jetonin në Deçan si refugjatë.⁵⁰² Sipas dëshmitares, 123 familje serbe kishin jetuar në “zonën e Deçanit” në fillim të vitit 1998.⁵⁰³ Shifrat e përmendura nuk mund krahasohen lehtë sepse 34 familje serbe ishin nga fshatrat në tërë “zonën e Dukagjinit” kurse 123 familje serbe ishin nga “zona e Deçanit.” Qoftë qyteti apo komuna e Deçanit, kjo zonë është më e vogël se “zona e Dukagjinit”. Edhe nëse Dhoma Gjyqësore mund të përdorte statistika të tilla, siç janë ofruar nga Dëshmitarja 28, ato nuk japin shpjegim pse serbët u larguan prej shtëpive. Në Deçan, serbët i thanë dëshmitares se deri më 19 prill 1998, disa serbë ishin larguar se kishin frikë nga sulmet,⁵⁰⁴ siç kishte bërë Dëshmitari 60. Mirëpo, Momçillo Antiq (Momčilo Antić) dëshmoi se ai dhe disa anëtarë të familjes së tij u larguan nga Lloqani për në Pejë në prill 1998, pasi kishte dëgjuar të shtëna dhe kishte parë fishekë sinjalizues diku në drejtim të Prejlepit.⁵⁰⁵ Dëshmitari qartësoi se askush nuk u tha atyre të largoheshin.⁵⁰⁶ Gjatë atyre ditëve u larguan nga fshati edhe familje të tjera serbe, duke lënë pas vetëm disa pleq.⁵⁰⁷ Po kështu, Dëshmitarja 61 dëshmoi se ajo dhe familja e saj u larguan nga fshati i tyre në Deçan në gusht 1998 për shkak të luftimeve të ashpra midis UÇK-së dhe forcave serbe.⁵⁰⁸ Dragosllav Stojanoviqi dëshmoi se në mbrëmjen e datës 24 mars 1998, pas sulmit kundër vendbanimit të familjes së Haradinajt, në shtëpinë e Stojanoviqit erdhi një komandant policor dhe i tha se Ramush Haradinaj dhe grupi i tij ishin të armatosur kështu që çdo gjë mund të ndodhte dhe prandaj dëshmitari dhe familja e tij duhej të largoheshin.⁵⁰⁹ Kjo u konfirmua nga vëllai i Dragosllavit, Mijat Stojanoviq, i cili dëshmoi se në mbrëmjen e datës 24 mars 1998, ai dhe familja e tij u urdhëruan nga një polic të largoheshin nga shtëpia për arsye sigurie.⁵¹⁰ Dhoma Gjyqësore ka marrë edhe prova të tjera për serbët të cilët u larguan nga shtëpia qoftë me vullnetin e vetë, qoftë ndihmuar, inkurajuar apo urdhëruar nga policia serbe, për shkak të konfliktit në vazhdim midis forcave serbe dhe UÇK-së.⁵¹¹ Dëshmitarja 28 dëshmoi se gjatë asaj periudhe familjet shqiptare kosovare ikën gjithashtu nga shtëpitë e tyre për shkak të rrezikut të sulmeve nga policia serbe apo

⁴⁹⁹ Dëshmitari 60, T. 2242.

⁵⁰⁰ Dëshmitari 60, T. 2268.

⁵⁰¹ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 2, 9, 11, 14; Dëshmitarja 28, T. 10172.

⁵⁰² P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 44-45; Dëshmitarja 28, T. 10185-10186.

⁵⁰³ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 45.

⁵⁰⁴ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 46; Dëshmitarja 28, T. 10201, 10223.

⁵⁰⁵ Momçillo Antiq, T. 2409-2415, 2417.

⁵⁰⁶ Momçillo Antiq, T. 2435.

⁵⁰⁷ Momçillo Antiq, T. 2412-2417.

⁵⁰⁸ Dëshmitarja 61, T. 3999, 4006.

⁵⁰⁹ Dragosllav Stojanoviq, T. 1860.

⁵¹⁰ Mijat Stojanoviq, T. 2011.

për shkak të konfliktit midis forcave serbe dhe UÇK-së.⁵¹² Dëshmitarë të tjerë dëshmuan gjithashtu për shqiptarë kosovarë të cilët braktisën shtëpitë e tyre për shkak të sulmeve ushtarake serbe apo rrezikut prej tyre.⁵¹³

120. Si përfundim, shumë serbë u larguan nga shtëpitë për shkak të frikës së bazuar ose të pabazuar, se do të sulmoheshin qëllimisht nga UÇK-ja, por kishte edhe disa serbë të cilët ikën nga frika se do të mbërtheheshin në mes të konfliktit të armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së. Kjo vëretohet më tej nga fakti se edhe shqiptarët kosovarë ikën nga shtëpitë gjatë periudhës së përcaktuar në Aktakuzë. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk mund të nxjerrë as përfundim të përgjithshëm lidhur me sulmin e pretenduar kundër popullsisë civile thjesht nga fakti se shumë civilë serbë u larguan nga shtëpitë gjatë kësaj periudhe.

121. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar shumë dëshmi për gjendjen e nderë në Kosovë shumë kohë para periudhës së Aktakuzës, me dy palë kundërshtare, pushteti serb dhe pakica serbe në Kosovë në një anë, dhe shqiptarët kosovarë në anën tjetër. Në këto rrethana kërkohet kujdes kur përcaktohet autorësia e dhunës kundër viktimave të një kombësie apo një përkatësie të caktuar. Në mungesë të provave kundërshtuese, Dhoma Gjyqësore lejon mundësinë që armiqësia midis palëve mund të ketë nxitur individë të një pale të veprojnë me dhunë kundër individëve të palës tjetër nga zemërimi personal dhe jo në mënyrë të strukturuar apo organizuar.

122. Në bazë të provave të marra Dhoma Gjyqësore përfundon se keqtrajtimi, transferimi i dhunshëm dhe vrasja e civilëve serbë dhe romë, dhe të civilëve shqiptarë të Kosovës të cilët konsideroheshin si bashkëpunëtorë të forcave serbe, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së (qoftë si grupe i veçantë apo bashkërisht), nuk ishin në një shkallë apo shpeshësi të tillë që të mundësojnë përfundimin se u krye një sulm kundër popullsisë civile. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore konkludon se disa viktima u zgjodhën kryesisht për shkaqe individuale, për shembull se kishin apo mendohej se kishin lidhje me pushtetin serb apo për arsye të tjera, dhe jo si anëtarë të popullsisë civile. Dhoma Gjyqësore nuk analizon elemente të tjera të krimit kundër njerëzimit, “i gjerë apo sistematik” sepse këto mund të shqyrtohen vetëm në lidhje me një sulm kundër popullsisë civile. Dhoma Gjyqësore

⁵¹¹ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 74; Zvonko Markoviq, T. 2327-2328, 2341-2343; Goran Vllahoviq, T. 1737-1742.

⁵¹² Dëshmitarja 28, T. 10195-10196; P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 50.

⁵¹³ P317 (Shemsedin Cekaj, deklaratë dëshmitari, 14 maj 2007), paragrafi 28; Shemsedin Cekaj, T. 4487, 4495; P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 56, 81-82; Zymer Hasanaj, T. 8723; Avni Krasniqi, T. 10716-10717; P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafët 5-6; P270 (Achilleas Pappas, deklaratë dëshmitari, 9 maj 2007), paragrafët 9, 14; Achilleas Pappas, T. 4083, 4264, 4282, 4306-4308.

përfundon se të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për Pikat 1, 3, 5, 7, 9, 11, 13, 15, 17, 19, 21, 23, 25, 27, 29, 31, 33, dhe 35 të Aktakuzës.

5. Ligji mbi krime sipas Nenit 3 të Statutit dhe përgjegjësia individuale

5.1 Krime

5.1.1 Vrasje

123. Pikat 8, 10, 12, 14, 16, 18, 20, 22, 24, 26, 30, dhe 32 të Aktakuzës ngarkojnë të Akuzuarit me vrasje si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës sipas Nenit 3. Elemente të përgjithshme të vrasjes sipas Nenit 3 u diskutuan në pjesën 3.1 më lart.

124. Krimi i vrasjes përmban elementet e mëposhtme:

- (a) vdekja e viktimës;
- (b) një veprim apo një mosveprim i kryesit shkaktoi vdekjen e viktimës: dhe
- (c) veprimi apo mosveprimi u krye me synim vrasjen e viktimës apo të shkaktimit të qëllimishëm të lëndimit të rëndë trupor për të cilin kryesi logjikisht duhet të ketë ditur se mund të rezultonte në vdekjen e viktimës.⁵¹⁴

5.1.2 Torturë dhe trajtim mizor

125. Pikat 2, 4, 6, 14, 16, 18, 20, 24, 26, 28, 30, 32, 34, dhe 37 të Aktakuzës ngarkojnë të Akuzuarit me trajtim mizor si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, i ndëshkueshëm sipas Nenit 3 të Statutit. Pikat 2, 4, 6, 20, 24, 28, 30, 32, 34, dhe 37 të Aktakuzës ngarkojnë të Akuzuarit me torturë si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Elementet e përgjithshme të këtyre krimeve si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës u diskutuan në pjesën 3.1 më lart.

126. *Trajtim mizor.* Trajtimi mizor kërkon vërtetimin e elementeve të mëposhtme:

- (a) një veprim apo mosveprim i cili shkaktoi vuajtje apo lëndime të rënda mendore apo fizike, ose përbënte një sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor,⁵¹⁵ dhe

⁵¹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, paragrafi 261.

(b) veprimi apo mosveprimi u krye me synim apo ndryshe me dijeni se veprimi apo mosveprimi kishte të ngjarë të shkaktonte vuajtje apo lëndime të rënda mendore apo fizike, ose përbënte një sulm të rëndë kundër dinjitetit njerëzor, dhe kryesi ishte mospërfillës ndaj pasojave të veprimit apo mosveprimit të tij.⁵¹⁶

127. *Torturë*. Krimi i torturës përmban elementet e mëposhtme:

- (a) një veprim apo një mosveprim i cili shkakton vuajtje apo lëndime fizike ose mendore shumë të rënda;
- (b) veprimi apo mosveprimi u krye qëllimisht;
- (c) veprimi apo mosveprimi synonte marrjen e informacionit apo rrëfimin, ose ndëshkimin, frikësimin apo detyrimin e viktimës ose të personit të tretë; apo diskriminimin për çfarëdo arsye të viktimës ose të personit të tretë.⁵¹⁷

128. Nuk kërkohet që vuajtjet apo lëndimet shumë të rënda të shkaktohen vetëm për një apo disa nga qëllimet e lartpërmendura, por vetëm se një apo disa qëllime të tilla të jenë pjesë e motivimit të sjelljes.⁵¹⁸

5.1.3 Përdhunim

129. Pika 36 e Aktakuzës ngarkon të Akuzuarit me përdhunim si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Elementet e përgjithshme për përdhunim sipas Nenit 3 u diskutuan në pjesën 3.1 më lart.

130. Krimi i përdhunimit përmban elementet e mëposhtme:

- (a) penetrimi seksual, sado i pjesshëm: (i) i vaginës apo anusit të viktimës prej penisit të kryesit apo prej ndonjë sendi tjetër të përdorur nga kryesi; ose (ii) i gojës së viktimës nga penisi i kryesit;
- (b) penetrimi seksual u krye pa pëlqimin e viktimës. Pëlqimi në këtë rast duhet të jepet me vullnet të lirë, dhe

⁵¹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 424: Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 595.

⁵¹⁶ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërnojelac*, paragrafi 132.

⁵¹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 142, 144.

- (c) penetrimi seksual u krye qëllimisht dhe me dijeni se u krye pa pëlqimin e viktimës.⁵¹⁹

⁵¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafi 155.

⁵¹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafët 127-128.

5.1.4 Shkelje të dinjitetit njerëzor

131. Pika 2 e Aktakuzës ngarkon të Akuzuarit me shkelje të dinjitetit njerëzor si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 të Statutit. Elementet e përgjithshme për shkelje të dinjitetit njerëzor sipas Nenit 3 u diskutuan në pjesën 3.1 më lart.

132. Krimi i shkeljes së dinjitetit njerëzor përmban elementet e mëposhtme:

- (a) një veprim apo një mosveprim i cili, nga pikëpamja objektive, shkakton poshtërim apo ulje të rëndë, apo ndryshe përbënte sulm të rëndë mbi dinjitetin njerëzor, dhe;
- (b) veprimi apo mosveprimi u krye me synimin dhe dijeninë se mund të shkaktonte pasojat e lartpërmendura;⁵²⁰

5.2 Përgjegjësia për krimet

5.2.1 Ndërmarrja e përbashkët kriminale

133. Prokuroria pretendon se çdo i Akuzuar është përgjegjës në bazë të Nenit 7 (1) të Statutit të Tribunalit për krimet e akuzuara në Aktakuzë dhe, në veçanti, se të Akuzuarit janë përgjegjës si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.⁵²¹ Në Aktakuzë pretendohet se çdo krim i akuzuar përfshihej në qëllimin e përbashkët kriminal të NPK-së dhe secili i Akuzuar kishte të njëjtin synim me bashkëkryesit e tjerë për kryerjen e këtyre krimeve. Ndryshe, nëqoftëse disa prej krimeve të akuzuara nuk përfshiheshin në NPK, ato ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të NPK-së dhe secili i Akuzuar ishte i vetëdijshëm se këto krime ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të zbatimit të NPK-së,⁵²²

134. Aktakuza përcakton më tej se, me anë të pjesëmarrjes në NPK, çdo i Akuzuar është individualisht përgjegjës për veprimet e të bashkakuarve si dhe për veprimet e anëtarëve të tjerë të NPK-së nëqoftëse veprimet i shërbenin realizimin të qëllimit të përbashkët kriminal dhe, ose përfshiheshin në objektivin e NPK-së ose ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të zbatimit të saj.⁵²³ Për më tepër pretendohet se çdo i Akuzuar është gjithashtu përgjegjës për

⁵²⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, paragrafët 161-163.

⁵²¹ Aktakuza, paragrafët 17, 25.

⁵²² Aktakuza, paragrafi 25.

⁵²³ Aktakuza, paragrafi 28.

veprimet e personave të tjerë të cilët nuk ishin anëtarë të NPK-së, por të cilët u përdorën prej anëtarëve të NPK-së për kryerjen e krimeve në realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal të cilat ose përfshiheshin në kuadrin e NPK-së ose ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të zbatimit të saj.⁵²⁴

135. Në kuadrin e jurisprudencës së Tribunalit, doktrina e NPK-së u trajtua hollësisht për herë të parë në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*.⁵²⁵ Dhoma e Apelit *Tadiq* përfundoi në vija të përgjithshme se një person i cili, në zbatim të qëllimit të përbashkët kriminal, ndihmon në kryerjen e krimeve prej një grupi personash mund të përballet me përgjegjësi penale në kushte të caktuara.⁵²⁶ Analiza e së drejtës ndërkombëtare zakonore nga Dhoma e Apelit rezultoi në identifikimin dhe përkufizimin e tri formave të përgjegjësisë së NPK-së. Në formën e parë të NPK-së:

të gjithë të bashkakuzuarit, duke vepruar në kuadrin e një qëllimi të përbashkët, kanë të njëjtën synim kriminal, për shembull, formimin e një plani mes bashkëkryesve për të vrarë, ku, në zbatimin e këtij qëllimi të përbashkët (edhe nëse çdo bashkëkryes ka një rol tjetër në të), ... të gjithë synonin të vrisnin.

Kushtet paraprake objektive dhe subjektive për ngarkimin me përgjegjësi penale të pjesëmarrësve të cilët nuk kryen vrasje apo nuk mund të vërtetohet se kane kryer vrasje, janë:

(i) i akuzuari duhet të marrë pjesë vullnetarisht në një aspekt të qëllimit të përbashkët (për shembull, duke shkaktuar dhunë jovekjeprurëse mbi viktimën, ose duke dhënë mbështetjen materiale apo duke lehtësuar veprimet e bashkëkryesve); dhe

(ii) edhe nëse nuk vret vetë, i akuzuari duhet të synojë të arrijë këtë qëllim.⁵²⁷

136. Forma e dytë e NPK-së e cila përshkruhet si lloj i formës së parë, u identifikua në çështjet ku pretendohet se shkeljet e akuzuara u kryen nga anëtarët e njësive ushtarake apo administrative, për shembull ato që komandonin kampet e përqendrimit dhe “sisteme” të ngjashme.⁵²⁸

⁵²⁴ Aktakuza, paragrafi 29.

⁵²⁵ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafët 172-185.

⁵²⁶ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 190.

⁵²⁷ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 196.

⁵²⁸ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafët 202-203. Për përkufizimin e fjalës “sistem”, shih Aktgjykimin e Apelit *Kërmojelac*, paragraf 89, dhe Aktgjykimin e Apelit *Vasileviq*, paragrafi 105.

137. Forma e tretë e NPK-së karakterizohet nga një qëllim i përbashkët kriminal që karakterizohet nga sjellja ku një apo disa bashkëkryes kryejnë një veprim i cili, megjithëse është jashtë qëllimit të përbashkët, është pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme të zbatimit të këtij qëllimi.⁵²⁹ Ekzistojnë edhe dy kushte të tjera për këtë formë, një objektiv dhe tjetri subjektiv.⁵³⁰ Elementi objektiv nuk varet prej gjendjes mendore të të akuzuarit. Ky kusht që konsiston në faktin se krimi që ndodhi, ishte pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e zbatimit të NPK-së. Ai duhet të dallohet prej gjendjes subjektive mendore, d.m.th. se i akuzuari ishte në dijeni se krimi që ndodhi, ishte pasojë e mundshme e zbatimit të NPK-së dhe se mori pjesë duke e ditur këtë.⁵³¹

138. Përmbledhje e elementëve të formës së parë dhe të tretë të NPK-së:

(i) *Shumësia e personave.* Ndërmarrja e përbashkët kriminale ekziston kur një shumësi personash merr pjesë në realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal.⁵³² Nuk kërkohet që pjesëmarrësit e ndërmarrjen kriminale të organizohen në një strukturë ushtarake, politike apo administrative.⁵³³

(ii) *Qëllimi i përbashkët i cili përbën apo përfshin kryerjen e një krimi sipas Statutit.* Forma e parë e NPK-së ekziston kur qëllimi i përbashkët përbën apo përfshin kryerjen e një krimi sipas Statutit. Gjendja mendore kriminale e kërkuar për formën e parë është se pjesëmarrësit e NPK-së, përfshirë të akuzuarit, kishin një gjendje mendore të përbashkët, d.m.th. gjendjen mendore që krim(et) statutore duhet të kryhen si pjesë e qëllimit.⁵³⁴

Forma e tretë e NPK-së varet nëse është e natyrshme dhe e parashikueshme që zbatimi i NPK-së në formën e parë sjell si pasojë kryerjen e një apo më shumë krimeve të tjera statutore. Përveç qëllimit në formën e parë, forma e tretë kërkon vërtetimin se i akuzuari rrezikoi kryerjen e një krimi tjetër statutor, i cili nuk ishte pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal, por gjithsesi ishte pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e NPK-së.⁵³⁵

⁵²⁹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 204.

⁵³⁰ *Prokurorja kundër Radosllav Bërgjaninit dhe Momir Taliqit*, Vendim për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar Sërish dhe Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshim, 26 qershor 2001, paragrafët 28-30.

⁵³¹ Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 33.

⁵³² Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kvoçka dhe të tjerë*, paragrafi 33.

⁵³³ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 227.

⁵³⁴ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafët 227-228.

⁵³⁵ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafët 227-228. *Prokurorja kundër Radosllav Bërgjaninit dhe Momir Taliqit*, Vendim për Formën e Aktakuzës së Ndryshuar Sërish dhe Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshim, 26 qershor 2001, paragrafi 31; Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Kërstiq*, paragrafi 613; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 33.

Sipas Dhomës së Apelit, nuk është e nevojshme që qëllimi i përbashkët të jetë përcaktuar apo formuluar paraprakisht.⁵³⁶ Kjo do të thotë se elementi i dytë i NPK-së nuk nënkupton planifikimin përgatitor apo një marrëveshje të shprehur ndërmjet pjesëmarrësve të NPK-së, ose ndërmjet pjesëmarrësve të NPK-së dhe personave të tretë.⁵³⁷

Për më tepër, një NPK mund të ekzistojë edhe kur asnjë apo vetëm disa keqbërës kryesorë janë anëtarë të NPK-së. Për shembull, një NPK mund të ekzistojë kur asnjë prej keqbërësve kryesor nuk dinte për NPK-në ose synimin e saj, por nxiten nga një ose disa anëtarë të NPK-së të kryejnë krime për realizimin e qëllimit. Kështu, “për të fajësuar një anëtar të një NPK-je si përgjegjës për krime të kryera nga joanëtarët e ndërmarrjes, duhet të vërtetohet se krimi mund t’i atribuohet një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, dhe se ky anëtar – kur përdor një keqbërës kryesor – veprimi në përputhje me planin e përbashkët.”⁵³⁸

(iii) *Pjesëmarrja e të akuzuarit në zbatimin e qëllimit.* Kjo realizohet kur kryerja e krimit prej të akuzuarit përbën pjesë të qëllimit të përbashkët (dhe të përcaktuar në Statut). Ndryshe, në vend të kryerjes së krimit të synuar si kryes kryesor, sjellja e të akuzuarit mund ta përmbush këtë kusht nëse ajo u konkretizua në ndërmjetësimin apo dhënien e ndihmës për zbatimin e krimit i cili ishte pjesë e qëllimit të përbashkët.⁵³⁹ Ndhimesa e një të akuzuari për NPK-në ligjërisht nuk ka nevojë të jetë thelbësore⁵⁴⁰ apo e nevojshme për realizimin e qëllimit të NPK-së.⁵⁴¹ Mirëpo, “ajo duhet të jetë një ndihmesë e rëndësishme ndaj krimit për të cilin i akuzuari shpallet fajtor.”⁵⁴²

139. Në lidhje me dy elementet e para të përgjegjësisë së NPK-së, është qëllimi i përbashkët i cili fillon të transformojë shumësinë e personave në një grup apo ndërmarrje, sepse në atë moment shumësia e ka të përbashkët qëllimin në fjalë. Mirëpo është e qartë se vetë qëllimi i përbashkët nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për përcaktimin e një grupi sepse mund të rastisë që grupe të ndryshme dhe të pavarura të kenë të njëjtat qëllime. Rrjedhimisht, jo vetëm qëllimi i përbashkët, por edhe ndërveprimi apo bashkëpunimi midis personave – veprime të tyre të përbashkëta – krijojnë grupin nga një shumësi e thjeshtë.⁵⁴³ Me fjalë të tjera, duhet të vërtetohet se personat në një ndërmarrje kriminale bashkëveprojnë, ose veprojnë në lidhje me njëri tjetrin, në zbatimin e

⁵³⁶ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 227.

⁵³⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, paragrafët 115-119; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafi 418.

⁵³⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafi 413.

⁵³⁹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 227; *Prokurorja kundër Milorad Kërnojelacit*, Vendim mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë, 11 maj 2000, paragrafi 15.

⁵⁴⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, paragrafi 97.

⁵⁴¹ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, paragrafi 98.

⁵⁴² Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafi 430.

⁵⁴³ Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore *Krajishnik*, paragrafi 884.

qëllimit të përbashkët, nëse përcaktohet se ndajnë përgjegjësitë për krimet e kryera nëpërmjet NPK-së.⁵⁴⁴

5.2.2 Kryerja, planifikimi, nxitja, urdhërimi dhe ndihma e inkurajimit

140. Veç pjesëmarrjes së tyre në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, ndryshe Aktakuza e fajëson çdo të Akuzuar për përgjegjësi penale individuale sipas Nenit 7 (1), bazuar në kategoritë e përgjegjësisë së kryerjes, planifikimit, nxitjes, urdhërimit apo ndihmës dhe inkurajimit. Në Pikat 4, 16 dhe 24 Ramush Haradinaj akuzohet për kryerje, në Pikën 16 për planifikimin, në Pikat 2 dhe 34 për nxitjen apo urdhërimin, dhe në Pikat 2, 4, 16, 24, 32 dhe 34 për ndihmë dhe inkurajim. Në Pikat 8, 14, 18, 20, 24, 32, 34, 36, dhe 37 Idriz Balaj akuzohet për kryerje, në Pikat 14, 32, 34, 36 dhe 37 për planifikim, në Pikat 14 dhe 32 për nxitje, dhe në Pikat 8, 14, 18, 20, 24, 32 dhe 34 për ndihmë dhe inkurajim. Në Pikat 28, 32 dhe 34 Lahi Brahimaj akuzohet për kryerje, në Pikat 32 dhe 34 për planifikim, në Pikat 24, 26 dhe 32 për nxitje, në Pikat 24 dhe 26 për urdhërim, dhe në Pikat 24, 26, 28, 32 dhe 34 për ndihmë dhe inkurajim.

141. Neni 7 (1) mbulon së pari dhe para së gjithash kryerjen fizike të një krimi apo mokryerjen e fajshme të një veprimi i cili ishte i detyrueshëm sipas ligjit.⁵⁴⁵ Neni 7 (1) pasqyron gjithashtu parimin se përgjegjësia penale për një krim sipas Neneve 2 deri 5 të Statutit nuk u ngarkohet vetëm individëve të cilët kryen krime, por mund t'u atribuohet edhe individëve të cilët ndihmojnë në krime në mënyrë të tjera të përshkruara më lart. Që një i akuzuar të jetë përgjegjës për një krim sipas këtyre kategorive të përgjegjësisë, krimi në fjalë duhet të jetë kryer.⁵⁴⁶ Për më tepër, veprimet e tij ose të saj duhet të kenë ndihmuar thelbësisht në kryerjen e krimin.⁵⁴⁷ Përgjegjësi mund të ketë edhe për mosveprime kur ekziston një detyrim për të vepruar.⁵⁴⁸

⁵⁴⁴ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafët 410, 430.

⁵⁴⁵ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 188.

⁵⁴⁶ Për planifikimin, shih Aktgjykimin e Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 26. Për nxitjen, shih Aktgjykimin e Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 27. Për urdhërimin, shih Aktgjykimin e Apelit *Kamuhanda*, paragrafi 75. Për ndihmën dhe inkurajimin, shih Aktgjykimin e Apelit *Simiç dhe të tjerë*, paragrafi 85.

⁵⁴⁷ Për planifikimin, shih Aktgjykimin e Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 26. Për nxitjen, shih Aktgjykimin e Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 27. Për urdhërimin, shih Aktgjykimin e Apelit *Kayishema dhe Ruzindana*, paragrafi 186; Aktgjykimin e Apelit *Kamuhanda*, paragrafi 75. Për ndihmën dhe inkurajimin, shih Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*, paragrafi 229; Aktgjykimin e Apelit *Çelebiqi*, paragrafi 352; Aktgjykimin e Apelit *Vasileviq*, paragrafi 102; Aktgjykimin e Apelit *Blashkiq*, paragrafët 45-46, 48; Aktgjykimin e Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, paragrafi 89; Aktgjykimin e Apelit *Simiç dhe të tjerë*, paragrafi 85; Aktgjykimin e Apelit *Blagojeviq dhe Jokiç*, paragrafi 127.

⁵⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 663; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, paragrafi 175; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafi 274.

142. *Planifikimi*. Përgjegjësia mund të burojë prej planifikimit të krimit i cili kryhet më vonë nga keqbërësi kryesor.⁵⁴⁹ Planifikuesi duhet të ketë si synim kryerjen e krimit, ose zbatimin e planit, duke ditur se ka shumë të ngjarë që të rezultojë në kryerjen e krimit.⁵⁵⁰

143. *Nxitja*. Përgjegjësia mund të burojë nëpërmjet nxitjes së keqbërësit kryesor në kryerjen e krimit.⁵⁵¹ Nxitësi duhet të ketë si synim kryerjen e krimit, apo të jetë në dijeni se ka shumë të ngjarë që kryerja e krimit të jetë pasojë e sjelljes së tij ose të saj.⁵⁵²

144. *Urdhërimi*. Përgjegjësia mund të burojë prej urdhërimit të keqbërësit kryesor për kryerjen e krimit apo kryerjen e veprimeve që rezultojnë në krim.⁵⁵³ Në kohën e dhënies së urdhrit, urdhërdhënësi duhet të ketë pushtet zyrtar apo jozyrtar mbi kryesin e krimit.⁵⁵⁴ Urdhërdhënësi duhet të ketë synim kryerjen e krimit ose dijeninë se ka shumë të ngjarë që zbatimi i urdhrit të rezultojë në kryerja e krimit⁵⁵⁵

145. *Ndihma dhe inkurajimi*. Përgjegjësia mund të burojë prej kryerjes së veprimeve që ndihmojnë, inkurajojnë ose përkrahin moralisht kryerjen e krimit.⁵⁵⁶ Inkurajim mund të jetë miratimi i heshtur i një ndihmuesi i cili ka pushtet dhe është fizikisht i pranishëm në vendin e krimit, edhe ku ai ose ajo nuk ka detyrim për të vepruar.⁵⁵⁷ Ndihma dhe inkurajimi mund të ndodhin para, gjatë dhe pas kryerjes së krimit kryesor.⁵⁵⁸ Ndihma dhe inkurajimi pas kryerjes së krimit mund të ndodhin nëse kryesi kreu krimin me dijeninë se ndihmuesi/inkurajuesi do të ofronte ndihmesë praktike.⁵⁵⁹ Ndihmuesi/inkurajuesi duhet të jetë në dijeni se veprimet e tij ose të saj ndihmojnë në kryerjen e krimit prej keqbërësit kryesor.⁵⁶⁰ Ndihmuesi/inkurajuesi duhet të jetë gjithashtu në dijeni të veprimeve kriminale të keqbërësit kryesor, megjithëse jo për sa i përket cilësimit të tyre ligjor, dhe gjendjes mendore kriminale të tij ose të saj.⁵⁶¹ Mirëpo nuk është e nevojshme që ndihmuesi/inkurajuesi të dijë për krimin konkret të synuar ose për krimin konkret të

⁵⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 26.

⁵⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafët 29, 31.

⁵⁵¹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 27.

⁵⁵² Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 29, 32.

⁵⁵³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 28; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, paragrafi 176.

⁵⁵⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafi 28; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, paragrafi 176.

⁵⁵⁵ Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 42; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq dhe Çerkez*, paragrafët 29-30.

⁵⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, paragrafi 229; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, paragrafi 352; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, paragrafi 102; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafët 45-46, 48; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, paragrafi 89; Aktgjykimi i Apelit *Simiç dhe të tjerë*, paragrafi 85; Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq dhe Jokiç*, paragrafi 127.

⁵⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafët 273, 277.

⁵⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 48; Aktgjykimi i Apelit *Simiç dhe të tjerë*, paragrafi 85; Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq dhe Jokiç*, paragrafi 127.

⁵⁵⁹ Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq dhe Jokiç*, paragrafi 731.

⁵⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, paragrafi 102; Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafët 45-46; Aktgjykimi i Apelit *Simiç dhe të tjerë*, paragrafi 86; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafët 484, 488; Aktgjykimi i Apelit *Blagojeviq dhe Jokiç*, paragrafi 127.

⁵⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, paragrafi 162; Aktgjykimi i Apelit *Simiç dhe të tjerë*, paragrafi 86; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, paragrafët 484, 487-488.

kryer; mjafton që ai ose ajo të dijë që ka të ngjarë se do të kryet një prej krimeve, nëse vërtet është kryer.⁵⁶²

⁵⁶² Aktgjykimi i Apelit *Blashkiq*, paragrafi 50; Aktgjykimi i Apelit *Simiq dhe të tjerë*, paragrafi 86.

6. Përfundime në lidhje me Pikat

6.1 Përfundime të përgjithshme lidhur me rrethinën e kanalit të Radoniqit

146. Në pjesët vijuese 6.2. - 6.19 Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë 30 vrasje të pretenduara emërues i përbashkët i të cilave është se viktimat u gjetën në një rrethinë që shtrihet nga kanali i Radoniqit deri në Liqenin e Radoniqit, në komunën e Deçanit.⁵⁶³ Kanali i Radoniqit dhe sistemi uJOR i liqenit përbëheshin nga pika e futjes së ujit përgjatë rrjedhës së Lumit Bistricë, në Llukën e Epërme, komuna e Deçanit; një kanal betoni shtatë kilometra që përfundonte në një rrëpirë natyrale dhe që çonte ujë në një rezervuar/liqen; vetë liqeni; dhe një impiant për trajtimin dhe shpërndarjen e ujit në pjesën jugore të liqenit.⁵⁶⁴ Akuzat për vrasjet e pretenduara bëhen në Pikat 8, 10, 14, 16, 18, 20, 22 dhe 34 të Aktakuzës. Prokuroria pretendon se të gjitha viktimat, në bazë të këtyre pikave u vranë "kur mbaheshin në arrest prej UÇK-së".⁵⁶⁵ Dhoma Gjyqësore mendon se, sipas Prokurorisë, kjo do të thotë se në këto vrasje është përfshirë UÇK-ja, në dallim me përfshirjen e ndonjë organizate apo subjekti tjetër, dhe në dallim me vrasjet e kryera nga njerëz që nuk janë anëtarë të UÇK-së ose nga ushtarë të UÇK-së që kanë vepruar thjesht në bazë të iniciativës së tyre individuale, dhe jo nën drejtimin apo duke zbatuar politikën e UÇK-së.

147. Dëshmitë e paraqitura para Dhomës Gjyqësore lidhur me autorët e shumë prej vrasjeve të pretenduara dhe rrethanat e tyre janë të mjegullta, të paqarta, apo thjesht joekzistuese. Shpesh dëshmia ndërpritet në momentin kur personi zhduket në rrethana të dyshimta dhe rifillon kur gjenden eshtrat e kufomave me shenja të një vdekjeje të dhunshme dhe kur këto eshtra identifikohen. Sidoqoftë mbetet e paqartë çfarë i ka ndodhur personit në fjalë në periudhën e ndërmjetme. Megjithatë, për një numër të vogël të vrasjeve të pretenduara Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi të shumta. Për këtë arsye çështja me të cilën ballafaqohet Dhoma Gjyqësore është nëse këto dëshmi të shumta vlejné vetëm për të nxjerrë përfundime për vrasjet e pretenduara për të cilat janë paraqitur këto dëshmi, apo nëse ato janë të mjaftueshme për të konkluduar se edhe vrasjet e tjera të pretenduara ndodhën kur viktimat mbaheshin në arrest e UÇK-së.

148. Kontrolli që UÇK-ja ushtronte në zonën përreth rrethinës së kanalit të Radoniqit dhe Liqenit të Radoniqit ishte i konsiderueshëm, por jo i plotë në çdo drejtim, gjatë periudhës së aktakuzës (shih

⁵⁶³ Të dy kufomat e gjetura në afërsi të Dashinocit do të trajtohen në pjesën e mëposhtme 6.7.

⁵⁶⁴ P367 (Faton Stefa, deklaratë dëshmitari, 29 maj 2007), paragrafët 11, 33-35, 80-81; Faton Stefa, T. 5999. Dhoma Gjyqësore do t'i referohet dy vendeve kryesore ku u gjetën kufomat "në kanalin e Radoniqit" dhe "në rrëpirën e poshtme të rrjedhës së kanalit të Radoniqit". Dhoma Gjyqësore e përdor termin "në rrethinën e kanalit të Radoniqit" për t'iu referuar të dy këtyre vendeve ku u gjetën kufomat.

⁵⁶⁵ Kjo shprehje përmendet në Aktakuzë për të gjitha vrasjet e pretenduara me përjashtim të vrasjes së pretenduar të Sanije Balajt sipas Pikës 22.

gjithashtu pjesën 3.2.1., sipër).⁵⁶⁶ Për të paktën një pjesë të kësaj periudhe ka patur forca serbe të dislokuara në Baballoq, Bitesh, dhe Cermjan.⁵⁶⁷ Ka patur gjithashtu forca serbe të dislokuara në pjesën jugore të Liqenit të Radoniqit.⁵⁶⁸ Forcat serbe mund të hynin në këtë rajon përkohësisht vetëm për kryerjen e operacione ushtarake.⁵⁶⁹ Dëshmitari 69, polic serb i caktuar në MPB-në e Gjakovës gjatë periudhës së aktakuzës,⁵⁷⁰ dëshmoi se policia e kishte informuar se deri nga mesi i vitit 1998 patrullat e policisë mund të hynin në pjesën veriore të Liqenit të Radoniqit nëpërmjet rrugës që kalonte përmes Ratishës, ose nëpërmjet rrugës që kalonte përmes Cermjanit, të dyja këto në komunën e Gjakovës, por se këto patrulla janë futur rrallë në zonën përreth liqenit dhe se mund t'a bënin një gjë të tillë vetëm nëse zona ishte e siguruar nga policia apo ushtria.⁵⁷¹ Dëshmitari 69 mësoi gjithashtu nga policia se në periudhën nga mesi i vitit 1998 deri në shtator 1998 policia hynte në zonën e kontrolluar nga UÇK-ja midis Pozharit në komunën e Deçanit, Jabllanicës dhe Dujakës, të dyja në komunën e Gjakovës, vetëm kur kryente ndonjë operacion policor.⁵⁷²

149. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi të shumta për numrin e kufomave të gjetura nga policia serbe në rrethinën e kanalit të Radoniqit në shtator 1998, për zhvarrimin e këtyre kufomave, si dhe për identifikimin e mëvonshëm të viktimave. Më 3 shtator 1998 forcat e MPB-së arrestuan dy anëtarë të UÇK-së, Bekim Kalimashi dhe Zenel Alija.⁵⁷³ Të dy këta persona u çuan në stacionin policor të Gjakovës ku u morën në pyetje.⁵⁷⁴ Disa dëshmitarë dëshmuan se Kalimashi dhe Alija dhanë hollësi për kufomat që mund të gjendeshin në rrethinën e kanalit të Radoniqit.⁵⁷⁵ Më 8 dhe 9 shtator 1998, oficerë të MPB-së si dhe zyrtarë të RDB-së, së bashku me Bekim Kalimashin, udhëtuan për në pjesën e fundme të kanalit të Radoniqit.⁵⁷⁶ Atje, Kalimashi tregoi se ku mund të gjendeshin kufomat.⁵⁷⁷

⁵⁶⁶ P854 (Radovan Zllatkoviç, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafët 28-36; Radovan Zllatkoviç, T. 6925-6939; Shemsedin Cekaj, T. 4486; 4488-4489; Zharko Bajçetiç, T. 6533-6534.

⁵⁶⁷ Dëshmitari 21, T. 2716; 2789-2790; 2792, 2794, 2804-2807, 2814-2815.

⁵⁶⁸ P1017 (Dragan Zhivanoviç, deklaratë, 9 gusht 2007), paragrafi 8; Dragan Zhivanoviç, T. 9394-9396; D83 (Urdhër i Gjeneralit Nebojsa Pavkoviç, 18 gusht 1998), f. 2.

⁵⁶⁹ Achilleas Pappas, T. 4284-4286, 4288-4290; P309 (Raport Ditor Përmbledhës paraqitur selisë së ECMM-së, 13 gusht 1998).

⁵⁷⁰ P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë, 20 qershor 2007) paragrafët 1-2, Dëshmitari 69, T. 9832-9833, 9846, 9848, 9892.

⁵⁷¹ P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë, 20 qershor 2007), paragrafët 30-31; Dëshmitari 69, T. 9846, 9876-9879, 9904.

⁵⁷² P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë, 20 qershor 2007), paragrafët 31-32, Dëshmitari 69, T. 9846, 9864-9865, 9878-9880; P1179 (Hartë e shënuar nga Dëshmitari 69).

⁵⁷³ P854 (Radovan Zllatkoviç, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafi 47; Radovan Zllatkoviç, T.6940, 7012, 7014-7016, 7018; P380 (Nebojsa Avramoviç, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 23, 25; Nebojsa Avramoviç, T.6625; P388 (Notë Zyrtare e MPB-PJP për arrestimin e anëtarëve të UÇK-së), P395 (Vendim për arrestimin e Zenel Alijajt, 6 shtator 1998).

⁵⁷⁴ P854 (Radovan Zllatkoviç, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafët 50-52; Radovan Zllatkoviç, T. 6940-6941, 6955-6956; P380 (Nebojsa Avramoviç, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 28, 30; P371 (Bogdan Tomash, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafët 22-23; Bogdan Tomash, T. 6134-6135; P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë dëshmitari, 20 qershor 2007), paragrafët 33-34; Dëshmitari 69, T.9846, 9888.

⁵⁷⁵ P854 (Radovan Zllatkoviç, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafët 53, 55; P380 (Nebojsa Avramoviç, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 31; P371 (Bogdan Tomash, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafët 24-25; P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë dëshmitari, 20 qershor 2007), paragrafët 34, 59, 65.

⁵⁷⁶ P854 (Radovan Zllatkoviç, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafët 64-65, 68-73; Radovan Zllatkoviç, T. 6972-6973, 6975; P380 (Nebojsa Avramoviç, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 43-45; Nebojsa Avramoviç, T. 6649-6658; P371 (Bogdan Tomash, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafët 29-34; Bogdan Tomash, T. 6227, 6232; P377 (Zharko Bajçetiç, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafët 32, 41-43, 48-51, 91; Zharko Bajçetiç, T. 6414, 6455-6456.

⁵⁷⁷ P854 (Radovan Zllatkoviç, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafët 74, 80; Radovan Zllatkoviç, T. 6974.

150. Duket se si UÇK-ja po ashtu dhe autoritetet serbe kanë qenë në dijeni që përpara shtatorit 1998 se në kanalën e Radoniqit gjendeshin disa kufoma. Dëshmitari 17 dëshmoi se më 20 gusht 1998, 68 përfaqësues të fshatrave morën pjesë në një mbledhje të kryesuar nga Tahir Zemaj në mensën e shtabit në Prapaqan.⁵⁷⁸ Gjatë kësaj mbledhjeje Ramush Haradinaj deklaroi se ai nuk ishte më në gjendje të udhëhiqte forcat në zonën e Dukagjinit pasi këto forca kishin humbur disa fshatra gjatë ofensivës serbe në gusht. U ra dakord që Tahir Zemaj të ishte komandant i Shtabit Operativ të Rrafshit të Dukagjinit dhe Haradinaj të ishte zëvendësi i tij.⁵⁷⁹ Në këtë mbledhje një person foli për veprime të gabuara nga disa njerëz dhe shtoi se për shkak të kësaj "peshqit në Liqenin e Radoniqit po dhjamoseshin me mish njeriu."⁵⁸⁰ Personi kërkoi që këta njerëz "të disiplinoheshin, të silleshin mirë dhe t'i ndërprisnin këto krime."⁵⁸¹ Dëshmitari 17 nuk i kujtohej nëse pati ndonjë reagim ndaj këtij pretendimi nga ana e ndonjë pjesëmarrësi në mbledhje.⁵⁸² Dëshmitari i kujtohej se në mbledhje erdhi edhe Idriz Balaj, por ai, sipas mendimit të dëshmitarit, qëndroi jashtë për të garantuar sigurinë.⁵⁸³ Informacioni për praninë e eshtrave njerëzore në kanalën e Radoniqit i erdhi edhe shërbimit serb të zbulimit.⁵⁸⁴ Fakti se autoritetet serbe kishin dijeni për këtë para se të informoheshin prej Kalimashit dhe Alijajt për kufomat dhe fakti se këto autoritete mund t'i kenë manipuluar deklaratat e tyre nuk ka lidhje me përfundimin që duhet të nxjerrë Dhoma Gjyqësore në këtë pjesë. Dhoma Gjyqësore nuk pranon sugjerimin e nënkuptuar se kufomat në rrethinën e kanalit të liqenit të Radoniqit ishin "vendosur" atje nga policia ose ushtria serbe. Nuk ekzistojnë prova të besueshme në mbështetje të skenarit, sipas të cilit eshtrat e një apo më shumë kufomave, të cilat përmenden në pikat e Aktakuzës, u sollën në atë vend ku u gjetën pasi forcat serbe kishin rivendosur kontrollin e nevojshëm për kryerjen e hetimeve në vendngjarje në fillim të shtatorit.

151. Gjykatësi hetues i Gjykatës së Qarkut të Pejës, Radomir Gojković (Radomir Gojković), u informua për kufomat më 9 shtator 1998.⁵⁸⁵ Ai shkoi në kanalën e Radoniqit po atë ditë dhe nisi një hetim i cili u krye gjatë ditëve të mëvonshme.⁵⁸⁶ Ekipi i tij hetues përbëhej nga ai vetë, Zëvendësprokurori Publik Zoran Babić (Zoran Babić) si dhe nga disa anëtarë të MPB-së, ndër të cilët Nebojsa Avramović dhe Radovan Zlatković.⁵⁸⁷ Gojkovići kërkoi që përfaqësuesit e Institutit Mjekoligjor të Fakultetit të Mjekësisë në Beograd të dërgoheshin në Kosovë për të bërë

⁵⁷⁸ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 100; Dëshmitari 17, T. 7592-7593.

⁵⁷⁹ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 100; Dëshmitari 17, T. 7592, 7600; D161 (Komunikatë nënshkruar nga Tahir Zemaj, 22 gusht 1998).

⁵⁸⁰ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 101; Dëshmitari 17, T. 7593-7597.

⁵⁸¹ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 101; Dëshmitari 17, T. 7597.

⁵⁸² Dëshmitari 17, T. 7750.

⁵⁸³ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 106.

⁵⁸⁴ D153 (Notë Zyrtare, 20 gusht 1998).

⁵⁸⁵ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafët 15, 21; P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 68; Nebojsa Avramović, T. 6271.

⁵⁸⁶ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafët 24, 26, 32, 36-37, 43, 58, 60, 62, 66, 68.

⁵⁸⁷ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 35.

zhvarrimet e kufomave të zbuluara.⁵⁸⁸ Ky ekip mbërriti në vendngjarje më 11 shtator 1998 dhe punoi deri më 16 shtator 1998. Gjatë kësaj kohe përfunduan zhvarrimet e kufomave.⁵⁸⁹ Ekipi përfshinte Profesor Dushan Dunjiqin (Dušan Dunjić), i cili drejtonte ekipin mjekoligjor, dhe Profesor Branimir Aleksandriqin (Branimir Aleksandrić).⁵⁹⁰ Më 12 shtator 1998, ekipi mjekoligjor u nda në dy grupe: një grup, i cili përfshinte Profesor Aleksandriqin, punoi për nxjerrjen e kufomave në kanal, dhe grupi tjetër, i cili përfshinte Profesor Dushan Dunjiqin, kreu ekzaminimin mjekoligjor të eshtrave.⁵⁹¹

152. Ekipi mjekoligjor zhvarrosi 17 kufoma në bregun perëndimor të kanalit.⁵⁹² Ekipet hetuese dhe mjekoligjore gjetën një automjet të përmbysur në rrëpirën përgjatë rrjedhës në fund të kanalit.⁵⁹³ Kur anëtarët e ekipit mjekoligjor u përpoqën ta lëviznin automjetin nga bagazhi i tij ra kufoma e një gruaje (shih pjesën 6.10, më poshtë).⁵⁹⁴ Shumë nga personat që merrnin pjesë në hetimin dhe zhvarrimin e kufomave vunë re vrima plumbash në murin e kanalit.⁵⁹⁵ Dhoma Gjyqësore pranon se personat e gjetur në atë vend mund të jenë ekzekutuar pikërisht atje. Mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundime më të përgjithshme, veçanërisht lidhur me kufomat e gjetura në një farë largësie nga ky vend. Më 15 shtator 1998, polici serb Slobodan Paniq (Slobodan Panić) dhe zhytësa të tjerë bënë kërkime në kanal dhe në pjesë të terrenit rreth tij dhe njoftuan se kishin gjetur disa kufoma të tjera apo pjesë kufomash rreth 700 deri në 2500 metra nga fundi i kanalit.⁵⁹⁶ Disa kufoma të tjera u gjetën në fermën Ekonomija aty pranë.⁵⁹⁷ Ekipi hetues gjeti gjithashtu atje tel me gjemba mbi të cilin dukej se kishte flokë njeriu, si dhe kabëll elektrik, i cili ishte lidhur me grazhdett metalike të bagëtive.⁵⁹⁸ Sa herë gjendej një kufomë, ekipi mjekoligjor

⁵⁸⁸ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 33; P409 (Kërkesë dërguar nga Radomir Gojković, 9 shtator 1998).

⁵⁸⁹ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafët 44, 66, 70; P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 110; Nebojsa Avramović, T. 6607; P411 (Letër nga Radomir Gojković, 17 shtator 1998); P412 (Raport i ekipit mjekoligjor, 16 shtator 1998).

⁵⁹⁰ P618 (Dushan Dunjić, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 23, 40, 151; P1260 (Branimir Aleksandrić, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1; paragrafët 4, 9; Branimir Aleksandrić, T. 6737; P1113 (CV e Branimir Aleksandriqit), f. 1.

⁵⁹¹ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 56; P1260 (Branimir Aleksandrić, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 33, 45; P618 (Dushan Dunjić, deklaratë, 8 qershor 2007), paragrafët 72, 91.

⁵⁹² P1260 (Branimir Aleksandrić, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 271; P1116 (Fotografi ajrore të shënuara nga Branimir Aleksandrić).

⁵⁹³ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 27; Radomir Gojković, T. 10112; P854 (Radovan Zlatković, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafi 88, P377 (Zharko Bajçetiç, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafët 62-63; Zharko Bajçetiç, T. 6526-6527; P1260 (Branimir Aleksandrić, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 31, 151, 153-156, 212; Branimir Aleksandrić, T. 9605.

⁵⁹⁴ P854 (Radovan Zlatković, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafi 88; P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 63-64; Nebojsa Avramović, T. 6621-6622, 6663-6665.

⁵⁹⁵ P854 (Radovan Zlatković, deklaratë dëshmitari, 25 qershor 2007), paragrafi 76; P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 59; P377 (Zharko Bajçetiç, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 59; P270 (Achilleas Pappas, deklaratë dëshmitari, 9 maj 2007), paragrafi 21; Achilleas Pappas, T. 4151-4158; P1260 (Branimir Aleksandrić, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 17-18, 22-23, 62, 67, 79; Branimir Aleksandrić, T. 6739, 9570-9571; P452 (Video e gjetjes së kufomave në kanal), 0:03'41"-0:04'20", 0:23'38".

⁵⁹⁶ D131 (Raport nga Slobodan Paniq, 16 shtator 1998).

⁵⁹⁷ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 42; P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 91-95, 181-182; P1260 (Branimir Aleksandrić, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 54, 56; Branimir Aleksandrić, T. 6741; P618 (Dushan Dunjić, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 28, 57, 147-149, 153-155, 160, 180, 601, 611-612, 623, 635, 650, 661, 673; Dushan Dunjić, T. 7296-7297, 7383-7385; P630 (Regjistër i zhvarrimeve, 16 shtator 1998), f. 1; P643 (Përmbledhje e operacionit lidhur me kufomat në fermën Ekonomija), faqet. 1-2; Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 138.

⁵⁹⁸ P1193 (Radomir Gojković, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 42; P380 (Nebojsa Avramović, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 97; Nebojsa Avramović, T. 6619; P1260 (Branimir Aleksandrić, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 55, 57-58; Branimir Aleksandrić, T. 6743-6744, 6750; P618 (Dushan Dunjić, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 59; P630 (Regjistër i zhvarrimeve, 16 shtator 1998), f. 1.

shënonte në të një numër si dhe vendin ku ishte gjetur (“R” për Irzniq, dmth. Kanali i Radoniqit, dhe “Re” për Fermën Ekonomija).⁵⁹⁹

153. Në Hotelin Pashtrik në Gjakovë u krijua një morg provizor ku u sollën eshtrat e kufomave nga zona e kanalit.⁶⁰⁰ Procesi i autopsisë filloi më 12 shtator 1998 dhe përfundoi më 19 shtator 1998.⁶⁰¹ Nga data 17 deri 19 shtator 1998, të afërmit e personave të zhdukur u ftuan të vinin në Hotelin Pashtrik dhe të përpiqeshin që të identifikonin kufomat me anën e mjeteve tradicionale.⁶⁰² Në bazë të këtij procesi, të afërmit u jepnin ekspertëve mjekoligjor karakteristika të personave të zhdukur, dhe më tej atyre iu tregoheshin veshje dhe sende personale si dhe iu kërkoheshin të dorëzonin fotografi apo dokumenta lidhur me personin e zhdukur.⁶⁰³ Njëqoftëse një i afërm identifikonte veshje apo sende të tjera, ekspertët mbanin shënim të dhëna si moshën e viktimës, gjininë, shtatllartësinë, peshën, plagë të mëparshme, historinë dentare dhe mjekësore, dhe i krahasonin këto të dhëna me kufomat.⁶⁰⁴ Njëqoftëse informacioni përputhej, kufoma konsiderohej e identifikuar.⁶⁰⁵ Nëpërmjet këtij procesi u identifikuan dhjetë nga viktimat: Velizar Stoshiq, Ilira dhe Tush Frrokaj, Ilija Antiq, Vukosava Vukosheviq, Darinka Kovaç, Milovan Vllahoviq, Isuf Hoxha, Agzhija Seferaj, and Hajrullah Gashi.⁶⁰⁶ Kufomat e identifikuara vendoseshin në arkivolë, të cilët vuloseshin dhe u dorëzoheshin anëtarëve të familjeve.⁶⁰⁷ Kufomat e paidentifikuara iu dorëzuan Milan Stanojeviqit (Milan Stanojević), shefit të MPB-së në Gjakovë, më 19 shtator 1998 për t'u varrosur në varrezën Piskotë në Gjakovë.⁶⁰⁸

154. Barney Kelly ishte një nga hetuesit e prokurorisë, i cili u ngarkua të verifikonte, nëpërmjet përdorimit të analizës së ADN-së, nëse identifikimet e bëra nga të afërmit kishin qënë të sakta.⁶⁰⁹ Gjatë kryerjes së kësaj detyre, Kelly u kërkoi të afërmit të viktimave që të ndihmonin për gjetjen e varreve familjarëve të tyre si dhe të jepnin gjak i cili nevojitej për kryerjen e analizës së ADN-së.⁶¹⁰ Nga dhjetë mbetje skeletore të gjetura në vendndodhjen e Liqenit të Radoniqit dhe të identikuara

⁵⁹⁹ P380 (Nebojsa Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 117; P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë dëshmitari, 20 qershor 2007), paragrafi 41; Dëshmitari 69, T. 9846; P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 40; Branimir Aleksandriq, T. 6741-6742; P1181 (Raport i Degës së Krimeve të Policisë së MPB-së në Gjakovë), faqet 28-33.

⁶⁰⁰ P1193 (Radomir Gojkoviq, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafët 42, 54-55; P380 (Nebojsa Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 122, 133; P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë dëshmitari, 20 qershor 2007), paragrafët 42, 46; Dëshmitari 69, T. 9846; P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 41, 62; P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 50, 62; Dushan Dunjiq, T. 7376.

⁶⁰¹ P380 (Nebojsa Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 136-137; P420 (Raport i Autopsisë më 12 shtator 1998).

⁶⁰² P1193 (Radomir Gojkoviq, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafët 71-72; Radomir Gojkoviq, T. 10067; P380 (Nebojsa Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 137.

⁶⁰³ P1193 (Radomir Gojkoviq, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 73.

⁶⁰⁴ P1193 (Radomir Gojkoviq, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 73.

⁶⁰⁵ P1193 (Radomir Gojkoviq, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafi 73.

⁶⁰⁶ P1193 (Radomir Gojkoviq, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafët 78-81; P380 (Nebojsa Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 170; P368 (Barney Kelly, deklaratë, 21 qershor 2007), paragrafi 5; Barney Kelly T. 6085-6086; P423 (Raport i identifikimit më 19 shtator 1998), f. 1; P1198 (Dokumenta lidhur me hetimin në Liqenin e Radoniqit), faqet 15-17.

⁶⁰⁷ P1193 (Radomir Gojkoviq, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafët 75-77; P380 (Nebojsa Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 169; P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 133; Dushan Dunjiq, T. 6850, 7377.

⁶⁰⁸ P1193 (Radomir Gojkoviq, deklaratë dëshmitari, 23 tetor 2007), paragrafët 83-86; P423 (Raport i identifikimit më 19 shtator 1998); P380 (Nebojsa Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafët 142-168; P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 136; Dushan Dunjiq, T. 6850-6851, 7377; P423 (Raport i identifikimit më 19 shtator 1998); P641 (Raport përmbledhës për Gjykatësin Gojkoviq), f. 2.

⁶⁰⁹ P368 (Barney Kelly, deklaratë dëshmitari, 21 qershor 2007), paragrafi 8; Barney Kelly, T. 6086.

nëpërmjet mjeteve tradicionale, nëpërmjet analizës së ADN-së u konfirmua vetëm identiteti i Velizar Stoshiqit (shënuar si “R-8”), Ilira Frrokajt (“R-18”), dhe Ilija Antiqit (“R-20”).⁶¹¹ Për disa kufoma të tjera, të cilat u sollën për identifikim me anë të ADN-së, nuk u arrit të përcaktohej përputhja me identifikimin e bërë me mjete tradicionale.⁶¹²

155. Mbi bazën e dëshmisë së dhënë nga Milutin Vishnjq (Milutin Višnjić), ekspert i balistikës, dhe një raporti që ai përgatiti më 2 dhjetor 1998,⁶¹³ Prokuroria pretendoi se e njëjta armë që ishte përdorur nga UÇK-ja në rrethinën e kanalit të Radoniqit “për të vrarë kundërshtarët e saj” ishte përdorur më parë nga UÇK-ja kundër MPB-së në Plançar më 7 mars 1998, si dhe në luftimet në vendbanimin e familjes Haradinaj më 24 mars 1998.⁶¹⁴ Në raportin e tij, Vishnjq krahasoi gëzhojat e gjetura në rrethinën e kanalit të Radoniqit në fillim të shtatorit 1998 me gëzhojat e gjetura në Plançar më 7 mars 1998 si dhe në vendbanimin e familjes Haradinaj më 24 mars 1998.⁶¹⁵ Mbi bazën e shqyrtimit krahasues mikroskopik të disa karakteristikave dalluese të gëzhojave, Vishnjq konkludoi se 14 nga gëzhojat e gjetura në rrethinën e kanalit të Radoniqit ishin të njëjta me 29 gëzhojat e gjetura në Plançar dhe 29 gëzhojat e gjetura në vendbanimin e familjes Haradinaj.⁶¹⁶

156. Dhoma Gjyqësore konstatoi se Milutin Vishnjq (Milutin Višnjić) ishte dëshmitar i besueshëm. Ndërtesa e departamentit të mjekësisë ligjore u godit gjatë bombardimeve të NATO-s në vitin 1999 dhe materialet origjinale të shqyrtuara nga Vishnjq si dhe shënimet e tij personale për këtë shqyrtim u zhdukën dhe për këtë arsye, ekspertët e Mbrojtjes nuk patën mundësi t'i shihnin ato.⁶¹⁷ Për më tepër, ishte e pamundur të verifikohej saktësia e përfundimeve të Vishnjqit pasi nuk ka dokumentacion fotografik për analizat e tij.⁶¹⁸ Gjithashtu në raportin e tij Vishnjq nuk ka dhënë hollësi për modelet e vëzhguara, të cilat e çuan në përfundimin se gëzhojat përputheshin.⁶¹⁹ Në raportin e tij përmenden vendet ku u gjetën gëzhojat e shqyrtuara, bëhet një përshkrim i shkurtër i metodës së përdorur, si dhe jepen konkluzionet e arritura mbi bazën e numrit të përputhjeve dhe vendeve ku u gjetën gëzhojat.⁶²⁰ Dhoma Gjyqësore shqyrtoi numrin e gëzhojave që Vishnjq kishte marrë në vende të ndryshme dhe konstatoi se disa gëzhoja mungonin. Vishnjq nuk ishte në gjëndje

⁶¹⁰ P368 (Barney Kelly, deklaratë dëshmitari, 21 qershor 2007), paragrafët 7-10, 34, 36.

⁶¹¹ Barney Kelly, T. 6087-6090.

⁶¹² Identifikimet e mëvonshme nëpërmjet ADN-së të viktimave të gjetura në rrethinën e kanalit të Radoniqit do të diskutohen në pjesët përkatëse më poshtë.

⁶¹³ Shih dëshminë e Milutin Vishnjq, T. 8317-8357, dhe P916 (Raport i balistikës nga Milutin Vishnjq).

⁶¹⁴ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, paragrafi 676.

⁶¹⁵ P916 (Raport i balistikës nga Milutin Vishnjq). Raporti i Vishnjqit i referohet Gramaqelit si vendi ku u gjetën gëzhojat më 24 mars 1998. Dhoma Gjyqësore e kupton këtë si referencë për oborrin me ndërtesa të familjes Haradinaj, i cili ndodhet midis fshatrave Gillogjan dhe Gramaqel në komunën e Deçanit. Shih gjithashtu P446 (Dokumentacioni i MPB-së që i referohet incidentit më 24 mars 1998 në Gillogjan); P448 (Nota zyrtare nga Nebojsa Avramović, 4 dhjetor 1998), e cila përmend vendgjetjen e gëzhojave.

⁶¹⁶ P916 (Raport i balistikës nga Milutin Vishnjq); Shih gjithashtu P446 (Dokumentacioni i MPB-së, që i referohet incidentit më 24 mars 1998 në Gillogjan) dhe P448 (Nota zyrtare nga Nebojsa Avramović, 4 dhjetor 1998).

⁶¹⁷ Milutin Vishnjq, T. 8331-8332.

⁶¹⁸ Milutin Vishnjq, T. 8351.

⁶¹⁹ Milutin Vishnjq, T. 8346-8347, 8349.

⁶²⁰ P916 (Raport i balistikës nga Milutin Vishnjq).

të shpjegonte në mënyrë bindëse mospërputhjen midis numrit të përgjithshëm të gëzhjave të marra për krahasim dhe numrit të përgjithshëm të gëzhjave të shqyrtuara.⁶²¹ Kjo, si dhe pamundësia për verifikimin e përfundimeve të Vishnjqit e shtynë Dhomën Gjyqësore të vendoste që të mos mbështetej në këtë dëshmi. Edhe nëqoftëse Dhoma Gjyqësore do të kishte mundur të konkludonte se arma e përdorur në të tre këto vende ishte, me të vërtetë e njëjta, përsëri kjo do të ishte e pamjaftueshme për të konkluduar se kush e kishte shkrehur këtë armë në rrethinën e kanalit të Radoniqit dhe individët që e kishin zotëruar këtë armë njëri pas tjetrit.

157. Ashtu siç do të diskutohet hollësisht në pjesët 6.5, 6.6, 6.8 - 6.12, si dhe në 6.16, më poshtë, dëshmitë e paraqitura pranë Dhomës Gjyqësore lidhur me 30 vrasjet e pretenduara ndryshojnë përsa i përket nivelit të hollësisbe që ofrojnë. Shumë nga këto dëshmi nuk japin identitetin e kryesve si dhe rrethanat e vdekjeve. Në pjesët e lartpërmendura Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë dëshmitë lidhur me: identitetin e viktimës; nëse viktimja u rrëmbye apo thjesht ka patur njoftime se ishte zhdukur; nëqoftëse ishte rrëmbyer, prej kujt u rrëmbye apo kujt grupi i përkiste rrëmbyesi apo rrëmbyesit; nëqoftëse kishte njoftime se viktimja ishte zhdukur, si mund të kishte rënë ai ose ajo në duart e atyre që kryen vrasjen apo hodhën kufomën; vendndodhjen e të rrëmbyerit apo të zhdukurit që nga koha e zhdukjes deri në vrasjen e tij apo të saj; shkakun e vdekjes si dhe nëse ishte vrasje e qëllimshme; kush e kishte vrarë viktimën ose kujt grupi i përkisnin vrasësist e viktimës; dhe rrethanat e ndodhjes së kufomës në rrethinën e kanalit të Radoniqit ku edhe u gjet më në fund.

158. Dhomës Gjyqësore nuk iu paraqitën dëshmi të plota për këto çështje për asnjë nga viktimat e gjetura në rrethinën e kanalit të Radoniqit. Për shumicën e viktimave Dhomës Gjyqësore iu paraqitën dëshmi vetëm për vendin dhe kohën kur ishin parë për herë të fundit të gjallë si dhe për faktin se u gjetur të vdekur në rrethinën e kanalit të Radoniqit. Viktimat u panë gjallë për herë të fundit në vendndodhje të ndryshme në tri komuna gjatë një periudhe prej pesë muajsh. Shumë prej tyre u panë gjallë për herë të fundit në zonat që në atë kohë kontrolloheshin nga UÇK-ja. Siç u theksua më sipër, rrethina e kanalit të Radoniqit ku u gjetën kufomat ishte përgjithësisht nën kontrollin e UÇK-së gjatë gjithë periudhës së aktakuzës. Rrjedhimisht ekziston gjasa që viktimat të jenë rrëmbyer nga UÇK-ja, që i ka ekzekutuar dhe më pas i ka hedhur kufomat e tyre në rrethinën e liqenit të Radoniqit ose i ka çuar viktimat në këtë vend dhe i ka ekzekutuar atje.

159. Dhomës Gjyqësore iu paraqitën dëshmi të shumta, veçanërisht për autorët dhe rrethanat e vdekjes vetëm për një nga vrasjet e pretenduara, atë të Sanije Balajt. Rasti i kësaj viktime tregon se me sa kujdes duhet të veprojnë Dhoma Gjyqësore në nxjerrjen e konkluzioneve për përgjegjësinë duke u mbështetur thjesht në zhdukjen e një personi dhe në zbulimin e kufomës së këtij personi në

⁶²¹ T. 8338-8341; Shih gjithashtu P445 (Kërkesë për ekzaminim balistik, 21 shtator 1998) dhe P916 (Raport i balistikës nga Milutin Vishnjq).

rrethinën e kanalit të Radoniqit. Siç do të diskutohet hollësisht nga Dhoma Gjyqësore në pjesën e mëposhtme 6.12.12, një opsion i arsyeshëm i ndryshëm prej atij të përfshirjes së UÇK-së në këtë vrasje të pretenduar, është se Sanije Balaj u shënjestrua prej njerëzve të cilët nuk vepronin nën drejtimin apo në zbatim të politikave të UÇK-së, dhe se, rrjedhimisht ajo nuk u vra kur mbahej në arrest prej UÇK-së.

160. Dhomës Gjyqësore iu paraqitën gjithashtu disa dëshmi lidhur me rrëmbimin e disa viktimave të tjera si dhe vdekjen e tyre të mëvonshme. Në një rast të tillë, konkretisht vrasja e pretenduar të Nurije dhe Istref Krasniqit, e cila do të diskutohet në pjesën 6.12.6, më poshtë, Dhoma Gjyqësore nuk mund të shpërfillë alternativën e arsyeshme se kjo vrasje e pretenduar është bërë në suazën e një grindjeje familjare apo hakmarrjeje individuale.

161. Në rast se Dhoma Gjyqësore nuk do të kishte marrë dëshmi aq të hollësishme lidhur me vrasjen e pretenduar të Sanije Balajt, Dhoma Gjyqësore me gjasë mund të kishte konkluduar se kjo vrasje ishte kryer kur viktima “mbahej në arrest prej UÇK-së”, sipas formulimit të mësipërm. Duket se të gjithë elementët janë të pranishëm: arrestim nga ushtarë të UÇK-së; përfshirja e emrit të Sanije Balajt në atë çka duket se ishte lista e personave në kërkim që përdorej nga këta ushtarë; çuarja në një shtab të UÇK-së dhe marrja në pyetje atje; gjetja e pjesëve të kufomës në rrethinën e kanalit të Radoniqit; dhe dëshmia mjekoligjore për vdekje të dhunshme. Në pamje të parë ky do të ishte një ndër argumentet më të forta mbi bazën e së cilës Prokuroria i kërkon Dhomës Gjyqësore të konkludojë se vrasjet ishin kryer kur viktimat “mbaheshin në arrest prej UÇK-së”. Megjithatë, dëshmitë e hollësishme për rrethanat e vdekjes së Sanije Balajt tregojnë se përfundimi i lartpërmendur do të kishte qenë i gabuar. Siç u theksua edhe më sipër, dëshmitë që iu paraqitën Dhomës Gjyqësore për shumicën e vrasjeve të pretenduara ishin më të pakta. Dëshmitë që Dhoma Gjyqësore ka marrë lidhur me vrasjen e pretenduar të Sanije Balajt kërkojnë përjasje shumë të kujdesshme. Ato tregojnë tregon se krijimi i një përshtypjeje të parë mbështetur në një rrëfim jo të plotë mund të çojë në një përfundim të gabuar.

162. Si përfundim, vetëm për një numër të vogël të vrasjeve të pretenduara ekzistojnë dëshmi, të cilat mundësojnë identifikimin e një apo të disa kryesve. Por edhe për kaq vrasje të pretenduara, dëshmitë nuk përputhen në lidhje me pjesëmarrjen e UÇK-së, siç pretendohet. Rrjedhimisht dëshmitë nuk i mundësojnë Dhomën Gjyqësore të nxjerrë përfundime të përgjithshme lidhur me viktimat e gjetura në rrethinën e kanalit të Radoniqit, autorët e vrasjeve, dhe cilit grup i përkisnin nëse një përkatësi e tillë ekzistonte. Në lidhje me sa më sipër, Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet thelbësisht në faktin e gjetjes së kufomave në këtë vend, veçse në dëshmi konkrete për zhdukjen dhe vdekjen e viktimave. Mirëpo kjo nuk e pengon Dhomën Gjyqësore të nxjerrë

përfundimet e veta duke analizuar çdo pikë se aksh viktimë u vra kur “mbahej në arrest prej UÇK-së”. Tani Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë çdo pikë.

6.2 Trajtimi çnjerëzor, tortura, dhe shkelja e dinjitetit personal të Dëshmitares 38 dhe familjes së dëshmitares (Pika 2)

163. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, për trajtim çnjerëzor, torturë, dhe shkelje të dinjitetit personal të Dëshmitares 38 dhe familjes së dëshmitares si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Ndryshe Ramush Haradinaj akuzohet se ka urdhëruar, nxitur kryerjen e krimeve, apo ka ndihmuar dhe inkuruajuar në kryerjen e tyre. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga Dëshmitarja 38, Dëshmitarja 58, dhe Dragan Zhivanoviqi.

164. Dëshmitarja 38, rome nga Juniku, komuna e Deçanit,⁶²² dëshmoi se një natë, në fillim të majit 1998, ajo pa njerëz duke iu shpërndarë armë një grupi burrash në rrugën e fshatit të saj.⁶²³ Dëshmitarja njohu dy nga këta burra që ishin banorë shqiptarë të Junikut.⁶²⁴ Të nesërmen, Qemal Shala, i cili ishte i armatosur dhe veshur me uniformë kamuflazhi të gjelbër me simbolin e UÇK-së, mbajti një fjalim në Junik.⁶²⁵ Dëshmitarja 38 pa familje rome që u larguan nga Juniku pas këtij fjalimi.⁶²⁶ Sipas dëshmitares, ato u larguan për shkak të frikës.⁶²⁷ Në atë kohë, asnjë pjesëtar i grupeve të tjera etnike nuk u largua nga fshati.⁶²⁸ Dëshmitarja qëndroi në Junik, por kishte frikë të kthehej në banesën e familjes së saj, kështu që e kaloi natën tek fqinjët.⁶²⁹ Dëshmitarja dëshmoi se atë natë apo herët në mëngjezin e ditës së nesërme shpërthyen luftime të ashpra midis policisë dhe UÇK-së.⁶³⁰ Pati të shtëna kundër banesës së dëshmitares dhe shtëpisë së fqinjit.⁶³¹ Dëshmitarja 38 dhe familja e saj u largua nga shtëpia e fqinjit dhe u kthyen në banesën e tyre.⁶³² Pak pas kësaj, katër burra të armatosur, dy të veshur me uniforma kamuflazhi dhe me maska të zeza, si dhe dy të veshur si civilë erdhën në banesë.⁶³³ Burrat me uniforma kamuflazhi e urdhëruan dëshmitaren dhe familjen e saj të largoheshin nga banesa dhe të bashkoheshin me kolonën e civilëve. Ato iu bindën.⁶³⁴ Kolona u drejtua për në Gacifer, një lokalitet pranë Junikut.⁶³⁵ Disa nga burrat e veshur

⁶²² Dëshmitarja 38, T. 704, 750.

⁶²³ Dëshmitarja 38, T. 705-707.

⁶²⁴ Dëshmitarja 38, T. 706.

⁶²⁵ Dëshmitarja 38, T. 709, 711.

⁶²⁶ Dëshmitarja 38, T. 714.

⁶²⁷ Dëshmitarja 38, T. 715.

⁶²⁸ Dëshmitarja 38, T. 715.

⁶²⁹ Dëshmitarja 38, T. 715, 718.

⁶³⁰ Dëshmitarja 38, T. 718.

⁶³¹ Dëshmitarja 38, T. 718, 802.

⁶³² Dëshmitarja 38, T. 719.

⁶³³ Dëshmitarja 38, T. 719-720.

⁶³⁴ Dëshmitarja 38, T. 720-722, 725, 802-803.

⁶³⁵ Dëshmitarja 38, T. 725, 758.

me rroba civile që shoqëronin kolonën ishin të armatosur.⁶³⁶ Sipas dëshmitares, pjesëtarë të UÇK-së nuk e lejuan dëshmitaren dhe familjen e saj të largoheshin nga kolona.⁶³⁷ Dëshmitarja dëshmoi se burrat me uniforma kamuflazhi me simbolin e UÇK-së si dhe burrat e veshur civilë dhe të armatosur ishin anëtarë të UÇK-së.⁶³⁸

165. Në një moment të caktuar, Dëshmitarja 38 dhe familja e saj u urdhëruan nga dy anëtarë të UÇK-së të largoheshin nga kolona dhe të shkonin në shtëpinë e Qazim Gaciferit.⁶³⁹ Edhe romë të tjerë u urdhëruan të largoheshin nga kolona.⁶⁴⁰ Dëshmitarja 38 dëshmoi se ajo dhe familja e saj arritën në shtëpinë e Gaciferit dhe prej andej u çuan në një mulli rreth gjysëm kilometër nga shtëpia.⁶⁴¹ Një nga anëtarët e UÇK-së, Asllan Luluni, u tha dëshmitares dhe babait të saj të zhvisheshin, e detyroi dëshmitaren të hante një librezë bankare, dhe i shkuli babait të saj gjysmën e mustaqes.⁶⁴² Pas një kontrolli trupor babai i dëshmitares u lejua të vishej, por dëshmitarja mbeti lakuriq.⁶⁴³ Luluni ua lidhi duart dëshmitares dhe babait të saj me tel me gjëmbe.⁶⁴⁴ Pastaj në mulli mbërriti një makinë Suzuki.⁶⁴⁵ Dëshmitarja i identifikoi të dy burrat në makinë si Muharem Knushi dhe Ramush Haradinaj; ky i fundit kishte një kapele dhe uniformë kamuflazhi me dy stema në formën e një V-je, si dhe një radio marrëse-dhënëse.⁶⁴⁶ Dëshmitarja 38 ishte e ulur në tokë rreth 20-30 metra larg nga të dy burrat dhe, duke vështuar anash, pa personin që më pas ajo e identifikoi si Ramush Haradinaj.⁶⁴⁷ Midis dëshmitares dhe burrave ndodheshin shkurre.⁶⁴⁸ Në atë kohë dëshmitarja nuk e njohu Haradinajn por kur e pa Haradinajn afro tre apo katër muaj më pas në televizor, ajo e kuptoi se kishte qënë pikërisht ai.⁶⁴⁹ Programi televiziv iu referua Ramush Haradinajt si komandant.⁶⁵⁰ Dëshmitarja 38 dëshmoi se me mbërritjen e automjetit, keqtrajtimi i dëshmitares dhe babait të saj u ndërpre.⁶⁵¹ Burrat në makinë dhe Asllan Luluni biseduan midis tyre, dhe dëshmitarja dëgjoi se të dy burrave, që erdhën me makinë, ju drejtoheshin me fjalën “komandant”.⁶⁵² Perveç kësaj, dëshmitarja nuk dëgjoi asgjë tjetër çfarë po bisedonin burrat.⁶⁵³ Automjeti qëndroi në mulli 10 deri në 15 minuta.⁶⁵⁴ Gjatë kësaj kohe, dëshmitarja dhe babai i saj

⁶³⁶ Dëshmitarja 38, T. 725, 834.

⁶³⁷ Dëshmitarja 38, T. 725.

⁶³⁸ Dëshmitarja 38, T. 833-834.

⁶³⁹ Dëshmitarja 38, T. 726-727.

⁶⁴⁰ Dëshmitarja 38, T. 727.

⁶⁴¹ Dëshmitarja 38, T. 729, 819.

⁶⁴² Dëshmitarja 38, T. 731, 792.

⁶⁴³ Dëshmitarja 38, T. 731-732, 739, 792-795.

⁶⁴⁴ Dëshmitarja 38, T. 731-733.

⁶⁴⁵ Dëshmitarja 38, T. 729, 731, 785, 789, 830-831.

⁶⁴⁶ Dëshmitarja 38, T. 733-734.

⁶⁴⁷ Dëshmitarja 38, T. 734, 755-758, 822.

⁶⁴⁸ Dëshmitarja 38, T. 756-757.

⁶⁴⁹ Dëshmitarja 38, T. 734, 736-737, 752, 760.

⁶⁵⁰ Dëshmitarja 38, T. 823.

⁶⁵¹ Dëshmitarja 38, T. 736, 740, 754.

⁶⁵² Dëshmitarja 38, T. 733, 749, 755, 787, 821, 823.

⁶⁵³ Dëshmitarja 38, T. 754-755, 820-821.

⁶⁵⁴ Dëshmitarja 38, T. 756.

nuk u keqtrajtu. ⁶⁵⁵ Dëshmitarja pranoi mundësinë se personi, të cilin ajo më pas e identifikoi si Ramush Haradinaj, nuk e vuri re atë. ⁶⁵⁶ Pas largimit të automjetit keqtrajtimi rifilloi. ⁶⁵⁷ Pas rreth dy orëve, Dëshmitarja 38 dhe familja e saj u ribashkuan me kolonën që kishte marrë drejtimin e kufirit shqiptar. ⁶⁵⁸ Sipas dëshmitares, ajo ishte ende lakuriq dhe se duart e saj, ashtu si edhe ato të babait, ishin ende të lidhura. ⁶⁵⁹ Në një moment të caktuar, një anëtar shoqërues i UÇK-së i veshur civil e veçoi dëshmitaren dhe familjen e saj nga kolona. ⁶⁶⁰ Anëtari i UÇK-së i mbajti në pyll gjatë natës. ⁶⁶¹ Njerëz të paidentifikuar u orvatën të përdhunonin motrën e dëshmitares, por anëtari i UÇK-së nuk i lejoi t'a bënin një gjë të tillë. ⁶⁶² Sipas dëshmitares, në atë kohë ajo ishte ende lakuriq dhe ende me duart të lidhura. Por natën e dytë ajo u lejua të vishej. ⁶⁶³ Mirëpo në deklaratën e saj për MPB-në, dëshmitarja kishte thënë se u lejua të vishej pas gjysëm ore. ⁶⁶⁴ Dëshmitarja dhe familja e saj u urdhëruan nga anëtarët e UÇK-së të shkonin në shtëpinë e Asllan, Gjocit në Jasiq, të cilën ajo e përshkroi si shtab të UÇK-së. ⁶⁶⁵ Atje dëshmitarja dhe familja e saj u urdhëruan të qëndronin në rresht buzë një kodre apo rrëpire dhe një ushtar urdhëroi një djalë që t'i ekzekutonte. ⁶⁶⁶ Në atë moment ndërhyri dikush dhe në përshtjellimin e krijuar dëshmitarja dhe familja e saj arritën të arratiseshin dhe të mbërrinin në Batushë, komuna e Gjakovës, ku iu ofrua ndihmë nga ushtarët e UJ-së. ⁶⁶⁷

166. Dëshmitarja 58, rome nga fshati Ponoshec, komuna e Gjakovës, ⁶⁶⁸ dëshmoi se në fillim të majit 1998, ushtarë të UÇK-së e urdhëruan atë dhe familjen e saj të largoheshin nga shtëpia, kështu që dëshmitarja u vendos në shtëpinë e Dëshmitares 38 në Junik, komuna e Deçanit. ⁶⁶⁹ Një mëngjez, dy apo tri javë pas mbërritjes së Dëshmitares 58 në shtëpinë e Dëshmitares 38, jashtë filluan të shtënat dhe disa plumba goditën shtëpinë. ⁶⁷⁰ Burra të armatosur me uniforma të UÇK-së dhe me stema të kuqe në mëngë hynë në shtëpi dhe u thanë në shqip atyre që ishin brenda se Dëshmitarja 38 kishte vrarë njerëz dhe se ata duhej të largoheshin. ⁶⁷¹ Dëshmitarja 58 mori fëmijët e saj dhe u largua në drejtim të një vendi të quajtur Tofaj ku ata u ndaluan tek një mulli. ⁶⁷² Atje u rrethuan nga ushtarë të armatosur me uniforma të gjelbra të UÇK-së, ndër të cilët Asllan Luluni, të cilin

⁶⁵⁵ Dëshmitarja 38, T. 740, 756.

⁶⁵⁶ Dëshmitarja 38, T. 757.

⁶⁵⁷ Dëshmitarja 38, T. 740, 748, 754, 825.

⁶⁵⁸ Dëshmitarja 38, T. 740-741, 793.

⁶⁵⁹ Dëshmitarja 38, T. 740-741.

⁶⁶⁰ Dëshmitarja 38, T. 741-742.

⁶⁶¹ Dëshmitarja 38, T. 742.

⁶⁶² Dëshmitarja 38, T. 742.

⁶⁶³ Dëshmitarja 38, T. 742-743.

⁶⁶⁴ D1 (Dëshmitarja 38 Deklaratë për MPB), faqe 2.

⁶⁶⁵ Dëshmitarja 38, T. 743.

⁶⁶⁶ Dëshmitarja 38, T. 746-747.

⁶⁶⁷ Dëshmitarja 38, T. 747.

⁶⁶⁸ Dëshmitarja 58, T. 869.

⁶⁶⁹ Dëshmitarja 58, T. 870-871, 939.

⁶⁷⁰ Dëshmitarja 58, T. 871-872.

⁶⁷¹ Dëshmitarja 58, T. 872, 876-877, 931.

⁶⁷² Dëshmitarja 58, T. 881-882, 931-932.

dëshmitarja e njihte që më parë.⁶⁷³ Luluni u tha se duhej t'i kontrollonte për armë dhe se ata meritonin të vriteshin të gjithë pasi Dëshmitarja 38 kishte bashkëpunuar me serbët.⁶⁷⁴ Dëshmitarja 58 dëshmoi se pastaj Luluni filloi të keqtrajtonte kunatën dhe vjehrrin e saj.⁶⁷⁵ Dëshmitares nuk i kujtohej se çfarë i bëri Luluni vjehrrit të saj, por ajo dëshmoi se ai i kontrolloi çantën kunatës së Dëshmitares 58 dhe më pas u përpoq t'a përdhunonte.⁶⁷⁶ Lutjet e Dëshmitares 58 e bënë që të hiqte dorë nga kjo gjë.⁶⁷⁷ Dëshmitarja 58 nuk vuri re nëse Dëshmitarja 38 apo të afërm të tjerë ishin lakuriq apo jo.⁶⁷⁸ Më pas Dëshmitarja 58 dhe familja e saj arritën të largoheshin nga mulliri dhe të drejtoheshin për nga mali Jasiq.⁶⁷⁹ Ditën e nesërme Dëshmitarja 58 dhe familja e saj arritën në Gjocaj.⁶⁸⁰ Si në Malin Jasiq po ashtu dhe në Gjocaj kishte shumë ushtarë të UÇK-së.⁶⁸¹ Disa ushtarë e urdhëruan Dëshmitaren 58 dhe familjen e saj të viheshin në rresht dhe pastaj drejtuan armët kundër tyre.⁶⁸² Ushtarët ishin gati të hapnin zjarr kur dikush ndërhyri dhe e ndaloi këtë.⁶⁸³ Pastaj Dëshmitarja 58 dhe familja e saj u larguan me vrap, ndërkohë që ushtarët hapën zjarr pas tyre.⁶⁸⁴ Ata mbërritën në Batushë, komuna e Gjakovës, ku kontaktuan forcat serbe, të cilat i çuan në qytetin e Gjakovës.⁶⁸⁵

167. Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se në fillim të qershorit 1998, Dëshmitarja 38, civile rome, kontaktoi kolegët e tij dhe i tha një oficeri të tij se ajo dhe familja e saj ishin arrestuar nga UÇK-ja.⁶⁸⁶ Zhivanoviqit nuk i kujtohej nëse ajo përmendi se ishte keqtrajtuar nga arrestuesit. Megjithatë, ai vuri re disa vrama në fytyrën e saj.⁶⁸⁷

168. Mbi bazën e dëshmisë, Dhoma Gjyqësore konkludon se në maj të vitit 1998, ushtarë të UÇK-së e detyruan Dëshmitaren 38 dhe të afërmit e saj të bashkoheshin me një kolonë njerëzish. Në një moment të caktuar ata u veçuan nga kolona dhe u çuan në një mulli në Junik. Ajo dhe babai i saj u detyruan të zhvisheshin. Ajo dëshmoi më tej se e lanë lakuriq për një kohë relativisht të gjatë dhe se ishte ende lakuriq kur u detyrua të ribashkohej me kolonën. Dëshmitarja 38 dëshmoi gjithashtu se ushtari e detyroi të hante një librezë banke, se ai ia shkui babait të saj gjysmën e mustaqes, dhe se u kishte lidhur të dyve duart me tel me gjemb. Dëshmitarja 38 dëshmoi se në vendin ku po e mbanin kishte mbërritur një automjet dhe se rreth 20-30 metra larg nga vendi ku ishte ulur në tokë kishte parë disa burra. Sipas Dëshmitares 38, midis saj dhe burrave kishte shkurre.

⁶⁷³ Dëshmitarja 58, T. 882-883, 898-899.

⁶⁷⁴ Dëshmitarja 58, T. 884, 899.

⁶⁷⁵ Dëshmitarja 58, T. 883, 906.

⁶⁷⁶ Dëshmitarja 58, T. 883-884, 901, 907.

⁶⁷⁷ Dëshmitarja 58, T. 903-904.

⁶⁷⁸ Dëshmitarja 58, T. 933-936.

⁶⁷⁹ Dëshmitarja 58, T. 908, 933.

⁶⁸⁰ Dëshmitarja 58, T. 909.

⁶⁸¹ Dëshmitarja 58, T. 908-909, 912.

⁶⁸² Dëshmitarja 58, T. 912, 917-921.

⁶⁸³ Dëshmitarja 58, T. 909, 911, 916-921, 936-938.

⁶⁸⁴ Dëshmitarja 58, T. 920, 938.

⁶⁸⁵ Dëshmitarja 58, T. 923, 939.

⁶⁸⁶ P1017 (Dragan Zhivanoviq, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafët 50-51.

Dëshmitarja 38 dëgjoi fjalën “komandant”, por nuk ishte e sigurtë se kujt i drejtohej kjo fjalë. Tre apo katër muaj më vonë, dëshmitarja njohu njërin prej burrave si Ramush Haradinaj kur e pa atë në televizor. Programi televiziv iu referua Ramush Haradinajt si komandant.

169. Megjithëse është e bindur se Dëshmitarja 38 dhe Dëshmitarja 58 u morën nga shtëpitë e tyre, Dhoma Gjyqësore mendon se dëshmitë e Dëshmitareve 38 dhe 58 nuk kanë vijimësi logjike dhe nuk japin hollësi të rëndësishme. Në një deklaratë që Dëshmitarja 38 i dha MPB-së serbe në 2002, ajo deklaroi se u lejua të vishej pas gjysmën ore, ndërsa në Tribunal ajo dëshmoi se kishte qëndruar lakuriq për afro dy ditë. Dëshmitarja 58 konfirmoi se Dëshmitarja 38 dhe babai i saj ishin keqtrajtuar nga ushtari i UÇK-së, por nuk dha hollësi se si ishin keqtrajtuar. Për më tepër, megjithëse Dëshmitarja 58 kishte qenë me Dëshmitaren 38 për pjesën më të madhe të kohës, ajo dëshmoi se nuk e kishte vënë re që Dëshmitarja 38 kishte qenë lakuriq. Dëshmitarja 58 gjithashtu nuk konfirmoi dëshminë e Dëshmitares 38 për ardhjen e automjetit me dy burra. Për më tepër Dhoma Gjyqësore, në mungesë të dëshmimeve konfirmuese, gjykon se ka mundësi që identifikimi i vonuar i Ramush Haradinajt prej Dëshmitares 38 të jetë ndikuar nga programi televiziv.

170. Për shkak të mospërputhjeve të konsiderueshme dhe mungesës së konfirmimit të hollësive të rëndësishme, Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, se Dëshmitarja 36 apo familja e saj pësuan vuajtje mendore apo fizike, ose lëndim të rëndë, apo akte që përbëjnë shkelje të rëndë të dinjitetit njerëzor. Po kështu Dhoma Gjyqësore nuk mund të konkludojë se Dëshmitarja 38 ose familja e saj janë poshtëruar ose turpëruar rëndë. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore mendon se dëshmitë e paraqitura janë të pamjaftueshme për të konkluduar se Ramush Haradinaj ishte në vendin ku ndodhi keqtrajtimi i pretenduar i Dëshmitares 38 dhe babait të saj. Fakti që një dëshmitar duket se e ka të vështirë të bëjë një përshkrim të mjaftueshëm të përvojave që ka përjetuar nuk e shtyn Dhomën Gjyqësore automatikisht në përfundimin se dëshmia e këtij dëshmitari është e pabesueshme. Megjithëse pati përshtypjen se si Dëshmitarja 38 ashtu dhe Dëshmitarja 58 patën vështirësi të tilla, Dhoma Gjyqësore i konsideron dëshmitë e tyre të pabesueshme, kryesisht për shkak të mungesës së vijimësisë logjike objektive, mospërputhjeve, dhe mungesës së informacionit konkret për hollësi të rëndësishme. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore gjykon se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë akuzë.

⁶⁸⁷ P1017 (Dragan Zhivanoviq, deklaratë dëshmitari, 9 gusht 2007), paragrafi 58.

6.3 Trajtimi mizor dhe torturimi i Dragosllav Stojanoviçit dhe të tjerëve (Pika 4)

171. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor dhe torturimin e Dragosllav Stojanoviçit dhe të tjerëve si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Ndryshe, Ramush Haradinaj akuzohet se ka kryer krimet, apo se ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmitë përkatëse të Dragosllav Stojanoviçit, Mijat Stojanoviçit, and Veselin Stijoviçit.

172. Dragosllav Stojanoviçi, serb nga fshati i Dubravës në komunën e Deçanit,⁶⁸⁸ dëshmoi se shtëpia e tij ishte rreth 150 metra nga shtëpia e familjes së Ramush Haradinajt dhe se e njihnte Ramush Haradinajn që nga fëmijëria.⁶⁸⁹ Dragoslav Stojanoviç nuk e kishte parë Ramush Haradinajn afërsisht dhjetë vjet para prillit 1998.⁶⁹⁰ Mëngjezin e 18 prillit 1998 dëshmitari, së bashku me vëllain e tij Mijat Stojanoviçin dhe kushëririn e tij, Veselin Stijoviçin, shkuan për të kontrolluar shtëpinë dhe bagëtinë e dëshmitarit.⁶⁹¹ Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi se policia serbe kishte zënë pozicione në oborrin e shtëpisë së Stojanoviçit apo pranë tij, më 24 mars gjatë sulmit kundër vendbanimit të familjes Haradinaj, sulm i cili u krye pas vrasjes së policit Otoviç. Në atë kohë, vëllezërit jetonin si refugjatë në Deçan.⁶⁹² Në një moment ndaj tyre u hap zjarr nga shtëpia e Haradinajve dhe persona të armatosur filluan t'i afroreshin shtëpisë nga të gjitha anët.⁶⁹³ Këta persona u thirrën në shqip njerëzve që ishin në shtëpi që të dilnin nga shtëpia dhe të dorëzoheshin.⁶⁹⁴ Mbi kulm u hodhën granata dhe dritarja u përshkua nga një plumb.⁶⁹⁵ Kur dëshmitari hapi derën, Zeqir Nimonaj, Daut Haradinaj, dhe 20 deri 30 të tjerë, shumica të veshur me uniforma kamuflazhi, hynë brenda dhe filluan të kontrollonin shtëpinë, duke i shkelmuar dhe goditur të tre burrat me qytat e pushkëve.⁶⁹⁶ Keqtrajtimi i shkaktoi dëshmitarit çarje në pankreas në dy vende si dhe disa plagë të tjera.⁶⁹⁷ Pas pak mbërriti Nasim Haradinaj, i cili u kërkoi burrave të ndërprisnin rrahjen e dëshmitarit dhe t'i çonin të tre burrat në shtab.⁶⁹⁸ Rrugës për atje ata u rrahën nga banorë vendas të armatosur, të cilët gjithashtu shtinë mbi kokat e tyre.⁶⁹⁹ Të tre burrat u çuan në shtëpinë e Smajl Haradinajt.⁷⁰⁰ Pasi i futën brenda, Daut Haradinaj, Zeqir Nimonaj, dhe Besnik Haradinaj e çuan dëshmitarin në një dhomë të vogël në katin e sipërm për t'a marrë në pyetje kurse

⁶⁸⁸ Dragosllav Stojanoviç, T. 1844-1845, 1940.

⁶⁸⁹ Dragosllav Stojanoviç, T. 1846-1847, 1853, 1915.

⁶⁹⁰ Dragosllav Stojanoviç, T. 1915.

⁶⁹¹ Dragosllav Stojanoviç, T. 1846, 1863-1864.

⁶⁹² Dragosllav Stojanoviç, T. 1858-1861, 1865.

⁶⁹³ Dragosllav Stojanoviç, T. 1864.

⁶⁹⁴ Dragosllav Stojanoviç, T. 1865, 1868.

⁶⁹⁵ Dragosllav Stojanoviç, T. 1865.

⁶⁹⁶ Dragosllav Stojanoviç, T. 1865-1867.

⁶⁹⁷ Dragosllav Stojanoviç, T. 1873.

⁶⁹⁸ Dragosllav Stojanoviç, T. 1866, 1904.

⁶⁹⁹ Dragosllav Stojanoviç, T. 1866, 1869.

⁷⁰⁰ Dragosllav Stojanoviç, T. 1868.

Mijat Stojanoviçin dhe Veselin Stijoviçin i lanë në korridorin jashtë dhomës.⁷⁰¹ Këta njerëz ishin të armatosur dhe të veshur me rroba të zeza. Në kokë kishin kapele me simbolin e shqipës dykrenare dhe fjalët “Ushtria Çlirimtare e Kosovës” të shkruara me gërma të verdha.⁷⁰² Besnik Haradinaj e pyeti dëshmitarin për policinë, përse ndodhej në Dubravë pa leje prej tyre, dhe përse nuk ishte bashkuar me “ata”.⁷⁰³ Në një moment, pasi rrufiti një herë kafënë, dëshmitarit filloi t’i merrej fryma. Atë e flakën në korridor ku i ra të fikët.⁷⁰⁴ Dëshmitari erdhi në vete pas ndihmës për frymëmarrje që i dhanë Mijat Stojanoviçi dhe Veselin Stijoviçi. Megjithatë, edhe pas kësaj, ai e humbi vetëdijen disa herë.⁷⁰⁵ Pas kësaj në dhomë futën në fillim Veselin Stijoviçin, dhe më pas Mijat Stojanoviçin, dhe dëshmitari i dëgjoji ata te ulërinin teksa po i keqtrajtonin.⁷⁰⁶

173. Ndërkohë që Dragosllav Stojanoviçi dergjej në korridor, një person që dëshmitari e identifikoi si Ramush Haradinaj kaloi pranë së bashku me pesë apo gjashtë ushtarë.⁷⁰⁷ Dëshmitari mendoi se ky person ishte komandant, pasi rojet që ruanin dëshmitarin e përshendetën me grushtin e ngritur lart.⁷⁰⁸ Ai kishte veshur pantallona kamuflazhi dhe një pulovër. Në dorën e djathtë mbante një automatik.⁷⁰⁹ E shtyu dëshmitarin me këmbë dhe i tha, “tung kojshi, a më njeh?”⁷¹⁰ Dëshmitari pretendoi se nuk e njohu dhe personi të cilin dëshmitari e identifikoi si Ramush Haradinaj, e shkëlmoi fort në shpinë dhe i tha se do t’a njihte shumë shpejt.⁷¹¹ Ndërkohë, nga rrahjet dëshmitari kishte pësuar dëmtime të rënda në organet e brendshme, kishte shumë dhimbje, dhe në fytyrë kishte njolla gjaku.⁷¹² Personi që dëshmitari e identifikoi si Ramush Haradinaj qëndroi në korridor për të paktën pesë deri në gjashtë minuta.⁷¹³ Dragosllav Stojanoviçi deklaroi se në korridor ai u shkëlmua të paktën edhe nga tre persona të tjerë, të cilët gjithashtu e pyetën nëse i njihte.⁷¹⁴ Dragosllav Stojanoviçi nuk ishte në gjendje të identifikonte individët që shoqëronin Ramush Haradinajn dhe, sipas tij, kjo ndodhi për shkak se ai ishte alivanosur disa here dhe ndjente dhimbje edhe sikur të kthente kokën për të parë përreth.⁷¹⁵ Fill pas largimit të këtij personi, erdhi një tjetër, të cilit i drejtoheshin me nofkën “Rusi”. Ai e shkëlmoi dhe goditi dëshmitarin fort me një tub metalik rreth një metër të gjatë, dhe, ndërkohë i thoshte dëshmitarit se çka po i bënte nuk ishte asgjë në krahasim me atë që policia po u bënte njerëzve të tij.⁷¹⁶ Dëshmitarit herë i binte të fikët dhe herë vinte në

⁷⁰¹ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1871-1872, 1884, 1918.

⁷⁰² Dragosllav Stojanoviçi, T. 1873-1875; P9 (stema e UÇK-së).

⁷⁰³ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1872-1873, 1881-1882.

⁷⁰⁴ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1872, 1882-1883.

⁷⁰⁵ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1885-1886, 1916, 1918.

⁷⁰⁶ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1890, 1918-1919, 1928.

⁷⁰⁷ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1886.

⁷⁰⁸ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1886-1887, 1920-1921, 1935.

⁷⁰⁹ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1886.

⁷¹⁰ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1886, 1920.

⁷¹¹ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1886, 1888, 1920, 1932.

⁷¹² Dragosllav Stojanoviçi, T. 1889-1890.

⁷¹³ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1922.

⁷¹⁴ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1921.

⁷¹⁵ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1885-1886, 1931-1933.

⁷¹⁶ Dragosllav Stojanoviçi, T. 1891-1892.

vete, dhe në një moment filloi të villoje gjak.⁷¹⁷ Më në fund dëshmitari dhe Veselin Stijoviqi u nxorën në oborr ku e hoqën gjakun nga fytyra në një pompë uji.⁷¹⁸ Kur i kthyen në shtëpi, Hilmi Haradinaj i ofroi dëshmitarit diçka për të pirë.⁷¹⁹ Pas rreth 20 minutash Nasim Haradinaj dhe një ushtar tjetër i çuan dëshmitarin, Mijat Stojanoviqin dhe Veselin Stijoviqin në shtëpinë e dëshmitarit dhe u kërkuan të hiqnin kashtën rreth pemës së fikut për të parë nëse atje ishin fshehur armë.⁷²⁰ Pas kësaj, ata u lidhën sytë të tre burrave dhe i çuan me makinë në Baballoq, komuna e Deçanit, ku ndaluan pranë një kampi refugjatësh.⁷²¹ Këtu Nasim Haradinaj u tha të tre burrave të ecnin përpara pa shikuar prapa, përndryshe do të qëlloheshin.⁷²² Mijat Stojanoviqi shkoi për të marrë ndihmë për dëshmitarin dhe një nga refugjatët erdhi me makinë dhe e çoi në një qendër shëndetësore në Deçan.⁷²³ Prej aty dëshmitari u çua në spitalin e Pejës dhe më pas u dërgua me ambulancë në spitalin e Prishtinës, ku qëndroi 28 ditë dhe ku iu nënshtua ndërhyrjes kirurgjikale për plagët e tij.⁷²⁴

174. Mijat Stojanoviqi nga fshati Dubravë në komunën e Deçanit,⁷²⁵ dëshmoi se kishte qënë në të njëjtën shkollë me Ramush Haradinajn nga mosha 12 deri në 15 vjeç, megjithëse Ramush Haradinaj ishte rreth katër vjet e gjysëm më i ri se ai.⁷²⁶ Më tej dëshmitari dëshmoi se u largua nga Dubrava në 1982 për të jetuar në Beograd dhe se më pas ai ishte kthyer në Dubravë në 1995 për të jetuar atje përgjithmonë.⁷²⁷ Gjatë periudhës 1982 - 1995, kur kthehej në shtëpi për pushimet vjetore, dëshmitarit nuk i kujtohej kur e kishte parë Ramush Haradinajn për herë të fundit përpara 18 prillit 1998.⁷²⁸ Mijat Stojanoviqi gjithashtu dëshmoi se më 18 prill 1998 rreth orës 8.30 të mëngjezit, ai shkoi në shtëpinë e tij në Dubravë së bashku me vëllain e tij Dragosllav Stojanoviqin dhe kushëririn e tij Veselin Stijoviqin.⁷²⁹ Pas pak ai dëgjoji një të shtënë nga drejtimi i Dubravës dhe më pas disa të shtëna të tjera nga drejtimi i Glllogjanit. Pas kësaj të tre burrat hynë në shtëpi për t'u mbrojtur nga plumbat.⁷³⁰ Të shtënat vazhduan për rreth 40 minuta.⁷³¹ Plumbat ranë mbi parvazet e dritareve të shtëpisë dhe makina që ishte parkuar përpara shtëpisë u dëmtua në të gjitha anët.⁷³² Të tre burrat ishin të paarmatosur.⁷³³ Personat që iu afruan shtëpisë ishin të veshur me uniforma kamuflazhi dhe

⁷¹⁷ Dragosllav Stojanoviq, T. 1891-1892.

⁷¹⁸ Dragosllav Stojanoviq, T. 1893-1894, 1935.

⁷¹⁹ Dragosllav Stojanoviq, T. 1894, 1935.

⁷²⁰ Dragosllav Stojanoviq, T. 1894-1895.

⁷²¹ Dragosllav Stojanoviq, T. 1895-1896.

⁷²² Dragosllav Stojanoviq, T. 1896.

⁷²³ Dragosllav Stojanoviq, T. 1896.

⁷²⁴ Dragosllav Stojanoviq, T. 1898-1900, 1903; P33 (Fletë-dalje lëshuar nga spitali i Prishtinës, 6 tetor 2005); P34 (Pjesë filmike të lajmit për rrahjen e Dragosllav Stojanoviqit, Mijat Stojanoviqit, dhe Veselin Stijoviqit).

⁷²⁵ Mijat Stojanoviq, T. 1985.

⁷²⁶ Mijat Stojanoviq, T. 2046.

⁷²⁷ Mijat Stojanoviq, T. 2047.

⁷²⁸ Mijat Stojanoviq, T. 2050.

⁷²⁹ Mijat Stojanoviq, T. 2019-2020.

⁷³⁰ Mijat Stojanoviq, T. 2021, 2051.

⁷³¹ Mijat Stojanoviq, T. 2021.

⁷³² Mijat Stojanoviq, T. 2021.

⁷³³ Mijat Stojanoviq, T. 2022.

veshje civile të pajisura me simbolin e UÇK-së. Ata ishin të armatosur me armë të lehta.⁷³⁴ Personi i parë që hyri në shtëpi ishte vëllai i Ramush Haradinajt, Daut Haradinaj, i pasuar nga Xhavit Nimonaj.⁷³⁵ Personat e armatosur i urdhëruan të tre burrat të shtriheshin barkas me fytyrë poshtë dhe pastaj filluan t'i rrihnin, shkelmonin, dhe godisnin me qytat e pushkëve.⁷³⁶ Gjithashtu ata i shanë të tre burrat, duke përmendur kombësinë e tyre serbe, si dhe duke ua sharë nënat e tyre serbe.⁷³⁷ Afërsisht pas njëzet minutash erdhi Nasim Haradinaj dhe u tha këtyre personave të ndërprisnin rrahjen.⁷³⁸

175. Sipas Mijat Stojanoviçit, atë e morën nga shtëpia dhe e çuan, së bashku me Dragosllav Stojanoviçin dhe Veselin Stijoviçin, në vendin e përmendur “shtabi në Gllogjan”, që ishte shtëpia e Smajl Haradinajt.⁷³⁹ Ndërkohë që po ecnin drejt shtëpisë, burrat vazhdonin t'i shanin personat e kapur, t'i godisnin, dhe të shtinin sipër kokave të tyre.⁷⁴⁰ Mijat Stojanoviçi deklaroi se atyre ju tha të mos shikonin as djathtas dhe as majtas, por t'i mbanin kokat poshtë.⁷⁴¹ Dëshmitari dëshmoi se gjatë rrugës pa Ramush Haradinajn në uniformë kamuflazhi të gjelbër dhe me një beretë të zezë në kokë duke qëndruar jashtë shtëpisë së tij së bashku me dy apo tre persona të tjerë.⁷⁴² Në atë cast dëshmitari ndodhej afërsisht 70 metra nga personi, për të cilin ai besonte se ishte Ramush Haradinaj.⁷⁴³ Në shtëpinë e Smajl Haradinajt, Dragosllav Stojanoviçin e çuan në një dhomë të vogël në katin e sipërm, ndërsa dy të tjerët pritën në koridor.⁷⁴⁴ Dëshmitari dëgjoi ulurimat e Dragosllav Stojanoviçit ndërkohë që po e rrihnin.⁷⁴⁵ Pak më vonë, Dragosllav Stojanoviçin e flakën përsëri në korridor.⁷⁴⁶ Ai mbante duart në stomak, fytyrën e kishte me gjak, qëndronte shtrirë i mbledhur kruspull mbi dyshe-menë prej betoni, dhe nuk ishte në gjendje të fliste.⁷⁴⁷ Në atë cast, në dhomë çuan Veselin Stijoviçin dhe dëshmitari dëgjoi rënkimet dhe ulërimat dhe ulërinte.⁷⁴⁸ Pastaj burrat futën në dhomë dëshmitarin, i cili pa Veselin Stijoviçin që qëndronte në këmbë, lakuriq që nga mesi e sipër, me fytyrë të drejtuar nga një cep i dhomës.⁷⁴⁹ Në dhomë ishin gjithashtu Zeqir Nimonaj, Nasim Haradinaj, dhe Besnik Haradinaj, kushëriri i Ramush Haradinajt, së bashku me dy burra të tjerë të cilët dëshmitari nuk i njihte.⁷⁵⁰ Zeqir Nimonaj, i cili ishte veshur me uniformë kamuflazhi, e

⁷³⁴ Mijat Stojanoviç, T. 2022-2023; Prova materiale P9 (Simboli i UÇK-së).

⁷³⁵ Mijat Stojanoviç, T. 2023.

⁷³⁶ Mijat Stojanoviç, T. 2023-2025.

⁷³⁷ Mijat Stojanoviç, T. 2024.

⁷³⁸ Mijat Stojanoviç, T. 2024-2025, 2076, 2088.

⁷³⁹ Mijat Stojanoviç, T. 2025.

⁷⁴⁰ Mijat Stojanoviç, T. 2025, 2091.

⁷⁴¹ Mijat Stojanoviç, T. 2026, 2062-2063.

⁷⁴² Mijat Stojanoviç, T. 2026, 2052-2058, 2062-2067, 2070-2071; D27 (Fotografi e shtëpisë së Haradinajve, me shënimet); D28 (Fotografi e shtëpisë së Haradinajve, me shënimet).

⁷⁴³ Mocion i Përbashkët për Faktet e Pranuara Shtesë, 30 nëntor 2007, paragrafi 2.

⁷⁴⁴ Mijat Stojanoviç, T. 2028.

⁷⁴⁵ Mijat Stojanoviç, T. 2029.

⁷⁴⁶ Mijat Stojanoviç, T. 2029-2030.

⁷⁴⁷ Mijat Stojanoviç, T. 2030, 2094.

⁷⁴⁸ Mijat Stojanoviç, T. 2029.

⁷⁴⁹ Mijat Stojanoviç, T. 2030.

⁷⁵⁰ Mijat Stojanoviç, T. 2030-2031, 2087-2088.

urdhëroi dëshmitarin të zhishej deri në mes dhe dëshmitari iu bind.⁷⁵¹ Të gjithë këta persona në dhomë kishin simbole të UÇK-së.⁷⁵² Dëshmitari dhe Veselin Stijoviqi u pyetën dhe u rrahën nga të gjithë njerëzit që ishin të pranishëm.⁷⁵³ Ata e akuzuan dëshmitarin se ishte spiun.⁷⁵⁴ Rrahja vazhdoi për një kohë të gjatë dhe pastaj të dy burrat i hodhën në korridor.⁷⁵⁵ Dëshmitari nuk kishte njolla gjaku në trup, ndërsa Veselin Stijoviqi kishte shumë dhimbje dhe gjak rreth dy veshëve.⁷⁵⁶ Ndërkohë Dragosllav Stojanoviqi vazhdonte të dergjej në një pellg gjaku.⁷⁵⁷ Kishte një plagë në kokë, një plagë në hundë, dhe kishte vjellur gjak.⁷⁵⁸ Gjendja e tij ishte keqësuar që kur dëshmitarin e kishin çuar në dhomë.⁷⁵⁹ Ai humbte herë pas here vetëdijen.⁷⁶⁰ Aty ishte edhe një person që e thërrisnin "Rusi" i cili e goditi Dragosllav Stojanoviqin megjithëse ky i fundit ishte i alivanosur.⁷⁶¹ Në një moment, Nasim Haradinaj iu afrua të tre burrave në koridor dhe u tha se do të liroheshin.⁷⁶² Ai e pyeti gjithashtu dëshmitarin se përse nuk ishte "bashkuar me ta".⁷⁶³ Dëshmitari mendoi se Nasim Haradinaj ishte një nga personat komandues sepses ushtarët e tjerë e nderonin.⁷⁶⁴ Nasim Haradinaj dhe një person i tretë e nxorrën dëshmitarin nga shtëpia për të marrë makinën e tij.⁷⁶⁵ Dëshmitari dëshmoi se rrugës kishte parë Hilmi dhe Ramush Haradinajn në oborrin e shtëpisë së Smajl Haradinajt, së bashku me ushtarë të tjerë që qëndronin në grupe prej dy apo tre vetash.⁷⁶⁶ Mijat Stojanoviqi dëshmoi se ai qëndroi në oborr vetëm për një kohë të shkurtër.⁷⁶⁷ Kur dëshmitari konstatoi se makina e tij ishte prishur kaq shumë sa nuk mund të rregullohej, Nasim Haradinaj dhe personi i tretë e kthyen dëshmitarin përsëri në shtëpinë e Smajl Haradinajt.⁷⁶⁸ Pasi mori leje nga Nasim Haradinaj, dëshmitari u ngjit sipër për të marrë Dragosllav Stojanoviqin, dhe pas kësaj të dy ata, së bashku me Veselin Stijoviqin, u nisën në këmbë për t'u kthyer në Dubravë.⁷⁶⁹ Për të bartur Dragosllav Stojanoviqin u përdor një traktor.⁷⁷⁰ Kur mbërritën në shtëpinë e dëshmitarit, Nasim Haradinaj dhe një person tjetër kontrolluan në kopsht dhe në shtëpi për armë, por nuk gjetën asgjë.⁷⁷¹ Pastaj Nasim Haradinaj preu perdet dhe i përdori për t'u lidhur sytë të tre burrave.⁷⁷² Pas

⁷⁵¹ Mijat Stojanoviq, T. 2030-2031.

⁷⁵² Mijat Stojanoviq, T. 2031.

⁷⁵³ Mijat Stojanoviq, T. 2031-2032, 2088.

⁷⁵⁴ Mijat Stojanoviq, T. 2039-2040, 2091.

⁷⁵⁵ Mijat Stojanoviq, T. 2032.

⁷⁵⁶ Mijat Stojanoviq, T. 2032.

⁷⁵⁷ Mijat Stojanoviq, T. 2032.

⁷⁵⁸ Mijat Stojanoviq, T. 2032-2033, 2096.

⁷⁵⁹ Mijat Stojanoviq, T. 2095-2096.

⁷⁶⁰ Mijat Stojanoviq, T. 2033-2034, 2092-2096.

⁷⁶¹ Mijat Stojanoviq, T. 2033.

⁷⁶² Mijat Stojanoviq, T. 2034, 2096.

⁷⁶³ Mijat Stojanoviq, T. 2034.

⁷⁶⁴ Mijat Stojanoviq, T. 2071-2072.

⁷⁶⁵ Mijat Stojanoviq, T. 2034-2035.

⁷⁶⁶ Mijat Stojanoviq, T. 2034-2036, 2067-2069, 2098.

⁷⁶⁷ Mijat Stojanoviq, T. 2069.

⁷⁶⁸ Mijat Stojanoviq, T. 2036-2037.

⁷⁶⁹ Mijat Stojanoviq, T. 2037.

⁷⁷⁰ Mijat Stojanoviq, T. 2037-2038.

⁷⁷¹ Mijat Stojanoviq, T. 2038, 2041.

⁷⁷² Mijat Stojanoviq, T. 2041.

kësaj, erdhi një veturë dhe të tre burrat u transportuan në Baballoq.⁷⁷³ Atje Nasim Haradinaj u zgjidhi sytë dhe i urdhëroi të largoheshin pa shikuar prapa, përndryshe do të qëlloheshin.⁷⁷⁴ Në Baballoq të tre burrat u morën nga serbët dhe u çuan në një qendër shëndetësore në Deçan dhe prej andej ata u transferuan menjëherë për në Pejë.⁷⁷⁵ Mijat Stojanoviçi u mjekua në një spital në Pejë.⁷⁷⁶ Ai nuk pranoi të shtrohej në spital, mirëpo iu desh të shkonte atje çdo ditë së bashku me Veselin Stijoviçin për t'u mjekuar.⁷⁷⁷ Mijat Stojanoviçi i dha një intervistë një reviste serbe më 25 prill 1998, në të cilën ai deklaroi se Nasim Haradinaj ishte ndoshta “bosi” i personave që e kishin rrahur.⁷⁷⁸ Ndonëse ai përmendi emrat e disa personave që kishin qenë të pranishëm dhe që kishin marrë pjesë në rrahjen e tij, ai nuk e përmendi Ramush Haradinajn.⁷⁷⁹ Mijat Stojanoviçi i dha informacion për incidentin edhe Qendrës të së Drejtës Humanitare më 25 prill, por nuk përmendi që Ramush Haradinaj kishte qenë i pranishëm.⁷⁸⁰

176. Veselin Stijoviçi, serb nga fshati Dashinoc, komuna e Deçanit,⁷⁸¹ dëshmoi se një ditë përpara Pashkëve Ortodokse në prill 1998, ai shoqëroi kushërinjtë e tij Dragosllav dhe Mijat Stojanoviç për në shtëpinë e tyre në Dubravë, komuna e Deçanit.⁷⁸² Kushërinjtë ishin larguar nga shtëpia një ditë më parë për arsye sigurie.⁷⁸³ Ndërkohë që të tre burrat ishin në shtëpi, ndaj tyre u hap zjarr me armë automatike dhe granathedhës nga drejtimi i Gllogjanit dhe “nga të gjitha drejtimet”.⁷⁸⁴ Të shtënat vazhduan për rreth 45 minuta.⁷⁸⁵ Burrat nuk iu përgjigjën zjarrit pasi nuk kishin armë.⁷⁸⁶ Pasi të shtënat pushuan, të tre burrat dëgjuan se dikush po u thërriste në shqip duke iu kërkuar të dilnin jashtë.⁷⁸⁷ Përpara shtëpisë ishin 20 apo 30 njerëz të armatosur, shumica e tyre me uniforma kamuflazhi me simbolin e UÇK-së, dhe disa të tjerë të veshur me rroba civile.⁷⁸⁸ Dëshmitari e përshkroi simbolin e UÇK-së si një shqiponjë dykrenare në një sfond të zi me fjalët “Ushtria Çlirimtare e Kosovës”.⁷⁸⁹ Kur Dragosllav Stojanoviçi hapi derën burrat hynë vrik në shtëpi.⁷⁹⁰ Dragosllav Stojanoviçin e rrahën dhe të tre burrat u urdhëruan të shtriheshin barkas.⁷⁹¹ Në shtëpi hynë edhe persona të tjerë dhe të tre burrat, që ishin të shtrirë barkas, u rrahën, u shkëlmuar,

⁷⁷³ Mijat Stojanoviç, T. 2041.

⁷⁷⁴ Mijat Stojanoviç, T. 2041, 2043.

⁷⁷⁵ Mijat Stojanoviç, T. 2042-2043.

⁷⁷⁶ Mijat Stojanoviç, T. 2043.

⁷⁷⁷ Mijat Stojanoviç, T. 2043.

⁷⁷⁸ D25 (Artikull i *Ilustrovana Politika*, 25 prill 1998).

⁷⁷⁹ D25 (Artikull i *Ilustrovana Politika*, 25 prill 1998); Mijat Stojanoviç, T. 2070.

⁷⁸⁰ D29 (Raport për incident, Qendra e së Drejtës Humanitare, 25 prill 1998); Mijat Stojanoviç, T. 2085-2086; Marijana Angjelkoviç, T. 657-661.

⁷⁸¹ Veselin Stijoviç, T. 2119.

⁷⁸² Veselin Stijoviç, T. 2124-2126, 2177.

⁷⁸³ Veselin Stijoviç, T. 2125, 2172.

⁷⁸⁴ Veselin Stijoviç, T. 2125-2127.

⁷⁸⁵ Veselin Stijoviç, T. 2125-2127.

⁷⁸⁶ Veselin Stijoviç, T. 2127.

⁷⁸⁷ Veselin Stijoviç, T. 2126-2128.

⁷⁸⁸ Veselin Stijoviç, T. 2128.

⁷⁸⁹ Veselin Stijoviç, T. 2128.

⁷⁹⁰ Veselin Stijoviç, T. 2126-2127.

⁷⁹¹ Veselin Stijoviç, T. 2126-2129.

dhe u goditën me qytat e pushkëve.⁷⁹² Dëshmitari dëshmoi se një person i quajtur Nasim (dëshmitari beson se mbiemrin e kishte Haradinaj, por nuk është i sigurtë për këtë) u përpoq t'i mbronte të tre burrat.⁷⁹³ Pas një farë kohe, personat që kishin hyrë në shtëpi morën dëshmitarin, si dhe Dragosllav dhe Mijat Stojanoviçin për në Gllogjan.⁷⁹⁴ Dëshmitari dëshmoi se gjatë rrugës kishte shumë ushtarë dhe civilë, të gjithë të armatosur, të cilët i rrahën të tre burrat.⁷⁹⁵ Disa nga ushtarët kishin veshje me simbolin e UÇK-së.⁷⁹⁶ Ushtarët i shanin të tre burrat, duke iu thënë se Kosova ishte e shqiptarëve, dhe ndërkohë vazhdonin t'i rrihnin.⁷⁹⁷ Të tre burrat kishin dhimbje, u rridhte gjak, dhe Dragosllav Stojanoviç mezi mund të ecte.⁷⁹⁸ Sapo arritën në Gllogjan, të tre burrat i futën në një shtëpi, në të cilën, sipas mendimit të dëshmitarit, ishte vendosur shtabi, sepse atje kishte shumë ushtarë.⁷⁹⁹ Dëshmitarin dhe Mijat Stojanoviçin e lanë në korridor, ndërsa Dragosllav Stojanoviçin e futën në një dhomë të vogël.⁸⁰⁰ Kur e nxorën nga dhoma gjysëm ore më vonë ai ishte në gjendje shumë të keq, villte gjak, dhe here pas here i binte të fiket.⁸⁰¹ Pastaj në dhomë futën Mijat Stojanoviçin dhe dëshmitari dëgjoi kur po e rrihnin.⁸⁰² Pas rreth një ore, atë e nxorën jashtë dhe në dhomë futën dëshmitarin. Në dhomë ishin dy apo tre ushtarë.⁸⁰³ Dëshmitarin e pyetën, ndër të tjera, nëse kishte ndonjë armë, megjithëse ai besonte se pyetjet ishin vetëm një pretekst i ushtarëve për t'a rrahur.⁸⁰⁴ Dëshmitari nuk njihte asnjëri, por Dragosllav dhe Mijat Stojanoviç i thanë më vonë se cilët ishin disa prej tyre.⁸⁰⁵ Midis ushtarëve ishin dy persona të cilët Dragosllav dhe Mijat Stojanoviç i njihnin, Daut Haradinaj dhe një person i quajtur "Zeqir".⁸⁰⁶ Dëshmitarin e rrahën rëndë për rreth një orë me një shkop, me grushte, dhe me qytat e pushkëve.⁸⁰⁷ Pas kësaj, sollën përsëri Mijat Stojanoviçin dhe të dy u rrahën përsëri dhe më pas u nxorën nga dhoma.⁸⁰⁸ Dëshmitari pa se disa ushtarë e rrahën Dragosllav Stojanoviçin edhe kur ai dergjej i shtrirë në korridor.⁸⁰⁹ Në korridor dëshmitari takoi një person që e njihte, Deli Lekaj, i cili ishte i armatosur dhe i veshur me rroba civile.⁸¹⁰ Lekaj i tha se nëse do të dilte gjallë nga shtëpia, ai nuk duhej të kthehej në Dashinoc pasi ata do të vendosnin shumë shpejt një postbllok në Pozhar, në rrugën që të çonte në Dashinoc, dhe dëshmitari rrezikonte të burgosej përsëri.⁸¹¹ Pas kësaj Dragosllav

⁷⁹² Veselin Stijoviç, T. 2126-2129.

⁷⁹³ Veselin Stijoviç, T. 2132, 2162-2164.

⁷⁹⁴ Veselin Stijoviç, T. 2129, 2132.

⁷⁹⁵ Veselin Stijoviç, T. 2129-2130, 2132-2134, 2174-2175.

⁷⁹⁶ Veselin Stijoviç, T. 2133-2134.

⁷⁹⁷ Veselin Stijoviç, T. 2130-2131, 2133, 2182.

⁷⁹⁸ Veselin Stijoviç, T. 2134, 2167.

⁷⁹⁹ Veselin Stijoviç, T. 2132, 2135.

⁸⁰⁰ Veselin Stijoviç, T. 2133-2134.

⁸⁰¹ Veselin Stijoviç, T. 2135-2136, 2139.

⁸⁰² Veselin Stijoviç, T. 2135, 2137.

⁸⁰³ Veselin Stijoviç, T. 2135.

⁸⁰⁴ Veselin Stijoviç, T. 2137.

⁸⁰⁵ Veselin Stijoviç, T. 2132.

⁸⁰⁶ Veselin Stijoviç, T. 2132, 2137-2138, 2165-2166.

⁸⁰⁷ Veselin Stijoviç, T. 2137-2139.

⁸⁰⁸ Veselin Stijoviç, T. 2137, 2139.

⁸⁰⁹ Veselin Stijoviç, T. 2139.

⁸¹⁰ Veselin Stijoviç, T. 2138, 2140.

⁸¹¹ Veselin Stijoviç, T. 2138, 2140, 2180.

Stojanoviqin dhe dëshmitarin i nxorën në oborrin e shtëpisë dhe i detyruan të pastroheshin nga gjaku tek një pompë uji.⁸¹² Pavarësisht gjendjes së tij Dragosllav Stojanoviqi u detyrua të nxirrte ujë prej pompës për dëshmitarin, dhe pastaj këtë gjë e bëri dëshmitari.⁸¹³ Më tej të tre burrat u urdhëruan të ktheheshin në Dubravë në këmbë, të shoqëruar nga ushtarët.⁸¹⁴ Dragosllav Stojanoviqi ishte në një gjendje kaq të keqe sa Mijat Stojanoviqi dhe dëshmitari e vendosën në një traktor që po shkonte në të njëjtin drejtim.⁸¹⁵ Sapo arritën në shtëpinë e Dragosllav dhe Mijat Stojanoviqit në Dubravë, ushtarët shoqërues u lidhën sytë dhe duart të të tre burrave, i futën në një makinë dhe i çuan në një vend afër fshatit Baballoq, komuna e Deçanit.⁸¹⁶ Një nga personat në makinë ishte Nasimi.⁸¹⁷ Të tre burrat u zgjidhën dhe u urdhëruan të ecnin drejt pa parë mbrapa.⁸¹⁸ Përfundimit të tre burrat ia dolën të shkonin në spitalin e Deçanit.⁸¹⁹ Atje iu dha ndihma e parë dhe iu tha të shkonin në spitalin e Pejës, ku Dragosllav Stojanoviqit iu bë një radiografi dhe u çua me ambulancë në Prishtinë.⁸²⁰ Mijat Stojanoviqit dhe Veselin Stijoviqit u thanë të qëndronin në spitalin e Pejës për mjekim, por ata e refuzuan një gjë të tillë.⁸²¹ Veselin Stijoviqi kishte pësuar plagë në vesh dhe kokë, lëndime në shpinë dhe në ije, dhe vazhdoi të kishte dhimbje edhe 20 ditë më pas.⁸²²

177. Bazuar në këto dëshmi, Dhoma Gjyqësore është e bindur se më 18 prill 1998, ushtarë të UÇK-së hynë në shtëpinë e familjes Stojanoviq në Dubravë. Atje, ata shkellmuan, rrahën, dhe goditën me qytat e pushkëve Dragosllav Stojanoviqin, Mijat Stojanoviqin, dhe Veselin Stijoviqin. Pastaj ushtarët e UÇK-së i çuan të tre burrat, të ciët ishin në gjendje jo të mirë, në shtëpinë e Smajl Haradinajt në Glllogjan. Një ushtar i UÇK-së e pyeti Dragosllav Stojanoviqin për policinë, përse ishte në Dubravë pa leje, dhe përse nuk ishte bashkuar me “ta”. Pastaj Dragosllav Stojanoviqin e hodhën në korridor, ku vazhduan t'a rrihnin ndërkohë që ai dergjej në dysHEME me dhimbje, villte gjak, dhe here pas here humbte vetëdijen. Mijat Stojanoviqi dhe Veselin Stijoviqi u morën në pyetje njëri pas tjetrit. Mijat Stojanoviqi u akuzua se ishte spiun. Veselin Stijoviqin e pyetën nëse kishte armë. Veselin Stijoviqin e rrahën me shkop, grushte, dhe qytat e pushkëve. Ai kishte dhimbje dhe gjak rreth veshëve. Pas rrahjes ushtarët e UÇK-së i kthyen Dragosllav Stojanoviqin, Mijat Stojanoviqin, dhe Veselin Stijoviqin në shtëpinë e familjes Stojanoviq për të kontrolluar për armë. Dragosllav Stojanoviqi ishte në gjendje kaq të keqe sa u desh t'a transportonin me traktor, ndërsa Veselin Stijoviqi kishte plagë në kokë dhe lëndime në shpinë. Për shkak të keqtrajtimit, Dragosllav Stojanoviqi iu nënshtrua ndërhyrjes kirurgjikale dhe qëndroi në spital për 28 ditë. Mijat Stojanoviqi

⁸¹² Veselin Stijoviq, T. 2141-2142.

⁸¹³ Veselin Stijoviq, T. 2141-2142.

⁸¹⁴ Veselin Stijoviq, T. 2141, 2143.

⁸¹⁵ Veselin Stijoviq, T. 2141, 2143-2144.

⁸¹⁶ Veselin Stijoviq, T. 2143, 2145-2146.

⁸¹⁷ Veselin Stijoviq, T. 2145.

⁸¹⁸ Veselin Stijoviq, T. 2143, 2146.

⁸¹⁹ Veselin Stijoviq, T. 2144, 2146-2148.

⁸²⁰ Veselin Stijoviq, T. 2148.

⁸²¹ Veselin Stijoviq, T. 2148.

dhe Veselin Stijoviqi u mjekuan në spital për disa ditë. Mbi bazën e këtyre dëshmime, Dhoma Gjyqësore është e bindur se keqtrajtimi u shkaktoi të tre burrave dhimbje dhe vuajtje të mëdha dhe ky keqtrajtim u bë me qëllim nxjerrjen e informacionit dhe ndëshkimit të tre burrave.

178. Dragosllav Stojanoviqi dëshmoi se kur dergjej i shtrirë në korridor aty erdhi Ramush Haradinaj, i cili e pyeti nëse e njohte dhe më pas e shkëlmoi Dragosllav Stojanoviqin në shpinë. Dhoma Gjyqësore është e bindur se Dragosllav Stojanoviqi besonte se ky person ishte Ramush Haradinaj. Megjithatë, duke marrë parasysh rrethanat e këtij identifikimi si dhe mungesën e dëshmime konfirmuese, Dhoma Gjyqësore duhet të jetë shumë e kujdesshme në vlerësimin e saj nëse personi që Dragosllav Stojanoviqi besoi se e njohu, ishte me të vërtetë Ramush Haradinaj. Lidhur me këtë, Dragosllav Stojanoviqi dëshmoi se të paktën tre persona të tjerë i bënë të njëjtën pyetje dhe e shkëlmuuan ndërkohë që ai dergjej në dysheme. Megjithatë Dragosllav Stojanoviqi dëshmoi se Ramush Haradinaj qëndroi në korridor pesë deri në gjashtë minuta, ai nuk mundi të njohte ndonjë nga personat e tjerë që shoqëronin Ramush Haradinaj për arsye se gjendja e tij ishte aq e keqe sa nuk mund të shihte siç duhet. Të tre dëshmitarët dëshmuuan se Dragosllav Stojanoviqi ishte në gjendje shumë të keqe dhe se herë pas here humbte vetëdijen. Dragosllav Stojanoviqi gjithashtu dëshmoi se nuk e kishte parë Ramush Haradinaj për rreth dhjetë vjet. Dhoma Gjyqësore gjithashtu shqyrtoi se çfarë rëndësie i duhej kushtuar faktit që në bisedat e zhvilluara në atë kohë askush nuk e kishte përmendur përfshirjen e Ramush Haradinajt në keqtrajtimin e Dragosllav Stojanoviqit. Në rast se Dhoma Gjyqësore do t'i ishin paraqitur dëshmi bashkëkohëse për praninë e Ramush Haradinajt, Dhoma Gjyqësore do të kishte pëjashtuar mundësinë e rikthimit të vonuar të kujtesës së Dragosllav Stojanoviqit. Mirëpo në mungesë të një dëshmie të tillë, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në këtë përfundimin. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore gjykon se nuk ekzistojnë arsye në mbështetje të identifikimit të Ramush Haradinajt prej Dragosllav Stojanoviqit. Gjithsesi, Dhoma Gjyqësore nuk gjykon se Dragosllav Stojanoviqi ka dhënë qëllimisht dëshmi të rreme për praninë dhe pjesëmarrjen e Ramush Haradinajt në keqtrajtimin e tij thjesht prej faktit se emri i Ramush Haradinajt nuk u përmend në ndonjë dëshmi bashkëkohëse. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore hedh poshtë argumentin se Dragosllav Stojanoviqi dha dëshmi të rreme për implikimin e Ramush Haradinaj sepse dëshmitari e konsideronte Ramush Haradinajn, apo familjen e tij përgjegjës për shkatërrimin e shtëpisë së familjes Stojanoviqi. Pas shqyrtimit të dëshmime, Dhoma Gjyqësore konkludon se rrethanat në të cilat Dragosllav Stojanoviqi e pa personin që ai besonte se ishte Ramush Haradinaj, ishin të tilla që e pamundësojnë përfundimin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ky person ishte me të vërtetë Ramush Haradinaj. Dhoma Gjyqësore konstaton se

⁸²² Veselin Stijoviqi, T. 2148-2149.

paragrafi 59 në Pikën 4 të Aktakuzës e akuzon Ramush Haradinajn për trajtimin mizor dhe torturimin vetëm të Dragosllav Stojanoviçit, jo të Mijat Stojanoviçit dhe Veselin Stijoviçit. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar ndonjë dëshmi për pjesëmarrjen personale të Ramush Haradinajt në keqtrajtimin e Mijat Stojanoviçit dhe të Veselin Stijoviçit.

179. Mijat Stojanoviçi dëshmoi se ai e pa Ramush Haradinajn kur Dragosllav Stojanoviçin, Mijat Stojanoviçin, dhe Veselin Stijoviçin i çuan nga shtëpia e familjes Stojanoviç në drejtim të Gllogjanit, si dhe në oborrin jashtë shtëpisë së Smajl Haradinajt kur ishin ndërprerë të rrahurat. Rrethanat në të dy këto raste të pretenduara kanë qënë të vështira dhe traumatike. Në rastin e parë, Mijat Stojanoviçi dëshmoi se ndërkohë që e kishin urdhëruar të mbante kokën ulur, kur po e rrihnin, dhe po e shanin, dhe mbi kokë i fluturonin plumba, ai kishte njohur Ramush Haradinajn nga një largësi e konsiderueshme. Po kështu, rasti i dytë kur Mijat Stojanoviçi pretendon se ka parë Ramush Haradinajn ndodhi pasi e kishin keqtrajtuar, gjatë kohës së shkurtër kur ndodhej në oborr. Duke patur parasysh përfundimet e veta lidhur me praninë e Ramush Haradinajt në korridor, Dhoma Gjyqësore nuk mund t'a konsiderojë pretendimin e Dragosllav Stojanoviçit se kishte parë Ramush Haradinajn si konfirmim të dy identifikimeve të lartpërmendura. Edhe sikur të supozohet se Mijat Stojanoviçi me të vërtetë e njohu Ramush Haradinajn, Dhoma Gjyqësore gjykon se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar se Haradinajn ndihmoi, inkurajoi, apo ofroi mbështetje morale, në çfarëdo mënyrë, përpara ose pas keqtrajtimit të Mijat Stojanoviçit, Veselin Stijoviçit, dhe Dragosllav Stojanoviçit. Mbi bazën e këtyre konstatimeve, Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Ramush Haradinajn mori pjesë personalisht në keqtrajtimin e të tre viktimave më 18 prill 1998. Në pjesën 3.2.3, sipër, Dhoma Gjyqësore konkludoi se nga 22 prilli e më tej në Kosovë ekzistonte konflikt i armatosur. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore konkludon se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për të gjitha akuzat e Pikës 4.

6.4 Trajtimi mizor dhe torturimi i Stanisha Radosheviçit dhe Novak Stijoviçit (Pika 6)

180. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtim çnjerëzor dhe torturim të Stanisha Radosheviçit dhe Novak Stijoviçit si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore dëgjoji dëshmitë përkatëse të Novak Stijoviçit, Stanisha Radosheviçit, Miloica Vllahoviçit, dhe Marijana Angelkoviçit.

181. Novak Stijoviq, serb,⁸²³ dëshmoi se më 21 prill 1998, ai punonte në ndërrimin e natës.⁸²⁴ Në Deçan, ai takoi Rosanda Radosheviqin⁸²⁵ dhe djalën e saj, Stanisha Radosheviqin, nga Dashinoci, komuna e Deçanit, dhe së bashku udhëtuan për në shtëpi.⁸²⁶ Novak Stijoviqi ngiste makinën e tij Yugo të kuqe, ndërsa Rosanda Radosheviq dhe Stanisha Radosheviq ngisnin Ladën e tyre në ngjyrë të hirtë.⁸²⁷ Kur mbërritën në Pozhar, ata u ndaluan në një postbllok nga ushtarë të UÇK-së me armët e drejtuara ndaj tyre.⁸²⁸ Disa nga ushtarët ishin të veshur me uniforma me simbolin e UÇK-së, ndërsa të tjerët ishin të veshur me rroba civile.⁸²⁹ Novak Stijoviqit iu kujtua se midis tyre pa Kujtim Berishën, shqiptar nga Pozhari, si dhe një farë “Jusuf”, mbiemri e të cilit nuk i kujtohej.⁸³⁰ Ushtarët e UÇK-së i pyetën ku po shkonin dhe kur Novak Stijoviqi dhe Rosanda dhe Stanisha Radosheviq u thanë se po shkonin në shtëpi, ushtarët iu përgjigjën se nuk mund të shkonin në shtëpi dhe se nuk kishin më asnjë punë atje.⁸³¹ Askush nuk dukej se ishte komandant, por afërsisht pas dhjetë minutash Jusufi urdhëroi që Novak Stijoviqi dhe Rosanda dhe Stanisha Radosheviq të çoheshin në Gllogjan, komuna e Deçanit.⁸³² Ushtarët e UÇK-së i morën në ruajtje dhe i çuan me makinat e tyre në drejtim të Gllogjanit.⁸³³

182. Në hyrje të Gllogjanit, makina e Novak Stijoviqit u prish dhe ata hasën afërsisht 30-50 ushtarë të UÇK-së, shumica e të cilëve ishin të armatosur.⁸³⁴ Dukej se nuk kishin asnjë komandant midis tyre.⁸³⁵ Pasi zbritën nga makina, ushtarët grushtuan, shkelmuan dhe goditën Novak Stijoviqin dhe Stanisha Radosheviqin me shufra dhe qytat e pushkëve afërsisht për njëzet deri në tridhjetë minuta.⁸³⁶ Novak Stijoviqi u godit në shpinë, por nuk ndjeu menjëherë lëndime.⁸³⁷ Novak Stijoviqi nuk kishte njolla gjaku, por Stanisha Radosheviq kishte.⁸³⁸ Novak Stijoviqi mendonte se Stanisha Radosheviqit i rridhte gjak nga një plagë në shpinë shkaktuar nga një goditje me qytën e pushkës.⁸³⁹ Rosanda Radosheviq ishte e pranishme, por nuk u rrah.⁸⁴⁰ Ushtarët u bënë pyetje në serbisht për vendndodhjen dhe numrin e forcave të policisë, si dhe për disa pjesëtarë të veçantë të forcave policore, përfshirë shefin e policisë së Deçanit dhe komandantin e stacionit policor në Irzniq.⁸⁴¹ Gjithashtu ushtarët i pyetën nëse kishin të afërm në polici, nëse ndonjë nga bashkëfshatarët e Novak

⁸²³ Novak Stijoviq, T. 7142-7143, 7162.

⁸²⁴ Novak Stijoviq, T. 7145-7146.

⁸²⁵ Mbështetur në dëshmitë, Dhoma Gjyqësore kupton se kur përmenden Roza dhe Rosanda Radosheviq, është fjala për të njëjtin person.

⁸²⁶ Novak Stijoviq, T. 7145-7146.

⁸²⁷ Novak Stijoviq, T. 7146.

⁸²⁸ Novak Stijoviq, T. 7147, 7160.

⁸²⁹ Novak Stijoviq, T. 7149, 7168.

⁸³⁰ Novak Stijoviq, T. 7149, 7169.

⁸³¹ Novak Stijoviq, T. 7150.

⁸³² Novak Stijoviq, T. 7172-7173, 7188.

⁸³³ Novak Stijoviq, T. 7149-7150, 7172, 7188.

⁸³⁴ Novak Stijoviq, T. 7151, 7171-7172.

⁸³⁵ Novak Stijoviq, T. 7172-7173, 7187-7188.

⁸³⁶ Novak Stijoviq, T. 7151, 7189.

⁸³⁷ Novak Stijoviq, T. 7161-7162.

⁸³⁸ Novak Stijoviq, T. 7153.

⁸³⁹ Novak Stijoviq, T. 7153.

⁸⁴⁰ Novak Stijoviq, T. 7153, 7185, 7188.

⁸⁴¹ Novak Stijoviq, T. 7151-7152, 7157.

Stijoviqit ishte anëtar i policisë, dhe cilët nga policët kishin hapur zjarr kundër shqiptarëve më 24 mars.⁸⁴² Disa individë të cilët Novak Stijoviqi nuk i identifikoi u thanë se ata nuk duhej të ktheheshin në shtëpitë e tyre, por të shkonin në Serbi.⁸⁴³ Novak Stijoviqit nuk i ra të fikët, por ai besonte se Stanisha Radosheviqi u alivanos për një kohë të shkurtër.⁸⁴⁴ Ushtarët i pyetën nëse kishin armë, dhe Novak Stijoviqi u përgjegj se kishte një pushkë. Edhe Stanisha Radosheviqi tha se kishte një pushkë.⁸⁴⁵ Ushtarët i pyetën se cili prej tyre mund të shkonte të merrte pushkët, dhe meqë asnjë prej tyre nuk ishte i gatshëm t'a bënte një gjë të tillë ushtarët vendosën të dërgonin Stanisha Radosheviqin.⁸⁴⁶ Disa persona, të cilët Novak Stijoviqi nuk i identifikoi, i dhanë Stanisha Radosheviqit një emblemë të UÇK-së, të cilën Novak Stijoviqi e konsideroi si leje-kalimi, dhe Stanisha Radosheviqi u nis me makinën e tij.⁸⁴⁷

183. Persona të pidentifikuar e sollën Novak Stijoviqin dhe Rosanda Radosheviqin nga drejtimi i Irzniqit në një shtëpi private dykatëshe në hyrje të Gllogjanit, e cila ishte shtëpia më e afërt ku ndaloi makina e Novak Stijoviqit.⁸⁴⁸ Ata hynë menjëherë në një dhomë të vogël me derë metalike dhe dritare me shufra hekuri, ku qëndruan të mbyllur për afro një orë deri në një orë e gjysëm.⁸⁴⁹ Në dhomë ishte një ushtar.⁸⁵⁰ Në dhomë hyri një burrë, i cili u tha Novak Stijoviqit dhe Rosanda Radosheviqit se mund të largoheshin, dhe ata iu bindën.⁸⁵¹ Ata i pyetën ushtarët se ku mund të shkonin dhe një prej tyre i tha se mund të shkonin ku të dëshironin përveç shtëpive të tyre.⁸⁵² Novak Stijoviqi nuk arriti të ndizte makinën e tij.⁸⁵³ Disa ushtarë të UÇK-së e rimorkuan makinën, ku ishin Novak Stijoviqi dhe Rosanda Radosheviqi, për rreth shtatë apo tetë kilometra deri në fshatin Prejlep, komuna e Deçanit, në rrugën kryesore midis Deçanit dhe Gjakovës. Ushtarët i lanë aty.⁸⁵⁴ Novak Stijoviqi dëshmoi se nga gjashtë serbët të cilët i njihte dhe që i kishin ndaluar në postbllokun e Pozharit, përfshirë babain e tij, vetëm atë dhe Stanisha Radosheviqin e kishin rrahur.⁸⁵⁵ afërsisht pas 3-5 muajsh, Novak Stijoviqi filloi të kishte probleme në shtyllën kurrizore, të cilat në fillim u shfaqën me hope dhe jo aq serioze.⁸⁵⁶ Marijana Angjolkoviqi bisedoi me Novak Stijoviqin më 25 prill 1998 në Deçan dhe përgjithësisht konfirmoi rrëfimin e tij për ngjarjet e 22 prillit 1998.⁸⁵⁷

⁸⁴² Novak Stijoviq, T. 7173-7274, 7188, 7191-7192.

⁸⁴³ Novak Stijoviq, T. 7152-7153.

⁸⁴⁴ Novak Stijoviq, T. 7153.

⁸⁴⁵ Novak Stijoviq, T. 7153-7154.

⁸⁴⁶ Novak Stijoviq, T. 7153-7154.

⁸⁴⁷ Novak Stijoviq, T. 7156, 7158.

⁸⁴⁸ Novak Stijoviq, T. 7154, 7161, 7172, 7192-7193.

⁸⁴⁹ Novak Stijoviq, T. 7154, 7193.

⁸⁵⁰ Novak Stijoviq, T. 7191.

⁸⁵¹ Novak Stijoviq, T. 7154-7155.

⁸⁵² Novak Stijoviq, T. 7155.

⁸⁵³ Novak Stijoviq, T. 7156.

⁸⁵⁴ Novak Stijoviq, T. 7155-7157.

⁸⁵⁵ Novak Stijoviq, T. 7160-7161, 7184-7187.

⁸⁵⁶ Novak Stijoviq, T. 7161, 7182-7183.

⁸⁵⁷ Marijana Angjolkoviqi, T. 463-464, 466, 514, 516-521; P4 (Blloku shënimeve të Angjolkoviqit, vëllimi 2), ff. 13-14; P5 (Raport për Incident, Qendra e së Drejtës Humanitare, 27 prill 1998).

184. Stanisha Radosheviq, serb,⁸⁵⁸ dëshmoi se në mëngjesin e 22 prillit 1998, ai, nëna e tij Roza Radosheviq dhe shoku i tij, Novak Stijoviq, po udhëtonin me dy makina nga Deçani për në shtëpinë e Radosheviqëve në Dashinoc.⁸⁵⁹ Kur arritën në kryqëzimin e rrugës midis fshatrave Pozhar dhe Llukë e Poshtme, në komunën e Deçanit, makinave iu afruan pesë burra të armatosur.⁸⁶⁰ Tre prej tyre ishin të veshur me rroba civile dhe dy të tjerët kishin uniforma.⁸⁶¹ Të gjithë burrat kishin simbolin e UÇK-së, shqiponjën dykrerëshe me gërmat UÇK në mëngë.⁸⁶² Burrat të cilët flisnin shqip dhe serbisht, i thanë dëshmitarit të dilte nga makina.⁸⁶³ Ata e pyetën dëshmitarin nëse kishte armë, ku po shkonte, dhe pastaj u thanë pasagjerëve se nuk mund të shkonin në Dashinoc, sepse ky vend “ ishte tani i tyre ... serbët nuk mund të jetonin më atje”.⁸⁶⁴ Rreth 50 burra të armatosur dolën nga një llogore betoni në anë të rrugës.⁸⁶⁵ Dëshmitari i njihte shumë prej tyre si fshatarë nga Lluka e Poshtme, Pozhari, dhe Lumbardha.⁸⁶⁶ Burrat ishin të armatosur dhe disa prej tyre ishin të veshur me uniforma kurse të tjerë kishin rroba civile me simbolin e UÇK-së në mëngë apo kapele.⁸⁶⁷

185. Pas rreth gjysëm ore një nga burrat e armatosur mori makinën e Novak Stijoviqit dhe e ngau përpara makinës së Stanisha Radosheviqit në drejtim të Irzniqit, komuna e Deçanit.⁸⁶⁸ Prapa dëshmitarit ishte ulur një burrë me automatik.⁸⁶⁹ Në makinë ishin edhe nëna e dëshmitarit si dhe Novak Stijoviq.⁸⁷⁰ Përgjatë rrugës dëshmitari pa llogore si dhe rreth 100 burra që brohorisnin “UÇK”.⁸⁷¹ Gjithashtu dëshmitari pa armë të kalibrit të rëndë si dhe dy burra me uniforma të zeza pranë një fortifikate midis Irzniqit dhe Gllogjanit.⁸⁷² Makina e Novak Stijoviqit u prish rreth dhjetë metra larg kësaj fortifikate, e cila ndodhej 200 deri 300 metra nga Gllogjani, dhe të tre ata u urdhëruan të dilnin nga makinat.⁸⁷³ Aty u afruan burra të tjerë me uniforma dhe disa me rroba civile, dhe në atë çast tre deri në pesë burra filluan të rrihnin Novak Stijoviqin.⁸⁷⁴ Këta njerëz e goditën Novak Stijoviqin në kokë, kraharor dhe brinjë, dhe vazhduan t'a shkelmonin edhe pasi ra përtokë.⁸⁷⁵ Kur dëshmitari ndërhyri dhe u përpoq të mbronte Stijoviqin, burrat filluan t'a rrihnin dhe shkelmonin edhe atë.⁸⁷⁶ Burrat i goditën me grushte, si dhe me qytat e pushkëve dhe revoleve.⁸⁷⁷

⁸⁵⁸ Stanisha Radosheviq, T. 956; D5 (Stanisha Radosheviq, deklaratë dëshmitari, 23 gusht 2005), f. 1.

⁸⁵⁹ Stanisha Radosheviq, T. 957, 960-961, 1011, 1020, 1022; P5 (Raporte për incident, Qendra e së Drejtës Humanitare, 5 Maj 1998), f. 15.

⁸⁶⁰ Stanisha Radosheviq, T. 961-962, 965; P11 (Harta e rrethinës së Liqenit të Radoniqit, me shënimet).

⁸⁶¹ Stanisha Radosheviq, T. 962.

⁸⁶² Stanisha Radosheviq, T. 961-962; P9 (stema të UÇK-së).

⁸⁶³ Stanisha Radosheviq, T. 963.

⁸⁶⁴ Stanisha Radosheviq, T. 963.

⁸⁶⁵ Stanisha Radosheviq, T. 961, 966, 1036.

⁸⁶⁶ Stanisha Radosheviq, T. 966.

⁸⁶⁷ Stanisha Radosheviq, T. 962, 966-967, 1036; P9 (stema të UÇK-së).

⁸⁶⁸ Stanisha Radosheviq, T. 967, 1036-1037.

⁸⁶⁹ Stanisha Radosheviq, T. 967.

⁸⁷⁰ Stanisha Radosheviq, T. 967.

⁸⁷¹ Stanisha Radosheviq, T. 967-968, 1040.

⁸⁷² Stanisha Radosheviq, T. 969-970; P12 (Harta e rrethinës së Liqenit të Radoniqit, me shënimet).

⁸⁷³ Stanisha Radosheviq, T. 970-971, 1041-1042.

⁸⁷⁴ Stanisha Radosheviq, T. 971-972.

⁸⁷⁵ Stanisha Radosheviq, T. 971-973.

⁸⁷⁶ Stanisha Radosheviq, T. 972-974, 1050.

Ndërkohë që i rrihnin, këta njerëz i shanë nga nënat dhe thonin se kjo ishte toka e tyre.⁸⁷⁸ Burrat nuk e rrahën nënën e dëshmitarit.⁸⁷⁹ Ata morën bllokun e adresave të dëshmitarit dhe për çdo emër në bllok e pyesnin nëse ishte serb apo rom.⁸⁸⁰ Afërsisht pas një ore një burrë, i cili dukej se ishte epror, mori dëshmitarin, nënën e tij, dhe Novak Stijoviqin në një dhomë të vogël pak metra më tej në anë të rrugës dhe mori në pyetje dëshmitarin, duke e rrahur.⁸⁸¹ Kur dëshmitari tha se babai i tij kishte dy armë burri e urdhëroi të shkonte dhe t'i sillte, përndryshe do të vriste nënën e tij dhe Novak Stijoviqin.⁸⁸² Burri i dha dëshmitarit një simbol të UÇK-së për t'a përdorur gjatë rrugës si mbrojtje nga ushtarët e UÇK-së.⁸⁸³ Pastaj dëshmitari u largua nga nëna e tij dhe nga Novak Stijoviqi dhe u nis për të marrë dy armët nga babai i tij në shtëpinë e familjes në Dashinoc (shih pjesën 6.7, më poshtë).⁸⁸⁴ Pasi mori një nga armët, dëshmitari u nis për në Deçan me pretekstin e marrjes së armës tjetër.⁸⁸⁵ Dëshmitari shkoi në stacionin policor në Deçan për të kallëzuar incidentin dhe një polic i atjeshëm e informoi se kishin gjetur nënën e tij dhe Novak Stijoviqin duke ecur pranë fshatit Prejlep, komuna e Deçanit, dhe se i kishin sjellë në Deçan.⁸⁸⁶

186. Miloica Vllahoviqi, serb,⁸⁸⁷ dëshmoi se më 22 prill 1999, policët në stacionin policor të Deçanit i kishin thënë se Konstantin Stijoviqi, i biri Novak Stijoviqi, Stanisha Radosheviqi dhe nuset e djemve, Milka Stijoviqi dhe Stanislava Popoviqi ishin arrestuar nga shqiptarët.⁸⁸⁸ Më vonë Novak Stijoviqi i tha dëshmitarit se ata i kishin mbajtur në fshatin Pozhar, komuna e Deçanit dhe më pas i kishin çuar në Gllogjan ku atë dhe Stanisha Radosheviqin i kishin rrahur.⁸⁸⁹ Dëshmitari nuk e dinte nëse i kishin mbajtur së bashku në të njëjtin vend.⁸⁹⁰ Konstantin Stijoviqi i tha dëshmitarit se atë e kishin liruar me ndërhyrjen e Hilmi Haradinajt, babai i të Akuzuarit Ramush Haradinaj.⁸⁹¹

187. Mbi bazën e dëshmimeve, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se më 22 prill 1998, Roza Radosheviqi, Novak Stijoviqi, dhe Stanisha Radosheviqi u ndalën nga ushtarë të armatosur të UÇK-së në rrugën në Pozhar apo pranë tij. Më pas ushtarët e UÇK-së i morën të tre me makinë në drejtimin e Gllogjanit. Në hyrje të Gllogjanit, Novak Stijoviqi dhe Stanisha Radosheviqi u shkëmbuan dhe u goditën me grushte dhe me qytat e pushkëve dhe të revoleve për një kohë të gjatë

⁸⁷⁷ Stanisha Radosheviq, T. 972, 974.

⁸⁷⁸ Stanisha Radosheviq, T. 973.

⁸⁷⁹ Stanisha Radosheviq, T. 982.

⁸⁸⁰ Stanisha Radosheviq, T. 974.

⁸⁸¹ Stanisha Radosheviq, T. 981-983.

⁸⁸² Stanisha Radosheviq, T. 983.

⁸⁸³ Stanisha Radosheviq, T. 984, 987.

⁸⁸⁴ Stanisha Radosheviq, T. 984.

⁸⁸⁵ Stanisha Radosheviq, T. 985-987, 1043, 1060, 1062, 1070-1071, 1073-1074.

⁸⁸⁶ Stanisha Radosheviq, T. 988.

⁸⁸⁷ Miloica Vllahoviq, T. 1542-1543.

⁸⁸⁸ Miloica Vllahoviq, T. 1577-1580, 1639-1640.

⁸⁸⁹ Miloica Vllahoviq, T. 1581-1582, 1639-1640.

⁸⁹⁰ Miloica Vllahoviq, T. 1581, 1639.

⁸⁹¹ Miloica Vllahoviq, T. 1581, 1640.

prej një grupi ushtarësh të UÇK-së. Novak Stijoviqi ra përtokë dhe Stanisha Radosheviqit i rridhte gjak. Pastaj të tre u çuan në një dhomë në një shtëpi aty pranë dhe Stanisha Radosheviqi u rrah dhe u mor në pyetje. Stanisha Radosheviqi u lejua të largohej nga shtëpia me kusht që të shkonte dhe të merrte dy armë. Pas një farë kohe u liruan Roza Radosheviqi dhe Novak Stijoviqi. Stanisha Radosheviqi mori një armë dhe pastaj u nis për në Deçan me pretekstin e marrjes së armës tjetër, por ai u arratis dhe shkoi në një stacion policor të atjeshëm.

188. Dhoma Gjyqësore është e bindur se rrahjet u shkaktuan vuajtje të mëdha fizike Novak Stijoviqit dhe Stanisha Radosheviqit. Duke patur parasysh egërsinë e rrahjeve dhe kohëzgjatjen e tyre, Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se rrahësit kishin për qëllim t'u shkaktonin vuajtje të tilla. Për më tepër Dhoma Gjyqësore është e bindur se ky krim kishte lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se viktimat nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën kur u krye krimi dhe se autorët e krimit ishin të vetëdijshëm ose duhej të ishin të vetëdijshëm për këtë fakt. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarët e UÇK-së kryen trajtim mizor ndaj Novak Stijoviqit dhe Stanisha Radosheviqit.

189. Ushtarët e UÇK-së vazhdimisht u thanë Novak Stijoviqit dhe Stanisha Radosheviqit se duke qenë serbë, ata nuk mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre pasi kjo tokë nuk ishte e tyre. Gjatë rrahjes ushtarët e UÇK-së i pyetën nëse kishin informata për policinë serbe dhe nëse kishin lidhje me këtë polici. Ata pyetën për numrin e forcave të policisë, vendndodhjen e tyre, si dhe për persona konkretë të policisë. Gjithashtu ata pyetën Stanisha Radosheviqin për kombësinë e personave emrat e të cilëve gjendeshin në bllokun e tij të adresave. Një ushtar i UÇK-së kërcënoi se do të vriste Roza Radosheviqin dhe Novak Stijoviqin në rast se Stanisha Radosheviqi nuk do të shkonte të merrte dy armët. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nxjerr përfundimin se qëllimi i rrahjeve ishte marrja e informacionit, frikësimi dhe shtrëngimi i viktimave si dhe diskriminimi i Novak Stijoviqit dhe Stanisha Radosheviqit për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore konkludon se ushtarët e UÇK-së torturuan Novak Stijoviqin dhe Stanisha Radosheviqin.

190. Në Pikën 6 të tre të Akuzuarit akuzohen si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do t'a shqyrtojë këtë formë përgjegjësie në pjesën 7, më poshtë.

6.5 Vrasja e Vukosava Markoviqit dhe Darinka Kovaçit (Pika 8)

191. Të tre të Akuzuarit akuzohen si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Vukosava Markoviqit dhe Darinka Kovaçit si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Ndryshe, Idriz Balaj akuzohet se ka kryer krimin, ose ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimit. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse të Miloica Vllahoviqit dhe Vera Kovaçeviqit si dhe dëshmitë mjekoligjore.

192. Miloica Vllahoviq dëshmoi se deri më 21 prill 1998, Darinka dhe Vukosava Vujoseviqi ishin ndër serbët e paktë të mbetur në Ratishën e Epërme dhe Dashinoc.⁸⁹² Në shtator 1998 një burrë i quajtur Muhamet nga fshati Kodrali në komunën e Deçanit, i tha atij se Darinka dhe Vukosava Vujoseviqi ishin vrarë nga fundi i korrikut 1998 dhe se të mbjellat e tyre i kishin djegur.⁸⁹³ Dëshmitari nuk e di nëse Muhameti i kishte parë vrasjet.⁸⁹⁴

193. Vera Kovaçeviqi, e bija e Darinka Kovaçit dhe mbesa e Vukosava Markoviqit,⁸⁹⁵ mësoi për zhdukjen e nënës së saj dhe më pas u informua se ajo ishte zhdukur më 21 prill 1998.⁸⁹⁶ Më 19 shtator 1998, Vera Kovaçeviqi mori pjesë në procesin e identifikimit të Darinka Kovaçit (mbetja skeletore me numrin “R-17”) dhe të Vukosava Markoviqit (mbetja skeletore me numrin “R-10”), kryer në Hotelin Pashtrik në Gjakovë.⁸⁹⁷ Ajo u dha ekspertëve kriminalistikë të dhëna personale për nënën dhe hallën e vet, përfshirë një përshkrim të pamjeve të tyre fizike si dhe një histori të shkurtër mjekësore dhe dentare.⁸⁹⁸ Sipas dëshmitares, Darinka Kovaçi kishte vuajtur nga probleme në shtyllën kurrizore, kishte një gungë të vogël në shpinë, dhe kishte proteza në dhëmbët e sipërm dhe të poshtëm, ndërsa Vukosava Markoviqi kishte pësuar lëndime në kokë dhe këmbë nga një aksident rrugor.⁸⁹⁹ Vera Kovaçeviqi identifoi një fustan të kaltër me lule të bardha dhe një jelek të bardhë që i kishte thurrur vetë si veshje të Darinka Kovaçit.⁹⁰⁰ Ajo identifikoi një fund në ngjyrë krem të errët dhe një fund të kaltër, të cilët i kishte qepur vetë, si dhe një xhaketë në të kaltër të mbyllët si veshje të Vukosava Markoviqit.⁹⁰¹ Mbi bazën e këtij informacioni, ekspertët mundën të bënin identifikimin.⁹⁰² Më vonë atë ditë, eshtrat e Darinka Kovaçit dhe Vukosava Markoviqit u varrosën

⁸⁹² Miloica Vllahoviq, T. 1554-1555.

⁸⁹³ Miloica Vllahoviq, T. 1572-1573.

⁸⁹⁴ Miloica Vllahoviq, T. 1573.

⁸⁹⁵ P1246 (Vera Kovaçeviq, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafi 1

⁸⁹⁶ P1246 (Vera Kovaçeviq, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafi 3.

⁸⁹⁷ P1246 (Vera Kovaçeviq, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafi 5. Shih gjithashtu P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 304, 306-307, 404-408; Dushan Dunjiq, T. 7207-7208, 7350, 11027-11028; P672 (Raport i autopsisë R-10), ff. 7-8; P706 (Raport i autopsisë R-17), faqet 2, 6-7; D66 (Filmim i kanalit të Radoniqit dhe Hotel Pashtrik, 12-19 shtator 1998), 1:58'07” – 1:59'47”.

⁸⁹⁸ P1246 (Vera Kovaçeviq, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafët 5, 9, 10.

⁸⁹⁹ P1246 (Vera Kovaçeviq, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafët 1, 9-10.

⁹⁰⁰ P1246 (Vera Kovaçeviq, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafët 1, 5-6, 14.

⁹⁰¹ P1246 (Vera Kovaçeviq, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafët 1, 5, 7, 14.

⁹⁰² P1246 (Vera Kovaçeviq, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafi 11.

në Varrezën Piskote në Gjakovë.⁹⁰³ Me gjithë dy përpjekje të ndryshme në vitin 2005, eshtrat e tyre nuk u gjetën.⁹⁰⁴

194. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me mbetjet skeletore R-10 dhe R-17, të identifikuara me mjete tradicionale si të Vukosava Markoviçit dhe Darinka Kovaçit. Branimir Aleksandriqi⁹⁰⁵ dëshmoi se kufoma R-10 u gjet më 12 shtator 1998 në kanalën e Radoniçit.⁹⁰⁶ Ngjitur me anën e jashtme të murit të betonuar të kanalit, heqja e kujdesshme e zhavorrit çoi në zbulimin e kufomës R-10, e cila kishte një tel me diametër tre milimetra lidhur rreth mesit.⁹⁰⁷ Më tej Aleksandriqi dëshmoi se kufoma R-17 u gjet më 12 shtator 1998 në kanalën e Radoniçit.⁹⁰⁸ Gërmimi i kujdesshëm zbuloi kufomën R-17 thellë në tokë.⁹⁰⁹ Në kokën e kufomës R-17 u gjet një komplet proteze dhëmbësh në nofullën e sipërme.⁹¹⁰ Aleksandriqi tha se, sipas raportit të autopsisë, shtylla vertebrore e kufomës ishte shumë e harkuar.⁹¹¹ Po sipas këtij raporti, gjatë identifikimit të kufomës R-17 në Hotelin Pashtrik vajza e Darinka Kovaçit deklaroi se, sipas mendimit të saj, nëna e saj nuk kishte dhëmbë, kishte protezë të pjesshme në pjesën e poshtme, protezë të plotë në pjesën e sipërme, si dhe vuante nga një sëmundje e gjatë e cila kishte shkaktuar eshtërzimin e kolonës vertebrore.⁹¹²

195. Dushan Dunjiqi⁹¹³ dëshmoi se kufoma R-10 ishte e veshur me një fund të thurur me ngjyrë si të gjelbër, një fund të zi prej liri, dhe një bluzë të kaltër me mëngë të gjata.⁹¹⁴ Kufoma R-10 ishte femër e moshës 50 deri në 60 vjeç dhe 156 deri në 165 centimetra e gjatë.⁹¹⁵ Autopsia zbuloi një vrimë plumbi përmes anës së majtë të legenit, dhe thyerje në krahun e majtë, në shtyllën kurrizore, dhe në këmbën e djathtë, mbi gju.⁹¹⁶ Më 19 shtator 1998, Vera Kovaçeviçi e identifikoi kufomën si të Vukosava Markoviçit (lindur me mbiemrin Vujosheviçi), mbi bazën e disa pjesë veshjesh dhe shenjave të plagëve në eshtëren e këmbës së djathtë dhe në kokë të shkaktuara nga një aksident rrugor.⁹¹⁷ Vera Kovaçeviçi arriti të përshkruante një bluzë të gjetur së bashku me kufomën, pa e

⁹⁰³ P1246 (Vera Kovaçeviçi, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafi 13.

⁹⁰⁴ P1246 (Vera Kovaçeviçi, deklaratë dëshmitari, 8 nëntor 2007), paragrafi 15.

⁹⁰⁵ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojcë A për Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojcë B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

⁹⁰⁶ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 4, 6, 128-129, 203-204.

⁹⁰⁷ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 129, 132-133; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 2; P452 (Filmim i gjetjes së kufomave në kanal), 0:55'38"- 1:04'39".

⁹⁰⁸ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 4, 6, 128-129, 203-204.

⁹⁰⁹ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë, 26 qershor 2007), paragrafi 144; Branimir Aleksandriqi, T. 6766-6767; P449 (Fotografi të ndryshme), f. 39; P452 (Filmim i gjetjes së kufomave në kanal), 1:27'24" - 1:31'05".

⁹¹⁰ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 144, 146; P452 (Filmim i gjetjes së kufomave në kanal), 1:29'36" - 1:29'46".

⁹¹¹ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 150; P706 (Raport i autopsisë R-17), faqet. 2, 5.

⁹¹² P706 (Raport i autopsisë R-17), faqet 6-7.

⁹¹³ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV i Dushan Dunjiqit), f. 2.

⁹¹⁴ P672 (Raport i autopsisë R-10), f. 2.

⁹¹⁵ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 298-299; P672 (Raport i autopsisë R-10), f. 7.

⁹¹⁶ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 300; P672 (Raport i autopsisë R-10), f. 2, 7.

⁹¹⁷ P618 (Dushan Dunjiqi, Raport i autopsisë, 8 qershor 2007), paragrafët 304, 306-307; Dushan Dunjiqi, T. 7207, 11027-11028; P672 (Raport i autopsisë R-10), faqet. 7-8; D66 (Filmim i kanalit të Radoniçit dhe Hotelit Pashtrik, 12-19 shtator 1998), 1:58'07" - 1:59'47".

parë duke ditur që më parë se bluza ishte dhuratë nga një prej vëllezërve.⁹¹⁸ Vera Kovaçeviqit iu paraqitën veshje të ndryshme për identifikim dhe ajo arriti të identifikonte ndër to veshjet e gjetura me kufomën.⁹¹⁹ Kufoma R-10 iu dorëzua të afërmve dhe komisioni lëshoi një vërtetim vdekjeje.⁹²⁰ Kufoma R-17 ishte e veshur me një fustan të kaltër, me figura ngjyrë manushaqe dhe të bardha, mbi një jelek të thurur me dorë.⁹²¹ Kufoma R-17 ishte femër e moshës 55 deri 65 vjeç si dhe 156 deri në 161 centrimetra e gjatë.⁹²² Autopsia zbuloi vrimën e hyrjes së një plumbi pistolette dhe daljes së tij në të majtë të eshtrës së legenit, plumb i cili po të godasë një person ende gjallë, mund të shkaktojë hemoragji dhe, më pas, vdekjen.⁹²³ Më 19 shtator 1998, Vera Kovaçeviqi identifikoi kufomën si të Darinka Kovaçit (lindur me mbiemrin Vujosheviq), mbi bazën e veshjeve, eshtërzimit të shtyllës kurrizore dhe shenjave të një sëmundjeje eshtërore kronike degjenerative, nga e cila personi kishte vuajtur që më parë dhe që kishte shkaktuar eshtërzim të thellë të shtyllës kurrizore.⁹²⁴ Vera Kovaçeviqi i tha ekipit se Vukosava Markoviqi dhe motra e saj Darinka Kovaçi u zhdukën më 21 prill 1998.⁹²⁵ Kufomat R-10 dhe R-17 iu dorëzuan të afërmve dhe u lëshua një vërtetim vdekjeje.⁹²⁶ Dëshmitarit nuk mori mostër të ADN-së prej R-17-ës për shkak të konkretësisë së identifikimit tradicional.⁹²⁷

196. Siç u përmend më sipër, Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi të dorës së dytë nga Vera Kovaçeviqi se Vukosava Markoviqi dhe Darinka Kovaçi ishin zhdukur më 21 prill 1998. Në shtator 1998, identifikimi i dy mbetjeve skeletore me anë të mjeteve tradicionale tregoi se ishin të këtyre dy grave. Të dy mbetjet skeletore u gjetën pranë murit prej betoni në kanalën e Radoniqit. Përveç karakteristikave të përgjithshme fizike, identifikimi i Vukosava Markoviqit u mbështet pjesërisht në gjurmët e plagëve në eshtra, të cilat përputheshin me plagët e pësuar në një aksident rrugor. Po kështu, përveç karakteristikave të përgjithshme fizike, identifikimi i Darinka Kovaçit u mbështet pjesërisht në simptomat e një sëmundjeje eshtërore, e dukshme në mbetjen skeletore, nga e cila ajo kishte vuajtur kur ishte gjallë. Gjatë identifikimit u shqyrtua gjithashtu një protezë e plotë e I dhëmbëve të sipërm, e cila u gjet me eshtrat dhe e cila, që dihej se përdorej prej Darinka Kovaçit. Gjithashtu, për të dy mbetjet e kufomave, Vera Kovaçeviqi identifikoi pjesë veshjesh, të cilat i kishte prodhuar vetë. Ekzistojnë disa mospërputhje midis rrëfimit të Vera Kovaçeviqit dhe Dushan Dunjiqit përse i përket identifikimit të veshjes së Vukosava Markoviqit. Megjithëse këto rrëfime

⁹¹⁸ Dushan Dunjiq, T. 7207.

⁹¹⁹ Dushan Dunjiq, T. 7207; D66 (Filmim i kanalit të Radoniqit dhe Hotelit Pashtrik, 12-19 shtator 1998), 1:57'57" – 1:58'38".

⁹²⁰ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 308; P635 (Vërtetime të vdekjes), faqet 5-6; P672 (Raport i autopsisë R-10), f. 8.

⁹²¹ P706 (Raport i autopsisë R-17), f. 3.

⁹²² P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 399; P706 (Raport i autopsisë R-17), f. 5.

⁹²³ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 401; P706 (Raport i autopsisë R-17), faqet 2, 6.

⁹²⁴ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 404-408; Dushan Dunjiq, T. 7208, 7350; P706 (Raport i autopsisë R-17), faqet 2, 6-7.

⁹²⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 305; P672 (Raport i autopsisë R-10), f. 7.

⁹²⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 308, 409; Dushan Dunjiq, T. 7351; P635 (Vërtetime të vdekjes), faqet 5-6, 9-10; P672 (Raport i autopsisë R-10), f. 8; P706 (Raport i autopsisë R-17), f. 7.

ndryshojnë, ato nuk bien domosdoshmërisht në kundërshtim me njëra tjetrën dhe disa mospërputhje kanë të bëjnë me detaje të papërcaktueshme, si ngjyra e saktë e veshjes. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk u kushton rëndësi këtyre mospërputhjeve dhe thekson se identifikimi i veshjes ishte vetëm një nga faktorët e marrë parasysh në identifikimin e mbetjeve të kufomave. Meqë eshtrat nuk u gjetën, ato nuk mund të identifikoheshin nëpërmjet analizës ADN. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi për identifikimin e bërë mbetjeve të kufomave të tjera me anën e metodave tradicionale dhe se ky identifikim më vonë u hodh poshtë nga analiza ADN. Gjithsesi duke marrë parasysh arsyet e forta për identifikimin tradicional si dhe faktin se të dy mbetjet e kufomave u gjetën në afërsi të njëra-tjetrës, Dhoma Gjyqësore konkludon se mbetja skeletore me numrin R-10 është e Vukosava Markoviçit, dhe mbetja skeletore me numrin R-17 është e Darinka Kovaçit. Provat mjekoligjore sugjerojnë se Vukosava Markoviçit dhe Darinka Kovaçi u vranë. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar faktin se gjetja e një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniçit nuk është e mjaftueshme dhe në vetvete vendimtare për të konkluduar se kush e kreu vrasjen apo se cilit grup I përkiste, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Dhoma Gjyqësore nuk mori prova nëse ndonjë nga këto gra u mbajt në arrest prej UÇK-së. Në fund të prillit 1998, Vukosava Markoviçit dhe Darinka Kovaçi ishin ndër serbët e fundit të mbetur në fshatin Ratishë e Epërme, i cili kishte kaluar nën kontrollin e UÇK-së më 21 prill 1998 ose rreth kësaj date. Gjithashtu Miloica Vllahoviçit dëshmoi se kishte dëgjuar nga një person me emrin Muhamet se Vukosava Markoviçit dhe Darinka Kovaçi u vranë në korrik 1998. Miloica Vllahoviçit nuk saktësoi burimin e informacionit të marrë prej Muhametit. Rrjedhimisht dëshmia është pa burim të identifikuar dhe mbaze e bazuar në thashetheme të ndryshme. Edhe nëqoftëse këto gra u zhdukën në një territor të kontrolluar nga UÇK-ja dhe ishin ndër serbët e fundit që kishin mbetur në fshatin e tyre në fund të prillit 1998, ky fakt nuk mund të përjashtojë mundësinë logjike që kjo vrasje të jetë kryer nga forca apo persona të tjerë që nuk kanë patur lidhje me UÇK-në.

197. Për këto arsye, edhe po të supozohet se Vukosava Markoviçit dhe Darinka Kovaçi u vranë, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të arrijë në një përfundim jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kush e kreu vrasjen e këtyre dy grave, cilit grup i përkiste vrasësi, nëqoftëse ka qënë i lidhur me ndonjë grup, si dhe nëse vrasjet u kryen gjatë mbajtjes në arrest prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi për përfshirjen e Idriz Balajt në vdekjen e ndonjërës prej dy grave. Dhoma Gjyqësore konkludon se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me këtë akuzë.

⁹²⁷ Dushan Dunjiq, T. 7350; P706 (Raport i autopsisë R-17), faqet 6-7.

6.6 Vrasja e Milovan dhe Milka Vllahoviqit (Pika 10)

198. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Milovan dhe Milka Vllahoviqit si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga një numër dëshmitarësh si dhe dëshmitë mjekoligjore.

199. Goran Vllahoviq, serb nga fshati Ratishë e Epërme, kryesisht me banorë shqiptarë, komuna e Deçanit,⁹²⁸ dëshmoi se më 21 prill 1998, ai dhe vëllai i tij Novak Vllahoviqi u larguan nga shtëpia e prindërve për punë në Deçan.⁹²⁹ Sipas dëshmitarit, kjo ishte hera e fundit që pa prindërit e tij.⁹³⁰ Pas punës, të dy vëllezërit u përpoqën të ktheheshin në shtëpinë e prindërve të tyre, por nuk arritën ta bënin një gjë të tillë, pasi rrugët për në Deçan dhe për në Prejlep ishin të bllokuara nga policia serbe e cila u tha se “kishte njerëz të armatosur”.⁹³¹ Vëllezërit e tjerë të Goran Vllahoviqit, Miloica dhe Rade, gjithashtu u përpoqën të ktheheshin në fshat por pa sukses.⁹³² Në ditët e mëvonshme, vëllezërit u përpoqën sërish të shkonin në Ratishën e Epërme, por nuk mundën pasi policia nuk i la të kalonin.⁹³³ Meqë nuk arritën të shkonin në Ratishën e Epërme, vëllai i Goran Vllahoviqit, Rade, dërgoi shokun e tij shqiptar katolik, Nuo Alakaj, në fshat për të parë si ishin prindërit.⁹³⁴ Rade Vllahoviqi i tha Goran Vllahoviqit se Nuo Alakaj kishte mësuar se prindërit nuk ishin më atje.⁹³⁵ Goran Vllahoviq nuk e dinte se kur shkoi Alakaj atje.⁹³⁶

200. Miloica Vllahoviqi, serb nga Peja,⁹³⁷ i pa prindërit e tij për herë të fundit më 21 prill 1998, pasdite, kur u nis për në Gjakovë pasi kishte kaluar natën në shtëpinë e prindërve në Ratishën e Epërme, komuna e Deçanit.⁹³⁸ Atë ditë, Millosh Radunoviqi, gruaja e tij Milica, dhe Sllobodan Radosheviqi vizituan shtëpinë e prindërve të dëshmitarit.⁹³⁹ Miloica Vllahoviqi dëshmoi se deri më 21 prill 1998, prindërit e tij ishin ndër serbët e fundit të mbetur në Ratishën e Epërme dhe Dashinoc.⁹⁴⁰ Më 22 prill 1998, dëshmitari dëgjoji nga vëllai i tij se prindërit e tij kishin qenë ende në shtëpi atë ditë deri rreth orës 6 të mëngjezit, kur vëllai ishte larguar nga shtëpia për të shkuar në punë.⁹⁴¹ Kur atë ditë dëshmitari donte të shkonte që të merrte prindërit e tij, një polic në Deçan i tha se nuk kishte siguri.⁹⁴² Dëshmitari i kërkoi Tafil Kuqit, një fqinji nga Ratisha e Epërme, të shikonte prindërit e tij.⁹⁴³ Më 24 prill 1998 apo rreth kësaj date, Tafil Kuqi shkoi në Ratishë të Epërme.⁹⁴⁴

⁹²⁸ Goran Vllahoviq, T. 1730-1731, 1734-1735.

⁹²⁹ Goran Vllahoviq, T. 1731, 1735, 1736.

⁹³⁰ Goran Vllahoviq, T. 1737, 1748.

⁹³¹ Goran Vllahoviq, T. 1737-1741.

⁹³² Goran Vllahoviq, T. 1742.

⁹³³ Goran Vllahoviq, T. 1741-1742.

⁹³⁴ Goran Vllahoviq, T. 1742-1743.

⁹³⁵ Goran Vllahoviq, T. 1743, 1762.

⁹³⁶ Goran Vllahoviq, T. 1744.

⁹³⁷ Miloica Vllahoviq, T. 1542-1543.

⁹³⁸ Miloica Vllahoviq, 1544, 1554, 1568, 1574, 1614; P28 (Fotografi e Milovan Vllahoviqit), P29 (Fotografi e Milka Vllahoviqit).

⁹³⁹ Miloica Vllahoviq, T. 1573.

⁹⁴⁰ Miloica Vllahoviq, T. 1554-1555.

⁹⁴¹ Miloica Vllahoviq, T. 1575.

⁹⁴² Miloica Vllahoviq, T. 1578.

⁹⁴³ Miloica Vllahoviq, T. 1583, 1643.

Më pas Kuqi i tha dëshmitarit se ishte ndaluar në Prejlep dhe Prekollukë, komuna e Deçanit, nga anëtarë të armatosur të UÇK-së me uniforma të cilët donin t'a çonin në Glllogjan për t'u bashkuar me UÇK-në.⁹⁴⁵ Kuqi mundi të shkonte deri në Prekollukë dhe nuk i pa prindërit e dëshmitarit.⁹⁴⁶ Më pas, dëshmitari i kërkoi Mehmet Gogës nga Deçani, i cili kishte prona pranë shtëpisë së prindërve të dëshmitarit, që të shkonte për të parë prindërit e tij.⁹⁴⁷ Dëshmitari e takoi Gogën përsëri në Deçan pas tri ose katër ditësh dhe Goga i tha se i kishte parë prindërit e tij.⁹⁴⁸ Ata ruheshin nga njerëz të armatosur dhe nuk mund të largoheshin nga shtëpia e tyre.⁹⁴⁹ Më pas, edhe Faza Haradinaj, dikur fqinjë në Ratishën e Epërme, i kishte parë prindërit e dëshmitarit në shtëpinë e tyre.⁹⁵⁰ Ajo i konfirmoi dëshmitarit se ata nuk lejoheshin të largoheshin nga shtëpia e tyre.⁹⁵¹ Në fillim të shtatorit 1998, dëshmitari dëgjoi nga Shaban Sadikaj se prindërit e tij kishin qenë në shtëpinë e tyre për 10 apo 15 ditë pas 21 prillit 1998.⁹⁵² Një burrë i quajtur Maxhun Arifaj, një nga fqinjët e dëshmitarit në Ratishë e Epërme, i tha dëshmitarit se kur ishte në rrugën midis Ratishës së Epërme dhe Irzniqit kishte parë se prindërit e dëshmitarit dhe Milica Radunoviqi po çoheshin në drejtim të Irzniqit nga burra të armatosur dhe me uniforma.⁹⁵³ Gjithashtu Maxhuni i tha dëshmitarit se një person i quajtur Bajram apo Imer Ademi u kishte kërkuar burrave të armatosur të lironin prindërit e dëshmitarit dhe të mos u bënë atyre asgjë të keqe, por burrat e armatosur e kishin kërcënuar se do t'a vrisnin.⁹⁵⁴

201. Dëshmitari 60 dëshmoi se ai i njihte Milka Vllahoviqin (që njihej gjithashtu si Markoviq) dhe Mika Radunoviqin.⁹⁵⁵ Më 23 prill 1998, Xhevdet Sadikaj i tha dëshmitarit se i kishte parë një ditë më parë, se ata ishin shumë mirë, dhe se do të përpiqej t'i nxirrte nga fshati.⁹⁵⁶ Sipas mendimit të dëshmitarit, Sadikaj ishte anëtar i UÇK-së.⁹⁵⁷

202. Sipas raportit HLC Spotlight, më 21 prill 1998 banorët serbe të Ratishës së Epërme, në komunën e Deçanit, u larguan kur UÇK-ja mori nën kontroll zonën dhe u strehuan në një qendër rinore në qytetin e Deçanit.⁹⁵⁸ Vajza e Vllahoviqit, e cila ishte larguar nga fshati së bashku me

⁹⁴⁴ Miloica Vllahoviq, T. 1583-1584, 1587, 1643.

⁹⁴⁵ Miloica Vllahoviq, T. 1584, 1643-1644.

⁹⁴⁶ Miloica Vllahoviq, T. 1644.

⁹⁴⁷ Miloica Vllahoviq, T. 1585, 1644.

⁹⁴⁸ Miloica Vllahoviq, T. 1582-1583, 1644-1645.

⁹⁴⁹ Miloica Vllahoviq, T. 1584-1585, 1646-1648.

⁹⁵⁰ Miloica Vllahoviq, T. 1585-1586, 1649-1654. Shih gjithashtu Goran Vllahoviq, T. 1744, 1746, 1748.

⁹⁵¹ Miloica Vllahoviq, T. 1585-1586, 1649-1654. Shih gjithashtu Goran Vllahoviq, T. 1744.

⁹⁵² Miloica Vllahoviq, T. 1588, 1681-1685.

⁹⁵³ Miloica Vllahoviq, T. 1591-1592, 1597-1598, 1698, 1703-1705.

⁹⁵⁴ Miloica Vllahoviq, T. 1593, 1598, 1699-1700.

⁹⁵⁵ Dëshmitari 60, T. 2249, 2251.

⁹⁵⁶ Dëshmitari 60, T. 2249-2250.

⁹⁵⁷ Dëshmitari 60, T. 2248-2249, 2288.

⁹⁵⁸ Marijana Angjelkoviq, T. 598; P6 (Spotlight Report Nr. 27, 5 gusht 1998), part. 2.1.

vëllain e saj më 21 prill, i tha HLC-së se ishin përpjekur të ktheheshin të nesërmen për të marrë prindërit e tyre, por ishin kthyer mbrapsh nga pjesëtarët e UÇK-së.⁹⁵⁹

203. Më 6 shtator 1998, Rade Vllahoviqi, i biri i Milovan dhe Milka Vllahoviqit, bëri një kallëzim në MPB-në e Gjakovës, me pretendimin se më 21 prill 1998 shqiptarë të pidentifikuar kishin hyrë në shtëpinë e familjes së tij dhe kishin marrë të dy prindërit e tij.⁹⁶⁰

204. Dëshmitarja 28, hulumtuese për një organizatë humanitare,⁹⁶¹ dëshmoi se Nada Vllahoviqi, e bija e Milovan dhe Milka Vllahoviqit, e kishte informuar atë se gjatë natës së 20 prillit 1998 UÇK-ja kishte hapur zjarr kundër shtëpive serbe në Ratishë nga drejtimi i Gillogjanit, komuna e Deçanit.⁹⁶² Më 21 prill 998, UÇK-ja dhe civilë të armatosur hynë në fshat me traktorë dhe kamiona, të armatosur me granathedhës, pushkë, dhe mortaja, duke shtënë në ajër përpara shtëpive të serbëve.⁹⁶³ Nada Vllahoviqi deklaroi se disa nga burrat e armatosur ishin të veshur me uniforma.⁹⁶⁴ Ajo tha gjithashtu se si rezultat i ketyre sulmeve, serbët u larguan nga fshati dhe u vendosën në Deçan, dhe se ajo u largua nga fshati më 21 prill 1998 me vëllezërit e saj.⁹⁶⁵ Nada Vllahoviqi shtoi se kur vëllezërit e saj u përpoqën të ktheheshin në fshat më 22 prill 1998, ata u ndaluan në një postbllok të policisë serbe.⁹⁶⁶ Nada Vllahoviqi tha gjithashtu se nga fshati ikën edhe gra dhe fëmijë shqiptarë.⁹⁶⁷

205. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Milka Vllahoviqin (mbetjet e kufomës me numër "R-35"). Branimir Aleksandriqi⁹⁶⁸ dëshmoi se më 12 shtator 1998, zhytësat e MPB-it kishin zbuluar eshtra dhe një këpucë, kjo e fundit shënuar me numrin R-35, në hyrje të liqenit dhe ia kishin dorëzuar ato ekipit mjekoligjor në Hotel Pashtrik.⁹⁶⁹ Prova e ADN-së prej KNPZh-së konkludoi se mbetjet e kufomës me numrin R-35 ishin të Milka Vllahoviqit.⁹⁷⁰ Një autopsi e kryer më 8 dhjetor 2003 nuk konstatoi plagë traumatike para vdekjes.⁹⁷¹ Shkaku i vdekjes nuk mund të përcaktohej.⁹⁷²

206. Mbi bazën e dëshmive, Dhoma Gjyqësore konkludon se më 21 prill 1998 ose rreth kësaj date, UÇK-ja mori nën kontroll Ratishën e Epërme, ku Milovan dhe Milka Vllahoviq ishin ndër

⁹⁵⁹ Marijana Angjelkoviq, T. 598; P6 (Spotlight Report Nr. 27, 5 gusht 1998), part. 2.1.

⁹⁶⁰ P1181 (Raport i Degës së Krimeve të Policisë së MPB-së së Gjakovës), faqet 10-11.

⁹⁶¹ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 2, 9, 11, 14; Dëshmitarja 28, T. 10172.

⁹⁶² P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 49; Dëshmitarja 28, T. 10229, 10232-10236.

⁹⁶³ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 49; Dëshmitarja 28, T. 10229, 10232-10236.

⁹⁶⁴ Dëshmitarja 28, T. 10235.

⁹⁶⁵ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 49-51; Dëshmitarja 28, T. 10226-10229, 10235.

⁹⁶⁶ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 49-51; Dëshmitarja 28, T. 10229-10231.

⁹⁶⁷ P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafi 50; Dëshmitarja 28, T. 10196.

⁹⁶⁸ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

⁹⁶⁹ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 246-247, 251; P773 (Fotografi të autopsies së R35), f. 2-3; P1133 (Fotografi e eshtrave të R35 dhe një këpucë atlete).

⁹⁷⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 110.

⁹⁷¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 111-112.

⁹⁷² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 112.

serbët e fundit të mbetur. Dhoma Gjyqësore dëgjoi dëshmi të dorës së dytë, sipas së cilave burra të armatosur e kishin detyruar çiftin të mbyllej në shtëpinë e vet. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi të tjera të dorës së dytë sipas së cilave çifti nuk ishte në shtëpi. Kronologjia e këtyre dëshmive të dorës së dytë nuk është e qartë. Eshtrat e Milka Vllahoviqit u gjetën në rrëpirën e poshtme të Kanalit të Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore nuk përcakton shkaku të vdekjes. Eshtrat e Milovan Vllahoviqit nuk janë gjetur. Duke marrë parasysh se Milovan Vllahoviqi nuk është parë që nga fundi i prillit apo fillimi i majit 1998, Dhoma Gjyqësore pranon se ka plotësisht të ngjarë që ai të mos jetë gjallë. Mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk disponon prova të mjaftueshme për të konkluduar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Milovan ose Milka Vllahoviqi është vrarë. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore gjykon se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me Pikën 10.

6.7 Vrasja e Sllobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit (Pika 12)

207. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Sllobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit si shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga një numër dëshmitarësh, si dhe dëshmi mjekoligjore.

208. Stanisha Radosheviq, serb i fshatit Dashinoc në komunën e Deçanit,⁹⁷³ dëshmoi se kur mbërriti në shtëpinë e familjes së tij në Dashinoc më 22 prill 1998, ai i tregoi babait të tij, Sllobodan Radosheviqit, për rrëmbimin e nënës së Stanishës dhe shokut të tij, dhe babai i dha një armë.⁹⁷⁴ Dëshmitari e informoi babain e tij se UÇK-ka kishte ngritur postblloqe kudo dhe se njerëzit nuk mund të lëviznin lirisht.⁹⁷⁵ Babai i tha se do të përpiquej të shkonte në Deçan përmes pyllit pasi të binte nata, dhe pas kësaj dëshmitari u largua duke e lënë babanë e tij në shtëpi (shih pjesën 6.4, më sipër).⁹⁷⁶ Kjo ishte hera e fundit që dëshmitari e pa babanë e tij të gjallë.⁹⁷⁷ Mëngjesin e nesërm Sllavisha Markoviqi, shok i dëshmitarit, i tha dëshmitarit se kishte ardhur nga Dashinoci, se kishte dëgjuar shumë të shtëna rreth orës 19:00 mbrëmjen e kaluar, se duhet të ishte kryer një sulm ndaj shtëpisë së familjes së dëshmitarit, dhe se Sllobodan Radosheviq ndoshta ishte kapur ose vrarë.⁹⁷⁸ Një shok tjetër i dëshmitarit e informoi atë se kishte parë ushtarë të UÇK-së që kishin marrë Sllobodan Radosheviqin së bashku me Millosh Radunoviqin në një makinë në drejtim të Pozharit,

⁹⁷³ Stanisha Radosheviq, T. 956; D5 (Stanisha Radosheviq, deklaratë dëshmitari, 23 gusht 2005), f. 1.

⁹⁷⁴ Stanisha Radosheviq, T. 984, 1011, 1020, 1022; P5 (Raporte të incidenteve nga Qendra e së Drejtës Humanitare, 5 Maj 1998), f 15.

⁹⁷⁵ Stanisha Radosheviq, T. 985.

⁹⁷⁶ Stanisha Radosheviq, T. 985.

⁹⁷⁷ Stanisha Radosheviq, T. 988.

⁹⁷⁸ Stanisha Radosheviq, T. 988-989.

megjithëse sipas dëshmitarit, ata do të udhëtonin prej andej për në Gllogjan.⁹⁷⁹ Shoku i tij kishte mundur të dallonte se ata ishin rrahur.⁹⁸⁰ Kur shoku i dëshmitarit u përpoq t'i ndalonte ushtarët, ata e rrahën.⁹⁸¹ Më pas shoku i dëshmitarit dëgjoi se Slllobodan Radosheviqi dhe Millosh Radunoviqi ishin vrarë, kufomat e tyre ishin hedhur në anë të rrugës pranë vendit që dëshmitari e quajti "Linkun Put."⁹⁸² Pas tre apo katër muajsh shoku i dëshmitarit shkoi atje për t'i mbuluar kufomat me dhé.⁹⁸³ Më 9 shtator 1998, Zoran Nikiqi dhe Vule Mirciqi, dy policë nga Deçani, e informuan dëshmitarin se kishin gjetur kufomën e Slllobodan Radosheviqit në anë të rrugës pranë fshatit Dashinoc në "Rrugën Ninka".⁹⁸⁴

209. Dëshmitari 60 dëshmoi se e kishte parë Slllobodan Radosheviqin gjallë për herë të fundit rreth datave 15-16 prill 1998 dhe Millosh Radunoviqin më 22 prill 1998, rreth orës 16:00, kur ishte larguar nga shtëpia e dëshmitarit me biçikletë për në shtëpinë e Radosheviqit.⁹⁸⁵ Më 23 prill 1998, Xhevdet Sadikaj e informoi dëshmitarin se një ditë më parë disa burra "nga Gllogjani" kishin kapur Millosh Radunoviqin kur po kalonte me biçikletë pranë shtëpisë së Sadikajt.⁹⁸⁶ Sadikaj gjithashtu e informoi dëshmitarin se burrat kishin shkuar me makinë në shtëpinë e Millosh Radunoviqit, i kishin treguar armët që kishin gjetur në shtëpinë e tij, dhe më pas ishin nisur për në shtëpinë e Slllobodan Radosheviqit për t'a kapur edhe atë.⁹⁸⁷ Rreth 10 deri në 15 minuta pasi Millosh Radunoviq ishte larguar nga shtëpia e dëshmitarit, dëshmitari, i cili ndodhej në oborrin para shtëpisë së tij, dëgjoi shumë të shtëna të armëve të ndryshme nga drejtimi i shtëpisë së Slllobodan Radosheviqit, të cilat vazhduan për rreth 10 deri në 15 minuta.⁹⁸⁸ Sadikaj e informoi dëshmitarin se afërsisht pas 10-15 minutash ai ndodhej tek kryqëzimi i rrugës për në Deçan me rrugën për në Gllogjan, ku kishte parë Millosh Radunoviqin, i plagosur në një krahë, dhe Slllobodan Radosheviqin, që po çoheshin në drejtim të Gllogjanit nga persona prej Gllogjanit.⁹⁸⁹ Sipas mendimit të dëshmitarit, Sadikaj ishte pjesëtar i UÇK-së.⁹⁹⁰

210. Qaush Sadikaj, shqiptar kosovar nga fshati Dashinoc në komunën e Deçanit,⁹⁹¹ dëshmoi se të gjithë serbët në fshat ishin armatosur në vitin 1998.⁹⁹² Ai dëshmoi gjithashtu se Millosh Radunoviqi dhe Slllobodan Radosheviqi, dy serbë nga ky fshat, ishin anëtarë të policisë rezerviste

⁹⁷⁹ Stanisha Radosheviq, T. 996-997, 1001-1003, 1005-1006, 1082.

⁹⁸⁰ Stanisha Radosheviq, T. 1005.

⁹⁸¹ Stanisha Radosheviq, T. 1006.

⁹⁸² Stanisha Radosheviq, T. 1006.

⁹⁸³ Stanisha Radosheviq, T. 998, 1006.

⁹⁸⁴ Stanisha Radosheviq, T. 989-990.

⁹⁸⁵ Dëshmitari 60, T. 2244-2245, 2247, 2251; P38 (Harta në të cilën dëshmitari shënoi shtëpitë e serbëve në Dashinoc).

⁹⁸⁶ Dëshmitari 60, T. 2232-2233, 2246-2247, 2277; P38 (Harta në të cilën dëshmitari shënoi shtëpitë e serbëve në Dashinoc).

⁹⁸⁷ Dëshmitari 60, T. 2247.

⁹⁸⁸ Dëshmitari 60, T. 2247-2248, 2267-2268, 2275-2277; P38 (Harta në të cilën dëshmitari shënoi shtëpitë e serbëve në Dashinoc).

⁹⁸⁹ Dëshmitari 60, T. 2246-2247.

⁹⁹⁰ Dëshmitari 60, T. 2248-2249, 2288.

⁹⁹¹ Qaush Sadikaj, T. 2876.

⁹⁹² Qaush Sadikaj, T. 2878-2879.

dhe se zotëronin disa armë.⁹⁹³ Slllobodan Radosheviq i mbantë armët e veta në bunkerët që kishte ndërtuar përpara dhe pas shtëpisë së tij.⁹⁹⁴ Në një moment të caktuar pemët pranë shtëpisë së dëshmitarit ishin djegur dhe dëshmitari dëgjoji Millosh Radunoviqin dhe Slllobodan Radosheviqin që thonin se tani "territori është pastruar", gjë që, sipas dëshmitarit, donte të thoshte se pamja ishte e qartë për të qëlluar.⁹⁹⁵ Një ditë dëshmitari ishte në oborrin e tij dhe pa pesë apo gjashtë burra të armatosur, tre prej të cilëve në uniforma të UJ-së, pranë një makine të bardhë rreth 200-300 metra larg.⁹⁹⁶ Burrat po i flisnin Millosh Radunoviqit në shqip dhe serbisht.⁹⁹⁷ Në fillim ata shkuan në drejtim të shtëpisë së Millosh Radunoviqit, më pas u kthyen dhe u drejtuan për në shtëpinë e Slllobodan Radosheviqit, e cila ishte 800 metra nga shtëpia e dëshmitarit.⁹⁹⁸ Pas më shumë se gjysëm ore dëshmitari dëgjoji pesë apo gjashtë të shtëna gjatë tri apo katër minutave nga drejtimi i shtëpisë së Radosheviqit.⁹⁹⁹ Çfarë dëgjoji, dëshmitari e përshkroi si shkëmbim zjarri.¹⁰⁰⁰ Dëshmitari gjithashtu dëgjoji zjarr artilerie nga drejtim i Deçanit, gjatë gjithë natës vijuese.¹⁰⁰¹ Pas dy-tri ditësh dikush u tha njerëzve në fshatin e dëshmitarit, por jo dëshmitarit, se kishte parë dy kufoma rreth dy kilometra larg, në territorin e Kodralisë, mirëpo ai nuk e dinte se kush ishin këto kufoma.¹⁰⁰² Pas disa javësh, dëshmitari dëgjoji në televizor se kufomat ishin Slllobodan Radosheviqi dhe Millosh Radunoviqi.¹⁰⁰³

211. Miloica Vllahoviqi dëshmoi se më 22 prill 1998, në Gjakovë, ai dëgjoji nga policë se Millosh Radunoviqi dhe Slllobodan Radosheviqi ishin arrestuar nga shqiptarët, të cilët, sipas mendimit të dëshmitarit, ishin të UÇK-së.¹⁰⁰⁴

212. Rrustem Tetaj dëshmoi se kishte dëgjuar dy versione të ndryshme për çka u kishte ndodhur të dy serbëve të quajtur Millosh dhe Slllobodan nga Dashinoci në komunën e Deçanit në fund të prillit apo fillim të majit 1998.¹⁰⁰⁵ Sipas versionit të parë, që dëshmitari e dëgjoji nga Deli Lekaj, komandant i UÇK-së për Lumbardhin, Lekaj dhe ushtarët e tij (Haxh Lekaj, Zymer Ukaj, Sami Lekaj, dhe të tjerët), të armatosur dhe veshur me uniforma të UÇK-së, kishin shkuan në fshatin Dashinoc dhe kishin hyrë në shtëpinë e Slllobodanit për t'a plaçkitur atë.¹⁰⁰⁶ Deli Lekaj ishte plagosur kur ndaj tyre u hap zjarr sapo hynë në shtëpi dhe Slllobodani u vra kur ushtarët e UÇK-së

⁹⁹³ Qaush Sadikaj, T. 2877-2878, 2907-2908.

⁹⁹⁴ Qaush Sadikaj, T. 2908.

⁹⁹⁵ Qaush Sadikaj, T. 2879-2881, 2909.

⁹⁹⁶ Qaush Sadikaj, T. 2890, 2911.

⁹⁹⁷ Qaush Sadikaj, T. 2890.

⁹⁹⁸ Qaush Sadikaj, T. 2890-2891, 2911.

⁹⁹⁹ Qaush Sadikaj, T. 2891-2892.

¹⁰⁰⁰ Qaush Sadikaj, T. 2909-2912.

¹⁰⁰¹ Qaush Sadikaj, T. 2904, 2912-2913.

¹⁰⁰² Qaush Sadikaj, T. 2893-2895, 2897, 2904.

¹⁰⁰³ Qaush Sadikaj, T. 2893, 2899-2901.

¹⁰⁰⁴ Miloica Vllahoviq, T. 1577-1578.

¹⁰⁰⁵ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 31; Rrustem Tetaj, T. 3696-3698, 3767.

¹⁰⁰⁶ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 31; Rrustem Tetaj, T. 3697-3698, 3767-3769.

iu përgjigjën zjarrit.¹⁰⁰⁷ Sipas versionit të dytë, grupi i Deli Lekajt kishte shkuar në shtëpinë e Sllobodanit, i cili, nga ana e tij, shkoi për të marrë Milloshin, i cili në atë kohë po i bënte një vizitë një fqinji shqiptar.¹⁰⁰⁸ Pastaj Sllobodani dhe Milloshi shkuan në shtëpinë e Sllobodanit ku Sllobodani qëlloi Deli Lekajn.¹⁰⁰⁹ Si pasojë, grupi kapi Sllobodanin dhe Milloshin dhe i solli ata në Gllogjan.¹⁰¹⁰ Kur Togeri mësoi se Sllobodani kishte qëlluar Lekajn në këmbë ai nxori revolen dhe e qëlloi Sllobodanin në këmbë.¹⁰¹¹ Pastaj Haradinaj urdhëroi që të dy burrat të çoheshin në Prejlep, komuna e Deçanit, ku ata mund të bashkoheshin me forcat serbe.¹⁰¹² Mirëpo meqë UÇK-ja në Prejlep kishte frikë se forcat serbe të MPB-it dhe UJ-së mund të hakmerreshin kur të mësonin se ishte vrarë një serb, UÇK-ja i ktheu burrat prapa në Dashinoc, ku kufomat e tyre u gjetën përpara shtëpisë së tyre pas dy ditësh.¹⁰¹³ Tetajt nuk i kujtohej se prej kujt e kishte dëgjuar versionin e dytë dhe nuk kishte informacion tjetër për t'a konfirmuar.¹⁰¹⁴

213. Ismet Kadrija dëshmoi se në prill 1998 ai kishte shoqëruar Deli Lekajn në fshatin Dashinoc, komuna e Deçanit.¹⁰¹⁵ Dëshmitari ishte i veshur me rroba civile dhe Deli Lekaj ishte i veshur me uniformë kamuflazhi të UÇK-së; të dy ishin të armatosur me Kallashnikov.¹⁰¹⁶ Kur vunë re se në postbllokun në Dashinoc, në rrugën Pozhar-Dashinoc, nuk kishte njeri, Deli Lekaj ndaloi dhe doli nga makina tre apo katër metra larg nga postblloku.¹⁰¹⁷ Në atë kohë dëshmitari dëgjoi të shtëna.¹⁰¹⁸ Dëshmitari pa se Deli Lekaj ishte goditur nga pas në kofshë.¹⁰¹⁹ Dëshmitari nuk e pa se kush e qëlloi Deli Lekajn, dhe as drejtimin nga erdhi e shtëna.¹⁰²⁰ Dëshmitari u largua menjëherë, duke e transportuar Deli Lekajn për në Pozhar, në komunën e Deçanit, ku Deli Lekaj u mjekua.¹⁰²¹

214. Zvonko Markoviqi dëshmoi se në verën e vitit 1998, ai dhe shtatë policë të tjerë u çuan nga një i ri shqiptar në një vend të quajtur Vidishte në hyrje të Dashinocit, komuna e Deçanit. Atje ata gjetën kufomat e Millosh Radunoviqit dhe Sllobodan Radosheviqit në anë të rrugës që të çonte në Dashinoc.¹⁰²² Pas këtij zbulimi, në vendngjarje erdhën disa persona me uniformë, që dëshmitari

¹⁰⁰⁷ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 32; Rrustem Tetaj, T. 3697-3698, 3767, 3769.

¹⁰⁰⁸ Rrustem Tetaj, T. 3697-3699.

¹⁰⁰⁹ Rrustem Tetaj, T. 3697-3699, 3769.

¹⁰¹⁰ Rrustem Tetaj, T. 3697-3699.

¹⁰¹¹ Rrustem Tetaj, T. 3698-3699.

¹⁰¹² Rrustem Tetaj, T. 3698-3699.

¹⁰¹³ Rrustem Tetaj, T. 3698-3699.

¹⁰¹⁴ Rrustem Tetaj, T. 3699, 3767.

¹⁰¹⁵ P1233 (Ismet Kadrija, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2004), paragrafët. 16, 18; Shtojca të deklaratës së dëshmitarit, 19 prill 2007, paragrafi 8.

¹⁰¹⁶ P1233 (Ismet Kadrija, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2004), paragrafi 17.

¹⁰¹⁷ P1233 (Ismet Kadrija, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2004), paragrafët. 18, 19.

¹⁰¹⁸ P1233 (Ismet Kadrija, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2004), paragrafi 19.

¹⁰¹⁹ P1233 (Ismet Kadrija, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2004), paragrafët. 19, 21.

¹⁰²⁰ P1233 (Ismet Kadrija, deklaratë, 28 tetor 2004), paragrafët 19, 24.

¹⁰²¹ P1233 (Ismet Kadrija, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2004), paragrafët 20-22, 24.

¹⁰²² Zvonko Markoviq, T. 2329-2331. Shihni gjithashtu P39 (Filmim që tregon vendet ku u gjetën kufomat e Millosh Radunoviqit dhe Sllobodan Rashoviqit). Shihni gjithashtu P380 (Nebojsja Avramoviq, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 75; P402 (Hartë që tregon vendin e kimit në Bandera).

mendonte se ishin ekspertë kriminalistë, të cilët kryen një hetim në terren.¹⁰²³ Dëshmitari kishte dëgjuar se Milosh Radunoviç dhe Slllobodan Radosheviç ishin vrarë nga “terroristët”.¹⁰²⁴

215. Sipas informacionit të grumbulluar nga një vëzhgues i të drejtave të njeriut për HLC, Marijana Angjelkoviç, gjatë intervistave me nusen e djalit të Radunoviçit dhe fshatarë të tjerë, më 22 prill 1998 UÇK-ja mori nën kontroll fshatin Dashinoc, komuna e Deçanit; shumica e serbëve ishin larguar nga fshati një ditë më parë.¹⁰²⁵ Slllobodan Radosheviç, Milica dhe Millosh Radunoviç, si dhe familja Markoviç kishin qëndruar.¹⁰²⁶ Roza dhe Stanisha Radosheviç u përpoqën të ktheheshin të nesërmen për të marrë Slllobodan Radosheviçin, por u ndaluan nga UÇK-ja në një postbllok në Pozhar, komuna e Deçanit; prej andej ata u çuan në një shtab të UÇK-së në Gllogjan, komuna e Deçanit, ku Stanisha Radosheviç u keqtrajtua fizikisht nga anëtarë të UÇK-së.¹⁰²⁷ Ata u liruan, por nuk u lejuan të shkonin në Dashinoc.¹⁰²⁸

216. Më 6 shtator 1998, Lubisha Radunoviç, i biri i Millosh dhe Milica Radunoviçit, bëri një kallëzim në MPB-në e Gjakovës, me pretendimin se më 24 prill 1998, rreth orës 15:00, shqiptarë të paidentifikuar kishin hyrë në shtëpinë e familjes së tij dhe kishin marrë prindërit e tij.¹⁰²⁹

217. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore mori prova mjekoligjore lidhur me Slllobodan Radosheviçin (mbetjet e kufomës me numër “D-2”) dhe Millosh Radunoviçin (mbetjet e kufomës me numër “D-1” si dhe disa eshtra të tjera). Dushan Dunjiç¹⁰³⁰ dëshmoi se me ardhjen e ekipit mjekoligjor më 11 shtator 1998, Gjykatësi Gojkoviç i dorëzoi ekipit një çantë të madhe plastike ku kishte eshtra njerëzish, veshje, si dhe sende të tjera.¹⁰³¹ Gjykatësi Gojkoviç e informoi dëshmitarin se MPB-ja i kishte gjetur eshtrat diku në fshatin Dashinoc ose pranë tij, në komunën e Deçanit.¹⁰³² Hetuesit i kishin larguar eshtrat nga Dashinoci, sepse ishte shume e rrezikshme për ekipin mjekoligjor që të punonte atje.¹⁰³³ Ekipi fillimisht caktoi numrat përkatës për eshtrat dhe disa sende të çantës D-1.¹⁰³⁴ Eshtrat përbëheshin nga copëza eshtrash që u përkisnin së paku tre personave, kështu që ekipi i emërtoi ato D-1a, D-1b dhe D-1c¹⁰³⁵. Më pas, ekipi i riemërtoi ato D-1, D-2 dhe D-3.¹⁰³⁶ Prej provës së ADN-së nga KNPZh-ja doli përfundimi se mbetjet e kufomës me numrin D-1 i përkisnin

¹⁰²³ Zvonko Markoviç, T. 2331.

¹⁰²⁴ Zvonko Markoviç, T. 2329.

¹⁰²⁵ Marijana Angjelkoviç, T. 598-599; P6 (Spotlight Report Nr. 27, 5 gusht 1998), pjesa. 2.2.

¹⁰²⁶ Marijana Angjelkoviç, T. 598; P6 (Spotlight Report Nr. 27, 5 gusht 1998), pjesa 2.2. Shihni gjithashtu P1211 (Dëshmitarja 28, deklaratë dëshmitari, 28 tetor 2007), paragrafët 45, 51.

¹⁰²⁷ Marijana Angjelkoviç, T. 598-599; P6 (Spotlight Report Nr. 27, 5 gusht 1998), pjesa. 2.2.

¹⁰²⁸ Marijana Angjelkoviç, T. 599; P6 (Spotlight Report Nr. 27, 5 gusht 1998), pjesa. 2.2.

¹⁰²⁹ P1181 (Raport i Degës së krimeve të Policisë së MPB-s së Gjakovës), faqet 8-9.

¹⁰³⁰ P618 (Dushan Dunjiç, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiçit), f. 2.

¹⁰³¹ P618 (Dushan Dunjiç, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 63, 126, 180, 683; Dushan Dunjiç, T. 6849-6850; P630 (Regjistër i zhvarrimeve, 16 shtator 1998), f. 3. Shihni gjithashtu P1260 (Branimir Aleksandriç, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 252.

¹⁰³² P618 (Dushan Dunjiç, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 63, 126, 180, 683; P636 (Fotografi të vendit në Dashinoc), faqet 1-22. Shihni gjithashtu P1260 (Branimir Aleksandriç, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 252.

¹⁰³³ P618 (Dushan Dunjiç, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 70.

¹⁰³⁴ P618 (Dushan Dunjiç, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 64, 66, 685-686.

¹⁰³⁵ P618 (Dushan Dunjiç, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 68, 686, 688; P817 (Raporti i autopsisë – mbetjet e kufomave të Dashinocit), faqet 3-4.

¹⁰³⁶ P618 (Dushan Dunjiç, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 69.

Millosh Radunoviqit.¹⁰³⁷ Autopsia e kryer në mbetjet e kufomës më 17 tetor 2005 identifikoi një nga eshtrat e gjetura si pjesëz e anës së majtë të eshtrës ballore.¹⁰³⁸ Shkaku i vdekjes nuk u përcaktua.¹⁰³⁹ Bazuar në provën e ADN-së nga KNPZh-ja u arrit gjithashtu në përfundimin se mbetjet e kufomës me numrin D-2 i përkisnin Slllobodan Radosheviqit.¹⁰⁴⁰ Autopsia e kryer më 8 dhjetor 2003 identifikoi një pjesë tërësisht të skeletizuar të eshtrës së majtë anësore me një plagë shkakuar nga armë zjarri.¹⁰⁴¹ Prej autopsisë u përcaktua se shkaku i vdekjes ishte një plagë në kokë shkaktuar me armë zjarri.¹⁰⁴² Prej proves së mëvonshme të ADN-së nga KNPZh-ja u konkludua se kishte të ngjarë që edhe disa eshtra të tjera t'i përkisnin Slllobodan Radosheviqit.¹⁰⁴³ Autopsia e kryer në ato eshtra konstatoi një të metë në këmbë që përputhej me një plagë plumbi.¹⁰⁴⁴ Megjithëse një plagë e tillë nuk shkakton vdekje të menjëhershme, në rast se nuk mjekohet, viktima mund të vdesë nga humbja e gjakut dhe ndërlikime të tjera.¹⁰⁴⁵

218. Në vlerësimin e provave lidhur me Pikën 12, Dhoma Gjyqësore hasi në probleme të konsiderueshme për shkak të nivelit të ulët të saktësisë dhe besueshmërisë së disa dëshmimeve. Po kështu, Dhoma Gjyqësore ka dyshime serioze lidhur me sinqeritetin e disa dëshmimeve. Ky dyshim buron prej reagimeve shmangëse të disa dëshmitarëve kur ballafaqoheshin me dëshmi për përfshirjen e tyre të mundshme në veprimet e policisë si dhe në ngjarjet që çuan në vdekjen e Slllobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit. Për më tepër dëshmitë karakterizoheshin nga mospërputhje lidhur me rrethanat në të cilat Slllobodan Radosheviq dhe Milosh Radunoviq ishin parë për herë të fundit. Si rrjedhim, dëshmitë nuk arritën të krijojnë një ide të qartë se çfarë u kishte ndodhur Slllobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit.

219. Slllobodan Radosheviqi dhe Millosh Radunoviqi ishin nga Dashinoci. Kur shumica e serbëve u larguan nga fshati më 21 prill 1998, ata ishin ndër personat që qëndruan në fshat. Më 22 prill 1998, UÇK-ja mori fshatin nën kontrollin e vet. Qaush Sadikaj dëshmoi se një ditë të pasaktësuar kishte parë pesë apo gjashtë burra të armatosur, tre të veshur me uniforma të UJ-së, të cilët po bisedonin me Millosh Radunoviqin në fshat. Dëshmitari i pa burrat duke ecur në drejtim të shtëpisë së Slllobodan Radosheviqit. Pas më shumë se gjysëm ore, ai dëgjoji pesë apo gjashtë të shtëna, të cilat i përshkroi si shkëmbim zjarri, që vinin nga drejtimi i asaj shtëpie. Dëshmitari 60 dëshmoi se Xhevdet Sadikaj i kishte thënë se më 22 prill 1998 burra “nga Gllogjani” e kishin çuar Millosh Radunoviqin fillimisht në shtëpinë e tij, i kishin treguar armët që kishin gjetur në shtëpinë e tij, dhe

¹⁰³⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 113.

¹⁰³⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr 115-116.

¹⁰³⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 116.

¹⁰⁴⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 117.

¹⁰⁴¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr 118-119.

¹⁰⁴² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 120.

¹⁰⁴³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 121.

¹⁰⁴⁴ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 123.

¹⁰⁴⁵ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 123.

më pas ishin nisur për në shtëpinë e Sllobodan Radoshviqit. Dëshmitari 60, i cili ka qenë në Dashinoc atë ditë, dëshmoi se kishte dëgjuar një shkëmbim zjarri që kishte vazhduar afërsisht 10 deri në 15 minuta dhe që vinte nga drejtimi i shtëpisë së Sllobodan Radosheviqit. Stanisha Radosheviqi dëshmoi se shoku i tij, Sllavisha Markoviqi, i kishte thënë se mbrëmjen e 22 prillit 1998 kishte dëgjuar “të shtëna të shumta me armë zjarri” në fshat. Rrustem Tetaj dëshmoi se Deli Lekaj, komandant i UÇK-së në Lumbardh, i kishte thënë se Lekaj ishte plagosur në një shkëmbim zjarri dhe se Sllobodan Radosheviqi ishte vrarë. Deli Lekaj i kishte thënë Rrustem Tetajt se kishin shkuar në shtëpinë e Sllobodan Radosheviqit për t'a plaçkitur. Kur kishin hyrë në shtëpi, ndaj tyre ishte hapur zjarr, Deli Lekaj ishte plagosur, dhe Sllobodan Radosheviqi ishte vrarë kur ushtarët e UÇK-së i ishin përgjigjur zjarrit me zjarr. Ismet Kadrijaj dëshmoi se Deli Lekaj ishte goditur me armë zjarri në këmbë në Dashinoc në prill 1998, megjithëse ai nuk e lidh këtë ngjarje me vrasjen e Sllobodan Radosheviqit. Rrustem Tetaj dëshmoi gjithashtu se kishte dëgjuar edhe një version tjetër se çfarë u kishte ndodhur të dy burrave, dhe se sipas këtij versioni, në këtë ngjarje ishin përfshirë si Ramush Haradinaj ashtu dhe Idriz Balaj. Megjithëse dëshmitë mjekoligjore ofruan një farë mbeshtetje objektive për këtë version, Dhoma Gjqësore nuk do të mbështetet në dëshminë e Rrustem Tetajt për këtë ngjarje, pasi Tetaj nuk dha burimin e informacionit të tij.

220. Dhoma Gjqësore dëgjoi dëshmi të dorës së dytë, sipas të cilave të dy burrat u morën nga fshati i tyre. Stanisha Radosheviqi dëshmoi se një shok i kishte thënë se kishte parë ushtarë të UÇK-së që po i çonin të dy burrat me makinë në drejtim të Pozharit. Ky person i tha gjithashtu se të dy burrat i kishin rrahur. Dëshmitari 60 dëshmoi se Xhevdet Sadikaj i kishte thënë se kishte parë persona nga Gllogjani që po i çonin të dy burrat në drejtim të Gllogjanit dhe se Millosh Radunoviqi ishte plagosur në krah. Mirëpo asnjë nga dëshmitarët që ishin të pranishëm në Dashinoc më 22 prill nuk dëshmoi se kishte parë se si po i largonin që andej të dy burrat.

221. Në shtator 1998, në anë të një rruge pranë Dashinocit u gjetën kufomat e dy burrave. Sipas provave mjekoligjore, shkaku i vdekjes së Sllobodan Radosheviqit ishte goditja me një plumb në kokë, ndërsa shkaku i vdekjes së Milosh Radunoviqit nuk mund të përcaktohej. Dhoma Gjqësore arrin në përfundimin se personat të cilët u panë me Millosh Radunoviqin më 22 prill 1998 ishin ushtarë të UÇK-së ose të lidhur me UÇK-në. Mirëpo, mbi bazën e dëshmimeve, Dhoma Gjqësore nuk mund të nxjerrë përfundime se përse këta persona iu afruan Sllobodan Radosheviqit dhe Milosh Radunoviqit atë ditë apo për rrethanat në të cilat u vranë të dy serbët. Rrjedhimisht, Dhoma Gjqësore nuk mund të konkludojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se të dy burrat u vranë apo të përjashtojë mundësinë se të dy ata merrnin pjesë aktive në luftime në momentin kur u vranë. Dhoma Gjqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për Pikën 12.

6.8 Trajtimi mizor dhe vrasja e të afërmve të Dëshmitarit 4 dhe Dëshmitarit 19 (Pika 14)

222. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor dhe vrasjen e të afërmve të Dëshmitarit 4 dhe Dëshmitarit 19 si shkelje e ligjeve ose të zakoneve të luftës. Ndryshe, Idriz Balaj akuzohet se ka kryer krime, apo ka planifikuar, nxitur, ose ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e tyre. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga Dëshmitari 4 dhe Dëshmitari 19, nga një numër dëshmitarësh të tjerë, si dhe prova mjekoligjore.

223. Dëshmitari 19 dëshmoi se më 2 mars 1998 në rrugën e fshatit për në Ratishë të Ulët, komuna e Deçanit, pranë kishës Ortodokse Trinia e Shenjtë, persona të paidentifikuar shkrehën disa plumba kundër një makine Lada të kuqe, ku ndodhej nëna e Dëshmitarit 19, Dëshmitari 4 dhe Slllobodan Prashçeviqi (Slobodan Praščević), polic serb dhe mik i familjes së Dëshmitarit 19; Slllobodan Prashçeviqi u vra, nëna u plagos, dhe Dëshmitarin 4 nuk e kapi asnjë plumb.¹⁰⁴⁶ Që prej asaj dite, dhe më rregullisht duke filluar afro një muaj më vonë, Dëshmitari 19 ka parë ushtarë të veshur me rroba të zeza apo kamuflazhi dhe me simbolin e UÇK-së, që qarkullonin në këmbë apo me makina në fshatin e tij.¹⁰⁴⁷ Disa burra të veshur me “veshje të zeza të UÇK-së”, të cilët Dëshmitari 19 i identifikoi me emër, filluan të vinin në shtëpinë e tij.¹⁰⁴⁸ Në fillim, këto grupe burrash vinin rreth dy apo tri herë në javë gjatë ditës, por pas afro një muaji ata filluan të vinin më shpesh.¹⁰⁴⁹ Burrat e pyetën familjen e Dëshmitarit 19 për lidhjet e tij me Slllobodan Prashçeviqin.¹⁰⁵⁰ Pyetën gjithashtu nëse ata kishin armë, por familja nuk kishte ndonjë armë.¹⁰⁵¹ Pas dy apo tri vizitave të para, burrat filluan të kontrollonin në shtëpi, kryesisht natën, çka e trembi Dëshmitarin 19.¹⁰⁵² Fytyrat i kishin të mbuluara me maska, e prezantonin veten si njësia e posaçme e natës dhe thonin se po kërkonin armë.¹⁰⁵³

224. Dëshmitari 19 dëshmoi se një mëngjes në verën e vitit 1998, ai mësoi nga nëna e tij se një natë më parë, rreth orës 22:00-23:00, ndërkohë që Dëshmitari 19 ishte në gjumë, në shtëpinë e familjes kishin ardhur tre deri në pese burra të maskuar.¹⁰⁵⁴ Nëna e dëshmitarit 19 i tha se midis tyre ishte një burrë me maskë “në kokë”, i cili e prezantoi veten si “Togeri”.¹⁰⁵⁵ Sipas nënës, kur burrat e maskuar ishin larguar, ata kishin marrë me vete motrën “S” të Dëshmitarit 19, duke thënë se ajo duhej të bashkohej me UÇK-në.¹⁰⁵⁶ Rreth një javë më vonë, Dëshmitari 19 e pa për herë të parë

¹⁰⁴⁶ Dëshmitari 19, T. 1137, 1139-1145; P22 (Kallëzim penal i stacionit policor në Gjakovë, 4 mars 1998).

¹⁰⁴⁷ Dëshmitari 19, T. 1146-1149, 1166, 1291; P9 (Simboli i UÇK-së); P22 (Kallëzim penal i stacionit policor në Gjakovë, 4 mars 1998).

¹⁰⁴⁸ Dëshmitari 19, T. 1149-1150, 1291.

¹⁰⁴⁹ Dëshmitari 19, T. 1151.

¹⁰⁵⁰ Dëshmitari 19, T. 1151.

¹⁰⁵¹ Dëshmitari 19, T. 1151-1152.

¹⁰⁵² Dëshmitari 19, T. 1152-1154.

¹⁰⁵³ Dëshmitari 19, T. 1154.

¹⁰⁵⁴ Dëshmitari 19, T. 1137, 1156-1157, 1163.

¹⁰⁵⁵ Dëshmitari 19, T. 1157, 1159-1160.

¹⁰⁵⁶ Dëshmitari 19, T. 1156-1157, 1163.

burrin që e thërrisnin “Togeri”.¹⁰⁵⁷ Nëna e Dëshmitarit i tha Dëshmitarit 19 se emri i tij i vërtetë i “Togërit” ishte “Idriz Balaj”.¹⁰⁵⁸ “Togëri” erdhi në shtëpinë e familjes me një automjet të zi, i shoqëruar nga dy apo tre burra të tjerë që ishin veshur me uniforma të zeza me simbolin e UÇK-së dhe ishin të pajisur me armë.¹⁰⁵⁹ Ata sollën motrën “S” për një vizitë në shtëpi që vazhdoi rreth 20-30 minuta.¹⁰⁶⁰ Motra “S” ishte e veshur me të njëjtën uniformë të zezë me simbolin e UÇK-së si dhe burrat që e sollën atë.¹⁰⁶¹ Gjatë gjithë kohës së vizitës, Dëshmitari 19 e pa “Togërin”, i cili nuk e kishte fytyrën të mbuluar me maskë, dhe e dëgjoi atë të fliste dhe të prezantonte veten.¹⁰⁶² Gjatë gjithë vizitës motra “S” ishte në shoqërinë e “Togërit”, gjë që nuk e lejoi familjen të fliste lirisht me motrën “S”.¹⁰⁶³ Sipas Dëshmitarit 19, nëna i kishte thënë se, sipas fjalëve të motrës “S”, ata nuk duhet t'a pyesnin fare se me çfarë merrej, pasi ajo kishte frikë të përgjigjej.¹⁰⁶⁴ Motra “S” u largua e shoqëruar nga të njëjtat persona dhe në të njëjtën makinë me të cilën kishte ardhur.¹⁰⁶⁵ Afro një apo dy javë më vonë, Dëshmitari 19 pa disa burra të armatosur dhe motrën “S” që erdhën në shtëpinë e familjes me një makinë kabriole Niva të bardhë.¹⁰⁶⁶ Burrat zbritën motrën “S” dhe u larguan menjëherë, duke e lënë atë vetëm me familjen në një takim që vazhdoi nga dy deri në katër orë.¹⁰⁶⁷ Motra “S” tha se personi që i thërrisnin “Togëri” e kishte udhëzuar të kthehej në bazë në një orë të caktuar.¹⁰⁶⁸ Motra “S” nuk ishte e armatosur, por ishte e veshur me uniformë të zezë me simbolin e UÇK-së, si dhe me një palë pranga që i vareshin në brez.¹⁰⁶⁹ Ajo tha se ishte anëtare e UÇK-së dhe se merrte urdhëra nga “Togëri”.¹⁰⁷⁰ Dëshmitari 19 nuk kishte dijeni që motra “S” apo ndonjë nga pjesëtarët e tjerë të familjes të kishte shprehur ndonjëherë dëshirë për t'u bashkuar me UÇK-në.¹⁰⁷¹ Pas vizitës, Dëshmitari 4 shoqëroi motrën “S” në rrugën e kthimit për në bazë në fshatin Irzniq.¹⁰⁷² Pas largimit të tyre erdhën dy apo tre ushtarë në një makine kabriole Niva të bardhë dhe një prej tyre e pyeti Dëshmitarin 19 dhe nënën e tij se ku ishte motra “S”.¹⁰⁷³ Ata iu përgjigjën se motrën “S” po e shoqëronte Dëshmitari 4 gjatë rrugë së kthimit për në bazë.¹⁰⁷⁴ Atëhere ushtarët u larguan menjëherë.¹⁰⁷⁵ Sipas Dëshmitarit 19, asnjë pjesëtar i familjes nuk e pa më motrën “S”.¹⁰⁷⁶

¹⁰⁵⁷ Dëshmitari 19, T. 1159, 1163.

¹⁰⁵⁸ Dëshmitari 19, T. 1159-1160.

¹⁰⁵⁹ Dëshmitari 19, T. 1158-1159, 1164, 1313.

¹⁰⁶⁰ Dëshmitari 19, T. 1158-1159, 1163-1164, 1313, 1324.

¹⁰⁶¹ Dëshmitari 19, T. 1166.

¹⁰⁶² Dëshmitari 19, T. 1164-1165.

¹⁰⁶³ Dëshmitari 19, T. 1165.

¹⁰⁶⁴ Dëshmitari 19, T. 1166-1167, 1169-1171.

¹⁰⁶⁵ Dëshmitari 19, T. 1167.

¹⁰⁶⁶ Dëshmitari 19, T. 1167-1168, 1172, 1312, 1315-1320.

¹⁰⁶⁷ Dëshmitari 19, T. 1169, 1315.

¹⁰⁶⁸ Dëshmitari 19, T. 1176-1178.

¹⁰⁶⁹ Dëshmitari 19, T. 1172.

¹⁰⁷⁰ Dëshmitari 19, T. 1173.

¹⁰⁷¹ Dëshmitari 19, T. 1174.

¹⁰⁷² Dëshmitari 19, T. 1175-1177, 1315, 1320.

¹⁰⁷³ Dëshmitari 19, T. 1178-1179, 1315, 1317, 1320-1323.

¹⁰⁷⁴ Dëshmitari 19, T. 1178-1179, 1317.

¹⁰⁷⁵ Dëshmitari 19, T. 1178-1179, 1317.

¹⁰⁷⁶ Dëshmitari 19, T. 1180.

225. Pas vizitës së dytë të motrës “S”, ushtarët nuk u dukën në familjen e Dëshmitarit 19 për afro një muaj.¹⁰⁷⁷ Më pas vizitat e tyre rifilluan, me një shpeshësi prej një deri në katër herë në javë.¹⁰⁷⁸ Vizitat bëheshin nga persona të maskuar dhe të armatosur, gjithmonë të veshur me uniforma të zeza me simbolin e UÇK-së.¹⁰⁷⁹ Disa herë dëshmitari 19 njohu ndërmjet tyre personin me emrin “Togeri” sa herë që ky i fundit e hiqte maskën nga fytyra.¹⁰⁸⁰ Afërsisht pesë - gjashtë muaj pas zhdukjes së motrës “S”, një natë, midis mesnatës dhe orës 1 të mëngjezit, persona të maskuar dhe të armatosur, të veshur me uniforma dhe me llampa dore, trokitën në derën e shtëpisë së familjes.¹⁰⁸¹ Dëshmitari 19 ishte prapa nënën së tij, e cila hapi derën.¹⁰⁸² Burrat i thanë asaj se ishin urdhëruar t'a merrnin me vete sepse duhej të bënte një deklaratë dhe të nënshkruante diçka.¹⁰⁸³ Nëna e dëshmitarit u largua me burrat, dhe që nga ai çast Dëshmitari 19 dhe familja e tij nuk e panë më atë.¹⁰⁸⁴ Pas largimit të nënës së Dëshmitarit, vizitat u ndërprejnë deri një natë në vjeshtën e vitit 1998, kur rreth dhjetë burra të armatosur dhe me maska, të veshur me uniforma të zeza dhe me llampa dore, thyen derën dhe hynë në shtëpinë e familjes.¹⁰⁸⁵ Ata i urdhëruan anëtarët e familjes që po flinin, të ngriheshin nga shtrati dhe i vendosën para një muri.¹⁰⁸⁶ Ndër këta burra, nga drita e një lllampe dore, Dëshmitari 19 pa dhe njohu fytyrën e “Togeri” kur hoqi maskën nga fytyra.¹⁰⁸⁷ Dëshmitari dalloj, veçanërisht, një shenjë plaje në buzën e tij të sipërme.¹⁰⁸⁸ Shenja ishte pak më e gjatë se një centimetër, dhe gjysëm deri në një centimetër e gjerë.¹⁰⁸⁹ Vizita vazhdoi për rreth 15-20 minuta.¹⁰⁹⁰ Kur u larguan, burrat morën motrën “M” të Dëshmitarit 19, e cila po qante, me duart e lidhura pas vetes, dhe e tërhequr nga “Togeri” nga dora e djathtë.¹⁰⁹¹ Afërsisht pas një jave, një i afërm i Dëshmitarit 19 dhe disa të tjerë sollën në shtëpinë e familjes kufomën e motrës “M”, e gjetur në pyll në afërsi të fshatit Bardhaniq.¹⁰⁹² Dëshmitari 19 pa një plagë pas një veshi të saj si dhe vrima të gjakosura në xhakëtën e saj.¹⁰⁹³ Të nesërmen familja varrosi motrën “M” dhe u largua menjëherë nga shtëpia për shkak të frikës së shkaktuar nga zhdukja apo vrasjet e vazhdueshme të anëtarëve të familjes.¹⁰⁹⁴

226. Dhomës Gjyqësore nuk iu paraqit asnjë dokument zyrtar për të vërtetuar se hetuesi i Tribunalit i kishte paraqitur një tabelë me fotografi të ndryshme Dëshmitarit 19 për të verifikuar

¹⁰⁷⁷ Dëshmitari 19, T. 1182, 1184-1185.

¹⁰⁷⁸ Dëshmitari 19, T. 1182, 1185.

¹⁰⁷⁹ Dëshmitari 19, T. 1182, 1186-1187.

¹⁰⁸⁰ Dëshmitari 19, T. 1182-1183, 1186-1188.

¹⁰⁸¹ Dëshmitari 19, T. 1189-1192.

¹⁰⁸² Dëshmitari 19, T. 1191.

¹⁰⁸³ Dëshmitari 19, T. 1191.

¹⁰⁸⁴ Dëshmitari 19, T. 1189, 1192.

¹⁰⁸⁵ Dëshmitari 19, T. 1201-1202, 1208.

¹⁰⁸⁶ Dëshmitari 19, T. 1202.

¹⁰⁸⁷ Dëshmitari 19, T. 1213-1214, 1328.

¹⁰⁸⁸ Dëshmitari 19, T. 1214, 1328.

¹⁰⁸⁹ Dëshmitari 19, T. 1328-1330.

¹⁰⁹⁰ Dëshmitari 19, T. 1328.

¹⁰⁹¹ Dëshmitari 19, T. 1137, 1215.

¹⁰⁹² Dëshmitari 19, T. 1217.

¹⁰⁹³ Dëshmitari 19, T. 1217-1218, 1332-1335.

nëse ai ishte në gjendje të identifikonte midis tyre të Akuzuarin Idriz Balaj.¹⁰⁹⁵ Mirëpo Dëshmitari 19 dëshmoi se kjo ishte bërë në fillim të një interviste të korrik 2004, në një zyrë në Prishtinë.¹⁰⁹⁶ I pranishëm ishte një hetues dhe një përkthyes.¹⁰⁹⁷ Tabela me fotografi përmbante afërsisht dhjetë fotografi të vogla me pamje nga shpatullat e sipër, të rreshtuara në një copë letër.¹⁰⁹⁸ Dëshmitari 19 njohu në një fotografi një person, të cilin e identifikoi si “Togeri” dhe ia tregoi këtë hetuesit.¹⁰⁹⁹ Kur Dëshmitarit 19 iu lexua deklarata e tij, ai nuk vuri re se në deklaratë nuk përmendej tabela e fotografive.¹¹⁰⁰

227. Dëshmitari 4 dëshmoi se dikur në fillim të vitit 1998 ai dhe nëna e tij ishin në një makinë private së bashku me Sllobodan Prashçeviqin, polic serb, dhe një mik i familjes.¹¹⁰¹ Rreth 100 metra nga shtëpia e Dëshmitarit 4, dy burra të armatosur dhe të veshur me rroba të zeza hapën zjarr ndaj makinës.¹¹⁰² Burrat ishin rreth shtatë deri në dhjetë metra larg makinës.¹¹⁰³ Makina doli nga rruga dhe kur ndaloi, dëshmitari arriti të largohej me vrap.¹¹⁰⁴ Më vonë ai mësoi se Prashçeviqi ishte vrarë në këtë incident dhe se nëna e tij ishte plagosur dhe ishte mjekuar në një spital në Pejë afërsisht për dy javë.¹¹⁰⁵ Sipas një raporti të policisë të asaj kohe, ky incident ndodhi më 2 mars 1998.¹¹⁰⁶ Një natë, rreth orës 22:30, në fillim të prillit 1998, në shtëpinë e familjes së Dëshmitarit 4 erdhi një grup burrash.¹¹⁰⁷ Burrat, të cilët flisnin shqip, ishin të veshur me rroba civile apo ushtarake, dhe i kishin fytyrat të mbuluara me maska apo të maskuara me bojë.¹¹⁰⁸ Të nesërmen e ëma i tregoi dëshmitarit se burrat kishin kontrolluar në shtëpi për armë dhe kishin kërkuara para nga familja.¹¹⁰⁹ Një apo dy javë më vonë, rreth orën 22:00, në shtëpi erdhën disa burra.¹¹¹⁰ Një burrë që bënte roje jashtë dhomës ku kishte fjetur dëshmitari, ishte i veshur me rroba ushtarake, në fytyrë kishte maskë, dhe ishte i armatosur.¹¹¹¹ Dëshmitari dëgjoi një nga burrat që përsëriste vazhdimisht emrin “Togeri”.¹¹¹² Të nesërmen e ëma i tha se një nga burrat e kishte prezantuar veten si Togeri.¹¹¹³ Ajo i tha gjithashtu se burrat kishin marrë me vete një nga motrat e dëshmitarit, motrën “S”, dhe se arsyeja që

¹⁰⁹⁴ Dëshmitari 19, T. 1219, 1348-1349.

¹⁰⁹⁵ Dëshmitari 19, T. 1226, 1230-1231, 1236, 1238-1239.

¹⁰⁹⁶ Dëshmitari 19, T. 1229-1230, 1235.

¹⁰⁹⁷ Dëshmitari 19, T. 1245-1246.

¹⁰⁹⁸ Dëshmitari 19, T. 1234-1236.

¹⁰⁹⁹ Dëshmitari 19, T. 1229-1230, 1234-1236.

¹¹⁰⁰ Dëshmitari 19, T. 1236-1237.

¹¹⁰¹ Dëshmitari 4, T. 1409-1410, 1415.

¹¹⁰² Dëshmitari 4, T. 1411-1412, 1415-1416, 1418, 1420.

¹¹⁰³ Dëshmitari 4, T. 1416.

¹¹⁰⁴ Dëshmitari 4, T. 1417-1419; P24 (Fotografi të një makine të përplasur).

¹¹⁰⁵ Dëshmitari 4, T. 1419-1421.

¹¹⁰⁶ P22 (Kallëzim penal i stacionit policor në Gjakovë, 4 mars 1998)

¹¹⁰⁷ Dëshmitari 4, T. 1422.

¹¹⁰⁸ Dëshmitari 4, T. 1422-1424.

¹¹⁰⁹ Dëshmitari 4, T. 1424-1426.

¹¹¹⁰ Dëshmitari 4, T. 1427-1428.

¹¹¹¹ Dëshmitari 4, T. 1429-1430, 1501.

¹¹¹² Dëshmitari 4, T. 1429-1430, 1501.

¹¹¹³ Dëshmitari 4, T. 1431.

i kishte dhënë Togeri ishte se çdo familje duhej të kishte një ushtar në ushtri.¹¹¹⁴ Dëshmitari nuk e identifikoi personalisht Togerin.¹¹¹⁵ Katër ditë më vonë, motra “S” u kthye në shtëpi e shoqëruar nga Togeri.¹¹¹⁶ Si Togeri ashtu dhe motra ishin të veshur me rroba ushtarake të zeza dhe motra kishte simbolin e UÇK-së në mëngë.¹¹¹⁷ Motra i tha familjes se e kishin sjellë në shtëpi për të marrë disa tesha dhe se ishte strehuar në ndërtesën e shkollës së vjetër në Irzniq ku, sipas motrës, ishte vendosur UÇK-ja.¹¹¹⁸ Pas vizitës së parë në familje, e cila vazhdoi 30 deri në 40 minuta, dëshmitari pa se motra u largua me Togerin në makinën e tij Niva.¹¹¹⁹ Afërisht pas një ose dy javësh, Togeri e ktheu motrën “S” në shtëpinë e familjes së saj dhe u largua me makinë.¹¹²⁰ Motra i tha familjes se në fshatin Irzniq kishte një burg të UÇK-së ku ajo kishte parë të burgosur.¹¹²¹ Motra “S” tha gjithashtu se ishte urdhëruar nga Togeri të vriste dikë dhe se nëqoftëse nuk e bënte këtë, Togeri do të vriste motrën.¹¹²² Kur motra “S” u largua, Dëshmitari 4 e shoqëroi për rreth 25 minuta, në një pjesë të rrugës drejt Irzniqit. Rreth 10-15 minuta pasi ai ishte kthyer, në shtëpi erdhi Togeri dhe një person tjetër me makinë.¹¹²³ Togeri e pyeti dëshmitarin përse ishte vonuar motra dhe dëshmitari iu përgjegj se motra ishte nisur me kohë.¹¹²⁴ Ishte rreth orës 4 pasdite dhe kur flisnin, dëshmitari e dallooi qartë fytyrën e Togerit.¹¹²⁵ Pas kësaj vizite të dytë dëshmitari nuk e pa më kurrë motrën “S”¹¹²⁶

228. Dëshmitari 4 dëshmoi se Togeri, Asllan, Rexhepi, Sokol Zefi, dhe Arush Islami erdhën në shtëpinë e familjes së tij rreth dy apo tre javë pas vizitës së dytë të motrës “S”. Rexhepi i tha nënës së dëshmitarit se nuk mund të jepej leje për të udhëtuar pasi burri i saj kishte punuar më parë me policinë serbe dhe se nëqoftëse do të përpiqej të largohej ata do t'a vrisnin.¹¹²⁷ Rreth një javë më vonë, Togeri dhe tre apo katër persona të tjerë erdhën në shtëpinë e dëshmitarit.¹¹²⁸ Togeri ishte veshur me rroba të zeza me simbolin e UÇK-së dhe në fytyrë nuk kishte maskë.¹¹²⁹ Togeri e pyeti nënën e dëshmitarit se ku gjendej vëllai i dëshmitarit, i cili në atë kohë ishte në burg.¹¹³⁰ Burrat morën me vete nënën dhe që nga ajo kohë dëshmitari nuk e ka parë më atë.¹¹³¹ Një natë (dëshmitari nuk e saktësoi datën), Togeri dhe disa ushtarë të tjerë, përfshirë Xhevat Islamin, erdhën në shtëpinë

¹¹¹⁴ Dëshmitari 4, T. 1430-1432.

¹¹¹⁵ Dëshmitari 4, T. 1503.

¹¹¹⁶ Dëshmitari 4, T. 1432-1433, 1504.

¹¹¹⁷ Dëshmitari 4, T. 1433-1436; P9 (Simboli i UÇK-së).

¹¹¹⁸ Dëshmitari 4, T. 1435, 1437-1439.

¹¹¹⁹ Dëshmitari 4, T. 1439-1440, 1504.

¹¹²⁰ Dëshmitari 4, T. 1440-1441, 1505.

¹¹²¹ Dëshmitari 4, T. 1441.

¹¹²² Dëshmitari 4, T. 1442.

¹¹²³ Dëshmitari 4, T. 1442-1443, 1506-1507.

¹¹²⁴ Dëshmitari 4, T. 1443-1440, 1507.

¹¹²⁵ Dëshmitari 4, T. 1443-1444.

¹¹²⁶ Dëshmitari 4, T. 1444.

¹¹²⁷ Dëshmitari 4, T. 1445, 1452-1453, 1498, 1508, 1516.

¹¹²⁸ Dëshmitari 4, T. 1453.

¹¹²⁹ Dëshmitari 4, T. 1453-1454.

¹¹³⁰ Dëshmitari 4, T. 1454.

¹¹³¹ Dëshmitari 4, T. 1455.

e dëshmitarit dhe pasi thyen derën, hynë brenda.¹¹³² Togerit ishte veshur me rroba të zeza dhe Xhevat Islami ishte veshur me rroba ushtarake kamuflazhi si ato që, sipas dëshmitarit, përdorte UÇK-ja.¹¹³³ Të dy burrat ishin të armatosur dhe Islami kishte maskë në fytyrë.¹¹³⁴ Islami i tha familjes se ai ishte Ramush Haradinaj por familja e njohu se ishte Islami, prandaj nuk u besoi fjalëve të tij.¹¹³⁵ Sipas dëshmitarit, Togerit dukej se ishte komandanti.¹¹³⁶ Togerit shkoi për të marrë një nga motrat e dëshmitarit, motrën “M”, e cila ishte veshur me të zeza me një xhakëtë të zezë, dhe burrat e morën atë me vete.¹¹³⁷ Dëshmitari nuk e pa më kurrë gjallë motrën “M”.¹¹³⁸ Pas katër ditësh, një burrë nga komuna e Gjakovës takoi dëshmitarin dhe i tha se kishte gjetur kufomën e motrës së dëshmitarit.¹¹³⁹ Dëshmitari shkoi me burrin për të marrë kufomën e motrës që dergjej në një pyll që nuk dukej nga rruga, diku midis Bardhaniqit dhe Zhabelit.¹¹⁴⁰ Motra nuk kishte këpucë në këmbë dhe ishte lakuriq nga mesi e sipër, me xhakëtën e saj të hedhur një apo dy metra larg trupit.¹¹⁴¹ Xhaketa ishte bërë shoshë nga plumbat dhe çarjet me thikë.¹¹⁴² Dëshmitari vuri re plagë të shkaktuara me thikë në krah dhe në fytyrë të motrës “M” si dhe një vrimë plumbi në llapën e veshit.¹¹⁴³ Rreth plagëve kishte gjak.¹¹⁴⁴ Dëshmitari dhe burri nga Bardhaniqi e morën kufomën e motrës me një qerre dhe e sollën në shtëpi për t'a varrosur.¹¹⁴⁵ Menjëherë pas kësaj, dëshmitari dhe pjesëtarët e familjes që kishin mbetur u larguan nga shtëpia nga frika.¹¹⁴⁶

229. Dëshmitari dëshmoi se e kishte parë Togerin në televizor në vitin 2002 lidhur me një sulm ndaj shtëpisë së Togerit, dhe se atij i ishin referuar edhe me emrin Toger edhe me emrin Idriz Balaj.¹¹⁴⁷ Gjatë interviste me Zyrën e Prokurorisë në Prishtinë në 2004, Dëshmitarit 4 iu tregua një tabelë me fotografi.¹¹⁴⁸ Dëshmitari 4 njohu të akuzuarin Idriz Balaj, shënoi fotografinë me një rreth dhe nënshkroi emrin e vet poshtë.¹¹⁴⁹ Dëshmitari 19 dhe Dëshmitari 4 i dhanë deklaratat e tyre veç e veç dhe po në këtë mënyrë iu treguan tabelat e fotografive.¹¹⁵⁰ Dëshmitari 4 tha se Dëshmitari 19 i kishte thënë se i ishte treguar një tabelë me fotografi dhe se ai nuk kishte qenë në gjendje të identifikonte asnjë nga fotografitë.¹¹⁵¹

¹¹³² Dëshmitari 4, T. 1463-1464.

¹¹³³ Dëshmitari 4, T. 1464-1465.

¹¹³⁴ Dëshmitari 4, T. 1465-1466.

¹¹³⁵ Dëshmitari 4, T. 1466, 1531.

¹¹³⁶ Dëshmitari 4, T. 1533-1534.

¹¹³⁷ Dëshmitari 4, T. 1467.

¹¹³⁸ Dëshmitari 4, T. 1468.

¹¹³⁹ Dëshmitari 4, T. 1468-1469.

¹¹⁴⁰ Dëshmitari 4, T. 1469-1470, 1472-1473; P25 (Fotografia e vendit ku u gjet kufoma e motrës së Dëshmitarit 4).

¹¹⁴¹ Dëshmitari 4, T. 1473-1475.

¹¹⁴² Dëshmitari 4, T. 1474.

¹¹⁴³ Dëshmitari 4, T. 1473.

¹¹⁴⁴ Dëshmitari 4, T. 1475-1476.

¹¹⁴⁵ Dëshmitari 4, T. 1475-1476.

¹¹⁴⁶ Dëshmitari 4, T. 1479.

¹¹⁴⁷ Dëshmitari 4, T. 1518-1520.

¹¹⁴⁸ Dëshmitari 4, T. 1479.

¹¹⁴⁹ Dëshmitari 4, T. 1481-1482, 1487; P27 (Tabela me fotografi për identifikim që iu tregua Dëshmitarit 4 gjatë intervistës së tij).

¹¹⁵⁰ Dëshmitari 4, T. 1481, 1488-1490.

¹¹⁵¹ Dëshmitari 4, T. 1491.

230. José Antonio Lorenzo Quiroz, ish hetues i TPNJ-së,¹¹⁵² dëshmoi se i kishte treguar një tabelë me fotografi Dëshmitarit 4 gjatë një interviste në tetor 2004.¹¹⁵³ Në atë kohë kur Lorenzo Quiroz i paraqiti Dëshmitarit 4 tabelën me fotografi, ai e dinte se Idriz Balaj kishte qenë i akuzuar në një proces gjyqësor në Kosovë dhe se fotografia e tij kishte dalë në gazeta dhe televizion.¹¹⁵⁴ Gjithashtu ai e intervistoi Dëshmitarin 19 në tetor 2004, megjithëse në një datë të ndryshme nga ajo kur intervistoi Dëshmitarin 4.¹¹⁵⁵ Të dy këta dëshmitarë kanë qenë të ndarë nga njëri tjetri gjatë intervistave të tyre si dhe kur u janë paraqitur tabelat e fotografive.¹¹⁵⁶ Lorenzo Quiroz i paraqiti Dëshmitarit 19 një tabelë me fotografi, ku përfshihej ajo e Idriz Balajt, gjatë një interviste në korrik 2004, megjithëse nuk e shënoi këtë në deklaratë.¹¹⁵⁷ Ai shpjegoi se kjo kishte qenë një harresë nga ana e tij.¹¹⁵⁸ Gjithashtu atij nuk i kujtohej nëse Dëshmitari 19 identifikoi dikë apo jo.¹¹⁵⁹ Dëshmitari 19 e informoi Lorenzo Quiroz se e kishte parë Idriz Balajn në lajme ku u tha se ai ishte shpallur fajtor për krime.¹¹⁶⁰

231. Maklen Misha, punonjës gjuhësor në Gjykatë, shërbeu si përkthyes gjatë intervistave të Dëshmitarëve 4 dhe 19 të kryera nga hetuesit e Tribunalit.¹¹⁶¹ Ai deklaroi se nganjëherë ata kishin ardhur në intervista së bashku.¹¹⁶² Ai dëshmoi gjithashtu se një hetues i Gjykatës i kishte paraqitur tabelat e fotografive secilit dëshmitar veç e veç.¹¹⁶³ Mirëpo, Misha theksoi vazhdimisht se nuk e mbante mend me siguri këtë gjë.¹¹⁶⁴ Ai deklaroi se nuk i kujtohej reagimi i secilit prej dëshmitarëve ndaj tabelave të fotografive.¹¹⁶⁵ Misha dëshmoi se tabelat e fotografive ishin zakonisht në formën e disa fotografive personash të vendosura në një faqe formati A4 horizontalisht megjithëse atij nuk i kujtohej nëse ishte vepruar kështu edhe në rastin e dëshmitarëve 4 dhe 19.¹¹⁶⁶ Ai tha se nuk i kujtohej të kishte parë ndonjë deklaratë dëshmitari, në të cilën të mos përmëndej se dëshmitari kishte parë tabelë me fotografi ndërkohë që dëshmitari kishte parë me të vërtetë një tabelë të tillë.¹¹⁶⁷ Misha dëshmoi se zakonisht kur një hetues i paraqet një tabelë me fotografi një Dëshmitari, ky fakt përmendet në deklaratën e dëshmitarit.¹¹⁶⁸

¹¹⁵² José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5862.

¹¹⁵³ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5873-5874, 5919-5920.

¹¹⁵⁴ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5927.

¹¹⁵⁵ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5875, 5917-5920.

¹¹⁵⁶ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5882-5883.

¹¹⁵⁷ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5877-5879, 5912, 5915-5917, 5920.

¹¹⁵⁸ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5878.

¹¹⁵⁹ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5879, 5920.

¹¹⁶⁰ José Antonio Lorenzo Quiroz, T. 5928-5929.

¹¹⁶¹ Maklen Misha, T. 1250-1251.

¹¹⁶² Maklen Misha, T. 1251.

¹¹⁶³ Maklen Misha, T. 1252.

¹¹⁶⁴ Maklen Misha, T. 1253-1254, 1256.

¹¹⁶⁵ Maklen Misha, T. 1256-1257.

¹¹⁶⁶ Maklen Misha, T. 1252-1253.

¹¹⁶⁷ Maklen Misha, T. 1255.

¹¹⁶⁸ Maklen Misha, T. 1255.

232. Dëshmitari 63 deklaroi se një ditë në verën e vitit 1998 kur shkoi për të marrë dru në pyllin e tij, gjeti kufomën e një vajze të re.¹¹⁶⁹ Kufoma ishte në pozicion kruspull dhe nën kokën e saj ishte një pëllg gjaku.¹¹⁷⁰ Dëshmitari informoi për këtë komandantin lokal të UÇK-së dhe nga një person në fshatin e tij mësoi se dikush në Ratishë po kërkonte motrën e zhdukur.¹¹⁷¹ Dëshmitari shkoi në fshat me një shok dhe, më në fund, foli me dikë që doli se ishte një i afërm i vajzës së vdekur.¹¹⁷² Të gjithë u kthyen tek kufoma dhe i afërmi e identifikoi atë dhe e mori me vete.¹¹⁷³

233. Sipas një raporti të RDB-së, më 2 mars 1998, rreth orës 16:00, “terroristë” shqiptarë hapën zjarr me armë automatike ndaj një makine të tipit “Lada” dhe vranë Sllobodan Prashçeviqin, nga Gjakova, i cili më parë kishte punuar si komandant i degës policore të Irzniqit.¹¹⁷⁴ Më tej në raport thuhet se në pritën ndaj Sllobodanit morën pjesë një numër “terroristësh” dhe se një prej tyre, i maskuar dhe me dy pistoleta në dorë, iu afrua makinës pas sulmit dhe shtiu në drejtim të Sllobodan Prashçeviqit.¹¹⁷⁵ Në makinë ndodheshin gjithashtu Dëshmitari 4 dhe nëna e tij, e cila u plagos rëndë dhe u shtrua në spital pas incidentit.¹¹⁷⁶ Zoran Stijoviq, shef i Sektorit të Analizave të Qendrës së RDB-së në Prishtinë nga viti 1995 deri në 1999, dëshmoi se RDB-ja kishte informacion të marrë nëpërmjet një hetimi policor se Sllobodan Prashçeviqi ishte vrarë nga vëllezërit e nënës së Dëshmitarit 4, me të cilën ai kishte një lidhje dashurie.¹¹⁷⁷ Sipas Stijoviqit, ky incident nuk kishte lidhje me UÇK-në, megjithëse më pas UÇK-ja u përpoq t'a paraqiste incidentin si vepër të saj.¹¹⁷⁸

234. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me motrën “S” (kufoma me numrin “R-12”), nënën e Dëshmitarit 4 (kufoma me numër “R-11”), dhe motrën “M” (kufoma me numrin “ACL02-001B”). Branimir Aleksandriqi¹¹⁷⁹ dëshmoi se kufomat R-11 dhe R-12 u gjetën më 12 shtator 1998.¹¹⁸⁰ Kufomat u gjetën me kokat e tyre të vendosura pranë njëra tjetrës.¹¹⁸¹ Pranë kufomave u gjet një tel i ndryshkur me gjemba 2.5 metra i gjatë dhe i lidhur në formën e një laku në një anë të tij.¹¹⁸² Nuk u përcaktua dot se për cilën nga kufomat ishte përdorur teli me gjemba apo nëse me të ishte lidhur ndonjë pjesë e trupit.¹¹⁸³ Mirëpo, meqë teli u gjet më afër kufomës R-12, ai u

¹¹⁶⁹ P339 (Dëshmitari 63, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2006), paragrafët 4, 5.

¹¹⁷⁰ P339 (Dëshmitari 63, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2006), paragrafi 5.

¹¹⁷¹ P339 (Dëshmitari 63, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2006), paragrafët 6, 7.

¹¹⁷² P339 (Dëshmitari 63, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2006), paragrafi 7.

¹¹⁷³ P339 (Dëshmitari 63, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2006), paragrafi 8.

¹¹⁷⁴ P967 (Notë zyrtare e RDB-së, 3 mars 1998).

¹¹⁷⁵ P967 (Notë zyrtare e RDB-së, 3 mars 1998).

¹¹⁷⁶ P967 (Notë zyrtare e RDB-së, 3 mars 1998).

¹¹⁷⁷ Zoran Stijoviq, T. 9062-9064.

¹¹⁷⁸ Zoran Stijoviq, T. 9062-9064.

¹¹⁷⁹ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

¹¹⁸⁰ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 128-129, 203-204.

¹¹⁸¹ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 72; Branimir Aleksandriq, T. 6759-6761; P414 (Fotografi të ndryshme), f. 4.

¹¹⁸² P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 72, 83, 86-87; Branimir Aleksandriq, T. 6761, 6764; P452 (Filmim i kufomës së gjetur në kanal), 0:27'25" - 0:30'15", 0:32'26" - 0:33'00"; P686 (Fotografi të autopsisë R-12), f. 2, fotografia në mes, f. 6.

¹¹⁸³ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 81; Branimir Aleksandriq, T. 6761-6762.

vendos në thesin e kufomës R-12.¹¹⁸⁴ Në gjembat e telit kishin ngelur fije të gjata floku të zi si dhe inde të kalbëzuara të buta, për të cilat nuk mund të përcaktohej se cilës prej kufomave i përkisnin.¹¹⁸⁵ Dushan Dunjiqi¹¹⁸⁶ dëshmoi se pranë kufomës u gjet një copë teli me gjemba 313 centimetra e gjatë. Njëra anë e telit ishte e lidhur në formën e një laku.¹¹⁸⁷ Në telin me gjemba u gjetën fije floku të njëjta në cilësi, ngjyrë, dhe gjatësi me ato të gjetura pranë kafkës së kufomës.¹¹⁸⁸ Kjo ngjashmëri u përcaktua me anë të analizës makroskopike.¹¹⁸⁹ Sipas dëshmitarit, i vetmi shpjegim për praninë e fijeve të flokut në tel ishte se teli kishte patur kontakt me një person.¹¹⁹⁰ Prej provës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numrin R-12 u identifikua si motra “S” e Dëshmitarit 4.¹¹⁹¹ Autopsia e kryer në këtë kufomë më 8 dhjetor 2003 zbuloi plagë në kraharor ndoshta të shkaktuara nga armë zjarri, thyerje në shtyllën kurrizore, një plagë e shkaktuara me armë zjarri në krahun e majtë, në bërrylin e djathtë, pjesën e legenit, dhe në këmbën e djathtë.¹¹⁹² Shkaku i vdekjes u përcaktua si plagë të shkaktuara me armë zjarri në kraharor, dhe/ose plagë të shkaktuara me armë zjarri në pjesën e poshtme të barkut.¹¹⁹³ Dushan Dunjiqi¹¹⁹⁴ dëshmoi se kufoma R-12 ishte e veshur me pantallona xhins të errta dhe bluzë me mëngë të shkurtra.¹¹⁹⁵ Autopsia e kryer e kryer mbi kufomën në shtator 1998, zbuloi thyerje të shumta në brinjë, thyerje në pjesët e sipërme të të dy krahëve, në kofshën e djathtë, dhe në eshtrën e djathtë të legenit.¹¹⁹⁶ Thyerjet përputheshin me lëndime të shkaktuara nga goditje të dhunshme fizike me anë të një objekti jo të mprehtë.¹¹⁹⁷ Sipas Dunjiqit, nuk kishte shenja që këto thyerje të ishin shkaktuar nga plumbat.¹¹⁹⁸

235. Prej provës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-11 u identifikua si nëna e dëshmitarit 4.¹¹⁹⁹ Autopsia e kryer mbi këtë kufomë më 8 dhjetor 2003 zbuloi thyerje të shumta në zonën e legenit që përputheshin me lëndime të shumta të shkaktuara nga armë zjarri.¹²⁰⁰ Gjithashtu autopsia zbuloi thyerje në shpatullën e majtë, në krahë dhe në parakrahun e majtë, të cilat gjithashtu përputheshin me lëndime të shumta të shkaktuara nga armë zjarri.¹²⁰¹ Si shkak i vdekjes u përcaktua një plagë me armë zjarri në zonën e legenit.¹²⁰² Dusan Dunjiqi dëshmoi se kufoma R-11

¹¹⁸⁴ Branimir Aleksandriq T. 6761, 6764-6765, 6787-6788; P686 (Fotografi të autopsisë R-12), f. 2, fotografia në mes.

¹¹⁸⁵ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 72, 82; P686 (Fotografi të autopsisë R-12), f. 5.

¹¹⁸⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹¹⁸⁷ Dushan Dunjiq, T. 6832-6833; P630 (Regjistër i zhvarrimeve, 16 shtator 1998), f. 2; P684 (Raport i autopsisë R-12), f. 3; P686 (Fotografi R-12), faqet 2, 5.

¹¹⁸⁸ Dushan Dunjiq, T. 6833-6835, 7274-7275; P630 (Regjistër i zhvarrimeve, 16 shtator 1998), f. 2; P684 (Raport i autopsisë R-12), f. 3.

¹¹⁸⁹ Dushan Dunjiq, T. 6835, 7274-7275, 7353-7355.

¹¹⁹⁰ Dushan Dunjiq, T. 6833-6834.

¹¹⁹¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 66.

¹¹⁹² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 67-68.

¹¹⁹³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 69.

¹¹⁹⁴ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹¹⁹⁵ P684 (Raport i autopsisë R-12), f. 2.

¹¹⁹⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 339; P684 (Raport i autopsisë R-12), f. 6.

¹¹⁹⁷ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 338.

¹¹⁹⁸ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 338.

¹¹⁹⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 63.

¹²⁰⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 64.

¹²⁰¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 64.

¹²⁰² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 65.

ishite e veshur me një fustan të kaltër të errët.¹²⁰³ Autopsia e kryer mbi kufomën në shtator 1998 zbuloi një plagë të shkaktuar nga hyrja e një plumbi në anë të majtë të zonës së barkut dhe një plagë të shkaktuar nga dalja e plumbit në shpatullën e majtë, si dhe pjesë të plumbit u gjetën pranë vertebrave.¹²⁰⁴ Autopsia zbuloi thyerje të shumta në të dy krahët si dhe në pjesën e poshtme të këmbës së majtë.¹²⁰⁵

236. Prej provës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër ACL02-001B u identifikua si motra “M” e dëshmitarit 4.¹²⁰⁶ Autopsia e kryer mbi këtë kufomë më 20 tetor 2005, zbuloi dëmtime të shumta në kokë dhe nofull, ndër të cilat thyerje shkaku të cilave përputhej me një plagë plumbi që kishte përshkuar nofullën.¹²⁰⁷ Gjithashtu u konstatuan thyerje në krahun e djathtë dhe shtyllën kurrizore, që përputheshin me lëndime të shkaktuara nga armë zjarri.¹²⁰⁸ Konkluzioni i raportit ishte se vdekja ishte shkaktuar nga plagë të shumta të shkaktuara me armë zjarri.¹²⁰⁹

237. Dhoma Gjyqësore i konsideron Dëshmitarin 4 dhe Dëshmitarin 19, të besueshëm. Mirëpo, ajo konstaton se Dëshmitari 4 është më i sakë se Dëshmitari 19 lidhur me kronologjinë e ngjarjeve në këtë pikë. Afërsisht që nga fillimi i prillit 1998, burra të armatosur vinin vazhdimisht në shtëpinë e dy dëshmitarëve. Burrat ishin të veshur me rroba civile, ushtarake apo të zeza të UÇK-së dhe disa prej tyre kishin maska në fytyrë. Ata pyesnin nëse familja kishte armë dhe kontrollonin shtëpinë. Sipas Dëshmitarit 19, ata pyesnin gjithashtu për lidhjet e familjes me oficerin e ndjerë të policisë serbe, Sllobodan Prashçeviq.

238. Pas një vizite vonë në mbrëmje rreth mesit të prillit 1998, nëna e familjes u tha Dëshmitarit 4 dhe Dëshmitarit 19 se burrat e armatosur kishin marrë me vete motrën e tyre “S”, me arsyetimin se ajo duhej të bashkohej me UÇK-në. Afërsisht pas katër ditësh motra “S” erdhi në shtëpi e shoqëruar nga një person, të cilin dëshmitarët e njohën me emrin “Togeri”. Të dy ishin të veshur me uniforma të zeza me simbolin e UÇK-së. Sipas Dëshmitarit 19, ishin gjithashtu edhe dy apo tre burra të tjerë të armatosur të veshur me rroba të zeza me simbolin e UÇK-së. Me sa dinte Dëshmitari 19, motra “S” nuk kishte dashur asnjëherë të bashkohej me UÇK-në. Sipas Dëshmitarit 4, pas rreth një apo dy javësh, “Togeri” e solli motrën “S” me makinë në shtëpinë e familjes. Dëshmitari 19 dëshmoi se motrën “S” e kishin sjellë disa njerëz të armatosur dhe se ajo ishte sërish e veshur me uniformë të zezë me simbolin e UÇK-së. Sipas Dëshmitarit 19, motra “S” tha se ishte anëtare e UÇK-së, dhe se merrte urdhra nga “Togeri”, i cili e kishte udhëzuar të kthehej në bazë

¹²⁰³ P680 (Raport i autopsisë R-11), f. 2.

¹²⁰⁴ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 328; P680 (Raport i autopsisë R-11), f. 6.

¹²⁰⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 328; P680 (Raport i autopsisë R-11), f. 6.

¹²⁰⁶ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 124.

¹²⁰⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 125-126.

¹²⁰⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 126.

¹²⁰⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 127.

brenda një kohe të përcaktuar. Dëshmitari 4 dëshmoi se motra “S” tha se “Togeri” e kishte urdhëruar të vriste dikë dhe se ai do të vriste motrën në rast se ajo nuk e zbatonte urdhrin. Sipas Dëshmitarit 19, dy apo tre ushtarë mbërritën me makinë për të pyetur për motrën “S” pasi ajo ishte larguar përsëri nga shtëpia. Sipas Dëshmitarit 4, “Togeri”, i shoqëruar nga një person tjetër, erdhi me makinë dhe pyeti përse ishte vonuar motra “S”. Afërsisht pas tri apo katër javësh, burra të maskuar, të armatosur, dhe të veshur me uniformë erdhën në shtëpinë e Dëshmitarit 4 dhe Dëshmitarit 19 midis mesnatës dhe orës 1 pas mesnate. Ata thanë se ishin urdhëruar të merrnin nënën me vete për të nënshkruar diçka. Dëshmitari 4 dëshmoi se njëri prej tyre ishte “Togeri”, i cili ishte veshur me rroba të zeza me simbolin e UÇK-së. Ai pyeti nënën për vëllain e Dëshmitarit 4. Burrat e morën nënën me vete. Mbi bazën e këtyre dëshmive, Dhoma Gjyqësore është e bindur se personat që morën motrën “S” dhe nënën ishin ushtarë të UÇK-së.

239. Në shtator 1998, kufoma e motrës “S” (R-12) dhe kufoma e nënës (R-11) u gjetën në kanalën e Radoniqit pranë njëra tjetrës. Në kufomën e nënës kishte thyerje të shumta, që përputheshin me plagë të shkaktuara nga armë zjarri, një prej të cilave mund të ketë shkaktuar vdekjen e saj. Dushan Dunjiqi dëshmoi se motra “S” u gjet me pantallona xhins në të kaltër të errëta dhe bluzë me mëngë të shkurtra. Në autopsinë e kryer në shtator 1998 u zbuluan thyerje të shumta në brinjë, në pjesën e sipërme të krahëve, në kofshën e djathtë, si dhe në eshtrën e djathtë të legenit. Dushan Dunjiqi dëshmoi se thyerjet përputheshin me lëndime të shkaktuara nga goditje të dhunshme me një objekt jo të mprehtë. Ai tha se nuk kishte shenja që thyerjet të ishin shkaktuar nga plumbat. Një autopsi tjetër e kryer mbi të njëjtën kufomë më 8 dhjetor 2003 zbuloi plagë, ndoshta të shkaktuara me armë zjarri, në kraharor, thyerje në shtyllën kurrizore, si dhe një plagë me armë zjarri në krahun e majtë, në bërrylin e djathtë, në zonën e legenit, si dhe në këmbën e djathtë. Autopsia përcaktoi si shkak të vdekjes plagë me armë zjarri në kraharor dhe/ose në pjesën e poshtme të barkut. Duke marrë parasysh provat mjekoligjore, faktin që si nëna po ashtu dhe motra “S” u morën nga shtëpia e tyre prej UÇK-së, periudhën e gjatë ndërmjet marrjes së njëres dhe tjetrës, si dhe faktin se, gjithsesi kufomat e tyre u gjetën në të njëjtin vend në kanalën e Radoniqit, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se nëna dhe motra “S” u vranë nga ushtarë të UÇK-së. Këto rrethana si dhe veshja me të cilën u gjet motra “S” tregojnë se ajo nuk u vra gjatë luftimeve. Dëshmia e Dëshmitarit 4 përcakton se ajo është vranë jo më herët se fundi i prillit 1998. Për më tepër Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto krime kanë lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se viktimat nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën kur u kryen këto krime, dhe se kryesit ishin ose duhej të ishin të vetëdijshëm për këtë fakt.

240. Pas një farë kohe pasi ushtarët e UÇK-së morën nënën, disa burrat të armatosur dhe të maskuar, të veshur me uniforma të zeza dhe kamuflazh, një prej të cilëve ishte “Togeri”, thyen derën e shtëpisë së familjes, hynë brenda dhe morën me vete motrën “M”. Dëshmitari 19 dëshmoi se ajo po qante, se ia kishin lidhur duart pas shpine, dhe se “Togeri” e mbante nga një dorë. Kufoma e saj u gjet afërsisht pas katër ditësh në një pyll pranë fshatit Bardhaniq. Sipas Dëshmitarit 63, kjo ndodhi në verën e vitit 1998. Mbi bazën e këtyre dëshmimeve, Dhoma Gjyqësore është e bindur se burrat që erdhën në shtëpi ishin ushtarë të UÇK-së dhe se motra “M” vdiq gjatë periudhës së aktakuzës. Duke marrë parasysh mënyrën e dhunshme të marrjes së motrës “M” nga shtëpia, plagët e shkaktuara në trupin e saj, si dhe periudhën e shkurtër prej marrjes së saj nga ushtarët e UÇK-së deri ku u gjet e vdekur, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se motra “M” u vra nga ushtarët e UÇK-së. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore është e bindur se ky krim ka lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se motra “M” nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën kur u krye ky krim, dhe se kryesit ishin ose duhej të ishin të vetëdijshëm për këtë fakt.

241. Të tre të Akuzuarit akuzohen gjithashtu për trajtim mizor në këtë Pikë. Dhoma Gjyqësore konkludon se provat janë të pamjaftueshme për të përcaktuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se janë kryer akte të trajtimit mizor. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me këtë akuzë. Të tre të Akuzuarit akuzohen në Pikën 14 si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do ta trajtojë këtë lloj përgjegjësie veças në pjesën 7, më poshtë. Ndryshe Idriz Balaj akuzohet se ka kryer, planifikuar, nxitur, ose ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 14.

242. Dhoma Gjyqësore nuk disponon prova që Idriz Balaj të ketë kryer, planifikuar, apo nxitur kryerjen e këtyre tri vrasjeve. Dëshmitë tregojnë se “Toger”, siç e prezantoi veten, e shoqëroi motrën “S” disa herë kur u rekrutua nga UÇK-ja dhe pas rekrutimit, dhe se ai ishte gjithashtu i pranishëm kur morën nënën dhe motrën “M”. Siç u përmend më sipër, motra “S” u tha Dëshmitarëve 4 dhe 19 se kishte marrë disa urdhra nga “Togeri”. Dëshmitari 19 mësoi nga nëna se “Togeri” ishte Idriz Balaj. Disa dëshmitarë të tjerë në këtë çështje e lidhën gjithashtu “Togerin” me Idriz Balajn, dhe, dëshmitë e tyre përputhen në pohimin se Idriz Balaj mbante një uniformë të zezë dhe kishte një fare pozite në UÇK.¹²¹⁰ Edhe pse kuptimi i fjalës “Lieutenant” është “toger” në shqip, duke patur parasysh faktin se nuk ka dëshmi që gjatë periudhës së aktakuzës në zonën e Dukagjinit të ketë patur ndonjë person tjetër me këtë titull apo emër apo që t'i jenë drejtuar me këtë emër, Dhoma Gjyqësore konkludon se “Togeri” është Idriz Balaj. Roli i tij në shoqërimin e motrës

¹²¹⁰ Shemsedin Cekaj, T. 4394; P1213 (Ylber Haskaj, deklaratë, 5 nëntor 2007), paragrafi 14; Ylber Haskaj, T. 10339; P371 (Bogdan Tomash, deklaratë, 24 maj 2007), paragrafi 26; dhe dëshmi të tjera siç janë diskutuar në përfundimet për këtë Pikë dhe në pjesën 6.19.

“S” në rekrutinin e saj në UÇK dhe pas rekrutimit, si dhe në marrjen e nënës dhe motrës “M” nga shtëpia e tyre është një hallkë në zinxhirin e ngjarjeve që çuan në vrasjen e këtyre grave. Ky rol kontribuoi në vendosjen dhe mbajtjen e viktimave në afërsi të autorëve të këtij krimi. Dhoma Gjyqësore nuk mund të spekulojë në lidhje me rolin e mëtejshëm të Idriz Balajt në këtë ngjarje, nëqoftëse ka patur rol. Dhoma Gjyqësore vëren se rrethanat e këtyre tri vrasjeve karakterizohen jo vetëm nga ngjashmëri të dukshme por edhe nga dallime të qenësishme. Mungesa e dëshmive konkrete për rrjedhën e ngjarjeve pasi nëna dhe dy motrat ranë në duart e UÇK-së bën që shumica e Dhomës Gjyqësore, me përjashtim të mospajtimit të Gjykatësin Höpfel, të mos ketë një bazë të mjaftueshme për vlerësimin e mëtejshëm të lidhjes dhe rëndësisë së veprimeve të Idriz Balajt. Shumica konkludon se nuk ekzistojnë prova që tregojnë se Idriz Balaj, me vetëdije kontribuoi apo në kryerjen e ndonjëres prej këtyre vrasjeve meqenëse nuk ekzistojnë prova konkrete që tregojnë se në atë kohë Idriz Balaj kishte dijeni se ishin kryer apo do të kryheshin këto vrasje. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se Idriz Balaj duhet të shpallet i pafajshëm për akuzën e kryerjes, planifikimit dhe nxitjen e këtyre tri vrasjeve. Shumica arrin gjithashtu në përfundimin se Idriz Balaj duhet të shpallet i pafajshëm edhe për akuzën se ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e këtyre vrasjeve.

6.9 Trajtimi mizor dhe vrasja e Hajrullah Gashit dhe Isuf Hoxhës (Pika 16)

243. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor dhe vrasjen e Hajrullah Gashit dhe Isuf Hoxhës si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Ndryshe Ramush Haradinaj akuzohet se ka kryer, planifikuar, ose ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Siç shpjegohet në pjesën 2.1, Dhoma Gjyqësore ka vendosur të mos mbështetet në dëshminë e Dëshmitarit 8, dhe ka dëgjuar dëshmitë përkatëse të Radovan Zllatkoviçit si dhe dëshmitë mjekoligjore.

244. Më 6 korrik 1998, oficeri i MPB-së Dushan Dragoviç shkroi një raport mbi bazën e një interviste me Vendim Hoxhën lidhur me zhdukjen e babait të tij Isuf Hoxha më 26 qershor në rrugën midis Prizrenit dhe Suharekës.¹²¹¹ Radovan Zllatkoviç dëshmoi se i biri i Isuf Hoxhës e kishte informuar se babai i tij ishte rrëmbyer midis Prizrenit dhe Suharekës dikur në qershor apo korrik 1998 nga “terroristë shqiptarë”, dhe se ai kishte vdekur në korrik 1998.¹²¹² Radovan Zllatkoviç deklaroi se nuk e dinte se si e kishte marrë Vendim Hoxha këtë informacion.¹²¹³

¹²¹¹ P1181 (Raport i Degës së Krimeve të Policisë së MPB-së Gjakovës), f. 60.

¹²¹² Radovan Zllatkoviç, T. 6882, 6898.

¹²¹³ Radovan Zllatkoviç, T. 6898.

245. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Hajrullah Gashin dhe Isuf Hoxhën. Branimir Aleksandriqi¹²¹⁴ dëshmoi se kufomat me numër “R-22” dhe “R-23” u gjetën më 12 shtator 1998.¹²¹⁵ R-22 dhe R-23 u gjetën rreth 650 metra larg fillimit të rrjedhës së kanalit të Radoniqit, pranë njëra tjetrës (në një largësi prej rreth 4 metra), në pjesën e thatë të rrëpirës direkt mbi vijën e ujit.¹²¹⁶ Dushan Dunjiqi¹²¹⁷ dëshmoi se kufoma R-22 ishte mashkull i moshës 40 deri në 55 vjeç si dhe 166 deri në 175 centimetra i gjatë.¹²¹⁸ Autopsia zbuloi gjithashtu thyerje në kafkë dhe eshtrat e parakrahëve.¹²¹⁹ Ekzistonte mundësia, megjithëse shumë e pakët, që këto thyerje të jenë shkaktuar nga rënia në kanal.¹²²⁰ Autopsia zbuloi plagë, të cilat mund të jenë shkaktuar nga goditjet me një objekt jo të mprehtë.¹²²¹ Olga Gashi e identifikoi kufomën e Hajrullah Gashit, bazuar në veshjet dhe karakteristika fizike, duke përfshirë informacionin dentar që përputhej me kufomën: Hajrullah Gashi kishte humbur shumë dhëmbë gjatë jetës së tij.¹²²² Olga Gashi i tha dëshmitarit se Hajrullah Gashi ishte parë për herë të fundit më 24 qershor 1998 dhe se ajo kishte dëgjuar që atë e kishte rrëmbyer UÇK-ja.¹²²³ Kufoma R-23 ishte mashkull i moshës 50 deri në 60 vjeç si dhe 163 deri në 170 centimetra i gjatë.¹²²⁴ Autopsia zbuloi thyerje në brinjë, në eshtrën e ijes së majtë, si dhe në eshtra të gjymtyrëve të poshtëm.¹²²⁵ Mungonin eshtrat e kokës, qafës, trungut, dhe të gjymtyrëve të sipërm.¹²²⁶ Vendim Hoxha e identifikoi kufomën e Isuf Hoxhës, bazuar në veshjet, sendet personale, përfshirë një orë të zezë dixhitale, si dhe në karakteristikat fizike.¹²²⁷ Vendim Hoxha tha se Isufit i kishin rënë pothuajse të gjithë dhëmbët gjatë jetës; autopsia konstatoi se në kufomën R-23 mungonin të gjithë dhëmbët, pothuajse të gjithë dhëmbët kishin rënë gjatë jetës.¹²²⁸ Vendim Hoxha i tha ekipit mjekoligjor se Isuf Hoxha ishte zhdukur tri muaj më parë.¹²²⁹ Eshtrat e të dy kufomave iu dorëzuan të afërmve dhe u lëshuan vërtetime vdekjeje.¹²³⁰

246. Siç u përmend më sipër, Dhomës Gjyqësore i janë paraqitur dëshmi sipas të cilave Isuf Hoxha u zhduk më 26 qershor 1998 në rrugën midis Prizrenit dhe Suharekës, si dhe dëshmi sipas të

¹²¹⁴ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

¹²¹⁵ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 128-129, 203-204.

¹²¹⁶ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 164, 171-172, 175, 177-178, 184; Branimir Aleksandriqi, T. 6807-6808, 6810, 9585; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 1:57'46" - 1:57'56", nga 1:59'24" deri në 1:59'33"; P1115 (Shtojca C e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007, raporte të datës 15 dhe 16 shtator 1998), faqet 4, 10.

¹²¹⁷ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹²¹⁸ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 473; P730 (Raport i autopsisë R-22), f. 4.

¹²¹⁹ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 475; P730 (Raport i autopsisë R-22), faqet 1-2, 4.

¹²²⁰ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 476.

¹²²¹ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 477.

¹²²² P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 125, 478-483; P730 (Raport i autopsisë R-22), faqet 2, 5.

¹²²³ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 125; P730 (Raport i autopsisë R-22), f. 5.

¹²²⁴ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 490; P734 (Raport i autopsisë R-23), f. 4.

¹²²⁵ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 492; P734 (Raport i autopsisë R-23), faqet 2, 4.

¹²²⁶ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë, 8 qershor 2007), paragrafi 492; P734 (Raport i autopsisë R-23), f. 4.

¹²²⁷ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 494-498; P734 (Raport i autopsisë R-23), f. 2, 4-5; Dushan Dunjiqi, T. 7210.

¹²²⁸ P734 (Raport i autopsisë R-23), faqet 2, 4; P737 (Pyetësor për identifikim R-23), f. 10.

¹²²⁹ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 494.

¹²³⁰ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 484, 499; P635 (Vërtetime vdekjeje), faqet 15-18; P730 (Raport i autopsisë R-22), f. 5; P734 (Raport i autopsisë R-23), f. 5.

të cilave Hajrullah Gashi u pa për herë të fundit më 24 qershor 1998. Radovan Zlatkoviç dëshmoi se Vendim Hoxha i kishte thënë se Isuf Hoxha ishte rrëmbyer megjithëse ai nuk e dinte se si e kishte marrë Vendim Hoxha këtë informacion. Veç kësaj, në raportin e hartuar në atë kohë nga oficeri i MPB-së për personat e zhdukur, Vendim Hoxha citohet të ketë thënë se babai i tij ishte zhdukur pa gjurmë dhe mund të ishte rrëmbyer, meqenëse ishte anëtar i Partisë Socialiste të Serbisë, ai. Kjo sugjeron se Vendim Hoxha nuk kishte informacion konkret lidhur me çfarë i kishte ndodhur Isuf Hoxhës. Po kështu, nuk dihet burimi i informacionit të Olga Gashit, e cila i tha Dushan Dunjiçit se kishte dëgjuar që Hajrullah Gashi ishte rrëmbyer. Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në këto dëshmi të dorës së dytë pa burime të identifikuar dhe të pakonfirmuara lidhur me pretendimin e rrëmbimit të Isuf Hoxhës dhe Hajrullah Gashit. Gjatë pyetjeve kryesore për Dëshmitarin 8, Prokuroria synonte të tregonte se Hajrullah Gashi dhe Isuf Hoxha ishin së bashku në kohën kur, siç pretendohet, u rrëmbyen. Mirëpo në pjesën 2.1 më parë, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar përse nuk mund të mbështetet në dëshminë e Dëshmitarit 8.

247. Kufomat që pretendohet se u përkasin dy personave, të emërtuara “R-22” dhe “R-23”, u identifikuan me mjete tradicionale mbi bazën e informacionit të dhënë nga të afërmit për karakteristikat fizike të Hajrullah Gashit dhe Isuf Hoxhës, identifikimit të veshjeve të gjetura në kufomat, mungesës së dhëmbëve, dhe sendeve personale. Kufomat nuk janë identifikuar me provën e ADN-së. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi për identifikimin me mjete tradicionale të kufomave të tjera, që u hodh poshtë më pas nga prova e ADN-së,¹²³¹ çka lyp kujdes. R-22 u identifikua nga bashkëshortja e viktimës bazuar në teshat e gjetura në kufomë, si dhe karakteristikat fizike, si informacioni për dhëmbët. R-23 u identifikua nga Vendim Hoxha mbi bazën e teshave të gjetura në kufomë, karakteristikave fizike, dhe sendeve personale, ndër të cilat një orë e zezë dixhitale. Duke patur parasysh se identifikimet me mjete tradicionale nuk kanë qenë gjithnjë të sakta, si dhe duke shqyrtuar me kujdes rrethanat mbi bazën e të cilave u bë identifikimi i kufomave, Dhoma Gjyqësore vendos që në këtë rast të mos nxjerrë asnjë përfundim lidhur me identitetet e kufomave R-22 dhe R-23. Duke marrë parasysh faktin se Hajrullah Gashi dhe Isuf Hoxha nuk janë parë më, Dhoma Gjyqësore pranon se ka plotësisht të ngjarë që të dy këta persona të kenë vdekur. Provat mjekoligjore lidhur me R-22 dhe R-23 nuk mundësojnë një konkluzion jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se të vdekurit janë vvarë. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi të besueshme për keqtrajtimin e pretenduar apo përfshirjen e pretenduar të Ramush Haradinajt në këtë ngjarje. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë Pikë.

6.10 Trajtimi mizor dhe vrasja e Ilira dhe Tush Frrokajt (Pika 18)

248. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor dhe vrasjen e Ilira dhe Tush Frrokajt si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Ndryshe Idriz Balaj akuzohet se ka kryer, apo ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi përkatëse nga Dëshmitari 21, si dhe dëshmi mjekoligjore.

249. Dëshmitari 21 i pa Tush Frrokajn, shqiptar katolik, dhe bashkëshorten e tij, Ilira Frrokaj, për herë të fundit në Plançar, dikur në fund të gushtit 1998.¹²³² Sipas një raporti të Misionit Monitorues Diplomatik të Kosovës, çifti u zhduk më 26 gusht 1998.¹²³³ Nëna e Tush Frrokajt i tha Dëshmitarit se çifti ishte larguar nga Plançari rreth orës 13 apo 14 me makinën e familjes, një Opel Kadet në të kuqe të errët, në drejtim të Napolës, komuna e Pejës, ku, siç i tha Dëshmitarit e bija e Tush Frrokajt, ata donin t'i bënin një vizitë motrës së Ilira Frrokajt, Shqipe Krasniqit.¹²³⁴ Sipas Dëshmitarit 21, rruga kryesore nga Gjakovë në Pejë, përmes Deçanit, ishte nën kontrollin serb dhe, për këtë arsye, mendohej se ishte më e sigurtë po të udhëtohej për në Napolë nëpërmjet zonës së kontrolluar nga UÇK-ja.¹²³⁵

250. Vonë natën e së njëjtës ditë, Dëshmitari 21 u informua nga nëna e Tush Frrokajt se çifti nuk ishte kthyer në shtëpi.¹²³⁶ Të nesërmen familja njoftoi policinë e Gjakovës për zhdukjen e çiftit.¹²³⁷ Dëshmitari 21 dëgjoi nga kunati i Tush Frrokajt se Ilira dhe Tush Frrokaj nuk kishin mbërritur në Napolë.¹²³⁸ Në një tubim të familjes dy ditë pas zhdukjes, Haxhi Shinari, i cili e kishte njohur Tush Frrokajn që kur ishin fëmijë, e informoi dëshmitarin se e kishte parë çiftin teksa po udhëtonte me makinë në rrugën nga Plançari në drejtim të Dujakës rreth orës 14:00, ditën kur ata u zhdukën.¹²³⁹ Po atë ditë, Dëshmitari 21 takoi dy ushtarë të UÇK-së, një prej të cilëve i tha dëshmitarit se ishte anëtar i Shqiponjave të Zeza nën komandën e Idriz Balajt.¹²⁴⁰ Përpara zhdukjes së Ilira dhe Tush Frrokajt, Dëshmitari 21 nuk e njihnte Idriz Balajn, të cilit iu referua me emrin "Toger".¹²⁴¹ Gjatë kërkimeve të tij për Tush dhe Ilirë Frrokajn, dëshmitari u ndesh përballë dy herë me Idriz Balaj, por në të dy rastet ky i fundit nuk pranoi të fliste me të.¹²⁴² Pekka Haverinen dëshmoi se i kishte

¹²³¹ Shihni pjesën 6.1, më sipër.

¹²³² P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 2-9; Dëshmitari 21, T. 2736-2739, 2748, 2845; P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), Shtojca A (Fotografi e Ilira dhe Tush Frrokajt).

¹²³³ D67 (Raport i Misionit Monitorues Diplomatik i Kosovës për zhdukjen e Ilira dhe Tush Frrokajt, 8 shtator 1998).

¹²³⁴ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 9-11; Dëshmitari 21, T. 2849.

¹²³⁵ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 12-13; Dëshmitari 21, T. 2785-2786.

¹²³⁶ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 14.

¹²³⁷ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 17; Dëshmitari 21, T. 2740-2741, 2850.

¹²³⁸ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 16.

¹²³⁹ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 18-19, 24-27; Dëshmitari 21, T. 2740-2741, 2850; P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), Shtojca G (Hartë e shënuar nga Dëshmitari 21).

¹²⁴⁰ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 29, 31, 33, 51; Dëshmitari 21, T. 2630-2635, 2641, 2740, 2754, 2802-2803, 2862-2863.

¹²⁴¹ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 32; Dëshmitari 21, T. 2720-2722.

¹²⁴² P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 32; Dëshmitari 21, T. 2719-2720, 2853.

paraqitur tabela me fotografi Dëshmitarit 21 gjatë një interviste më 17 qershor 2004 dhe se dëshmitari e kishte njohur Idriz Balajn.¹²⁴³

251. Dy apo tri ditë pas zhdukjes së Ilirë dhe Tush Frrokajt, Dëshmitari 21 udhëtoi me dy ushtarë të UÇK-së për në postbllokun e UÇK-së në jug të Gramaqelit.¹²⁴⁴ Në detyrë ishin pesë ushtarë të veshur me uniforma të UÇK-së.¹²⁴⁵ Dëshmitari 21 njihte tre nga këta ushtarë me emër.¹²⁴⁶ Dy prej tyre i thanë Dëshmitarit se kishin qenë në detyrë kur Ilira and Tush Frrokaj kishin kaluar në postbllokun e tyre.¹²⁴⁷ Ata e informuan Dëshmitarin se kur ushtarët ndaluan makinën e Tush Frrokajt në postbllok, dy nga tre gratë që ishin në makinë dolën jashtë.¹²⁴⁸ Po këta dy ushtarë të UÇK-së i thanë Dëshmitarit se ata e kishin këshilluar Tush Frrokajn të mos kalonte përmes kësaj zone sepse dy apo tri ditë më parë ishte zhvilluar një ofensivë e madhe serbe dhe kalimi përmes këtij territori nuk ishte ende i sigurt.¹²⁴⁹ Të dy ushtarët i thanë Dëshmitarit 21 se u kujtohej që Tush Frrokaj kishte thënë “Jemi të gjithë shqiptarë” dhe se kishte këmbëngulur që të vazhdonte rrugën me makinë përmes zonës së Gramaqelit dhe Jabllanicës, komuna e Gjakovës, për në Nepolë. Ata e lejuan të vazhdonte rrugën.¹²⁵⁰

252. Në ditët e mëvonshme, ushtarët në postbllokun në të dalë të Gllogjanit, në rrugën që të çon në Gramaqel, i thanë Dëshmitarit 21 se personat që ishin në një Opel Kadet të kuq, që ishin, sipas ushtarëve, një grua e shëndoshë shtatshkurtër dhe një burrë trupmadh me flokë kaçurrel, u morën nga Idriz Balaj, u pyetën për gjysëm ore dhe më pas u lejuan të kalonin.¹²⁵¹ Dëshmitari 21 mësoi nga rojet në postbllokun në të dalë të Gllogjanit, në rrugën që të çon në Irzniq se makina nuk kishte kaluar përmes postbllokut të tyre.¹²⁵² Dëshmitari 21 nuk verifikoi nëse kishte ndonjë postbllok të UÇK-së në rrugën që të çon në Shaptej.¹²⁵³

253. Ditën e pestë, apo rreth kësaj dite, pas zhdukjes së Ilirë dhe Tush Frrokajt, një ushtar i UÇK-së i tregoi Dëshmitarit 21 për dy kufoma në kanalën e Radoniqit.¹²⁵⁴ Dëshmitari 21 dhe ushtari i UÇK-së shkuan fillimisht në shtabin e UÇK-së në Gllogjan pa njoftim paraprak.¹²⁵⁵ Dëshmitari hyri në oborr vetëm.¹²⁵⁶ Dëshmitari 21 pyeti një ushtar të UÇK-së se donte të takonte Ramush

¹²⁴³ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 47-52, f. 68-71; P63 (Tabelë e TPNJ-së me fotografi për identifikim në të cilën Dëshmitari 21 identifikoi dhe shënoi Idriz Balajn).

¹²⁴⁴ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 34-35; Dëshmitari 21, T. 2740-2741, 2754.

¹²⁴⁵ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 35-37; P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), Shtojca H (Simboli i UÇK-së).

¹²⁴⁶ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 36, 42; Dëshmitari 21, T. 2786-2787.

¹²⁴⁷ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 39; Dëshmitari 21, T. 2787.

¹²⁴⁸ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 40; Dëshmitari 21, T. 2787.

¹²⁴⁹ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 40; Dëshmitari 21, T. 2724, 2763-2766, 2773-2775, 2787-2789.

¹²⁵⁰ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 40.

¹²⁵¹ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 44-45, 47, 55-56; Dëshmitari 21, T. 2742, 2754-2761, 2768-2769; P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), Shtojca I (Hartë e shënuar nga Dëshmitari 21); D35 (Fotografi ajrore e fshatit Gllogjan).

¹²⁵² P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 40; Dëshmitari 21, T. 2761.

¹²⁵³ Dëshmitari 21, T. 2777-2780; D35 (Fotografi ajrore e fshatit Gllogjan).

¹²⁵⁴ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 49; Dëshmitari 21, T. 2742-2744, 2790.

¹²⁵⁵ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 51; Dëshmitari 21, T. 2742-2743.

¹²⁵⁶ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 52.

Haradinajn.¹²⁵⁷–Ramush Haradinaj nuk ishte i disponueshëm, kështu që dëshmitari u takua me vëllain e Ramush Haradinajt, Shkëlzen Haradinaj, i cili ishte veshur me uniformë të UÇK-së.¹²⁵⁸ Shkëlzen Haradinaj u shpreh skeptik që Idriz Balaj të kishte ndalur Ilirë dhe Tush Frrokajn për t'i pyetur dhe e siguroi dëshmitarin se UÇK-ja do t'i kërkonte dhe do t'i gjente po të ishin në territorin e UÇK-së.¹²⁵⁹ Shkëlzen Haradinaj kërkoi një fotografi të të dy personave të zhdukur, dhe në prani të dëshmitarit, lëshoi një dokument të shkruar me shkrim dore dhe të nënshkruar, i cili e lejonte dëshmitarin të qarkullonte në zonën e Dukagjinit.¹²⁶⁰ Dëshmitari 21 e përdori këtë dokument për të udhëtuar në territorin e kontrolluar nga UÇK-ja.¹²⁶¹ Pastaj Dëshmitari 21 dhe ushtari i UÇK-së, i cili e kishte informuar për kufomat, shkuan na kanalën e Radoniqit, ku ushtari i tregoi dëshmitarit dy kufoma në ujë, të cilat nuk ishin Ilira dhe Tush Frrokaj.¹²⁶² Më tej Dëshmitari 21 dhe ushtari i UÇK-së shkuan për të takuar Tahir Zemajn në Prapaqan, komuna e Deçanit i cili e siguroi dëshmitarin se do t'a ndihmonte t'i gjente të dy personat, gjallë apo vdekur, nëqoftëse ata ishin në territorin e UÇK-së.¹²⁶³

254. Ditën e gjashtë, apo rreth kësaj dite, pas zhdukjes, Dëshmitari 21 u kthye në shtabin e UÇK-së në Gllogjan me të njëjtin ushtar për t'u takuar për herë të dytë me Shkëlzen Haradinajn.¹²⁶⁴ Dëshmitari 21 i dha Shkëlzen Haradinajt një fotografi të personave të zhdukur dhe i kërkoi takim me Idriz Balajn, të cilin e kishte parë dhe njohur në oborr.¹²⁶⁵ Shkëlzen Haradinaj dërgoi dikë të thërriste Idriz Balajn, por Idriz Balaj u dërgoi fjalë se ishte i zënë.¹²⁶⁶ Pas takimit ata vendosën të ktheheshin në kanalën e Radoniqit, së bashku me një ushtar tjetër të UÇK-së që dëshmitari e kishte takuar më parë.¹²⁶⁷ Në Ratishë, me ata u bashkuan dhe tre ushtarë të UÇK-së të veshur me uniforma të UÇK-së. Një prej tyre tha se ishte pjesëtar i njësisë së Idriz Balajt.¹²⁶⁸ Në kanal, këta tre ushtarë të UÇK-së qëndruan në një kodër për të bërë roje.¹²⁶⁹ Së bashku me dy ushtarët e tjerë Dëshmitari 21 zbriti tek dy kufomat që kishte parë më parë në kanal.¹²⁷⁰ Dëshmitari vazhdoi të kontrollonte më tej me një nga ushtarët dhe pa më shumë se 30 kufoma në atë vend, por midis tyre ai nuk gjeti Ilira apo Tush Frrokajn.¹²⁷¹ Dëshmitari 21 nuk mundi të vazhdonte kërkimet e tij për Ilira dhe Tush Frrokajn pasi në zonë shpërthyen luftime midis forcave serbe dhe UÇK-së.¹²⁷²

¹²⁵⁷ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 52; Dëshmitari 21, T. 2781-2783.

¹²⁵⁸ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 53; Dëshmitari 21, T. 2780-2781.

¹²⁵⁹ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12pPrill 2007), paragrafi 53; Dëshmitari 21, T. 2783-2784.

¹²⁶⁰ P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafi 53; Dëshmitari 21, T. 2642, 2747, 2783-2784.

¹²⁶¹ Dëshmitari 21, T. 2641.

¹²⁶² P42 (Dëshmitari 21, deklaratë dëshmitari, 12 prill 2007), paragrafët 54, 57; Dëshmitari 21, T. 2616, 2625, 2627, 2745-2646, 2818.

¹²⁶³ Dëshmitari 21, T. 2629, 2637, 2744, 2718-2719, 2855.

¹²⁶⁴ Dëshmitari 21, T. 2641-2642, 2747.

¹²⁶⁵ Dëshmitari 21, T. 2643, 2747, 2720-2722, 2747, 2784-2785, 2853-2854.

¹²⁶⁶ Dëshmitari 21, T. 2643, 2784-2785.

¹²⁶⁷ Dëshmitari 21, T. 2641, 2644, 2802-2803.

¹²⁶⁸ Dëshmitari 21, T. 2641, 2644-2648, 2802-2803.

¹²⁶⁹ Dëshmitari 21, T. 2647-2648, 2653, 2803-2804.

¹²⁷⁰ Dëshmitari 21, T. 2648, 2651, 2804.

¹²⁷¹ Dëshmitari 21, T. 2648-2651, 2658-2660, 2668-2669, 2672-2678, 2696, 2699, 2701-2715, 2717; P45 (Fotografi ajrore e kanalit të Liqenit të Radoniqit); P46 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 21 shënoi rrugën që bëri); P47 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 21 shënoi vendin ku gjeti kufomat); P54 (Fotografi e Dëshmitarit 21 përpara fermës); P55 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 21 shënoi se ku hyri në ahurin e lopëve dhe nga doli prej tij);

255. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Ilira Frrokajn (kufoma me numrin “R-18”). Branimir Aleksandriqi¹²⁷³ dëshmoi se kufoma R-18 u gjet më 12 shtator 1998.¹²⁷⁴ Një Opel Kadet i kuq u gjet nën një ujëvarë në vendin ku pjesa e betonuar e kanalit bashkohet me pjesën natyrale të tij; makina ishte përmbys, pjesa e prapme ishte e djegur, dhe pranë saj dergjej kufoma e një femre.¹²⁷⁵ Të gjitha këto mbetje prej kufomës si dhe makina u emërtuan R-18 dhe mbetjet e kufomës u grumbulluan në një thes të vetëm.¹²⁷⁶ Prej proves së ADN-së nga KNPZh-ja u konkludua se kufoma me numrin R-18 ishte Ilira Frrokaj.¹²⁷⁷ Autopsia e kryer më 20 tetor 2005 zbuloi një vrimë të vogël sa vrima e një çelësi në eshtrën ballore të kokës, nga e cila dalloheshin thyerje të shumta të shtrira në krejt eshtrën ballore.¹²⁷⁸ Baza e kafkës ishte e copëtuar.¹²⁷⁹ Në pjesën e prapme të kafkës dalloheshin shenja djegieje.¹²⁸⁰ Plagët në vertebra përputheshin me plagë prej armëve të zjarrit.¹²⁸¹ U arrit në përfundimin se vdekja ishte shkaktuar nga plagët e shumta me armë zjarri në kokë dhe kraharor.¹²⁸² Dushan Dunjiqi¹²⁸³ dëshmoi se makina dhe kufoma me numër R-18 ishin pjesërisht të zhytura në ujë për shkak të shirave të rrëmbyer.¹²⁸⁴ Kufoma ishte veshur me një bluzë portokalli, cepat e së cilës ishin nxirë dhe shkruar.¹²⁸⁵ Autopsia e kufomës në shtator 1998 zbuloi thyerje në kafkë, vertebra, shpatullën e majtë, pjesën e sipërme të krahut të majtë, dhe në kërcirin e këmbës së majtë, si dhe një plagë me hyrje të cekët në pjesën e poshtme të këmbës së djathtë, me një plumb që pjesërisht kishte dalë nga këmba.¹²⁸⁶ Plumbi nuk kishte kaluar përmes indeve të buta të këmbës, dhe, për këtë arsye, dëshmitari arriti në përfundimin se plumbi e kishte humbur shpejtësinë e tij fillestare.¹²⁸⁷ Dëshmitari besonte se plumbi e kishte humbur shpejtësinë pasi kishte hasur në një pengesë të fortë,

P56 (Fotografi me bloqe betoni në të cilën Dëshmitari 21 shënoi pozicionet ku gjeti kufomat); P57 (Fotografi me pemë lajthish); P58 (Fotografi me pemë lajthish ku Dëshmitari 21 gjeti kufomën e një gruaje bionde); P59 (Fotografi me pemë lajthish ku Dëshmitari 21 gjeti kufomën në thesin e miellit); P60 (Fotografi me pemë lajthish ku Dëshmitari 21 gjeti kufomën e një gruaje me rroba civile); P61 (Fotografi e vendit ku Dëshmitari 21 gjeti kufomat e dy meshkujve); P62 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 21 shënoi vendin ku pa pesë deri në gjashtë kufoma).

¹²⁷³ Dëshmitari 21, T. 2750-2751.

¹²⁷⁴ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

¹²⁷⁵ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 128-129, 203-204.

¹²⁷⁶ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 31, 151, 153-157, 212; Branimir Aleksandriq, T. 6803, 9605; P64 (Fotografia e një makinë në rrëpirë); P414 (Fotografi të ndryshme), faqe 2, 9-10, 13; P416 (Fotografi të ndryshme), f. 6; P418 (Fotografi të ndryshme), faqet 10, 22; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 0:15'40" - 0:16'13", 1:22'35" - 1:23'02", 1:24'43" - 1:24'55", 1:31'14" - 1:32'06", 1:32'30" - 1:32'40", 1:34'50" - 1:40'06"; P714 (), f. 5-7, 9. Shihni gjithashtu P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 411; Dushan Dunjiq, T. 7252-7253; P72 (Filmim i vendeve në kanal in e Radoniqit, Fermës Ekonomija dhe Dashinoc, 8-10 shtator 1998), 14'35"-15'02", 20'29"-20'54", 28'05"-30'00"; P630 (Regjistër i zhvarimeve, 16 shtator 1998), f. 4; P710 (Fotografi të R-18), faqet 2-3; P714 (Fotografi të R-18), faqet 2, 4-11; D66 (Filmim i kanalit të Radoniqit dhe Hotelit Pashtrik, 12-19 shtator 1998), 36'24" - 38'03".

¹²⁷⁶ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 152, 158, 231; Branimir Aleksandriq, T. 6804; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 1:37'34" - 1:37'45".

¹²⁷⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 86.

¹²⁷⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 87-88.

¹²⁷⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 88.

¹²⁸⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 88.

¹²⁸¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 88.

¹²⁸² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, No. 89.

¹²⁸³ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹²⁸⁴ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 412.

¹²⁸⁵ P711 (Raport i autopsisë R-18), f. 3.

¹²⁸⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 418; Dushan Dunjiq, T. 7250-7252; P711 (Raport i autopsisë R-18), faqet 3-5.

¹²⁸⁷ Dushan Dunjiq, T. 7250-7251; P711 (Raport i autopsisë R-18), f. 1.

fakt që e bëri Dëshmitarin të arrinte në përfundimin se kufoma ka qenë në vendbagazh apo brenda makinës kur ndaj saj është hapur zjarr.¹²⁸⁸ Në makinë kishte vrime plumbash dhe pjesa e prapme e saj ishte djegur.¹²⁸⁹ Në kufomë kishte shenja djegieje dhe e tërë pjesa e prapme e ishte shkumbëzuar.¹²⁹⁰

256. Siç u përmend më sipër, Dëshmitari 21 i pa Ilira dhe Tush Frrokajt për herë të fundit në Plançar më 26 gusht 1998 ose rreth kësaj date. Dëshmi të dorës së dytë sugjerojnë se në orët e vona të po asaj dite ushtarë të paidentifikuar të UÇK-së e panë çiftin në një postbllok në jug të Gramaqelit dhe më vonë në një postbllok tjetër në të dalë të Gllogjanit, ku u morën në pyetje nga Idriz Balaj për rreth gjysëm ore dhe më pas u lejuan të kalonin. Makina e çiftit dhe trupi i Ilira Frrokajt u gjetën në kanalit e Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore tregon se vdekja e Ilira Frrokajt ishte shkaktuar nga plagë të shumta me armë zjarri, dhe se kufoma e saj ishte pjesërisht e djegur. Kjo sugjeron me forcë se ajo është vrarë. Eshtrat e Tush Frrokajt nuk janë gjetur, kështu që nuk ka dëshmi mjekoligjore që të sugjerojë se ai është vrarë. Duke patur parasysh se nuk ka dëshmi që dikush t'a ketë parë Tush Frrokajt që nga fundi i gushtit 1998, Dhoma Gjyqësore pranon se ka shumë të ngjarë që ai të ketë vdekur. Megjithatë, megjithëse Tush Frrokajt është parë për herë të fundit së bashku me Ilira Frrokajt, Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të arrijë në përfundimin, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, se ai është vrarë.

257. Në pjesën 6.1, sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti që në rrethinën e kanalit të Radoniqit është gjetur një kufomë nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar se kush e ka kryer vrasjen apo se me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Dëshmitë e dorës së dytë për postblloqet e UÇK-së dhe marrja në pyetje e Ilira dhe Tush Frrokajt sugjerojnë se ata janë parë për herë të fundit në territorin që ishte nën kontrollin e UÇK-së dhe se janë liruar nga UÇK-ja. Ndihma që i dhanë ushtarë dhe oficerë të ndryshëm të UÇK-së Dëshmitarit 21 për të hetuar fatin e çiftit bën krijon dyshimin se këta ushtarë apo oficerë mund të mos kenë patur dijeni për ndonjë krim të kryer ndaj çiftit. Mbi bazën e dëshmimeve Dhoma Gjyqësore nuk mund të përjashtojë mundësinë e arsyeshme që Ilira Frrokajt të jetë vrarë nga forca apo persona që nuk kanë patur lidhje me UÇK-në. Për këto arsye, si dhe duke supozuar se si Ilira po ashtu dhe Tush Frrokajt janë vrarë, Dhoma Gjyqësore konstaton se dëshmitë nuk janë të mjaftueshme për të konkluduar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, dhe nëse vrasjet u kryen kur këta persona mbaheshin në arrest prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi për përfshirjen e pretenduar të Idriz Balajt në vdekjen e Ilira apo Tush Frrokajt, apo në trajtimin mizor të tyre, siç pretendohet.

¹²⁸⁸ Dushan Dunjiq, T. 7250-7251.

¹²⁸⁹ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 419; P630 (Regjistër i zhvarrimeve, 16 shtator 1998), f. 4.

Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë Pikë.

6.11 Trajtimi mizor, torturimi dhe vrasja e Zenun Gashit, dhe Misin dhe Sali Berishës (Pika 20)

258. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor, torturimin dhe vrasjen e Zenun Gashit dhe Misin dhe Sali Berishës si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Përndryshe Idriz Balaj akuzohet se ka kryer, apo ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi përkatëse nga Dëshmitari 52, Vesel Dizdari, Sadri Selca, Avni Krasniqi, Dëshmitari 17 si dhe dëshmi mjekoligjore.

259. Dëshmitari 52 dëshmoi se Zenun Gashi ishte polic i dalë në pension në komunën e Pejës në vitin 1998.¹²⁹¹ Në fund të qershorit apo në fillim të korrikut 1998, pasi dëgjoji se policia serbe po largohej nga një fshat fqinj, familja e dëshmitarit dhe disa familje të tjera u përpoqën gjithashtu të largoheshin, por u kthyen kur e kuptuan se nga fshati po largohej vetëm policia, jo fshatarët.¹²⁹² Familja e dëshmitarit vendosi të largohej për shkak të frikës nga UÇK-ja.¹²⁹³ Po atë ditë tre persona të panjohur vizituan Zenun Gashin dhe i kërkuan armën dhe uniformën e tij të policisë.¹²⁹⁴ Dy prej burrave ishin të veshur me uniforma të zeza, ndërsa tjetri ishte i veshur me një uniformë kamuflazhi.¹²⁹⁵ Zenun Gashi u dha burrave pistoletën dhe uniformën e tij të policisë.¹²⁹⁶ Më 29 korrik 1998, dy burra të panjohur, të veshur me uniforma të zeza, erdhën në shtëpi dhe kontrolluan për armë dhe uniforma, por nuk gjetën gjë.¹²⁹⁷ Më 1 gusht 1998, rreth orës 11 paradite, tre burra që flisnin shqip erdhën me makinë në shtëpinë e dëshmitarit dhe thanë se ishin urdhëruar nga komandanti i tyre të merrnin me vete Zenun Gashin për rreth 20 minuta dhe pastaj do t'a kthenin përsëri.¹²⁹⁸ Dy nga burrat ishin po ata persona që kishin kontrolluar në shtëpi tri ditë më parë.¹²⁹⁹ Dëshmitari mësoi nga Zenun Gashi se një prej burrave ishte Vesel Dizdari, ndërsa tjetrit i drejtoheshin si Komandant Cergashi.¹³⁰⁰ Dy nga burrat ishin të veshur me rroba të zeza, ndërsa tjetri me uniformë kamuflazhi.¹³⁰¹ Pas dy-tri ditësh, disa persona të veshur me uniforma kamuflazhi të

¹²⁹⁰ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 421; Dushan Dunjiq, T. 7294-7295; P711 (Raport i autopsisë R-18), f. 5.

¹²⁹¹ Dëshmitari 52, T. 9624-9625.

¹²⁹² Dëshmitari 52, T. 9625-9634.

¹²⁹³ Dëshmitari 52, T. 9629-9634.

¹²⁹⁴ Dëshmitari 52, T. 9636-9638.

¹²⁹⁵ Dëshmitari 52, T. 9637.

¹²⁹⁶ Dëshmitari 52, T. 9636-9638.

¹²⁹⁷ Dëshmitari 52, T. 9639-9641.

¹²⁹⁸ Dëshmitari 52, T. 9635, 9640-9643.

¹²⁹⁹ Dëshmitari 52, T. 9641.

¹³⁰⁰ Dëshmitari 52, T. 9634-9636, 9646-9647.

¹³⁰¹ Dëshmitari 52, T. 9642.

gjelbra me simbolin e UÇK-së në mëngë dhe kapele erdhën për të marrë ilaçet e Zenun Gashit si dhe një xhakëtë.¹³⁰² Ata nuk ishin nga fshati i dëshmitarit.¹³⁰³ Pas 1 gushtit 1998, dëshmitari dhe familja e dëshmitarit shkuan dy-tri herë në shtabin lokal të UÇK-së për të pyetur për Zenun Gashin, por nuk patën asnjë rezultat.¹³⁰⁴

260. Vesel Dizdari, shqiptar nga Kosuriqi, komuna e Pejës,¹³⁰⁵ dëshmoi se pak kohë përpara 7 shtatorit 1998 Metë Krasniqi, të cilin dëshmitari e përshkroi si Komandant i Policisë Ushtarake të UÇK-së, iu afrua dhe i tha të shkonte në shtëpinë e Zenun Gashit në Kosuriq dhe të sillte Gashin në shkollën në Baran, komuna e Pejës.¹³⁰⁶ Vesel Dizdari veprroi sipas këtyre udhëzimeve dhe ia dorëzoi Zenun Gashin Metë Krasniqit.¹³⁰⁷ Pastaj dëshmitari u urdhërua nga Krasniqi që të kontrollonte në shtëpinë e Zenun Gashit për armë, por ai gjeti atje vetëm çizme ushtarake.¹³⁰⁸

261. Sadri Selca, oficer i zbulimit të FARK-ut i vendosur në Baran, komuna e Pejës,¹³⁰⁹ dëshmoi se Zenun Gashi, rom, kishte qënë koleg i tij në polici dhe se Zenun Gashi vazhdoi të punonte në polici edhe pas vitit 1990, kur dëshmitari ndërpreu punën në të.¹³¹⁰ Hera e fundit që dëshmitari e pa Zenun Gashin ishte në Baran, në një makinë me burra shqiptarë të veshur me uniforma kamuflazhi.¹³¹¹ Zenun Gashi ishte në gjëndje të mjeruar dhe e kishin rrahur.¹³¹² Zenun Gashi i kërkoi dëshmitarit ujë dhe dëshmitari i dha atij ujë.¹³¹³ Dëshmitari u kërkoi ushtarëve t'a lironin Zenun Gashin.¹³¹⁴ Ushtarët u përgjigjën duke thënë “ja ku e ke kolegun tënd,” dhe se dëshmitari do të pësonte të njëjtin fat dhe u larguan së bashku me Zenun Gashin.¹³¹⁵ Bashkëshortja e Zenun Gashit i tha dëshmitarit se Zenun Gashi ishte rrëmbyer nga një grup ushtarësh herët në mëngjes po atë ditë që dëshmitari e kishte parë në makinë në Baran.¹³¹⁶

262. Dëshmitari 17 dëshmoi se në fund të korrikut apo fillim të gushtit 1998, ai u informua nga dikush në shërbimin e sigurimit të brigadës së tretë se një civil i quajtur Zenun nga Barani, komuna e Pejës, ishte marrë nga Metë Krasniqi, polic ushtarak i UÇK-së.¹³¹⁷ Dëshmitari pyeti Din Krasniqin, komandantin e Metës, i cili i tha se Faton Mehmeti, shefi i policisë ushtarake të UÇK-së në Glllogjan (i cili, në bazë të vëzhgimeve të drejtpërdrejta të dëshmitarit, i raportonte drejtpërdrejt

¹³⁰² Dëshmitari 52, T. 9644-9645.

¹³⁰³ Dëshmitari 52, T. 9645.

¹³⁰⁴ Dëshmitari 52, T. 9643-9644.

¹³⁰⁵ P366 (Vesel Dizdari, deklaratë dëshmitari, 15 prill 2007), f. 1; Vesel Dizdari, T. 5954-5955.

¹³⁰⁶ P366 (Vesel Dizdari, deklaratë dëshmitari, 15 prill 2007), paragrafët 18-19.

¹³⁰⁷ P366 (Vesel Dizdari, deklaratë dëshmitari, 15 prill 2007), paragrafi 19.

¹³⁰⁸ P366 (Vesel Dizdari, deklaratë dëshmitari, 15 prill 2007), paragrafi 21.

¹³⁰⁹ Sadri Selca, T. 10858-10860, 10864.

¹³¹⁰ Sadri Selca, T. 10872. Shihni gjithashtu Avni Krasniqi, T. 10754.

¹³¹¹ Sadri Selca, T. 10873-10875, 10884.

¹³¹² Sadri Selca, T. 10874.

¹³¹³ Sadri Selca, T. 10873-10874, 10884.

¹³¹⁴ Sadri Selca, T. 10875.

¹³¹⁵ Sadri Selca, T. 10875.

¹³¹⁶ Sadri Selca, T. 10884.

¹³¹⁷ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 71; Dëshmitari 17, T. 7705.

Ramush Haradinajt), kishte urdhëruar që Zenuni të sillej në Glogjan.¹³¹⁸ Siç dëgjoi dëshmitari, pas ndërhyrjes së tij dhe të Din Krasniqit, Zenuni u lirua.¹³¹⁹ Më pas, Dëshmitari 17 mësoi se Zenuni ishte arrestuar përsëri. Ai pyeti Din Krasniqin, i cili bëri një gjest që donte të thoshte se Zenuni ishte vrarë.¹³²⁰

263. Luan Tetaj dëshmoi se dikur në qershor apo korrik 1998, tezja/halla e tij, Ajmone Berisha, nga Glogjani, komuna e Pejës, erdhi në shtëpinë e tij.¹³²¹ Ajo i tha Luan Tetajt se një ditë më parë, kur ishte kthyer nga tregu në shtëpi, bashkëshorti i saj Misin Berisha si dhe dy nga pesë djemtë e tyre, Xhevat dhe Salih Berisha, ishin zhdukur.¹³²² Ajo kishte pritur gjithë natën që ata të ktheheshin dhe më pas kishte shkuar tek Luan Tetaj pasi prania e paraushtarakëve serbë afër fshatit të saj nuk e lejonte të lëvizte në zonën përreth.¹³²³ Luan Tetaj doli për të kërkuar me tre burra, por jo më larg se 300-400 metra nga shtëpia dëgjoi zhurmën e automjeteve ushtarake dhe u kthye në shtëpi.¹³²⁴ Luan Tetaj nuk doli më për të kërkuar Xhevat Berishën apo vëllain dhe babain e tij.¹³²⁵ Dëshmitari nuk i pa më këta tre burra.¹³²⁶

264. Dhoma Gjyqësore dëgjoi gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Zenun Gashin (kufoma me numër "R-4"), Misin Berishën (kufoma me numër "R-3") dhe Sali Berishën (kufoma me numër "R-7"). Branimir Aleksandriqi¹³²⁷ dëshmoi se të tri kufomat u gjetën më 11 shtator 1998 në një fushë pranë kanalit, përgjatë anës së jashtme të murit prej betoni ku kishte shenja plumbash, së bashku me gjashtë kufoma të tjera.¹³²⁸ Kufoma R-4 u gjet në sipërfaqen pranë murit prej betoni.¹³²⁹ Prej proves së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-4 u identifikua si Zenun Gashi.¹³³⁰ Autopsia e kufomës e kryer më 8 dhjetor 2003, zbuloi një plagë me armë zjarri në kokë, sipas një trajektoreje nga e djatha në të majtë dhe nga lart poshtë.¹³³¹ Gjithashtu kishte thyerje në krahun e djathtë, në parakrahun e majtë, brinjë, dhe këmbën e djathtë të viktimës, të cilat mund të jenë shkaktuar nga plagë me armë zjarri.¹³³² U arrit në përfundimin se shkaku i vdekjes ishte një plagë shrapneli në kokë.¹³³³ Dushan Dunjiqi¹³³⁴ deklaroi se rreth qafës së kufomës R-4 u gjet një copë

¹³¹⁸ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 71; Dëshmitari 17, T. 7707.

¹³¹⁹ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 71; Dëshmitari 17, T. 7604.

¹³²⁰ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 72; Dëshmitari 17, T. 7707.

¹³²¹ P1236 (Luan Tetaj, deklaratë dëshmitari, 6 qershor 2007), paragrafët 5, 12-13.

¹³²² P1236 (Luan Tetaj, deklaratë, 6 qershor 2007), paragrafët 12-14.

¹³²³ P1236 (Luan Tetaj, deklaratë dëshmitari, 6 qershor 2007), paragrafi 13.

¹³²⁴ P1236 (Luan Tetaj, deklaratë dëshmitari, 6 qershor 2007), paragrafi 14.

¹³²⁵ P1236 (Luan Tetaj, deklaratë dëshmitari, 6 qershor 2007), paragrafët 14, 16.

¹³²⁶ P1236 (Luan Tetaj, deklaratë dëshmitari, 6 qershor 2007), paragrafët 15-16, 20.

¹³²⁷ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

¹³²⁸ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 61-62; P414 (Fotografi të ndryshme), f. 20; P416 (Fotografi të ndryshme), f. 3; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 18; P645 (Fotografi të ndryshme), f. 2; P649 (Fotografi të ndryshme), f. 2.

¹³²⁹ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 101-102; P418 (Fotografi të ndryshme), faqe 12, 15, numri 85, f. 20; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal, 0:04'44", 0:23'08"); P645 (Fotografi të ndryshme), f. 3; P648 (Fotografi të autopsisë së R-4), f. 2.

¹³³⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 36.

¹³³¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 37-38.

¹³³² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 38.

¹³³³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 39.

¹³³⁴ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

shiriti ngjitës me ngjyrë të verdhë.¹³³⁵ Duke u nisur nga gjendja fizike e shiritit ngjitës, ekipi mjekoligjor arriti në përfundimin se ky shirit ishte përdorur për t'i lidhur gojën viktimës.¹³³⁶ Autopsia zbuloi hyrjen e një plumbi në anën e poshtme majtas dhe plagën e daljes së plumbit në anën e sipërme, të djathtë të kafkës.¹³³⁷ Rë dy krahët ishin thyer në të njëjtin vend, në parakrahë.¹³³⁸

265. Prek proves së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-3 u identifikua si Misin Berisha.¹³³⁹ Autopsia e kufomës e kryer më 14 dhjetor 2005 zbuloi të paktën një plagë shkaktuar me armë zjarri në kokë si dhe plagë të tjera me armë zjarri në kraharor, shtyllën kurrizore, dhe kofshën e majtë.¹³⁴⁰ Raporti konkludoi se shkaku i vdekjes ishin plagët e shumta me armë zjarri në kokë, kraharor, bark, dhe gjymtyrë.¹³⁴¹ Dushan Dunjiqi¹³⁴² dëshmoi se një copë shiriti i verdhë ngjitës ishte gjetur pranë kufomës R-3, e ngjashme me shiritin e gjetur pranë R-4.¹³⁴³ Mbi bazën e gjendjes së shiritit ngjitës, ekipi mjekoligjor arriti në përfundimin se ky shirit ishte përdorur për t'i lidhur gojën viktimës.¹³⁴⁴ Autopsia zbuloi thyerje të shumta në kafkë dhe në nofullën e poshtme.¹³⁴⁵ Sipas Dunjiqit, thyerjet në kafkë ishin shkaktuar nga një send jo i mprehtë dhe nuk mund të ishin shkaktuar prej rënies nga bregu i kanalit.¹³⁴⁶

266. ZPZhK-ja arriti në përfundimin se kufoma me numër R-7 ishte e Sali Berishës.¹³⁴⁷ Autopsia e kufomës e kryer më 5 dhjetor 2005, zbuloi thyerje në pjesën e sipërme të krahut të majtë, në eshtrat e kofshave, si dhe në eshtrën e kërcirit të majtë, që mund të jenë përputhëse me thyerje që shkaktohen nga plagë me armë zjarri.¹³⁴⁸ Thyerjet në zonën e legenit përputheshin me lëndime që shkaktohen prej armëve të zjarrit.¹³⁴⁹ Autopsia arriti në përfundimin se ka shumë të ngjarë që shkaku i vdekjes ishin plagët e shumta me armë zjarri në trung dhe gjymtyrë.¹³⁵⁰ Dushan Dunjiqi¹³⁵¹ dëshmoi se autopsia e kryer në shtator 1998 zbuloi thyerje që kishin shkaktuar shkëputjen e eshtrave që mungonin nga skeleti, dhe, sipas Dunjiqit, këto thyerje nuk mund të ishin shkaktuar thjesht nga një rrëzim.¹³⁵²

¹³³⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 228; Dushan Dunjiq, T. 6837; P646 (Raport i autopsisë R-4), f. 2.

¹³³⁶ Dushan Dunjiq, T. 6837.

¹³³⁷ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 233; P646 (Raport i autopsisë R-4), faqet 2, 6; P648 (Photographs R-4), f. 3-4.

¹³³⁸ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 233-234; P646 (Raport i autopsisë R-4), faqet 3, 6; Dushan Dunjiq, T. 6839.

¹³³⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 32.

¹³⁴⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr.33-35.

¹³⁴¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 35.

¹³⁴² P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹³⁴³ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 212; Dushan Dunjiq, T. 6837; P811 (Fotografi e shiritit ngjitës), f. 2.

¹³⁴⁴ Dushan Dunjiq, T. 6837.

¹³⁴⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 220; P812 (Raport i autopsisë R-3), f. 2, 5.

¹³⁴⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 220.

¹³⁴⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 44.

¹³⁴⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 45-46.

¹³⁴⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 46.

¹³⁵⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 47.

¹³⁵¹ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹³⁵² P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 256; P655 (Raport i autopsisë R-7), f. 2, 6.

267. Siç u përmend më sipër, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi sipas të cilave Misin Berisha dhe dy djemtë e tij, Sali dhe Xhevat Berisha, u panë për herë të fundit në fshatin Gllogjan, komuna e Pejës, në qershor apo korrik 1998. Në shtator 1998, kufomat e tyre u zbuluan në kanalit të Radoniqit. Vrasja e pretenduar e Xhevat Berishës trajtohet në pjesën 6.12.10, më poshtë. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi nga Luan Tetaj, i cili, nga ana e tij, mësoi nga tezja/halla e tij, Ajmone Berisha, se burri i saj Misini dhe dy djemtë e tij, Sali dhe Xhevat Berisha, ishin zhdukur. Megjithatë, Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi lidhur me rrethanat e zhdukjes së tyre. Sipas Dëshmitarit 17, emri i Misin Berishës ishte në listën që iu dha atij gjatë një takimi më 12 korrik 1998 në shtëpinë e Din Krasniqit në Vranoc. Dhoma Gjyqësore e diskuton rëndësinë e kësaj liste në pjesën 7, më poshtë. Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundime mbi bazën e këtyre dëshmive lidhur me autorët e vrasjeve. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të konkluduar kush e kreu vrasjen, apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse një lidhje e tillë ka ekzistuar.

268. Dëshmia mjekoligjore sugjeron bindshëm se Misin dhe Sali Berisha u vranë. Edhe sikur të supozohet se ka ndodhur kështu, Dhoma Gjyqësore konstaton se dëshmitë e paraqitura nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, dhe nëse vrasja ndodhi kur viktimat mbaheshin në arrest prej UÇK-së. Nuk u pranua asnjë dëshmi në lidhje me pretendimin për keqtrajtimin e Misin dhe Sali Berishës. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se përsa u përket Misin dhe Sali Berishës të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë pikë.

269. Lidhur me Zenun Gashin, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se më 1 gusht 1998, atë e morën nga shtëpia e tij në Kosuriq. Zenun Gashi ishte polic në pension, i kombësisë rome. Vesel Dizdari, një nga të tre personat që mori Zenun Gashin, dëshmoi se atë e kishte urdhëruar Metë Krasniqi të merrte Zenun Gashin dhe t'a çonte në një shkollë në Baran. Sadri Selca dëshmoi se ditën kur Zenun Gashin e morën nga shtëpia e tij, ai e kishte parë atë së bashku me persona me uniformë në një makinë që shkonte në drejtim të Baranit, dhe se Zenun Gashin dukej se e kishin rrahur. Personat me uniformë u larguan me Zenun Gashin në makinë. Pas dy-tri ditësh, persona të veshur me uniforma të gjelbra kamuflazhi me simbolin e UÇK-së, shkuan në shtëpinë e Zenun Gashit dhe morën ilaçet e tij si dhe një xhakëtë. Dëshmitari 17 dëshmoi se rreth kohës kur Zenun Gashin e morën nga shtëpia e tij, atij i kishte thënë Din Krasniqi se një person me emrin Zenun, nga Barana, ishte arrestuar. U tha se Zenunin e kishin liruar. Por, më vonë, Zenuni u arrestua përsëri dhe u çua në Gllogjan. Kur Dëshmitari 17 pyeti Din Krasniqin për fatin e Zenunit, Din Krasniqi la të kuptohej se Zenuni ishte vrarë. Në kundërshtim me informacionin e dhënë nga Din Krasniqi, Zenun Gashi

ishite nga fshati Kosuriq dhe pasi e morën më 1 gusht 1998, Zenun Gashi nuk u kthye më në shtëpinë e tij. Për më tepër, sipas dëshmimeve, personat që morën Zenun Gashin deklaruan se do ta çonin në Baran, jo në Gllogjan. Megjithatë, Dhoma Gjyqësore gjykon se kjo nuk përjashton mundësinë që personi, të cilit iu referua Din Krasniqi në bisedën e tij me Dëshmitarin 17, të ishte Zenun Gashi. Sipas Dëshmitarit 17, emri i Zenun Gashit ishte në listën që iu dha atij gjatë një takimi më 12 korrik 1998 në shtëpinë e Din Krasniqit në Vranoc. Dhoma Gjyqësore diskuton rëndësinë e kësaj liste në pjesën 7, më poshtë.

270. Në shtator 1998, kufoma e Zenun Gashit u gjet në kanal in e Radoniqit. Autopsitë e kufomës së Zenun Gashit u kryen me largësi të konsiderueshme kohe midis tyre. Një autopsi u bë afërsisht 6 javë pas zhdukjes së tij, ndërsa dy autopsitë e tjera u kryen përkatësisht pas 5 deri në 7 vjet. Megjithëse të gjithë ekspertët mjekoligjorë gjetën një apo më shumë plagë plumbi në kokë, kur shqyrtuan shkakun e vdekjes, ata nuk ishin të një mendimi në përshkrimin që i bënë llojit të plumbit apo objektit që kishte shkaktuar plagët në kafkë. Dhoma Gjyqësore është në gjendje t'i vlerësojë dëshmitë mjekoligjore në kuadrin e të gjitha dëshmimeve lidhur me vdekjen e Zenun Gashit, pra: dëshminë lidhur me personat që erdhën në shtëpinë e tij, rrugën e përshkruar pasi e morën nga shtëpia, si dhe konstatimi i gjendjes së tij fizike pasi ishte arrestuar. Mbi bazën e atyre elementëve të konkluzioneve mjekoligjore për të cilat ekspertët janë të një mendimi, pavarësisht se nuk janë në një mendje për çdo hollësi, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ndaj Zenun Gashit u ushtrua trajtim mizor dhe, më pas, u vra kur mbahej në arrest prej UÇK-së. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto krime ishin të lidhura ngushtë me konfliktin në Kosovë, se Zenun Gashi nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën kur u kryen krimet, dhe se kryesit ishin ose duhej të ishin të vetëdijshëm për këtë fakt. Dëshmitë nuk vërtetojnë se Zenun Gashi u torturua. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi për përfshirjen e pretenduar të Idriz Balajt në këtë ngjarje. Të tre të Akuzuarit akuzohen në bazë të Pikës 20 si pjesëmarrës në një ndë marrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do ta trajtojë këtë formë përgjegjësie veças në pjesën 7, më poshtë.

6.12 Vrasjet lidhur me rrethinën e kanalit të Radoniqit (Pika 22)

6.12.1 Vrasja e Afrim Sylejmanit

271. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndë marrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Afrim Sylejmanit si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi nga Agim Sylejmani, si dhe dëshmi mjekoligjore.

272. Agim Sylejmani dëshmoi se forcat serbe ishin të pranishme në Gjakovë gjatë gjithë vitit 1998.¹³⁵³ Në vitin 1998 dëshmitari nuk pa prani të UÇK-së në qytet.¹³⁵⁴ Ai deklaroi se UÇK-ja ishte në fshatrat dhe malet përreth.¹³⁵⁵ Më 26 prill 1998, kur kishte rënë muzgu, dëshmitari dhe Afrim Sylejmani udhëtuan për në Gjakovë me makinën e Afrimit, Opel Corsa.¹³⁵⁶ Pasi u ndaluan në një postbllok serb në rrugën Pejë-Gjakovë, në hyrje të Gjakovës, Afrimi e çoi dëshmitarin në shtëpinë e tij.¹³⁵⁷ Afrimi i tha dëshmitarit se edhe ai do të shkonte në shtëpinë e vet, por pas mbërritjes në shtëpinë e tij dëshmitari nuk e di ku shkoi Afrimi.¹³⁵⁸ Kjo ishte hera e fundit që dëshmitari pa Afrimin.¹³⁵⁹ Rreth një javë më vonë motra e dëshmitarit i tha dëshmitarit se në shtëpinë e saj ishte strehuar bashkëshortja e Afrimit dhe fëmijët e saj, sepse Afrimi ishte larguar.¹³⁶⁰ Motra nuk i tha dëshmitarit se ku kishte shkuar Afrimi.¹³⁶¹ Duke u nisur nga fakti se në shtëpi mungonte edhe makina, Dëshmitari mendoi se Afrimi ishte larguar me makinën e tij.¹³⁶² Dëshmitari dëgjoi thashetheme se Afrimi ishte bashkuar me UÇK-në, megjithëse ai nuk i kishte thënë asnjëherë dëshmitarit se donte të bashkohej me UÇK-në.¹³⁶³ Më vonë bashkëshortja e Afrimit i tha dëshmitarit se Afrim ishte me UÇK-në.¹³⁶⁴

273. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Afrim Sylejmanin (kufoma me numër "R-28"). Branimir Aleksandriqi¹³⁶⁵ dëshmoi se më 15 shtator 1998 kufoma R-28 u gjet nën një shkëmb në ujë rreth 700 metra në rrjedhën e poshtme nga fillimi i rrëpirës.¹³⁶⁶ Prej proves së ADN-së nga KNPZh-ja u arrit në përfundimin se kufoma me numër R-28 ishte e Afrim Sylejmanit.¹³⁶⁷ Autopsia e kufomës e kryer më 8 dhjetor 2003 zbuloi një plagë shkaktuar me armë zjarri në kokë si dhe plagë të tjera me armë zjarri në anën e majtë të kraharorit si dhe në pjesën e sipërme të krahut.¹³⁶⁸ Nga autopsia u arrit në përfundimin se shkaku i vdekjes ishte një plagë e shkaktuar me armë zjarri në kokë.¹³⁶⁹ Dushan Dunjiqi¹³⁷⁰ dëshmoi se autopsia e kryer në shtator 1998 zbuloi thyerje të shumta në pjesën e parme të kafkës, ndoshta të shkaktuara prej një sendi jo të mprehtë.¹³⁷¹ Nëqoftëse nuk mjekohet, një plagë e tillë mund të shkaktojë vdekjen.¹³⁷²

¹³⁵³ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafi 5.

¹³⁵⁴ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafi 5.

¹³⁵⁵ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafi 5.

¹³⁵⁶ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafët 3-4, 9, 10.

¹³⁵⁷ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafët 11-12.

¹³⁵⁸ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafi 12.

¹³⁵⁹ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafët 9, 12.

¹³⁶⁰ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafi 13.

¹³⁶¹ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafi 13.

¹³⁶² P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafi 13.

¹³⁶³ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafët 7, 12, 14.

¹³⁶⁴ P1247 (Agim Sylejmani, deklaratë dëshmitari, 13 gusht 2006), paragrafi 16.

¹³⁶⁵ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

¹³⁶⁶ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 206-207, 209, 214; P753 (Fotografi të autopsisë R-28), f. 2-3; P1121 (Fotografi të R-28).

¹³⁶⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 102.

¹³⁶⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 104.

¹³⁶⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 105.

¹³⁷⁰ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹³⁷¹ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 542; P751 (Raport i autopsisë R-28), f. 2, 4.

274. Mbi bazën e dëshmimeve, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se më 26 prill 1998, Agim Sylejmani pa vëllain e tij, Afrim Sylejmanin, shqiptar kosovar, për herë të fundit kur Afrimi çoi me makinë Agimin në shtëpinë e këtij të fundit në Gjakovë. Rreth një javë më vonë ai mësoi se Afrim Sylejmani ishte zhdukur. Në shtator 1998, kufoma e Afrim Sylejmanit u gjet në një rrëpirë në pjesën e poshtme të rrjedhës së kanalit të Radoniqit. Dëshmitë mjekoligjore sugjerojnë se Afrim Sylejmani u vra. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore shpjegoi se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të konkluduar se kush e kreu vrasjen apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë dëshmi që Afrim Sylejmani të jetë mbajtur në arrest nga UÇK-së apo dëshmi lidhur me rrethanat e vrasjes apo kryesit. Përveç kësaj, dëshmitë nuk e bëjnë të qartë se përse Afrim Sylejmani, shqiptar kosovar, i cili mund të jetë bashkuar me UÇK-në, të ketë qënë objekt sulmi nga ana e UÇK-së.

275. Për këto arsye, edhe po të supozohet se Afrim Sylejmani u vra, Dhoma Gjyqësore konstaton se dëshmitë e paraqitura nuk e lejojnë të arrijë në përfundimin se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, apo nëse vrasja u bë kur personi mbahej prek UÇK-së. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë akuzë.

6.12.2 Vrasja e Rade Popadiqit

276. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndëmarje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Rade Popadiqit si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga disa dëshmitarë si dhe dëshmi mjekoligjore.

277. Rade Repiqi, komandant i një kompanie PJP në vitin 1998,¹³⁷² dëshmoi se Rade Popadiq ishte komandant i një toge PJP dhe Nikolla Jovanoviq ishte rreshter i MPB-së.¹³⁷⁴ Rreth datës 23 maj 1998, Rade Popadiq dhe Nikolla Jovanoviqi u nisën me një makinë civile të konfiskuar Opel Kadett nga njësia policore në Junik në drejtim të sekretariatit të MPB-së së Gjakovës për të marrë furnizimet ushqimore ditore për njësinë.¹³⁷⁵ Të dy burrat ishin të armatosur me një pistoletë dhe një pushkë automatike, por të veshur civilë dhe në një makinë civile për të mos rënë në sy.¹³⁷⁶ Ata morën furnizimet në Gjakovë dhe pastaj i raportuan për këtë me radio shtabit të tyre në Junik,

¹³⁷² P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 551.

¹³⁷³ Rade Repiq, T. 8487, 8536-8537.

¹³⁷⁴ Rade Repiq, T. 8504, 8509, 8517, 8575.

¹³⁷⁵ Rade Repiq, T. 8510-8512; P919 (Kallëzime Penale për sulmin kundër Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit), f. 6.

¹³⁷⁶ Rade Repiq, T. 8512-8513, 8565, 8574; P919 (Kallëzime Penale për sulmin kundër Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit), f. 6.

komuna e Deçanit.¹³⁷⁷ Të dy burrat u urdhëruan së pari të dorëzonin disa furnizime në Baballoq, komuna e Deçanit, dhe pastaj të vazhdonin rrugën e kthimit për në Junik.¹³⁷⁸ Kur këta dy persona ishin gati të niseshin për pjesën e fundit të udhëtimit prej dhjetë minutash nga Baballoq për në Junik, ata u lidhën me njësinë e tyre PJP në Junik.¹³⁷⁹ Të dy burrat kishin ndërruar makinën në Baballoq sepse Opel Kadett ishte prishur kështu që ata e vazhduan udhëtimin për në Junik me një furgon Micubishi me ngjyrë metalike të verdhë, e cila, sipas mendimit të dëshmitarit, ishte e pajisur me një targë të kaltër të Ministrisë së Brëndshme.¹³⁸⁰ Gjysëm ore më vonë burrat nuk ishin kthyer ende në Junik.¹³⁸¹ Kjo bëri që Rade Repiqi të dërgonte dy makina nga Juniku për në Baballoq për të kërkuar të dy burrat.¹³⁸² Ata kontrolluan vetëm përgjatë rrugës sepse Rade Repiq besonte se, si oficer me përvojë, Rade Popadiqi nuk do të kishte shkelur urdhrat e marra dhe të bënte ndonjë devijim gjatë rrugës.¹³⁸³ Më pas u dërgua një helikopter për të kontrolluar një zonë më të gjerë të Junikut dhe Baballoqit si dhe rrugët nga Deçani për në Gjakovë pasi kontrolli i terrenit nuk ishte i sigurtuar pa dislokimin e një njësi të madhe dhe pa një operacion të organizuar të hyrjes në terren.¹³⁸⁴ Në një raport kriminalistik të MPB-së të datës 28 shtator 1998 lexohet se pranë rrugës lokale në Strelc të Epërm, komuna e Deçanit, u gjet një furgon.¹³⁸⁵ Për të dy burrat nuk u gjet më asnjë gjurmë.¹³⁸⁶ Rade Repiqi shkoi për të inspektuar makinën në trupin e së cilës kishte vrima plumbi.¹³⁸⁷ Fotografitë e automjetit në raportin kriminalistik të MPB-së të datës 28 shtator 1998 tregojnë xhamin e përparmë të bërë shoshë nga plumbat si në anën e shoferit po ashtu dhe atë të udhëtarit.¹³⁸⁸ Të nesërmen, në rrugën ku ishin zhdukur Rade Popadiqi dhe Nikolla Jovanoviqi u sulmua dhe u plagos në këmbë komandanti i një skuadre policore, Miladin Novakoviqi. Sipas Novakoviqit, sulmi u krye nga UÇK-ja.¹³⁸⁹ Kjo ndodhi në kryqëzimin e Rastavicës, rreth 500-600 metra larg bazës së PJP-së në Baballoq, komuna e Deçanit.¹³⁹⁰ Si rezultat i këtyre dy incidenteve, më 25 maj 2007, në të dy anët e rrugës nga Juniku dhe Rastavica në drejtim të Deçanit u organizua dhe zhvillua një operacion “spastrues” për gjetjen e dy policëve të zhdukur dhe automjetit të tyre.¹³⁹¹

¹³⁷⁷ Rade Repić, T. 8513-8514.

¹³⁷⁸ Rade Repiq, T. 8513-8514; P919 (Kallëzime Penale për sulmin kundër Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit), f. 6.

¹³⁷⁹ Rade Repiq, T. 8514, 8516.

¹³⁸⁰ Rade Repiq, T. 8514-8515.

¹³⁸¹ Rade Repiq, T. 8516-8517.

¹³⁸² Rade Repiq, T. 8516-8517.

¹³⁸³ Rade Repiq, T. 8517.

¹³⁸⁴ Rade Repiq, T. 8518.

¹³⁸⁵ P919 (Kallëzime Penale për sulmin kundër Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit - Fotografitë të makinës së bërë shosh nga plumbat), f. 21.

¹³⁸⁶ Rade Repiq, T. 8520-8521.

¹³⁸⁷ Rade Repiq, T. 8521-8522, 8529-8530; P919 (Kallëzime Penale për sulmin kundër Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit - Fotografitë të makinës së bërë shosh nga plumbat).

¹³⁸⁸ P919 (Kallëzime Penale për sulmin kundër Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit - Fotografitë të makinës së bërë shosh nga plumbat), f. 19, Fotografitë 3, 4, 5.

¹³⁸⁹ Rade Repiq, T. 8518-8519.

¹³⁹⁰ Rade Repiq, T. 8518-8519.

¹³⁹¹ Rade Repiq, T. 8518, 8527, 8557-8558, 8560-8561.

278. Sipas katër intervistave të kryera nga RDB-ja, Rade Popadiqi dhe Nikolla Jovanoviqi u arrestuan nga UÇK-ja e komanduar nga Ramush Haradinaj, Nazim Haradinaj, dhe Idriz Balaj.¹³⁹² Sipas katër të dyshuarve që u pyetën, ata u çuan në bazën e UÇK-së në Gllogjan, ku u morën në pyetje dhe u torturuan.¹³⁹³ Pas kësaj ata u çuan në kanalën e Radoniqit ku u ekzekutuan.¹³⁹⁴

279. Në një raport të komandës së korpusit të Prishtinës për veprimet luftarake i datës 25 maj 1998 lexohet se më 24 maj 1998, rreth orës 14:30, Rade Popadiqi dhe Nikolla Radoviqi u rrëmbyen në rrugën Gjakovë–Junik, ndërkohë që po transportonin me makinë furnizime ushqimore për në postbllokun e Junikut.¹³⁹⁵

280. Radovan Zllatkoviqi dëshmoi se ai kreu hetime për zhdukjen e Rade Popadiqit, dhe hartoi një raport për incidentin në të cilin arriti në përfundimin se Rade Popadiqi dhe Nikolla Jovanoviqi ishin rrëmbyer nga një grup “terrorist” shqiptar në kryqëzimin e Rastavicës, komuna e Deçanit.¹³⁹⁶ Radovan Zllatkoviqi e mori këtë informacion nga pyetjet që u bëri shqiptarëve.¹³⁹⁷ Më pas ai theksoi se ky incident u dokumentua zyrtarisht gjatë marrjes në pyetje të një shqiptari, Nexhat Dervishaj.¹³⁹⁸ Sipas raportit të datës 26 maj 1998 për incidentin, Rade Popadiqi dhe Nikolla Jovanoviqi, të cilët ishin të armatosur dhe të veshur me rroba civile, u larguan nga dega policore më 24 maj 1998, në orën 7:30 të mëngjesit, dhe shkuan me një furgon Opel Kadett civil në Gjakovë për të marrë ushqime dhe më tej në Baballoq.¹³⁹⁹ Në raport gjithashtu pretendohet se ata u larguan nga dega policore në Baballoq në orën 10:30 të mëngjesit me një automjet Micubishi pa targa dhe se afër kryqëzimit që të çon për në Junik, shqiptarë të paidentifikuar i sulmuan, i rrëmbyen, dhe i çuan në drejtim të panjohur.¹⁴⁰⁰

281. Një raport i MPB-së i datës 4 qershor 1998 pohon se në shtëpinë e Ismail dhe Nasim Haradinajt në Gllogjan, komuna e Deçanit, ekzistonte një gjykatë nderi, ku gjykoheshin personat e dyshuar si spiunë serbe, të cilët nganjëherë ekzekutoheshin.¹⁴⁰¹ Sipas këtij raporti, të dy oficerët e kapur të policisë u dënuan dhe ekzekutuan nga një togë pushkatimi.¹⁴⁰² Zoran Stijoviqi dëshmoi se një raport i MPB-së më 6 gusht përmend se të dy policët e kapur në Deçan dhe të mbajtur në Jabllanicë, ishin Rade Popadiqi dhe Nikolla Jovanoviqi.¹⁴⁰³

¹³⁹² Rade Repiq, T.8531-8533; P921 (Deklarata lidhur me zhdukjen e Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit).

¹³⁹³ Rade Repiq, T.8531-8533; P921 (Deklarata lidhur me zhdukjen e Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit).

¹³⁹⁴ Rade Repiq, T.8531-8533; P921 (Deklarata lidhur me zhdukjen e Rade Popadiqit dhe Miladin Novakoviqit).

¹³⁹⁵ P858 (Raport i krimit për zhdukjen e Rade Podadiqit dhe Nikolla Jovanoviqit, 26 maj 1998).

¹³⁹⁶ P854 (Radovan Zllatkoviq, deklaratë, 25 qershor 2007), paragrafi 13; Radovan Zllatkoviq, T. 6885-6888; P858 (Raport i krimit për zhdukjen e Rade Podadiqit dhe Nikolla Jovanoviqit, 26 maj 1998).

¹³⁹⁷ Radovan Zllatkoviq, T. 6885-6888; P858 (Raport i krimit për zhdukjen e Rade Podadiqit dhe Nikolla Jovanoviqit, 26 maj 1998).

¹³⁹⁸ P854 (Radovan Zllatkoviq, deklaratë, 25 qershor 2007), paragrafi 13.

¹³⁹⁹ P858 (Raport i krimit për zhdukjen e Rade Podadiqit dhe Nikolla Jovanoviqit, 26 maj 1998).

¹⁴⁰⁰ P858 (Raport i krimit për zhdukjen e Rade Podadiqit dhe Nikolla Jovanoviqit, 26 maj 1998).

¹⁴⁰¹ P981 (Raport i krimit, 4 qershor 1998), faqja 4.

¹⁴⁰² P981 (Raport i krimit, 4 qershor 1998), faqja 4.

¹⁴⁰³ P931 (Deklarata e Zoran Stijoviqit, 27 shtator 2007), paragrafi 55; P1003 (Raport i krimit, 6 gusht 1998), faqja 1.

282. Dëshmitari 69, polic serb që shërbente gjatë periudhës së aktakuzës në MPB-në e Gjakovës,¹⁴⁰⁴ dëshmoi se dy nga kolegët e tij, Rade Popadiqi dhe Nikolla Jovanoviqi ishin rrëmbyer nga persona të panjohur në rrugën midis Gjakovës dhe Deçanit.¹⁴⁰⁵

283. HLC-ja, duke iu referuar zhdukjes së Rade Popadiqit dhe Nikolla Jovanoviqit raportoi se më 29 maj 1998 e përditshmja e Beogradit *Danas* kishte cituar burime policore në Kosovë sipas të cilave dy policë ishin zënë rob nga UÇK-ja dhe se kishte patur kontakte midis UÇK-së dhe policisë për kthimin e tyre në këmbim të furnizimeve me ushqime.¹⁴⁰⁶

284. Dëshmitari 74 dëshmoi se më 14 maj 1998, Rade Popadiq u dërgua me disa kolegë të MPB-së së Shabacit, Serbi, për në Kosovë në kuadrin e detyrave të tij të zakonshme.¹⁴⁰⁷ Më 23 maj 1998, Dëshmitari 74 foli me Rade Popadiqin për herë të fundit dhe Popadiqi i tha se ishte në Junik.¹⁴⁰⁸ Më 25 maj 1998, autoritetet e MPB-së së Shabacit informuan Dëshmitarin 74 se më 24 maj 1998 Rade Popadiqi dhe kolegu i tij Nikolla Jovanoviqi ishin zhdukur gjatë transportimit të ushqimeve me një furgon të hirtë nga Baballoqi për në Junik.¹⁴⁰⁹ Gjithashtu Dëshmitari 74 u informua se MPB-ja nuk kishte mundur të gjente asnjë gjurmë të furgonit apo të dy burrave.¹⁴¹⁰ Në fund të shtatorit apo në fillim të tetorit 1998, një zyrtar i MPB-së nga Deçani i tha Dëshmitarit 74 se furgoni i hirtë ishte gjetur në një kanal përgjatë rrugës së pashtruar në Strelc, komuna e Deçanit.¹⁴¹¹

285. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Rade Popadiqin (kufoma me numër "R-31"). Branimir Aleksandriqi¹⁴¹² dëshmoi se kufoma R-31 u gjet më 15 shtator 1998.¹⁴¹³ R-31 u gjet rreth 800 metra në pjesën e poshtme të rrjedhës nga ujëvara, në ujë, e ngecur nën një shkëmb.¹⁴¹⁴ Prej proves së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-31 u identifikua si Rade Popadiqi.¹⁴¹⁵ Autopsia e kufomës e kryer më 8 dhjetor 2003 zbuloi një plagë të shkaktuar me armë zjarri në kraharor, si dhe një plagë të mundshme të hyrjes së plumbit në anën e djathtë.¹⁴¹⁶ Kishte gjithashtu një plagë plumbi në pjesën e shpatullave.¹⁴¹⁷ Po ashtu thyerjet në anën e djathtë të fytyrës dhe thyerje të shumta dhe humbja e pjesës së prapme të kafkës përputheshin me një plagë të mundshme vdekjeprurëse me armë zjarri në kokë.¹⁴¹⁸ Shkaku i vdekjes u përcaktua

¹⁴⁰⁴ P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë dëshmitari, 20 qershor 2007), paragrafët 1-2; Dëshmitari 69, T. 9832-9833, 9846, 9848, 9892.

¹⁴⁰⁵ P1231 (Dëshmitari 69, deklaratë dëshmitari, 20 qershor 2007), paragrafi 29; Dëshmitari 69, T. 9846.

¹⁴⁰⁶ P6 (Spotlight Report Nr. 27, 5 gusht 1998), faqja 31.

¹⁴⁰⁷ P1243 (Dëshmitari 74, deklaratë dëshmitari, 14 nëntor 2007), paragrafi 2.

¹⁴⁰⁸ P1243 (Dëshmitari 74, deklaratë dëshmitari, 14 nëntor 2007), paragrafi 4.

¹⁴⁰⁹ P1243 (Dëshmitari 74, deklaratë dëshmitari, 14 nëntor 2007), paragrafi 5.

¹⁴¹⁰ P1243 (Dëshmitari 74, deklaratë dëshmitari, 14 nëntor 2007), paragrafi 5.

¹⁴¹¹ P1243 (Dëshmitari 74, deklaratë dëshmitari, 14 nëntor 2007), paragrafi 11.

¹⁴¹² P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

¹⁴¹³ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 206-207, 240, 242; P762 (Fotografi të autopsisë R31), f. 2-3.

¹⁴¹⁴ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 225, 228, 267; P449 (Fotografi të ndryshme), f. 59-60; P1115 (Shtojca C e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007, raporte të datës 15 dhe 16 shtator 1998), f. 5, 12.

¹⁴¹⁵ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 106.

¹⁴¹⁶ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 108.

¹⁴¹⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 108.

¹⁴¹⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 108.

plaga me armë zjarri në kraharor.¹⁴¹⁹ Dushan Dunjiqi¹⁴²⁰ dëshmoi se autopsia e kufomës e kryer në vitin 1998 zbuloi fraktura në eshtrën e kofshës së djathtë, në kafkë, dhe në brinjët e anës së djathtë.¹⁴²¹ Thyerjet në brinjë ishin të njëpasnjëshme dhe ndoshta ishin shkaktuar nga goditjet me një send jo të mprehtë.¹⁴²²

286. Siç u përmend më sipër, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se më 23 apo 24 maj 1998, Rade Popadiqi, komandant i PJP-ve, dhe Nikolla Jovanoviqi, rreshter i MPB-së, u zhdukën në rrugën midis Baballoqit dhe Junikut ndërsa ishin me detyrë të PJP/MPB-së. Në shtator 1998, kufoma e Rade Popadiqit u gjet në rrëpirën në rrjedhën e poshtme të kanalit të Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore arriti në përfundimin se Rade Popadiqi kishte plagë të shkaktuara me armë zjarri në kraharor si dhe thyerje në fytyrë dhe kafkë, që përputheshin me një plagë me armë zjarri në kokë. Megjithëse Dushan Dunjiqi deklaroi se thyerjet në anën e djathtë të brinjëve ishin shkaktuar nga goditjet me një objekt jo të mprehtë, një autopsi e kryer në vitin 2005 zbuloi plagë me armë zjarri në kraharor si dhe plagën e shkaktuar nga hyrja e plumbit në anën e djathtë. Shkaku i vdekjes u përcaktua plaga me armë zjarri në kraharor. Furgoni me të cilin po udhëtonte Rade Popadiqi u gjet më pas në Strellcën e Epërme. Fotografitë e automjetit me të cilin po udhëtonin të dy burrat tregojnë se xhami i përparmë është i bërë shosh nga plumbat si në anën e shoferit po ashtu dhe atë të udhëtarit. Ekzistojnë tre dokumenta të MPB-së që përmendin se Rade Popadiqi ishte rrëmbyer. Dokumenti i parë është një kallëzim penal i asaj kohe, i përpiluar nga Radovan Zlatkoviqi, me datë 26 maj 1998. Mirëpo nuk mund të verifikohen burimi dhe besueshmëria e informacionit në këtë dokument lidhur me rrëmbimin. Radovan Zlatkoviqi dëshmoi se ky informacion ishte marrë gjatë intervistimit të “shqiptarëve”, duke përmendur konkretisht Nexhat Dervishajn. Por nuk ekziston asnjë provë për marrjen e kësaj interviste. Dy raporte të tjera të MPB-së, në të cilat nuk përmendet burimi i informacionit, kundërshtojnë njëri-tjetrin. Në raportin e datës 4 qershor 1998 pohohet se Rade Popadiqi u ndalua dhe më pas u ekzekutua në Gllogjan, kurse në raportin tjetër të datës 6 gusht 1998 deklarohet se të dy policët ishin mbajtur në Jabllanicë. Zoran Stijoviqi dëshmoi se ishte fjala për Rade Popadiqin dhe Nikolla Jovanoviqin. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore nuk do të mbështetet në këto dokumenta për përcaktimin e fakteve. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi sipas të cilave UÇK-ja ngrinte rregullisht prita kundër MPB-së në rrugën kryesore rreth kohës kur u zhduk Rade Popadiqi.¹⁴²³ Rade Popadiqi ishte polic serb i armatosur dhe në detyrë. Mungesa e dëshmive bindëse për rrëmbim dhe vrasje jashtë luftimeve, dëmtimi i xhamit të përparmë të furgonit prej plumbave si dhe raportet mjekoligjore për plagët e pësuar nuk e lejojnë Dhomën Gjyqësore të arrijë në një përfundim jashtëj çdo dyshimi të arsyeshëm se Rade Popadiqi u vra apo

¹⁴¹⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 109.

¹⁴²⁰ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁴²¹ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 568; P760 (Raport i autopsisë R-31), f. 2, 4.

¹⁴²² P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 568; Raport i autopsisë f. 4.

¹⁴²³ Shihni pjesët 3.2 dhe 4.2, më sipër.

se nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën e vdekjes. Për këto arsye Dhoma Gjyqësore konkludon se të tre të Akuzuarit duhet të lirohen nga kjo akuzë.

6.12.3 Vrasja e Ilija Antiqit

287. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Ilija Antiqit si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga Momçillo dhe Jovanka Antiqi, si dhe dëshmi mjekoligjore.

288. Momçillo Antiqi, i biri i Ilija Antiqit, dëshmoi se ai jetonte në Lloçan, komuna e Deçanit, dhe se në fillim të vitit 1998 punonte si polic me orar të plotë në MPB-në e Deçanit.¹⁴²⁴ Në prill 1998, një ditë pas pashkëve ortodokse, pasi dëgjuan të shtëna armësh si dhe panë fishekë sinjalizues diku në drejtim të Prejlepit, dëshmitari dhe disa anëtarë të familjes së tij u larguan nga Lloçani për në Pejë, duke lënë në shtëpi babain e dëshmitarit, Ilija.¹⁴²⁵ Dëshmitari sqaroi se atyre nuk u tha askush të largoheshin.¹⁴²⁶ Edhe familje të tjera serbe në fshat u larguan ato ditë, duke lënë në shtëpi ndonjë të moshuar.¹⁴²⁷ Antiqi e vizitonte babain herë pas here për t'i sjellë ushqime.¹⁴²⁸ Ai u informua nga vëllai i tij për zhdukjen e babait në fund të korrikut 1998.¹⁴²⁹ Dëshmitari shpjegoi se vëllai i kishte thënë se “shqiptarët” (dëshmitari më pas i përshkroi ata si “fqinjë” të Ilija Antiqit) e kishin marrë atë nga oborri përpara shtëpisë natën e 28 majit 1998.¹⁴³⁰ Vëllai e kishte marrë këtë informacion nga motra e tij, e cila, nga ana e saj, e kishte mësuar këtë nga një i afërm tjetër, i cili e kishte dëgjuar këtë nga xhaxhai dhe halla e dëshmitarit në Lloçan, Gjorgje dhe Milosava Antiq.¹⁴³¹ Asnjë prej tyre nuk kishte qënë dëshmitar okular i incidentit.¹⁴³² Dëshmitari shtoi se elementë të këtij rrëfimi, si për shembull kush e mori babain e tij, mund të supozoheshin si të vërteta duke patur parasysh rrethanat e asaj kohe.¹⁴³³ Antiqit iu treguan dokumente si prova, sipas të cilave ditën kur u zhduk babai i tij, forcat e UJ-së u urdhëruan të sulmonin Lloçanin dhe rrethinën, herët në mëngjesin e 29 majit.¹⁴³⁴ Dëshmitari mohoi të ketë ndodhur një sulm i tillë, mirëpo në atë kohë dëshmitari ishte në spital në Beograd.¹⁴³⁵

¹⁴²⁴ Momçillo Antiq, T. 2402-2404, 2432.

¹⁴²⁵ Momçillo Antiq, T. 2409-2415, 2417.

¹⁴²⁶ Momçillo Antiq, T. 2435.

¹⁴²⁷ Momçillo Antiq, T. 2412-2417.

¹⁴²⁸ Momçillo Antiq, T. 2411.

¹⁴²⁹ Momçillo Antiq, T. 2424-2425, 2440-2441.

¹⁴³⁰ Momçillo Antiq, T. 2424-2425, 2428, 2443-2444.

¹⁴³¹ Momçillo Antiq, T. 2425-2428, 2440-2443.

¹⁴³² Momçillo Antiq, T. 2428.

¹⁴³³ Momçillo Antiq, T. 2428-2429.

¹⁴³⁴ Momçillo Antiq, T. 2473-2475; D34 (Vendim për Luftim, ku ndër objektivat e tjerë përmendet Lloçani, i nënshkruar nga Gjenerali Nebojsa Pavkoviq, 28 maj 1998).

¹⁴³⁵ Momçillo Antiq, T. 2475.

289. Jovanka Antiqi dëshmoi se një e afërm, e Milosava Antiqi, i kishte thënë se e kishte parë Ilija Antiqin për herë të fundit mbrëmjen e 28 majit 1998 kur ai ishte larguar nga shtëpia e saj në Lloçan pas një vizite.¹⁴³⁶ Milosava i tha gjithashtu dëshmitarit se atë mbrëmje në fshat kishte patur shumë të shtëna.¹⁴³⁷ Të nesërmen, Milosava shkoi në shtëpinë e Ilijas por e gjeti atë pa njeri, të mbyllur me çels, si dhe me dritat dhe televizorin të ndezur.¹⁴³⁸

290. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Ilija Antiqin (kufoma me numër “R-20”). Branimir Aleksandriqi¹⁴³⁹ dëshmoi se kufoma R-20 u gjet në kanalën e Radoniqit, 500 metra larg nga fillimi i pjesës natyrale të rrëpirës, përgjatë rrjedhës, prapa një liqeni të vogël, në pjesën e thatë të rrëpirës, një metër mbi vijën e ujit.¹⁴⁴⁰ R-20 ishte pjesërisht e mbuluar me baltë dhe pjesërisht me copa të mëdha guri argjilor.¹⁴⁴¹ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja u arrit në përfundimin se kufoma me numër R-20 është e Ilija Antiqit.¹⁴⁴² Nga autopsia e kryer më 20 tetor 2005 u arrit në përfundimin se viktimja kishte vdekur nga plagë të shumta me armë zjarri.¹⁴⁴³ Dushan Dunjiqi¹⁴⁴⁴ dëshmoi se autopsia e kufomës e kryer në shtator 1998 zbuloi thyerje në kafkë, nofullën e poshtme, brinjët në anën e majtë, qafën, të dy kërcinjët, dhe në dorën e majtë.¹⁴⁴⁵ Këto thyerje nuk mund të jenë shkaktuar nga ndonjë rrëzim apo pluskimi i kufomës nëpër rrjedhën e lumit.¹⁴⁴⁶

291. Mbi bazën e dëshmive, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se Ilija Antiqi u pa për herë të fundit në Lloçan më 28 maj 1998. Në shtator 1998, kufoma e tij u gjet në rrëpirën në rrjedhën e poshtme të kanalit të Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore sugjeron se Ilija Antiqi u vra. Në pjesën 6.1, sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i majftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi nga Momçillo Antiqi për personat që ishin përgjegjës për vdekjen e Ilija Antiqit. Mirëpo dëshmia e Momçillo Antiqit se Ilija Antiqin e rrëmbyen “shqiptarët” apo “fqinjët” e tij është e zbehtë dhe e pamjaftueshme për identifikimin e kryesve apo përkatësisë së tyre. Për më tepër, dëshmitë bazohen në thashetheme të shumëfishta dhe burimi origjinal, Gjorgje dhe Milosava Antiqi, nuk ishin dëshmitarë okularë të rrëmbimit të pretenduar. Milosava Antiqi e konfirmoi këtë

¹⁴³⁶ P337 (Jovanka Antiq, deklaratë dëshmitari, 17 korrik 2004), f. 1, paragrafët 2, 4.

¹⁴³⁷ P337 (Jovanka Antiq, deklaratë dëshmitari, 17 korrik 2004), paragrafi 5.

¹⁴³⁸ P337 (Jovanka Antiq, deklaratë dëshmitari, 17 korrik 2004), paragrafi 4.

¹⁴³⁹ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojcë A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojcë B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

¹⁴⁴⁰ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 4, 6, 164-165; Branimir Aleksandriqi, T. 6790-6791; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 1:46'17" - 1:46'19".

¹⁴⁴¹ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 164, 166-167, 170; Branimir Aleksandriqi, T. 6789-6790; P452 (Filmim i kufomës së gjetur në kanal), 1:45'22"- 1:46'04", nga 1:46'28" deri 1:53'30"; P724 (Fotografi të ndryshme), f. 2-3.

¹⁴⁴² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 90.

¹⁴⁴³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 93.

¹⁴⁴⁴ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁴⁴⁵ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 449; P722 (Raport i autopsisë R-20), f. 5.

kur i rrëfeu Jovanka Antiqit për incidentin. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në dëshminë e Momçillo Antiqit në lidhje personat që janë përgjegjës për vrasjen apo nëse Ilija Antiq mbahej në arrest prej UÇK-së në kohën e vdekjes së tij. Dëshmia e Jovanka Antiqit nuk ndihmon në identifikimin e kryesve. Fakti se Ilija Antiq ishte një nga serbët e pakët që mbetën në Lloçan në atë kohë dhe se i biri ishte polic në Deçan sugjerojnë, motiv të mjaftueshëm që ai të ishte cak i UÇK-së, sipas Prokurorisë.¹⁴⁴⁷ Mirëpo, një motiv i tillë nuk mund të kompensojë mungesën e dëshmive se çfarë i ndodhi Ilija Antiqit. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore ka marrë prova dokumentare për urdhërimin e forcave të UJ-se që të sulmonin fshatin rreth kohës kur ai u pa për herë të fundit i gjallë, si dhe dëshmi nga Jovanka Antiqi se në fshat ishin dëgjuar të shtëna të shumta natën midis 28 dhe 29 majit 1998.

292. Për këto arsye, si dhe duke supozuar se Ilija Antiq u vra, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të arrijë në një përfundim jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, apo nëse vrasja ndodhi kur viktima mbahej në arrest prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë akuzë.

6.12.4 Vrasja e Idriz Hotit

293. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Idriz Hotit si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi përkatëse nga Hajdar Hoti si dhe dëshmi mjekoligjore.

294. Hajdar Hoti, nga Dejna në komunën e Rahovecit, dëshmoi se u bashkua me UÇK-në në maj 1998.¹⁴⁴⁸ Në qershor apo korrik 1998, xhaxhai i dëshmitarit, Idriz Hoti, erdhi për të vizituar dëshmitarin në Dejnë.¹⁴⁴⁹ Idriz Hoti ishte rreth 63 vjeç në pranverën e vitit 1998.¹⁴⁵⁰ Idriz Hoti ishte martuar me një myslimane boshnjake dhe në vitin 1998 përkrahte si LDK-në po ashtu dhe UÇK-në.¹⁴⁵¹ Idriz Hoti tha se ishte rrahur dhe plaçkitur nga policia ushtarake serbe në një postbllok.¹⁴⁵² Policia ushtarake e akuzoi se po i çonte para dhe cigare UÇK-së dhe kërcënoi se do të vriste familjen e tij nëqoftëse nuk do të kthehej të nesërmen.¹⁴⁵³ Dëshmitari dëgjoji gjithashtu Idriz Hotin

¹⁴⁴⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 449.

¹⁴⁴⁷ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Prokurorisë, paragrafët 492, 496.

¹⁴⁴⁸ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafët 1-2.

¹⁴⁴⁹ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafët 3, 6.

¹⁴⁵⁰ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafi 3.

¹⁴⁵¹ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafët 3, 5.

¹⁴⁵² P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafët 7-8.

¹⁴⁵³ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafi 8.

t'i thoshte babait të dëshmitarit se donte të bashkohej me UÇK-në.¹⁴⁵⁴ Idriz Hoti e kaloi natën në shtëpinë e dëshmitarit dhe të nesërmen, rreth mesditës, u largua me biçikletën e tij.¹⁴⁵⁵ Idriz Hoti i tha dëshmitarit se do të shkonte në “zonën e Ramush Haradinajt” për t'u bashkuar me UÇK-në.¹⁴⁵⁶ Pastaj Idriz Hoti u largua në drejtim të Jabllanicës.¹⁴⁵⁷ Sipas dëshmitarit, në atë kohë zona midis Cermjanit, komuna e Gjakovës, dhe Jabllanicës, ishte nën kontrollin e UÇK-së dhe nën komandën e Ramush Haradinajt.¹⁴⁵⁸ Ditën që u largua Idriz Hoti, dëshmitari pa luftime midis forcave serbe dhe ushtarëve të UÇK-së diku midis Cermjanit dhe Sukës së Bekteshit.¹⁴⁵⁹ Në vitin 1999, pas luftës, Ali Hoti, një kushëri i afërt i dëshmitarit, i tha dëshmitarit se e pa Idriz Hotin për herë të fundit në korrik të vitit 1998 në Cermjan, duke shkuar në drejtim të Jabllanicës.¹⁴⁶⁰

295. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Idriz Hotin (kufoma me numër “R-13”). Branimir Aleksandriqi¹⁴⁶¹ dëshmoi se më 12 shtator 1998, kufoma R-13 u gjet në kanalën e Radoniqit, pasi më parë ishte hequr kufoma R-3 nga muri.¹⁴⁶² Pranë kufomës R-13 u gjetën tela me shtresë izoluese plastike të zezë, të ngjashme me ato të gjetura në fermën Ekonomija. Gjithashtu u gjet edhe një litar i përdredhur alpinistësh, rreth një centimetër i trashë, i lidhur në njërin anë në formën e një laku.¹⁴⁶³ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-13 u identifikua si Idriz Hoti.¹⁴⁶⁴ Nga autopsia e kufomës e kryer më 8 dhjetor 2003 u arrit në përfundimin se shkak i vdekjes ishte një plagë me armë zjarri në kokë/fytyrë.¹⁴⁶⁵ Dushan Dunjiqi¹⁴⁶⁶ dëshmoi se autopsia e kryer në shtator 1998 zbuloi se mungonin disa brinjë dhe në disa brinjë të tjera kishte thyerje, fakt që sugjeron një goditje traumatike rreth zonës së kraharorit. Në kafkë kishte gjithashtu dy thyerje të mëdha dhe vrima të shtaktuar mbase nga plumba.¹⁴⁶⁷

296. Siç u përmend më sipër, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi të drejtëpërdrejta dhe të dorës së dytë se Idriz Hoti ishte parë për herë të fundit në qershor apo korrik 1998, në zonën midis Dejnës dhe Cermjanit, siç u tha, duke shkuar në drejtim të Jabllanicës (që Dhoma Gjyqësore e kupton se është Jabllanica në komunën e Gjakovës). Në shtator 1998, kufoma e Idriz Hotit u gjet në kanalën e Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore sugjeron bindshëm se ai u vra. Në pjesën 6.1, më sipër,

¹⁴⁵⁴ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafi 9.

¹⁴⁵⁵ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafët 9-10.

¹⁴⁵⁶ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafi 11.

¹⁴⁵⁷ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafi 11.

¹⁴⁵⁸ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafi 12.

¹⁴⁵⁹ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2004), paragrafi 12.

¹⁴⁶⁰ P1232 (Hajdar Hoti, deklaratë dëshmitari, 24 tetor 2007), paragrafi 14.

¹⁴⁶¹ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

¹⁴⁶² P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 4, 6, 94, 97, 100, 128-129, 203-204; Branimir Aleksandriqi, T. 6766-6767; P452 (Filmim i gjetjes së e kufomës në kanal), 0:39'12" - 0:40'58".

¹⁴⁶³ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 97-98, 100; Branimir Aleksandriqi, T. 6743-6744, 6749-6750, 6769; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 32; P449 (Fotografi të ndryshme), f. 33; P690 (Fotografi të autopsisë R-13), f. 7. Shihni gjithashtu P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 352; P630 (Regjistër i zhvarrimeve, 16 shtator 1998), f. 2.

¹⁴⁶⁴ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 70.

¹⁴⁶⁵ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 73.

¹⁴⁶⁶ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë ndonjë provë se Idriz Hoti u mbajt në arrest prej UÇK-së apo lidhur me rrethanat e vrasjes ose vrasësit. Idriz Hoti ishte i martuar me një myslimane boshnjake dhe përkrahte LDK-në. Mirëpo ai përkrahte edhe UÇK-në dhe, përpara se ta shikonin për herë të fundit, ai kishte deklaruar synimin e tij për t'u bashkuar me UÇK-në. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se rreth kohës kur Idriz Hoti u pa për herë të fundit, Cermjani ishte nën kontrollin e UÇK-së dhe se në zonën e Cermjanit ka patur luftime midis UÇK-së dhe forcave serbe.¹⁴⁶⁸ Pak kohë para se t'a shikonin për herë të fundit, policia ushtarake serbe e kishte kërcënuar dhe rrahur. Edhe sikur Idriz Hotin ta kenë parë për herë të fundit në një territor të kontrolluar nga UÇK-ja, mbi bazën e dëshmimeve, Dhoma Gjyqësore nuk mund të përjashtojë mundësinë e arsyeshme që vrasjen ta kenë kryer forca apo persona të tjerë që nuk kanë patur lidhje me UÇK-në.

297. Për këto arsye, edhe po të supozohet se Idriz Hoti u vra, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të arrijë në një përfundim jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, apo nëse vrasja u krye kur viktima mbahej prej UÇK-së. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me këtë akuzë.

6.12.5 Vrasja e Kujtim Imerajt

298. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Kujtim Imerajt si shkelje e ligjeve ose zakonet e luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshminë përkatëse nga Dëshmitari 65, si dhe dëshmi mjekoligjore.

299. Dëshmitari 65 dëshmoi se në pranverën e vitit 1998 një burrë i quajtur Binak i tha se disa shqiptarë nga Glllogjani, komuna e Deçanit, kishin ardhur në Palabardhë, komuna e Gjakovës.¹⁴⁶⁹ Ata ishin të veshur civilë dhe e pyetën Binakun përse nuk i kishte thënë Dëshmitarit 65 dhe Kujtim Imerajt, rom, që të bashkoheshin me UÇK-në.¹⁴⁷⁰ Binaku iu përgjegj se nuk mund t'a bënte një gjë të tillë.¹⁴⁷¹ Rreth orës 1 apo 2 pasdite të po asaj dite, dëshmitari, Binaku, dhe Kujtim Imeraj

¹⁴⁶⁷ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 349; P688 (Raport i autopsisë R-13), f. 2, 6; P690 (Fotografitë R-13), f. 4-5.

¹⁴⁶⁸ P1138 (Branko Gajiq, deklaratë dëshmitari, 2 tetor 2007), paragrafi 13; P1142 (Raport i Komandës së Brigadës 549 të Motorizuar për komunën e Gjakovës në fillim të vitit 1998, 23 shkurt 1998), f. 1.

¹⁴⁶⁹ Dëshmitari 65, T. 8239-8240, 8242-8243, 8245.

¹⁴⁷⁰ Dëshmitari 65, T. 8240, 8243-8245.

¹⁴⁷¹ Dëshmitari 65, T. 8244.

udhëtuan nga Palabardha për në Novosellë, komuna e Gjakovës.¹⁴⁷² Arsyeja e largimit të tyre nga Palabardha ishte afrimi i forcave serbe nga drejtimi i Gjakovës.¹⁴⁷³ Ndërkohë që po largoheshin, dëshmitari pa ushtarë mbi katër apo pesë tanke që po përparonin drejt Palabardhës.¹⁴⁷⁴ Ai dëshmoi se pas dy javësh, siç i ishte thënë Binaku, rreth mesditës së 4 korrikut 1998, ai pa një grup njerëzish me afro shtatë apo tetë makina që po i afroheshin lagjeve të poshtme të Novosellës nga drejtimi i Dujakës dhe Gllogjanit.¹⁴⁷⁵ Një person në këtë grup ishte veshur me rroba të zeza dhe kishte një kapuç të zi mbi fytyrë, ndërsa të tjerët ishin të veshur me rroba civile.¹⁴⁷⁶ Ata ishin të armatosur me automatikë dhe flisnin shqip.¹⁴⁷⁷ Në kohën kur erdhën këta persona, Dëshmitari 65 dhe Binaku ishin në një oborr, ndërsa Kujtimi kishte dalë në rrugë për të blerë cigare.¹⁴⁷⁸ Personat që ishin në këtë grup e pyetën Dëshmitarin se ku gjendej një burrë me emrin Bashkim.¹⁴⁷⁹ Dëshmitari u përgjegj se nuk e dinte, dhe me të dëgjuar këtë përgjigje ushtarët e rrahën.¹⁴⁸⁰ Ata e rrethuan dhe i bërtisnin, “Përse qëndron këtu? Ke marrë anën e serbëve. Ti je magjup, jevg”.¹⁴⁸¹ Ata sollën Kujtimin nga rruga.¹⁴⁸² Dëshmitari i pa kur po goditnin Kujtimin me një qytë pushke dhe kur e futën në një makinë.¹⁴⁸³ Dëshmitari u tha të mos e merrnin Kujtimin, por ata e rrahën dëshmitarin derisa humbi ndjenjat.¹⁴⁸⁴ Sipas dëshmitarit, më pas grupi u largua me makinë së bashku me Kujtimin në drejtimin nga kishin ardhur.¹⁴⁸⁵ Më vonë, po atë ditë, Binaku i tha dëshmitarit se i kishte dëgjuar të thonin, “Do ta lirojmë Kujtimin kur të gjeni dhe të na sillni Bashkimin”.¹⁴⁸⁶ Që nga ajo ditë dëshmitari nuk ka dëgjuar asgjë për Kujtimin.¹⁴⁸⁷

300. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Kujtim Imerajn (pjesë kufome me numër “R-26” dhe “R-27A”). Branimir Aleksandriqi¹⁴⁸⁸ dëshmoi se më 12 shtator 1998, rreth 660 metra nga rrjedha e poshtme e kanalit të Radoniqit u gjetën një palë pantallona me eshtra këmbësh në to si dhe një xhaketë e zezë. Atyre iu caktua numri R-26.¹⁴⁸⁹ Më 12 shtator 1998, rreth 50 metra nga rrjedha nga R-26, u gjetën një xhaketë e zezë, dy eshtra kërcinjsh, një eshtër e shpatullës së majtë, si dhe një pjesë e shtyllës kurrizore, ndoshta me një pjesë të brinjëve që shtrihen

¹⁴⁷² Dëshmitari 65, T. 8242-8243, 8246-8247, 8302-8303.

¹⁴⁷³ Dëshmitari 65, T. 8305.

¹⁴⁷⁴ Dëshmitari 65, T. 8305-8307.

¹⁴⁷⁵ Dëshmitari 65, T. 8247, 8249, 8251, 8296.

¹⁴⁷⁶ Dëshmitari 65, T. 8251-8252, 8296-8297.

¹⁴⁷⁷ Dëshmitari 65, T. 8297.

¹⁴⁷⁸ Dëshmitari 65, T. 8249-8251, 8300.

¹⁴⁷⁹ Dëshmitari 65, T. 8249, 8251-8252, 8298.

¹⁴⁸⁰ Dëshmitari 65, T. 8249, 8298.

¹⁴⁸¹ Dëshmitari 65, T. 8299.

¹⁴⁸² Dëshmitari 65, T. 8248-8251.

¹⁴⁸³ Dëshmitari 65, T. 8299-8300.

¹⁴⁸⁴ Dëshmitari 65, T. 8248, 8251, 8298.

¹⁴⁸⁵ Dëshmitari 65, T. 8248, 8299-8300, 8303-8305.

¹⁴⁸⁶ Dëshmitari 65, T. 8300-8301.

¹⁴⁸⁷ Dëshmitari 65, T. 8301.

¹⁴⁸⁸ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

¹⁴⁸⁹ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 4, 6, 128, 164, 171, 197-198, 203-204; Branimir Aleksandriq, T. 9602; P415 (Fotografi të ndryshme), f. 6; P744 (Fotografi të autopsisë R-26), f. 2-3.

gjatë shtyllës kurrizore. Atyre iu caktua numri R-27.¹⁴⁹⁰ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja mbetjet skeletore me numrat R-26 dhe R-27A (pjesë e eshtrave R-27) u identifikuan si të Kujtim Imerajt.¹⁴⁹¹ Autopsia e këtyre mbetjeve e kryer më 20 tetor 2005 nuk zbuloi plagë qartësisht para vdekjes.¹⁴⁹² Për këtë arsye, shkaku i vdekjes nuk u përcaktua.¹⁴⁹³ Dushan Dunjqi¹⁴⁹⁴ dëshmoi se autopsia e kryer në shtator 1998 zbuloi një thyerje në eshtrat e kafkës.¹⁴⁹⁵

301. Siç u përmend më sipër, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi të besueshme nga Dëshmitari 65 se më 4 korrik 1998 një grup burrash të armatosur morën Kujtim Imeraj nga rruga në Novosellë, e rrahën, e futën me forcë në makinë, dhe pastaj u larguan së bashku me të në makinë. Kujtim Imeraj nuk u kthye në familjen e tij dhe askush nuk e pa më deri kur eshtrat e tij u gjetën në rrëpirën e rrjedhës së poshtme të kanalit të Radoniqit. Sipas dëshmisë mjekoligjore, shkaku i vdekjes së Kujtim Imerajt nuk mund të përcaktohej. Duke patur parasysh dëshmitë për rrëmbimin e tij, ka të ngjarë që ai të jetë vrarë dhe që vrasja të jetë bërë nga personat që e rrëmbyen apo gjatë kohës që ishte në duart e tyre. Dëshmitari 65 nuk i përcaktoi burrat e armatosur si persona që i përkasin një grupi apo organizate të caktuara. Për më tepër, ai dëshmoi se asnjë prej tyre nuk ishte veshur me uniformë ushtarake apo të mbante ndonjë simbol të UÇK-së. Megjithatë Dëshmitari 65 dëshmoi se grupi i burrave të armatosur erdhi nga drejtimi i Dujakës dhe Glllogjanit, kjo është e pamjaftueshme për të provuar se rrëmbyesit e kishin bazën në Glllogjan. Për më tepër, fakti se këta persona flisnin shqip dhe ishin të armatosur me pushkë automatike nuk është i mjaftueshëm për të identifikuar anëtarësinë apo përkatësinë e tyre në UÇK apo ndonjë grup tjetër. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar faktin se gjetja e një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen, apo se me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Dëshmitari 65 dëshmoi për një incident në pranverën e vitit 1998, gjatë të cilit disa shqiptarë iu afruan një personi të quajtur Binak dhe e pyetën përse nuk u kishte thënë Dëshmitarit 65 dhe Kujtim Imerajt të bashkoheshin me UÇK-në. Dëshmitari 65 dëgjoi për këtë incident nga Binaku. Mirëpo kjo dëshmi është e pamjaftueshme për përcaktimin e një lidhjeje midis këtyre shqiptarëve dhe personave të armatosur që rrëmbyen Kujtim Imerajn.

302. Për këto arsye, si dhe duke supozuar se Kujtim Imeraj u vra, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk janë të mjaftueshme që ajo të arrijë në përfundimin se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, apo nëse vrasja ka

¹⁴⁹⁰ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 128, 200, 201-204; Branimir Aleksandriq, T. 9602-9603, 9613-9614; P449 (Fotografi të ndryshme), f. 52, Fotografia më e ulët, f. 53; P747 (Raport i autopsisë R-27), f. 1-2; P749 (Fotografi të autopsisë R-27), f. 2-3; P1115 (Shtojca C e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007, raporte të dates 15 dhe 16 shtator 1998), f. 5, 11.

¹⁴⁹¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 98.

¹⁴⁹² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 99-100.

¹⁴⁹³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 101.

¹⁴⁹⁴ P618 (Dushan Dunjqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

ndodhur në kohën kur viktimat mbahej prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me këtë akuzë.

6.12.6 Vrasja e Nurije dhe Istref Krasniqit

303. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndë marrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Nurije dhe Istref Krasniqit si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi përkatëse nga Dëshmitari 62, Sadri Selca, Rrustem Tetaj, dhe Cufë Krasniqi, si dhe dëshmi mjekoligjore.

304. Dëshmitari 62 dëshmoi se më 9 ose 10 korrik 1998, Rrustem Tetaj, komandant në UÇK, i cili e prezantonte veten si zëvendës i Ramush Haradinajt, dhe Hazir Gjoci, kushëri i largët i Muharrem Gjocit (shih më poshtë), të shoqëruar nga shtatë apo tetë ushtarë të veshur me uniforma të zeza, shkuan në shtëpinë e familjes së Istref dhe Nurije Krasniqit në Turjakë, komuna e Pejës, për të parë Muhamet Krasniqin që ishte plagosur si dhe për të vepruar “si pajtues gjaqesh” për t’i dhënë fund gjakmarrjes ku ishte përfshirë familja Krasniqi.¹⁴⁹⁶ Sipas Dëshmitarit 62, familja ishte në gjak me familjen e Muharrem, Xhevdet, dhe Rexhep Gjocit si dhe me familjen e Brahim dhe Avdi Krasniqit, dajallarë të vëllezërve Gjoci.¹⁴⁹⁷ Dëshmitari dëshmoi për katër incidente lidhur me këtë gjak të familjes. Incidenti i parë ishte vrasja e Muharrem Gjocit më 27 gusht 1981.¹⁴⁹⁸ Incidenti i dytë ndodhi në vitin 1990.¹⁴⁹⁹ Në vitin 1992 apo 1993, Muhamet Krasniqi, i biri i Istref dhe Nurije Krasniqit, plagosi Avdi Krasniqin me sëpatë.¹⁵⁰⁰ Rreth gjashtë muaj pas këtij incidenti, Skënder Krasniqi, gjithashtu i biri i Istref dhe Nurije Krasniqit, qëlloi dhe plagosi Brahim Krasniqin me çifte gjutiet.¹⁵⁰¹ Incidenti i fundit ndodhi më 26 qershor 1998, një ditë pasi UÇK-ja vuri nën kontroll zonën rreth Turjakës dhe Brahim dhe Avdi Krasniqi u bënë komandantë të UÇK-së në këtë zonë. Në këtë incident Muhamet Krasniqi u qëllua dhe plagos në qafë pranë shtëpisë së familjes së tij.¹⁵⁰² Muhamet Krasniqi i tha dëshmitarit se kishte parë Brahim Krasniqin aty pranë, prapa disa ferrave, në kohën kur ndodhën të shtënat.¹⁵⁰³ Muhamet Krasniqi vdiq më 27 korrik 1998.¹⁵⁰⁴ Dëshmitari 62 dëshmoi se që nga viti 1992 deri në vitin 1998, dy apo tri familje, duke përfshirë Avdi dhe Brahim

¹⁴⁹⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 518; P742 (Raport i autopsisë R-26), f. 2, 4.

¹⁴⁹⁶ P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafët 4, 19-22; Dëshmitari 62, T. 5528, 5534-5535, 5604-5605, 5610-5611, 5617.

¹⁴⁹⁷ P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafët 7-14; Dëshmitari 62, T. 5555, 5559-5560, 5562-5563, 5591-5598.

¹⁴⁹⁸ P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafët 7-11; Dëshmitari 62, T. 5591-5593.

¹⁴⁹⁹ Dëshmitari 62, T. 5592, 5596.

¹⁵⁰⁰ P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafi 11; Dëshmitari 62, T. 5595-5596.

¹⁵⁰¹ P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafi 12; Dëshmitari 62, T. 5596.

¹⁵⁰² P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafi 14; Dëshmitari 62, T. 5597-5598, 5635.

¹⁵⁰³ P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafi 14; Dëshmitari 62, T. 5597, 5614.

¹⁵⁰⁴ P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafi 18; Dëshmitari 62, T. 5597.

Krasniqin, të shtyrë nga gjakmarrja midis familjeve, përhapën thashetheme në fshatin Turjakë sipas të cilave familja e Nurije dhe Istref Krasniqit ishte bashkëpuntore e serbeve.¹⁵⁰⁵

305. Në mesnatën e 12 korrikut 1998, Smajl Gashi dhe një grup prej katër ushtarësh me uniforma të zeza dhe simbolin e UÇK-së, të paktën tre prej tyre të armatosur, erdhën në shtëpinë e Istref dhe Nurije Krasniqit, duke thënë se ishin dërguar nga Rrustem Tetaj.¹⁵⁰⁶ Ata thanë se ishin urdhëruar të merrnin Istref dhe Nurije Krasniqin dhe t'i çonin në shtab në Gllogjan, komuna e Deçanit, dhe se do t'i kthenin përsëri të nesërmen në mëngjes.¹⁵⁰⁷ Dëshmitari i identifikoi uniformat e tyre të zeza si uniforma që përdreshin nga njësia e Togerit.¹⁵⁰⁸ Istref dhe Nurije Krasniqi u morën në një makinë fuoristrada të zezë dhe që nga ajo natë Dëshmitari nuk i pa më kurrë.¹⁵⁰⁹

306. Më 14 korrik 1998, Dëshmitari 62 u takua me Rrustem Tetajn në Llukë, komuna e Deçanit, për të pyetur për rrëmbimin e Istref dhe Nurije Krasniqit.¹⁵¹⁰ Rrustem Tetaj i tha dëshmitarit se nuk dinte asgjë për këtë rrëmbim. Por Dëshmitari 62 nuk e besoi.¹⁵¹¹ Po atë ditë, Dëshmitari 62 pyeti Din Krasniqin, komandant i UÇK-së i zonës së Vranocit, komuna e Pejës, se ku gjendeshin Istref dhe Nurije Krasniqi.¹⁵¹² Din Krasniqi u habit kur dëgjoi për rrëmbimin e tyre dhe tha se nuk besonte se ata ishin rrëmbyer. Ai premtoi se do të pyeste personat përkatës në shtabin e Gllogjanit si dhe komandantët e zonave të tjera.¹⁵¹³ Më 15 korrik 1998, dëshmitari shkoi për t'a takuar Din Krasniqin për herë të dytë. Atij iu tha se kishte dy versione lidhur me çka mund t'i kishte ndodhur Istref dhe Nurije Krasniqit.¹⁵¹⁴ Sipas versionit të parë, çifti ishte marrë në pyetje në shtabin e Gllogjanit dhe më pas ishte liruar në Irzniq, komuna e Deçanit.¹⁵¹⁵ Versioni i dytë ishte se ata ishin çuar në shtabin e Gllogjanit, por më pas pa dijeninë e shtabit, për shkak të gjakmarrjes familjare, ishin marrë prej andej prej dikujt dhe nuk kishte më informacione se ku gjendeshin aktualisht.¹⁵¹⁶ Dëshmitari besonte se versioni i dytë ishte i vërtetë.¹⁵¹⁷

307. Rrustem Tetaj dëshmoi se në Turjakë kishte dy gjakmarrje, një gjakmarrje midis dy familjeve me të njëjtin mbiemër Krasniqi si dhe një gjakmarrje midis familjes së një personi të quajtur Smajl Gashi dhe një familjeje tjetër.¹⁵¹⁸ Dikur në verën e vitit 1998, Tetaj shkoi në fshat për

¹⁵⁰⁵ Dëshmitari 62, T. 5563-5565, 5567-5569, 5573-5574, 5576-5577, 5621-5622, 5634-5635, 5637-5638.

¹⁵⁰⁶ Dëshmitari 62, T. 5531-5533, 5535-5537, 5540, 5622-5624.

¹⁵⁰⁷ Dëshmitari 62, T. 5533-5534, 5536-5537, 5540, 5545.

¹⁵⁰⁸ P345 (Dëshmitari 62, deklaratë dëshmitari, 12 qershor 2007), paragrafi 19; Dëshmitari 62, T. 5563.

¹⁵⁰⁹ Dëshmitari 62, T. 5538.

¹⁵¹⁰ Dëshmitari 62, T. 5540-5542, 5587, 5625-5626.

¹⁵¹¹ Dëshmitari 62, T. 5545, 5617, 5626-5627.

¹⁵¹² Dëshmitari 62, T. 5547-5548, 5631.

¹⁵¹³ Dëshmitari 62, T. 5548, 5554, 5631, 5633.

¹⁵¹⁴ Dëshmitari 62, T. 5549.

¹⁵¹⁵ Dëshmitari 62, T. 5549.

¹⁵¹⁶ Dëshmitari 62, T. 5549, 5555, 5590, 5630-5631, 5633.

¹⁵¹⁷ Dëshmitari 62, T. 5552, 5590.

¹⁵¹⁸ Rrustem Tetaj, T. 3784-3785.

t'i bindur familjet që të linin mënjanë kontradiktat midis tyre.¹⁵¹⁹ Ai tha se kishte lexuar në një libër të shkruar nga Tahir Zemaj se ai akuzohej për rrëmbimin e Istref Krasniqit.¹⁵²⁰

308. Sadri Selca, oficer zbulimi i FARK-ut,¹⁵²¹ dëshmoi se Naser Kuqi, korrieri i dëshmitarit, nga Juniku, komuna e Deçanit, i tha dëshmitarit se pleqtë me emrin Nurije dhe Istref Krasniqi, ishin marrë nga Rrustem Tetaj me një makinë.¹⁵²² Naser Kuqi e kishte dëgjuar këtë nga fshatarë në Turjakë, komuna e Pejës.¹⁵²³ Megjithëse në shënimet e tij zyrtare dëshmitari shkruan se Imer Krasniqin, banor i Turjakës, e morën për t'a pyetur për bashkëpunimin e tij me policinë serbe, Sadri Selca nuk besonte se Nurije dhe Istref Krasniqi bashkëpunonin me policinë serbe.¹⁵²⁴

309. Cufë Krasniqi, komandant në UÇK,¹⁵²⁵ dëshmoi se dikur para shtatorit 1998, Tahir Zemaj e pyeti nëse e dinte çfarë u kishte ndodhur Nurije dhe Istref Krasniqit.¹⁵²⁶ Zemaj i tha Cufë Krasniqit se për këtë çështje ishte caktuar komandanti i policisë ushtarake të UÇK-së, Fadil Nimani.¹⁵²⁷ Cufë Krasniqi i tha Zemajt që të pyeste oficerët e policisë ushtarake që patrullonin nëpër fshatra.¹⁵²⁸

310. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashat dëshmi mjekoligjore lidhur me Nurije Krasniqin (kufoma me numër "R-14") dhe Istref Krasniqin (kufoma me numër "R-15"). Branimir Aleksandriqi¹⁵²⁹ dëshmoi se kufomat R-14 dhe R-15 u gjetën më 12 shtator 1998.¹⁵³⁰ Në fund të murit prej betont të kanalit ndodhej një pirg zhavorri në anën e jashtme të murit.¹⁵³¹ Kur u hoq zhavorri u zbuluan kufomat R-14 dhe R-15.¹⁵³² Kufoma R-14 ishte në anën e majtë të shenjave të plumbave mbi murin prej betoni, ndërsa kufoma R-15 ishte në anën e djathtë të shenjave të plumbave.¹⁵³³ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma R-14 u identifikua si Nurije Krasniqi.¹⁵³⁴ Autopsia e kufomës e kryer më 5 dhjetor 2003 zbuloi thyerje në kafkë, që përputheshin me plagë të shkaktuara me armë zjarri, me vrimë hyrjeje nga pjesa e prapme e kokës.¹⁵³⁵ Kishte edhe thyerje të tjera që tregonin plagë të shkaktuara me armë zjarri në shpatullën e majtë dhe në krah.¹⁵³⁶ Autopsia përcaktoi se shkak i vdekjes ishte një plagë plumbi në kokë.¹⁵³⁷

¹⁵¹⁹ Rrustem Tetaj, T. 3783-3784.

¹⁵²⁰ Rrustem Tetaj, T. 3785.

¹⁵²¹ Sadri Selca, T. 10858-10860, 10864.

¹⁵²² Sadri Selca, T. 10867-10869, 10883; P1229 (Notë zyrtare hartuar nga Sadri Selca, 25 gusht 1998).

¹⁵²³ Sadri Selca, T. 10883.

¹⁵²⁴ Sadri Selca, T. 10870-10872, 10884-10885; P896 (Shënimet zyrtare të Sadri Selcës, pa datë), f. 8.

¹⁵²⁵ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), f. 1, paragrafi 1.

¹⁵²⁶ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 88; Cufë Krasniqi, T. 5726-5727.

¹⁵²⁷ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 88.

¹⁵²⁸ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 88.

¹⁵²⁹ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

¹⁵³⁰ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 128, 203-204.

¹⁵³¹ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 134; Branimir Aleksandriqi, T. 9553.

¹⁵³² P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 134-135; Branimir Aleksandriqi, T. 6772-6773, 9553; P449 (Fotografi të ndryshme), f. 34-35; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 1:05'03"- 1:12'05"; P694 (Fotografi të autopsisë R-14), f. 3-5.

¹⁵³³ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 136.

¹⁵³⁴ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 74.

¹⁵³⁵ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 75-76.

¹⁵³⁶ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 76.

¹⁵³⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 77.

Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-15 u identifikua si Istref Krasniqi.¹⁵³⁸ Autopsia e kufomës e kryer më 12 tetor 2005 zbuloi thyerje të shumta, ndër të cilat një thyerje për shkak të shtypjes, si dhe dëmtime në shtyllën kurrizore, brinjë, parakrah, dhe bërryl, disa prej të cilave përputhen me plagë plumbi.¹⁵³⁹ U arrit në përfundimin se shkak i vdekjes ishin plagë të shumta plumbi në kraharor.¹⁵⁴⁰ Dushan Dunjiqi¹⁵⁴¹ dëshmoi se autopsia e R-15 e kryer në shtator 1998 zbuloi thyerje në të dy eshtrat e parakrahëve, të cilat nuk mund të ishin shkaktuar nga një rrëzim poshtë në kanal.¹⁵⁴² Sipas dëshmitarit, ka më shumë të ngjarë që këto thyerje të jenë shkaktuar nga ndonjë goditje.¹⁵⁴³

311. Siç u përmend më sipër, Dëshmitari 62 dëshmoi se, rreth mesnatës së 12 korrikut 1998, një grup ushtarësh me uniforma të zeza dhe simbolin e UÇK-së erdhën në shtëpinë e Nurije dhe Istref Krasniqit në Turjakë dhe i morën me vete. Më tej Dëshmitari 62 dëshmoi se ushtarët thanë se ishin dërguar nga Rustem Tetaj, se ishin urdhëruar të merrnin çiftin dhe t'a çonin në Gllogjan, dhe se do t'i kthenin përsëri Nurije dhe Istref Krasniqin të nesërmen në mëngjes. Nurije dhe Istref Krasniqi nuk u kthyen më në shtëpinë e tyre. Sadri Selca dha dëshmi nga burime të shumta të dorës së dytë, të paidentifikuara të cilat implikonin Rustem Tetajn në marrjen e Nurije dhe Istref Krasniqit. Mirëpo Dëshmitari 62 dëshmoi se Rustem Tetaj kishte mohuar dhënien e një urdhri të tillë dhe vetë Rustem Tetaj dëshmoi se kishte lexuar më vonë në një libër se ai akuzohej për rrëmbimin e Istref Krasniqit. Sipas Dëshmitarit 62, Din Krasniqi, komandant i UÇK-së në zonën e Vranocit, premtoi se do të pyeste dhe më pas i tha Dëshmitarit 62 se ekzistonin dy versione të ndryshme lidhur me çfarë mund t'i kishte ndodhur çiftit. Sipas versionit të parë, çifti u mor në pyetje në shtabin e Gllogjanit dhe më pas u lirua në Irzniq. Sipas versionit të dytë, çifti u mor në pyetje në shtab në Gllogjan dhe më pas ishte marrë prej dikujt për arsye që kishin lidhje me një gjakmarrje. Pika e përbashkët e të dy versioneve është se Nurije dhe Istref Krasniqi u çuan në shtab në Gllogjan. Versionet nuk përputhen lidhur me çfarë ka ndodhur më pas. Cufë Krasniqi dha dëshmi të dorës së dytë për një hetim të UÇK-së së kryer nga Fadil Nimoni, komandant i policisë ushtarake të UÇK-së, lidhur me fatin e Nurije dhe Istref Krasniqit. Në shtator 1998, kufomat e tyre u gjetën pranë njëra tjetrës në kanalën e Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore sugjeron bindshëm se Nurije dhe Istref Krasniqi u vranë. Mbi bazën e dëshmimeve të mësipërme, Dhoma Gjyqësore është e bindur se ushtarë të UÇK-së morën Nurije dhe Istref Krasniqin nga shtëpia e tyre dhe i çuan në shtabin e UÇK-së në Gllogjan. Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Nurije dhe Istref Krasniqi u vranë kur mbaheshin nga UÇK-ja. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore është e bindur

¹⁵³⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 78.

¹⁵³⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 79-80.

¹⁵⁴⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 81.

¹⁵⁴¹ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁵⁴² P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 374; P697 (Raport i autopsisë R-15), f. 6.

se ky krim kishte lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se viktimat nuk merrnin pjesë aktive në luftime në kohën kur u krye krimi dhe se kryesit ishin ose duhej të ishin të vetëdijshëm për këtë fakt.

312. Dëshmitari 62 dëshmoi se ekzistonte një gjakmarrje midis familjes së Nurije dhe Istref Krasniqit dhe familjes së Avdi dhe Brahim Krasniqit, anëtarë të UÇK-së, të cilët përhapën thashetheme se Nurije dhe Istref Krasniqi ishin bashkëpunorë. Më 26 qershor 1998, sipas Dëshmitarit 62, Muhamet Krasniqi, i biri i Nurije dhe Istref Krasniqit, u plagos në qafë, një incident të cilin Dëshmitari 62 e lidhi me gjakmarrjen. Dëshmitë treguan se Rrustem Tetaj u përpoq të arrinte pajtimin e gjakut më 9 apo 10 korrik 1998. Siç thuhet në pjesën 7, më poshtë, Dëshmitari 17 dëshmoi se gjatë një takimi në shtëpinë e Din Krasniqit në Vranoc më 12 korrik 1998, atij i dhanë një listë ku përmendeshin “dy bashkëpunore femra Turjakë – Kosturiq”. Dëshmitë nuk vërtetuan se ishte fjala për Nurije dhe Istref Krasniqin. Dhoma Gjyqësore gjykon se provat nuk mundësojnë nxjerrjen e ndonjë përfundimi për arsyet e vrasjes së Nurije dhe Istref Krasniqit.

313. Të tre të Akuzuarit akuzohen për vrasjen e Nurije dhe Istref Krasniqit si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do t'a trajtojë këtë formë përgjegjësie në pjesën 7, më poshtë.

6.12.7 Vrasja e Zdravko Radunoviqit

314. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Zdravko Radunoviqit si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshminë përkatëse nga Dëshmitarja 68, si dhe dëshmi mjekoligjore. Dhoma Gjyqësore nuk ka pranuar deklaratatë të dhëna MPB-së nga rrëmbyes të pretenduar, për shkak të dyshimeve të forta për besueshmërinë e tyre. Për një diskutim të mëtejshëm për mospranueshmërinë e këtyre deklaratave, Dhoma Gjyqësore i referohet pjesës 2.1, më sipër.

315. Dëshmitarja 68 dëshmoi se e pa për herë të fundit Zdravko Radunoviqin, malazez, mëngjesin e 16 korrikut 1998, rreth orës 07:00 të mëngjezit.¹⁵⁴⁴ Ai i tha se po shkonte në punë si dhe do t'u bënte një vizitë disa kushërinjve në Gjakovë dhe Dobriq, komuna e Gjakovës, të cilët ishin sulmuar nga UÇK-ja para disa ditësh.¹⁵⁴⁵ Rreth orës 13:30, Dëshmitarja foli me Zdravko Radunoviqin për herë të fundit kur ai i tha në telefon se do të largohej nga Gjakova dhe se do të

¹⁵⁴³ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 374.

¹⁵⁴⁴ P1016 (Dëshmitarja 68, deklaratë dëshmitari, 9 tetor 2007), paragrafët 4, 6; Dëshmitarja 68, T. 9273.

¹⁵⁴⁵ P1016 (Dëshmitarja 68, deklaratë dëshmitari, 9 tetor 2007), paragrafët 6-7.

shkonte në fshatin Dobriq.¹⁵⁴⁶ Dëshmitarja kontaktoi MPB-në në Pejë rreth orës 21:00, kur Zdravko Radunoviçi nuk ishte kthyer në fshatin e tij, dhe ata i thanë se ishin informuar nga MPB-ja në Gjakovë në orën 18:00 se anëtarë të UÇK-së me uniforma kishin rrëmbyer Zdravko Radunoviçin në fshatin Dujakë, komuna e Gjakovës.¹⁵⁴⁷ Në shtator 1998, zyrtarë të MPB-së në Gjakovë i thanë dëshmitarëve se kishin arrestuar Lek dhe Krist Përvorfin, dy anëtarë të UÇK-së nga Dujaka të cilët kishin rrëmbyer Zdravko Radunoviçin në Dujakë.¹⁵⁴⁸ Zyrtarët e informuan gjithashtu dëshmitaren se të dy burrat ia kishin dorëzuar Zdravko Radunoviçin komandantit të tyre me emrin “Vuk”, dhe se më pas Zdravko Radunoviçi e kishin çuar në Gllogjan, komuna e Deçanit, ku komandant ishte Ramush Haradinaj.¹⁵⁴⁹ Në janar 1999, MPB-ja në Pejë i tha dëshmitares se Lek dhe Krist Përvorfi kishin deklaruar se Zdravko Radunoviçi ishte vrarë dhe se kufoma e tij ishte hedhur në Liqenin e Radoniqit.¹⁵⁵⁰

316. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekologjore lidhur me Zdravko Radunoviçin (kufoma me numër “R-8/1”). Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja pjesët e kufomës me numër R-8/1 u identifikuan si të Zdravko Radunoviçit.¹⁵⁵¹ Autopsia e kryer më 5 dhjetor 2003 bëri një përshkrim të një kufome jo të plotë, tërësisht të skeletizuar dhe të zbrërthyer.¹⁵⁵² Shkaku i vdekjes nuk mund të përcaktohej.¹⁵⁵³ Dushan Dunjiqi¹⁵⁵⁴ dëshmoi se mbetja skeletore R-8/1 nuk ishin të plota, mungonin shumë eshtra.¹⁵⁵⁵ Eshtrat ishin vendosur gabimisht në të njëjtën thes me kufomën R-8.¹⁵⁵⁶ Në atë pjesë të kafkës që u gjet dukej gjurma e daljes së një plumbi.¹⁵⁵⁷

317. Siç u tha më sipër, Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi të drejtpërdrejta sipas të cilave Zdravko Radunoviçi u pa për herë të fundit mëngjesin e 16 korrikut 1998 kur u nis për në punë, dhe me atë u kontaktua për herë të fundit në një bisedë telefonike në orën 13:30 po atë ditë, kur tha se po largohej nga Gjakova për në Dobriq. Pas kësaj MPB-ja informoi Dëshmitaren 68 se Zdravko Radunoviçi ishte rrëmbyer nga ushtarët e UÇK-së në Dujakë, se ishte transferuar në Gllogjan, ishte vrarë, dhe kufoma e tij ishte hedhur në Liqenin e Radoniqit. Rrëfimi i dorës së dytë i Dëshmitares 68 është e vetmja dëshmi që disponon Dhoma Gjyqësore për rrëmbimin e pretenduar dhe ngjarjet që ndodhën pas tij. Në këtë dëshmi nuk përmendet se nga mësoi MPB-ja për rrëmbimin. Për më tepër, ajo bazohet në shumë thashetheme dhe Dëshmitarja 68 nuk përcakton burimin e

¹⁵⁴⁶ P1016 (Dëshmitarja 68, deklaratë dëshmitari, 9 tetor 2007), paragrafi 8.

¹⁵⁴⁷ P1016 (Dëshmitarja 68, deklaratë dëshmitari, 9 tetor 2007), paragrafët 10-11.

¹⁵⁴⁸ P1016 (Dëshmitarja 68, deklaratë dëshmitari, 9 tetor 2007), paragrafët 12, 14-16; Dëshmitarja 68, T. 9265-9268, 9273-9274.

¹⁵⁴⁹ Dëshmitarja 68, T. 9267-9268.

¹⁵⁵⁰ Dëshmitarja 68, T. 9266-9267, 9269, 9271-9272.

¹⁵⁵¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 52.

¹⁵⁵² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nos 53-54.

¹⁵⁵³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 55.

¹⁵⁵⁴ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁵⁵⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 278; P665 (Fotografi të R-8 dhe R-8/1).

¹⁵⁵⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 276; P659 (Raport i autopsisë R-8), f. 1; P662 (Fotografi të R-8 dhe R-8/1); P663 (Raport i autopsisë R-8/1), f. 1.

informacionit. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore nuk do të mbështetet në rrëfimin e dorës së dytë të Dëshmitares 68 për rrëmbimin e pretenduar dhe ngjarjet e mëtejshme. Në shtator 1998, kufoma e Zdravko Radunoviqit u gjet në kanalën e Radoniqit.

318. Megjithëse autopsia e kryer më 5 dhjetor 2003 nuk mundi të përcaktonte shkakun e vdekjes së Zdravko Radunoviqit, raporti i autopsies prej Dunjiqit në vitin 1998 përmend gjurmën e daljes së plumbit në atë pjesë të kafkës që u gjet. Edhe po të supozohet se Zdravko Radunoviq u vra, duhet të vërtetohet përfshirja e UÇK-së për të provuar vërtetësinë e akuzave të paraqitura në këtë Pikë. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është në vetvete i mjaftueshëm për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen, apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Fakti që Zdravko Radunoviq shkoi për të vizituar të afërm në Dobriq, pasi ata ishin sulmuar prej UÇK-së para disa ditësh, nuk përcakton në masë mjaftueshme midis zhdukjes së tij dhe UÇK-së. Siç është shpjeguar më sipër, Dhoma Gjyqësore nuk do të mbështetet në rrëfimin e dorës së dytë të Dëshmitares 68 për rrëmbimin e pretenduar dhe ngjarjet e mëtejshme. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk mundësojnë nxjerrjen e një përfundimi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, apo nëse vrasja ndodhi kur viktima mbahej prej UÇK-së. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë akuzë.

6.12.8 Vrasja e Velizar Stoshiqit

319. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Velizar Stoshiqit si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshminë përkatëse nga Miomir Stoshiqi, si dhe dëshmi mjekoligjore.

320. Miomir Stoshiqi, serb nga Bellopoja, komuna e Pejës,¹⁵⁵⁷ dëshmoi se babai i tij Velizar Stoshiq u zhduk më 17 korrik 1998 apo rreth kësaj date, kur po shkonte me biçikletë për në tokën e familjes, që gjendej pranë Loxhës, komuna e Pejës.¹⁵⁵⁹ Përveç faktit se në korrik të vitit 1998 gjendja në atë zonë ishte e nderë, dëshmitari nuk mundi të japë hollësi apo fakte lidhur me zhdukjen e babait të tij.¹⁵⁶⁰ Dëshmitari, i cili lajmëroi Kryqin e Kuq në Pejë dhe MPB-në për zhdukjen e

¹⁵⁵⁷ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 281; P663 (Raport i autopsisë R-8/1), f. 1-2, 4; P666 (Fotografi të R-8/1).

¹⁵⁵⁸ Miomir Stoshiq, T. 5493-5494.

¹⁵⁵⁹ Miomir Stoshiq, T. 5495-5498, 5655-5658; P341 (Fotografi e Velizar Stoshiqit).

¹⁵⁶⁰ Miomir Stoshiq, T. 5498-5499.

babait të tij, u informua nga policia lokale rreth një muaj pas zhdukjes së biçikleta e babait të tij ishte gjetur në tokën e familjes në afërsi të Loxhës.¹⁵⁶¹

321. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Velizar Stoshiqin (kufoma me numër "R-8"). Branimir Aleksandriqi¹⁵⁶² dëshmoi se kufoma R-8 u gjet më 11 shtator 1998 pranë kanalit të Radoniqit, përgjatë anës së jashtme të murit prej betoni ku kishte shenja plumbash, së bashku me tetë kufoma të tjera.¹⁵⁶³ Rreth qafës së kufomës R-8, me një perimetër mesatar të qafës së një personi të rritur, u gjet një litar alpinistësh rreth një centimetër i trashë, i lidhur në formë laku.¹⁵⁶⁴ Prej analiza së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-8 u identifikua si Velizar Stoshiqi.¹⁵⁶⁵ Autopsia e kufomës e kryer më 11 tetor 2005 konstatoi dëmtime të shumta në kokë të shkaktuara nga goditje me një send jo të mprehtë dhe plagë me armë zjarri.¹⁵⁶⁶ Në shpatullën e majtë si dhe në eshtrën e kofshës së djathtë u zbuluan dëmtime dhe thyerje, që përputheshin me plagë prej armëve të zjarrit.¹⁵⁶⁷ Në bazë të autopsisë u arrit në përfundimin se shkaku i vdekjes ishin plagët e shumta me armë zjarri të shkaktuara në kokën dhe gjymtyrët e viktimës.¹⁵⁶⁸ Dushan Dunjiqi¹⁵⁶⁹ dëshmoi se autopsia e kryer në shtator 1998 zbuloi vrima plumbash në të dyja anët e kokës dhe në eshtrën e kofshës së djathtë, si dhe një plumb në kupën e gjurit të majtë.¹⁵⁷⁰

322. Mbi bazën e dëshmive Dhoma Gjyqësore konkludon se Velizar Stoshiqi u zhduk më 17 korrik 1998 ose rreth kësaj date, në zonën midis Bellopojës dhe Loxhës. Kufoma e Velizar Stoshiqit u gjet në kanalit të Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore konstatoi thyerje të shumta, që përputheshin me plagë prej armëve të zjarrit dhe rrjedhimisht sugjerohet bindshëm se Velizar Stoshiq u vra. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen, apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse një lidhje e tillë ka ekzistuar. Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë dëshmi se Velizar Stoshiqi u mbajt në arrest prej UÇK-së, apo në lidhje me rrethanat e vrasjes ose vrasësit. Biçikleta që Velizar Stoshiq përdori ditën e zhdukjes së tij u gjet në një fushë pranë Loxhës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se në atë kohë fshati Loxhë ishte nën

¹⁵⁶¹ Miomir Stoshiq, T. 5500-5501.

¹⁵⁶² P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

¹⁵⁶³ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë, 26 qershor 2007), paragrafët 4, 6, 61-62; P414 (Fotografi të ndryshme), f. 20; P416 (Fotografi të ndryshme), f. 3; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 18; P645 (Fotografi të ndryshme), f. 2; P649 (Fotografi të ndryshme), f. 2.

¹⁵⁶⁴ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 111, 113, 118-119; Branimir Aleksandriq, T. 6769-6770; P415 (Fotografi të ndryshme), f. 16; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 0:52'49"-0:53'12", 0:53'28" - 0:54'24".

¹⁵⁶⁵ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 48.

¹⁵⁶⁶ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 49-50.

¹⁵⁶⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 50.

¹⁵⁶⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 51.

¹⁵⁶⁹ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁵⁷⁰ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 266-267; P659 (Raport i autopsisë R-8), f. 2-3; P661 (Fotografi të R-8), f. 2-3, 9.

kontrollin e UÇK-së.¹⁵⁷¹ Edhe sikur Velizar Stoshiq të jetë zhdukur në një territor të kontrolluar nga UÇK-ja, nuk përjashtohet mundësia e arsyeshme që vrasja të jetë kryer nga forca apo personë të tjerë, të cilët nuk kishin lidhje me UÇK-në.

323. Për këto arsye, si dhe duke supozuar se Velizar Stoshiq u vra, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të arrijë në përfundimin se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, apo nëse vrasja u krye kur viktimja mbahej në arrest prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me këtë akuzë.

6.12.9 Vrasja e Malush Shefki Mehës

324. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndëmmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Malush Shefki Mehës si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshminë përkatëse nga Hasime Racaj, si dhe dëshmi mjekoligjore.

325. Hasime Racaj, nga Peja,¹⁵⁷² deklaroi se më 27 korrik 1998, rreth orës 8 të mëngjesit, burri i saj u largua nga shtëpia për të blerë disa ilaçe dhe se kjo ishte hera e fundit që ajo e pa gjallë.¹⁵⁷³ Sipas dëshmitares, burri i saj, Malush Meha, vuante nga një sëmundje mendore.¹⁵⁷⁴ Pas tri ditësh dëshmitarja lajmëroi zhdukjen e tij në “Organizatën Humanitare” në Pejë.¹⁵⁷⁵

326. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Malush Shefki Mehën (kufoma me numër “R-16”). Branimir Aleksandriqi¹⁵⁷⁶ dëshmoi se kufoma R-16 u gjet më 12 shtator 1998 në kanal in e Radoniqit.¹⁵⁷⁷ Kufoma u gjet në anën e jashtme të kanalit prej betoni, në një thellësi prej rreth 30 centimetra.¹⁵⁷⁸ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja u arrit në përfundimin se kufoma me numër R-16 është e Malush Mehës.¹⁵⁷⁹ Autopsia e kufomës e kryer më 5 dhjetor 2003 zbuloi një thyerje të madhe në të majtë të ijës, që përputhej me një plagë prej armëve të zjarrit.¹⁵⁸⁰ Nga kufoma u nxorën gjithashtu tre plumba.¹⁵⁸¹ U arrit në përfundimin se shkaku i

¹⁵⁷¹ Rustem Tetaj, T. 3691-3692, 3807-3809, 3810-3811; P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 77; Cufë Krasniqi, T. 5805, 5816, 5818-5819; P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 35; P165 (Analizë e betejës së Loxhës në: Procesverbalin e takimit më 5 korrik 1998).

¹⁵⁷² P1235 (Hasime Racaj, deklaratë dëshmitari, 16 prill 2007), f. 1.

¹⁵⁷³ P1235 (Hasime Racaj, deklaratë dëshmitari, 16 prill 2007), paragrafi 9.

¹⁵⁷⁴ P1235 (Hasime Racaj, deklaratë dëshmitari, 16 prill 2007), paragrafët 7, 17.

¹⁵⁷⁵ P1235 (Hasime Racaj, deklaratë dëshmitari, 16 prill 2007), paragrafi 11.

¹⁵⁷⁶ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

¹⁵⁷⁷ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 4, 6, 128, 141.

¹⁵⁷⁸ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 141, 143; Branimir Aleksandriq, T. 6766-6767; P449 (Fotografi të ndryshme), f. 36; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 0:52'35", 1:12'46"- 1:21'11".

¹⁵⁷⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 82.

¹⁵⁸⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 83-84.

¹⁵⁸¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 84.

vdekjes ishte goditja me një plumb në trungun e trupit.¹⁵⁸² Dushan Dunjiqi¹⁵⁸³ dëshmoi se autopsia e kryer në shtator 1998 zbuloi thyerje në shpatullën e djathtë dhe në gjysmën e majtë të eshtrës së legenit të cilat nuk mund të ishin shkaktuar nga ndonjë rrëzim.¹⁵⁸⁴

327. Mbi bazën e dëshmive, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se Malush Shefki Meha u zhduk më 27 korrik 1998 në Pejë. Kufoma e tij u gjet në kanalën e Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore sugjeron se Malush Shefki Meha u vra. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen, apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse një lidhje e tillë ka ekzistuar. Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë dëshmi për mbajtjen e Malush Shefki Mehës prej UÇK-së, apo lidhur me rrethanat e vrasjes ose vrasësit. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se Malush Shefki Meha vuante nga një sëmundje mendore.

328. Për këto arsye, si dhe duke supozuar se Malush Shefki Meha u vra, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të arrijë në përfundimin se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse një lidhje e tillë ka ekzistuar, apo nëse vrasja ndodhi kur viktima mbahej në arrest prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë akuzë.

6.12.10 Vrasja e Xhevat Berishës

329. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Xhevat Berishës si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi nga Luan Tetaj, si dhe dëshmi mjekoligjore. Dhoma Gjyqësore ka analizuar dëshminë e Luan Tetajt në pjesën 6.11, më sipër.

330. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Xhevat Berishën (kufoma me numër "R-5"). Branimir Aleksandriqi¹⁵⁸⁵ dëshmoi se kufoma R-5 u gjet më 11 shtator 1998 pranë kanalit të Radoniqit, përgjatë anës së jashtme të murit beton ku kishte shenja plumbash, së bashku me tetë kufoma të tjera.¹⁵⁸⁶ ZPZhK-ja arriti në përfundimin se kufoma R-5 është e Xhevat Berishës.¹⁵⁸⁷ Autopsia e kufomës e kryer më 8 dhjetor 2003 zbuloi se viktima kishte pësuar një

¹⁵⁸² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 85.

¹⁵⁸³ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁵⁸⁴ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 391; P702 (Raport i autopsisë R-16), f. 1-2, 6.

¹⁵⁸⁵ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

¹⁵⁸⁶ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 4, 6, 61-62; P414 (Fotografi të ndryshme), f. 20; P416 (Fotografi të ndryshme), f. 3; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 18; P645 (Fotografi të ndryshme), f. 2; P649 (Fotografi të ndryshme), f. 2.

¹⁵⁸⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 40.

plagë me armë zjarri në kokë.¹⁵⁸⁸ Kishte gjithashtu plagë të tjera me armë zjarri në krahun e djathtë, kraharor, dhe shtyllën kurrizore.¹⁵⁸⁹ U arrit në përfundimin se vdekja ishte shkaktuar nga plaga me armë zjarri në kokë; edhe plagët me armë zjarri në kraharor mund të kenë qënë vdekjeprurëse.¹⁵⁹⁰

331. Siç u përmend në pjesën 6.11, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se Xhevat Berisha dhe babai i tij, Misin Berisha, dhe vëllai, Sali Berisha, u panë për herë të fundit në fshatin Gllogjan, komuna e Pejës, në qershor apo korrik 1998. Në shtator 1998, kufoma e Xhevat Berishës u gjet në kanalën e Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore sugjeron bindshëm se Xhevat Berisha u vra. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen, apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse një lidhje e tillë ka ekzistuar. Dhoma Gjyqësore ka shqyrtuar vrasjet e Sali dhe Misin Berishës në pjesën 6.11, më sipër, dhe përfundimi i saj për autorët e mundshëm të këtyre vrasjeve është i vlefshëm edhe për vrasjen e Xhevat Berishës. Me përjashtim të dëshmive të shqyrtuara në atë pjesë, Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi për rrëmbimin e Xhevat Berishës ose mbajtjen e tij prej UÇK-së, apo lidhur me rrethanat e vrasjes ose vrasësit.

332. Për këto arsye, si dhe duke supozuar se Xhevat Berisha u vra, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të arrijë në një përfundim jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse një lidhje e tillë ka ekzistuar, apo nëse vrasja ndodhi kur viktimi mbahej prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me këtë akuzë.

6.12.11 Vrasja e Kemajl Gashit

333. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Kemajl Gashit si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshminë përkatëse nga Medin Gashi, si dhe dëshminë mjekoligjore. Nuk është e nevojshme të paraqitet edhe një herë këtu përmbajtja e dëshmisë së Medin Gashit.¹⁵⁹¹ Për arsyet e shpjeguara më poshtë, Dhoma Gjyqësore nuk mund të mbështetet në thujtë asnjë element të përmbajtjes së kësaj dëshmie.

¹⁵⁸⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 42. Shihni gjithashtu P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 245; P650 (Raport i autopsisë R-5), f. 4; P652 (Fotografi të R-5).

¹⁵⁸⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 42. Shihni gjithashtu P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 244-245; P650 (Raport i autopsisë R-5), f. 1-2, 4; P652 (Fotografi të R-5).

¹⁵⁹⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr 42-43.

¹⁵⁹¹ Medin Gashi, T. 4840-4899, 4910-4936.

334. Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi mjekoligjore lidhur me Kemajl Gashin (kufoma me numër "R-2"). Branimir Aleksandriqi¹⁵⁹² dëshmoi se kufoma R-2 u gjet më 11 shtator 1998 pranë kanalit të Radoniqit, përgjatë anës së jashtme të murit prej betoni ku kishte shenja plumbash, së bashku me tetë kufoma të tjera.¹⁵⁹³ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-2 u identifikua si Kemajl Gashi.¹⁵⁹⁴ Autopsia e kufomës e kryer më 8 dhjetor 2003 zbuloi thyerje në kafkë, në shpatullën e majtë, krahun e majtë, brinjë, dhe pjesën e sipërme të shtyllës kurrizore, të cilat dukej se ishin shkaktuar me armë zjarri.¹⁵⁹⁵ Thyerjet e tjera në të dyja anët e eshtrës së ijes dhe në pjesë e poshtme të shtyllës kurrizore përputheshin me së paku dy goditje me armë zjarri në pjesën e legenit.¹⁵⁹⁶ Autopsia arriti në përfundimin se shkak i vdekjes ishin plagët me armë zjarri në pjesën e legenit.¹⁵⁹⁷ Dushan Dunjiqi¹⁵⁹⁸ dëshmoi se kufoma R-2 ishte e veshur me blu xhins dhe një bluzë me mëngë të shkurtëra me vija të kuqe dhe të gjelbra.¹⁵⁹⁹ Autopsia e kufomës e kryer në shtator 1998 zbuloi një plagë e hyrjes së një plumbi në anën e djathtë, plagën e daljes në anën e majtë të eshtrës së legenit si dhe thyerje të shumta në brinjë, krahun e majtë, shpatullën e majtë, dhe në pjesën e poshtme të nofullës së djathtë.¹⁶⁰⁰ Thyerjet që nuk ishin në pjesën e legenit, përputheshin me lëndime të shkaktuara nga goditje me një send jo të mprehtë dhe nuk mund të ishin shkaktuar nga ndonjë rrëzim.¹⁶⁰¹ Ka shumë të ngjarë që këto thyerje që nuk ishin në pjesën e legenit, të jenë shkaktuar para vdekjes dhe po të mos mjekohen, ato mund të shkaktojnë vdekjen e personit nga hemoragjia.¹⁶⁰²

335. Dhoma Gjyqësore konstaton se dëshmia e Medin Gashit për këtë pikë është e paqartë, mospërputhëse, dhe kundërtëse në lidhje me deklaratat që u ka dhënë më parë palëve dhe deklaratën që motra e tij i dha Prokurorisë. I vetmi fakt në dëshminë e tij që Dhoma Gjyqësore e vlerëson të besueshëm është se Kemajl Gashi ka qenë në shtabin e UÇK-së në ndërtesën e shkollës në Baran dikur në verën e vitit 1998. Mirëpo është e paqartë përse Kemajl Gashi ishte atje, nëse ka qenë viktimë, apo i shërbente UÇK-së, çfarë i ndodhi atje, nëse u largua ndonjëherë nga Barani, dhe në rast se po, ku shkoi. Në shtator 1998 kufoma e Kemajl Gashit u gjet në kanalën e Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore sugjeron bindshëm se Kemajl Gashi u vra. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e

¹⁵⁹² P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriqi, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriqi, 26 qershor 2007).

¹⁵⁹³ P1260 (Branimir Aleksandriqi, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 61-62; P414 (Fotografi të ndryshme), f. 20; P416 (Fotografi të ndryshme), f. 3; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 18; P645 (Fotografi të ndryshme), f. 2; P649 (Fotografi të ndryshme), f. 2.

¹⁵⁹⁴ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 28.

¹⁵⁹⁵ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 29-30.

¹⁵⁹⁶ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 30.

¹⁵⁹⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 31.

¹⁵⁹⁸ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁵⁹⁹ P807 (Raport i autopsisë R-2), f. 3; P809 (Fotografi të R-2), f. 5-6.

¹⁶⁰⁰ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 207-208; P807 (Raport i autopsisë R-2), f. 6; P809 (Fotografi të R-2), f. 2-3.

¹⁶⁰¹ P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 208-209.

¹⁶⁰² P618 (Dushan Dunjiqi, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 209.

kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen ose me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Për këtë arsye, edhe po të supozohet se Kemajl Gashi u vra, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponnin, nuk e lejojnë të konkudojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kush e kreu vrasjen, me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë, apo nëse vrasja ndodhi kur viktima mbahej prej UÇK-së. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë akuzë.

6.12.12 Vrasja e Sanije Balajt

336. Të tre të akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndëmmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Sanije Balaj si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi nga një numër dëshmitarësh, si dhe dëshmi mjekoligjore.

337. Shaban Balaj, shqiptar kosovar nga Strellci i Poshtëm në komunën e Deçanit, ishte ushtar i UÇK-së që nga fundi i marsit 1998 deri sa dha dorëheqjen në gusht 1998.¹⁶⁰³ Shaban Balaj jetonte me motrën e tij, Sanije Balaj, në Strellcin e Poshtëm në vitin 1998.¹⁶⁰⁴ Shaban Balaj dëshmoi se Sanije Balaj nuk ishte anëtare e UÇK-së.¹⁶⁰⁵ Mirëpo një herë, Sanije Balaj veshi uniformën e UÇK-së të Shaban Balajt dhe mbajti në krah armën e tij, kur doli për të blerë ushqime në Malishevë për banorët e fshatit të saj.¹⁶⁰⁶ Dëshmitari dëshmoi se më 12 gusht 1998, në orën 8:30 të mëngjesit, Sanije Balaj u largua nga Strellci i Poshtëm, me makinë, me të afërm të dëshmitarit.¹⁶⁰⁷ Sanije Balaj ishte e veshur me rroba civile.¹⁶⁰⁸ Ajo donte të shkonte në Pejë për të blerë një telefon celular dhe Shaban Balaj i kishte dhënë 2,700 marka gjermane për këtë qëllim.¹⁶⁰⁹ Një ditë para udhëtimit, Shaban Balaj kishte marrë një autorizim të UÇK-së nga komandanti lokal i UÇK-së në mënyrë që ajo të udhëtonte për në Rosujë në komunën e Pejës.¹⁶¹⁰ Pas largimit të saj, Shaban Balaj nuk e pa më Sanije Balajn gjallë.¹⁶¹¹ Më 12 gusht 1998, dikur midis orës 14:00 - 16:00, të afërmit e dëshmitarit u kthyen.¹⁶¹² Ata i thanë se kishin udhëtuar me Sanije Balajn për në Baran në komunën e Pejës, kur ishin ndaluar në një postbllok të UÇK-së.¹⁶¹³ Të afërmit e dëshmitarit thanë se ishin ndaluar nga Metë Krasniqi, Avni Krasniqi, Ibër Krasniqi, Vesel Dizdari, dhe një person tjetër që në

¹⁶⁰³ P922 (Shaban Balaj, deklaratë dëshmitari, 2 qershor 2007), paragrafët 4, 17; Shaban Balaj, T. 8649, 8703.

¹⁶⁰⁴ Shaban Balaj, T. 8649, 8680.

¹⁶⁰⁵ Shaban Balaj, T. 8652, 8702, 8704.

¹⁶⁰⁶ P922 (Shaban Balaj, deklaratë dëshmitari, 2 qershor 2007), paragrafi 15; Shaban Balaj, T. 8652, 8702-8704.

¹⁶⁰⁷ Shaban Balaj, T. 8649-8650, 8653, 8686.

¹⁶⁰⁸ Shaban Balaj, T. 8652-8653.

¹⁶⁰⁹ Shaban Balaj, T. 8650, 8682.

¹⁶¹⁰ Shaban Balaj, T. 8655.

¹⁶¹¹ Shaban Balaj, T. 8653.

¹⁶¹² Shaban Balaj, T. 8653, 8686.

¹⁶¹³ Shaban Balaj, T. 8651, 8653-8654, 8656, 8660, 8686.

atë kohë dëshmitari nuk e njihte.¹⁶¹⁴ Më pas dëshmitari mësoi se emri i tij ishte Idriz Gashi, me nofkën “Galani”.¹⁶¹⁵ Të afërmve te dëshmitarit iu tha më vonë se ajo ishte marrë në pyetje nga Cufë Krasniqi, dhe se tashmë ishte kthyer në Strellc të Poshtëm.¹⁶¹⁶ Dëshmitari iu referua Metë, Avni, Ibër, dhe Cufë Krasniqit dhe “Galanit” si “persona që vetëqoheshin UÇK [...] dhe që ishin nën komandën e askujt”.¹⁶¹⁷ Më pas Shaban Balaj dhe të afërmit e tij shkuan për të takuar burrat që kishin ndaluar Sanije Balajn.¹⁶¹⁸ Pranë Vranocit në komunën e Pejës dëshmitari takoi Metë Krasniqin.¹⁶¹⁹ Metë Krasniqi i tha dëshmitarit se e kiste ndaluar Sanije Balajn dhe se ajo ishte çuar në Gllogjan, komua e Deçanit.¹⁶²⁰ Dëshmitari nuk i besoi Metë Krasniqit.¹⁶²¹ Pastaj dëshmitari pastaj shkoi në Zllapek në komunën e Pejës, ku foli me Vesel Dizdarin.¹⁶²² Vesel Dizdari i tha dëshmitari se Sanije Balajn e kishte ndaluar Metë Krasniqi.¹⁶²³ Vesel Dizdari e këshilloi dëshmitarin të kërkonte Sanije Balajn pasi, sipas Dizdarit, Metë, Avni, dhe Ibër Krasniqi si dhe Galani ishin njerëz të rrezikshëm.¹⁶²⁴ Më pas dëshmitari mësoi nga Vesel Dizdari se Cufë Krasniqi kishte marrë në pyetje Sanije Balajn.¹⁶²⁵ Më 13 apo 14 gusht 1998, Shaban Balaj u takua me Cufë Krasniqin.¹⁶²⁶ Cufë Krasniqi i tha Dëshmitarit se Avni dhe Ibër Krasniqi e kishin marrë Sanije Balajn për t'a pyetur si bashkëpunetore serbe.¹⁶²⁷ Cufë Krasniqi e kishte marrë në pyetje Sanije Balajn dhe më pas e kishte liruar dhe “Galani” kishte qenë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje dhe kishte parë paratë që Sanije Balaj kishte me vete.¹⁶²⁸ Cufë Krasniqi shtoi se pasi ai e kishte liruar atë, Ibër dhe Avni Krasniqi e kishin larguar Sanije Balaj në një mënyrë miqësore.¹⁶²⁹

338. Më 13 gusht 1998, Shaban Balaj u takua me komandantin e FARK-ut, Tahir Zemaj, në Prapaqan, komuna e Deçanit, dhe i tregoi për zhdukjen e Sanije Balajt.¹⁶³⁰ Tahir Zemaj tha se do merrte masa dhe, sipas Shaban Balajt, më pas i mori në pyetje personat që kishin ndaluar Sanije Balajn.¹⁶³¹ Kur Shaban Balaj erdhi përsëri në Baran, Tahir Zemaj e prezantoi tek Fadil Nimani dhe Hysen Gashi.¹⁶³² Gjatë katër apo pesë ditëve të mëvonshme, Fadil Nimani dhe Hysen Gashi i bënë

¹⁶¹⁴ Shaban Balaj, T. 8653-8654, 8660, 8686.

¹⁶¹⁵ Shaban Balaj, T. 8654, 8657-8658, 8697-8698.

¹⁶¹⁶ Shaban Balaj, T. 8653, 8686-8687.

¹⁶¹⁷ Shaban Balaj, T. 8651, 8653, 8688, 8693.

¹⁶¹⁸ Shaban Balaj, T. 8654-8655.

¹⁶¹⁹ Shaban Balaj, T. 8655-8656.

¹⁶²⁰ Shaban Balaj, T. 8656-8657, 8701. Shihni gjithashtu P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafi 15.

¹⁶²¹ Shaban Balaj, T. 8657.

¹⁶²² Shaban Balaj, T. 8657-8659.

¹⁶²³ Shaban Balaj, T. 8659-8660.

¹⁶²⁴ Shaban Balaj, T. 8657, 8660. Shihni gjithashtu P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafi 16.

¹⁶²⁵ Shaban Balaj, T. 8658-8659.

¹⁶²⁶ Shaban Balaj, T. 8664, 8666-8667.

¹⁶²⁷ Shaban Balaj, T. 8668.

¹⁶²⁸ Shaban Balaj, T. 8668-8669, 8689.

¹⁶²⁹ Shaban Balaj, T. 8696.

¹⁶³⁰ Shaban Balaj, T. 8663-8664. Shihni P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 10.

¹⁶³¹ Shaban Balaj, T. 8663-8664.

¹⁶³² Shaban Balaj, T. 8664-8665.

dëshmitarit pyetje për zhdukjen e Sanije Balajt dhe mbajtën shënim përgjigjet e tij.¹⁶³³ Ditën e katërt apo të pestë Fadil Nimani i tha Shaban Balajt se Sanije Balaj kishte vdekur.¹⁶³⁴

339. Dy apo tre ditë pas zhdukjes, bashkëshortja e Shaban Balajt i tha atij se Ramush Haradinaj dhe Gani Gjukaj kishin ardhur në shtëpinë e tyre për të shprehur ngushëllimet e tyre.¹⁶³⁵ Dëshmitari besonte se Ramush Haradinaj nuk ishte përfshirë në zhdukjen dhe vrasjen e Sanije Balajt.¹⁶³⁶ Në një nga ditët e mëvonshme, Shaban Balaj shkoi në shtëpinë e Metë Krasniqit për të zgjidhur çështjen e zhdukjes së Sanije Balajt.¹⁶³⁷ Në përputhje me Kanunin e zonës, Shaban Balaj ishte i shoqëruar nga 20 vetë, ndër të cilët paria e fshatit.¹⁶³⁸ Grupi i tha Din Krasniqit të informonte Metë Krasniqin se donin që kufoma e Sanije Balajt të kthehej në fshatin e saj, Strellci i Poshtëm, ashtu siç e kërkonte Kanuni.¹⁶³⁹ Pas tri apo katër ditësh, Metë Krasniqi mori pjesë në një tubim me 50-60 njerëz dhe pranoi se kishte ndaluar Sanije Balajn në rrugë, por u betua se nuk ishte përgjegjës për vdekjen e saj.¹⁶⁴⁰ Metë Krasniqi tha se Avni Krasniqi dhe një person i quajtur “Kolonel Galani” ishin përgjegjës për vdekjen e Sanije Balajt.¹⁶⁴¹ Metë Krasniqi tha gjithashtu se kufoma e saj ishte varrosur në një vend të quajtur Lugu i Isufit, pranë Vranocit, komuna e Pejës, por më vonë ishte hequr që andej nga Avni dhe Ibër Krasniqi si dhe një burrë i quajtur Togeri.¹⁶⁴² Avni dhe Ibër Krasniqi ishin detyruar nga një farë Galani për t'a larguar kufomën.¹⁶⁴³ Metë Krasniqi shtoi se Togeri e kishte transportuar kufomën në xhipin e tij.¹⁶⁴⁴ Zymer Hasanaj u kishte thënë ta largonin kufomën.¹⁶⁴⁵ Dëshmitari mësoi në vitin 2002 se “Togeri” ishte në fakt Idriz Balaj, por ai nuk besonte se Idriz Balaj ishte përfshirë në vdekjen e Sanije Balajt apo në largimin e kufomës së saj.¹⁶⁴⁶ Shaban Balaj shkoi tek Lugu i Isufit për të kërkuar kufomën e Sanije Balajt.¹⁶⁴⁷ Në një rrëpirë, pranë një pusi, dëshmitari gjeti një vend kur toka sapo ishte gërmuar dhe ai “gjeti ... gjakun e saj atje”.¹⁶⁴⁸ Mirëpo dëshmitari nuk sqaroi se nga e dinte se ishte gjaku i saj, ai besonte se Sanije Balaj ishte varrosur atje dhe se vendi më pas ishte mbuluar me dhé.¹⁶⁴⁹ Dëshmitari besonte se Sanije Balajn e kishin vlarë për paratë që kishte me vete ditën e zhdukjes së saj.¹⁶⁵⁰

¹⁶³³ Shaban Balaj, T. 8665-8666.

¹⁶³⁴ Shaban Balaj, T. 8666.

¹⁶³⁵ Shaban Balaj, T. 8670.

¹⁶³⁶ Shaban Balaj, T. 8670-8671, 8705.

¹⁶³⁷ Shaban Balaj, T. 8671-8672, 8689-8690.

¹⁶³⁸ Shaban Balaj, T. 8671-8672, 8690. Kanuni është një tërësi rregullash zakonore që zbatohet në Shqipërinë veriore dhe në Kosovë.

¹⁶³⁹ Shaban Balaj, T. 8672, 8690-8691.

¹⁶⁴⁰ Shaban Balaj, T. 8672-8673, 8691-8693.

¹⁶⁴¹ Shaban Balaj, T. 8673, 8692-8693.

¹⁶⁴² Shaban Balaj, T. 8673-8674, 8677, 8688, 8693.

¹⁶⁴³ Shaban Balaj, T. 8673-8675, 8693.

¹⁶⁴⁴ Shaban Balaj, T. 8674.

¹⁶⁴⁵ Shaban Balaj, T. 8673.

¹⁶⁴⁶ Shaban Balaj, T. 8674-8675.

¹⁶⁴⁷ Shaban Balaj, T. 8677-8678.

¹⁶⁴⁸ Shaban Balaj, T. 8678.

¹⁶⁴⁹ Shaban Balaj, T. 8678.

¹⁶⁵⁰ Shaban Balaj, T. 8650, 8679, 8682, 8689.

340. Dëshmitari 72 deklaroi se më 12 gusht 1998, Sanije Balaj po udhëtonte me makinë nga fshati Strelci i Poshtëm, komuna e Deçanit, për në Rosujë, komuna e Pejës.¹⁶⁵¹ Makina kaloi përmes fshatit Baran, komuna e Pejës, ku ndodheshin njëqind deri në treqind ushtarë.¹⁶⁵² Midis ushtarëve ishin Metë Krasniqi, Avni Krasniqi, dhe Vesel Dizdari.¹⁶⁵³ Në një postblllok, Metë Krasniqi, i shoqëruar nga dy apo tre ushtarë, i dha shenjë makinës të ndalonte.¹⁶⁵⁴ Avni Krasniqi paraqiti një blllok ku ishte shkruar emri i Sanije Balajt si person që duhej marrë në pyetje.¹⁶⁵⁵ Sanije Balaj u çua në ndërtesën e shkollës, e cila shërbente si kazermë e UÇK-së.¹⁶⁵⁶ Një të afërmi të dëshmitarit iu tha më vonë se Sanije Balaj ishte çuar te Gani Gjokaj, në Strelc, komuna e Deçanit.¹⁶⁵⁷ Mirëpo ushtarët e UÇK-së në atë fshat thanë se nuk e kishin parë atë.¹⁶⁵⁸

341. Cufë Krasniqi, komandant në UÇK, nga Vranoci, komuna e Pejës,¹⁶⁵⁹ dëshmoi se një ditë në gusht 1998 ai ishte në shkollën fillore në Baran, komuna e Pejës, ku UÇK-ja kishte tri ndërtesa.¹⁶⁶⁰ Dëshmitari ishte me Nazif Ramabanë kur Avni dhe Ibër Krasniqi, dy anëtarë të policisë ushtarake dhe të afërm të dëshmitarit, erdhën për t'i takuar.¹⁶⁶¹ Ata raportuan se policia ushtarake kishte kapur një grua e cila dyshohej se ishte bashkëpunëtore serbe dhe e kishin sjellë në ndërtesën e shkollës së vjetër ku ishte vendosur njëësia e policisë ushtarake të UÇK-së.¹⁶⁶² Komandanti i njësisë së policisë ushtarake, Hasan Gashi,¹⁶⁶³ nuk ishte i pranishëm atë ditë.¹⁶⁶⁴ Avni dhe Ibër Krasniqi informuan Cufë Krasniqin dhe Ramabanë se kur ishte ndaluar nga policia ushtarake ajo kishte thënë se po shkonte nga Strelci, komuna e Deçanit, në Pejë, por rruga që ajo kishte marrë kishte ngjallur dyshime tek ata.¹⁶⁶⁵ Për më tepër, Avni dhe Ibër Krasniqi u thanë se dyshonin se ajo punonte për një serb të quajtur Dragan Coroviq, emri i të cilit ishte në bllokun që i kishin gjetur asaj.¹⁶⁶⁶ Ramabaja i tha Cufë Krasniqit t'a merrte gruan në pyetje.¹⁶⁶⁷ Dëshmitari e gjeti atë në një dhomë të ndërtesës së shkollës së vjetër, e veshur me rroba civile dhe e ruajtur nga një ushtar i armatosur i UÇK-së me nofkën "Galani".¹⁶⁶⁸ Vetëm pas vitit 2002 dëshmitari mësoi se emri i vërtetë i "Galanit" ishte Idriz Gashi.¹⁶⁶⁹ Cufë Krasniqi e njohu të dyshuarën nga fytyra, pasi e kishte parë më parë në një video të

¹⁶⁵¹ P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafi 6.

¹⁶⁵² P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafi 8.

¹⁶⁵³ P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafi 8.

¹⁶⁵⁴ P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafi 9.

¹⁶⁵⁵ P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafi 9.

¹⁶⁵⁶ P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafët 9-10.

¹⁶⁵⁷ P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafët 12-13.

¹⁶⁵⁸ P1238 (Dëshmitari 72, deklaratë dëshmitari, 13 qershor 2007), paragrafi 13.

¹⁶⁵⁹ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1-2.

¹⁶⁶⁰ Cufë Krasniqi, T. 5771, 5777, 5818.

¹⁶⁶¹ Cufë Krasniqi, T. 5771, 5782, 5818, 5832.

¹⁶⁶² P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafi 24; Cufë Krasniqi, T. 5771-5773, 5775, 5777.

¹⁶⁶³ Mbi bazën e dëshmiave, Dhoma Gjyqësore e kupton se Hasan dhe Hysen Gashi është i njëjti person.

¹⁶⁶⁴ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), paragrafët 24, 72; Cufë Krasniqi, T. 5714-5715, 5777.

¹⁶⁶⁵ Cufë Krasniqi, T. 5771-5772.

¹⁶⁶⁶ Cufë Krasniqi, T. 5772, 5778.

¹⁶⁶⁷ Cufë Krasniqi, T. 5771-5773, 5832.

¹⁶⁶⁸ Cufë Krasniqi, T. 5773-5774, 5779, 5824, 5832.

¹⁶⁶⁹ Cufë Krasniqi, T. 5779, 5788.

një grupi vajzash që këndonin një këngë kushtuar UÇK-së.¹⁶⁷⁰ Ajo i tha dëshmitarit se quhej Sanije Balaj dhe i shpjegoi se donte të blente një telefon në Pejë dhe kishte marrë këtë rrugë më të gjatë pasi ishte më e sigurtë si dhe gjatë rrugës donte t'i bënte një vizitë hallës së saj në Kliqinë, komuna e Pejës.¹⁶⁷¹ Avni dhe Ibër Krasniqi ndërhyjnë duke thënë se Sanije Balaj po gënjente dhe Cufë Krasniqi i urdhëroi të dilnin nga dhoma. Ata iu bindën urdhrit.¹⁶⁷² Dëshmitari pa se Sanije Balaj kishte me vete një shumë të hollash, gjë që e bindi dëshmitarin se me të vërtetë ajo donte të blinte një telefon.¹⁶⁷³ Pasi e pyeti për rreth pesë minuta, Cufë Krasniqi vendosi t'a lironte.¹⁶⁷⁴ Dëshmitari i tha se duhej të merrte leje nga shtabi i UÇK-së në fshatin e saj, Strelc, për të shkuar në Pejë.¹⁶⁷⁵ Ajo pranoi që Avni dhe Ibër Krasniqi t'a shoqëronin me makinën e tyre Volkswagen Golf të kuqe.¹⁶⁷⁶ Cufë Krasniqi e pa për herë të fundit duke u larguar me makinë së bashku me Avni dhe Ibër Krasniqin.¹⁶⁷⁷ Ai i raportoi Nazif Ramabasë për çka kishte ndodhur.¹⁶⁷⁸ Dy apo tri ditë pas marrjes në pyetje, vëllai i Sanije Balajt, Shaban Balaj, erdhi për të takuar dëshmitarin në shkollë dhe për të pyetur se ku gjendej e motra.¹⁶⁷⁹ Ai i tha Cufë Krasniqit se e motra nuk kishte ardhur në shtëpi ditën kur e kishin marrë në pyetje.¹⁶⁸⁰ Më pas, Nazif Ramabaja i tha Cufë Krasniqit se në Prapaqan, komuna e Deçanit, po bëhej një hetim dhe se dëshmitari duhej të shkonte atje për të bërë një deklaratë rreth Sanije Balajt.¹⁶⁸¹ Në Prapaqan, Cufë Krasniqi informoi Fadil Nimanin, komandantin lokal të policisë ushtarake, që po kryente hetimin, lidhur me çka kishte ndodhur.¹⁶⁸² Dëshmitari tha se Avni dhe Ibër Krasniqi, si dhe Metë Krasniqi, i vëllai i Avniut, ishin të pranishëm në Prapaqan atë ditë, por Idriz Gashi nuk ishte i pranishëm.¹⁶⁸³ Sipas Cufë Krasniqit, Tahir Zemaj kishte dijeni për hetimin.¹⁶⁸⁴

342. Avni Krasniqi nga Vranoci, komuna e Pejës,¹⁶⁸⁵ dëshmoi se ishte anëtarësuar në policinë ushtarake të FARK-ut në Baran, komuna e Pejës, në korrik 1998 dhe se komandanti i policisë ushtarake ishte Hasan Gashi.¹⁶⁸⁶ Gashi ishte nën komandën e Nazif Ramabasë.¹⁶⁸⁷ Avni Krasniqi dëshmoi se një pasdite në gusht 1998 ai dhe disa anëtarë të tjerë të policisë ushtarake, ndër të cilët Ahmet Ukaj, kishin parë dy ushtarë, të cilët dëshmitari nuk mundi t'i identifikojë, duke çuar Sanije

¹⁶⁷⁰ Cufë Krasniqi, T. 5774, 5824-5825, 5833, 5856-5857.

¹⁶⁷¹ Cufë Krasniqi, T. 5774-5775.

¹⁶⁷² Cufë Krasniqi, T. 5775-5776.

¹⁶⁷³ Cufë Krasniqi, T. 5778.

¹⁶⁷⁴ Cufë Krasniqi, T. 5777-5778, 5833.

¹⁶⁷⁵ Cufë Krasniqi, T. 5776-5777.

¹⁶⁷⁶ Cufë Krasniqi, T. 5779-5780, 5823.

¹⁶⁷⁷ Cufë Krasniqi, T. 5780, 5823-5824.

¹⁶⁷⁸ Cufë Krasniqi, T. 5833-5834.

¹⁶⁷⁹ Cufë Krasniqi, T. 5780-5782, 5789.

¹⁶⁸⁰ Cufë Krasniqi, T. 5790.

¹⁶⁸¹ Cufë Krasniqi, T. 5783-5785, 5825-5826.

¹⁶⁸² Cufë Krasniqi, T. 5784, 5786, 5834.

¹⁶⁸³ Cufë Krasniqi, T. 5787-5788.

¹⁶⁸⁴ Cufë Krasniqi, T. 5786.

¹⁶⁸⁵ Avni Krasniqi, T. 10709, 10712.

¹⁶⁸⁶ Avni Krasniqi, T. 10720-10722, 10780.

¹⁶⁸⁷ Avni Krasniqi, T. 10722, 10781.

Balajn në Shkollën e Kuqe në Baran ku ishin kazermat ushtarake.¹⁶⁸⁸ Avni Krasniqi pa përmes një dritareje se Cufë Krasniqi po merrte në pyetje Sanije Balajn brënda ndërtesës së shkollës.¹⁶⁸⁹ Pastaj dëshmitari dëgjoi se Sanije Balaj u lejua të kthehej në shtëpi mirëpo ai nuk e dinte se kush e kishte liruar, por tha se ajo priti brenda në ndërtesën e shkollës që të vinin të afërmit e saj për t'a marrë dhe çuar në shtëpi.¹⁶⁹⁰ Pas një orë e gjysëm, dëshmitari pa Idriz Gashin, me nofkën Galani, që hyri në shkollë, foli me Cufë Krasniqin, dhe pastaj u largua me Sanije Balajn.¹⁶⁹¹ Galani ishte veshur me uniformë të zezë me një kapelë me simbolin e UÇK-së dhe ishte i armatosur.¹⁶⁹² Galani i tha dëshmitarit se ishte komandant i Lugut të Drinit dhe se ishte emëruar në këtë detyrë nga Ramush Haradinaj dhe Sali Veseli, tek të cilët raportonte.¹⁶⁹³ Dëshmitari pranoi se në atë kohë shumë njerëz vetëquheshin komandant.¹⁶⁹⁴ Një urdhër transferimi i UÇK-së, i nënshkruar nga Ramush Haradinaj dhe me datë 7 korrik 1998, thotë se “luftëtari” Idriz Gashi ishte transferuar me kërkesën e vet nga zona e Dukagjinit në një zonë tjetër.¹⁶⁹⁵ Ndërkohë që po dilte nga ndërtesa e shkollës, Galani kishte me vete një bllok të vogël të bardhë dhe u foli ashpër dëshmitarit dhe ushtarëve të tjerë që ishin aty, duke thënë se si mund t'a lironin atë dhe se në bllokun e saj ajo kishte shkuar emrat e kriminelëve serbe.¹⁶⁹⁶ Ai ua lexoi këto emra dëshmitarit dhe ushtarëve të tjerë.¹⁶⁹⁷ Dëshmitari e dinte se disa nga emrat ishin të disa policëve në Pejë.¹⁶⁹⁸

343. Pastaj Galani e urdhëroi dëshmitarin t'a çonte atë dhe Sanije Balajn në shtabin në Gllogjan, komuna e Deçanit.¹⁶⁹⁹ Të tre hipën në makinë, Avni Krasniqi në vendin e shoferit, Galani në ulësen e përparme, dhe Sanije Balaj në ulësen e pasme, dhe u nisën në drejtim të Gllogjanit.¹⁷⁰⁰ Pas kishin udhëtuar për rreth 20 minuta, në vendin e quajtur Lugu i Isufit, Sanije Balaj e pyeti Galanin nëse mund të bisedonin diçka privatisht dhe Galani i tha Avni Krasniqit të ndalonte makinën.¹⁷⁰¹ Galani dhe Sanije Balaj zbritën dhe u larguan.¹⁷⁰² Sanije Balaj kishte një çantë apo “sende personale” që i kishte lënë në makinë.¹⁷⁰³ Avni Krasniqi qëndroi në makinë.¹⁷⁰⁴ Pas rreth 40 sekondash ai dëgjoi të shtëna pistolette.¹⁷⁰⁵ Kur u kthye Galani, Avni Krasniqi e pyeti çfarë kishte bërë dhe Galani i tha se nuk duhej të tregonte asgjë, përndryshe edhe ai do të pësonte të njëjtin fat.¹⁷⁰⁶ Dëshmitarit iu kujtua

¹⁶⁸⁸ Avni Krasniqi, T. 10721, 10723-10725, 10806-10807.

¹⁶⁸⁹ Avni Krasniqi, T. 10724, 10726, 10729, 10808.

¹⁶⁹⁰ Avni Krasniqi, T. 10729-10730, 10816.

¹⁶⁹¹ Avni Krasniqi, T. 10726-10727, 10729-10730, 10808-10809, 10816.

¹⁶⁹² Avni Krasniqi, T. 10728, 10736.

¹⁶⁹³ Avni Krasniqi, T. 10728, 10732, 10784, 10787.

¹⁶⁹⁴ Avni Krasniqi, T. 10787.

¹⁶⁹⁵ P172 (Urdhër i UÇK-së për transferim i nënshkruar nga Ramush Haradinaj, 7 korrik 1998).

¹⁶⁹⁶ Avni Krasniqi, T. 10727, 10731, 10816.

¹⁶⁹⁷ Avni Krasniqi, T. 10730.

¹⁶⁹⁸ Avni Krasniqi, T. 10727.

¹⁶⁹⁹ Avni Krasniqi, T. 10731-10732, 10809.

¹⁷⁰⁰ Avni Krasniqi, T. 10732-10733.

¹⁷⁰¹ Avni Krasniqi, T. 10734-10735, 10817.

¹⁷⁰² Avni Krasniqi, T. 10735, 10806, 10817.

¹⁷⁰³ Avni Krasniqi, T. 10737.

¹⁷⁰⁴ Avni Krasniqi, T. 10735, 10806.

¹⁷⁰⁵ Avni Krasniqi, T. 10735, 10817.

¹⁷⁰⁶ Avni Krasniqi, T. 10735-10736, 10818.

gjithashtu se një moment të caktuar Galani iu bërtiti disa fëmijëve që po kullosnin bagëtitë aty pranë të largoheshin.¹⁷⁰⁷ Pastaj Avni Krasniqi e ktheu Galanin në Baran, komuna e Pejës, la makinën, mori makinën e tij dhe shkoi në shtëpi.¹⁷⁰⁸ Vëllai i dëshmitarit, Metë Krasniqi, i tha dëshmitarit se ishte grindur me Galanin më vonë po atë ditë për çfarë kishte ndodhur dhe Galani i kishte thënë se kishte vrarë Sanije Balajn.¹⁷⁰⁹ Dëshmitari dëgjoi gjithashtu se Galani u kishte thënë të tjerëve se kishte vrarë Sanije Balajn me urdhër të Sali Veselit.¹⁷¹⁰

344. Po atë mbrëmje Ibër Krasniqi dhe Galani morën Avni Krasniqin për të shkuar që të varrosnin Sanije Balajn.¹⁷¹¹ Galani i tregoi Avni Krasniqit vendin ku ishte vrarë dhe në atë moment erdhën Ahmet Ukaj si dhe disa burra të tjerë që ishin informuar për vrasjen nga një fëmijë.¹⁷¹² Galani ishte armatosur dhe ua drejtoi armën burrave që po vinin, duke u thënë të mos afroheshin.¹⁷¹³ Ndërkohë Avni Krasniqi po varroste Sanije Balajn dhe Galani urdhëroi Ahmet Ukajn t'a ndihmonte.¹⁷¹⁴ Avni Krasniqi dhe Ahmet Ukaj e varrosën Sanije Balajn në një gropë të cekët e cila nuk ishte më e thellë se 30 deri në 40 centimetra.¹⁷¹⁵ Tri ditë më vonë Galani, Togeri, dhe dy persona të tjerë erdhën në Shkollën e Kuqe në Baran me një xhip të zi dhe morën Avni Krasniqin për të shkuar dhe zhvarrosur kufomën e Sanije Balajt dhe për t'a rivarrosur në një vend tjetër.¹⁷¹⁶ Galani i urdhëroi t'a bënin këtë dhe iu tha se kufomën do ta varrosnin në një vend më të sigurtë.¹⁷¹⁷ Galani qëndroi në Baran ndërsa të tjerët shkuan.¹⁷¹⁸ Dëshmitari dëshmoi se e kishte parë Togerin disa herë më parë.¹⁷¹⁹ Dëshmitari mori Ibër Krasniqin me vete për t'a ndihmuar si dhe për arsye sigurie.¹⁷²⁰ Avni Krasniqi, Ibër Krasniqi, dhe dy persona të tjerë e zhvarrosën kufomën, e mbështollën në një batanije dhe e vendosën në vendbagazhin e xhipit.¹⁷²¹ Pastaj Avni Krasniqi dhe Ibër Krasniqi u çuan me makinë në Bisticë ku zbritën dhe dëshmitari nuk e di se ku shkuan më pas Togeri dhe të tjerët.¹⁷²²

345. Avni Krasniqi dëshmoi se u krye një hetim për vdekjen e Sanije Balajt dhe ai ishte thirrur për t'u intervistuar nga një person i quajtur Fadil Nimonaj.¹⁷²³ Sipas dëshmitarit, në atë kohë Galani ishte arratisur nga zona.¹⁷²⁴ Metë Krasniqi i tha dëshmitarit se Ramush Haradinaj dhe Gani Gjokaj

¹⁷⁰⁷ Avni Krasniqi, T. 10736-10737, 10818.

¹⁷⁰⁸ Avni Krasniqi, T. 10736, 10738.

¹⁷⁰⁹ Avni Krasniqi, T. 10738-10741, 10818.

¹⁷¹⁰ Avni Krasniqi, T. 10741.

¹⁷¹¹ Avni Krasniqi, T. 10742-10743, 10826.

¹⁷¹² Avni Krasniqi, T. 10742.

¹⁷¹³ Avni Krasniqi, T. 10742-10743.

¹⁷¹⁴ Avni Krasniqi, T. 10743.

¹⁷¹⁵ Avni Krasniqi, T. 10744.

¹⁷¹⁶ Avni Krasniqi, T. 10744-10745, 10750, 10842, 10847.

¹⁷¹⁷ Avni Krasniqi, T. 10747, 10749-10750.

¹⁷¹⁸ Avni Krasniqi, T. 10746-10748, 10842.

¹⁷¹⁹ Avni Krasniqi, T. 10841, 10847-10848.

¹⁷²⁰ Avni Krasniqi, T. 10745-10746, 10752-10754.

¹⁷²¹ Avni Krasniqi, T. 10746-10747, 10844.

¹⁷²² Avni Krasniqi, T. 10747-10748.

¹⁷²³ Avni Krasniqi, T. 10781.

¹⁷²⁴ Avni Krasniqi, T. 10781.

kishin pyetur se çfarë i kishte ndodhur Sanije Balajt dhe se ai u kishte thënë se ajo ishte vrarë si dhe prej kujt ishte vrarë.¹⁷²⁵

346. Zymer Hasanaj, ushtar i UÇK-së në Vranoc i Vogël në Pejë,¹⁷²⁶ dëshmoi se ditën e vrasjen së Sanije Balajt, në gusht 1998, ai u kthye në shtëpi rreth orës 18, ku i biri, Durimi, i tregoi për një incident që kishte parë.¹⁷²⁷ Durimi i tha babait të tij se po ruante bagëtinë së bashku me djem të tjerë në një vend të quajtur Lugu i Isufit, dhe se dikur midis orës 12 dhe 14 të drekës ata kishin parë dy burra që po nxirrnin me forcë një grua nga një makinë.¹⁷²⁸ Një prej burrave u thirri djemve të largoheshin.¹⁷²⁹ Ata iu bindën dhe pas kësaj Durimi dëgjoi tri të shtëna me armë.¹⁷³⁰ Zymer Hasanaj vendosi të shkonte me Durimin në vendin e incidentit të përshkruar nga i biri, i cili ishte rreth 10 minuta në këmbë nga Vranoci i Vogël.¹⁷³¹ Ata shkuan atje së bashku me njerëz të tjerë nga fshati, ndër të cilët Ahmet Ukaj.¹⁷³² Tek Lugu i Isufit, ata u urdhëruan të ndalonin nga një burrë, i cili, sipas Hasanaj, ishte ndoshta luftëtar i armatosur i UÇK-së.¹⁷³³ Pasi Hasanaj u kthye në shtëpi me Durimin, Ahmet Ukaj qëndroi tek Lugu i Isufit edhe për një orë dhe pastaj ai shkoi në shtëpinë e Hasanajt për t'i treguar se çfarë kishte ndodhur pasi kishte ikur ai.¹⁷³⁴ Ukaj i tha Hasanajt se kishte parë dy burra tek Lugu i Isufit, dhe pikërisht Idriz Gashin dhe Avni Krasniqin.¹⁷³⁵ Ukaj i tha gjithashtu Hasanajt se Gashi e kishte kërcënuar të mos i tregonte askujt se Gashi kishte vrarë një grua të quajtur Sanije Balaj.¹⁷³⁶ Po atë natë, Hasanaj shkoi me Ukajn për të informuar komandantin e UÇK-së në Vranoc të Vogël, Din Krasniqi, për incidentin.¹⁷³⁷ Hasanaj i kërkoi Din Krasniqit të informonte për incidentin Nazif Ramabanë, komandantin në Baran, komuna e Pejës.¹⁷³⁸ Din Krasniqi tha se do t'a ndiqte çështjen dhe se personi përgjegjës do të ndëshkohej.¹⁷³⁹

347. Ahmet Ukaj, ushtar i UÇK-së nga Vranoci i Vogël, komuna e Pejës,¹⁷⁴⁰ dëshmoi se mëngjesin e një dite në gusht 1998 pa një grua të re në moshë, e cila siç mësoi më vonë ishte Sanije Balaj, të cilën po e sillnin në ndërtesën e Shkollës së Kuqe në Baran, komuna e Pejës.¹⁷⁴¹ Sanije Balaj ishte me një grup njerëzish të cilët dëshmitari nuk i njihte.¹⁷⁴² Rreth 15 minuta më vonë

¹⁷²⁵ Avni Krasniqi, T. 10781-10783.

¹⁷²⁶ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafët 1-2; Zymer Hasanaj, T. 8720.

¹⁷²⁷ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 16; Zymer Hasanaj, T. 8738.

¹⁷²⁸ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 16; Zymer Hasanaj, T. 8738. Shihni gjithashtu P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 12; Ahmet Ukaj, T. 10665-10660.

¹⁷²⁹ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 16.

¹⁷³⁰ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 16. Shihni gjithashtu P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë, 11 nëntor 2007), paragrafi 12; Ahmet Ukaj, T. 10665-10660.

¹⁷³¹ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafët 16-17; P925 (Fotografi të zonës së Lugut të Isufit).

¹⁷³² P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 17.

¹⁷³³ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 18.

¹⁷³⁴ Zymer Hasanaj, T. 8731.

¹⁷³⁵ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 18.

¹⁷³⁶ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 20.

¹⁷³⁷ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafët 20-21.

¹⁷³⁸ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 21.

¹⁷³⁹ P923 (Zymer Hasanaj, deklaratë dëshmitari, 1 tetor 2007), paragrafi 21.

¹⁷⁴⁰ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 1, Ahmet Ukaj, T.10656.

¹⁷⁴¹ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafët 8-10; Ahmet Ukaj, T. 10660, 10668.

¹⁷⁴² P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 9; Ahmet Ukaj, T. 10668.

dëshmitari e pa atë të largohej me katër apo pesë burra të cilët dëshmitari gjithashtu nuk i njihte.¹⁷⁴³ Po atë mbrëmje, kur u kthye në fshatin e tij Vranoc, Ahmet Ukaj takoi Zymer Hasanajn.¹⁷⁴⁴ Ky i fundit i tha se dikush ishte vrarë tek Lugu i Isufit.¹⁷⁴⁵ Dëshmitari, Zymer Hasanaj, Hysen Ukaj, dhe të tjerët shkuan tek Lugu i Isufit për të parë çfarë kishte ndodhur.¹⁷⁴⁶ Në pyll dëshmitari takoi Idriz Gashin, me nofkën Galani, për të cilin dëshmitari kishte dëgjuar se ishte komandant i Lugut të Drinit, komuna e Klinës.¹⁷⁴⁷ Galani i drejtoi grupit një Kallashnikov dhe kur ata i thanë përse kishin ardhur, ai pohoi se kishte vrarë gruan.¹⁷⁴⁸ Galani i tha grupit se e kishte vrarë pasi kishte gjetur se ajo kishte me vete një bllok shënimesh.¹⁷⁴⁹ Galani lexoi disa emra serbë nga blloku dhe tha se në bllok ishin shkruar edhe numrat e telefonit të serbëve.¹⁷⁵⁰ Dëshmitari i njohu këta emra si police serbë të cilët, siç kishte dëgjuar, punonin në komunën e Deçanit.¹⁷⁵¹ Pastaj Galani urdhëroi Hysen Ukanj dhe dëshmitarin të qëndronin ndërsa të tjerët të largoheshin, dhe në atë moment nga disa shkurre doli Avni Krasniqi.¹⁷⁵² Galani e urdhëroi dëshmitarin të ndihmonte Avni Krasniqin për të varrosur gruan.¹⁷⁵³ Kur dëshmitari pa kufomën, e kuptoi se ishte e njëjta grua që kishin sjellë atë mëngjes në Baran.¹⁷⁵⁴ Ajo ishte qëlluar në kraharor.¹⁷⁵⁵ Pasi ndihmoi Avni Krasniqin të vendoste kufomën në një gropë të hapur, dëshmitari u kthye te Galani, i cili i tha përsëri se gruan e kishte vrarë ai.¹⁷⁵⁶ Pastaj Galani u tha dëshmitarit dhe Hysen Ukajt të largoheshin dhe ata u kthyen në Vranoc ku dëshmitari ia rrëfeu gjithçka Zymer Hasanajt.¹⁷⁵⁷ Pas disa ditësh, pasi u thirr për një intervistë si pjesë e një hetimi, dëshmitari informoi Fadil Nimanin për çfarë kishte ndodhur.¹⁷⁵⁸

348. Dëshmitari 17 dëshmoi se një njësi e policisë ushtarake në Baran, komuna e Pejës, u krijua më 13 korrik 1998 dhe se Hasan Gashi u zgjodh si shef i policisë.¹⁷⁵⁹ Sipas Dëshmitarit 17, Avni dhe Iber Krasniqi nuk ishin pjesëtarë të policisë ushtarake të brigadës së tretë, mirëpo pranoi se Avni Krasniqi mund të ketë kryer funksione të policisë ushtarake edhe pa autorizim nga brigada e tretë.¹⁷⁶⁰ Dëshmitari dëshmoi gjithashtu se Metë Krasniqi nuk ishte pjesë e strukturës së brigadës së tretë.¹⁷⁶¹ Mirëpo, de fakto ai vepronte si pjesëtar i policisë ushtarake në Baran dhe kishte edhe një

¹⁷⁴³ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 10.

¹⁷⁴⁴ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 12.

¹⁷⁴⁵ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 12.

¹⁷⁴⁶ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 13.

¹⁷⁴⁷ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafët 11, 15, 17.

¹⁷⁴⁸ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 15.

¹⁷⁴⁹ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 15.

¹⁷⁵⁰ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 15.

¹⁷⁵¹ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 15; Ahmet Ukaj, T. 10663.

¹⁷⁵² P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 16.

¹⁷⁵³ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 18.

¹⁷⁵⁴ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 19.

¹⁷⁵⁵ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 19.

¹⁷⁵⁶ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 20.

¹⁷⁵⁷ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 21.

¹⁷⁵⁸ P1226 (Ahmet Ukaj, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 22; Ahmet Ukaj, T. 10660-10661.

¹⁷⁵⁹ Dëshmitari 17, T. 7666-7667, 7695, 7698-7699.

¹⁷⁶⁰ Dëshmitari 17, T. 7669-7671, 7736.

¹⁷⁶¹ Dëshmitari 17, T. 7668-7669, 7671, 7703-7704, 7723, 7725.

zyrë atje.¹⁷⁶² Sipas Dëshmitarit 17, Sanije Balaj u ndalua prej Metë Krasniqit.¹⁷⁶³ Disa nga të afërmit e Sanije Balajt informuan për zhdukjen e saj Tahir Zemajn, në gusht 1998.¹⁷⁶⁴ Tahir Zemaj udhëzoi dy pjesëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së, Hysen Gashin dhe Fadil Nimanin, të hetonin zhdukjen.¹⁷⁶⁵ Në të njëjtën kohë, edhe Sadri Selca, i cili ishte përgjegjës për sigurinë e brigadës në brigadën e tretë, u udhëzua të kryente hetime për zhdukjen.¹⁷⁶⁶ Sipas një Shkrese Zyrtare të datës 26 gusht 1998, nënshkruar nga Sadri Selca, Sanije Balaj u çua nga Metë Krasniqi tek “komandanti” i cili autorizoi “Cufën” për të biseduar me të.¹⁷⁶⁷ Pasi “Cufa” e liroi, atë e mori një person i quajtur Galan, i cili e çoi në një vend të panjohur ku e vrau.¹⁷⁶⁸ Sipas Skresës, “ka plotësisht të ngjarë që më pas Togeri ta ketë çuar kufomën në Liqenin e Radoniqit”.¹⁷⁶⁹ Shkresa pohon gjithashtu se Sanije Balaj u vra sepse pranoi se punonte për policinë serbe.¹⁷⁷⁰ Pak kohë pas zhdukjes së Sanije Balajt, Dëshmitari 17 e pyeti Metë Krasniqin çfarë i kishte ndodhur asaj dhe ai pranoi se e kishte arrestuar por shtoi se më pas ia kishte dorëzuar dy personave të tjerë, Idriz Gashit dhe Avni Krasniqit.¹⁷⁷¹ Dëshmitari 17 ishte takuar më parë me Idriz Gashin i cili i kishte thënë se ishte ushtar i Ramush Haradinajt mirëpo donte të bashkohej me një brigadë të FARK-ut.¹⁷⁷²

349. Rrustem Tetaj, ish-oficer i APJ-së,¹⁷⁷³ dëshmoi se kishte dëgjuar për kapjen dhe vrasjen e një gruaje shqiptare të quajtur Sanije Balaj nga fshati Strelle, komuna e Deçanit, dikur në qershor të vitit 1998.¹⁷⁷⁴ Tetaj mësoi nga Metë Krasniqi dhe Faton Mehmetaj, ushtar i UÇK-së nga Vranoci, komuna e Pejës, se Metë Krasniqi e kishte kapur dhe ekzekutuar gruan në bazë të urdhrave të Mehmetajt.¹⁷⁷⁵ Ky i fundit i tha më vonë Tetajt se Sanije Balaj ishte arrestuar dhe ekzekutuar pasi dyshohej se u jepte informacione MPB-së dhe policisë së fshehtë serbe.¹⁷⁷⁶ Sipas dëshmitarit, Ramush Haradinaj, Tahir Zemaj, dhe Gani Gjokaj këmbëngulën për hetimin e rrethanave të vdekjes së Sanije Balajt.¹⁷⁷⁷

350. Sadri Selca, oficer i zbulimit të FARK-ut i vendosur në Baran, komuna e Pejës,¹⁷⁷⁸ dëshmoi se Shaban Balaj kishte ardhur në kazermën në Baran dhe i kishte thënë dëshmitarit se motra e tij, Sanije Balaj, ishte zhdukur.¹⁷⁷⁹ Shaban Balaj i tha dëshmitarit se Sanija kishte patur rreth 2,000

¹⁷⁶² Dëshmitari 17, T. 7671, 7704, 7726, 7729, 7733, 7738, 7803.

¹⁷⁶³ Dëshmitari 17, T. 7733.

¹⁷⁶⁴ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 75.

¹⁷⁶⁵ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 76; Dëshmitari 17, T. 7805-7806.

¹⁷⁶⁶ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 76; Dëshmitari 17, T. 7654, 7673, 7792, 7805.

¹⁷⁶⁷ P897 (Notë Zyrtare, nënshkruar nga Sadri Selca, 26 gusht 1998).

¹⁷⁶⁸ P897 (Notë Zyrtare, nënshkruar nga Sadri Selca, 26 gusht 1998).

¹⁷⁶⁹ P897 (Notë Zyrtare, nënshkruar nga Sadri Selca, 26 gusht 1998).

¹⁷⁷⁰ P897 (Notë Zyrtare, nënshkruar nga Sadri Selca, 26 gusht 1998).

¹⁷⁷¹ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 79; Dëshmitari 17, T. 7805.

¹⁷⁷² P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 80.

¹⁷⁷³ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 1; Rrustem Tetaj, T. 3604-3605.

¹⁷⁷⁴ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 Prill 2007), paragrafi 26.

¹⁷⁷⁵ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafët 26-27; Rrustem Tetaj, T. 3776.

¹⁷⁷⁶ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafët 26-27.

¹⁷⁷⁷ Rrustem Tetaj, T. 3775-3778.

¹⁷⁷⁸ Sadri Selca, T. 10858-10860, 10864.

¹⁷⁷⁹ Sadri Selca, T. 10865-10866, 10880-10882, 10887.

marka gjermane me vete ditën e zhdukjes së saj.¹⁷⁸⁰ Më pas dëshmitari hetoi për zhdukjen e Sanije Balajt.¹⁷⁸¹ Në një deklaratë dhënë nga dëshmitari dhe nënshkruar prej tij më 28 gusht 1998, Hysen dhe Ahmet Ukaj thanë se Metë Krasniqi e çoi Sanije Balajn në postën e policisë ushtarake.¹⁷⁸² Sipas deklaratës, Cufë Krasniqi bisedoi me Sanije Balajn, e cila më pas u mor nga Galani dhe Avni Krasniqi me një makinë Golf të kuqe dhe u çua në një vend që njihej me emrin Lugu i Isufit.¹⁷⁸³ Në deklaratë, Hysen dhe Ahmet Ukaj thanë se shkuan te Lugu e Isufit me Zymer Hasanajn dhe të tjerë, ku panë kufomën. Ahmeti u urdhërua nga Galani që të ndihmonte Avni Krasniqin për të varrosur kufomën në Lugun e Isufit, pranë një burimi.¹⁷⁸⁴ Dëshmitari tha se Metë Krasniqi nuk ishte në brigadën e tretë të FARK-ut, por bashkëpunonte si me FARK-un po ashtu dhe me UÇK-në dhe se ishte polic i vetëpunësuar.¹⁷⁸⁵

351. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Sanije Balajn (eshtat me numër “R-1”). Branimir Aleksandriqi¹⁷⁸⁶ dëshmoi se kufoma R-1 u gjet më 11 shtator 1998 në një fushë pranë kanalit, përgjatë anës së jashtme të murit prej betoni ku kishte shenja plumbash, së bashku me tetë kufoma të tjera.¹⁷⁸⁷ Më saktësisht, kufoma R-1 u gjet përbri murit, afër shkurreve.¹⁷⁸⁸ Kufoma R-1 u gjet në tokë me një thes plastik që mbulonte gjysmën e sipërme të trupit dhe një thes jute që mbulonte pjesën e poshtme të trupit.¹⁷⁸⁹ Mirëpo sipas Dushan Dunjiqit, gjysma e sipërme e trupit ishte në një çantë të fortë pambuku dhe gjysma e poshtme në një çantë najloni.¹⁷⁹⁰ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma u identifikua si Sanije Balaj.¹⁷⁹¹ Autopsia e kufomës e kryer më 8 dhjetor 2003 zbuloi disa plagë me armë zjarri: një plagë në pjesën e prapme të kokës, me vrime hyrëse prapa kafkës, një në pjesën e legenit, si dhe plagë të mundshme të shkaktuara prej armëve të zjarrit në kraharor dhe në krahun e djathtë.¹⁷⁹² Autopsia arriti në përfundimin se shkaku i vdekjes ishte një plagë me armë zjarri në kokë. Por edhe plaga me armë zjarri në pjesën e legenit mund të ketë qënë vdekjeprurëse.¹⁷⁹³ Dushan Dunjiqi¹⁷⁹⁴ arriti në përfundimin se viktima nuk ishte vrarë në vendin ku u gjet kufoma, porse kufoma është sjellë atje

¹⁷⁸⁰ Sadri Selca, T. 10886-10887.

¹⁷⁸¹ Sadri Selca, T. 10865.

¹⁷⁸² Sadri Selca, T. 10867; P898 (Deklarata e Hysen dhe Ahmet Ukajt, 28 gusht 1998).

¹⁷⁸³ Sadri Selca, T. 10867; P898 (Deklarata e Hysen dhe Ahmet Ukajt, 28 gusht 1998).

¹⁷⁸⁴ Sadri Selca, T. 10867; P898 (Deklarata e Hysen dhe Ahmet Ukajt, 28 gusht 1998).

¹⁷⁸⁵ Sadri Selca, T. 10862, 10864.

¹⁷⁸⁶ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojcë A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

¹⁷⁸⁷ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 61-62; P414 (Fotografi të ndryshme), f. 20; P416 (Fotografi të ndryshme), f. 3; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 18; P645 (Fotografi të ndryshme), f. 2; P649 (Fotografi të ndryshme), f. 2.

¹⁷⁸⁸ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 65; P415 (Fotografi të ndryshme), f. 14; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 16, numri 89, f. 19; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 0:22'10".

¹⁷⁸⁹ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 64; Branimir Aleksandriq, T. 6758; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 19, numri 102; P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 188; P801 (Fotografi të R-1).

¹⁷⁹⁰ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 188.

¹⁷⁹¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 24.

¹⁷⁹² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 26.

¹⁷⁹³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 27.

¹⁷⁹⁴ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

pas vdekjes.¹⁷⁹⁵ Kufoma ishte veshur me një fustan të gjatë me vija vertikale në të kaltër të errët dhe të bardha si dhe me kopsa të bardha.¹⁷⁹⁶ Autopsia e kufomës e kryer në shtator 1998 zbuloi një vrimë plumbi në kokë shkrehur nga një armë dore.¹⁷⁹⁷ Plaga e hyrjes së plumbit ishte në anën e majtë të pjesës fundore të kafkës; plaga e daljes ishte në pjesën e prapme të kafkës, pak me poshtë pikës së mesit.¹⁷⁹⁸ Sipas dëshmitarit, mund të supozohet se plaga me armë zjarri në kokë u shkaktua para vdekjes dhe se kjo plagë mund të ketë qenë shkaku i vdekjes.¹⁷⁹⁹

352. Meqë Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi të shumta për vrasjen e pretenduar të Sanije Balajt, ajo do t'i shqyrtojë këto dëshmi me hollësi. Më 12 gusht 1998, Sanije Balaj u ndalua në një postbllok pranë Baranit nga një grup ushtarësh të UÇK-së, midis të cilëve ishte Metë Krasniqi. Pastaj Sanije Balajn e çuan në një ndërtesë në Baran. Dëshmitari 72 dëshmoi se Avni Krasniqi ishte një nga ushtarët në postbllok dhe se ai tregoi një bllok shënimesh ku ishte emri i Sanije Balajt si person që duhet të merrej në pyetje. Mirëpo Avni Krasniqi mohon të ketë qenë i pranishëm në postbllok. Përkundrazi, ai dëshmoi se pa dy ushtarë që nuk mund t'i identifikonte të cilët e çuan Sanije Balajn në ndërtesën në Baran. Në dallim me këtë, Cufë Krasniqi dëshmoi se Avni dhe Ibër Krasniqi erdhën tek ai dhe e informuan se Sanije Balaj ishte ndaluar pasi ekzistonin dyshime se ajo bashkëpunonte me serbët. Pas kapjes së saj, Cufë Krasniqi e mori atë shkurtimisht në pyetje për çështjen e bashkëpunimit. Ai pa se ajo kishte me vete një bllok ku ishin shkruar emra serbësh, si dhe një sasi të konsiderueshme parash. Cufë Krasniqi dëshmoi se fillimisht Avni Krasniqi ishte i pranishëm gjatë marrjes në pyetje, se më pas atij iu tha të largohej, porse ai vazhdoi të qëndronte shumë afër deri në përfundimin e seancës së pyetjeve. Avni Krasniqi mohoi të ketë qenë i pranishëm gjatë seancës së pyetjeve, por deklaroi se e kishte ndjekur këtë seancë nga dritarja. Pas një seance të shkurtër pyetjesh, Cufë Krasniqi vendosi t'a lironte Sanije Balajn nga mbajtja në arrest prej UÇK-së. Sipas Avni Krasniqit, pas lirim të saj, Idriz Gashi, i cili njihej gjithashtu si Galani, lexoi me zë të lartë emra serbësh nga blloku i Sanije Balajt. Avni Krasniqi njohu disa prej tyre si emra të disa policëve serbe. Pastaj Idriz Gashi dha urdhër që ajo të çohet në Gllogjan. Pas kësaj, Sanije Balaj hipi në një makinë me disa ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët të paktën Idriz Gashi dhe Avni Krasniqi. Përveç urdhrin të dhënë nga Idriz Gashi, Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi tjetër për ndonjë urdhër të UÇK-së që Sanije Balaj të çohet në Gllogjan, dhe as që për këtë urdhër të ketë pasur dijeni ndonjë person tjetër përveç Idriz Gashit dhe Avni Krasniqit. Përkundrazi, dëshmitë tregojnë se Cufë Krasniqi besonte se Sanije Balaj kishte pranuar që Avni Krasniqi t'a shoqëronte me makinë për në shtëpinë e saj.

¹⁷⁹⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 188, 710; Dushan Dunjiq, T. 7306-7307.

¹⁷⁹⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 198; Dushan Dunjiq, T. 6847; P802 (Raport i autopsisë R-1), f. 1-2; P804 (Fotografi R-1), f. 5.

¹⁷⁹⁷ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 194.

¹⁷⁹⁸ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 194; P802 (Raport i autopsisë R-1), f. 1-2, 6; P805 (Fotografi të R-1).

353. Ushtarët udhëtuan për në jug të Baranit dhe ndaluan në një vend të quajtur Lugu i Isufit. Avni Krasniqi pretendon se Sanije Balaj kërkoi të bisedonte privatisht me Idriz Gashin, dhe se doli nga makina me dëshirën e vet, së bashku me Idriz Gashin. Avni Krasniqi qëndroi në makinë dhe menjëherë pas kësaj ai dëgjoi disa të shtëna arme. Mirëpo Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar gjithashtu dëshmi të dorës së dytë sipas të cilave dy burra e kishin nxjerrë me forcë gruan nga makina dhe se menjëherë pas kësaj u dëgjuan disa të shtëna. Duke patur parasysh situatën në të cilën ndodhej gruaja, Dhoma Gjyqësore nuk mendon se kishte arsye që Sanije Balaj të kërkonte një bisedë private, siç sugjeron Avni Krasniqi në dëshminë e tij. Dhoma Gjyqësore konkludon se Idriz Gashi, duke vepruar vetëm, apo me Avni Krasniqin, doli nga makina me Sanije Balajn, bëri disa hapa deri sa hynë në pyll, dhe shtiu kundër saj disa herë, duke e vrarë.

354. Më vonë po atë ditë, më 12 gusht 1998, ushtarë të UÇK-së nga fshati fqinj i Vranocit të Vogël hasën Idriz Gashin pranë kufomës së Sanije Balajt në Lugun e Isufit. Idriz Gashi u tha se kishte vrarë Sanije Balajn, dhe u lexoi emra serbësh nga blloku i saj. Ahmet Ukaj dëshmoi se njohu disa nga emrat si emra të policëve serbe. Avni Krasniqi dhe disa ushtarë vendas të UÇK-së, me urdhër të Idriz Gashit, e varrosën trupin e Sanije Balajt në atë vend. Avni Krasniqi dëshmoi se më 15 gusht 1998, përsëri me urdhër të Idriz Gashit, ai, Ibër Krasniqi, dhe Idriz Balaj u kthyen në atë vend, zhvarrosën kufomën dhe e mbështollën me një batanije. Pastaj Idriz Balaj e transportoi kufomën nga Lugu i Isufit në një vend tjetër. Në shtator 1998, kufoma e saj u gjet në kanalën e Radoniqit. Kufoma ishte mbështellë me një thes plastik dhe një thes jute. Megjithëse Dushan Dunjiq konstatoi vetëm një plagë me armë zjarri në kokë, një autopsi e mëvonshme konstatoi disa plagë me armë zjarri. Dëshmia mjekoligjore e përcakton plagën me armë zjarri në kokë apo në legen si shkakun e vdekjes.

355. Mbi bazën e dëshmive, dhe megjithëse Idriz Gashi nuk pati mundësi të paraqiste versionin e tij për ngjarjet, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes para saj si dhe për të përcaktuar nëse autorët e vrasjes kishin lidhje me UÇK-në, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se Idriz Gashi vrau Sanije Balajn. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi sipas të cilave Idriz Gashi pretendonte se ishte komandant i UÇK-së. Dëshmitë tregojnë gjithashtu se ishin disa persona që atë kohë pretendonin se ishin komandantë të zonës. Për më tepër një urdhër i UÇK-së, i nënshkruar nga Ramush Haradinaj, i referohet Idriz Gashit si “luftëtar” dhe e transferon atë larg zonës së Dukagjinit në korrik të vitit 1998. Duke patur parasysh disa mospërputhje midis dëshmisë së Avni Krasniqit dhe dëshmive të disa dëshmitarëve të tjerë, si dhe rolin e tij në ngjarjet, Dhoma Gjyqësore

¹⁷⁹⁹ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 196.

konkludon se nuk mund të mbështetet plotësisht në dëshminë e Avni Krasniqit përse i përket implikimit të tij në vrasjen.

356. Dhoma Gjyqësore është e bindur se krimi kishte lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se Sanije Balaj nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën kur u krye krimi, dhe se vrasësi ishte ose duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë fakt.

357. Idriz Balaj nuk akuzohet për vrasjen në bazë të asnjë formë përgjegjësie, veçse si pjesëmarrës në ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore e trajton implikimin e tij në këtë kontekst. Duke patur parasysh mospërputhjet midis dëshmisë së Avni Krasniqit me ato të dëshmitarëve të tjerë, siç u theksua më sipër, Dhoma Gjyqësore konstaton se dëshmia e tij për implikimin e Idriz Balajt nuk vërtetohet në mënyrë të mjaftueshme. Shaban Balaj dha vetëm dëshmi të dorës së dytë, me burim Metë Krasniqin, sipas së cilës Idriz Balaj ishte i implikuar në rivarrosjen. Burimi i informacionit të Metë Krasniqit nuk dihet. Për më tepër, Avni Krasniqi dëshmoi se kufoma u transportua e mbështjellë me një batanije, ndërsa dëshmia mjekoligjore thotë se kufoma u gjet e mbështjellur në dy thasë. Për shkak të kësaj mospërputhjeje dhe duke marrë parasysh dëshminë e Avni Krasniqit, Dhoma Gjyqësore nuk mund të përcaktojë nëse kufoma u çua drejtpërdrejtë nga Lugu i Isufit në kanalin e Radoniqit. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundimin nëse Idriz Balaj ka qënë i implikuar në transportimin e kufomës së Sanije Balajt në kanalin e Radoniqit.

358. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi nga një numër dëshmitarësh për një hetim të UÇK-së në lidhje me vdekjen e Sanije Balajt. Ramush Haradinaj, Tahir Zemaj, dhe Gani Gjukaj këmbëngulën në një hetim të tillë. Fadil Nimani dhe Hysen Gashi, të dy pjesëtarë të policisë ushtarake të UÇK-së, kryen një hetim dhe morën në pyetje, të paktën, Shaban Balajn, Avni Krasniqin, Cufë Krasniqin, dhe Ahmet Ukajn. Edhe Sadri Selca e hetoi këtë çështje, dhe Zymer Hasanaj i raportoi për çështjen Din Krasniqit i cila tha se ata që ishin përgjegjës për të duhet të dënoheshin. Gjithashtu Ramush Haradinaj dhe Gani Gjukaj vizituan të afërmit e Sanije Balajt për t'u shprehur ngushëllimet e tyre.

359. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se Sanije Balaj dyshohej se bashkëpunonte me serbët. Mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundimin se kjo ishte arsyeja e vrasjes së Sanije Balajt, pasi dëshmitë sugjerojnë motive të tjera të logjikshme. Të tre të Akuzuarit akuzohen për vrasjen e Sanije Balajt si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do t'a trajtojë këtë formë përgjegjësie veças në pjesën 7, më poshtë.

6.12.13 Vrasja e Sejd Nocit

360. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e Sejd Nocit si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga Avdullah Avdija, Dëshmitari 64, dhe Dëshmitari 71, si dhe dëshmi mjekoligjore.

361. Avdullah Avdija, anëtar i UÇK-së,¹⁸⁰⁰ dëshmoi se një ditë në fillim të korrikut 1998 dëshmitari u informua nga Besim Alija Rama, eprori i tij në UÇK, se Sejd Noci kërkohet nga UÇK-ja.¹⁸⁰¹ Dëshmitari dëgjoi nga fshatarë të tjerë se Deli Delija, kushëri i Sejd Nocit, i kishte premtuar Besim Alija Ramës se do ta sillte Sejd Nocin tek UÇK-ja.¹⁸⁰² Sipas dëshmitarit, Deli Delija nuk ishte anëtar i UÇK-së.¹⁸⁰³ Dëshmitarit i thanë disa njerëz, emrat e të cilëve nuk i kujtoheshin, se po atë natë Besim Alija Rama, i armatosur dhe i veshur me uniformë të UÇK-së, shkoi në shtëpinë në Koshare, komuna e Gjakovës, ku banonin në atë kohë Sejd Noci dhe Deli Delija dhe thirri Deli Delinë.¹⁸⁰⁴ Sejd Noci e kuptoi se ai që po thërriste ishte Besim Alija Rama dhe i tha Deli Delisë se atë po e kërkonte UÇK-ja.¹⁸⁰⁵ Pas një bisede të shkurtër me Deli Delinë, Besim Alija Rama u largua.¹⁸⁰⁶ Të nesërmen dëshmitari pa Deli Delinë dhe Besim Alija Ramën që po bisedonin me njëri tjetrin në Junik, komuna e Deçanit.¹⁸⁰⁷ Dëshmitari e kaloi atë natë në shtëpinë në Koshare ku ishin strehuar Deli Delija dhe Sejd Noci.¹⁸⁰⁸ Të nesërmen, Sejd Noci e pyeti dëshmitarin nëse mund t'a ndihmonte të arratisesh në Shqipëri pasi ishte frikësuar për faktin se po e kërkonte UÇK-ja.¹⁸⁰⁹ Dëshmitari tha se për shkak se ishte anëtar i UÇK-së, ai nuk mund t'a ndihmonte Sejd Nocin.¹⁸¹⁰ Si përfundim Sejd Noci vendosi të shkonte në Junik, të dorëzohej tek UÇK-ja dhe të mësonte se përse po e kërkonin.¹⁸¹¹ Sejd Noci, Deli Delija, dhe dëshmitari shkuan në Junik atë ditë dhe u ndaluan në një vend, në hyrje të qytetit, nga 3 apo 4 ushtarë të UÇK-së.¹⁸¹² Meqë dëshmitari ishte i veshur me uniformë të UÇK-së, ai u lejua të kalonte dhe të vazhdonte rrugën për në qytet.¹⁸¹³ Deli Delija dhe Sejd Noci qëndruan prapa dhe kjo ishte hera e fundit që dëshmitari i pa të dy burrat.¹⁸¹⁴ Më pas dëshmitari dëgjoi nga njerëz në Tropojë në Shqipëri se Sejd Noci ishte marrë nga UÇK-ja.¹⁸¹⁵

¹⁸⁰⁰ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), f. 2, paragrafët 1, 11, 15; Avdullah Avdija, T. 10568-10569.

¹⁸⁰¹ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 8; Avdullah Avdija, T. 10580-10581.

¹⁸⁰² P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 8.

¹⁸⁰³ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 8.

¹⁸⁰⁴ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 9.

¹⁸⁰⁵ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 9.

¹⁸⁰⁶ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 9.

¹⁸⁰⁷ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 10.

¹⁸⁰⁸ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 10.

¹⁸⁰⁹ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 11.

¹⁸¹⁰ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 11.

¹⁸¹¹ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafët 11-12.

¹⁸¹² P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 13; Avdullah Avdija, T. 10575-10577.

¹⁸¹³ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 13.

¹⁸¹⁴ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 13; Avdullah Avdija, T. 10578, 10580-10581; P1224 (Hartë e shënuar nga Avdullah Avdija).

¹⁸¹⁵ P1223 (Avdullah Avdija, deklaratë dëshmitari, 11 nëntor 2007), paragrafi 14.

362. Dëshmitari 64, oficer i MPB-së, ishte ngarkuar që të mblihte dëshmi fotografike dhe filmike për hetimin në rrethinën e kanalit të Radoniqit nga 11 deri më 26 shtator 1998.¹⁸¹⁶ Më 18 dhe 19 shtator 1998, Dëshmitari 64 filmoi procesin e identifikimit që u krye në Hotelin Pashtrik.¹⁸¹⁷ Ai dëshmoi se në një moment të caktuar, Dëshmitari 71, i cili dukej se ishte i nervozuar nga filmimi me video që po i bënte Dëshmitari 64, i tha Gjykatësit Radomir Gojkoviç se ai dhe Sejd Noci ishin rrëmbyer dhe ishin çuar në shtëpinë e Ramush Haradinajt.¹⁸¹⁸ Sipas Dëshmitarit 64, i cili e pa edhe një herë filmin, Dëshmitari 71 tha se më pas atë e kishin liruar por Sejd Nocin e kishin vvarë.¹⁸¹⁹ Kur kjo pjesë e videofilmimit së dëshmitarit u shfaq para Dhomës Gjyqësore, cilësia e zërit të filmimit ishte e paqartë dhe filmimi nuk vërtetonte rrëfimin e Dëshmitarit 64 për bisedën.¹⁸²⁰ Dëshmitari 71 dëshmoi se ushtarë të UÇK-së e kishin çuar në shtabin e UÇK-së në Glogjan, se atje ishte pyetur në lidhje me një djalë të ri dhe se më pas e kishin liruar.¹⁸²¹

363. Dhoma Gjyqësore ka marrë gjithashtu dëshmi mjekoligjore lidhur me Sejd Nocin (kufoma me numrat “R-21”, “R-24” dhe “R-27B”). Branimir Aleksandriç¹⁸²² dëshmoi se pjesët R-21 dhe R-24 të kufomës u gjetën rreth 650 metra përgjatë rrjedhës së poshtme të kanalit të Radoniqit, pranë njëra tjetrës (rreth 4 metra largësi), në pjesën e thatë të rrëpirës, fill mbi vijën e ujit.¹⁸²³ Më 12 shtator 1998, rreth 60 metra larg R-21 dhe R-24, në rrjedhën e poshtme, u gjetën një xhaketë e zezë, dy eshtra kërcinjsh, fleta e shpatullës së majtë, dhe një pjesë e shtyllës kurrizore së bashku me disa eshtra brinjësh. Ato u shënuan me numrin R-27.¹⁸²⁴ Rezultatet e ADN-së së KNPZh-së arritën në përfundimin se pjesët e kufomës me numër R-21, R-24 dhe R-27B i përkisnin Sejd Nocit.¹⁸²⁵ Prej autopsive të pjesëve të kufomës të kryera në dhjetor 2003 u arrit në përfundimin se thyerjet në shpatullën e majtë dhe në krahun e majtë dukeshin se ishin nga armë zjarri.¹⁸²⁶ Shkaku i vdekjes nuk u përcaktua.¹⁸²⁷ Dushan Dunjiç¹⁸²⁸ dëshmoi se autopsia e kryer në shtator 1998 zbuloi thyerje

¹⁸¹⁶ P907 (Dëshmitari 64, deklaratë dëshmitari, 23, 24, dhe 27 gusht 2007), paragrafët 6, 9-13.

¹⁸¹⁷ P907 (Dëshmitari 64, deklaratë dëshmitari, 23, 24, and 27 gusht 2007), paragrafi 106-109.

¹⁸¹⁸ P907 (Dëshmitari 64, deklaratë dëshmitari, 23, 24, and 27 gusht 2007), paragrafi 108.

¹⁸¹⁹ P907 (Dëshmitari 64, deklaratë dëshmitari, 23, 24, and 27 gusht 2007), paragrafi 108.

¹⁸²⁰ Dëshmitari 71, T. 10034-10037; D66 (Filmim i kanalit të Radoniqit dhe Hotel Pashtrikut, 12-19 shtator 1998), 1:48'00" – 1:49'50"; P1024 (Kopje e zmadhuar e një pjese të D66).

¹⁸²¹ Dëshmitari 71, T. 10022-10028, 10046-10049.

¹⁸²² P1260 (Branimir Aleksandriç, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriç, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriç, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriç, 26 qershor 2007).

¹⁸²³ P1260 (Branimir Aleksandriç, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 164, 171-172, 175, 177-178; Branimir Aleksandriç, T. 6807-6808, 6810, 9585; P452 (Filmim i gjetjes së kufomës në kanal), 1:57'46"- 1:57'56", 1:59'24"- 1:59'33"; P1115 (Shtojca C e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriç, 26 qershor 2007, raporte të datave 15 dhe 16 shtator 1998), f. 4, 10.

¹⁸²⁴ P1260 (Branimir Aleksandriç, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 128, 164, 171, 197, 200, 201-204; Branimir Aleksandriç, T. 9602-9603, 9613-9614; P449 (Fotografi të ndryshme), f. 52, fotografi e poshtme, f. 53; P747 (Raport i autopsisë R-27), f. 1-2; P749 (Fotografi të autopsisë R-27), f. 2-3; P1115 (Shtojca C e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriç, 26 qershor 2007, raporte të datave 15 dhe 16 shtator 1998), f. 5, 11.

¹⁸²⁵ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 95.

¹⁸²⁶ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 97.

¹⁸²⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 97.

¹⁸²⁸ P618 (Dushan Dunjiç, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiçit), f. 2.

në kafkë, në shpatullën e majtë, dhe në këmbën e djathtë, të cilat mund të ishin shkaktuar nga një rrëzim në kanal.¹⁸²⁹

364. Siç u përmend më sipër, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi nga Avdullah Avdiija, sipas të cilit në fillim të korrikut 1998 ai mësoi se Sejd Nocin e kërkonte UÇK-ja. Rreth asaj kohe Noci u pa për herë të fundit në një postbllok me 3 apo 4 ushtarë të UÇK-së në hyrje të Junikut. Ai po shkonte në Junik për t'iu dorëzuar UÇK-së. Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur nga dëshmia e Dëshmitarit 64 se ushtarët i shoqëruan Dëshmitarin 71 dhe Sejd Nocin për në Gllogjan së bashku pasi videofilmimi, ku Dëshmitari 64 mbështet dëshminë e tij, nuk i vërteton thëniet e tij për këtë çështje. Për më tepër, në dëshminë e tij para Dhomës Gjyqësore, Dëshmitari 71 nuk përmendi se Sejd Noci u çua në Gllogjan së bashku me të. Eshtrat e Sejd Nocit u gjetën në rrëpirën në rrjedhën e poshtme të kanalit të Radoniqit. Dëshmia mjekoligjore nuk e përcakton shkakun e vdekjes. Ndërsa dëshmia e KNPZh-së sugjeron se thyerjet e konstatuara në eshtrat e Sejd Nocit ishin shkaktuar me armë zjarri, Dushan Dunjiqi nuk përjashton mundësinë që këto thyerje të jenë shkaktuar nga hedhja e trupit në kanal. Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Sejd Noci është vrarë. Për këtë arsye Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të lirohen shpallen të pafajshëm për këtë akuzë.

6.12.14 Vrasja e personave të paignifikuar

365. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndëmmarrje të përbashkët kriminale, për vrasjen e pesë personave si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi mjekoligjore lidhur me këta pesë persona (kufomat me numër “R-10/1”, “R-29”, “R-30”, “R-32” dhe “R-18/1”, dhe “R-33”).

366. Branimir Aleksandriq dëshmoi se kufomat R-10/1, R-29, R-30, R-32 and R-18/1, dhe R-33 u gjetën më 15 shtator 1998 në vende të ndryshme në kanalën e Radoniqit dhe në rrëpirën në rrjedhën e poshtme të kanalit.¹⁸³⁰ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja pjesët e kufomës me numër R-10/1 u identifikuan se i përkisnin një anëtari të familjes së Misin Berishës.¹⁸³¹ Autopsia e kufomës e kryer më 8 dhjetor 2003 zbuloi mbetje kufome tërësisht të skeletizuar të një personi të moshës nga 10 deri në 17 vjeç.¹⁸³² Autopsia konstatoi thyerje të shumta në krahun e djathtë, por nuk

¹⁸²⁹ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 464; P727 (Raport i autopsisë R-21), f. 2; P739 (Raport i autopsisë R-24), f. 2.

¹⁸³⁰ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 206-207, 215-216, 219-221, 224, 229-230, 232, 235-236, 240, 242, 267; Branimir Aleksandriq, T. 9583-9584; P449 (Fotografi të ndryshme), f. 55, 57, fotografi e poshtme, 61; P459 (Fotografi të ndryshme), f. 59, fotografi e sipërme, 61; P756 (Fotografi të autopsisë R-29), f. 2-3; P757 (Raport i autopsisë R-30), f. 1; P759 (Fotografi të autopsisë R-30), f. 2-3; P769 (Fotografi të autopsisë R-33), f. 2; P1115 (Shtojca C e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007, raporte të datave 15 dhe 16 shtator 1998), f. 12; P1122 (Fotografi e R-29); P1123 (Fotografi e R-29); P1127 (Fotografi e R-30); P1131 (Fotografi e kafkës R-33).

¹⁸³¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 60.

¹⁸³² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr 61-62.

përcakttoi shkakun e vdekjes.¹⁸³³ Dushan Dunjiqi¹⁸³⁴ dëshmoi se mbetja skeletore R-10/1 ishte vendosur në të njëjtin thes kufomash me kufomën R-10, por ato nuk i përkiste kufomës R-10.¹⁸³⁵ Autopsia e kryer në shtator 1998 konstatoi se parakrahu i djathtë ishte thyer në një mënyrë të tillë që nuk mund të ishin shkaktuar nga një rënie.¹⁸³⁶

367. Më 5 dhjetor 2003, një autopsi e kufomës me numër R-29 konstatoi se kufoma ishte e një mashkulli të moshës nga 33 deri në 45 vjeç dhe se në ballë kishte një plagë që përputhej me një goditje me një send jo e mprehtë.¹⁸³⁷ Shkaku i vdekjes u përcaktua goditja me armë zjarri në kraharor si dhe plaga e shkaktuar me një send jo të mprehtë në kokë.¹⁸³⁸ Më 8 dhjetor 2003, një autopsi e kufomës me numër R-30 identifikoi vetëm pjesë të këmbëve në të cilat nuk kishte shenja të qarta plagësh.¹⁸³⁹ Shkaku i vdekjes nuk u përcaktua.¹⁸⁴⁰

368. Më 8 dhjetor 2003, autopsia e kufomës me numër R-32 dhe R-18/1 konstatoi se kufoma i përkiste një mashkulli të moshës 17 deri në 22 vjeç.¹⁸⁴¹ Autopsia konstatoi të shumta në kafkë që zakonisht shkaktohen nga plaga e futjes së një plumbi.¹⁸⁴² Gjithashtu u panë fraktura në shpatullën e majtë dhe në pjesën e legenit, të cilat zakonisht shkaktohen nga plagë me armë zjarri.¹⁸⁴³ Shkaku i vdekjes u përcaktua plagë me armë zjarri në kraharor, kokë, dhe në pjesën e legenit.¹⁸⁴⁴ Dushan Dunjiqi¹⁸⁴⁵ dëshmoi se autopsia e kufomës kryer në shtator 1998, zbuloi plagë nga hyrja e një plumbi në shpatullën e djathtë dhe në eshtrenë e kofshës së djathtë, të cilat nëqoftëse do të shkaktohen para vdekjes sugjerojnë se vdekja ka ardhur nga goditje me plumb në kraharor dhe zonën e legenit.¹⁸⁴⁶ Autopsia zbuloi gjithashtu thyerje në kafkë, në trung, si dhe në duar dhe shputat e këmbëve, ndoshta të shkaktuara prej goditjes me një send jo të mprehtë.¹⁸⁴⁷ Më 5 dhjetor 2003, autopsia e një kafke tërësisht të skeletizuar me numër R-33 zbuloi se kafka i përkiste një mashkulli nën moshën 30 vjeç.¹⁸⁴⁸ Kishte thyerje në pjesët ballore të kafkës.¹⁸⁴⁹ Shkaku i vdekjes nuk u përcaktua.¹⁸⁵⁰

369. Mbi bazën e dëshmive, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se në shtator 1998, në kanalën e Radoniqit si dhe në rrëpirën në rrjedhën e poshtme të kanalit, u gjetën mbetje skeletore të

¹⁸³³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 62.

¹⁸³⁴ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁸³⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 311; P677 (Raport i autopsisë R-10/1), f. 1.

¹⁸³⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 313; P677 (Raport i autopsisë R-10/1), f. 2.

¹⁸³⁷ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 128.

¹⁸³⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 129.

¹⁸³⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 131.

¹⁸⁴⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 131.

¹⁸⁴¹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 133.

¹⁸⁴² Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 133.

¹⁸⁴³ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 133.

¹⁸⁴⁴ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 134.

¹⁸⁴⁵ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafët 2-3, 23, 40, 151; P620 (CV e Dushan Dunjiqit), f. 2.

¹⁸⁴⁶ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 580; P764 (Raport i autopsisë R-32), f. 4.

¹⁸⁴⁷ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 581; P718 (Raport i autopsisë R-18/1), f. 1; P764 (Raport i autopsisë R-32), f. 2-4.

¹⁸⁴⁸ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 136.

¹⁸⁴⁹ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 136.

pesë personave. Këto mbetje skeletore të paightifikuara u emërtuan R-10/1, R-29, R-30, R-32 së bashku me R-18/1, dhe R-33. Dhoma Gjyqësore nuk disponon prova se kur u panë për herë të fundit si dhe në çfarë rrethanash janë vranë këta pesë persona të paightifikuar. Për më tepër, Dhomës Gjyqësore nuk mori prova në lidhje me identitetin e këtyre personave, kombësinë e tyre, përkatësinë politike, nëse ka ekzistuar një përkatësi e tillë, apo se cili ishte statusin e tyre civil ose ushtarak. I vetmi përjashtim është mbetja skeletore me numër R-10/1, që i përkiste një anëtarit të familjes së Misin Berishës (Dhoma Gjyqësore e shqyrtoi vrasjen e pretenduar të Misin Berishës në pjesën 6.11, më sipër). Dëshmia mjekoligjore e lartpërmendur për R-29 dhe R-32 së bashku me R-18/1 sugjeron bindshëm se këta persona janë vranë. Në pjesën 6.1, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shpjeguar se fakti i gjetjes së një kufome në rrethinën e kanalit të Radoniqit nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të arritur në përfundimin se kush e kreu vrasjen, apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse ka ekzistuar një lidhje e tillë. Thyerjet në mbetjet skeletore R-10/1 dhe R-33 nuk zbardhin shkakun e këtyre thyerjeve, me përjashtim të faktit se thyerjet e R-10/1 nuk mund të jenë shkaktuar nga ndonjë rënie. Rrjedhimisht këto lëndime nuk ndihmojnë për të përcaktuar nëse shkakun e vdekjes ka qënë vrasja. Mbetja skeletore R-30, që përbëhet vetëm nga eshtra këmbësh, nuk kishte lëndime që të çojnë në përfundimin se shkakun e vdekjes ka qënë vrasja.

370. Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, se individët, mbetjet skeletore të të cilëve janë shënuar R-10/1, R-30, dhe R-33, u vranë. Edhe po të supozohet se R-29 dhe R-32 së bashku me R-18/1 janë vranë, Dhoma Gjyqësore gjykon se provat që disponon nuk e lejojnë të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se kush e kreu këto vrasje, apo me cilin grup ishte i lidhur vrasësi, nëqoftëse një lidhje e tillë ka ekzistuar. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për këtë akuzë.

6.13 Trajtimi mizor, torturimi dhe vrasja e Ivan Zariqit dhe të tjerëve (Pika 24)

371. Të tre të akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor, torturimin, dhe vrasjen e Ivan Zariqit dhe të tjerëve si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Ndryshe, Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj akuzohen se kanë kryer, apo ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Ndryshe, Lahi Brahimaj, akuzohet se ka urdhëruar, nxitur, apo ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga Dëshmitari 3, Dëshmitari 66, dhe Dëshmitarja 31.

¹⁸⁵⁰ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 136.

372. Dëshmitari 3 dëshmoi se në fshatin Grabanicë, komuna e Klinës, ka patur një mulli që punonte ende, të paktën deri më 19 maj 1998.¹⁸⁵¹ Pak ditë para 19 majit 1998, ai ishte në fshat kur pa një serb dhe dy të rinj romë në një karrocë kuajsh të ngarkuar me drithra.¹⁸⁵² Dëshmitari 3 i pyeti ku po shkonin, dhe ata u përgjigjën se po shkonin në Grabanicë.¹⁸⁵³ Sipas Dëshmitarit 3, ata nuk dolën kurrë nga fshati.¹⁸⁵⁴

373. Dëshmitari 66 dëshmoi se e pa Burim Bejtën, Agron Berishën, të dy romë, dhe Ivan Zariqin, serb, për herë të fundit më 19 maj 1998, në orën 9:30 të mëngjesit.¹⁸⁵⁵ Këta tre persona po largoheshin nga Dollci, komuna e Klinës, me karrocën e Burim Bejtës e tërhequr nga një kalë.¹⁸⁵⁶ Ata po çonin misër për t'a bluar, në mullirin e Grabanicës, komuna e Klinës.¹⁸⁵⁷ Dëshmitarit nuk iu kujtua vetë data e saktë, por e mësoi këtë datë nga motra e tij.¹⁸⁵⁸ Kur të tre personat nuk u kthyen nga udhëtimi i tyre për në mulli, dy të afërmit të dëshmitarit shkuan në Grabanicë rreth orës 2:00 apo 3:00 pasdite po atë ditë për të pyetur për ta.¹⁸⁵⁹ Pasi u kthyen, të afërmit i thanë dëshmitarit se ishin ndaluar në Grabanicë nga tre apo katër shqiptarë të cilët ishin të armatosur me pushkë gjysëm automatike dhe se ata u kishin kërkuar letërnjoftimet dhe më pas kishin shënuar emrat e tyre.¹⁸⁶⁰ Të pyetur nga të afërmit, shqiptarët iu thanë se nuk i kishin parë kurrë personat që po kërkonin ata.¹⁸⁶¹

374. Të nesërmen më 20 maj 1998, disa nga të afërmit e dëshmitarit u nisën nga fshati rreth mesditës drejt Grabanicës sërish në kërkim të personave të zhdukur.¹⁸⁶² Atje ata hasën 40 - 50 veta, gjysma prej të cilëve të veshur me uniforma, dhe tre apo katër prej tyre i kërcënuan të afërmit e dëshmitarit duke iu drejtuar armët, dhe u thanë se personat e zhdukur nuk kishin qenë asnjëherë në fshatin e tyre dhe u kërkuan të largoheshin.¹⁸⁶³ Dëshmitari e mësoi këtë ngjarje nga të afërmit e tij kur këta u kthyen.¹⁸⁶⁴ Tri apo katër ditë pas zhdukjes së Burim Bejtës, Agron Berishës, dhe Ivan Zariqit, dëshmitari pa karrocën me kalë të Burim Bejtës, e cila kaloi pranë shtëpisë së dëshmitarit e ngarë nga tre djem shqiptarë nga fshati Zajm, komuna e Klinës.¹⁸⁶⁵ Dëshmitari dhe nëna e tij e njohën kalin dhe dëshmitari njohu gjithashtu një thes të bardhë me misër.¹⁸⁶⁶ Dëshmitari ua dorëzoi djemtë policisë, së cilës i tergoi gjithashtu për personat e zhdukur. Më pas policia i tha dëshmitarit

¹⁸⁵¹ Dëshmitari 3, T. 7898, 7905, 7912-7914, 7916, 7985.

¹⁸⁵² Dëshmitari 3, T. 7915, 8029-8030.

¹⁸⁵³ Dëshmitari 3, T. 7916, 8030-8031.

¹⁸⁵⁴ Dëshmitari 3, T. 7915-7916.

¹⁸⁵⁵ Dëshmitari 66, T. 8413-8415, 8417-8419, 8422-8423, 8431.

¹⁸⁵⁶ Dëshmitari 66, T. 8422-8423, 8431.

¹⁸⁵⁷ Dëshmitari 66, T. 8419, 8422-8423, 8431.

¹⁸⁵⁸ Dëshmitari 66, T. 8423.

¹⁸⁵⁹ Dëshmitari 66, T. 8424, 8427.

¹⁸⁶⁰ Dëshmitari 66, T. 8424-8425, 8427-8428.

¹⁸⁶¹ Dëshmitari 66, T. 8424-8425.

¹⁸⁶² Dëshmitari 66, T. 8426, 8428.

¹⁸⁶³ Dëshmitari 66, T. 8426-8429.

¹⁸⁶⁴ Dëshmitari 66, T. 8428-8429.

¹⁸⁶⁵ Dëshmitari 66, T. 8429-8430. Shihni gjithashtu Dëshmitaren 31, T. 9520-9521.

¹⁸⁶⁶ Dëshmitari 66, T. 8429-8430.

se fëmijët ishin nga Përlina, komuna e Klinës, dhe se ata e kishin gjetur karrocën para shtëpisë së tyre.¹⁸⁶⁷

375. Dëshmitarja 31 i njihte mirë Burim Bejtën, Ivan Zariqin, dhe Agron Berishën.¹⁸⁶⁸ Dëshmitarja dëshmoi se tre të rinjtë i pa për herë të fundit një mëngjes rreth orës 10:00.¹⁸⁶⁹ Dëshmitares nuk i kujtohej muaji apo viti i kësaj ngjarjeje, por mendonte se kishte ndodhur në vitin 1998 ose 1999.¹⁸⁷⁰ Të tre këta persona po udhëtonin së bashku në një karrocë me kalë.¹⁸⁷¹ Ata po çonin një thes me misër në një mulli në Grabanicë, komuna e Klinës.¹⁸⁷² Mbrëmjen e po asaj dite, pasi pritën që Bejta dhe dy shokët e tij të ktheheshin, Dëshmitarja 31 dhe nëna e Burim Bejtës u nisën për t'i kërkuar.¹⁸⁷³ Në Grabanicë dëshmitarja hasi në një numër të madh burrash të armatosur (“ndoshta 100”) të veshur me uniforma të UÇK-së.¹⁸⁷⁴ Ato shkuan në mulli dhe atje takuan një person i cili i tha nënës së Bejtës se nuk e kishte parë Burim Bejtën atë ditë.¹⁸⁷⁵

376. Mbi bazën e dëshmimeve, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se më 19 maj 1998 apo pak para kësaj date, Ivan Zariqi, serb, dhe Agron Berisha e Burim Bejta, romë, u nisën prej Dollcit për në Grabanicë me një karrocë kuajsh. Në Grabanicë ishte hera e fundit kur u panë të gjallë. Pak ditë pas zhdukjes së tyre, të afërmit gjetën karrocën me kalë, që po e ngisnin disa fëmijë, të cilët e kishin gjetur në Përlinë. Kufomat e të zhdukurve nuk u gjetën. Duke marrë parasysh se këta persona nuk janë parë më gjallë, Dhoma Gjyqësore pranon se ka plotësisht të ngjarë që ata të kenë vdekur. Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë dëshmi për mbajtjen në arrest e këtyre të rinjve prej UÇK-së, apo për rrethanat e vdekjes së tyre, ose për vrasësit. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se Grabanica ishte nën kontrollin e UÇK-së kur të tre të rinjtë hynë në këtë fshat. Mirëpo Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të konkludojë nëse ata dolën apo jo përsëri nga fshati, dhe nëqoftëse po, kur dhe si. Gjatë periudhës së zhdukjes së pretenduar të Ivan Zariqit, Agron Berishës, dhe Burim Bejtës në atë zonë ka patur veprime ushtarake. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi për një sulm të UÇK-së në Dollc në mbrëmjen e 12 majit 1998, se forcat serbe filluan të granatonin Grabanicën më 19 maj 1998 dhe se ato arritën të hynin në fshat më 21 maj 1998.¹⁸⁷⁶ Rrjedhimisht duke patur parasysh luftimet e ashpra në zonë si dhe mosgjetjen e kufomave, dhe si pasojë, mungesën e shkakut të vdekjes, Dhoma Gjyqësore nuk mund të përjashtojë mundësinë e arsyeshme se të rinjtë kanë rënë pre e luftimeve, ose forca ose persona të tjerë, që nuk kanë patur lidhje me UÇK-në, janë përgjegjës

¹⁸⁶⁷ Dëshmitari 66, T. 8429-8431.

¹⁸⁶⁸ Dëshmitarja 31, T. 9513-9514.

¹⁸⁶⁹ Dëshmitarja 31, T. 9515-9517.

¹⁸⁷⁰ Dëshmitarja 31, T. 9515.

¹⁸⁷¹ Dëshmitarja 31, T. 9516-9517, 9521.

¹⁸⁷² Dëshmitarja 31, T. 9516.

¹⁸⁷³ Dëshmitarja 31, T. 9517.

¹⁸⁷⁴ Dëshmitarja 31, T. 9518-9519.

¹⁸⁷⁵ Dëshmitarja 31, T. 9520.

¹⁸⁷⁶ Cufë Krasniqi, T. 5815; P355 (Hartë në të cilën Dëshmitari shënoi me ngjyrë të kaltër të ashtuquajturën zonë të lirë); P1166 (Raport i veprimeve luftarake, i datës 13 maj 1998), f. 1.

për zhdukjen e tyre. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi për veprime të pretenduara të të Akuzuarve lidhur me këtë ngjarje, si në akuzat alternative kundër tyre. Për këto arsye Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me këtë pikë.

6.14 Trajtimi mizor dhe vrasja e Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt (Pika 26)

377. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndëmmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimi mizor dhe vrasjen e Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Ndryshe, Lahi Brahimaj akuzohet se ka nxitur, apo ndihmuar dhe inkurajuar krytjen e krimeve. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshminë përkatëse të Dëshmitarit 54.

378. Dëshmitari 54 dëshmoi se më 20 maj, datë që më vonë iu tha dëshmitarit nga nëna e vet, Ukë Rexhepaj, ashkali nga komuna e Klinës, dhe Nesret Alijaj e morën atë nga shtëpia e Ibër Januzajt në Grabanicë, komuna e Klinës.¹⁸⁷⁷ Ata shkuan së bashku në Dollovë, komuna e Klinës, për të ushqyer bagëtitë e tyre.¹⁸⁷⁸ Në gjysmën e rrugës ata u ndaluan nga dy burra të cilët kërcënuan se do t'i vrisnin.¹⁸⁷⁹ Burrat ishin të veshur me uniforma të errta të gjelbra dhe kishin mitralozë të lehtë.¹⁸⁸⁰ Ata flisnin shqip.¹⁸⁸¹ Burrat i kontrolluan dhe u morën biçikletat si dhe të gjitha sendet personale nga xhepat e tyre.¹⁸⁸² Pastaj Ukë Rexhepajt dhe Nesret Alijajt ua mbuluan sytë dhe u lidhën duart.¹⁸⁸³ I futën me forcë në një makinë dhe thanë se do t'i sillnin përsëri.¹⁸⁸⁴ Ata i bënë me shenjë dhe thirrën një burrë të quajtur Ismet, i cili ishte në pyll, që të vinte dhe të merrte Dëshmitarin 54.¹⁸⁸⁵ Ismeti dhe Dëshmitari 54 ecën për pesë minuta derisa arritën në një shtëpi.¹⁸⁸⁶ Që atje, pa i kërkuar dëshmitarit informacion për rrugën, Ismeti e ktheu në shtëpinë e Ibër Januzajt.¹⁸⁸⁷ Dëshmitari nuk i pa më kurrë Ukë Rexhepajn dhe Nesret Alijajn.¹⁸⁸⁸

379. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se më 20 maj 1998 ose rreth kësaj date, Ukë Rexhepaj dhe Nesret Alija u morën nga dy burra të armatosur dhe me uniforma, që flisnin shqip, dhe u çuan diku midis Grabanicës dhe Dollovës. Që nga ai moment Ukë Rexhepaj dhe Nesret Alija nuk u panë më kurrë. Edhe kufomat e tyre nuk janë gjetur. Dhoma Gjyqësore gjykon se dëshmia që disponon nuk është e mjaftueshme për të arritur në përfundimin se personat që morën Ukë

¹⁸⁷⁷ Dëshmitari 54, T. 8271, 8273-8275, 8277-8278.

¹⁸⁷⁸ Dëshmitari 54, T. 8275, 8277.

¹⁸⁷⁹ Dëshmitari 54, T. 8275, 8277.

¹⁸⁸⁰ Dëshmitari 54, T. 8276.

¹⁸⁸¹ Dëshmitari 54, T. 8276.

¹⁸⁸² Dëshmitari 54, T. 8275.

¹⁸⁸³ Dëshmitari 54, T. 8276.

¹⁸⁸⁴ Dëshmitari 54, T. 8275-8276.

¹⁸⁸⁵ Dëshmitari 54, T. 8275, 8277-8278.

¹⁸⁸⁶ Dëshmitari 54, T. 8275, 8280.

¹⁸⁸⁷ Dëshmitari 54, T. 8275, 8280-8281.

¹⁸⁸⁸ Dëshmitari 54, T. 8277.

Rexhepaj dhe Nesret Alijan ishin anëtarë të UÇK-së ose të lidhur me të. Duke marrë parasysh faktin se të dy burrat nuk janë parë më që nga ajo ditë, Dhoma Gjyqësore pranon se ka plotësisht të ngjarë që Ukë Rexhepaj dhe Nesret Alija të kenë vdekur. Meqë kufomat e tyre nuk janë gjetur, mungon dëshmia e ekspertëve për shkakun e vdekjes së tyre. Dhoma Gjyqësore konstaton se dëshmia që disponoin nuk e lejon të arrijë në përfundimin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Ukë Rexhepaj dhe Nesret Alija janë vrarë. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi për keqtrajtim të pretenduar, si dhe as dëshmi për veprime të pretenduara të Lahi Brahimajt lidhur me këtë ngjarje, si në akuzën alternative. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm në lidhje me këtë pikë.

6.15 Trajtimi mizor dhe torturimi i Dëshmitarit 6 (Pika 28)

380. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndë marrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor dhe torturimin e Dëshmitarit 6 si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës. Ndryshe Lahi Brahimaj akuzohet se ka kryer, apo ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga Dëshmitari 6, si dhe nga një numër dëshmitarësh të tjerë.

381. Dëshmitari 6, shqiptar katolik,¹⁸⁸⁹ dëshmoi se rreth mesditës së 13 qershorit 1998 ai dhe familja e tij po udhëtonin me makinë në drejtim të veriut në rrugën Gjakovë - Klinë.¹⁸⁹⁰ Në hyrje të Dollovës, komuna e Klinës, ata u ndaluan nga UJ-ja e cila u tha të mos vazhdonin rrugën më tej.¹⁸⁹¹ Ata u kthyen për në Gjakovë, dhe rreth orës 13:00 pasdite, në rrugën kryesore pranë Volljakës, komuna e Klinës, ata u ndaluan nga më tepër se 10 ushtarë të UÇK-së.¹⁸⁹² Ata ishin të gjithë të armatosur; disa prej tyre ishin të veshur me rroba civile dhe të tjerët me uniforma kamuflazhi, por mbi veshjet e tyre nuk kishte asnjë simbol.¹⁸⁹³ Burrat kontrolluan dokumentat e Dëshmitarit 6 si dhe makinën e tij, ku gjetën një pistoletë të lëshuar nga policia si dhe një fotografi të Dëshmitarit 6 së bashku me një polic shqiptar në pension të veshur me uniformë.¹⁸⁹⁴ Ata morën pistoletën dhe dokumentat e Dëshmitarit 6 së bashku me lejen e armës.¹⁸⁹⁵ Dëshmitari 6 dhe familja e tij pritën në makinën e tyre, të nxjerrë nga rruga, për rreth dy orë.¹⁸⁹⁶ Pastaj dëshmitari dëgjoi një makinë që po vinte nga rruga kryesore si dhe disa të shtëna.¹⁸⁹⁷ Ushtarët sollën një Opel Kadett në ngjyrë të kaltër

¹⁸⁸⁹ Dëshmitari 6, T. 5166-5167, 5238-5239, 5263-5264, 5305, 5399.

¹⁸⁹⁰ Dëshmitari 6, T. 5168-5171, 5293, 5386; P331 (Hartë në të cilën Dëshmitari shënoi udhëtimin e tij).

¹⁸⁹¹ Dëshmitari 6, T. 5171, 5173, 5179, 5188-5190, 5352; P331 (Hartë në të cilën Dëshmitari shënoi udhëtimin e tij).

¹⁸⁹² Dëshmitari 6, T. 5171, 5173-5174, 5190-5191, 5193, 5293-5294; P331 (Hartë në të cilën Dëshmitari shënoi udhëtimin e tij).

¹⁸⁹³ Dëshmitari 6, T. 5193-5194.

¹⁸⁹⁴ Dëshmitari 6, T. 5194, 5352-5355, 5399.

¹⁸⁹⁵ Dëshmitari 6, T. 5194, 5352-5353.

¹⁸⁹⁶ Dëshmitari 6, T. 5194-5195.

¹⁸⁹⁷ Dëshmitari 6, T. 5195.

të çelëtr me targa të Gjakovës pranë vendit ku ishte parkuar makina e Dëshmitarit 6.¹⁸⁹⁸ Një nga ushtarët e pyeti Dëshmitarin 6 nëse e njihte makinën dhe ai iu përgjigj se nuk e njihte.¹⁸⁹⁹ Rreth 20 minuta më vonë, rreth orës 3 apo 4 pasdite, dy ushtarë u larguan me makinën e Dëshmitarit 6 dhe Opel Kadettin. Dëshmitari 6 dhe familja e tij udhëtuan të ndarë në të dy makinat.¹⁹⁰⁰ Dëshmitari 6 ishte në Opel Kadett ku gjeti një album fotografik në të cilin njohu “Nenadin”, një polic serb apo malazez, që kishte punuar në Gjakovë.¹⁹⁰¹ Në një moment të caktuar, ushtarët i thanë bashkëshortes dhe fëmijëve të dëshmitarit të dilnin nga makina dhe ata iu bindën urdhrit.¹⁹⁰² Makinat mbërritën në Jabllanicë, komuna e Gjakovës.¹⁹⁰³

382. Më 13 qershor 1998 përpara orës 6 pasdite, kur nuk ishte errësuar ende, ushtarët e shoqëruan Dëshmitarin 6 përmes një porte, në një oborr, dhe e futën në një dhomë në krah të hyrjes së oborrit.¹⁹⁰⁴ Në këtë dhomë, ushtarët e rrahën njëri pas tjetrit me shkelma dhe me një shkop si dhe me objekte të tjera, duke i shkaktuar atij humbjen e vetëdijes.¹⁹⁰⁵ Një nga pjesëmarrësit në këtë rrahje ishte Nazmi Brahimaj.¹⁹⁰⁶ Dëshmitari 6 dëshmoi se e ata i bënë pyetje, por asnjëri prej tyre nuk i shpjegoi përse po e rrihnin.¹⁹⁰⁷ Dëshmitarit 6 nuk i kujtohet t'a ketë parë Lahi Brahimajn atë mbrëmje.¹⁹⁰⁸ Disa persona, të cilët Dëshmitari 6 nuk i identifikoi, i lidhën Nenadin, fotografinë e të cilit Dëshmitari 6 e kishte parë në Opel Kadett, dhe Dëshmitarin 6 së bashku dhe i lanë deri ditën e nesërme në dhomë.¹⁹⁰⁹ Pasditen e ditës së nesërme, 14 qershor 1998, kur nuk ishte errësuar ende, persona të cilët Dëshmitari 6 nuk i identifikoi, e morën atë dhe e çuan në një shtëpi njëkatëshe me tulla të kuqe dhe me katër dhoma që ishte në mes të një oborri.¹⁹¹⁰ Dëshmitari 6 qëndroi në një dhomë të asaj shtëpie gjatë gjithë pjesës tjetër të kohës që qëndroi në Jabllanicë.¹⁹¹¹ Dhoma kishte një dritare të izoluar me dërrasa përmes të cilave hynte vetëm pak dritë.¹⁹¹² Në dhomë nuk kishte llampë elektrike.¹⁹¹³ Gjatë katër javëve të para, ai u mbajt i mbyllur në këtë dhomë dhe i pa ushtarët vetëm kur vinin për t'a rrahur.¹⁹¹⁴ Vinin Lahi dhe Nazmi Brahimaj, zakonisht qëndronin pesë deri në dhjetë minuta, dhe e rrihnin Dëshmitarin 6 me grushte dhe me shkopa.¹⁹¹⁵ Nazmi dhe Lahi

¹⁸⁹⁸ Dëshmitari 6, T. 5195-5196.

¹⁸⁹⁹ Dëshmitari 6, T. 5195.

¹⁹⁰⁰ Dëshmitari 6, T. 5196, 5203-5204, 5316.

¹⁹⁰¹ Dëshmitari 6, T. 5196-5197, 5354.

¹⁹⁰² Dëshmitari 6, T. 5200.

¹⁹⁰³ Dëshmitari 6, T. 5197-5201, 5203; P331 (Hartë në të cilën Dëshmitari shënoi udhëtimin e tij).

¹⁹⁰⁴ Dëshmitari 6, T. 5204-5205, 5213-5215, 5316, 5322; P333 (Fotografi e objektit në Jabllanicë në të cilën Dëshmitari shënoi vendin ku rrahën atë dhe Nenadin).

¹⁹⁰⁵ Dëshmitari 6, T. 5207-5211, 5214-5215, 5324, 5350-5351.

¹⁹⁰⁶ Dëshmitari 6, T. 5209.

¹⁹⁰⁷ Dëshmitari 6, T. 5210, 5400.

¹⁹⁰⁸ Dëshmitari 6, T. 5372.

¹⁹⁰⁹ Dëshmitari 6, T. 5210, 5213, 5215-5216, 5304, 5316; P333 (Fotografi e objektit në Jabllanicë në të cilën Dëshmitari shënoi vendin ku rrahën atë dhe Nenadin).

¹⁹¹⁰ Dëshmitari 6, T. 5204-5205, 5216, 5316, 5324; P332 (Fotografi e objektit në Jabllanicë).

¹⁹¹¹ Dëshmitari 6, T. 5205, 5213, 5216, 5316-5317, 5325, 5347.

¹⁹¹² Dëshmitari 6, T. 5216, 5325-5326.

¹⁹¹³ Dëshmitari 6, T. 5401

¹⁹¹⁴ Dëshmitari 6, T. 5217-5218, 5220.

¹⁹¹⁵ Dëshmitari 6, T. 5208-5209, 5219-5220, 5372-5373.

Brahimaj ishin gjithashtu të pranishëm në disa raste kur ushtarë të tjerë rrihnin Dëshmitarin 6.¹⁹¹⁶ Nganjëherë Lahi, Nazmi, dhe Hamza Brahimaj vinin në dhomën ku e kishin mbyllur, por nuk e rrihnin atë.¹⁹¹⁷ Ushtarët e UÇK-së, ndër të cilët Lahi dhe Nazmi Brahimaj, e akuzonin Dëshmitarin 6 se kishte lidhje apo spiunonte për serbët.¹⁹¹⁸ Në trup Dëshmitari 6 kishte enjtje për shkak të rrahjeve të pësuar.¹⁹¹⁹ Ai ishte sëmurë dhe shpesh humbte vetëdijen.¹⁹²⁰ Gani Brahimaj, i cili punonte atje si kuzhinier, i sillte çdo ditë një copë bukë, marmallatë, dhe ujë.¹⁹²¹

383. Gjatë katër javëve të para të mbajtjes atje, Dëshmitari 6 nuk i dinte emrat e personave që e mbanin të burgosur.¹⁹²² Ai mësoi se ata quheshin Lahi, Nazmi, dhe Hamza Brahimaj kur i drejtoheshin me këto emra njëri-tjetrit në oborr.¹⁹²³ Ai e pa Nazmi Brahimaj atje pothuajse çdo ditë.¹⁹²⁴ Gani Brahimaj i tregoi Dëshmitarit 6 emrin e Nazmi Brahimajt.¹⁹²⁵ Ai dëgjoi që të tjerët i drejtoheshin Nazmiut si “zëvendëskomandant”.¹⁹²⁶ Dëshmitari 6 gjithashtu pa Hamzanë pothuajse çdo ditë në Jabllanicë.¹⁹²⁷ Dëgjoi që të tjerët i drejtoheshin atij me këtë emër.¹⁹²⁸ Shumë më vonë, ai mësoi se mbiemri i Hamzait ishte Brahimaj.¹⁹²⁹ Dëshmitari 6 pa edhe Lahi Brahimajn në Jabllanicë, dhe dëgjoi se të tjerët i drejtoheshin si “Lahi” apo “Magjup”.¹⁹³⁰ Gani Brahimaj i tha Dëshmitarit 6 se nofka e Lahi Brahimajt ishte “Magjup”.¹⁹³¹ Dëshmitari 6 dëshmoi se gjatë kohës që ishte në Jabllanicë nuk kalonin dy ditë që ai të mos e shihte Lahi Brahimajn.¹⁹³² Lahi Brahimaj ishte i veshur ose me uniformë kamuflazhi ose uniformë të zezë.¹⁹³³ Dëshmitari 6 dëshmoi se Lahi Brahimaj ishte anëtar i UÇK-së.¹⁹³⁴ Gjatë afërsisht dhjetëditëshit të fundit të qëndrimit të tij në Jabllanicë, Dëshmitari 6 i kaloi netët në të njëjtën dhomë, por nuk mund të lëvizte rreth shtëpisë dhe në oborr gjatë ditës.¹⁹³⁵ Atë nuk e rrihnin më.¹⁹³⁶ Hante ushqim, duke përfshirë bukë dhe fasule.¹⁹³⁷ Lante pjatat në një lëndinë të hapur.¹⁹³⁸ Dëshmitari 6 dëshmoi se besonte se kishte mundësi të arratisesh, por “nuk donte të rrezikohej”.¹⁹³⁹ Dëshmitarin 6 e vizitonte bashkëshortja, babai i tij si dhe

¹⁹¹⁶ Dëshmitari 6, T. 5220-5221, 5373.

¹⁹¹⁷ Dëshmitari 6, T. 5220.

¹⁹¹⁸ Dëshmitari 6, T. 5351-5352, 5398-5400.

¹⁹¹⁹ Dëshmitari 6, T. 5220.

¹⁹²⁰ Dëshmitari 6, T. 5326.

¹⁹²¹ Dëshmitari 6, T. 5218-5219, 5240, 5244, 5326-5329, 5341.

¹⁹²² Dëshmitari 6, T. 5208, 5218, 5232, 5295-5297, 5347.

¹⁹²³ Dëshmitari 6, T. 5208-5209, 5245.

¹⁹²⁴ Dëshmitari 6, T. 5219.

¹⁹²⁵ Dëshmitari 6, T. 5378.

¹⁹²⁶ Dëshmitari 6, T. 5245.

¹⁹²⁷ Dëshmitari 6, T. 5219.

¹⁹²⁸ Dëshmitari 6, T. 5246.

¹⁹²⁹ Dëshmitari 6, T. 5209.

¹⁹³⁰ Dëshmitari 6, T. 5245.

¹⁹³¹ Dëshmitari 6, T. 5218-5219.

¹⁹³² Dëshmitari 6, T. 5218, 5372.

¹⁹³³ Dëshmitari 6, T. 5245.

¹⁹³⁴ Dëshmitari 6, T. 5246.

¹⁹³⁵ Dëshmitari 6, T. 5217, 5231-5232, 5241-5243, 5332-5334, 5386, 5391.

¹⁹³⁶ Dëshmitari 6, T. 5243, 5259.

¹⁹³⁷ Dëshmitari 6, T. 5329.

¹⁹³⁸ Dëshmitari 6, T. 5244, 5333-5334, 5341, 5361, 5395.

¹⁹³⁹ Dëshmitari 6, T. 5243, 5349.

një nga djemtë e tij.¹⁹⁴⁰ Dikush, të cilin Dëshmitari 6 nuk e identifikoi, u dha atyre një pusullë ku ishte shkruar se do t'a lironin pas një jave.¹⁹⁴¹ Dëshmitari 6 pa shumë ushtarë në Jabllanicë, një herë 100 deri në 200 ushtarë, që shkonin të merrnin armë në Shqipëri.¹⁹⁴² Shumica prej tyre nuk ishin të veshur me uniformë ose ishin pjesërisht të veshur me uniformë.¹⁹⁴³ Përveç personave të burgosur, Dëshmitari 6 pa gjithashtu civilë në Jabllanicë.¹⁹⁴⁴

384. Më 25 korrik 1998, Nazmi Brahimaj i dha Dëshmitarit 6 dy vendime të nënshkruara prej tij si zëvendëskomandant i UÇK-së në Jabllanicë në nënzonën e Dukagjinit, një për lirin e Dëshmitarit 6 dhe tjetri për konfiskimin e makinës dhe armës së tij.¹⁹⁴⁵ Në vendimin për lirin e tij thuhej se liri i Dëshmitari 6 ishte me kusht dhe “[nëqoftëse] ai përsërit gabimet e tij, [dëshmitari] do të nxirret në gjyq”.¹⁹⁴⁶ Dëshmitari 6 u lirua po atë ditë.¹⁹⁴⁷ Dëshmitari 6 kërkoi që t'i kthehej makina, arma, patentat e shoferit, letërnjoftimi dhe kuleta por nuk iu kthye asgjë.¹⁹⁴⁸ Dëshmitarit 6 nuk i treguan asnjëherë arsyen e arrestimit.¹⁹⁴⁹ Pas lirit të tij, babai i tij i tha se banorët e fshatit të tyre kishin ardhur dhe ishin lutur që ai të lirohej.¹⁹⁵⁰ Dëshmitari 6 dëshmoi se kur e liruan kishte shpinë të mavijosur, një thyerje në parakrahun e majtë pranë kyçit të dorës, dhe një plagë të hapur në pjesën e prapme të krahut apo të shpatullës së djathtë.¹⁹⁵¹ Dëshmitari 6 u ankua se kishte dhimbje të vazhdueshme në të gjithë trupin.¹⁹⁵² Ai dëshmoi gjithashtu se se nuk ishte më në gjendje të bënte punë fizike apo të ngrinte pesha mbi pesë kilogram.¹⁹⁵³ Ai dëshmoi se problemet e tij shëndetësore ishin shkaktuar nga rrahjet që kishte pësuar në Jabllanicë, dhe se para mbajtjes së tij në atë vend, ai gëzonte shëndet të mirë.¹⁹⁵⁴ Më 30 korrik 1998, Dëshmitari 6 shkoi për t'u vizituar tek një mjek në Gjakovë, i cili i bëri radiografi dhe i lëshoi recetë për disa ilaçe.¹⁹⁵⁵ Radiografia zbuloi një thyerje në eshtërën e parakrahut të majtë.¹⁹⁵⁶ Mjeku nuk ia kuroi parakrahun e majtë.¹⁹⁵⁷ Dëshmitari 6 u vizitua gjithashtu edhe tek një mjek tjetër, i cili i lëshoi recetë për ilaçe kundër dhimbjeve.¹⁹⁵⁸ Në kohën kur dha dëshminë e tij, Dëshmitari 6 ende merrte ilaçe për plagët që kishte pësuar gjatë burgimit të tij.¹⁹⁵⁹

¹⁹⁴⁰ Dëshmitari 6, T. 5252.

¹⁹⁴¹ Dëshmitari 6, T. 5252.

¹⁹⁴² Dëshmitari 6, T. 5246, 5360-5361.

¹⁹⁴³ Dëshmitari 6, T. 5246.

¹⁹⁴⁴ Dëshmitari 6, T. 5246.

¹⁹⁴⁵ Dëshmitari 6, T. 5253-5256, 5379; P335 (Vendime të nënshkruara nga Nazmi Brahimaj).

¹⁹⁴⁶ Dëshmitari 6, T. 5255-5256; P335 (Vendime të nënshkruara nga Nazmi Brahimaj).

¹⁹⁴⁷ Dëshmitari 6, T. 5206, 5252-5255, 5297-5298.

¹⁹⁴⁸ Dëshmitari 6, T. 5254, 5256, 5304, 5342, 5361, 5378-5380, 5398, 5403.

¹⁹⁴⁹ Dëshmitari 6, T. 5252-5253.

¹⁹⁵⁰ Dëshmitari 6, T. 5252.

¹⁹⁵¹ Dëshmitari 6, T. 5210, 5243, 5259, 5265-5268, 5373-5375.

¹⁹⁵² Dëshmitari 6, T. 5268, 5373-5374, 5401.

¹⁹⁵³ Dëshmitari 6, T. 5243, 5268.

¹⁹⁵⁴ Dëshmitari 6, T. 5259, 5401.

¹⁹⁵⁵ Dëshmitari 6, T. 5259, 5261-5262, 5298-5299, 5312-5313; P336 (Raport i kontrollit mjekësor të Dëshmitarit 6).

¹⁹⁵⁶ P336 (Raport i kontrollit mjekësor të Dëshmitarit 6).

¹⁹⁵⁷ Dëshmitari 6, T. 5265-5268.

¹⁹⁵⁸ Dëshmitari 6, T. 5267-5268.

¹⁹⁵⁹ Dëshmitari 6, T. 5269, 5401.

385. Dëshmitari 6 e takoi përsëri Nazmi Brahimajn rreth një viti pas burgosjes së tij dhe e njohu atë.¹⁹⁶⁰ Gjithashtu, më 24 shkurt 2004, Dëshmitari 6 e njohu atë midis fotografive që iu treguan.¹⁹⁶¹ Në po atë rast, ndër fotografitë ai njohu edhe atë të Lahi Brahimajt.¹⁹⁶²

386. Pekka Haverinen, polic finlandez, i cili punoi si hetues i TPNJ-së nga qershori 2002 deri në mars 2005,¹⁹⁶³ dëshmoi se i kishte paraqitur shtatër kolazhe fotografish Dëshmitarit 6 gjatë intervistimit të tij më 25 shkurt 2004.¹⁹⁶⁴ Dëshmitari 6 njohu Ramush Haradinajn dhe Lahi Brahimajn midis fotografive.¹⁹⁶⁵ Dëshmitari 6 i tha Haverinenit se e njohu Haradinaj pasi e kishte parë fytyrën e tij në gazeta dhe televizor.¹⁹⁶⁶ Ai nuk e njohte Ramush Haradinajn në kohën e luftës dhe nuk e kishte parë atë në burgun e UÇK-së në Jabllanicë.¹⁹⁶⁷ Dëshmitari 6 nënshkroi kolazhet e fotografive, por në to nuk ka shënime që të tregojnë numrat përkatës.¹⁹⁶⁸

387. Dëshmitarja 23 dëshmoi se më 12 qershor 1998, rreth orës 1:00 pasdite, ajo dhe Dëshmitari 6 si dhe pjesa tjetër e familjes po udhëtonin nga Bardhasa, komuna e Gjakovës, për në Napolë, komuna e Pejës.¹⁹⁶⁹ Kur po shkonin me makinë në rrugën Pejë- Prishtinë, ata u ndaluan nga policia serbe në një postbllok në urën e Dollovës, komuna e Klinës.¹⁹⁷⁰ Policia u tha se ishte e rrezikshme të udhëtonin për në Napolë për shkak të UÇK-së.¹⁹⁷¹ Familja vendosi të kthehej, por gjatë rrugës së kthimit ata u ndalën nga afro 10-15 burra të armatosur pranë një vendi të quajtur “Guri i Zi” në rrugën Klinë- Gjakovë.¹⁹⁷² Disa burra ishin të veshur me uniforma kamuflazhi.¹⁹⁷³ Burrat e morën familjen në pyetje për rreth dy orë.¹⁹⁷⁴ Dëshmitarin 6 e pyetën për një armë që kishte me vete si dhe për një fotografi që kishte në makinë ku kishte dalë me një polic shqiptar.¹⁹⁷⁵ Dëshmitari 6 u detyrua t’ua dorëzonte burrave armën.¹⁹⁷⁶ Pas rreth dy orësh, Dëshmitarja dëgjoi një makinë që po vinte nga drejtimi i Gjakovë, pasuar prej zhurmës së disa të shtënave.¹⁹⁷⁷ Dëshmitarja nuk pa çfarë ndodhi dhe gjithashtu nuk i kujtohej asnjë hollësi për makinën.¹⁹⁷⁸ Dëshmitarja u urdhërua të hipte në këtë makinë së bashku me Dëshmitarin 6 dhe një pjesëtar tjetër të familjes.¹⁹⁷⁹ Pjesa tjetër e familjes hipi në makinën e familjes.¹⁹⁸⁰ Të dy makinat drejtoheshin nga ushtarë të UÇK-së.¹⁹⁸¹ Ata

¹⁹⁶⁰ Dëshmitari 6, T. 5269-5271.

¹⁹⁶¹ P375/P376 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 10, 14, Shtojca 4. Shihni gjithashtu Dëshmitari 6, T. 5371-5372.

¹⁹⁶² Dëshmitari 6, T. 5371-5372; P375/P376 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 10, 15, Shtojca 5.

¹⁹⁶³ P375/P376 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 1; Pekka Haverinen, T. 6299-6300.

¹⁹⁶⁴ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 8, 10; Pekka Haverinen, T. 6339-6340.

¹⁹⁶⁵ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 11, 15, Shtojca 2, Shtojca 5.

¹⁹⁶⁶ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 12.

¹⁹⁶⁷ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 12.

¹⁹⁶⁸ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 12, 15; Pekka Haverinen, T. 6348-6350.

¹⁹⁶⁹ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 2.

¹⁹⁷⁰ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 2; Dëshmitarja 23, T. 10539.

¹⁹⁷¹ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 2.

¹⁹⁷² P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 2-3; Dëshmitarja 23, T. 10528.

¹⁹⁷³ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3; Dëshmitarja 23, T. 10539-10540.

¹⁹⁷⁴ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3; Dëshmitarja 23, T. 10528.

¹⁹⁷⁵ Dëshmitarja 23, T. 10540.

¹⁹⁷⁶ Dëshmitarja 23, T. 10540-10541.

¹⁹⁷⁷ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3; Dëshmitarja 23, T. 10529-10531.

¹⁹⁷⁸ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3; Dëshmitarja 23, T. 10529.

¹⁹⁷⁹ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3; Dëshmitarja 23, T. 10529-10534.

¹⁹⁸⁰ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3; Dëshmitarja 23, T. 10529-10534.

udhëtuan të gjithë në një vend në Napolë ku Dëshmitarja 23 dhe pjesa tjetër e familjes, me përjashtim të Dëshmitarit 6, u lejuan të zbrisnin; ushtarët e UÇK-së u larguan me dy makinat dhe Dëshmitarin 6.¹⁹⁸² Pas incidentit, Dëshmitarja i tregoi vëllait të saj dhe një kushëriri se Dëshmitarin 6 e kishte marrë UÇK-ja.¹⁹⁸³ Ata filluan të kërkonin për të dhe mësuan se Dëshmitari 6 mbahej në fshatin Jabllanicë.¹⁹⁸⁴ Dëshmitarja qëndroi në Napolë për tri - katër ditë dhe çdo ditë shikonte dikë që ngiste makinën e saj në fshat.¹⁹⁸⁵ Pas pesë javësh Dëshmitari 7 mori një letër nga UÇK-ja ku thuhej se ai, dëshmitarja, dhe disa anëtarë të tjerë të familjes mund të vizitonin Dëshmitarin 6 në Jabllanicë, gjë që ata e bënë.¹⁹⁸⁶ Dëshmitarja 23 vuri re se Dëshmitari 6 kishte humbur shumë në peshë dhe dukej në gjendje të keqe.¹⁹⁸⁷ Dëshmitarja qëndroi me Dëshmitarin 6 për rreth gjysëm ore në oborrin e ndërtesave dhe u lejuan të bisedonin vetëm për gjëra të rëndomta.¹⁹⁸⁸ Dëshmitari 6 ishte i veshur me këmbishë me mëngë të shkurtra dhe Dëshmitarja nuk pa lëndime të dukshme në trup.¹⁹⁸⁹ Dikush, që dëshmitarja besonte se ishte komandant në UÇK, u tha se mund të vinin dhe t'a merrnin Dëshmitarin 6 për t'a çuar në shtëpi pas një jave.¹⁹⁹⁰ Një javë më pas, më 25 korrik 1998, vëllai i Dëshmitarit 6 shkoi në Jabllanicë dhe e solli Dëshmitarin 6 në shtëpi.¹⁹⁹¹ Atëhere Dëshmitarja 23 pa se Dëshmitari 6 kishte shumë mavijosje në trup, por jo në fytyrë.¹⁹⁹² Dëshmitari 6 shkoi për t'u vizituar tek një mjek dhe radiografia tregoi se kishte thyerje në një krah.¹⁹⁹³ Dëshmitari 6 i tregoi asaj se e kishin rrahur gjithë kohës dhe se kur ajo kishte ardhur për vizitë krahun e kishte të thyer, por ata e kishin detyruar të hiqte të gjitha fashot para vizitës.¹⁹⁹⁴

388. Dëshmitari 16 dëshmoi se bashkëfshatarët i kishin thënë se Dëshmitarin 6 e kishin çuar në Jabllanicë, komuna e Gjakovës, dhe po mbahej atje nga persona të cilët Dëshmitari 16 nuk i identifikoi.¹⁹⁹⁵ Një grup fshatarësh, ndër të cilët Dëshmitari 16 dhe Dëshmitari 7, shkuan me makinë në Jabllanicë për të kërkuar lirimin e tij.¹⁹⁹⁶ Midis Zhabelit, komuna e Gjakovës, dhe Jabllanicës ata hasën në një postbllok të kontrolluar nga ushtarë të UÇK-së.¹⁹⁹⁷ Dëshmitari 16 u tha ushtarëve se kishin ardhur për të mësuar për fatin e Dëshmitarit 6.¹⁹⁹⁸ Një nga ushtarët u tha se mund të

¹⁹⁸¹ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3; Dëshmitarja 23, T. 10532-10537.

¹⁹⁸² P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3; Dëshmitarja 23, T. 10532-10533.

¹⁹⁸³ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3.

¹⁹⁸⁴ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 3-4.

¹⁹⁸⁵ Dëshmitarja 23, T. 10535, 10547-10548.

¹⁹⁸⁶ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 4.

¹⁹⁸⁷ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 4; Dëshmitarja 23, T. 10550-10551.

¹⁹⁸⁸ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 4; Dëshmitarja 23 T. 10538; D118 (Fotografi që tregon objektin në Jabllanicë).

¹⁹⁸⁹ Dëshmitarja 23, T. 10550, 10558-10559.

¹⁹⁹⁰ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 4.

¹⁹⁹¹ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 2, 4.

¹⁹⁹² P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 4; Dëshmitarja 23, T. 10538-10539, 10559.

¹⁹⁹³ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 4; Dëshmitarja 23, T. 10538-10539, 10551-10552.

¹⁹⁹⁴ P1221 (Dëshmitarja 23, deklaratë dëshmitari, 18 janar 2003), f. 4.

¹⁹⁹⁵ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafët 3-4.

¹⁹⁹⁶ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafët 4-5, 14.

¹⁹⁹⁷ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 5.

¹⁹⁹⁸ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 6.

vazhdonin rrugën në drejtim të Jabllanicës, por nuk duhej të hynin në fshat.¹⁹⁹⁹ Fshatarët e ndaluan makinën në të hyrë të Jabllanicës.²⁰⁰⁰ Dy ushtarë, një me uniformë të UÇK-së, tjetri me uniformë të zezë, iu afruan dhe i përshëndetën me grushtin ngritur.²⁰⁰¹ Dëshmitari 16 iu tha se fshatarët kishin ardhur për të pyetur komandantin për fatin e Dëshmitarit 6.²⁰⁰² Një nga ushtarët konfirmoi se Dëshmitari 6 mbahej atje dhe tha se do të vinte komandanti për t'i takuar.²⁰⁰³ Fshatarët pritën përballë grupit të ndërtesave të UÇK-së, që ishte vendbanimi i parë në Jabllanicë në anë të majtë të rrugës kur vjen nga Zhabeli, dhe përbëhej nga një ndërtesë e gjatë që dukej si stallë dhe një ndërtesë dykatëshe.²⁰⁰⁴ Një burrë i armatosur arriti me xhip, ngrehu çarkun e automatikut, përshendeti fshatarët me grusht dhe prezantoi veten si komandanti.²⁰⁰⁵ Ai tha se Dëshmitari 6 ishte arrestuar dhe dënuar, por do të lirohej.²⁰⁰⁶ Ai nuk lejoi asnjë nga grupi të vizitonte Dëshmitarin 6.²⁰⁰⁷ Kur fshatarët thanë se edhe ata ishin pjesëtarë të kombit shqiptar dhe se kishin president të njëjtin person, Rugovën, komandanti iu përgjegj se ata nuk ishin njëjloj pasi fshatarët nuk po luftonin. Ai shtoi gjithashtu se nuk e njohte Rugovën.²⁰⁰⁸ Pastaj komandanti u kthye në ndërtesat e UÇK-së dhe fshatarët u kthyen në shtëpi.²⁰⁰⁹ Dëshmitari 16 nuk ishte në gjendje të përshkruante dhe identifikonte komandantin.²⁰¹⁰

389. Dëshmitari 7 dëshmoi se kishte dëgjuar nga një mik në fund të qershorit 1998 se Dëshmitari 6 ishte arrestuar dhe çuar në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë, komuna e Gjakovës.²⁰¹¹ Miku e kishte dëgjuar këtë nga një i afërm i Dëshmitarit 7, i cili kishte parë ushtarë të UÇK-së që po çonin Dëshmitarin 6 me makinë në Jabllanicë.²⁰¹² Pastaj Dëshmitari 7 shkoi me makinë me kryepleqësinë e fshatit në Jabllanicë për të kërkuar lirim të Dëshmitarit 6.²⁰¹³ Dëshmitari 7 e përshkroi shtabin e UÇK-së si grupin e ndërtesave të para në të majtë të hyrjes së fshatit kur vjen nga drejtimi i Zhabelit, komuna e Gjakovës.²⁰¹⁴ Ishte një shtëpi e madhe brenda një territori të rrethuar me gardh, në të cilin ishin të pranishëm shumë ushtarë të UÇK-së.²⁰¹⁵ Kur mbërritën në shtabin e UÇK-së, Dëshmitari 7 dhe kryepleqësia e fshatit i shpjeguan rojes tek porta e hyrjes arsyen e ardhjes; roja iu përgjigj se ata duhej të bisedonin me komandantin, "Magjupin".²⁰¹⁶ Pas një farë kohe, tek porta e hyrjes erdhën dy burra të veshur me uniforma të zeza, me simbole të UÇK-së dhe të armatosur me

¹⁹⁹⁹ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 6.

²⁰⁰⁰ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 7.

²⁰⁰¹ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 7.

²⁰⁰² P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 8.

²⁰⁰³ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 9.

²⁰⁰⁴ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 10.

²⁰⁰⁵ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafët 11-13.

²⁰⁰⁶ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 13.

²⁰⁰⁷ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafët 14, 18.

²⁰⁰⁸ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafët 15-17.

²⁰⁰⁹ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 18.

²⁰¹⁰ P1237 (Dëshmitari 16, deklaratë dëshmitari, 6 maj 2004), paragrafi 19.

²⁰¹¹ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 3.

²⁰¹² P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 4.

²⁰¹³ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 5.

²⁰¹⁴ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 6.

²⁰¹⁵ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 6.

pistoleta në brez, njëri prej tyre e prezantoi veten si “Komandant Magjupi”.²⁰¹⁷ Dëshmitari 16 kërkoi të dinte emrin e vërtetë të “Magjupit”, por pa sukses.²⁰¹⁸ Pastaj Dëshmitari 16 shpjegoi se kishin ardhur për të kërkuar lirim të Dëshmitarit 6.²⁰¹⁹ “Magjupi” iu përgjigj se ai e kishte dënuar Dëshmitarin 6, pa thënë se për çfarë, dhe se ai duhej t'a kryente dënimin duke qëndruar me UÇK-në.²⁰²⁰ “Magjupi” nuk i lejoi vizitorët t'a shihnin Dëshmitarin 6, por i premtoi Dëshmitarit 7 se do të kishte mundësi t'a takonte atë pas dy javësh.²⁰²¹ Pastaj “Magjupi” e pyeti grupin përse nuk luftonte në vijën e frontit, dhe dikush i tha se ata shpresonin se udhëheqësi i tyre në luftë do të ishte Rugova.²⁰²² “Magjupi” u përgjigj me zemërim se e konsideronte Rugovën tradhëtar dhe përkrahës të autoriteteve serbe.²⁰²³

390. Dëshmitari 7 e vizitoi Jabllanicën çdo ditë gjatë dy javëve të ardhshme, por atë nuk e lejua asnjëherë të hynte në oborr.²⁰²⁴ 13 ditë pas rrëmbimit të Dëshmitarit 6, Dëshmitari 7 informoi rojen tek porta e hyrjes së grupit të ndërtesave të Jabllanicës se “Magjupi” i kishte thënë se do të mund të takohej me Dëshmitarin 6 pas dy javëve.²⁰²⁵ Roja i tha se do të informonte Komandant “Magjupin” se kishte ardhur dëshmitari dhe e lejoi të hynte në oborr.²⁰²⁶ Pas pak në oborr hyri me një xhip ushtarak, individ i që vetëquhej “Magjupi”.²⁰²⁷ Dëshmitari i shpjegoi se Dëshmitari 6 ishte burgosur para dy javësh dhe se “Magjupi” kishte thënë se dëshmitari do të lejohej të takohej me Dëshmitarin 6 vetëm pas dy javëve.²⁰²⁸ “Magjupi” i tha dëshmitarit se nuk do ta lejonte të takohej me Dëshmitarin 6, dhe pastaj urdhëroi Dëshmitarin 7 që të largohej nga territori.²⁰²⁹ Megjithëse Dëshmitari 7 u kthye në Jabllanicë gjatë ditëve të mëvonshme (por nuk u lejua asnjëherë të hynte në oborr), ai nuk e takoi më asnjëherë “Magjupin”.²⁰³⁰ Gjatë këtyre vizitave, Dëshmitari 7 fitoi besimin e njërit prej ushtarëve të UÇK-së, i cili i tha Dëshmitarit 7 se Dëshmitari 6 ishte gjallë dhe se punonte në kuzhinë dhe në shpërndarjen e ushqimit.²⁰³¹ Një ditë Dëshmitari 7 u lejua të hynte në oborr dhe u çua tek një komandant, të cilin nuk e kishte takuar asnjëherë më parë.²⁰³² Komandanti i tha Dëshmitarit 7 të largohej pasi Dëshmitari 6 ishte dënuar.²⁰³³ Mirëpo, pasi foli me këtë person, Dëshmitari 7 shkoi të takonte ushtarin e UÇK-së me të cilin kishte zënë miqësi. Ai i rrëfeu atij për

²⁰¹⁶ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 7.

²⁰¹⁷ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 8.

²⁰¹⁸ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 9-10.

²⁰¹⁹ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 10-12.

²⁰²⁰ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 13.

²⁰²¹ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 14, 16.

²⁰²² P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 15.

²⁰²³ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 15.

²⁰²⁴ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 18.

²⁰²⁵ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 19.

²⁰²⁶ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 20.

²⁰²⁷ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 21.

²⁰²⁸ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 21-22.

²⁰²⁹ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 23-25.

²⁰³⁰ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 26-27.

²⁰³¹ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 27-28.

²⁰³² P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 29-30.

²⁰³³ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 29-30.

takimin me komndantin.²⁰³⁴ Ushtari shprehu dyshim që Dëshmitari 7 të ishte takuar me të vërtetë me komandantin. Ai hyri brenda në oborr dhe i tha Dëshmitarit 6 se Dëshmitari 7 ishte jashtë dhe se i dërgonte të fala.²⁰³⁵ Kështu ushtari u bë korrier që sillte dhe çonte fjalë midis Dëshmitarit 6 dhe Dëshmitarit 7.²⁰³⁶ Një javë më vonë një ushtar i UÇK-së i tha Dëshmitarit 7 se do të lejohej të takonte Dëshmitarin 6.²⁰³⁷ Pastaj Dëshmitari 7 shkoi në shtëpi dhe u kthye me dy persona të tjerë, një ndër të cilët ishte Dëshmitarja 23, dhe të tre e takuan Dëshmitarin 6 për dy orë.²⁰³⁸ Më pas Dëshmitari 7 mësoi nga Dëshmitari 6 se personi i cili kishte lejuar takimin ishte Nazmi Brahimaj i cili, siç dëshmoi Dëshmitari 7, ishte vëllai i “Magjupit”.²⁰³⁹ Nazmi Brahimaj i tha Dëshmitarit 7 se do t'a lironte Dëshmitarin 6 po atë ditë, por nuk kishte dokumentat përkatëse dhe me këtë ai e kishte fjalën për lejen e armës së Dëshmitarit 6, për patentën e tij të shoferit, si dhe dëftesat për armën dhe makinën që i ishin konfiskuar Dëshmitarit 6. Ai shtoi se këto dokumenta do të ishin gati brenda një jave.²⁰⁴⁰ Dëshmitari 6 u lirua një javë pas takimit.²⁰⁴¹ Dëshmitari 7 tha se fshati i Dëshmitarit 6 përbëhej kryesisht nga përkrahës të LDK-së, por shtoi se ai nuk e dinte arsyen e rrëmbimit të Dëshmitarit 6.²⁰⁴²

391. Siç u përmend më sipër, Dëshmitari 6 dëshmoi se më 13 qershor 1998 apo rreth kësaj date, ushtarë të UÇK-së e rrahën atë egërsisht në një grup ndërtesash brenda një oborri në Jabllanicë. Dëshmitari 6 dëshmoi më tej se atë e mbajtën në një dhomë në këtë vendbanim për katër javë dhe se ushtarë të UÇK-së e rrihnin rregullisht. Sipas Dëshmitarit 6, ai ishte në një gjendje të keqe fizike dhe iu shkaktuan probleme të përhershme fizike nga rrahjet. Dhoma Gjyqësore e konsideron Dëshmitarin 6 të besueshëm, dhe është e bindur se rrahjet i shkaktuan vuajtje dhe lëndime të rënda fizike. Duke marrë paraysh egërsinë e rrahjeve si dhe vazhdueshmërinë e tyre, Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se rrahësit kanë patur për qëllim shkaktimin e vuajtjeve dhe lëndimeve të tilla. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarët e UÇK-së kryen trajtim mizor të Dëshmitarit 6.

392. Dëshmitari 6 dhe Dëshmitarja 23 dëshmuuan se më 13 qershor 1998, apo rreth kësaj date, ushtarët të UÇK-së kontrolluan Dëshmitarin 6 dhe makinën e tij, ku gjetën një pistoletë të lëshuar me leje policie si dhe një fotografi ku Dëshmitari 6 kishte dalë me një polic shqiptar. Dëshmitarja 23 dëshmoi se ushtarët e pyetën Dëshmitarin 6 për këto sende. Dëshmitari 6 dëshmoi se ata që e rrahën ditën e parë të mbajtjes së tij në ndërtesat brenda oborrit në Jabllanicë nuk i treguan arsyen e

²⁰³⁴ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 31.

²⁰³⁵ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 31-32.

²⁰³⁶ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 32.

²⁰³⁷ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 34.

²⁰³⁸ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 35-36.

²⁰³⁹ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 36.

²⁰⁴⁰ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 37-38.

²⁰⁴¹ P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafi 39.

²⁰⁴² P1248 (Dëshmitari 7, deklaratë dëshmitari, 28 prill 2004), paragrafët 40-41.

rrahjes. Mirëpo ai gjithashtu dëshmoi se gjatë mbajtjes së tij në ndërtesat brenda oborrit në Jabllanicë, disa ushtarë të UÇK-së e akuzuan se kishte lidhje me serbët dhe spiunonte për ta. Dëshmitari 7 dhe Dëshmitari 16 dëshmuan se një komandant në ndërtesat brenda oborrit në Jabllanicë u tha se Dëshmitari 6 ishte shpallur fajtor apo dënuar, dhe shprehu zemërim kundër Presidentit Rugova dhe atyre që nuk luftonin. Kur Dëshmitari 6 u lirua atij iu dorëzua një vendim nga Nazmi Brahimaj në të cilin thuhej se, “[nëqoftëse] do të përsëriste gabimet, [Dëshmitari 6] do të nxirrej në gjyq”. Mbi bazën e këtyre dëshmime Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarë të UÇK-së e keqtrajtuuan Dëshmitarin 6 për t'a ndëshkuar për këtë bashkëpunim të pretenduar me serbët, si dhe për t'a diskriminuar për arsye politike. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarët e UÇK-së e torturuan Dëshmitarin 6.

393. Për më tepër Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto krime kanë lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se Dëshmitari 6 nuk merrte pjesë aktive në luftime në atë kohë, dhe se keqtrajtuesit e tij e dinin ose duhet t'a kenë ditur këtë.

394. Të tre të Akuzuarit akuzohen në Pikën 28 si pjesëmarrë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do t'a trajtojë pretendimin për ndërmarrjen e përbashkët kriminale në pjesën 7, më poshtë. Ndryshe Lahi Brahimaj akuzohet se ka kryer apo ndihmuar dhe inkurajuar krimet për të cilat akuzohet në këtë pikë.

395. Dëshmitari 6 dëshmoi se Lahi Brahimaj mori pjesë në disa nga rrahjet, dhe se nganjëherë ishte i pranishëm kur të tjerët e rrihnin atë. Dëshmitari 6 dëshmoi gjithashtu se Lahi Brahimaj ishte ndër ata që e akuzonin se kishte lidhje dhe spiunonte për serbët. Dëshmitari 6 e pa shpesh Lahi Brahimajn gjatë afro katër javëve që e rrahën. Për më tepër, Dëshmitari 6 dëshmoi se gjatë javëve të mëvonshme ai e pa vazhdimisht Lahi Brahimajn brenda ndërtesave dhe oborrit në Jabllanicë. Sipas Dëshmitarit 6, ai dëgjoji se të tjerët i drejtoheshin me emrin “Lahi” apo “Magjup”, se kishte dëgjuar nga Gani Brahimaj se “Magjup” ishte nofka e Lahi Brahimajt. Më pas Dëshmitari 6 e njohu Lahi Brahimajn midis një grupi fotografish, fakt që përmendet në pjesën 2.3, më sipër. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshem se Lahi Brahimaj mori pjesë personalisht në trajtimin mizor dhe torturimin e Dëshmitarit 6, dhe arrin në përfundimin se ai duhet të shpallet fajtor për kryerjen e këtyre krimeve. Si rezultat, Dhoma Gjyqësore nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë nëse ai ndihmoi dhe nxiti kryerjen e tyre.

6.16 Trajtimi mizor, torturimi, dhe vrasja e Nenad Remishtarit dhe katër personave të pidentifikuar (Pika 30)

396. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor, torturimin dhe vrasjen e Nenad Remishtarit dhe katër personave të tjera të panjohur

si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga Dëshmitari 73, Nebojsa Avramoviqi, Zoran Stijoviqi dhe Dëshmitari 6.

397. Dëshmitari 73 deklaroi se më 13 qershor 1998 Nenad Remishtari, i cili punonte si polic i qarkullimit rrugor në Gjakovë, u nis nga Binxha, komuna e Klinës, për të shkuar në Gjakovë me Opel Kadettin e tij të kaltër me targa të Gjakovës.²⁰⁴³ Ai ishte veshur me rroba civile.²⁰⁴⁴ Pas 10 ditësh, Dragisha Shimigiqi, koleg pune i tij dhe oficer i MPB-së me detyrë në Gjakovë, informoi Dëshmitarin se Nenad Remishtari kishte munguar në punë gjatë asaj kohe.²⁰⁴⁵ Aleksandar Remishtar, i ati i Nenadit, mësoi nga një shqiptar i paidentifikuar se i biri dhe një shqiptar katolik, ishin rrëmbyer pranë fshatit Rakovinë, komuna e Gjakovës, dhe se ishin burgosur në Jabllanicë në të njëjtën komunë.²⁰⁴⁶ Shqiptari i paidentifikuar tha se Nenad Remishtari ishte ende gjallë dhe se mbahej nën roje nga një ushtar i UÇK-së, që e njihte atë.²⁰⁴⁷ Shqiptari i paidentifikuar e kishte marrë këtë informacion nga shqiptari katolik.²⁰⁴⁸

398. Nebojsa Avramoviqi dëshmoi se punonjësi i MPB-së Rade Popoviqi (si në origjinal), Nikolla Jovanoviqi dhe Nenad Remishtar u zhdukën në fund të prillit apo në fillim të majit 1998 në zonën rreth rrugës Gjakovë – Pejë.²⁰⁴⁹ Nga raportet që kishte lexuar në atë kohë, Avramoviqi konkludoi se Rade Popoviqi (si në origjinal) dhe Nikolla Jovanoviqi ishin në detyrë.²⁰⁵⁰ Eprori i tyre raportoi se ata ishin zhdukur.²⁰⁵¹ Avramoviqi dëshmoi se në një raport të paraqitur nga të afërmit e Nenad Remishtarit dhe eprorët e tij, thuhej se Nenad Remishtar u rrëmbye ndërkohë që po shkonte nga shtëpia e tij në Klinë për në punë, kur po udhëtonte në rrugën Gjakovë-Prishtinë.²⁰⁵² Dhoma Gjyqësore mendon se kur përmend Rade Popoviqin në dëshminë e tij, dëshmitari në fakt e ka fjalën për Rade Popadiqin, siç dëshmohet nga lidhja me Nikolla Jovanoviqin të përmendur në pjesën 6.12.2, më sipër.

399. Zoran Stijoviqi, drejtori i Sektorit Analitik të Qendrës së RDB-së në Prishtinë nga 1995 deri 1999, dëshmoi se RDB-ja kishte informacion sipas të cilit Nenad Remishtar, polic serb, ishte burgosur në Jabllanicë.²⁰⁵³

400. Dëshmitari 6, shqiptar katolik,²⁰⁵⁴ dëshmoi se më 13 qershor 1998, para orës 6 pasdite ai dhe “Nenadi” ndodheshin në një dhomë pranë hyrjes së oborrit në Jabllanicë.²⁰⁵⁵ Dëshmitari 6 e njihte

²⁰⁴³ P1242 (Dëshmitari 73, deklaratë dëshmitari, 13 nëntor 2007), paragrafi 4.

²⁰⁴⁴ P1242 (Dëshmitari 73, deklaratë dëshmitari, 13 nëntor 2007), paragrafi 5.

²⁰⁴⁵ P1242 (Dëshmitari 73, deklaratë dëshmitari, 13 nëntor 2007), paragrafi 8.

²⁰⁴⁶ P1242 (Dëshmitari 73, deklaratë dëshmitari, 13 nëntor 2007), paragrafët 10-11.

²⁰⁴⁷ P1242 (Dëshmitari 73, deklaratë dëshmitari, 13 nëntor 2007), paragrafi 11.

²⁰⁴⁸ P1242 (Dëshmitari 73, deklaratë dëshmitari, 13 nëntor 2007), paragrafi 10.

²⁰⁴⁹ P380 (Nebojsa Avramoviqi, deklaratë dëshmitari, 4 qershor 2007), paragrafi 13; Nebojsa Avramoviqi, T. 6600-6602. Shihni gjithashtu P385 (Hartë e zonës së pasigurtë për serbët sipas Dëshmitarit Avramoviqi.

²⁰⁵⁰ Nebojsa Avramoviqi, T. 6604.

²⁰⁵¹ Nebojsa Avramoviqi, T. 6604.

²⁰⁵² Nebojsa Avramoviqi, T. 6605.

²⁰⁵³ P931 (Zoran Stijoviqi, deklaratë dëshmitari, 27 shtator 2007), paragrafët 2, 55.

²⁰⁵⁴ Dëshmitari 6, T. 5166-5167, 5238-5239, 5263-5264, 5305, 5399.

Nenadin si polic serb apo malazez, i cili punonte në Gjakovë.²⁰⁵⁶ Dëshmitari 6 kishte dëgjuar nga Zokan Kuqi se Nenadi ishte nga fshati Binxhë, komuna e Klinës.²⁰⁵⁷ Dëshmitari 6 pa Nazmi Brahimajn dhe një grup ushtarësh kur shkelmuan dhe rrahën Nenadin me një shkop dhe objekte të tjera, duke e lënë të alivanosur, të mavijosur, dhe të paaftë për të ecur.²⁰⁵⁸ Ushtarët nuk dhanë asnjë shpjegim pse po e rrihnin Nenadin.²⁰⁵⁹ Dëshmitari 6 nuk i kujtohej t'a ketë parë Lahi Brahimajn atë mbrëmje.²⁰⁶⁰ Dëshmitari 6 dhe Nenadi u lidhën dhe u lanë në dhomë atë natë.²⁰⁶¹ Pasditen e nesërme më 14 qershor 1998, dy ushtarë erdhën dhe morën Nenadin me vete.²⁰⁶² Dëshmitari 6 nuk e pa më kurrë Nenadin.²⁰⁶³ Më pas ai dëgjoji nga Pavle Zuviqi, polic, se Nenadi ishte vrarë në Jabllanicë dhe kufoma e tij mund të ishte flakur diku në malet pranë Pejës ose Klinës.²⁰⁶⁴

401. Afërsisht dy javë pas 13 qershorit, ditën që kishin sjellë aty Dëshmitarin 6, në dhomën e tij futën një grup me katër të burgosur të tjerë, një bosnjak dhe tre malazezë.²⁰⁶⁵ Dëshmitari 6 dëshmoi se bosnjaku ishte mysliman, dhe se kur ushtarët po e rrihnin bosnjakun ai i dëgjoji të thoshnin se bosnjaku kishte punuar për kompaninë Elektrokosova në Deçan, se kishte ndërprerë rrymën, dhe se punonte për Serbinë.²⁰⁶⁶ Individë, të cilët Dëshmitari 6 nuk i njihte dhe të cilët ai nuk mund t'i përshkruante, njëri pas tjetrit shkelmuan, u ranë me shuplakë dhe rrahën katër personat e porsaardhur me shkopinj bejzbolli; një person përdori gjithashtu një thikë për t'iu shkaktuar atyre, veçanërisht bosnjakut, plagë sipërfaqore.²⁰⁶⁷ Nga plagët u rridhte gjak dhe ata pështynin gjak nga goja.²⁰⁶⁸ Mbi dysHEME kishte njolla gjaku.²⁰⁶⁹ Të katër personat i mbajtën në dhomë për tri-katër ditë.²⁰⁷⁰ Gjatë kësaj kohe Dëshmitari 6 shihte Nazmi dhe Hamza Brahimajn në dhomë.²⁰⁷¹ Një mbrëmje, rreth orës 2200, të katër të burgosurit u morën nga disa persona, të cilët Dëshmitari 6 nuk i identifikoi.²⁰⁷² Dëshmitari 6 nuk i pa më.²⁰⁷³

402. Dëshmia e Dëshmitari 73 përputhet me dëshminë e Dëshmitarit 6 dhe Dëshmitares 23 (shihni pjesën 6.15, më sipër) dhe Dhoma Gjyqësore është e bindur se Nenadi, që përmendet nga

²⁰⁵⁵ Dëshmitari 6, T. 5204, 5213-5215, 5293, 5316; P333 (Fotografi e objektit në Jabllanicë në të cilën Dëshmitari shënoi vendin ku rrahën atë dhe Nenadin).

²⁰⁵⁶ Dëshmitari 6, T. 5196-5197, 5354.

²⁰⁵⁷ Dëshmitari 6, T. 5197, 5354.

²⁰⁵⁸ Dëshmitari 6, T. 5208-5211, 5324.

²⁰⁵⁹ Dëshmitari 6, T. 5211.

²⁰⁶⁰ Dëshmitari 6, T. 5372.

²⁰⁶¹ Dëshmitari 6, T. 5210, 5213, 5215-5216, 5304, 5316; P333 (Fotografi e objektit në Jabllanicë në të cilën Dëshmitari shënoi vendin ku rrahën atë dhe Nenadin).

²⁰⁶² Dëshmitari 6, T. 5211, 5213, 5216, 5316-5317, 5324.

²⁰⁶³ Dëshmitari 6, T. 5317-5318, 5324.

²⁰⁶⁴ Dëshmitari 6, T. 5279, 5313-5314, 5323-5324.

²⁰⁶⁵ Dëshmitari 6, T. 5217, 5226-5227, 5329, 5387.

²⁰⁶⁶ Dëshmitari 6, T. 5227, 5329-5330, 5397.

²⁰⁶⁷ Dëshmitari 6, T. 5228, 5330-5331.

²⁰⁶⁸ Dëshmitari 6, T. 5228.

²⁰⁶⁹ Dëshmitari 6, T. 5230.

²⁰⁷⁰ Dëshmitari 6, T. 5227, 5330, 5387.

²⁰⁷¹ Dëshmitari 6, T. 5228.

²⁰⁷² Dëshmitari 6, T. 5230.

²⁰⁷³ Dëshmitari 6, T. 5230.

Dëshmitari 6, ishte Nenad Remishtari. Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se rrahjet i shkaktuan vuajtje të rënda Nenad Remishtarit. Për më tepër, duke patur paraysh egërsinë e rrahjeve, Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se rrahësit kanë patur për qëllim të shkaktonin vuajtje të tilla. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore është e bindur se ushtarët e UÇK-së kryen trajtim mizor ndaj Nenad Remishtarit. Për shkak të përkatësisë së tij etnike, punës së tij si polic, dhe mungesës së ndonjë shpjegimi të tjetër të arsyeshëm për burgosjen dhe keqtrajtimin e tij, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarët e UÇK-së e keqtrajtojnë Nenad Remishtarin për t'a ndëshkuar, frikësuar, dhe/ose diskriminuar. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarët e UÇK-së e torturuan Nenad Remishtarin.

403. Dëshmitari 6 dëshmoi se pasditën e 14 qershorit 1998, dy ushtarë të UÇK-së morën Nenad Remishtarin nga dhoma ku ai dhe Dëshmitari 6 kishin kaluar natën. Dëshmitari 6 dëshmoi gjithashtu se nuk e pa më kurrë Nenad Remishtarin. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi bazuar në thashethem të shumëfishtë nga Dëshmitari 73 sipas së cilës Nenad Remishtari ishte në Jabllanicë, gjallë, dhe nën ruajtjen e një ushtari të UÇK-së. Kjo dëshmi bazuar në thashethem të shumëfishtë sugjeron se burimi original ishte vetë Dëshmitari 6. Dhoma Gjyqësore mendon se dëshmia e drejtpërdrejtë e Dëshmitarit 6 është më e besueshme se dëshmia bazuar në thashethem të shumëfishtë. Përsa i përket vdekjes së Nenad Remishtarit, Dëshmitari 6 mundi të japte vetëm dëshmi të dorës së dytë se ai ishte vrarë në Jabllanicë, gjë që Dëshmitari 6 e kishte mësuar nga një polic serb. Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë prova konfirmuese të kësaj dëshmie të dorës së dytë. Duke marrë parasysh se askush nuk e pa më Nenad Remishtarin, Dhoma Gjyqësore pranon se ka plotësisht të ngjarë që ai të ketë vdekur. Meqë kufoma e tij nuk është gjetur, nuk ekziston dëshmi ekspertësh për shkakun e vdekjes së tij. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se provat nuk e lejojnë të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, se Nenad Remishtari është vrarë.

404. Dhoma Gjyqësore është e bindur se trajtimi mizor dhe torturimi kishin lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se Nenad Remishtari nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën e krimeve, dhe se kryesit e dinin ose duhet t'a kenë ditur këtë.

405. Dëshmitari 6 dëshmoi se nga fundi i qershorit 1998, në dhomën e tij në ndërtesat brenda oborrit në Jabllanicë sollën një bosnjak dhe tre malazezë. Sipas Dëshmitarit 6, ai pa disa persona që, njëri pas tjetrit, i shkelmuan, i goditën me shuplaka, dhe i rrahën me shkopa bejzbolli dhe një person u shkaktoi plagë të sipërfaqshme në lëkurë me një thikë. Dëshmitari 6 dëshmoi se atyre u rridhte gjak nga plagët dhe se pështynin gjak nga goja. Ai dëshmoi se ata u mbajtën në këtë dhomë tri-katër ditë përpara se t'i merrnin që andej. Dëshmitari 6 nuk dha ndonjë informacion për keqbërësit. Bazuar në dëshmitë në lidhje me Pikat 27-32 dhe aftësisë e keqbërësve për të hyrë në atë kohë në atë dhomë në oborrin dhe ndërtesat brenda tij në Jabllanicë, Dhoma Gjyqësore është e

bindur se ata ishin ushtarë të UÇK-së ose persona që kishin lidhje me UÇK-në. Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se rrahjet dhe goditjet me thikë u shkaktuan këtyre katër burrave lëndime dhe vuajtje të rënda fizike. Për më tepër, duke patur parasysh egërsinë e keqtrajtimit, Dhoma Gjyqësore është e bindur se keqbërësit kanë patur për qëllim të shkaktojnë vuajtje dhe lëndime të tilla. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarë të UÇK-së apo persona të lidhur me UÇK-në kryen trajtim mizor ndaj këtyre katër burrave.

406. Dëshmitari 6 dëshmoi se kishte dëgjuar nga keqbërësit, ndërkohë që ata rrihnin bosnjakun, se ai kishte punuar për kompaninë Elektrokosova në Deçan, se kishte ndërprerë furnizimin me energji elektrike, dhe se kishte punuar për Serbinë. Dhoma Gjyqësore është e bindur se atë po e rrihnin për t'a ndëshkuar për këto akte të pretenduara. Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë dëshmi për arsyen e keqtrajtimit të tre malazezëve. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ushtarë të UÇK-së apo persona të lidhur me UÇK-në torturuan bosnjakun, por Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur se këta persona torturuan të tre malazezët. Aktakuza nuk përmban pretendime faktuale për vrasjen e bosnjaku dhe tre malazezëve. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore konkludon se akuza për vrasje vlen vetëm për Nenad Remishtarin.

407. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto krime kanë lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se viktimat nuk merrnin pjesë aktive në luftime kur u kryen këto krime, dhe se kryesit e dinin ose duhet t'a kenë ditur këtë.

408. Të tre të Akuzuarit akuzohen në Pikën 30 si pjesëmarrës në një ndë marrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do të trajtojë këtë formë përgjegjësie në pjesën 7, më poshtë.

6.17 Shtabi i UÇK-së në Jabllanicë (Pika 32)

6.17.1 Trajtimi mizor, torturimi dhe vrasja e Pal Krasniqit

409. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndë marrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor, torturimin dhe vrasjen e Pal Krasniqit si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës.

410. Pika 32 e Aktakuzës akuzon të Akuzuarit për krime lufte që pretendohen se janë kryer kunder tre viktimave. Paragrafët 99-100 kanë të bëjnë me Pal Krasniqin, paragrafët 101-102 kanë të bëjnë me Skënder Kuqin, dhe paragrafët 103-106 janë në lidhje me Dëshmitarin 3. Paragrafët 99-100 nuk përcaktojnë ndonjë veprim apo mosveprim nga ana e të Akuzuarve. Paragrafët 101-102 nuk përcaktojnë ndonjë veprim apo mosveprim nga ana e Lahi Brahimajt dhe Idriz Balajt. Për më tepër, në asnjë pjesë tjetër të Aktakuzës nuk përmenden veprime apo mosveprime nga ana e të Akuzuarve lidhur me pretendimet konkrete faktuale të paragrafëve 99-102. Megjithatë, duket se në

Pikën 32, të tre të Akuzuarit akuzohen për të gjitha krimet e pretenduara kundër të tre viktimave, mbi bazën e një apo më shumë përgjegjësie.

411. Përveç Pikës 32 (dhe Pikës 31 e cila ka të bëjë me të njëjtat pretendime faktuale), të gjitha Pikat në Aktakuzë, në të cilat një i Akuzuar akuzohet me çfarëdoformë përgjegjësie përveç asaj të pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, përshkruajnë veprimet apo mosveprimet e pretenduara të atij të Akuzuari. Gjithashtu Pika 32 pretendon, në paragrafin 102, se Ramush Haradinaj udhëzoi zhvarrosjen e kufomës të Skënder Kuqit dhe dorëzimit të kufomës familjes së tij. Ndryshe, Haradinaj akuzohet se ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 32. Dhoma Gjyqësore kupton se Aktakuza i konsideron udhëzimet e dhëna nga Haradinaj si ndihmë dhe inkurajim për trajtimin mizor, torturimin, dhe vrasjen e Skënder Kuqit. Duke marrë parasysh këtë element, mospërmendja e dy të Akuzuarve të tjerë në pretendimet faktuale lidhur me Skënder Kuqin lë të kuptohet se Prokuroria nuk synoi t'i akuzonte në ndonjë formë përgjegjësie alternative në lidhje me krimet e pretenduara kundër kësaj viktime. Po kështu, kjo sugjeron se Prokuroria nuk synoi të akuzojë asnjë nga të Akuzuarit me ndonjë formë përgjegjësie alternative për krimet e pretenduara kundër Pal Krasniqit.

412. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore konstaton se format alternative të përgjegjësisë, mbi bazën e të cilave akuzohet në Pikën 32, *in fine* duhet të kufizohen tek përgjegjësitë e atyre të Akuzuarve, emrat të cilët përmenden lidhur me pretendimet faktuale për secilin nga tre viktimat. Rrjedhimisht asnjë prej të Akuzuarve nuk akuzohet ndryshe për krimet e pretenduara kundër Pal Krasniqit. Vetëm Haradinaj akuzohet ndryshe për krimet e pretenduara kundër Skënder Kuqit (Pjesa 6.17.2). Për sa i përket Dëshmitarit 3, të tre të Akuzuarit akuzohen në alternativë (Pjesa 6.17.3).

413. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse për krimet e pretenduara kundër Pal Krasniqi nga një numër dëshmitarësh si dhe dëshminë mjekoligjore.

414. Mahir Demaj, shqiptar kosovar,²⁰⁷⁴ deklaroi se ai dhe Pal Krasniqi - të dy donin të bashkoheshin me UÇK-në - po udhëtonin me një autobus në vitin 1998, megjithëse atij nuk i kujtohet data e saktë.²⁰⁷⁵ Ata u ndaluan nga një grup civilësh serbë të armatosur në rrugën midis Tërstenikut, komuna e Pejës, dhe Klinës.²⁰⁷⁶ Civilët thirrën policinë me uniformë, e cila filloi menjëherë t'i rrihte dhe shkëlmonte.²⁰⁷⁷ Ata u çuan në stacionin policor të Klinës, ku u morën në pyetje ndërsa vazhduan t'i rrihnin me grushte, shkelma, dhe një send metalik.²⁰⁷⁸ Rreth mesnatës, Mahir Demaj dhe Pal Krasniqi u lejuan të largoheshin nga stacioni policor.²⁰⁷⁹ Ata u fshehën, por

²⁰⁷⁴ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 3.

²⁰⁷⁵ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafët 3, 4, 5, Shtojcë, paragrafi 2.

²⁰⁷⁶ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 5.

²⁰⁷⁷ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 5.

²⁰⁷⁸ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 5.

²⁰⁷⁹ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 6.

policia i gjeti menjëherë përsëri dhe i solli në Klinë, ku përsëri u liruan.²⁰⁸⁰ Të dy burrat nuk kishin ndërmend të paraqiteshin në stacionin policor, siç ishin urdhëruar, dhe vazhduan rrugën për në Grabanicë, komuna e Klinës, ku takuan disa anëtarë të UÇK-së; një nga anëtarët e UÇK-së u tregoi rrugën për në Jabllanicë, komuna e Gjakovës.²⁰⁸¹ Pasi mbërritën në Jabllanicë, Pal Krasniqi dhe Mahir Demaj u çuan në një spital të improvizuar ku Mahir Demaj u mjekua për plagët e tij.²⁰⁸² Mahir Demajt i kujtohet se në spital mjekoheshin të paktën dhjetë persona, një prej të cilëve ishte një anëtar i UÇK-së i plagosur nga një plumb.²⁰⁸³ Mahir Demaj deklaroi se doli vetë nga spitali të nesërmen dhe se ai si dhe disa të afërm të tij u bashkuan me një grup që do të nisej për në Junik, komuna e Deçanit, për të marrë armë nga Shqipëria.²⁰⁸⁴ Pal Krasniqi mbeti në Jabllanicë.²⁰⁸⁵ Herën e fundit që Mahir Demaj e pa Pal Krasniqin, ai ishte i veshur me rroba civile, duke përfshirë një palë pantallona blu xhins.²⁰⁸⁶ Pal Krasniqi tha se do të qëndronte me disa miq në Jabllanicë.²⁰⁸⁷

415. Ded Krasniqi, shqiptar,²⁰⁸⁸ dëshmoi se më 10 korrik 1998 i biri, Pal Krasniqi, së bashku me një mik, Mahir Demaj, u nis për në Jabllanicë për t'u bashkuar me UÇK-në.²⁰⁸⁹ Pal Krasniqi ishte i veshur me një bluzë me mëngë të shkurtra me vija dhe me jakë me vija të kuqe, këpucë sportive të kaltër në të bardhë, si dhe tuta sportive me një shirit të bardhë.²⁰⁹⁰ Gjatë rrugës ata u ndalën në një postbllok të policisë në Krushën e Madhe.²⁰⁹¹ Ata u rrahën nga policia serbe dhe u çuan në Klinë.²⁰⁹² Më 11 korrik 1998, rreth orës 6 të mëngjesit, Pal Krasniqi mori në telefon Ded Krasniqin nga Klina dhe i tregoi çfarë kishte ndodhur.²⁰⁹³ Dëshmitari e këshilloi të birin të shkonte në Jabllanicë, siç kishte ndërmend.²⁰⁹⁴ Dedë Deda, nipi i dëshmitarit dhe shok i Pal Krasniqit, i tha dëshmitarit se në mes të gushtit 1998, Pal Krasniqi pati një bisedë të shkurtër telefonike me të nga Jabllanica.²⁰⁹⁵ Sipas Dedë Dedës, Pal Krasniqi tha se kishte shumë para me vete dhe se donte t'a takonte.²⁰⁹⁶ Dedë Deda tregoi se ranë dakord të takoheshin po atë ditë në Gjakovë, por Pal Krasniqi nuk erdhi.²⁰⁹⁷ Në një datë të papërcaktuar pas luftës, dëshmitari u takua me Mahir Demajn në Pejë dhe e pyeti për të birin.²⁰⁹⁸ Demaj u frikësua dhe i tha Dëshmitarit të mos e kërkonte të birin, duke

²⁰⁸⁰ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 6.

²⁰⁸¹ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafët 7, 8, 9.

²⁰⁸² P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafët 10, 11.

²⁰⁸³ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 12.

²⁰⁸⁴ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 13.

²⁰⁸⁵ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 13.

²⁰⁸⁶ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 14.

²⁰⁸⁷ P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 14.

²⁰⁸⁸ Ded Krasniqi, T. 4767-4768.

²⁰⁸⁹ Ded Krasniqi, T. 4768-4770, 4774, 4805.

²⁰⁹⁰ Ded Krasniqi, T. 4787-4789.

²⁰⁹¹ Ded Krasniqi, T. 4770, 4807.

²⁰⁹² Ded Krasniqi, T. 4770, 4773-4774, 4807, 4833.

²⁰⁹³ Ded Krasniqi, T. 4770, 4807, 4829. Shihni gjithashtu P1240 (Mahir Demaj, deklaratë dëshmitari, 26 prill 2007), paragrafi 8.

²⁰⁹⁴ Ded Krasniqi, T. 4771.

²⁰⁹⁵ Ded Krasniqi, T. 4818-4821, 4835-4837.

²⁰⁹⁶ Ded Krasniqi, T. 4820-4821, 4835.

²⁰⁹⁷ Ded Krasniqi, T. 4820-4821, 4835-4837.

²⁰⁹⁸ Ded Krasniqi, T. 4771-4772, 4809.

shtuar se “askush nuk do të guxojë të thotë diçka për këtë”.²⁰⁹⁹ Demaj i tha gjithashtu dëshmitarit se ai dhe Pal Krasniqi shkuan në Jabllanicë, se Demajn e çuan në spital për shkak të plagëve që kishte pësuar nga rrahjet, dhe se Pali u bashkua me UÇK-në.²¹⁰⁰ Sipas asaj që Demaj i rrëfeu Dëshmitarit, rreth pesë ditë pasi ishin nisur për në Jabllanicë, Pal Krasniqi i bëri një vizitë Demajt në spital.²¹⁰¹ Ai shoqërohej nga dy ushtarë.²¹⁰² Kjo ishte hera e fundit që Demaj pa të birin e Dëshmitarit.²¹⁰³

416. Ded Krasniqi dëshmoi se në vitin 1998, vëllai i tij së bashku me disa fshatarë shkuan në Jabllanicë për të pyetur për të birin e dëshmitarit.²¹⁰⁴ Vëllait të dëshmitarit i thanë se Pal Krasniqi “shkoi në Pejë”, me kuptimin që është zhdukur dhe nuk do të kthehet më kurrë.²¹⁰⁵ Në vitin 2000, dëshmitari filloi të kërkojë të birin.²¹⁰⁶ Në fillim shkoi në Jabllanicë dhe foli me një anëtar të UÇK-së të quajtur Hamëz Ukshini, i cili i tha dëshmitarit se Pal Krasniqi nuk ishte i regjistruar në listën e anëtarëve të UÇK-së që kishin ardhur dhe ishin larguar nga Jabllanica.²¹⁰⁷ Pas kësaj dëshmitari shkoi në Klinë për të takuar Alush Agushin, komandant në UÇK.²¹⁰⁸ Agushi i tha dëshmitarit se djali i tij kishte qënë me të deri në “ofensivën e parë në shtator”.²¹⁰⁹ Alush Agushi mbajti disa shënime dhe i tha Ded Krasniqit të kthehej tek ai pas dy javësh, por Agushi nuk e kontaktoi më dëshmitarin.²¹¹⁰

417. Në tetor apo nëntor 2000, Dëshmitari 6 i bëri një vizitë Ded Krasniqit.²¹¹¹ Ai i tha Ded Krasniqit se kishte qënë në burg në Jabllanicë së bashku me të birin e Ded Krasniqit, të cilin e kishin keqtrajtuar.²¹¹² Të birin e Dedës e akuzonin si spiun të policisë serbe.²¹¹³

418. Dëshmitari 6 dëshmoi se një ditë rreth mesit të korrikut 1998, një ditë pas mbërritjes në Jabllanicë të një personi nga Zahaqi, komuna e Pejës, atje sollën edhe Pal Krasniqin.²¹¹⁴ Dëshmitari 6 solli ushqime dhe ujë në dhomën ku mbaheshin këta burra.²¹¹⁵ Dëshmitari 6 mësoi nga Pal Krasniqi se ishte nga Meqa, komuna e Gjakovës, dhe se ishte katolik.²¹¹⁶ Ai ishte veshur me rroba sportive – një kostum sportiv me shirita të bardhë anash.²¹¹⁷ Dëshmitari 6 pa se si ushtarët e rrahën

²⁰⁹⁹ Ded Krasniqi, T. 4772, 4809.

²¹⁰⁰ Ded Krasniqi, T. 4772-4773, 4810.

²¹⁰¹ Ded Krasniqi, T. 4773-4774, 4810.

²¹⁰² Ded Krasniqi, T. 4810.

²¹⁰³ Ded Krasniqi, T. 4773-4774.

²¹⁰⁴ Ded Krasniqi, T. 4817-4818, 4822.

²¹⁰⁵ Ded Krasniqi, T. 4817-4818, 4822-4825.

²¹⁰⁶ Ded Krasniqi, T. 4775-4776.

²¹⁰⁷ Ded Krasniqi, T. 4775-4778.

²¹⁰⁸ Ded Krasniqi, T. 4775, 4779, 4810.

²¹⁰⁹ Ded Krasniqi, T. 4783-4784, 4810-4812.

²¹¹⁰ Ded Krasniqi, T. 4780-4781.

²¹¹¹ Ded Krasniqi, T. 4790, 4793, 4795.

²¹¹² Ded Krasniqi, T. 4794.

²¹¹³ Ded Krasniqi, T. 4794.

²¹¹⁴ Dëshmitari 6, T. 5206, 5231-5233, 5247-5249, 5252-5255, 5293, 5297-5298, 5334, 5386, 5388-5389, 5391; P334 (Fotografi e Pal Krasniqit me paterica dhe një personi tjetër).

²¹¹⁵ Dëshmitari 6, T. 5204-5205, 5332-5333, 5335-5337; P332 (Fotografi e objektit në Jabllanicë).

²¹¹⁶ Dëshmitari 6, T. 5238, 5335, 5358.

²¹¹⁷ Dëshmitari 6, T. 5247.

Pal Krasniqin me një shkop.²¹¹⁸ Si pasojë, Pal Krasniqi ishte në gjendje të keqe shëndetësore.²¹¹⁹ Po atë ditë, rreth orës 13 pasdreke, Dëshmitari 6 pa se si Pal Krasniqi u orvat të arratisëj përmes dritares së bashku me personin nga Zahaqi dhe një burrë nga Grabanica, komuna e Klinës.²¹²⁰ Hamza Brahimaj dhe ushtarë të tjerë e kapën Pal Krasniqin, e rrahën atë në prani të Dëshmitarit 6, dhe e futën përsëri në dhomën e tij.²¹²¹ Pal Krasniqi ishte i enjtur, i gjakosur, pështynte gjak, dergjej në dysheme dhe nuk ishte në gjendje as të hante, as të pinte.²¹²² Nga fundi i qëndrimit të Dëshmitarit 6 në Jabllanicë, shëndeti i Pal Krasniqit u përmirësua dhe ai filloi të shëtiste përreth në oborr.²¹²³ Më 25 korrik 1998, Dëshmitari 6 u largua nga Jabllanica.²¹²⁴ Në atë kohë Pal Krasniqi ishte personi i vetën që mbahej atje.²¹²⁵ Dëshmitari 6 nuk e pa më kurrë atë.²¹²⁶

419. Dëshmitari 3 dëshmoi se diku nga fillimi deri në mes të korrikut 1998, atë e futën në një dhomë në ndërtesën e shtabit të UÇK-së në Jabllanicë, ku qëndroi dy netë dhe tri ditë.²¹²⁷ Në dhomë ishin dhe dy persona të tjerë.²¹²⁸ Një prej tyre ishte Skënder Kuqi; tjetri ishte i veshur me një kostum sportiv me disa kopsa të verdha dhe të bardha anash, por Dëshmitari 3 dëshmoi se dikush ia ndërroi këto rroba më vonë pasi vinin erë të keqe.²¹²⁹ Ky person kishte shumë plagë, trupin e kishte të enjtur, dhe nuk ishte në gjendje të lëvizte.²¹³⁰ Ai i kryente nevojat personale brenda në dhomë.²¹³¹ Natën, të tre të burgosurve ua lidhnin duart.²¹³² Dëshmitari 3 pa njëherë Nazmi Brahimajn dhe Miftar Brahimajn që erdhën në dhomë.²¹³³ Ai pa gjithashtu Naser “Rusi” Brahimajn, të cilin e kishte njohur prej shumë kohe, që vinte në dhomë dhe i rrihte vazhdimisht dy të burgosurit e tjerë.²¹³⁴ Dëshmitari vendosi të arratisëj dhe u tha dy të bashkëburgosurve, se po të dëshironin mund të vinin me të.²¹³⁵ Rreth mesditës, Dëshmitari 3 u arratis nëpërmjet dritares.²¹³⁶ Dëshmitari 3 pa Skënder Kuqin që u orvat të vinrte pas tij, por nuk pa nëse personi tjetër bëri të njëjtën gjë.²¹³⁷ Të paktën 10 ditë më vonë, ai u kthye i shoqëruar nga Lahi Brahimaj në selinë e shtabit të UÇK-së në Jabllanicë, dhe shkoi për të parë personin të cilit nuk ia dinte emrin, dhe pa se ai ishte në po atë gjendje që Dëshmitari 3 e kishte parë për herë të fundit.²¹³⁸ Brahimaj e pyeti këtë person nëse

²¹¹⁸ Dëshmitari 6, T. 5235, 5335.

²¹¹⁹ Dëshmitari 6, T. 5235, 5237.

²¹²⁰ Dëshmitari 6, T. 5236-5238, 5338-5339, 5389-5390.

²¹²¹ Dëshmitari 6, T. 5237, 5239-5240, 5338, 5390.

²¹²² Dëshmitari 6, T. 5240-5241.

²¹²³ Dëshmitari 6, T. 5341, 5359-5360.

²¹²⁴ Dëshmitari 6, T. 5206, 5255, 5297-5298; P335 (Vendime të nënshkruara nga Nazmi Brahimaj).

²¹²⁵ Dëshmitari 6, T. 5239, 5251, 5359-5360.

²¹²⁶ Dëshmitari 6, T. 5241, 5250-5251.

²¹²⁷ Dëshmitari 3, T. 7937-7938, 7942-7943, 7945, 7948, 8008-8010; D118 (Fotografi e një kasoljeje në Jabllanicë që pretendohet se u përdor si burg (pamje me lëndinë)).

²¹²⁸ Dëshmitari 3, T. 7946.

²¹²⁹ Dëshmitari 3, T. 7947.

²¹³⁰ Dëshmitari 3, T. 7950, 8028.

²¹³¹ Dëshmitari 3, T. 7951, 8028.

²¹³² Dëshmitari 3, T. 7951, 8010.

²¹³³ Dëshmitari 3, T. 7949, 8017.

²¹³⁴ Dëshmitari 3, T. 7949-7950, 8018.

²¹³⁵ Dëshmitari 3, T. 7955, 7957.

²¹³⁶ Dëshmitari 3, T. 7957-7959, 8019-8020; P914 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 3 shënoi rrugën e arratisjes së tij dhe dhomën e Lahi Brahimajt).

²¹³⁷ Dëshmitari 3, T. 7957.

²¹³⁸ Dëshmitari 3, T. 7946, 7962, 8026-8028.

Skënder Kuqi i kishte premtuar Dëshmitarit 3 10,000 marka gjermane për t'a ndihmuar të arratisëj.²¹³⁹ Burri u përgjegj negativisht duke bërë me dorë shenjën e kryqit.²¹⁴⁰

420. Branimir Aleksandriqi²¹⁴¹ dëshmoi se kufoma me numër “R-9” u gjet më 11 shtator 1998 pranë kanalit, përgjatë anës së jashtme të murit prej betoni ku kishte shenja plumbash, së bashku me tetë kufoma të tjera.²¹⁴² Në pjesën e jashtme të murit prej betoni, direkt mbi kufomën R-9, dukeshin shenja plumbash.²¹⁴³ Prej analizës së ADN-së nga KNPZh-ja kufoma me numër R-9 u identifikua si Pal Krasniqi.²¹⁴⁴ Autopsia e kufomës e kryer më 5 dhjetor 2003 zbuloi plagë me armë zjarri në kokë, trung dhe gjymtyrët e sipërme.²¹⁴⁵ Këto plagë të shumta me armë zjarri u përcaktuan si shkaku i vdekjes.²¹⁴⁶ Autopsia e kufomës e kryer në shtator 1998 zbuloi plagën e hyrjes anësore të një plumbi në pjesë e poshtme të nofullës së majtë; plagën e daljes në anën e djathtë të kafkës.²¹⁴⁷ Autopsia zbuloi thyerje në të dy pjesët e sipërme të të dy krahëve, në parakrahun e djathtë dhe në kofshën e djathtë; këto thyerje nuk mund të jenë shkaktuar nga ndonjë rrëzim.²¹⁴⁸ Shkalla e shpërbërjes tregonte se vdekja mund të kishte ndodhur midis prillit dhe gushtit 1998.²¹⁴⁹ Dominique Lecomte²¹⁵⁰ arriti në përfundimin se R-9 duhej të ishte vrarë afërsisht 2-3 muaj më parë.²¹⁵¹

421. Siç u përmend më sipër, Dëshmitari 6 dëshmoi se rreth mesit të korrikut 1998, ai pa ushtarë të UÇK-së në ndërtesat brenda oborrit në Jabllanicës kur rrahën Pal Krasniqin me një shkop, duke I shkaktuar gjendje të keqe fizike. Ai dëshmoi më tej se pasi Pal Krasniqi u përpoq të arratisëj, ushtarët e UÇK-së e rrahën përsëri duke e lënë të enjtur, të përgjakur, duke pështyrë gjak, dhe të dergjur mbi dysheme, të paaftë të hante apo të pinte. Dëshmitari 3 dëshmoi se rreth fillimit apo mesit të korrikut 1998, ai shkoi në vendindodhjen e lartpërmendur në Jabllanicë, ku kaloi dy netë dhe tri ditë në një dhomë me dy persona të tjerë, njërin prej të cilëve ai nuk e njohte. Ky burrë, sipas Dëshmitarit 3, ishte i enjtur, me shumë plagë, nuk mund të lëvizte, dhe i kryente nevojat personale në dhomë. Më tej Dëshmitari 3 dëshmoi se pa një ushtar të UÇK-së që hyri në dhomë disa herë dhe e rrihte burrin. Sipas Dëshmitarit 3, kur u kthye në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë të paktën 10 ditë më vonë, ai e pa përsëri të njëjtin person në të njëjtën gjendje të keqe fizike. Dëshmitari 3

²¹³⁹ Dëshmitari 3, T. 7962.

²¹⁴⁰ Dëshmitari 3, T. 7947-7948, 7962.

²¹⁴¹ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1, 4, 6, 9, 11-12, 245; Branimir Aleksandriq, T. 6732-6733, 6737; P1113 (Shtojca A e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007), f. 1; P1114 (Shtojca B e deklaratës së dëshmitarit Branimir Aleksandriq, 26 qershor 2007).

²¹⁴² P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 61-62; P414 (Fotografi të ndryshme), f. 20; P416 (Fotografi të ndryshme), f. 3; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 18; P645 (Fotografi të ndryshme), f. 2; P649 (Fotografi të ndryshme), f. 2.

²¹⁴³ P1260 (Branimir Aleksandriq, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 102; P418 (Fotografi të ndryshme), f. 12, 15; P645 (Fotografi të ndryshme), f. 3.

²¹⁴⁴ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 56.

²¹⁴⁵ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 57-58.

²¹⁴⁶ Fakte të Pranuara, 26 nëntor 2007, Nr. 59.

²¹⁴⁷ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 291; Dushan Dunjiq, T. 6844; P668 (Raporti i autopsisë R-9), f. 1-2, 5-6; P670 (Fotografi R-9), f. 4.

²¹⁴⁸ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 291; P668 (Raport i autopsisë R-9), f. 2, 6.

²¹⁴⁹ P618 (Dushan Dunjiq, deklaratë dëshmitari, 8 qershor 2007), paragrafi 292.

²¹⁵⁰ P926 (CV i Dominique Lecomte); Dominique Lecomte, T. 8758.

²¹⁵¹ D166 (Aktekspertiza e dytë nga Lecomte dhe Vorhauer, 15 qershor 2007), f. 20; Dominique Lecomte, T. 8769-8782.

deklaroi se pa burrin që bëri shenjën e kryqit mbi gjoks. Dëshmitari 6 dëshmoi se Pal Krasniqi tha se ishte katolik. Përshkrimet e veshjes së tij nga Dëshmitari 3 dhe Dëshmitari 6 përgjithësisht përputhen. Dhoma Gjyqësore është e bindur se burri për të cilin dëshmoi Dëshmitari 3, dhe të cilin ai nuk e njohte, ishte Pal Krasniqi. Dëshmia mjekoligjore konfirmon se Pal Krasniqi kishte pësuar lëndime të rënda fizike. Dhoma Gjyqësore është e bindur se ushtarët e UÇK-së i shkaktuan Pal Krasniqit vuajtje dhe lëndime të rënda fizike. Duke marrë parasysh egërsinë e rrahjeve, të cilat vazhduan pavarësisht nga gjendja e keqe fizike e Pal Krasniqit, Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se keqbërësit duhet të kenë patur qëllim pikërisht shkaktimin e vuajtjeve dhe lëndimeve të tilla. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarët e UÇK-së kryen trajtimin mizor ndaj Pal Krasniqit. Ded Krasniqi dëshmoi se Dëshmitari 6 e kishte informuar se kur Pal Krasniqi, ndodhej në ndërtesat brenda oborrit në Jabllanicë, ai ishte rrahur dhe akuzuar si spiun i serbëve. Meqë kjo dëshmi e dorës së dytë nuk u konfirmua prej vetë dëshmisë së Dëshmitarit 6, Dhoma Gjyqësore nuk mund të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në lidhje me qëllimin e rrahjeve. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore konkludon se pretendimi për torturim të Pal Krasniqit nuk u vërtetua jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

422. Sipas dëshmive, Pal Krasniqi u pa për herë të fundit i gjallë, në një gjendje të përmirësuar shëndetësore, më 25 korrik 1998. Ded Krasniqi dëshmoi se dikur në vitin 1998, vëllai i tij shkoi në Jabllanicë për të pyetur për Pal Krasniqin dhe më vonë i tha Ded Krasniqit se një person i paidentifikuar i kishte thënë se Pal Krasniqi “shkoi në Pejë”. Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi së paku të dorës së tretë nga Ded Krasniqi se një ditë nga mesi i gushtit 1998 Dede Deda mësoi nga Pal Krasniqi në një bisedë telefonike se ai ishte në Jabllanicë me një shumë të madhe parash. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar gjithashtu dëshmi të dorës së dytë se ai nuk erdhi në një takim të caktuar me Dede Dedën në Gjakovë po atë ditë. Ded Krasniqi dëshmoi gjithashtu se komandanti i UÇK-së Alush Agushi i tha atij se Pal Krasniqi kishte qënë me Agushin deri në ofensivën e parë në shtator 1998. Dhoma Gjyqësore nuk e pranon këtë dëshmi të pakonfirmuar, të dorës së dytë, e cila hidhet poshtë nga dëshmia e ekspertëve mjekoligjorë, asnjë prej të cilëve nuk e konsideroi si të mundshme që Pal Krasniqi të kishte vdekur vetëm pak para se kufoma e tij të gjendej në kanalën e Radoniqit. Provat nuk përcaktojnë nëse Pal Krasniqi doli ndonjëherë nga mbajtja në arrest prej UÇK-së. Përshkrimi i Dëshmitarit 6 për veshjen e Pal Krasniqit kur ai ishte në ndërtesën brenda oborrit në Jabllanicë, përputhet me veshjen e gjetur në kufomën e tij. Duke marrë parasysh keqtrajtimin e egër të Pal Krasniqit nga njerëzit e UÇK-së, në duart e të cilëve ai u pa për herë të fundit, Dhoma Gjyqësore është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Pal Krasniqi u vra kur mbahej prej UÇK-së.

423. Për më tepër Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto krime kishin lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosova, se Pal Krasniqi nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën e kryerjes së këtyre krimeve, dhe se kryesit e dinin ose duhej t'a dinin një gjë të tillë.

424. Të tre të Akuzuarit akuzohen me Pikën 32 si pjesëmarrës në një ndërrmarje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do t'a trajtoj këtë formë përgjegjësie në pjesën 7, më poshtë.

6.17.2 Trajtimi mizor, torturimi dhe vrasja e Skënder Kuqit

425. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërrmarje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor, torturimin, dhe vrasjen e Skënder Kuqi si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Ndryshe Ramush Haradinaj akuzohet se ka ndihmuar dhe inkurajuar krimet e kryera ndaj Skender Kuqit. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi përkatëse nga një numër dëshmitarësh.

426. Qerim Kuqi, shqiptar, dëshmoi se kushëriri i tij, Skënder Kuqi, jetonte në Lutogllavë në vitin 1998.²¹⁵² Skënder Kuqi ishte pronar i një shitoreje në Zahaq, aty pranë.²¹⁵³ Në korrik 1998, dëshmitari vizitoi Skënder Kuqin në shitoren e tij.²¹⁵⁴ Dhjetë minuta pas mbërritjes së dëshmitarit në shitore erdhën dy burra me makinë.²¹⁵⁵ Burrat ishin të veshur me xhaketa ushtarake kamuflazhi pa simbole dalluese.²¹⁵⁶ Ata mbanin maska të kuqe dhe të zeza dhe ishin të armatosur me armë automatike.²¹⁵⁷ Burrat hynë në shitore, duke bërë titur në serbisht.²¹⁵⁸ Ata i drejtuan armët dëshmitarit dhe i kontrolluan xhepat.²¹⁵⁹ Burrat e nxorrën Skënder Kuqin nga shitorja dhe e çuan te garazhi ku ndodhej makina e Skënder Kuqit, një Mercedes.²¹⁶⁰ Tri minuta pas ardhjes, burrat u larguan me Skënder Kuqin në makinën e Skënder Kuqit, si dhe me makinën me të cilën kishin ardhur.²¹⁶¹ Skënder Kuqi ngiste makinën e vetë, i shoqëruar nga një prej burrave.²¹⁶² Dëshmitari pa që të dy makinat u larguan së bashku në drejtim të Klinës, njëra pas tjetrës.²¹⁶³ Dëshmitari nuk e pa më kurrë Skënder Kuqin.²¹⁶⁴ Më pas dëshmitari i tregoi Adem Kuqit, vëllait të Skënder Kuqit, çfarë kishte ndodhur.²¹⁶⁵ Në vitin 1998, Adem Kuqi ishte polic i papunë, i shkarkuar nga policia serbe.²¹⁶⁶ Disa

²¹⁵² Qerim Kuqi, T. 9988-9990.

²¹⁵³ Qerim Kuqi, T. 9990; D32 (Hartë e Vendndodhjeve të përmendura në Aktakuzë).

²¹⁵⁴ Qerim Kuqi, T. 9991.

²¹⁵⁵ Qerim Kuqi, T. 9991, 9997.

²¹⁵⁶ Qerim Kuqi, T. 9997, 10003.

²¹⁵⁷ Qerim Kuqi, T. 9998-9999.

²¹⁵⁸ Qerim Kuqi, T. 9998-9999.

²¹⁵⁹ Qerim Kuqi, T. 9999-10000.

²¹⁶⁰ Qerim Kuqi, T. 9999-10001, 10005.

²¹⁶¹ Qerim Kuqi, T. 10000-10001.

²¹⁶² Qerim Kuqi, T. 10001.

²¹⁶³ Qerim Kuqi, T. 10002.

²¹⁶⁴ Qerim Kuqi, T. 9990, 10005.

²¹⁶⁵ Qerim Kuqi, T. 9990, 10004.

²¹⁶⁶ Qerim Kuqi, T. 9990.

javë pas këtyre ngjarjeve, Adem Kuqi i tha dëshmitarit se Skënder Kuqi kishte vdekur, pa përmendur rrethanat e vdekjes.²¹⁶⁷

427. Dëshmitari 6 dëshmoi se një ditë rreth mesit të korrikut 1998 ai ishte në oborrin në Jabllanicë, ku mbahej, kur pa mbërritjen e një Mercedesi 190 me ngjyrë të metalizuar. Ai pa gjithashtu se disa persona, të cilët nuk i identifikoi, nxorën nga bagazhi i makinës një burrë shumë të shëndoshë.²¹⁶⁸ Dëshmitari 6 dëgjoi nga Pal Krasniqi se ky burrë ishte shqiptar mysliman nga Zahaqi, komuna e Pejës.²¹⁶⁹ Dëshmitari 6 dëshmoi se pa ushtarë të UÇK-së kur e rrahën burrin.²¹⁷⁰ Dëshmitari 6 i sollti burrit, që nuk e njihte, ushqim dhe ujë në dhomën ku mbahej.²¹⁷¹ Burri ishte në gjendje të keqe fizike, i shtrirë në dysheme, me trupin e enjtur, dhe me sytë të mbyllur.²¹⁷² Po atë ditë, rreth orës 1 pasdite, Dëshmitari 6 pa po këtë burrë që u përpoq të arratisej përmes një dritareje së bashku me Pal Krasniqin dhe një burrë tjetër nga Grabanica, komuna e Klinës.²¹⁷³ Hamza Brahimaj dhe ushtarë të tjerë e kapën burrin nga Zahaqi dhe e rrahën në prani të Dëshmitarit 6.²¹⁷⁴ Dëshmitari 6 mësoi nga Gani Brahimaj, i cili punonte në objektin e Jabllanicës si kuzhinier, se të nësërmen disa persona të cilët Dëshmitari 6 nuk i identifikoi, e dërguan burrin nga Zahaqi për mjekim në Gllogjan, komuna e Deçanit, dhe se ai vdiq atje.²¹⁷⁵ Dëshmitari 6 dëshmoi se nuk njihte ndonjë person me emrin Skënder Kuqi.²¹⁷⁶

428. Dëshmitari 3²¹⁷⁷ dëshmoi se rreth fillimit deri në mesin e korrikut 1998, atë e futën në një dhomë të ndërtesës së shtabit të UÇK-së në Jabllanicë, ku e mbajtën dy netë dhe tri ditë.²¹⁷⁸ Në atë dhomë mbaheshin edhe dy persona të tjerë.²¹⁷⁹ Dëshmitari 3 e njihte njërin prej tyre sepse kishte qenë mësuesi i tij Skënder Kuqi.²¹⁸⁰ Kuqi kishte plagë të shumta, anën e djathtë të kokës e kishte të nxirë, dhe rënkonte dhe qante nga dhimbjet.²¹⁸¹ Ai foli pak me Dëshmitarin 3, por kishte vështirësi të fliste.²¹⁸² Kuqi i kryente nevojat e tij personale në dhomë.²¹⁸³ Natën, të tre të burgosurve ua lidhnin duart.²¹⁸⁴ Natën e dytë erdhi një mjek për të vizituar Kuqin.²¹⁸⁵ Dëshmitari 3 pa që Nazmi Brahimaj dhe Miftar Brahimaj hynë një herë në dhomë.²¹⁸⁶ Ai pa gjithashtu Naser “Rusi” Brahimajn, një burrë të fortë, bjond, të cilin e njihte prej kohësh, që hynte vazhdimisht në dhomë

²¹⁶⁷ Qerim Kuqi, T. 10004-10005.

²¹⁶⁸ Dëshmitari 6, T. 5206, 5231-5232, 5252-5255, 5293, 5297-5298, 5331-5332, 5337, 5386, 5388-5389, 5391.

²¹⁶⁹ Dëshmitari 6, T. 5231, 5331-5333, 5340-5341.

²¹⁷⁰ Dëshmitari 6, T. 5231-5232, 5335, 5337-5338.

²¹⁷¹ Dëshmitari 6, T. 5204-5205, 5332-5333, 5335-5337; P332 (Fotografi e kompleksit në Jabllanicë).

²¹⁷² Dëshmitari 6, T. 5235, 5332-5333, 5337.

²¹⁷³ Dëshmitari 6, T. 5236-5238, 5338-5339, 5389-5390.

²¹⁷⁴ Dëshmitari 6, T. 5237, 5239-5240, 5338, 5390, 5395.

²¹⁷⁵ Dëshmitari 6, T. 5218-5219, 5231, 5233, 5239-5240, 5332, 5341, 5388-5391.

²¹⁷⁶ Dëshmitari 6, T. 5368.

²¹⁷⁷ Dëshmitari 3, T. 7891-7892, 7894, 7912, 7981-7982, 7985.

²¹⁷⁸ Dëshmitari 3, T. 7937-7938, 7942-7943, 7945, 7948, 8008-8010; D118 (Fotografi e një kasolleje në Jabllanicë që pretendohet se u përdor si burg (pamje me lëndinë)).

²¹⁷⁹ Dëshmitari 3, T. 7946.

²¹⁸⁰ Dëshmitari 3, T. 7946.

²¹⁸¹ Dëshmitari 3, T. 7946, 7950-7951, 8016-8017.

²¹⁸² Dëshmitari 3, T. 7956-7957.

²¹⁸³ Dëshmitari 3, T. 7951.

²¹⁸⁴ Dëshmitari 3, T. 7951, 8010.

²¹⁸⁵ Dëshmitari 3, T. 8016-8017.

dhe rrihte dy të burgosurit e tjerë.²¹⁸⁷ Dëshmitari vendosi të arratisëj dhe u tha dy të burgosurve të tjerë se po të donin mund të vinin me të.²¹⁸⁸ Rreth mesditës Dëshmitari 3 u arratis përmes dritares, dëgjoi të shtëna, dhe arriti të hynte në një pyll.²¹⁸⁹ Ai pa se Kuqi po përpiqej të vinte pas tij.²¹⁹⁰ Pas incidentit ai nuk e pa më kurrë Kuqin.²¹⁹¹ Të paktën 10 ditë më vonë, Dëshmitari 3 u kthye së bashku me Lahi Brahimajn në selinë e shtabit të UÇK-së në Jabllanicë.²¹⁹² Brahimaj e pyeti personin e paidentifikuar nëse Skënder Kuqi i kishte premtuar Dëshmitarit 3 10,000 marka gjermane për t'a ndihmuar të arratisëj.²¹⁹³ Burri u përgjegj se jo.²¹⁹⁴

429. Rrustem Tetaj dëshmoi se në korrik 1998, Imer Jusaj i tha se Skënder Kuqi ishte rrëmbyer nga UÇK-ja dhe se po mbahej në Jabllanicë, komuna e Gjakovës.²¹⁹⁵ Tetaj kontaktoi Faton Mehmetajn, i cili i tha se duhej të kontaktonte Ramush Haradinajn.²¹⁹⁶ Pastaj ai u takua me Haradinajn, i cili nuk kishte dijeni për rrëmbimin, dhe së bashku ata shkuan në shtabin lokal të UÇK-së në Jabllanicë ku takuan Nazmi Brahimajn.²¹⁹⁷ Haradinaj i tha Brahimajt se Skënder Kuqi duhej të lirohej menjëherë pasi kjo “po dëmton kauzën tonë”.²¹⁹⁸ Brahimaj i informoi të dy se Skender Kuqi ishte përpjekur të arratisëj dhe se, si pasojë, ushtarët e kishin lënduar pak, por shtoi se ai do të lirohej sapo të shërohej.²¹⁹⁹ Pas tri - katër ditësh dëshmitari shkoi përsëri në Jabllanicë, së bashku me një kushëri të Skënder Kuqit, dhe kësaj here Nazmi Brahimaj u tha se Skënder Kuqi ishte dërguar në një spital provizor në Irzniq, komuna e Deçanit.²²⁰⁰ Ai shtoi se për shkak të mungesave mjekësore ata nuk kishin mundur ta shpëtonin nga vdekja dhe e kishin varrosur pranë një pylli në Jabllanicë.²²⁰¹ Pastaj Tetaj ndihmoi që varri të rihapej, natën, në mënyrë që kufoma t'i dorëzohej familjes.²²⁰² Kufoma nuk ishte vendosur në arkivol.²²⁰³ Tetaj pa se në kufomë kishte mavijosje, por jo plagë të hapura.²²⁰⁴ Në një takim të mëvonshëm, Nazmi Brahimaj i dha dëshmitarit një unazë dhe një shumë të hollash të Skender Kuqit, që t'ja jepte gruas së Kuqit.²²⁰⁵ Makina e Skënder Kuqit nuk u kthye, pasi ishte dëmtuar.²²⁰⁶

²¹⁸⁶ Dëshmitari 3, T. 7949, 8017.

²¹⁸⁷ Dëshmitari 3, T. 7949-7950, 8018.

²¹⁸⁸ Dëshmitari 3, T. 7955, 7957.

²¹⁸⁹ Dëshmitari 3, T. 7957-7959, 8019-8020; P914 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 3 shënoi rrugën e arratisjes së tij dhe dhomën e Lahi Brahimajt).

²¹⁹⁰ Dëshmitari 3, T. 7957-7958; P914 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 3 shënoi rrugën e arratisjes së tij dhe dhomën e Lahi Brahimajt).

²¹⁹¹ Dëshmitari 3, T. 7962.

²¹⁹² Dëshmitari 3, T. 7962, 8015, 8026-8028.

²¹⁹³ Dëshmitari 3, T. 7962.

²¹⁹⁴ Dëshmitari 3, T. 7947-7948, 7962.

²¹⁹⁵ Rrustem Tetaj, T. 3680, 3852-3853.

²¹⁹⁶ Rrustem Tetaj, T. 3680.

²¹⁹⁷ Rrustem Tetaj, T. 3680-3681, 3686, 3778, 3852; P267 (Fotografi e Jabllanicës, me shënime të bëra nga Rrustem Tetaj).

²¹⁹⁸ Rrustem Tetaj, T. 3681-3682, 3778, 3852.

²¹⁹⁹ Rrustem Tetaj, T. 3682.

²²⁰⁰ Rrustem Tetaj, T. 3682-3683, 3779-3780.

²²⁰¹ Rrustem Tetaj, T. 3683, 3686-3688, 3779-3782, 3853; P267 (Fotografi e Jabllanicës, me shënime të bëra nga Rrustem Tetaj).

²²⁰² Rrustem Tetaj, T. 3684, 3853.

²²⁰³ Rrustem Tetaj, T. 3836-3837.

²²⁰⁴ Rrustem Tetaj, T. 3782, 3845-3846.

²²⁰⁵ Rrustem Tetaj, T. 3854.

²²⁰⁶ Rrustem Tetaj, T. 3854.

430. Dikur në qershor-gusht 1998, Haki Shehu, i cili punonte si mjek në një spital ushtarak në Irzniq, komuna e Deçanit, mjekoi Skënder Kuqin si pacient.²²⁰⁷ Persona të veshur me uniforma ushtarake, të cilët nuk folën me askënd, e lanë Kuqin tek dera e spitalit.²²⁰⁸ Haki Shehu vuri re se Skender Kuqi kishte mavijosje dhe se fytyrën e kishte pak të enjtur.²²⁰⁹ Skënder Kuqi vdiq nga bllokimi tërësor i veshkave.²²¹⁰

431. Harjit Sandhu, hetues i Prokurorisë,²²¹¹ dëshmoi se më 9 mars 2004 Genc Kuqi e çoi atë dhe një ekip të ZPZHK-së në një varr në varrezën e Dubovikit, komuna e Deçanit, të cilin Genc Kuqi e identifikoi si varrin e babait të tij, Skënder Kuqit.²²¹² Harjit Sandhu pa se ekipi i ZPZHK-së vuri shenjën “SSA 01” mbi varr, fotografoi vendin përfaqë, dhe zhvarrosi eshtrat.²²¹³ Ata i vendosën eshtrat në një thes kufomash me numrin “SSA 01 01” dhe e morën me vete kur u larguan.²²¹⁴ Më pas Prokuroria mori dy raporte autopsie prej ZPZHK-së të shënuara me numrin e çështjes “SSA/001B” të datuar 12 prill 2004 dhe dhjetor 2004, si dhe fotografi të ndryshme të varrezës, varrit, dhe zhvarrimit.²²¹⁵ Raportet e autopsive të ZPZHK-së konkludonin se eshtrat ishin të një mashkulli të rritur të moshes nga 40 në 60 vjeç, rreth 176 centimetra i gjatë, i cili kishte pësuar thyerje të shumta para apo pas vdekjes, dhe se shkak i vdekjes nuk mund të përcaktohej.²²¹⁶

432. Cufë Krasniqi, komandant në UÇK,²²¹⁷ dëshmoi se një ditë ai bisedoi me vëllain e Skënder Kuqit, Adem Kuqin.²²¹⁸ Adem Kuqi i tha dëshmitarit se po kërkonte të vëllanë, të cilin e kishte kapur UÇK-ja, për të cilin ai besonte se gjendej në këtë zonë.²²¹⁹ Cufë Krasniqi i tha Adem Kuqit se nuk kishte informacion për vëllain e tij, porse do të caktonte dy ushtarë të tij që t'a ndihmonin për t'a gjetur.²²²⁰ Pas dy javësh, dikush në Qallapek, komuna e Pejës, i tha Cufë Krasniqit se Adem Kuqi e kishte gjetur vëllain e tij, Skënderin, por të vdekur.²²²¹

433. Siç u përmend më sipër, Qerim Kuqi dëshmoi se e pa për herë të fundit Skënder Kuqin në korrik 1998, kur persona të armatosur e morën nga shtitorja e tij në Zahaq dhe u larguan me të në makinën e tij Mercedes. Dëshmitari 6 dëshmoi se diku rreth mesit të korrikut 1998, ai pa se si nxorrën një burrë nga vendbagazhi i një makine Mercedes në oborrin e Jabllanicës, dhe se si ushtarë të UÇK-së e rrahën menjëherë. Sipas Dëshmitarit 6, Pal Krasniqi i tha atij se ky burrë ishte nga

²²⁰⁷ D59 (Deklaratë nën betim dhe e nënshkruar nga Haki Shehu dhënë policisë së UNMIK-ut, datë 14 tetor 2002).

²²⁰⁸ D59 (Deklaratë nën betim dhe e nënshkruar nga Haki Shehu dhënë policisë së UNMIK-ut, datë 14 tetor 2002).

²²⁰⁹ D59 (Deklaratë nën betim dhe e nënshkruar nga Haki Shehu dhënë policisë së UNMIK-ut, datë 14 tetor 2002).

²²¹⁰ D59 (Deklaratë nën betim dhe e nënshkruar nga Haki Shehu dhënë policisë së UNMIK-ut, datë 14 tetor 2002).

²²¹¹ P1220 (Harjit Sandhu, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafët 2-4; Harjit Sandhu, T. 10357.

²²¹² P1220 (Harjit Sandhu, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafët 5-9, 11-12; Harjit Sandhu, T. 10360-10361; 10364.

²²¹³ P1220 (Harjit Sandhu, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafët 11, 13, 17; Harjit Sandhu, T. 10362-10363, 10369; P1219 (Regjistër i Fotografisë dhe Fotove së ZPZHK-së për SSA 01).

²²¹⁴ P1220 (Harjit Sandhu, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paras 13-14; Harjit Sandhu, T. 10363, 10369.

²²¹⁵ P1220 (Harjit Sandhu, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafët 15, 17; Harjit Sandhu, T. 10363; P1218 (Raporte të autopsisë për eshtrat me numër SSA01-001B); P1219 (Regjistër i Fotografisë dhe Fotove së ZPZHML-së për SSA 01).

²²¹⁶ Harjit Sandhu, T. 10371-10373; P1218 (Raporte të autopsisë për mbetjen skeletore me numër SSA01-001B).

²²¹⁷ P351 (Cufë Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 14 qershor 2007), f. 1, paragrafët 1-2.

²²¹⁸ Cufë Krasniqi, T. 5722.

²²¹⁹ Cufë Krasniqi, T. 5722-5723.

²²²⁰ Cufë Krasniqi, T. 5723-5724.

²²²¹ Cufë Krasniqi, T. 5724, 5726.

Zahaqi. Më pas Dëshmitari 6 dëshmoi se e pa më vonë këtë burrë në një dhomë aty në gjendje të keqe fizike, teksa dergjej në dysHEME, me trup të enjtur dhe me sytë e mbyllura. Dëshmitari 3 dëshmoi se në periudhën nga fillimi deri në mes të korrikut 1998, atë e sollën në oborrin me ndërtesa në Jabllanicë ku kaloi disa ditë në një dhomë me mësuesin e tij të mëparshëm, Skënder Kuqin dhe një burrë tjetër. Dëshmitari 3 dëshmoi se Skënder Kuqi kishte lëndime të shumta, rënkonte dhe qante nga dhimbjet, mezi fliste, dhe kryente nevojat personale në dhomë. Më tej Dëshmitari 3 dëshmoi se pa një ushtar të UÇK-së që hyri disa herë në dhomë dhe e rrahu Skënder Kuqin, dhe se më pas erdhi një mjek për t'a vizituar. Dëshmitari 6 deklaroi se e pa këtë burrë që u përpoq të arratisej, që e kapën, dhe pastaj e rrahën ushtarët e UÇK-së. Dëshmitari 6 dha dëshmi të dorës së dytë se burri nga Zahaqi u dërgua për mjekim në Gllogjan, ku vdiq. Rustem Tetaj dha dëshmi të dorës së dytë se Skënder Kuqi u dërgua nga objekti i Jabllanicës në një spital në Irzniq, ku vdiq. Dhoma Gjyqësore është e bindur se dëshmia e Dëshmitarit 6 i referohet Skënder Kuqit. Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se ushtarë të UÇK-së i shkaktuan Skënder Kuqit vuajtje dhe lëndime të rënda fizike. Duke marrë parasysh egërsinë e rrahjeve, të cilat vazhduan pavarësisht gjendjes së keqe fizike të Skënder Kuqit, Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se autorët duhet të kenë patur qëllim shkaktimin e vuajtjeve dhe lëndimeve të tilla. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimi se ushtarë të UÇK-së kryen trajtim mizor ndaj Skënder Kuqit.

434. Sipas Dëshmitarit 17, emri i Skënder Kuqit ishte në një listë që iu dha atij gjatë një takimi më 12 korrik 1998 në shtëpinë e Din Krasniqit në Vranoc. Dhoma Gjyqësore e diskuton rëndësinë e kësaj liste në pjesën 7, më poshtë. Dhoma Gjyqësore nuk mund të nxjerrë nga kjo dëshmi ndonjë përfundim përse i përket qëllimit të rrahjeve, dhe konkludon se pretendimi për torturimin e Skënder Kuqit nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

435. Dëshmia e mësipërme e dorës së dytë, sipas së cilës Skënder Kuqi u dërgua në një spital në Irzniq dhe se vdiq atje përputhet me deklaratën e Dr Haki Shehut dhënë policisë së UNMIK-ut. Deklarata sugjeron se Skënder Kuqi u flak në hyrje të spitalit nga persona ushtarakë, të cilët nuk biseduan me askënd në spital. Mjeku konstatoi mavijosje në trupin e Skënder Kuqit dhe deklaroi se ai vdiq për shkak të bllokimit tërësor të veshkave. Dhoma Gjyqësore nuk disponon prova që tregojnë se Skënder Kuqi ka vuajtur më parë nga veshkat. Rustem Tetaj dëshmoi se ai ka qënë i pranishëm në zhvarrimin e kufomës së Skënder Kuqit dhe se ai gjithashtu ka vënë re mavijosje mbi trup. Harjit Sandhu dëshmoi se në 2004 Genc Kuqi i tregoi varrin e babait të tij, Skënder Kuqi. Raportet e autopsive të ZPZHK-së konkluduan se kufoma kishte pësuar thyerje të shumta. Mbi bazën e këtyre provave Dhoma Gjyqësore është e bindur se vdekja e Skënder Kuqit u shkaktua prej kushteve të mbajtjes së Skënder Kuqit prej UÇK-së, ndër të cilat rrahjet e egra dhe mungesa e kujdesit mjekësor në kohë ndërkohë që dukej se ishte në gjendje të keqe. Së fundi, Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto veprime apo mosveprime u kryen me qëllim që të shkaktonin

lëndime të rënda trupore për të cilat kryesi normalisht duhej të dinte se mund të shkaktonin vdekjen. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkludon se Skënder Kuqi u vra kur gjatë mbajtjes në arrest nga UÇK-ja.

436. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto krime kishin lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se Skënder Kuqi nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën kur u kryen krimet, dhe se autorët e tyre dinin ose duhej ta dinin një gjë të tillë.

437. Të tre të Akuzuarit akuzohen në Pikën 32 si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do t'a trajtojë këtë formë përgjegjësie në pjesën 7, më poshtë. Ndryshe Ramush Haradinaj akuzohet se ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e vrasjes, trajtimin mizor, dhe torturimin e Skënder Kuqit. Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi se Ramush Haradinaj nuk kishte dijeni se Skënder Kuqi ndodhej në objektin e Jabllanicës deri në momentin kur u informua për këtë nga Rrustem Tetaj. Pas kësaj ai kërkoi lirin e Skënder Kuqit. Mbi bazën e dëshmimeve, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundimin se Ramush Haradinaj ndihmoi dhe inkurajoi krimet e lartpërmendura, dhe gjykon se ai duhet të shpallet i pafajshëm për akuzën se ka ndihmuar dhe inkurajuar trajtimin mizor, torturimin, dhe vrasjen e Skënder Kuqit.

6.17.3 Trajtimi mizor dhe torturimi i Dëshmitarit 3 dhe dy burrave të tjerë

438. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor dhe torturimin e Dëshmitarit 3 dhe dy burrave të tjerë si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Përndryshe, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj akuzohen se kanë kryer, apo planifikuar, nxitur, ose ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve kundër Dëshmitarit 3. Ramush Haradinaj akuzohet ndryshe se ka ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve kundër Dëshmitarit 3. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga një numër dëshmitarësh.

439. Dëshmitari 3 dëshmoi se më 21 maj 1998 ai dhe katër - pesë persona të tjerë u tërhoqën nga Grabanica, komuna e Klinës, pasi nuk arritën t'a mbronin fshatin nga forcat serbe.²²²² Diku midis Bokshiqit dhe Glllogjanit, të dy në komunën e Pejës, ata hasën Lahi Brahimajn dhe Alush Agushin, me pseudonim “Mal” ose “Pip”, ky i fundit nga Drenoci, komuna e Klinës.²²²³ Dëshmitari 3 e kishte takuar Lahi Brahimajn disa herë më parë dhe e njohte mirë.²²²⁴ Brahimaj dhe Agushi e akuzuan grupin me zemërim se ishin tradhëtarë sepse kishin lëshuar pozicionet.²²²⁵ Dëshmitari 3 vazhdoi rrugën për në Glllogjan, ku fshatarët i thanë se ishin urdhëruar nga Lahi Brahimaj që të mos u jepnin

²²²² Dëshmitari 3, T. 7916, 7922, 7993.

²²²³ Dëshmitari 3, T. 7922-7924, 7991-7992.

²²²⁴ Dëshmitari 3, T. 7895, 7924, 7976-7977.

²²²⁵ Dëshmitari 3, T. 7923-7924, 7989, 7991.

ndihmë atyre që tërhiqeshin nga Grabanica.²²²⁶ Pastaj Dëshmitari 3 shkoi në Jabllanicë, komuna e Gjakovës.²²²⁷ Afërsisht një javë më pas, Dëshmitari 3 u largua nga Jabllanica sepse fshatarët, në shtëpinë e të cilëve ishte strehuar, i thanë se shtabi lokal i UÇK-së po i kërkonte ata që kishin braktisur Grabanicën për t'i kthyer atje, dhe se kush i kishte strehuar, duhej t'ua dorëzonte shtabit.²²²⁸

440. Rreth fillimit apo mesit të korrikut 1998, Dëshmitari 3 ishte në shtëpinë e Tal Zekës nga Zhabeli, komuna e Gjakovës, kur erdhi Lahi Brahimaj për t'a kërkuar.²²²⁹ Brahimaj i tha Dëshmitarit 3 se duhej të shkonte me të dhe u largua së bashku me dëshmitarin në një makinë Mercedes.²²³⁰ Mbi makinë ishin shkruar gërmat “UÇK” si dhe ishte pikturuar një shqiponjë; fshatarët e Jabllanicës i thanë Dëshmitarit 3 se makina ishte e Skënder Kuqit.²²³¹ Brahimaj e çoi Dëshmitarin 3 në një dhomë në ndërtesën e shtabit të UÇK-së në Jabllanicë, dhe pastaj u largua.²²³² Disa minuta më vonë në dhomë hynë disa persona, të cilët e rrahën Dëshmitarin 3 me shkopinj deri sa humbi vetëdijen.²²³³ Dëshmitari 3 arriti të shikonte vetëm njërin prej tyre, i cili ishte i veshur me uniformë.²²³⁴ Dëshmitari 3 qëndroi në këtë dhomë edhe dy netët dhe tri ditët e ardhshme.²²³⁵ Në dhomë mbaheshin edhe dy persona të tjerë.²²³⁶ Natën të tre të burgosurve ua lidhnin duart.²²³⁷

441. Dëshmitari 3 pa njëherë Nazmi Brahimajn dhe Miftar Brahimajn kur erdhën në dhomën ku e mbanin.²²³⁸ Ai pa gjithashtu Naser “Rusi” Brahimajn, të cilin e njohte prej kohësh, kur hynte vazhdimisht në dhomë dhe rrihte dy të burgosurit e tjerë.²²³⁹ Pas një farë kohe, Lahi Brahimaj e çoi Dëshmitarin 3 në dhomën ngjitur, e cila ishte dhoma e Brahimajt.²²⁴⁰ Përveç Brahimajt, në dhomë ishte edhe një burrë tjetër si dhe dy gra, të katër të veshur me uniforma të zeza.²²⁴¹ Të dy burrat kishin gërmat “PU” (policia ushtarake) në mëngë.²²⁴² Brahimaj e mori në pyetje Dëshmitarin 3 dhe e akuzoi se mbështeste policinë serbe dhe se nuk kishte dorëzuar një armë automatike.²²⁴³ Brahimaj u tha grave “të praktikoheshin” me Dëshmitarin 3, dhe ato e goditën në duar me një teleskop për 5 deri në 10 minuta.²²⁴⁴ Brahimaj i dha pistoletën e vet Dëshmitarit 3 dhe i tha të vriste veten.²²⁴⁵ Dëshmitari 3 mori revolverin dhe qeshi, dhe pas kësaj një nga gratë ia mori armën dhe ia ktheu

²²²⁶ Dëshmitari 3, T. 7924-7925, 7928, 7989, 7992-7993.

²²²⁷ Dëshmitari 3, T. 7928, 7993, 8006.

²²²⁸ Dëshmitari 3, T. 7929-7930, 7933-7937, 7993, 8006.

²²²⁹ Dëshmitari 3, T. 7937-7938, 7942-7943, 8008.

²²³⁰ Dëshmitari 3, T. 7943-7944.

²²³¹ Dëshmitari 3, T. 7944, 8029.

²²³² Dëshmitari 3, T. 7943, 7945; D118 (Fotografi e një kasoljeje në Jabllanicë që pretendohet se u përdor si burg (pamje me lëndinën)).

²²³³ Dëshmitari 3, T. 7943, 7945-7946, 7948, 8009.

²²³⁴ Dëshmitari 3, T. 7946.

²²³⁵ Dëshmitari 3, T. 7945, 7948, 8009-8010.

²²³⁶ Dëshmitari 3, T. 7946.

²²³⁷ Dëshmitari 3, T. 7951, 8010.

²²³⁸ Dëshmitari 3, T. 7949, 8017.

²²³⁹ Dëshmitari 3, T. 7949-7950, 8018.

²²⁴⁰ Dëshmitari 3, T. 7951, 7958; P914 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 3 shënoi rrugën e arratisjes së tij dhe dhomën e Lahi Brahimajt).

²²⁴¹ Dëshmitari 3, T. 7952.

²²⁴² Dëshmitari 3, T. 8020.

²²⁴³ Dëshmitari 3, T. 7952-7953.

²²⁴⁴ Dëshmitari 3, T. 7953-7954.

²²⁴⁵ Dëshmitari 3, T. 7954.

Brahimajt.²²⁴⁶ Burri tjetër që ishte në dhomë e akuzoi Dëshmitarin 3 se bashkëpunonte me serbët dhe e kërcënoi se do t'i priste fytyrë.²²⁴⁷ Dikush e ktheu Dëshmitarin 3 në dhomën e tij.²²⁴⁸ Dëshmitari vendosi të arratisë dhe u tha të dy të burgosurve të tjerë se po të donin mund të vinin me të.²²⁴⁹ Rreth mesditës, Dëshmitari 3 u arratis nëpërmjet dritares, dëgjoi të shtëna, dhe arriti të hynte në një pyll.²²⁵⁰

442. Dëshmitari 3 u end fshat më fshat, por njerëzit kishin frikë t'a ndihmonin pasi kishin dëgjuar se ishte person në kërkim.²²⁵¹ Ai u kthye në Jabllanicë, ku qëndroi afërsisht 10-12 ditë.²²⁵² Ai mendoi se ishte pa rrezik të kthehej në Jabllanicë, sepse një Kallashnikov, të cilën e kishte marrë nga një bashkëluftëtar i plagosur rëndë në betejën e Grabanicës, ia ishte kthyer pronarit të vet të ligjshëm, kështu që besoi se nuk ishte i rrezikuar më.²²⁵³ Ai mendonte se mosdorëzimi i atëhershëm i kësaj arme mund të kishte qenë shkak i keqtrajtimit të tij të mëparshëm.²²⁵⁴ Ai hasi Lahi Brahimajn, i cili nën kërcënimin e armës e çoi në shtëpinë e tij, ku me ta u bashkua dhe një grua, dhe pastaj shkuan tek një makinë Mercedes.²²⁵⁵ Si Lahi Brahimaj po ashtu dhe gruaja e qëlluan Dëshmitarin 3 me pëllëmbë në fytyrë disa herë.²²⁵⁶ Ata shkuan me makinë në selinë e shtabit të UÇK-së, dhe ai pa atje përsëri burrin të cilin nuk e njohte dhe i cili ishte mbajtur në të njëjtën dhomë me dëshmitarin.²²⁵⁷ Brahimaj e pyeti këtë burrë nëse Skënder Kuqi i kishte premtuar Dëshmitarit 3, 10,000 marka gjermane për t'a ndihmuar të arratisë.²²⁵⁸ Burri u përgjegj që jo.²²⁵⁹ Brahimaj, Dëshmitari 3, dhe gruaja u kthyen tek makina, dhe u nisën, Brahimaj në vendin e shoferit, Dëshmitari 3 i ulur pranë tij dhe gruaja me armën e ngjeshur pas kokës së dëshmitarit.²²⁶⁰ Në një moment, Brahimaj ndaloi makinën dhe e detyroi Dëshmitarin 3 të futej në bagazh.²²⁶¹ Më pas, ai ndaloi makinën përsëri, hapi bagazhin, nxori armën dhe e pyeti Dëshmitarin 3 a t'a shkrepse armën apo jo. Dëshmitari 3 u përgjigj po, Lahiu hapi zjarr, dhe Dëshmitari 3 pa se nga arma doli flakë, dëgjoi kërcitjen e armës, dhe ndjeu dhimbje, por pastaj e kuptoi se nuk ishte qëlluar.²²⁶² Brahimaj e mbylli kapakun e bagazhit dhe u nis përsëri.²²⁶³ Rreth orës 16 apo 17, ata arritën në Gllogjan, komuna e Deçanit.²²⁶⁴ Brahimaj e çoi Dëshmitarin 3 në një shtëpi dhe u largua.²²⁶⁵ Një burrë i ofroi Dëshmitarit 3 ushqim, e pyeti nëse kishte të afërm në Gllogjan tek të cilët mund të kalonte natën,

²²⁴⁶ Dëshmitari 3, T. 7954-7955.

²²⁴⁷ Dëshmitari 3, T. 7955-7956.

²²⁴⁸ Dëshmitari 3, T. 7955.

²²⁴⁹ Dëshmitari 3, T. 7955, 7957.

²²⁵⁰ Dëshmitari 3, T. 7957-7959, 8019-8020; P914 (Fotografi në të cilën Dëshmitari 3 shënoi rrugën e arratisjes së tij dhe dhomën e Lahi Brahimajt).

²²⁵¹ Dëshmitari 3, T. 7957, 7959-7960, 8010-8011, 8016.

²²⁵² Dëshmitari 3, T. 7960, 7968, 8012, 8015-8016, 8026.

²²⁵³ Dëshmitari 3, T. 8003-8005, 8012.

²²⁵⁴ Dëshmitari 3, T. 8012.

²²⁵⁵ Dëshmitari 3, T. 7944-7945, 7961-7962, 8027.

²²⁵⁶ Dëshmitari 3, T. 7962.

²²⁵⁷ Dëshmitari 3, T. 7962, 8026-8028.

²²⁵⁸ Dëshmitari 3, T. 7962.

²²⁵⁹ Dëshmitari 3, T. 7947-7948, 7962.

²²⁶⁰ Dëshmitari 3, T. 7962.

²²⁶¹ Dëshmitari 3, T. 7962-7963.

²²⁶² Dëshmitari 3, T. 7963, 8029.

²²⁶³ Dëshmitari 3, T. 7963.

²²⁶⁴ Dëshmitari 3, T. 7963-7964.

dhe pastaj i ofroi vend për të fjetur në shtëpinë e tij.²²⁶⁶ Rreth orës 23 burri i tha se ishte i lirë të largohej, dhe pas kësaj Miftar dhe Naser Brahimaj erdhën dhe e kthyen Dëshmitarin 3 përsëri në Jabllanicë.²²⁶⁷ Dëshmitari 3 dëgjoi se një ushtar iu drejtua burrit në shtëpinë në Gllogjan si komandant.²²⁶⁸

443. Dëshmitari 6 dëshmoi se një ditë rreth mesit të korrikut 1998, një ditë pasi në Jabllanicë kishin sjellë një burrë nga Zahaqi, dhe vetëm dy- tri orë pasi kishin sjellë Pal Krasniqin (pjesa 6.17.1, më sipër), aty sollën edhe një person të tretë, një burrë nga Grabanica, komuna e Klinës.²²⁶⁹ Dëshmitari 6 çoi ushqim dhe ujë në dhomën e tij.²²⁷⁰ Dëshmitari 6 dëshmoi se burrin nga Grabanica nuk e kishin rrahur.²²⁷¹ Po atë ditë, rreth orës 13 pasdite, burri nga Grabanica arriti të arratisëj përmes dritares në dhomën e tij, ndërsa burrin nga Zahaqi dhe Pal Krasniqin i kapën ndërsa po përpiqeshin të bënin të njëjtën gjë.²²⁷²

444. Pekka Haverinen, polic finlandez, i cili punoi si hetues i TPNJ-së nga qershori 2002 deri në mars 2005,²²⁷³ dëshmoi se i paraqiti Dëshmitarit 3 shtatë tabela me fotografi gjatë një interviste në maj 2004.²²⁷⁴ Dëshmitari 3 njohu Lahi Brahimajn dhe Ramush Haradinajn në tabelat e fotografive.²²⁷⁵ Dëshmitari 3 shënoi numrat që tregonin fotografitë e Haradinajt dhe Brahimajt dhe nënshkroi tabelat e fotografive.²²⁷⁶

445. Siç u përmend më sipër, Dëshmitari 3 dëshmoi se se diku nga fillimi deri në mes të korrikut 1998, Lahi Brahimaj e futi në një dhomë në objektin e Jabllanicës dhe pastaj u largua. Më tej Dëshmitari 3 dëshmoi se pak minuta më vonë, në dhomë hynë disa persona, ndër të cilët të paktën njëri ishte veshur me uniformë, dhe e rrahën Dëshmitarin 3 me shkop bejzbolli deri sa ai humbi vetëdijen. Bazuar në dëshmitë e cituara në Pikat 27-32 dhe në aftësinë e personave për të hyrë në atë dhomë në objektin e Jabllanicës në atë kohë, Dhoma Gjyqësore është e bindur se ata ishin ushtarë të UÇK-së ose persona të lidhur me UÇK-në. Dëshmitari 6, i cili ishte po në atë objekt në atë kohë, dëshmoi se sollën një burrë nga Grabanica dhe se ai ishte personi i vetëm nga të tre që arriti të arratisëj. Kjo dëshmi përputhet me rrëfimin e Dëshmitarit 3 se çfarë i kishte ngjarë atij. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore është e bindur se dëshmia e Dëshmitarit 6 i referohet Dëshmitarit 3. Mirëpo Dëshmitari 6 dëshmoi gjithashtu se Dëshmitarin 3 nuk e kishin rrahur, gjë që duket se bie në kundërshtim me dëshminë e Dëshmitarit 3. Dhoma Gjyqësore i konsideron të besueshëm si

²²⁶⁵ Dëshmitari 3, T. 7964.

²²⁶⁶ Dëshmitari 3, T. 7964-7965.

²²⁶⁷ Dëshmitari 3, T. 7964, 7966-7967.

²²⁶⁸ Dëshmitari 3, T. 7966-7967.

²²⁶⁹ Dëshmitari 6, T. 5206, 5233, 5247-5249, 5252-5255, 5293, 5297-5298, 5331-5332, 5334-5335, 5386, 5388-5389, 5391.

²²⁷⁰ Dëshmitari 6, T. 5204-5205, 5332-5333, 5335-5337; P332 (Fotografi e objektit në Jabllanicë).

²²⁷¹ Dëshmitari 6, T. 5235, 5237, 5336.

²²⁷² Dëshmitari 6, T. 5236-5238, 5338-5339, 5389-5390.

²²⁷³ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 1; Pekka Haverinen, T. 6299-6300.

²²⁷⁴ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafi 28, 31.

²²⁷⁵ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 34, 38, Shtojca 16; Pekka Haverinen, T. 6301.

Dëshmitarin 3 po ashtu dhe Dëshmitarin 6. Duket se Dëshmitari 6 ka patur shumë pak kontakt të drejtpërdrejtë, thuajse aspak, me Dëshmitarin 3. Dëshmia nuk thotë se Dëshmitari 6 pa kur e rrahën Dëshmitarin 3 për herë të parë, apo se Dëshmitari 6 hynte në dhomë sa herë sillte ushqim dhe ujë. Për më tepër, nuk është e qartë që Dëshmitari 6 e pa Dëshmitarin 3 duke u arratisur nga dhoma e tij. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore mendon se Dëshmitari 6 nuk ishte në gjendje të vërtetonte nëse Dëshmitarin 3 e rrahën, dhe e interpreton dëshminë e tij në kuptimin se ai nuk kishte dijeni që Dëshmitarin 3 e kishin rrahur. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore mbështetet në dëshminë e Dëshmitarit 3 për këtë çështje.

446. Dëshmitari 3 dëshmoi se i kaloi dy netët dhe tre ditët e mëpasme në të njëjtën dhomë. Më tej ai dëshmoi se një herë Lahi Brahimaj e çoi në një dhomë tjetër ku ishin dy gra dhe një burrë, të gjithë të veshur me uniforma të zeza. Sipas Dëshmitarit 3, Lahi Brahimaj e mori në pyetje dhe e akuzoi se përkrahte policinë serbe dhe se nuk kishte dorëzuar një armë automatike. Gjithashtu Dëshmitari 3 dëshmoi se Lahi Brahimaj u tha grave “të praktikoheshin” me Dëshmitarin 3, dhe pas kësaj ato e goditën Dëshmitarin 3 në duar me disa mjete për 5 deri në 10 minuta. Së fundi, Dëshmitari 3 dëshmoi se burri tjetër që ishte në dhomë e akuzoi se bashkëpunonte me serbët dhe e kërcënoi se do t'i priste fytyrën.

447. Mbi bazën e kësaj dëshmie, Dhoma Gjyqësore është e bindur se rrahjet i shkaktuan Dëshmitarit 3 vuajtje të rënda fizike dhe se keqbërësit kishin për qëllim të shkaktonin vuajtje të tilla. Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se rrahjet e Dëshmitarit 3 kishin për qëllim t'a ndëshkonin se nuk kishte dorëzuar armën, si dhe t'a diskriminonin mbi bazën e mendimit se ai kishte lidhje me serbet. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtarë të UÇK-së apo persona të lidhur me UÇK-në kryen trajtim mizor ndaj Dëshmitarit 3 dhe e torturuan.

448. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore është e bindur se këto krime ishin të lidhura ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë, se Dëshmitari 3 nuk merrte pjesë aktive në luftime në kohën kur u kryen këto krime, dhe se kryesit ishin ose duhej të ishin të vetëdijshëm për një gjë të tillë.

449. Dëshmitari 3 dëshmoi se të paktën 10 ditë pasi u arratis nga objekti në Jabllanicë, Lahi Brahimaj e gjeti atë dhe, së bashku me një grua, nën kërcënimin e armës, e solli përsëri në objekt dhe, më pas, në Gllogjan. Sipas Dëshmitarit 3, pasi ishin nisur nga Jabllanica, Lahi Brahimaj e futi në bagazhin e makinës, vazhdoi rrugën, ndaloi makinën, e nxorri atë nga bagazhi, dhe hapi zjarr me armën e tij, duke i krijuar Dëshmitarit 3 përshtypjen se po e ekzekutonte. Dhoma Gjyqësore është e bindur se Dëshmitari 3 e njihte Lahi Brahimajn, pasi kishte patur njohje me të që më parë. Mbi bazën e kësaj dëshmie, Dhoma Gjyqësore është gjithashtu e bindur se Lahi Brahimaj i shkaktoi

²²⁷⁶ P375 (Pekka Haverinen, deklaratë dëshmitari, 26 qershor 2007), paragrafët 34, 38, Shtojca 21; Pekka Haverinen, T. 6301.

vuajtje të rënda mendore Dëshmitarit 3, dhe se këtë e bëri qëllimisht. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore konkludon se akuza për trajtim mizor është provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Mbi bazën e dëshmive Dhoma Gjyqësore nuk është në gjendje të identifikojë qëllimin përkatës për të vërtetuar se ky trajtim mizor është në fakt torturë. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore konkludon se akuza për torturim nuk është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

450. Të tre të Akuzuarit akuzohen në Pikën 32 si pjesëmarrës në një ndëmmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do t'a trajtojë këtë formë përgjegjësie në pjesën 7, më poshtë. Të tre të Akuzuarit akuzohen gjithashtu, si alternativë, me forma të tjera përgjegjësie për krime kundër Dëshmitarit 3. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi për implikimin e pretenduar të Idriz Balajt në krimet e kryera kundër Dëshmitarit 3. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ai duhet të shpallet i pafajshëm për këtë akuzë. Ramush Haradinaj akuzohet, si alternativë, se ka ndihmuar dhe inkurajuar krimet e pretenduara në këtë Pikë kundër Dëshmitarit 3. Edhe po të supozohet se komandanti në Gllogjan, për të cilin dëshmoi Dëshmitari 3, ishte Ramush Haradinaj, Dëshmitari 3 dëshmoi se Ramush Haradinaj e trajtoi mirë dhe e lejoi të largohej pas disa orësh. Mbi bazën e dëshmive, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundimin se Ramush Haradinaj ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të lartpërmendura, dhe konkludon se ai duhet të shpallet I pafajshëm për akuzën se ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e trajtimit mizor dhe torturimin e Dëshmitarit 3.

451. Ndryshe Lahi Brahimaj akuzohet se ka kryer, planifikuar, nxitur, apo ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve kundër Dëshmitarit 3 të akuzuara në Pikën 32. Sipas dëshmisë për rrahjet dhe marrjen në pyetje, siç përmendet më sipër, Lahi Brahimaj e futi Dëshmitarin 3 në një dhomë në objektin e Jabllanicës. Menjëherë pas kësaj në dhomë hynë ushtarë të UÇK-së apo persona të lidhur me UÇK-në, të pajisur me shkopa bejsbolli, të cilët rrahën Dëshmitarin 3. Dëshmia përcakton gjithashtu se Dëshmitari 3 u mbajt në atë dhomë deri kur Lahi Brahimaj e çoi në një dhomë tjetër dhe e mori në pyetje Dëshmitarin 3 ndërkohë që persona të tjerë e rrihnin. Dhoma Gjyqësore gjykon se roli i Lahi Brahimajt gjatë marrjes në pyetje të Dëshmitarit 3 pas mbërritjes së këtij të fundit në objektin e Jabllanicës vërteton synimin për t'i shkaktuar vuajtje të rënda fizike me qëllim që ta ndëshkonte për mosdorëzimin e një arme dhe ta diskriminonte sepse mendohej se kishte lidhje me serbët. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Lahi Brahimaj kreu trajtimin e lartpërmendur mizor dhe torturimin të Pikës 32. Si pasojë Dhoma Gjyqësore nuk ka nevojë të shqyrtojë nëse Lahi Brahimaj planifikoi, nxiti, apo ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e këtyre krimeve. Gjithashtu pasi ka konstatuar se Lahi Brahimaj, personalisht, e futi Dëshmitarin 3 në bagazhin e një makinë dhe simuloi ekzekutimin e tij, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se Lahi Brahimaj duhet të shpallet fajtor për kryerjen e këtij trajtimi

mizor të Dëshmitarit 3. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë nëse Lahi Brahimaj planifikoi, nxiti, apo ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e këtij krimi.

452. Në paragrafi 104 të Aktakuzës deklarohet se ushtarë të UÇK-së rrahën “dy të burgosur të panjohur”. Duke patur parasysh dëshminë e cituar në bazë të Pikës 32, kjo mund të jetë një referencë jo e qartë përsa i përket Pal Krasniqit dhe Skënder Kuqit, rastet e të cilëve janë shqyrtuar përkatësisht në pjesët 6.17.1 dhe 6.17.2. Në rast se “dy të burgosurit e panjohur” janë persona të tjerë dhe jo Pal Krasniqi dhe Skënder Kuqi, Dhoma Gjyqësore konkludon se nuk janë paraqitur dëshmi në mbështetje të pretendimit se ata kanë qenë të pranishëm ose se janë rrahur, dhe, si pasojë, të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për të gjitha akuzat në lidhje me këta dy të burgosur të pretenduar.

6.18 Trajtimi mizor dhe torturimi i Naser Likës dhe të tjerëve (Pika 34)

453. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, për trajtimin mizor dhe torturimin e Naser Likës dhe të tjerëve në rastet e ndodhura në maj dhe korrik 1998, si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Ndryshe, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj akuzohen se kanë kryer, planifikuar, apo ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Ramush Haradinaj akuzohet se ka urdhëruar, nxitur, apo ndihmuar dhe inkurajuar kryerjen e krimeve. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi përkatëse nga Fadil Fazliu, Dëshmitari 3, dhe Dëshmitari 6. Siç shpjegohet në pjesën 2.2, më sipër, Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi nga Naser Lika.

454. Fadil Fazliu nga Grabanica, komuna e Klinës,²²⁷⁷ dëshmoi se ai u largua nga fshati së bashku me një bashkëfshatar të tij, Naser Likën, mbrëmjen e 20 majit 1998 në përfundim të një sulmi serb që kishte filluar mbrëmjen e shkuar.²²⁷⁸ Fadil Fazliu dhe Naser Lika mbërritën në shtëpinë e Tal Zekës në Zhabel, komuna e Gjakovës, rreth orës 10 apo 11 të mbrëmjes.²²⁷⁹ Mbrëmjen e 22 majit 1998, një grup prej 7-8 ushtarësh të UÇK-së erdhën në shtëpinë e Tal Zekës.²²⁸⁰ Sipas Fadil Fazliut, këta burra, ndër të cilët Nazmi Brahimaj dhe një person të cilit i drejtoheshin me emrin Tahir (komandant i Zhabelit) erdhën fillimisht të flisnin me ata që ishin në shtëpi dhe të shikonin nëse ata ishin të gatshëm për t'u kthyer në Grabanicë që të luftonin kundër serbëve.²²⁸¹ Me ta ishte edhe një burrë që thirrej Ujku dhe ai ishte i vetmi ndër ushtarët e UÇK-së që iu drejtua Fadil Fazliut dhe Naser Likës me fjalë fyese.²²⁸² Të nesërmen, më 23 maj 1998, Ujku u kthye së bashku me Arbnor Zenelin, dhe sërish filloi të fyente të pranishmit.²²⁸³ Tahiri dhe Arbnor

²²⁷⁷ Fadil Fazliu, T. 7397; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 1.

²²⁷⁸ Fadil Fazliu, T. 7413-7415, 7460-7461; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 3-4.

²²⁷⁹ Fadil Fazliu, T. 7417-7418, 7423; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 4.

²²⁸⁰ Fadil Fazliu, T. 7423; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 4.

²²⁸¹ Fadil Fazliu, T. 7423-7425, 7427-7430; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 4-5.

²²⁸² Fadil Fazliu, T. 7429, 7464-7465; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 4-6.

²²⁸³ Fadil Fazliu, T. 7430-7431; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 5-6.

Zeneli e qortuan Ujkun për sjelljen e tij ndaj të tjerëve.²²⁸⁴ Pastaj Arbnor Zeneli u tha të pranishmëve se të gjithë duhej të shkonin në Jabllanicë, komuna e Gjakovës, për të diskutuar mobilizimin.²²⁸⁵ Pas kësaj, Fadil Fazliu dhe Naser Lika, së bashku me dy persona të tjerë nga fshati i tyre, Fadil Selmani dhe Ali Berisha, u nisën për në Jabllanicë me Tahirin dhe disa ushtarë të tjerë.²²⁸⁶ Fadil Fazliu dëshmoi se ai shkoi me dëshirën e vet, pa u detyruar nga askush.²²⁸⁷ Ata mbërritën në Jabllanicë pasditen e asaj dite që duhej të ketë qenë 24 maj 1998.²²⁸⁸ Burrat hynë në oborrin e selisë së shtabit të UÇK-së në Jabllanicë.²²⁸⁹ Pasi iu ofrua ushqim, Fadil Fazliu, Naser Lika, dhe 10 - 15 të tjerë diskutuan me Lahi dhe Nazmi Brahimajn çështjen e mobilizimit dhe përgatitjeve për përballjen me forcat serbe.²²⁹⁰ Përfundimisht u konkludua se nuk mund të siguroheshin armë në sasi të mjaftueshme, dhe pas kësaj Fadil Fazliu, Naser Lika, dhe të tjerët dolën nga oborri dhe takuan Arbnor Zenelin jashtë portës së shtabit i cili po i priste për t'i çuar ku donin të shkonin.²²⁹¹ Arbnor Zeneli i çoi Fadil Fazliun dhe Naser Likën me makinë në shtëpinë e Haxhi Bajramit, ku Fadil Fazliu dhe Naser Lika u ndanë nga njëri tjetri.²²⁹² Fadil Fazliu dëshmoi se kishte qenë bashkë me Naser Likën prej momentit kur ikën nga Grabanica deri kur arritën në shtëpinë e Haxhi Bajramit.²²⁹³ Fadil Fazliu deklaroi se ai nuk pa askënd që të keqtrajtohej në selinë e shtabit në Jabllanicë.²²⁹⁴ Fadil Fazliu dëshmoi se ai ishte i sigurtë se Ramush Haradinaj nuk ishte i pranishëm në selinë e shtabit në Jabllanicë megjithëse shtoi se nuk do t'a kishte njohur pasi në atë kohë nuk e njhte.²²⁹⁵

455. Dëshmitari 3 dëshmoi se ai i njhte Naser Likën dhe Fadil Fazliun.²²⁹⁶ Në fund të majit 1998, Dëshmitari 3 ishte me ta në shtëpinë e Tal Zekës në Zhabel, komuna e Gjakovës.²²⁹⁷ Ai dëshmoi se tek kjo shtëpi erdhën “Ujku”, Tahir Qorri, dhe një person tjetër, i cili mund të ishte Sadri Berisha.²²⁹⁸ Dëshmitari 3 pa se si të tre burrat i zbritën me dhunë Naser Likën dhe Fadil Fazliun poshtë shkallëve, duke i shkelmuar dhe rrahur ata, ndërkohë që Ujku i quante tradhëtarë.²²⁹⁹ Të tre burrat ishin të armatosur dhe të veshur me uniforma; Ujku ishte i veshur me uniformë të zezë dhe dy të tjerët kishin uniforma kamuflazhi.²³⁰⁰ Dëshmitari 3 besonte se ata ishin anëtarë të UÇK-së.²³⁰¹ Dëshmitari 3 dëshmoi se ai e kishte parë Ujkun disa herë më parë, se kishte dëgjuar që me

²²⁸⁴ Fadil Fazliu, T. 7431, 7464-7465; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 5.

²²⁸⁵ Fadil Fazliu, T. 7430-7432; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 5-6.

²²⁸⁶ Fadil Fazliu, T. 7431-7432; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 6.

²²⁸⁷ Fadil Fazliu, T. 7435, 7466-7467; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 6.

²²⁸⁸ Fadil Fazliu, T. 7439; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 6.

²²⁸⁹ Fadil Fazliu, T. 7439-7440; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 6.

²²⁹⁰ Fadil Fazliu, T. 7439-7443; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 6-7.

²²⁹¹ Fadil Fazliu, T. 7440, 7442-7443, 7469; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 7-8.

²²⁹² Fadil Fazliu, T. 7443, 7470-7471; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 8.

²²⁹³ Fadil Fazliu, T. 7471-7472; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 7.

²²⁹⁴ Fadil Fazliu, T. 7472-7475; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 8.

²²⁹⁵ Fadil Fazliu, T. 7476; D155 (Fadil Fazliu, deklaratë e dëshmitarit të mbrojtjes, 15 qershor 2006), f. 7.

²²⁹⁶ Dëshmitari 3, T. 7930-7931, 7978-7981.

²²⁹⁷ Dëshmitari 3, T. 7931, 7933-7934, 7937-7938, 7993, 8033.

²²⁹⁸ Dëshmitari 3, T. 7935, 7938-7939, 8007-8008.

²²⁹⁹ Dëshmitari 3, T. 7935, 7938, 7940, 8007, 8032-8033.

²³⁰⁰ Dëshmitari 3, T. 7940.

²³⁰¹ Dëshmitari 3, T. 7939-7940.

këtë nofkë e thërrisnin fshatarët në Jabllanicë, dhe se kishte dëgjuar prej tyre që Ujku ishte anëtar i policisë ushtarake të UÇK-së.²³⁰² Pas disa javësh, Dëshmitari 3 u takua përsëri me Naser Likën, i cili i tha se ata njerëz e kishin çuar në Jabllanicë ku e kishin rrahur.²³⁰³

456. Dëshmitari 6 dëshmoi se ai u mbajt në Jabllanicë nga 13 qershori deri më 25 korrik 1998.²³⁰⁴ Ai dëshmoi se nuk e njohte ndonjë person me emrin Naser Lika, se nuk e kishte njohur kur i ishte treguar fotografia e tij nga një hetues i Tribunalit, dhe se nuk e kishte parë këtë person asnjëherë në Jabllanicë apo gjetkë.²³⁰⁵

457. Siç u përmend më sipër, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi se në maj 1998, Naser Lika dhe Fadil Fazliu u larguan nga shtëpia e Tal Zekës në Zhabel së bashku me disa ushtarë të UÇK-së dhe se shkuan në Jabllanicë. Dëshmitari 3 dëshmoi se ai pa dy burra që po i zbrisnin me dhunë shkallëve në shtëpinë e Tal Zekës, ndërkohë që disa persona, që ai besonte se ishin të UÇK-së, i shkelmonin, rrihnin dhe i quanin tradhëtarë. Ai dëshmoi gjithashtu se pas disa javësh Naser Lika i tha se këta persona e kishin çuar në Jabllanicë ku e kishin rrahur. Tërësia e dëshmive tregon se Naser Lika dhe Fadil Fazliu ishin të dy të pranishën në shtëpinë e Tal Zekës në Zhabel, dhe në Jabllanicë. Mirëpo dëshmia e Fadil Fazliut nuk përputhet me dëshminë e Dëshmitarit 3 në pikën që megjithëse konfirmon se të dy burrat shkuan në Jabllanicë të shoqëruar nga ushtarët e UÇK-së, Fadil Fazliu deklaroi se ata shkuan atje vullnetarisht dhe se nuk u keqtrajtuan dhe as u burgosën për asnjë moment. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrijë në përfundimin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se në maj 1998, ndaj Naser Likës dhe Fadil Fazliut u ushtrua trajtim mizor dhe tortura.

458. Dhoma Gjyqësore nuk ka dëgjuar dëshmi për incidentet në korrik 1998, të pretenduara në paragrafin 108 në lidhje me Pikat 33 dhe 34 të Aktakuzës, si dhe nuk ka dëgjuar dëshmi për aktet e pretenduara të të Akuzuarve lidhur me këto incidente, siç akuzohen ndryshe. Për këto arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhen të shpallen të pafajshëm për këtë pikë.

6.19 Përdhunimi i Dëshmitares 61 dhe trajtimi mizor dhe torturimi i Dëshmitarit 1 dhe Dëshmitares 61 (Pikat 36 dhe 37)

459. Të tre të Akuzuarit akuzohen, si pjesëmarrës në një ndëmmarrje të përbashkët kriminale, për përdhunimin, trajtimin mizor dhe torturimin e Dëshmitares 61 dhe trajtimin mizor dhe torturimin e Dëshmitarit 1 si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës. Ndryshe, Idriz Balaj akuzohet se ka kryer,

²³⁰² Dëshmitari 3, T. 7938-7939.

²³⁰³ Dëshmitari 3, T. 7940-7942.

²³⁰⁴ Dëshmitari 6, T. 5206, 5252-5255, 5293, 5297-5298, 5386.

²³⁰⁵ Dëshmitari 6, T. 5368, 5381-5382, 5392-5394.

apo planifikuar kryerjen e krimeve. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmitë përkatëse nga Dëshmitarja 61, Dëshmitari 1, Dëshmitari 56, dhe Roel Versonnen.

460. Dëshmitarja 61, grua rome nga komuna e Deçanit,²³⁰⁶ dëshmoi se një ditë në verën e vitit 1998, rreth mesnatës, një burrë që dëshmitarja e quajti “Toger” dhe katër burra të tjerë, të gjithë të armatosur dhe të veshur me uniforma të zeza me simbole në mëngë, erdhën në shtëpinë e dëshmitares.²³⁰⁷ Ajo nuk mundi t'i përshkruajë ushtarët pasi ishte errësirë.²³⁰⁸ Burrat pyetën vjehrrin e dëshmitares se ku ishte i biri, duke thënë se donin t'a pyesnin për diçka.²³⁰⁹ Pastaj burrit të dëshmitares ia lidhën duart pas shpine dhe i çuan atë dhe dëshmitaren në këmbë në një shtëpi njëkatëshe në Irzniq, komuna e Deçanit.²³¹⁰ Shtëpia përmendej zakonisht si “shtabi i UÇK-së” dhe gjendej pranë rrugës që të çonte në Gllogjan.²³¹¹ Dëshmitari 1 u çua nga dy burra tek një pus pranë shtëpisë.²³¹² Dy persona të tjerë çuan Dëshmitaren 61 tek shtëpia.²³¹³ Dëshmitaren e futën në një dhomë me një tavolinë, disa karrike, një televizor, dhe një krevat.²³¹⁴ Në dhomë nuk kishte njeri tjetër veç “Togerit” dhe dëshmitares.²³¹⁵ Një nga ushtarët që kishte marrë Dëshmitaren 61 nga shtëpia e saj qëndroi tek dera, por “Togeri” i tha ushtarit të largohej, duke shtuar se do t'a thërriste po të kishte nevojë për të.²³¹⁶ Dritat ishin nderur dhe dëshmitarja mundi të shikonte qartë fytyrën e “Togerit”.²³¹⁷ “Togeri” kishte një thikë dhe një pistoletë, të cilat i vendosi mbi tavolinë.²³¹⁸ Ai i kërkoi rojes të sillte një shkop druri, të cilin e vendosi gjithashtu mbi tavolinë.²³¹⁹ I ulur pranë tavolinës, “Togeri” e mori dëshmitaren në pyetje për afro gjysëm ore, duke e pyetur nëse burri i saj kishte bashkëpunuar me policinë serbe.²³²⁰ Pas pyetjeve, “Togeri” i tha dëshmitares të shkonte tek krevati dhe të zhishej.²³²¹ Ai mbylli dritat, por televizioni mbeti i nderur; u afrua tek krevati dhe u zhvesh.²³²² Pastaj “Togeri” e përdhunoj dëshmitaren disa herë afërsisht për një një ore e gjysëm.²³²³ Dëshmitarja kishte frikë se mos e vriste.²³²⁴ “Togeri” i tha dëshmitares të mos i tregonte burrit të saj se çfarë kishte ndodhur.²³²⁵ Pasi dëshmitarja u vesh, “Togeri” i tha të largohej.²³²⁶ Rreth orës 3 të mëngjesit dëshmitarja shkoi në shtëpi me bashkëshortin e saj.²³²⁷ Bashkëshorti i tregoi dëshmitares se e kishin futur në një pus, të zhytur në ujë deri në brez, grykën e pusit e kishin mbyllur me kapak,

²³⁰⁶ Dëshmitarja 61, T. 3970-3972, 4028-4029.

²³⁰⁷ Dëshmitarja 61, T. 3977-3985, 3987-3988, 4014-4015, 4032.

²³⁰⁸ Dëshmitarja 61, 4043.

²³⁰⁹ Dëshmitarja 61, T. 3982, 3984.

²³¹⁰ Dëshmitarja 61, T. 3988, 3990-3991, 4016-4017, 4032-4033.

²³¹¹ Dëshmitarja 61, T. 3988, 4003, 4016-4022; P269 (Fotografi e Irzniqit shënuar nga Dëshmitarja 61).

²³¹² Dëshmitarja 61, T. 3991, 4005-4007.

²³¹³ Dëshmitarja 61, T. 4006

²³¹⁴ Dëshmitarja 61, T. 3991-3992, 4034.

²³¹⁵ Dëshmitarja 61, T. 3991.

²³¹⁶ Dëshmitarja 61, T. 3991, 4041.

²³¹⁷ Dëshmitarja 61, T. 3991, 3993, 4034, 4036-4037.

²³¹⁸ Dëshmitarja 61, T. 3992-3993.

²³¹⁹ Dëshmitarja 61, T. 3993.

²³²⁰ Dëshmitarja 61, T. 3991-3992, 4034.

²³²¹ Dëshmitarja 61, T. 3993.

²³²² Dëshmitarja 61, T. 3993-3994, 4044-4045, 4047.

²³²³ Dëshmitarja 61, T. 3994-3996.

²³²⁴ Dëshmitarja 61, T. 3993-3996.

²³²⁵ Dëshmitarja 61, T. 3996.

²³²⁶ Dëshmitarja 61, T. 3996.

dhe se e kishin mbajtur atje deri kur i liruan të dy.²³²⁸ Dëshmitarja 61 nuk e pa vetë dëshmitarin 1 në pus.²³²⁹ Dëshmitarja 61 dëshmoi se rrobat e Dëshmitarit 1 ishin të lagura nga mesi e poshtë, dhe se ai i ndërroi rrobat kur erdhën në shtëpi.²³³⁰ Kur dëshmitarja erdhi në shtëpi, ajo u tregoi bashkëshortit të saj dhe të afërmve të vet, që ishin aty, se çfarë i kishte ndodhur.²³³¹ Rreth orës 5 të mëngjesit bashkëshorti i dëshmitares dhe vjehri i saj shkuan në shtabin e UÇK-së dhe raportuan për incidentin.²³³² Më pas, në shtëpinë e dëshmitares erdhën tre persona, të cilët e pyetën për atë që kishte ndodhur.²³³³ Një prej tyre ishte i veshur me uniformë të UÇK-së, të tjerët ishin me rroba civile.²³³⁴ Dëshmitarja deklaroi se një prej tyre quhej Shemsedin Ceku.²³³⁵ Dëshmitarja u tregoi se çfarë i kishte ndodhur; ata u larguan, dhe pastaj u kthyen dhe i thanë dëshmitares se kishin folur me Togerin, i cili në fillim e kishte mohuar akuzën dhe më pas kishte pranuar çfarë i kishte bërë asaj.²³³⁶ Rreth dy javë pas këtij incidenti, dëshmitarja dhe familja e saj u larguan nga fshati për shkak të luftimeve të ashpra midis UÇK-së dhe forcave serbe.²³³⁷ Dëshmitarja nuk e njihnte më parë burrin që ajo e quajti “Togeri”, dhe nuk e dinte emrin e tij të vërtetë.²³³⁸ Bashkëshorti i dëshmitares i tregoi pas incidentit se e kishte njohur personin që kishte ardhur në shtëpinë e tyre dhe i kishte marrë me vete, dhe se emri i tij ishte “Togeri”.²³³⁹ Atë e thërrisnin “Togeri” edhe katër burrat që e shoqëronin kur erdhi në shtëpinë e dëshmitares.²³⁴⁰ Dëshmitarja e përshkroi atë si shqipfolës, rreth 20 e ca vjeç, me flokë të zeza, pak më i gjatë se dëshmitarja, e cila është 1.58 metra e gjatë.²³⁴¹ Rezulton se Idriz Balaj është 1.78 m i gjatë.²³⁴² Dëshmitarja 61 dëshmoi se “Togeri” kishte disa kokra apo puçrra të vogla në faqe dhe në mjekër, ndoshta të shkaktuara nga të rruajturit, por dëshmitarja nuk dalloi asgjë të veçantë në fytyrë apo në qafë.²³⁴³ Dëshmitarja 61 e pa “Togerin” të paktën një herë pas incidentit.²³⁴⁴ Ai po ngiste një xhip të zi.²³⁴⁵ Dëshmitares iu tregua një tabelë me tetë fotografi, ku përfshihej edhe një fotografi e Idriz Balajt, por ajo nuk e njohu.²³⁴⁶ Kur dëshmitarja e pa të Akuzuarin Idriz Balaj në televizor pasi ishte arrestuar dhe sjellë në Hagë, ajo

²³²⁷ Dëshmitarja 61, T. 3996, 4008, 4045.

²³²⁸ Dëshmitarja 61, T. 4005-4007.

²³²⁹ Dëshmitarja 61, T. 4005-4007.

²³³⁰ Dëshmitarja 61, T. 4007.

²³³¹ Dëshmitarja 61, T. 3996, 4046.

²³³² Dëshmitarja 61, T. 3997, 4007-4008.

²³³³ Dëshmitarja 61, T. 3997-3998.

²³³⁴ Dëshmitarja 61, T. 3998.

²³³⁵ Dëshmitarja 61, T. 4050.

²³³⁶ Dëshmitarja 61, T. 3997-3999.

²³³⁷ Dëshmitarja 61, T. 3999, 4006.

²³³⁸ Dëshmitarja 61, T. 3981-3982, 4000-4001, 4005.

²³³⁹ Dëshmitarja 61, T. 3981-3982, 4003, 4005.

²³⁴⁰ Dëshmitarja 61, T. 4001.

²³⁴¹ Dëshmitarja 61, T. 4000, 4061, 4063.

²³⁴² T. 10519-10520.

²³⁴³ Dëshmitarja 61, T. 4002-4003, 4044, 4047.

²³⁴⁴ Dëshmitarja 61, T. 3999, 4050.

²³⁴⁵ Dëshmitarja 61, T. 3999, 4050.

²³⁴⁶ Dëshmitarja 61, T. 4048-4049.

mendoj se ai nuk dukej si “Togeri” dhe se Idriz Balaj kishte një pamje më të moshuar.²³⁴⁷
Dëshmitarja deklaroi gjithashtu se nuk do të ishte në gjendje t'a njihje “Togerin” sot.²³⁴⁸

461. Dëshmitari 1 nga komuna e Deçanit deklaroi se një ditë në fillim të gushtit 1998, rreth mesnatës, “Togeri” dhe katër burra të tjerë hynë me forcë në shtëpinë e dëshmitarit.²³⁴⁹ Burrat ishin të armatosur dhe kishin uniforma të zeza me shenjën e UÇK-së në mëngë dhe në xhepat e përparmë të xhaketave.²³⁵⁰ Dy nga burrat kishin maska.²³⁵¹ “Togeri” i urdhëroi Dëshmitarin 1 dhe Dëshmitaren 61 të shkonin me ta.²³⁵² Burrat i lidhën Dëshmitarit 1 duart pas shpine dhe i çuan Dëshmitarin 1 dhe Dëshmitaren 61 në këmbë në shtabin lokal të UÇK-së në Irzniq.²³⁵³ Shtabi i UÇK-së ishte vendosur në një shtëpi njëkatëshe, e cila më parë kishte qënë shkollë.²³⁵⁴ Shtëpia përbëhej nga dy apo tri dhoma.²³⁵⁵ Sapo mbërriti në shtab, “Togeri” e futi Dëshmitaren 61 brenda në ndërtesë kurse dy burrat me maska në fytyrë e futën Dëshmitarin 1 në një pus përpara shtëpisë.²³⁵⁶ Sipas dëshmitarit, atë e mbajtën të zhytur në ujë deri në qafë.²³⁵⁷ Rreth orës 4 të mëngjesit, Dëshmitari 1 dhe Dëshmitarja 61 u liruan dhe ata shkuan në shtëpinë e tyre.²³⁵⁸ Gjatë rrugës për në shtëpi, Dëshmitarja 61, duke qarë, i tha Dëshmitarit 1 se “Togeri” i kishte bërë diçka kur ishin brenda në ndërtesë.²³⁵⁹ Kur mbërritën në shtëpi, Dëshmitarja 61 i tha Dëshmitarit 1 se “Togeri” e kishte përdhunuar.²³⁶⁰ Rreth orës 5 të mëngjesit të po asaj dite, dëshmitari takoi komandantin lokal të UÇK-së, Shemsedin Cekaj, të cilit i tregoi se çfarë kishte ngjarë.²³⁶¹ Dëshmitari dëshmoi se pas kësaj Cekaj thirri një oficer të lartë të UÇK-së për t'ju ankuar për çfarë u kishte ndodhur Dëshmitarit 1 dhe Dëshmitares 61.²³⁶² Të nesërmen, Cekaj dhe oficeri i UÇK-së shkuan në shtëpinë e dëshmitarit dhe e shoqëruan atë në shtabin e UÇK-së në Irzniq.²³⁶³ Atje Dëshmitari 1 i tregoi Ramush Haradinajt çfarë i kishte ndodhur atij dhe Dëshmitares 61.²³⁶⁴ Ramush Haradinaj tha se ishte e pamundur që “Togeri” të kishte bërë një gjë të tillë, dhe e akuzoi Dëshmitarin 1 se po gënjente.²³⁶⁵ Dëshmitari dëshmoi gjithashtu se një ditë pas incidentit ai i tregoi Dëshmitarit 56 se çfarë kishte ndodhur.²³⁶⁶ Rreth 31 gushtit 1998, Dëshmitari 1 dhe të afërmit e tij u

²³⁴⁷ Dëshmitarja 61, T. 4050-4051.

²³⁴⁸ Dëshmitarja 61, T. 4000.

²³⁴⁹ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 1-3; P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 4.

²³⁵⁰ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3.

²³⁵¹ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3.

²³⁵² P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3.

²³⁵³ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3.

²³⁵⁴ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3.

²³⁵⁵ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3.

²³⁵⁶ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3; P1253 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 11 gusht 2006), paragrafi 7.

²³⁵⁷ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3.

²³⁵⁸ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 5.

²³⁵⁹ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3; P1252 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 28 maj 2006), paragrafi 38.

²³⁶⁰ P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 4; P1252 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 28 maj 2006), paragrafi 38.

²³⁶¹ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 3, 5; P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 3.

²³⁶² P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 5; P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 3.

²³⁶³ P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 3.

²³⁶⁴ P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 3.

²³⁶⁵ P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 3.

²³⁶⁶ P1252 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 28 maj 2006), paragrafi 39.

larguan nga fshati i tyre.²³⁶⁷ Shemsedin Cekaj dëshmoi se ai nuk kishte dijeni për incidentin dhe se dëgjoi për herë të parë për të kur u pyet për këtë incident nga një hetues i TPNJ-së.²³⁶⁸

462. Dëshmitari 1 dëshmoi se se e kishte parë “Togerin” disa herë para dhe pas këtij incidenti në fillim të gushtit.²³⁶⁹ Më 15 dhe 16 tetor 2002, Dëshmitarit 1 iu paraqit një tabelë me tetë fotografi.²³⁷⁰ Dëshmitari deklaroi se njohu “pa asnjë dyshim” fotografinë me numër gjashtë të burrit që ai e quajti “Togeri”.²³⁷¹ Fotografia me numër gjashtë është fotografia e të Akuzuarit Idriz Balaj.²³⁷²

463. Dëshmitari 56 dëshmoi se një ditë në vitin 1998, rreth orës 23, në shtëpinë e tij erdhën katër apo pesë burra të armatosur, të cilën e pyetën se ku gjendej i biri dhe më pas shoqëruan për në “shtab” të birin dhe nusen e të birit, të cilit jetonin me të në të njëjtën shtëpi”.²³⁷³ Sipas Dëshmitarit, burrat ishin të UÇK-së.²³⁷⁴ Pasi u kthyen të dy rreth orës 4 atë të natës, i biri i tregoi Dëshmitarit 56 se e kishin futur në një pus dhe se “kishin bërë çfarë kishin dashur” me gruan e tij.²³⁷⁵ Dëshmitari 56 vuri re se i biri i kishte teshat e lagura.²³⁷⁶ Sipas Dëshmitarit 56, i biri i tij dhe nusja e të birit u morën nga shtëpia dhe u kthyen atje me makinë.²³⁷⁷ Dëshmitari 56 dëgjoi nusen që i tha të shoqit: “ai bëri çfarë desh me mua ” dhe “ata më bënë diçka dhe ti e kupton se çfarë”.²³⁷⁸ Dëshmitari 56 dëgjoi gjithashtu nusen që përmendi emrin “Toger”, por ajo nuk foli më gjatë për këtë.²³⁷⁹ Mëngjesin e së nesërme pas incidentit, Dëshmitari 56 shkoi të takonte komandantin e UÇK-së në fshat, Shemsedin Cekaj, por ai po flinte.²³⁸⁰ Rreth dy orë më vonë, Shemsedin Cekaj, dhe një komandant tjetër erdhën në shtëpinë e Dëshmitarit 56 dhe biseduan me pjestarët e tjerë të familjes për çfarë kishte ndodhur.²³⁸¹ Vetë Dëshmitari 56 nuk u përfshi në këtë bisedë.²³⁸² Dëshmitari 56 dëshmoi gjithashtu se i biri kishte punuar nganjëherë për hapjen e llogoreve për UÇK-në, por ai nuk e dinte nëse i biri e kishte bërë këtë vullnetarisht apo jo.²³⁸³

464. Roel Versonnen, hetues i TPNJ-së,²³⁸⁴ dëshmoi se intervistoi Dëshmitarin 1 më 15 dhe 16 tetor 2002.²³⁸⁵ Versonnen i tregoi Dëshmitarit 1 një tabelë të përgatitur nga ekipi i tij me fotografitë

²³⁶⁷ P1250 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 24 gusht 2002), f. 2; P1252 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 28 maj 2006), paragrafi 35.

²³⁶⁸ Shemsedin Cekaj, T. 4517-4518.

²³⁶⁹ P1252 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 28 maj 2006), paragrafët 30-35.

²³⁷⁰ P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 9, Shtojca 1.

²³⁷¹ P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 9.

²³⁷² P1251 (Dëshmitari 1, deklaratë dëshmitari, 16 tetor 2002), f. 9, Shtojca 1-2.

²³⁷³ Dëshmitari 56, T. 7101-7103, 7111, 7114-7115, 7126, 7128-7129.

²³⁷⁴ Dëshmitari 56, T. 7113.

²³⁷⁵ Dëshmitari 56, T. 7103-7104, 7108-7109, 7111, 7128-7129.

²³⁷⁶ Dëshmitari 56, T. 7111-7112.

²³⁷⁷ Dëshmitari 56, T. 7126-7127.

²³⁷⁸ Dëshmitari 56, T. 7109-7110.

²³⁷⁹ Dëshmitari 56, T. 7108-7109, 7112-7113, 7127.

²³⁸⁰ Dëshmitari 56, T. 7101, 7105-7106.

²³⁸¹ Dëshmitari 56, T. 7105.

²³⁸² Dëshmitari 56, T. 7102, 7105-7106, 7116-7117.

²³⁸³ Dëshmitari 56, T. 7113-7114.

²³⁸⁴ P1225 (Roel Versonnen, deklaratë dëshmitari, 12 shkurt 2007), paragrafi 2; Roel Versonnen, T. 10610, 10902.

²³⁸⁵ P1225 (Roel Versonnen, deklaratë dëshmitari, 12 shkurt 2007), paragrafët 8-9; Roel Versonnen, T. 10896.

e tetë meshkujve.²³⁸⁶ Përveç Versonnen-it, të vetmit persona të pranishëm në këtë rast ishin Dëshmitari 1 dhe një përkthyes.²³⁸⁷ Versonnen e pyeti Dëshmitarin 1 nëse njihje ndonjë nga personat e paraqitur në tabelën me fotografi.²³⁸⁸ Versonnen nuk i kërkoi Dëshmitarit 1 të identifikonte ndonjë person të veçantë dhe as nuk i tha nëse fotografia e të dyshuarit ishte apo jo midis fotografive në tabelë.²³⁸⁹ Versonnen qëndronte në këmbë pranë Dëshmitarit 1 kur i tregoi atij tabelën e fotografive.²³⁹⁰ Dëshmitari 1 e pa tabelën me fotografi dhe tregoi menjëherë me gisht fotografinë me numrin 6 si fotografi të “Togerit”.²³⁹¹ Fotografia me numër 6 është e të Akuzuarit Idriz Balaj.²³⁹² Versonnen-it nuk i kujtohet nëse Dëshmitari 1 bëri një përshkrim të “Togerit”.²³⁹³ Versonnen-it nuk i kujtohet të ketë parë udhëzimet e Zyrës së Prokurorisë për identifikimin dhe nuk mendon se kishte dijeni për to kur kreu intervistën me Dëshmitarin 1.²³⁹⁴ Versonnen nuk i kërkoi Dëshmitarit 1 të nënshkruante tabelën e fotografive.²³⁹⁵

465. Siç u përmend më sipër, Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi që një natë, rreth mesnatës, në verën e vitit 1998, pesë burra të armatosur të veshur me uniforma të zeza me simbolin e UÇK-së morën Dëshmitaren 61 dhe Dëshmitarin 1 nga shtëpia e tyre për në shtabin e UÇK-së në Irzniq. Atje ata i ndanë dëshmitarët nga njëri tjetri. Dëshmitari 1 deklaroi se dy nga pesë burrat e armatosur e futën atë në një pus, ku e lanë të qëndronte në ujë. Dëshmitarja 61 dëshmoi se dy nga burrat e tjerë e futën atë në një dhomë, ku e lanë vetëm me një burrë, i cili e mori në pyetje për rreth gjysëm ore nëse bashkëshorti i saj kishte bashkëpunuar me policinë serbe. Ky burrë vendosi disa armë mbi tavolinë dhe pastaj kreu penetrim seksual ndaj saj disa herë për rreth një orë e gjysëm. Dëshmitarja 61 pati frikë se ai do ta vriste. Dëshmitarja 61 dhe Dëshmitari 1 u kthyen në shtëpi rreth orës 3 - 4 të mëngjesit. Dëshmitarja 61 i tregoi Dëshmitarit 1 çfarë i kishte ndodhur, bisedë që u dëgjua nga Dëshmitari 56. Dëshmitari 1 u tha Dëshmitares 61 dhe Dëshmitarit 56 se atë e kishin futur në një pus, dhe të dy ata panë se teshat e tij ishin të lagura.

466. Mbi bazën e këtyre dëshmive, Dhoma Gjyqësore është e bindur se një ushtar i UÇK-së kreu qëllimisht penetrim seksual ndaj Dëshmitares 61, duke e ditur se kjo po ndodhte pa pëlqimin e saj. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore është e bindur se kjo i shkaktoi asaj vuajtje të rënda fizike dhe mendore, si dhe përbën sulm të rëndë ndaj dinjitetit të saj njerëzor. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtari i UÇK-së kreu krimet e përdhunimit dhe trajtimit mizor kundër Dëshmitares 61. Duke patur parasysh rrethanat në të cilat u krye përdhunimi, veçanërisht

²³⁸⁶ P1225 (Roel Versonnen, deklaratë dëshmitari, 12 shkurt 2007), paragrafët 6, 12; Roel Versonnen, T. 10896, 10902; P1230 (Tabelë me fotografi paraqitur Dëshmitarit 1), f. 2.

²³⁸⁷ P1225 (Roel Versonnen, deklaratë dëshmitari, 12 shkurt 2007), paragrafi 13; Roel Versonnen, T. 10896, 10910.

²³⁸⁸ P1225 (Roel Versonnen, deklaratë dëshmitari, 12 shkurt 2007), paragrafët 12-13; Roel Versonnen, T. 10896.

²³⁸⁹ P1225 (Roel Versonnen, deklaratë dëshmitari, 12 shkurt 2007), paragrafi 13.

²³⁹⁰ P1225 (Roel Versonnen, deklaratë dëshmitari, 12 shkurt 2007), paragrafi 13; Roel Versonnen, T. 10896.

²³⁹¹ Roel Versonnen, T. 10897-10899.

²³⁹² Roel Versonnen, T. 10900; P1230 (Tabelë me fotografi treguar Dëshmitarit 1), f. 1-2.

²³⁹³ Roel Versonnen, T. 10908.

²³⁹⁴ Roel Versonnen, T. 10905-10906.

²³⁹⁵ Roel Versonnen, T. 10906-10907.

faktin se Dëshmitarja 61 u pyet për rreth gjysëm ore nëse burri i saj kishte bashkëpunuar me policinë serbe, Dhoma Gjyqësore gjykon se përdhunimi kishte për qëllim që të ndëshkonte dhe/ose frikësonte Dëshmitaren 61. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se ushtari i UÇK-së kreu torturë ndaj Dëshmitares 61. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore është e bindur se krimet kishin lidhje të ngushtë me konfliktin e armatosur në Kosovë.

467. Dhoma Gjyqësore gjykon se nuk është përcaktuar se duke e futur Dëshmitarin 1 në një pus apo nëpërmjet akteve të tjera, ushtarët e UÇK-së i shkaktuan atij vuajtje apo lëndime të rënda mendore ose fizike, ose kryen sulm të rëndë ndaj dinjitetit të tij njerëzor. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ndaj Dëshmitarit 1 u ushtrua trajtim mizor apo torturës.

468. Të tre të Akuzuarit akuzohen në Pikat 36 dhe 37 si pjesmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore do t'a trajtojë këtë formë përgjegjësie veças në pjesën 7, më poshtë. Ndryshe, Idriz Balaj akuzohet se ka kryer ose planifikuar krimet e përshkuara në Pikat 36 dhe 37.

469. Dëshmitari 1 deklaroi se një nga pesë burrat që morën atë dhe Dëshmitaren 61 nga shtëpia e tyre ishte "Togeri", të cilin Dëshmitari 1 e njohte që më parë. Dëshmitarja 61 dëshmoi se katër nga pesë burrat i drejtoheshin të pestit me emrin "Toger". Ajo dëshmoi gjithashtu se pas incidentit Dëshmitari 1 i tha se njërin nga burrat e kishte njohur që ishte "Togeri". Dhoma Gjyqësore konkludon se "Togeri" ishte një ndër burrat që morën Dëshmitaren 61 dhe Dëshmitarin 1 nga shtëpia e tyre. Bazuar në tërësinë e dëshmive, Dhoma Gjyqësore është e bindur se "Togeri" është Idriz Balaj.²³⁹⁶ Dëshmitarja 61 dhe Dëshmitari 1 deklaruan që dy nga pesë burrat e armatosur e çuan Dëshmitarin 1 tek pusi. Dëshmitarja 61 dëshmoi se dy burrat të tjerë e futën atë në një dhomë të ndërtesës, kurse Dëshmitari 1 deklaroi se ishte Togeri ai që e shoqëroi Dëshmitaren 61 drejt ndërtesës. Dëshmitari 1 nuk mund të shikonte se kush e futi Dëshmitaren 61 në dhomën ku u përdhunua. Dhoma Gjyqësore gjykon se kjo dëshmia krijon dyshimin e arsyeshëm nëse ishte Togeri apo ndonjë ushtar tjetër i UÇK-së, personi që përdhunoi Dëshmitaren 61. Meqë ajo dëshmoi se ishte shumë errësirë për të dalluar ushtarët që erdhën në shtëpinë e saj, ka të ngjarë që ajo të ketë ngatërruar Togerin me dikë tjetër. Për më tepër, Dëshmitarja 61 nuk e njohu Idriz Balajn në tabelën e fotografive të TPNJ-së, dhe deklaroi se kur e pa Idriz Balajn në televizor në vitin 2005, ai nuk ju duk si burri që e kishte përdhunuar dhe se kishte një pamje më të moshuar. Ajo dëshmoi gjithashtu në gjy se nuk do të ishte më në gjendje të njohte personin që e kishte përdhunuar. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se, ose kujtesa e saj për identifikimin e përdhunuesit është e pmjaftueshme, ose nuk përputhet me ngjasimin e Idriz Balajt. Sa i përket Dëshmitarit 1, ai ndodhej në rrethana ku

²³⁹⁶ Shemsedin Cekaj, T. 4394; P1213 (Ylber Haskaj, deklaratë dëshmitari, 5 nëntor 2007), paragrafi 14; Ylber Haskaj, T. 10339; P371 (Bogdan Tomash, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 26; dhe dëshmi të tjera siç është diskutuar në konkluzionet për këtë Pikë dhe në pjesën 6.8.

nuk mund të dinte se kush e kreu përdhunimin. Duke patur parasysh dyshimet që lindin nga kjo dëshmi, Dhoma Gjyqësore nuk do mbështetet në dëshmi të dorë së dytë sipas të cilave Togër pranoi se kishte përdhunuar Dëshmitaren 61. Mbi bazën e provave, Dhoma Gjyqësore nuk mund të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyshëm se personi që përdhanoi Dëshmitaren 61 ishte Idriz Balaj, ose se ai planifikoi që dikush tjetër ta bënte këtë. Si pasojë, Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se Idriz Balaj duhet të shpallet i pafajshëm për kryerjen ose planifikimin e krimeve të përdhunimit, trajtimit mizor, dhe torturës kundër Dëshmitares 61.

7. Pjesëmarrja e të Akuzuarve në një ndërmarrje të përbashkët kriminale

470. Prokuroria i ka akuzuar të tre të Akuzuarit për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Qëllimi i kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale të pretenduar ishte “konsolidimi i kontrollit të plotë të UÇK-së mbi Zonën Operative të Dukagjinit përmes largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë dhe përmes keqtrajtimit të civilëve shqiptarë kosovarë, romë/egjiptianë kosovarë, dhe civilëve të tjerë, të cilët bashkëpunonin ose mendohej se kishin bashkëpunuar me forcat serbe ose se nuk e kishin përkrahur UÇK-në”.²³⁹⁷ Ky qëllim konsistonte në kryerjen e krimeve të akuzuara në Aktakuzë. Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se ushtarë të UÇK-së kryen akte të trajtimit mizor, torturës, përdhunimit, dhe vrasjes të akuzuara në Pikat 6, 14, 20, 22 (lidhur me vrasjen e Nurijs dhe Istref Krasniqit dhe vrasjen e Sanije Balajt), 28, 30, 32, 36, dhe 37 (lidhur me Dëshmitaren 61).

471. Prokuroria ka paraqitur pak dëshmi të drejtpërdrejta lidhur me qëllimin e përbashkët kriminal të pretenduar. Jakup Krasniqi, anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në fund të vitit 1996 apo në fillim të vitit 1997 dhe zëdhënës i UÇK-së që prej 11 qershorit 1998,²³⁹⁸ dëshmoi se sulmi ndaj civilëve të çfarëdo përkatësie etnike nuk ka qenë asnjëherë politikë e UÇK-së.²³⁹⁹ Një deklaratë e politikave të UÇK-së e lëshuar më 29 prill 1998 dënonte dhunën kundër popullsisë civile dhe personave të kapur.²⁴⁰⁰ Krasniqi pranoi se UÇK-ja ndalonte njerëz në postbllloqe, i mbante, i merrte në pyetje, dhe pastaj i lironte.²⁴⁰¹ Ai deklaroi se në rastet kur individë të UÇK-së kanë kryer krime kundër civilëve të pafajshëm apo personave që nuk merrnin pjesë në luftime, këto krime janë kryer nga elementë jashtë kontrollit, pa dijeninë, miratimin apo mbështetjen e personave me pushtet apo në poste komanduese.²⁴⁰² Dëshmitari dëshmoi se gjatë betejave në vijën e frontit, janë vrarë “bashkëpunorë” “ndërkohë që i shërbenin armikut,” por shtoi se nuk dinte asnjë rast të ekzekutimit të “bashkëpunorëve” pas arrestimit të tyre.²⁴⁰³ Dëshmitari e përkufizoi “bashkëpunorin” si një person të rekrutuar nga shërbimet serbe të sigurimit, policia apo ushtria, dhe që, në këtë mënyrë, i shërbente regjimit serb.²⁴⁰⁴

²³⁹⁷ Aktakuza, paragrafi 26.

²³⁹⁸ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 4, Shtojca 14 (Komunikatë e UÇK-së në Bujku, 12 qershor 1998); P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3296, 3298, 3307, 3313, 3355, 3427-3429; Jakup Krasniqi, T. 4953, 4973, 4989, 5022, 5024, 5070, 5072, 5074-5075, 5078.

²³⁹⁹ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 6; P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3329, 3363, 3439-3441, 3443, 3445, 3449; P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), Shtojca 18 (Intervistë e Jakup Krasniqit në Kohën Ditore, 12 korrik 1998), f. 4; Jakup Krasniqi, T. 4959-4961.

²⁴⁰⁰ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), Shtojca 12 (Deklaratë politike e UÇK-së, 29 prill 1998), f. 2.

²⁴⁰¹ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3449; Jakup Krasniqi, T. 5114-5115, 5152-5153.

²⁴⁰² P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), paragrafi 6; P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3440-3441.

²⁴⁰³ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3321; Jakup Krasniqi, T. 5066, 5115, 5117.

²⁴⁰⁴ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), Shtojca 18 (Intervistë e Jakup Krasniqit në Kohën Ditore, 12 korrik 1998), f. 4; P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3320, 3326-3327, 3437; Jakup Krasniqi, T. 5060-6062, 5064-5065, 5153.

472. Dy komunikata të UÇK-së përkatësisht të datave 13 maj 1998 dhe 13 korrik 1998, informojnë se UÇK-ja kishte kryer operacione kundër bashkëpunorëve në mars, prill, maj, dhe korrik 1998.²⁴⁰⁵ Mirëpo komunikatat e UÇK-së nuk saktësojnë çfarë operacionesh.²⁴⁰⁶ Një komunikatë më e hershme, e datës 27 shkurt 1998, përshkruante “një sërë sulmesh kundër forcave të policisë serbe dhe bashkëpunorëve të tyre” gjatë janarit dhe shkurtit 1998.²⁴⁰⁷ Dy nga këto sulme të përmendura ishin kryer kundër policisë, i treti ishte kundër “një bashkëpunori me pushtuesin”, dhe i katërti kundër “një bashkëpunori të ngushtë të Arkanit”. Krasniqi theksoi se qëllimi i komunikatave të UÇK-së ishte informimi i publiku për veprimtarinë e UÇK-së, por se ato përdorshin edhe për propagandë, për ngjitjen e moralit të UÇK-së, për rritjen e popullaritetit të UÇK-së si dhe për të nxitur rekrutimet.²⁴⁰⁸ Ai dëshmoi se megjithëse ngjarjet e përshkruara në komunikatë kishin ndodhur, komunikatat zmadhohin sukseset dhe nivelin organizativ të UÇK-së dhe, nga ana tjetër, zvogëlonin dështimet dhe humbjet e UÇK-së.²⁴⁰⁹

473. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar disa dëshmi sipas të cilave UÇK-ja hartonte lista me emrat e njerëzve që kërkoheshin dhe se këto lista shpërndaheshin brenda UÇK-së. Dëshmitari 17 dëshmoi se më 12 korrik ai mori pjesë në një mbledhje në shtëpinë e Din Krasniqit në Vranoc, komuna e Pejës, së bashku, midis të tjerëve, me komandantët e fshatrave të Lugut të Baranit, komuna e Pejës.²⁴¹⁰ Në mbledhje dëshmitarit i dhanë një listë me emra personash.²⁴¹¹ Lista, të cilën dëshmitari e kopjoi në shënimet e tij, përfshinte emrat e mëposhtëm: Zenel (mbiemri i palexueshëm), Ali (mbiemri i palexueshëm), Mehmet Alia, Tahir Zhukri, Zenun Gashi (së bashku me të birinj), Zenel Mehmeti, Shekrelet Sadiku (së bashku me familjen e tij), “dy gra bashkëpunore Turjak-Kosturiq”, Misin Berisha “- rom, Gllogjan”, dhe Skënder Sali Kuqi “- Lutogllavë”.²⁴¹² Dëshmitari nuk njihje asnjë nga personat e përmendur në listë.²⁴¹³ Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi për fatin e mëvonshëm të tre personave të renditur në listë, por nuk ka marrë dëshmi për tetë personat e tjerë. Dëshmitari 17 nuk e dinte se prej kujt e mori listën.²⁴¹⁴ Atij nuk i kujtohej nëse e kishte marrë listën me gojë apo me shkrim.²⁴¹⁵ Dëshmitari e kuptonte se këta persona ishin në kërkim, por ai nuk e dinte se prej kujt apo se për cilën arsye kërkoheshin, dhe nuk kërkoi informacion për këtë.²⁴¹⁶ Nga kjo dëshmi, Dhoma Gjyqësore nuk mund të nxjerrë përfundime në lidhje me qëllimin e listës, kush

²⁴⁰⁵ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 maj 2007), Shtojca 13 (Komunikatë e UÇK-së në Kohën Ditore, 13 maj 1998), f. 1, Shtojca 16 (Komunikatë e UÇK-së në Kohën Ditore, 13 korrik 1998); P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3350; Jakup Krasniqi, T. 4972.

²⁴⁰⁶ P328 (Jakup Krasniqi, deklaratë dëshmitari, 24 Maj 2007), Shtojca 13 (Komunikatë e UÇK-së në Kohën Ditore, 13 maj 1998), f. 1, Shtojca 16 (Komunikatë e UÇK-së në Kohën Ditore, 13 korrik 1998).

²⁴⁰⁷ P966 (Komunikatë e UÇK-së në Zëri, 27 shkurt 1998).

²⁴⁰⁸ P340 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3339-3341, 3346, 3350, 3353-3354, 3377, 3419-3420; Jakup Krasniqi, T. 4953-4954, 4967-4968, 4980, 5011, 5035.

²⁴⁰⁹ P328 (Jakup Krasniqi, *Limaj e të tjerë* transkript, 10-12 shkurt 2005), f. 3321-3327, 3350-3351, 3420; Jakup Krasniqi, T. 4967-4968, 4978-4980, 5011-5012, 5038, 5044.

²⁴¹⁰ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 56; Dëshmitari 17, T. 7583-7586.

²⁴¹¹ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafët 57-58; Dëshmitari 17, T. 7584.

²⁴¹² P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 57; P886 (Shënime të Dëshmitarit 17), pf. 13-14

²⁴¹³ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 58; Dëshmitari 17, T. 7694.

²⁴¹⁴ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafi 57; Dëshmitari 17, T. 7584, 7699.

²⁴¹⁵ Dëshmitari 17, T. 7694.

²⁴¹⁶ P885 (Dëshmitari 17, deklaratë dëshmitari, 14 gusht 2007), paragrafët 57-58; Dëshmitari 17, T. 7696-7697, 7700.

e lëshoi listën atë dhe me çfarë kompetence, për ndonjë lidhje të mundshme midis shpërndarjes së listës dhe kryerjes së krimeve të akuzuara në Aktakuzë, apo ndonjë lidhje midis listës dhe ndonjë prej të Akuzuarve.

474. Rrustem Tetaj, ish-oficer i APJ-së nga Lluka e Poshtme, komuna e Deçanit,²⁴¹⁷ dëshmoi se kishte dijeni që dy ushtarë të UÇK-së me emrin Faton Mehmetaj dhe Fitnete Ramosaj, kishin hartuar “lista të zeza” me emrat e shumë njerëzve, pasi ata nuk ishin besnikë ndaj UÇK-së, përkrahnin LDK-në, ose se kishin punuar për MPB-në serbe apo organe të tjera.²⁴¹⁸ Këto lista qarkullonin në duart e rojeve të UÇK-së në ato fshatra që ishin përkrahës të UÇK-së në mënyrë që njerëzit e përsirë në këto lista të mos lejoheshin të hynin në këto fshatra.²⁴¹⁹ Qëllimi ishte “kompromentimi” apo diskreditimi i personave emrat e të cilëve ishin në këto “lista të zeza”.²⁴²⁰ Rrustem Tetaj dëshmoi se edhe emri i tij ishte përfshirë në një listë të tillë dhe se atë e kishte thirrur Faton Mehmetaj për t’a marrë në pyetje në fillim të majit 1998.²⁴²¹ Megjithëse ndjeu se pyetjet u bënë në mënyrë kërcënuese, ai nuk u keqtrajtua asnjëherë gjatë seancës dyorëshe të pyetjeve.²⁴²² Rrustem Tetaj nuk përmendi shembullin e ndonjë personi tjetër emri i të cilit përfshihej në një listë të tillë.

475. Dhoma Gjyqësore mendon se dëshmitë e drejtëpërdrejta që disponon nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka ekzistuar një ndërmarrje e përbashkët kriminale, qëllimi i së cilës ka qenë të kryerja e krimeve të akuzuara në Aktakuzë. Në mungesë të dëshmive të mjaftueshme të drejtëpërdrejta, mbetet mundësia për të parë, mbi bazën e dëshmive rrethore, kryesisht dëshmive për krimet e kryera nga ushtarë të UÇK-së, nëse ka ekzistuar një ndërmarrje e përbashkët kriminale për kryerjen e këtyre krimeve. Sidoqoftë ky përfundim duhet të jetë përfundimi i vetëm i arsyeshëm mbi bazën e dëshmive.²⁴²³ Lidhur me vrasjet e Sanije Balajt dhe Istref e Nurije Krasniqit, në pjesët e mësipërme 6.1, 6.12.6, dhe 6.12.12, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin, se ekzistojnë mundësi të arsyeshme të ndryshme prej opsionit të implikimit të UÇK-së në këto krime, dhe, pikërisht, mundësia që të tre këta persona të jenë vrarë nga persona, të cilët nuk vepronin nën drejtimin e UÇK-së apo në zbatim të politikave të saj. Në këtë drejtim, veçanërisht lidhur me Sanije Balajn, Dhoma Gjyqësore konstaton se Ramush Haradinaj, ndër të tjerët, nguli këmbë në kryerjen e një hetimi për vdekjen e saj dhe se, në fakt, një hetim i tillë u krye.

476. Krimet në Pikat 28, 30, dhe 32 u kryen të gjithë në objektin e Jabllanicës ku u mbajtën të nëntë viktimat e përmendur në këto pika. Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se ushtarë të UÇK-së morën pjesë në keqtrajtimin e nëntë të burgosurve dhe në vrasjen e dy prej tyre. Të paktën dy nga të

²⁴¹⁷ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 1; Rrustem Tetaj, T. 3604-3605.

²⁴¹⁸ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafët 14-15, 29; Rrustem Tetaj, T. 3671.

²⁴¹⁹ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 29; Rrustem Tetaj, T. 3863, 3858-3859, 3863.

²⁴²⁰ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 29; Rrustem Tetaj, T. 3671, 3858-3859.

²⁴²¹ P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 30.

²⁴²² P265 (Rrustem Tetaj, deklaratë dëshmitari, 17 prill 2007), paragrafi 30.

burgosurit u liruan nga burgimi. Dhoma Gjyqësore ka marrë dëshmi për katë njerëz të identifikuar me emër, ndër të cilët Lahi Brahimaj, të cilët morën pjesë në keqtrajtim. Dhoma Gjyqësore nuk ka marrë dëshmi se kush vendosi për krijimin e objektit të burgimit, kur u mor një vendim i tillë, dhe se për çfarë qëllimi u krijua. Dhoma Gjyqësore ka marrë pak dëshmi për përfshirjen e ushtarëve të UÇK-së, që ishin jashtë Jabllanicës, në ngjarjet që ndodhën në këtë objekt. Një përjashtim i dukshëm, i përshkruar hollësisht në pjesën 6.17.2, më sipër, është ndërhyrja e Ramush Haradinajt dhe Rrustem Tetajt për të siguruar lirin e Skënder Kuqit nga burgimi. Megjithëse ngjarjet në objektin e Jabllanicës duket se tregojnë se krimet atje u kryen në mënyrë sistematike, dëshmitë që disponon Dhoma Gjyqësore janë të pamjaftueshme për të konkluduar për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal të të gjithë të Akuzuarve, siç pretendon Prokuroria. Kryerja e krimeve në Pikat 6, 14, 20, 28, 30, 32, 36, dhe 37 ndodhi gjatë një periudhe prej pesë muajsh në fshatra të ndryshme të tre komunave. Nga dëshmitë e paraqitura për pikat, Dhoma Gjyqësore nuk mund të konkludojë se këto krime u kryen sistematikisht nga anëtarët e UÇK-së, për realizimin e një qëllimi të vetëm.

477. Në pjesën 4.2, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka shqyrtuar dëshmi të tjera që kishin lidhje me çështjen e ekzistencës së një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, veçanërisht për serbet që u larguan nga shtëpitë e tyre gjatë periudhës së Aktakuzës. Megjithatë, në pjesën e lartpërmendur, Dhoma Gjyqësore arriti në përfundimin se përveç atyre që u larguan prej frikës të justifikuar ose të pajustificuar, se do të sulmoheshin nga UÇK-ja, ka patur gjithashtu të tjerë që u larguan për shkak të frikës mbizotëruese se do të ngecnin në një konflikt të armatosur midis forcave serbe dhe UÇK-së. Mbi bazën e këtyre dëshmive, Dhoma Gjyqësore nuk mund të arrinte në një përfundim të përgjithshëm lidhur me sulmin e pretenduar kundër popullsisë civile. Gjithashtu këto dëshmi nuk i mundësojnë Dhomës Gjyqësore të konkludojë për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal, të pretenduar nga Prokuroria.

478. Mbi bazën e dëshmive të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të përmendura më lart, Dhoma Gjyqësore nuk mund të konkludojë se UÇK-ja kishte si synim largimin e paligjshëm dhe keqtrajtimin e civilëve serbë ose keqtrajtimin e civilëve shqiptarë kosovarë dhe civilëve romë/egjiptianë kosovarë, dhe civilëve të tjerë, të cilët ishin bashkëpunorë të forcave serbe ose konsideroheshin sit ë tillë ose përndryshe, nuk përkrahnin UÇK-në. Rrjedhimisht, Dhoma Gjyqësore nuk është e bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për ekzistencën e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale në të cilën morën pjesë të tre të Akuzuarit, siç pretendon akuza. Dhoma Gjyqësore arrin në përfundimin se të tre të Akuzuarit duhet të shpallen të pafajshëm për Pikat 6, 14, 20, 22 (lidhur me vrasjen e Nurije dhe Istref Krasniqit dhe vrasjen e Sanije Balajt), 30, 36, and 37.

²⁴²³ Çelebiqi Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 458.

Gjithashtu Ramush Haradinaj dhe Idriz Balaj duhet të shpallen të pafajshëm për Pikat 28 dhe 32. Lahi Brahimaj nuk do të gjykohet përgjegjës për Pikat 28 dhe 32 si pjesëmarrës në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Dhoma Gjyqësore ka shqyrtuar format alternative të përgjegjësisë në lidhje me të për pikat e përmendura në pjesët 6.15 dhe 6.17.3, më sipër.

8. Fajësia e shumëfishtë

479. Dhoma Gjyqësore ka arritur në përfundimin se Lahi Brahimaj duhet të shpallet për akuzat e Pikave 28 dhe 32 sepse janë plotësuar elementët e krimeve të trajtimit mizor dhe torturës. Mirëpo mbi bazën e dispozitave të ndryshme statutores, shpallja e fajësisë së shumëfishtë për të ndëshkuar të njëjtën sjellje kriminale është e lejueshme vetëm nëqoftëse “çdo dispozitë statutores përkatëse ka një element materialisht të ndryshëm që nuk përfshihet në një dispozitë tjetër”, dhe një element është materialisht i ndryshëm “nëqoftëse kërkon vërtetimin e një fakti që nuk kërkohet nga një dispozitë tjetër statutores”.²⁴²⁴ Kur ky kriter nuk plotësohet, fajësia bazohet në dispozitën më konkrete.²⁴²⁵ Vepra penale më konkrete përfshin atë më pak konkrete, sepse kryerja e saj nënkupton domosdoshmërisht kryerjen e veprës më pak konkrete.²⁴²⁶

480. Elementët e secilës prej dy veprave penale të torturës dhe trajtimit mizor janë analizuar në pjesën 5.1.2, më sipër. Të dy veprat penale kërkojnë që viktima të ketë pësuar dëmtime të rënda trupore apo mendore, dëmtimi duhet të jetë rezultat i një veprimi apo mosveprimi, dhe veprimi i kryesit duhet të ketë qenë i qëllimshëm. Vepra penale e torturës ka një element shtesë që konsiston në faktin se veprimi apo mosveprimi duhet të jetë kryer me një qëllim të caktuar, p.sh. për të marrë informacion apo një pohim, për të ndëshkuar, frikësuar, apo detyruar viktimën apo një person të tretë, ose për të diskriminuar, për çfarëdo arsye, viktimën apo një person të tretë. Vepra penale e trajtimit mizor nuk kërkon vërtetimin e ndonjë elementi shtesë, përveç atyre të kërkuara për torturën. Rrjedhimisht në ato raste kur veprat penale të torturës dhe trajtimit mizor burojnë nga e njëjta sjellje kriminale e të Akuzuarit, Dhoma Gjyqësore do të shpallë fajësinë vetëm në lidhje me akuzën e torturës.

481. Në këtë çështje Dhoma Gjyqësore është e bindur se Lahi Brahimaj ka kryer krimet e trajtimit mizor dhe torturës, akuza të pikave Pikave 28 dhe 32. Sa i përket Pikës 28, kjo buron nga e njëjta sjellje kriminale dhe, për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore do të shpallë fajësi vetëm për tortura. Mirëpo në lidhje me Pikën 32, Dhoma Gjyqësore konstatoi dy incidente të sjelljes kriminale, të veçuara në kohë dhe hapësirë. Sjellja në incidentin e parë ishte e barasvlefshme me trajtim mizor dhe torturë, dhe, për këtë arsye, mbi bazën e fajësisë së shumëfishtë, Dhoma Gjyqësore do të shpallë fajësi vetëm për torturë. Sjellja në incidentin e dytë ishte e barasvlefshme vetëm me trajtim mizor. Për këtë incident Dhoma Gjyqësore do të shpallë fajësi për trajtim mizor.

²⁴²⁴ *Çelebiqi* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 412; *Jelisiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 78; *Kupreshkiq e të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 387; *Kunarac e të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafët 168, 173; *Kërstiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 218; *Stakiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 355; *Naletiliq dhe Martinoviq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 584; *Galiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 163.

²⁴²⁵ *Çelebiqi* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 413; *Jelisiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 79; *Kupreshkiq e të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 387; *Kunarac e të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 168; *Kërstiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 218; *Stakiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 355; *Galiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 163.

²⁴²⁶ *Kërstiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 218; *Galiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 163.

9. Përcaktimi i dënimit

9.1 Kuadri ligjor për përcaktimin e dënimit

482. Dispozitat përkatëse të Statutit dhe Rregullores së Tribunalit janë:

Neni 24 i Statutit

Dënimet

1. I vetmi dënim që cakton Dhoma Gjyqësore është burgimi. Në përcaktimin e kushteve të burgimit, Dhomat Gjyqësore i referohen praktikës së përgjithshme të dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë.
2. Gjatë përcaktimit të dënimit, Dhomat Gjyqësore duhet të mbajnë parasysh faktorë të tillë si pesha e krimit dhe rrethanat individuale të fajtorit
3. Përveç burgimit, Dhomat Gjyqësore mund të urdhërojnë kthimin te pronarët e ligjshëm të çdo prone ose të ardhure të siguruar nëpërmjet veprimeve kriminale, ndër të tjera nëpërmjet shtrëngimit.

Rregulla 101

Dënimet

- (A) Personi i shpallur fajtor mund të dënohet me burgim për një periudhë deri në burgim të përjetshëm.
- (B) Në përcaktimin e dënimit, Dhoma Gjyqësore merr parasysh faktorët e përmendur në paragrafin 2 të Nenit 24 të Statutit dhe faktorë të tillë si:
- (i) rrethana rënduese;
 - (ii) rrethana lehtësuese duke përfshirë bashkëpunimin thelbësor të fajtorit me Prokurorin para ose pas shpalljes së fajësisë;
 - (iii) praktikën e përgjithshme të dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë;
 - (iv) masën e kryer të dënimit që i është dhënë fajtorit nga gjykata e ndonjë shteti për të njëjtën vepër, siç përmendet në paragrafin 3 të Nenit 10 të Statutit.
- (C) periudha, gjatë së cilës fajtori është mbajtur i paraburgosur në pritje të dorëzimit në Tribunal ose në pritje të gjykimit apo apelimit, zbritet prej kohëzgjatjes së dënimit me burgim.

483. Në përcaktimin e një dënimi duhet të merren parasysh faktorët e mëposhtëm: (i) sa të rënda janë veprat penale si dhe tërësia e sjelljes së fajshme; (ii) rrethanat individuale të fajtorit, duke

përshirë rrethanat lehtësuese; (iii) praktika e përgjithshme e dënimeve me burgim në gjykatat e ish-Jugosllavisë; (iv) llogaritja e periudhës së paraburgimit në pritje të dorëzimit në Tribunal ose në pritje të gjykimit ose apelit brenda kohëzgjatjes së dënimit me burgim; (v) masa e kryer e dënimit që i është dhënë fajtorit nga gjykata e ndonjë shteti për të njëjtën veprë, siç përmendet në paragrafin 3 të Nenit 10 të Statutit..²⁴²⁷ Faktori i fundit nuk është i vlefshëm për këtë rast.

9.2 Qëllimi i dënimit

484. Jurisprudenca e Tribunalit tregon se dy qëllimet kryesore të dënimit janë ndëshkimi dhe parandalimi.²⁴²⁸

485. Si formë ndëshkimi, dënimi shpreh kundërvënien e shoqërisë ndaj veprimit kriminal dhe kryesit të tij.²⁴²⁹ Rrjedhimisht, për realizimin e qëllimit të ndëshkimi, Dhoma Gjyqësore duhet të përcaktojë një dënim që pasqyron siç duhet fajësinë individuale të keqbërësit.²⁴³⁰ Dhoma Gjyqësore gjykon se ky qëllim pasqyrohet në detyrimin që ka Dhoma Gjyqësore për të marrë parasysh se sa të rënda janë veprat penale ose tërësinë e sjelljes së fajshme.

486. Parandalimi i veçantë dhe i përgjithshëm janë dy qëllime të rëndësishme të dënimit në të drejtën penale.²⁴³¹ Arsyeja e parandalimit të veçantë është shkurajimi i keqbërësit prej përsëritjes së shkeljeve në të ardhmen, kurse parandalimi i përgjithshëm synon të shkurajojë të tjerët që të mos kryejnë krime të ngjashme.²⁴³² Në rastin konkret, si dhe duke marrë parasysh rrethanat në të cilat u kryen krimet, Dhoma Gjyqësore mendon se rreziku që Lahi Brahimaj mund të kryejë të njëjtat krime në të ardhmen është shumë i vogël, faktor që pakëson dukshëm rëndësinë e parandalimit të veçantë.

487. Për sa i përket parandalimit të përgjithshëm, personat që mendojnë se janë të paprekshëm prej të drejtës penale ndërkombëtare, duhet të paralajmërohen se ata duhet të respektojnë normat e përcaktuara në të drejtën penale të mirëfilltë ose përndryshe do të procedohen penalisht dhe, nëqoftëse shpallen fajtorë, do të dënohen.²⁴³³ Dhoma Gjyqësore mendon se një dënim i përshtatshëm për të Akuzuarin në këtë çështje kontribuon, në mënyrë thelbësore, në arritjen e një efekti të përgjithshëm parandalues.

²⁴²⁷ *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 679.

²⁴²⁸ *Aleksovski* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 185; *Çelebiqi* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 806; *Stakiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 402.

²⁴²⁹ *Jokiq* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore për Dënimin, paragrafi 31; *Mërgja* Aktgjykimi për Dënimin, paragrafi 14.

²⁴³⁰ *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 1075.

²⁴³¹ *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 1076.

²⁴³² *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafët 1077-1078; *Dragan Nikoliq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 45.

²⁴³³ *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 1078.

488. Rehabilitimi konsiderohet gjithashtu si qëllim i vlefshëm i dënimit, megjithëse më pak i rëndësishëm.²⁴³⁴

9.3 Faktorët në përcaktimin e dënimit

9.3.1 Sa të rënda janë veprat penale dhe tërësia e sjelljes së fajshme

489. Faktori kryesor që merret parasysh në dhënien e vendimit është se sa të rënda janë veprat penale.²⁴³⁵ Dhoma Gjyqësore e gjykon të përshtatshme të shqyrtojë rrezikshmërinë e veprave penale të kryera nga i Akuzuari së bashku me rrethanat e tjera rënduese, pasi shqyrtimi i shkëputur i këtyre dy aspekteve do të ishte artificial .²⁴³⁶ Duke zbatuar këtë përqasje, Dhoma Gjyqësore shmang rrezikun që një faktor i caktuar të merret dy herë parasysh në marrjen e vendimit, gjë që është e palejueshme sipas Dhomës së Apelit.²⁴³⁷ Përcaktimi i rrezikshmërisë së krimit për dhënien e dënimit të përshtatshëm kërkon shqyrtimin e rrethanave të veçanta të çështjes, si dhe formën dhe shkallën e pjesëmarrjes së fajtorit në krim.²⁴³⁸ Rrethanat rënduese duhet të kenë lidhje të drejtpërdrejtë me veprën penale për të cilin është paraqitur akuza.²⁴³⁹ Dhoma Gjyqësore ka kompetencë të përcaktojë nëse përgjegjësia e drejtpërdrejtë, në bazë të Nenit 7 (1) të Statutit, rëndohet nga pozita eprore e kryesit të krimit.²⁴⁴⁰ Vetëm faktorë, të cilët janë vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, do të merren parasysh si rrethana rënduese.²⁴⁴¹

490. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar dëshmi që Lahi Brahimaj mori pjesë personalisht në rrahjet e përsëritura të Dëshmitarit 6 gjatë një periudhe prej afro katër javësh. Në disa raste, Lahi Brahimaj ishte i pranishëm kur rrahjet bëheshin nga ushtarë të tjerë. Gjithashtu Lahi Brahimaj solli personalisht një viktimë tjetër, Dëshmitarin 3, nga një shtëpi në Zhabel dhe më pas e mbylli atë në një dhomë në objektin e Jabllanicës. Pak pasi Lahi Brahimaj kishte dalë nga dhoma, në të hynë disa burra të cilët e rrahën Dëshmitarin 3 me shkopinj deri sa ai humbi vetëdijen. Më pas Lahi Brahimaj e futi Dëshmitarin 3 në një dhomë kur e mori personalisht në pyetje në prani të disa personave të tjerë. Pastaj Lahi Brahimaj u kërkoi dy grave që ishin të pranishme në dhomë “të praktikoheshin” me Dëshmitarin 3. Këto dy persona goditën duart e Dëshmitarit 3 për pesë deri në dhjetë minuta

²⁴³⁴ *Celebiqi* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 806; *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 1079; *Stakiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 402.

²⁴³⁵ *Aleksovski* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 182; *Çelebiqi* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 731; *Kupreshkiq dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 442; *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 683; *Momir Nikoliq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 11; *Galiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 442.

²⁴³⁶ *Bralo* Aktgjykimi për Dënimin, paragrafi 27; *Krajishnik* Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 1139.

²⁴³⁷ *Deronjiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafët 106-107; *Limaj* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 143.

²⁴³⁸ *Aleksovski* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 182; *Furunxhija* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 249; *Çelebiqi* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 731; *Jelisiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 101; *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 683; *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 1061; *Dragan Nikoliq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 18; *Babiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 39; *Galiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 409.

²⁴³⁹ *Stakiq* Aktgjykim, paragrafi 911.

²⁴⁴⁰ *Aleksovski* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 183; *Çelebiqi* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 745; *Kupreshkiq dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 451; *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafët 90-91; *Naletiliq dhe Martinoviq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 613.

²⁴⁴¹ *Celebiqi* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 763.

duke përdorur një instrument teleskopik. Gjatë këtij incidenti, Lahi Brahimaj i dha Dëshmitarit 3 një pistoletë dhe e nxiti të vriste veten. Një person tjetër që ishte i pranishëm kërcënoi se do t'i priste viktimës fytyrën. Gjatë një incidenti tjetër të mëvonshëm, Lahi Brahimaj e çoi Dëshmitarin 3, nën grykën e armës, me makinë në një shtëpi, ku më pas erdhi edhe një grua. Lahi Brahimaj dhe gruaja, pasi e rrahën viktimën me shpulla, e detyruan të futej në makinë dhe u larguan. Gjatë rrugës Lahi Brahimaj ngiste makinën, ndërsa gruaja mbante armën e drejtuar në kokën e viktimës. Në një moment Lahi Brahimaj ndaloi makinën dhe e futi Dëshmitarin 3 në bagazhin e makinës. Më pas, Lahi Brahimaj hapi bagazhin, nxorri armën nga brezi dhe e pyeti Dëshmitarin 3 nëse duhej t'a shkrehte armën. Kur Dëshmitari 3 u përgjigj pozitivisht, ai hapi zjarr. Për një moment Dëshmitari 3 mendoi se ishte qëlluar, por menjëherë e kuptoi se një gjë e tillë nuk kishte ndodhur. Në pjesët 6.15 dhe 6.17.3, më sipër, Dhoma Gjyqësore ka konkluduar se Lahi Brahimaj duhet të shpallet fajtor për dy akuza torture dhe një akuzë të trajtimit mizor.

491. Lahi Brahimaj ka mbajtur poste të larta në UÇK. Ai nuk ishte vetëm anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, por për një farë kohe në qershor dhe në fillim të korrikut 1998 ishte edhe zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit.²⁴⁴² Këto poste të larta, megjithëse ai nuk ishte zëvendëskomandant kur u krye shumica e krimeve, konsiderohen faktorë rëndues. Dhoma Gjyqësore ushtron gjithashtu kompetenën e vetë gjyqësore e vet në këtë aspekt, pasi Brahimaj i kreu krimet në prani të ushtarëve vartës të UÇK-së dhe ishte i pranishëm kur ushtarë të tjerë vepruan në mënyrë të ngjashme. Dhoma Gjyqësore gjykon se padyshim që kjo mund të ketë patur ndikim nxitës ndaj ushtarëve që ata të kryenin apo të vazhdonin të kryenin krime të tilla. Eprorët duhet të jenë të parët që nuk duhet të përfshihen në kryerjen e krimeve, në mënyrë që të tjerët të mos mendojnë se një përfshirje e tillë është e lejueshme dhe se veprimi duhet imituar.

492. Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh gjendjen veçanërisht të rrezikuar të Dëshmitarit 3 dhe Dëshmitarit 6 kur ishin të izoluar.²⁴⁴³ Ata ishin jo vetëm të privuar nga liria, por edhe të mbajtur në kushte të tilla, që ata të ishin tërësisht në mëshirën e atyre që i mbanin në Jabllanicë. Së fundi, Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh traumën fizike dhe mendore të pësuar dhe ende të përjetuar nga të dy viktimat.²⁴⁴⁴ Dëshmitari 6 dëshmoi se pa rrahjen e Skënder Kuqit dhe më pas mësoi se ai ishte dërguar për mjekim në Gllogjan ku vdiq. Duke mësuar për fatin e këtij të burgosuri tjetër, në një kohë kur ai vetë ishte i burgosur dhe i keqtrajtuar, Dëshmitari 6 duhet të ketë patur frikë edhe më të madhe për jetën e tij. Gjithashtu, Dëshmitari 6 dëshmoi për dhimbje të përhershme në të gjithë trupin dhe paaftësi për kryerjen e punëve fizike, të gjitha këto si rezultat i trajtimit që kishte

²⁴⁴² Jakup Krasniqi T. 5009, 5055-5056, 5070, 5075, 5077-5078, 5138, 5140-5141; Rrustem Tetaj T. 3657-3658, 3661, 3744; P141 (Procesverbali i mbledhjes së shtabit të Dukagjinit më 23 qershor 1998), f. 6-8; P142 (Procesverbali i hollësishtëm i mbledhjes së shtabit të Dukagjinit më 23 qershor 1998), f. 3.

²⁴⁴³ See *Kunarac dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 352; *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 683; *Deronjiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 124.

²⁴⁴⁴ *Vasileviq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 167; *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 683.

pësuar në Jabllanicë. Në kohën kur dha dëshminë në vitin 2007, Dëshmitari 6 ende merrte ilaçe për lëndime që i ishin shkaktuar afërsisht para dhjetë vitesh.

493. Dhoma Gjyqësore ka arritur në përfundimin se Lahi Brahimaj duhet të shpallet fajtor për dy rastet e torturës dhe një rast të trajtimit mizor. Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh se sa të rënda ishin këto krime në vetvete si dhe faktin se Lahi Brahimaj, i cili ka patur poste të larta në UÇK, mori pjesë drejtpërdrejtë në kryerjen e tyre. Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh gjithashtu gjendjen e rrezikuar të viktimave dhe traumat fizike dhe mendore të përjetuara prej tyre. Të gjitha këta faktorë përbëjnë rrezikshmërinë e veprës penale dhe tërësinë e sjelljes në këtë çështje.

9.3.2 Rrethanat individuale të Lahi Brahimajt

494. Pranimi dhe zbatimi i rrethanave lehtësuese nuk do të thotë se krimi i kryer është më pak i rëndë.²⁴⁴⁵ Faktorë të tillë duhet të provohen mbi bazën e barazpeshimit të gjasave.²⁴⁴⁶ I vetmi faktor lehtësues që përmendet në mënyrë konkrete në Rregullore është “bashkëpunimi thelbësor i fajtorit me Prokurorin para apo pas shpalljes së fajësisë”.²⁴⁴⁷ Faktorë të tjerë lehtësues përfshijnë: dorëzimin vullnetar;²⁴⁴⁸ karakterin e mirë, ku përfshihet mungesa e precedentëve penalë;²⁴⁴⁹ sjelljen e mirë gjatë paraburgimit;²⁴⁵⁰ rrethanat individuale dhe familjare;²⁴⁵¹ dhe moshën.²⁴⁵² Dorëzimi vullnetar përbën faktor lehtësues pasi është me përfitim të konsiderueshëm për bashkësinë ndërkombëtare dhe mund të inkurajojë të akuzuar të tjerë, që të dorëzohen në të ardhmen.²⁴⁵³ Sjellja e mirë gjatë paraburgimit, edhe po të jetë e dokumentuar mirë, nuk ka peshë të rëndësishme si faktor lehtësues.²⁴⁵⁴ Moshja e re e personit të akuzuar në kohën e kryerjes së krimeve mund të merret parasysh, me kujdes, si faktor lehtësues.²⁴⁵⁵ Përgjithësisht, të akuzuarve, që janë 25 vjeç në kohën e kryerjes së krimeve të tyre, nuk do t'u merret parasysh moshja si faktor lehtësues.²⁴⁵⁶

495. Mbrojtja e Brahimajt nuk ka paraqitur argumente lidhur me faktorë lehtësues, duke përfshirë ndonjë rrethanë personale.²⁴⁵⁷ Megjithatë, Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë informacionin që disponon përpara se të përcaktojë nëse ekzistojnë rrethana lehtësuese. Lahi Brahimaj iu dorëzua

²⁴⁴⁵ *Erdemoviq* Aktgjykimi për Dënimin, paragrafi 46; *Bralo* Aktgjykimi për Dënimin, paragrafi 42; *Zelenoviq* Aktgjykimi për Dënimin, paragrafi 44.

²⁴⁴⁶ *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 697.

²⁴⁴⁷ Rregulla 101 (B) (ii).

²⁴⁴⁸ *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 696; *Babiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 43.

²⁴⁴⁹ *Kupreshkiq dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 459; *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 696; *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 1090; *Babiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 43.

²⁴⁵⁰ *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafët 696, 728; *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 1091; *Babiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 43; *Blagoje Simiq dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 266.

²⁴⁵¹ *Kunarac dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafët 362 dhe 408; *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 696; *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 1091; *Babiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 43; *Simiq dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 266

²⁴⁵² *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 696; *Babiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 43; *Simiq dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 266.

²⁴⁵³ *Naletliq dhe Martinoviq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 600.

²⁴⁵⁴ *Momir Nikoliq* Aktgjykimi për Dënimin, paragrafi 168; *Deronjiq* Aktgjykimi për Dënimin, paragrafi 273.

²⁴⁵⁵ *Furunxhija* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 284; *Jelisiq* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 124; *Banoviq* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 75-76; *Oriq* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 756-757.

²⁴⁵⁶ *Çeshiq* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 91; *Mërgja* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafi 93; *Bralo* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 47-48; *Oriq* Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore, paragrafët 756-757.

²⁴⁵⁷ T. 11195-11197.

vullnetarisht Tribunalit sapo mësoi për Aktakuzën kundër tij.²⁴⁵⁸ Dhoma Gjyqësore gjykon se ky është një faktor lehtësues. Për Lahi Brahimajn u paraqitën letra reference në mbështetje të kërkesave të tij për lirim të përkohshëm, ku letërshkruesit dëshmonin për karakterin e mirë të Lahi Brahimajt.²⁴⁵⁹ Mirëpo përmbajtja e këtyre letrave është kaq e përgjithshme sa që Dhoma Gjyqësore nuk mund t'i marrë ato parasysh si rrethanë lehtësuese. Lahi Brahimaj ka katër fëmijë të moshës katër deri në nëntë vjeç.²⁴⁶⁰ Dhoma Gjyqësore është e ndërgjegjshme se burgimi i çdo të Akuzuari i shkakton vështirësi familjes së tij dhe, për këtë arsye, ajo do të marrë parasysh rrethanat familjare të Lahi Brahimajt në vlerësimin e faktorëve lehtësues. Sipas vendimeve të mëparshme të marra në këtë çështje, Lahi Brahimaj ishte i disponueshëm për intervistën me hetuesit e Prokurorisë, gjë që tregoi një farë gatishmërie për bashkëpunim me Prokurorinë.²⁴⁶¹ Por meqë paraqitja e tij vullnetare për intervistë nuk ishte me rëndësi thelbësore, veçanërisht për faktin se informacioni i dhënë prej tij ishte i kufizuar, ky fakt nuk do të merret parasysh në vlerësimin e rrethanave lehtësuese. Duke qenë se nuk ekziston dokumentacion lidhur me sjelljen e Lahi Brahimajt në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara (NJPKB), Dhoma Gjyqësore nuk mund t'a marrë këtë faktor në konsideratë. Lahi Brahimaj ishte 28 vjeç kur u kryen krimet dhe 38 vjeç kur u shpall ky Aktgjykim.²⁴⁶² Në shpalljen e këtij Aktgjykimi Lahi Brahimaj nuk është kaq i moshuar që do t'ia bënte burgimin më të vështirë se sa për të tjerët, dhe, po ashtu, kur u kryen krimet mosha e tij nuk ishte aq e re sa të mendohet se ai ishte më pak i përgjegjshëm për veprimet e tij se sa të tjerët.

496. Si përfundim, Dhoma Gjyqësore i ka konsideruar dorëzimin vullnetar të Lahi Brahimajt në Tribunal si dhe gjendjen e tij familjare, si rrethana lehtësuese.

9.3.3 Praktika e përgjithshme e dënimeve me burgim të gjykatave të ish-Jugosllavisë

497. Në përcaktimin e dënimit të duhur Dhoma Gjyqësore duhet të marrë parasysh “praktikën e përgjithshme lidhur me dënimet me burgim të gjykatave të ish-Jugosllavisë”. Kjo nuk do thotë se Dhoma Gjyqësore është e detyruar të veprojë në përputhje me këtë praktikë.²⁴⁶³ Dhoma Gjyqësore mund të miratojë një dënim më të ashpër se dënimet që jepen në bazë të ligjit përkatës në ish-Jugosllavi, dhe Dhoma e Apelit ka vlerësuar se një praktikë e tillë në dhënien e vendimeve nuk shkel parimin *nulla poena sine lege*, sepse i akuzuari duhet të ketë qenë i vetëdijshëm se krimet për

²⁴⁵⁸ Vendimi mbi Mocionin në emër të Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 14 dhjetor 2007, paragrafët 8, 13.

²⁴⁵⁹ Vendimi i Mëtejshëm mbi Mocionin për Lirimin e Përkohshëm të Lahi Brahimajt, 3 maj 2006, paragrafi 32; Vendimi mbi Mocionin në Emër të Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 14 dhjetor 2007, paragrafi 8.

²⁴⁶⁰ Vendimi mbi Mocionin në Emër të Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 14 dhjetor 2007, paragrafët 10, 21.

²⁴⁶¹ Vendimi për Apelimin e ndërkohshëm të Lahi Brahimajt të Vendimit të Dhomës Gjyqësore që Refuzoi Lirimin e tij të Përkohshëm, 9 mars 2006, paragrafët 12-18; Vendimi i Mëtejshëm mbi Mocionin për Lirimin e Përkohshëm të Lahi Brahimajt, 3 maj 2006, paragrafi 31.

²⁴⁶² Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Katërt, 16 tetor 2007, paragrafi 11.

²⁴⁶³ *Tadiq* Aktgjykim i Apelit, paragrafi 21; *Çelebiq* Aktgjykim i Apelit, paragrafët 813, 816 dhe 820; *Jelisiq* Aktgjykim i Apelit, paragrafi 117; *Kupreshkiq dhe të tjerë* Aktgjykim i Apelit, paragrafi 418; *Kunarac dhe të tjerë* Aktgjykim i Apelit, paragrafët 347-349; *Krstiq* Aktgjykim i Apelit, paragrafi 260; *Blashkiq* Aktgjykim i Apelit, paragrafët 681-682; *Kordiq dhe Çerkez* Aktgjykim i Apelit, paragrafi 1085; *Dragan Nikoliq* Aktgjykim për Apelimin e Dënimit, paragrafët 17, 69; *Jokiq* Aktgjykim për Apelimin e Dënimit, paragrafi 38; *Galiq* Aktgjykim i Apelit, paragrafi 398.

të cilat ai apo ajo është akuzuar përbëjnë shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtar dhe se, si të tilla, ato ndëshkohen me dënime më të ashpra.²⁴⁶⁴ Për më tepër, dënime të miratuara nga Dhoma Gjyqësore mund të jenë të ndryshme nga praktika e dënimeve që zbatohet në ish-Jugosllavi nëqoftëse një praktikë e tillë nuk është e përshtatshme në bazë të së drejtës ndërkombëtare.²⁴⁶⁵

498. Neni 24 (1) i Statutit dhe Rregulla 101 (B) (iii) e Rregullores i referohen praktikës aktuale së gjykatave në ish-Jugosllavi. Mirëpo në bazë të praktikës tashmë të konsoliduar të Tribunalit, burimet që duhet konsultuar në bazë të këtyre dispozitave nuk kufizohen në jurisprudencën e ish-Jugosllavisë, por në to përfshihen edhe dispozitat statutoare që ishin në fuqi në ish-Jugosllavi në kohën e kryerjes së krimeve në fjalë.²⁴⁶⁶ E drejta penale në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, përse u përket krimeve të luftës, ishte rregulluar në bazë të Kodit Penal të miratuar nga Kuvendi Federal i RSFJ-së më 28 shtator 1976 dhe i hyrë në fuqi që më 1 korrik 1977 (“Kodi Penal”).²⁴⁶⁷ Kodi ndëshkon krimet e luftës kundër civilëve, ndër të cilat vrasjet, torturën dhe trajtimin çnjerrëzor me një dënim minimal prej pesë vjet burg ose dënim me vdekje, ose, në vend të dënimit me vdekje, me 20 vjet burg.²⁴⁶⁸

499. Në përcaktimin e dënimit për këtë çështje Dhoma Gjyqësore i ka marrë në konsideratë këta faktorë që lidhen me praktikën e dhënies së dënimeve në ish-Jugosllavi.

²⁴⁶⁴ *Tadiq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 21; *Çelebiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 817; *Krstiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 262; *Blashkiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 681; *Stakiq* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 398; *Simiq dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 264.

²⁴⁶⁵ *Kunarac dhe të tjerë* Aktgjykimi i Apelit, paragrafi 377.

²⁴⁶⁶ *Dragan Nikoliq* Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, paragrafi 85.

²⁴⁶⁷ Neni. 104 (1) i Kodit Penal.

²⁴⁶⁸ Nenet 38 (2), 142 të Kodit Penal.

9.3.4 Përfitimi i kohës së paraburgimit

500. Sipas Rregullës 101 (C) periudha gjatë së cilës personi i dënuar ka kaluar në paraburgim në pritje të dorëzimit të tij në Tribunal ose në pritje të procesit gjyqësor, llogaritet brenda kohëzgjatjes së dënimit. Lahi Brahimaj u dorëzua dhe u transferua në NJPKB më 9 mars 2005. Ai ka qenë në paraburgim që nga ajo ditë, me përjashtim të lirit të tij të përkohshëm nga 21 dhjetor deri më 4 janar 2008. Për këtë arsye, Lahi Brahimaj ka të drejtë të përfitojë 1,109 ditë.

9.4 Përcaktimi i dënimit

501. Dhoma Gjyqësore ka marrë parasysh të gjitha rrethanat e lartpërmendura dhe gjykom se dënimi i përshtatshëm në këtë rast është një dënim i vetëm prej 6 vjet burg. Siç u përmend më sipër, Lahi Brahimaj ka të drejtë të përfitojë kohën e paraburgimit, e cila deri ditën e shpalljes së vendimit arrin në 1,109 ditë.

10. Vendim

502. Dhoma Gjyqësore e shpall Ramush Haradinajn **TË PAFAJSHËM** për të gjitha Pikat e Aktakuzës. Në bazë të Rregullës 99 (A) të Rregullores, Dhoma Gjyqësore urdhëron që Ramush Haradinaj të lirohet menjëherë nga Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara.

503. Dhoma Gjyqësore, me përjashtim të Gjykatësit Höpfel, e shpall Idriz Balajn **TË PAFAJSHËM** për të gjitha Pikat e Aktakuzës. Në bazë të Rregullës 99 (A) të Rregullores, Dhoma Gjyqësore urdhëron që Idriz Balaj të lirohet nga Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara pasi të jenë marrë masat e nevojshme praktike për transferimin e tij tek autoritetet kompetente për zbatimin e dënimit që po vuante në kohën e transferimit të tij në selinë e Tribunalit.

504. Dhoma Gjyqësore e shpall Lahi Brahimajn **FAJTOR** për akuzat e mëposhtme të Aktakuzës:

Pika 28: Torturë si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës;

Pika 32: Torturë dhe trajtim mizor si shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës;

por e shpall Lahi Brahimajn **TË PAFAJSHËM** për të gjitha pikat e tjera të Aktakuzës.

505. Përfundimisht Dhoma Gjyqësore e dënon Lahi Brahimajn me një dënim të vetëm me 6 vjet burg. Në bazë të Rregullës 101 (C) të Rregullores, ai ka të drejtë të përfitojë kohën e kaluar në paraburgim, e cila deri në datën e këtij vendimi arrin në 1,109 ditë. Në bazë të Rregullës 103 (C) të Rregullores, Lahi Brahimaj do të mbahet në paraburgim në Tribunal deri në marrjen e masave për transferimin e tij në shtetin ku do të vuajë dënimin.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti anglisht ka përparësi.

Sot më 3 prill 2008
Në Hagë
Holandë

/Nënshkruar në original/

Kryegjykatësi Alphons Orië

/Nënshkruar në original/

Gjykatësi Frank Höpfel

/Nënshkruar në original/

Gjykatësi Old Bjørn Støle

11. Mendimi pjesërisht mospajtues i Gjykatësit Höpfel për Pikën 14

1. Në këtë Aktgjykim, Dhoma Gjyqësore konkludoi se ushtarë të UÇK-së kishin kryer vrasjet e nënës së Dëshmitarëve 4 dhe 19, motrës së tyre “S”, dhe motrës së tyre “M”, siç përshkruhet në pjesën 6.8 të Aktgjykimit. Dhoma Gjyqësore konkludoi gjithashtu se Idriz Balaj e shoqëroi motrën “S” kur ajo u rekrutua në UÇK dhe më pas, dhe se ai ishte i pranishëm kur nëna dhe motra e saj “M” u morën nga shtëpia.

2. Megjithëse pajtohem me konstatimet e Dhomës Gjyqësore për Pikën 14 përsa u përket çështjeve të lartpërmendura, me respect shpreh mospajtimin me përfundimin e shumicës se nuk ekzistojnë prova që vërtetojnë se Idriz Balaj, me vetëdije, kontribuoi, ose lehtësoi kryerjen e vrasjes së motrës "S". Nëpërmjet këtij mendimi dëshiroj të shpjegoj mospajtimin tim.

3. Siç u përmend më sipër, Idriz Balaj e shoqëroi motrën “S” disa herë kur ajo u rekrutua në UÇK dhe më pas, sipas mënyrës së përshkruar. Ai ishte gjithashtu i pranishëm kur morën nënën dhe motrën e saj “M” nga shtëpia. Këto fakte, sipas mendimit tim, vërtetojnë se ai dha ndihmë thelbësore në kryerjen e tri vrasjeve. Sipas mendimit tim, kontributi i tij nuk ishte thjesht një hallkë në zinxhirin e ngjarjeve të secilit prej tre incidenteve, porse nëpërmjet këtij kontributi ai dha mbështetje thelbësore në kryerjen e vrasjeve, pasi duke i vendosur viktimat nën kontrollin e UÇK-së në këtë mënyrë, ato u ballafaquan me rrezik të drejtpërdrejtë dhe të rëndë. Ky rrezik në fakt u materializua dhe rezultoi në vdekjen e tyre.

4. Dëshmitari 4 deklaroi se gjatë vizitave të tij në këtë familje, Idriz Balaj luajti një rol udhëheqës në të gjitha këto incidente: “[...] në çdo rast që ata erdhën, Togeri ishte numri një”.²⁴⁶⁹ Siç përmendet më sipër në pjesën 6.8, sipas rrëfimeve të Dëshmitarëve 4 dhe 19 të bazuara në thashetheme të besueshme, motra “S” mori urdhra nga Togeri. Dëshmitari 4 dëshmoi se Togeri kishte kërcënuar se do t'a vriste motrën “S” nëqoftëse ajo nuk i bindej urdhrave të tij për të vrarë dikë. Sipas Dëshmitarit 19, Togeri e kishte udhëzuar atë [motrën “S”] të kthehej në bazë brenda një ore të caktuar pas vizitës së saj të dytë. Siç u deklarua nga Dëshmitari 4, Togeri erdhi për të kërkuar motrën “S” pas vizitës së saj të dytë. Kjo do të thotë se përveç pozicionit të tij epror që kishte ndaj familjes së pambrojtur dhe të paarmatosur, Idriz Balaj kishte një marrëdhënie veçanërisht të ngushtë me motrën “S”, e cila karakterizohej nga kontrolli i tij i fortë dhe frikësues ndaj saj. Për më tepër, besimi i Idriz Balajt se jeta dhe vdekja e saj ishin në dorën e tij, u pasqyrua dukshëm prej kërcënimit të tij të lartpërmendur me vdekje.

²⁴⁶⁹ Dëshmitari 4, T. 1533-1534.

5. Sipas Dëshmitarit 4, motra “S” i tha gjatë vizitës së saj të dytë pas rekrutimit në UÇK se ajo banonte në shtabin e UÇK-së në shkollën e vjetër në Irzniq. Kjo mbështetet nga dëshmia e Dëshmitarit 19, sipas të cilit motra “S” i kishte thënë se duhej të kthehej në bazë brenda një kohe të caktuar, si dhe nga deklarata e Dëshmitarit 4, se ai e kishte shoqëruar atë gjatë një pjesë të rrugës për në Irzniq. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar edhe dëshmi të tjera, të paraqitura në pjesën 6.19 më sipër, të cilat flasin për praninë e Idriz Balajt në shtabin e UÇK-së në Irzniq. Duke patur parasysh rolin kryesor të Idriz Balajt në përndjekjen e familjes, si dhe marrëdhënien e tij veçanërisht të ngushtë me motrën “S” dhe kontrollin e tij të fortë ndaj saj, unë konkludoj se ai ishte i vetëdijshëm se motra “S” do të vritej, dhe se ai ishte i vetëdijshëm se marrja e motrës “S” dhe kontrolli i fortë ndaj saj do të ndihmonte në kryerjen e këtij krimi. Sipas mendimit tim, informacioni i hollësishëm që disponon Dhoma Gjyqësore lidhur me kontrollin e Idriz Balajt ndaj motrës “S”, është i mjaftueshëm për vërtetimin e gjendjes mendore kriminale për ndihmë dhe inkurajim në vrasjen e motrës “S”, në dallim me gjendjen mendore përkatëse lidhur me dy viktimat e tjera.

6. Rrjedhimisht, jam i bindur jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Idriz Balaj është fajtor për ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e vrasjes së motrës “S”, faktor që, sipas mendimit tim, duhej të kishte rezultuar në fajësinë e tij për Pikën 14.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti anglisht ka përparësi.

Sot më 3 prill 2008

Në Hagë

Hollandë

/Nënshkruar në origjinal/

Gjykatësi Frank Höpfel

Shtojca

A. Historia Proedurale

1. *Aktakuzat.* Aktakuza fillestare kundër Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, dhe Lahi Brahimajt u konfirmua më 4 mars 2005.²⁴⁷⁰ Më 26 prill 2006, Prokuroria kërkoi leje për ndryshimin e Aktakuzës fillestare për të shtuar dy pika të reja si dhe një numër pretendimesh të reja.²⁴⁷¹ Më 25 tetor 2006, Dhoma Gjyqësore II konfirmoi Aktakuzën e Ndryshuar.²⁴⁷² Po atë ditë, Prokuroria kërkoi leje për të bërë ndryshime të tjera në Aktakuzën e Ndryshuar.²⁴⁷³ Ndërkohë që ende nuk ishte marrë vendim për këtë mocion, Prokuroria kërkoi leje për të ndryshuar Aktakuzën e Ndryshuar si dhe për të zëvendësuar Aktakuzën e Dytë të Ndryshuar të propozuar me një Aktakuzë të Ndryshuar për Herë të Dytë të Rishikuar.²⁴⁷⁴ Më 12 janar 2007, Dhoma Gjyqësore II konfirmoi Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë të Rishikuar.²⁴⁷⁵ Aktakuza e Ndryshuar për Herë të Dytë e Rishikuar hoqi Pikat 1 dhe 2 të Aktakuzës së Ndryshuar dhe shtoi veprën penale të torturës në Pikat 3, 4, 5, 6, 16, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 26, 27, 28, 29, 31, 35, dhe 37.²⁴⁷⁶ Në Konferencën Paragjyqësore më 1 mars 2007 të Akuzuarit u shprehën përsëri për të gjitha akuzat e përfshira në këto pika.²⁴⁷⁷ Më 13 qershor 2007, Prokuroria kërkoi leje për të ndryshuar Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë të Rishikuar.²⁴⁷⁸ Më 5 shtator 2007, Dhoma Gjyqësore konfirmoi Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Tretë të Rishikuar.²⁴⁷⁹ Ndryshimi kishte të bënte me identifikimin e dy viktimave që më parë nuk ishin identifikuar.²⁴⁸⁰ Meqë kjo nuk çoi në shtimin e një akuze të re ndaj të Akuzuarve, nuk ishte e nevojshme që këta të fundit të shpreheshin përsëri.²⁴⁸¹ Më 28 shtator 2007, Prokuroria kërkoi leje për të ndryshuar Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Tretë.²⁴⁸² Më 15 tetor 2007, Dhoma Gjyqësore konfirmoi Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Katërt.²⁴⁸³ Ndryshimi kishte të bënte me identifikimin e një viktime që më parë nuk ishte identifikuar.²⁴⁸⁴ Meqë ndryshimi i propozuar nuk çoi në shtimin e një akuze të re ndaj të Akuzuarve, nuk ishte e nevojshme që këta të fundit të shpreheshin përsëri.²⁴⁸⁵

²⁴⁷⁰ Vendimi mbi Shqyrtimin e Aktakuzës, 4 mars 2005.

²⁴⁷¹ Mocioni për Leje për Ndryshimin e Aktakuzës, 26 prill 2006.

²⁴⁷² Vendimi mbi Mocionin për Ndryshimin e Aktakuzës dhe mbi Kundërshtimet ndaj Formës së Aktakuzës së Ndryshuar, 25 tetor 2006.

²⁴⁷³ Mocioni i Prokurorisë për Leje për Ndryshimin e Aktakuzës, 25 tetor 2006.

²⁴⁷⁴ Mocioni për Leje për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar Duke Zëvendësuar Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë të Rishikuar, 10 nëntor 2006.

²⁴⁷⁵ Vendimi mbi Mocionin për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar, 12 janar 2007.

²⁴⁷⁶ Po aty., paragrafi 7.

²⁴⁷⁷ T. 265-266.

²⁴⁷⁸ Mocioni për Leje për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë të Rishikuar, 13 qershor 2007.

²⁴⁷⁹ Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë ku kërkohet Leje për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë të Rishikuar, 5 shtator 2007.

²⁴⁸⁰ Po aty., paragrafi 15.

²⁴⁸¹ Po aty., paragrafët 11-15.

²⁴⁸² Mocioni i Prokurorisë për Leje për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Tretë, 28 shtator 2007.

²⁴⁸³ Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë që Kërkon Leje për Ndryshimin e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Tretë, 15 tetor 2007.

²⁴⁸⁴ Po aty., paragrafi 5.

²⁴⁸⁵ Po aty., paragrafi 6.

2. *Reduktimi i Aktakuzës.* Më 6 shkurt 2007, Dhoma Gjyqësore ftoi Prokurorinë të reduktonte fushën e veprimit të Aktakuzës.²⁴⁸⁶ Më 13 shkurt 2007, Prokuroria e refuzoi këtë ftesë.²⁴⁸⁷ Më 22 shkurt 2007, Dhoma Gjyqësore vendosi të mos e reduktonte fushën e veprimit të Aktakuzës, duke arsyetuar se heqja e pikave apo incidenteve “(i) mund të rezultojë në një aktakuzë që nuk përfaqëson në masë të mjaftueshme tërësinë e çështjes dhe (ii) mund të ndikojë në aftësinë e Prokurorisë për paraqitjen e provave mbi shtrirjen e sulmit të pretenduar të gjerë apo sistematik, dhe ndërmarrjes së përbashkët kriminale”.²⁴⁸⁸
3. *Arrestimi, transferimi, dhe paraqitja e parë.* Sapo u njoh me Aktakuzën, Haradinaj, i cili ishte Kryeministër i Kosovës i dalë prej institucioneve të përkohshme demokratike vetëqeverisëse në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit (1990), dha dorëheqjen dhe iu dorëzua Tribunalit. Brahimaj gjithashtu iu dorëzua vullnetarisht Tribunalit kur u informua për Aktakuzën. Balaj po vuante dënimin me 13 vjet burg pasi ishte shpallur fajtor nga një gjykatë lokale për vrasje në Kosovë. Të tre të Akuzuarit u transferuan në selinë e Tribunalit më 9 mars 2005, dhe u mbajtën në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara.²⁴⁸⁹
4. Më 9 mars 2005, Ushtuesi i Detyrës së Kryetarit të Tribunalit ia caktoi çështjen Dhomës Gjyqësore II të Tribunalit.²⁴⁹⁰ Paraqitja e parë e të tre të Akuzuarve u kryer para Gjykatësit Carmel Agius më 14 mars 2005.²⁴⁹¹ Secili nga të Akuzuarit deklaroi se nuk ishte fajtor për akuzat.²⁴⁹² Të nesërmen, Gjykatësi Agius krijoi një trup gjykues të përbërë nga gjykatësit Agius, Hans Hendrik Brydensholt, dhe Albin Eser, dhe caktoi Gjykatësin Brydensholt si Gjykatës Paragjyqësor.²⁴⁹³ Më 14 korrik 2006, pas përfundimit të mandatit të Gjykatësve Brydensholt dhe Eser, Gjykatësi Agius caktoi vetveten, Gjykatësin O-Gon Kwon, dhe Gjykatësen Kimberly Prost si trup gjykues për fazën paragjyqësore, si dhe Gjykatësin Kwon si Gjykatës Paragjyqësor.²⁴⁹⁴
5. *Caktimi i mbrojtjes.* Më 31 mars 2005, Haradinaj caktoi Z. Ben Emmerson, QC, Z. Rodney Dixon, dhe Z. Michael O’Reilly si avokatë të tij të mbrojtjes.²⁴⁹⁵ Më 18 prill 2005, Sekretari caktoi Z. Gregor Guy-Smith si avokat për mbrojtjen e Balajt, dhe Z. Richard Harvey si avokat për mbrojtjen e Brahimajt.²⁴⁹⁶ Më 26 korrik 2006, Z. Paul Troop u caktua si bashkavokat për Brahimajn.²⁴⁹⁷ Më 9 shkurt 2007, Znj. Colleen Rohan u caktua si bashkë-avokat për Balaj.²⁴⁹⁸

²⁴⁸⁶ Kërkesë drejtuar Prokurorit për Paraqitjen e Propozimeve për Reduktimin e fushës së veprimit të Aktakuzës, 6 shkurt 2007.

²⁴⁸⁷ Përgjigje e Prokurorisë ndaj 'Kërkesës së Dhomës Gjyqësore drejtuar Prokurorit për Paraqitjen e Propozimeve për Reduktimin e fushës së veprimit të Aktakuzës', 13 shkurt 2007, paragrafi 4.

²⁴⁸⁸ Vendim në Bazë të Rregullës 73 bis (D), 22 shkurt 2007, paragrafi 9.

²⁴⁸⁹ Urdhër për Mbajtje në Paraburgim, 11 mars 2005.

²⁴⁹⁰ Urdhër që i Cakton Çështjen Dhomës Gjyqësore, 9 mars 2005.

²⁴⁹¹ Urdhër që Cakton Gjykatësin për Paraqitjen e Parë, 11 mars 2005.

²⁴⁹² T. 1-51.

²⁴⁹³ Urdhër në lidhje me Përbërjen e Dhomës Gjyqësore dhe Caktimin e Gjykatësit Paragjyqësor, 15 mars 2005.

²⁴⁹⁴ Urdhër në lidhje me Përbërjen e Dhomës Gjyqësore dhe Caktimin e Gjykatësit Paragjyqësor, 14 korrik 2006.

²⁴⁹⁵ Autorizim për Përfaqësim, 31 mars 2005.

²⁴⁹⁶ Vendim i Sekretarit për Caktimin e Avokatit Mbrojtës për Balajn, 18 prill 2005; Vendim i Sekretarit për Caktimin e Avokatit Mbrojtës për Lahi Brahimajn, 19 prill 2005.

²⁴⁹⁷ Vendim i Sekretarit për Caktimin e Bashkavokatit për Lahi Brahimajn, 26 korrik 2006.

²⁴⁹⁸ Vendim i Sekretarit për Caktimin e Bashkavokatit për Idriz Balajn, 9 shkurt 2007.

6. *Caktimi i çështjes Dhomës Gjyqësore I.* Ushtruesi i Detyrës së Kryetarit të Tribunalit, Gjykatësi Parker, ia caktoi çështjen Dhomës Gjyqësore I (“Dhoma Gjyqësore”) më 15 janar 2007.²⁴⁹⁹ Të nesërmen, Gjykatësi Alphons Orië caktoi vetveten si Gjykatës Paragjyqësor.²⁵⁰⁰ Më 17 janar 2007, Gjykatësi Parker caktoi gjykatësit *ad litem* Frank Höpfel dhe Ole Bjørn Støle në këtë çështje për përgatitjen paragjyqësore.²⁵⁰¹ Më 19 janar 2007, Kryetari i Tribunalit caktoi të njëjtët gjykatës *ad litem* në Dhomën Gjyqësore për procesin gjyqësor.²⁵⁰²
7. *Fillimi i procesit gjyqësor.* Më 24 janar 2007, Gjykatësi Orië caktoi konferencën paragjyqësore më 1 mars 2007 dhe nisjen e procesit gjyqësor më 5 mars 2007.²⁵⁰³
8. *Dosjet paragjyqësore.* Prokuroria paraqiti dosjen e saj paragjyqësore më 29 janar 2007.²⁵⁰⁴ Secili nga të akuzuarit paraqiti një dosje paragjyqësore më 12 shkurt 2007.²⁵⁰⁵
9. *Mocionet paraprake.* Më 5 shkurt 2007, Mbrojtja e Balajt kërkoi sqarim të paragrafit 29 të Aktakuzës së 12 janarit 2007.²⁵⁰⁶ Dhoma Gjyqësore konkludoi se Mbrojtja nuk kishte identifikuar ndonjë paqartësi të vazhdueshme apo mangësi të pakorrigjuar në Aktakuzë, e cila, po të lexohej së bashku me dosjen paragjyqësore të Prokurorisë, jepte informacion të mjaftueshëm për fushën e zbatimit të paragrafit 29.²⁵⁰⁷
10. *Mocionet për lirim të përkohshëm.* Më 16 prill 2005, Gjykatësi kujdestar Iain Bonomy miratoi një kërkesë të paraqitur nga Haradinaj për lirim të përkohshëm për 48 orë.²⁵⁰⁸ Më 6 qershor 2005, Dhoma Gjyqësore II miratoi lirim të përkohshëm për Haradinajn deri kur ai të urdhërohej për t’u kthyer në paraburgimin e Tribunalit.²⁵⁰⁹ Haradinaj ishte i detyruar të njoftonte UNMIK-un 24 orë më parë sa herë dëshironte të shkonte nga Prishtina në Glllogjan dhe anasjelltas.²⁵¹⁰ Gjatë 90 ditëve të para të lirimimit të tij të përkohshëm, Haradinaj nuk lejohej “të bënte dalje në publik apo të merrte pjesë në veprimtari politike”.²⁵¹¹ Haradinaj u lejua të “merret me veprimtari administrative ose organizative në cilësinë e Kryetarit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës”, me kusht që veprimtari të tilla nuk binin ndesh me kushtet e lirimimit të përkohshëm.²⁵¹²
11. Më 12 tetor 2005, Dhoma Gjyqësore II, pasi shqyrtoi parashtrimet e mëtejshme të Mbrojtjes së Haradinajt, i ndryshoi këto kushte duke e lejuar Haradinajn të dalë publikisht dhe të marrë pjesë në veprimtari politike publike, për aq sa UNMIK-u i konsideronte të rëndësishme për “zhvillimet

²⁴⁹⁹ Urdhër që i Ricakton Çështjen një Dhome Gjyqësore, 15 janar 2007.

²⁵⁰⁰ Urdhër për Caktimin e Gjykatësit Paragjyqësor, 16 janar 2007.

²⁵⁰¹ Urdhër për Caktimin e Gjykatësve Ad-Litem për Punë Gjyqësore, 17 janar 2007.

²⁵⁰² Urdhëri për Caktimin e Gjykatësve Ad-Litem në një Çështje para Dhomës Gjyqësore, 19 janar 2007.

²⁵⁰³ Urdhër për Caktim Date, 24 janar 2007.

²⁵⁰⁴ Dosja Paragjyqësore e Prokurorisë, 29 janar 2007.

²⁵⁰⁵ Dosja Paragjyqësore e Ramush Haradinajt, 12 shkurt 2007; Dosja Paragjyqësore e Idriz Balajt, 12 shkurt 2007; Dosja Paragjyqësore në Emër të Lahi Brahimajt, 12 shkurt 2007.

²⁵⁰⁶ Mocioni i të Akuzuarit Idriz Balaj për Sqarimin e Paragrafit 29 të Aktakuzës së 12 janarit 2007, 12 prill 2007.

²⁵⁰⁷ Vendimi mbi Mocionin Paraprak të Idriz Balajt në lidhje me Paragrafin 29 të Aktakuzës, 31 maj 2007.

²⁵⁰⁸ Vendimi mbi Mocionin e Ngutshëm të Mbrojtjes në Emër të Ramush Haradinajt për lirim të përkohshëm, 16 prill 2005.

²⁵⁰⁹ Vendimi mbi Mocionin e Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 6 qershor 2005.

²⁵¹⁰ Po aty., paragrafi 53, nënparagrafi 6b.

²⁵¹¹ Po aty., paragrafi 53, nënparagrafi 5.

pozitive të gjendjes politike dhe sigurisë në Kosovë”.²⁵¹³ Në përgjigje të një apelimi prej Prokurorisë, Dhoma e Apelit vendosi një detyrim shtesë ndaj UNMIK-ut që ky i fundit të informonte Prokurorinë si dhe të merrte parasysh përgjigjen e Prokurorisë përpara se të autorizonte ndonjë veprimtari politike.²⁵¹⁴ Më 1 shkurt 2007, për shkak të procesit gjyqësor të afërt, Dhoma Gjyqësore urdhëroi kthimin e Haradinajt nga lirimi i përkohshëm.²⁵¹⁵

12. Më 10 tetor 2005, Mbrojtja e Brahimajt kërkoi lirim të përkohshëm.²⁵¹⁶ Më 3 nëntor 2005, Dhoma Gjyqësore e refuzoi kërkesën.²⁵¹⁷ Mbrojtja e Brahimajt apeloj dhe Dhoma e Apelit i kërkoi Dhomës Gjyqësore t'a rimerrte në shqyrtim.²⁵¹⁸ Më 3 maj 2006, Dhoma Gjyqësore refuzoi përsëri kërkesën e Brahimajt.²⁵¹⁹

13. Më 29 qershor 2007, Mbrojtja e Haradinajt kërkoi lirim të përkohshëm gjatë pushimeve të verës së Tribunalit.²⁵²⁰ Më 11 korrik 2007, Prokuroria e kundërshtoi këtë kërkesë.²⁵²¹ Më 16 korrik 2007, Haradinaj paraqiti kundërpërgjigjen.²⁵²² Më 20 korrik 2007, Dhoma Gjyqësore e refuzoi kërkesën, duke argumentuar se lirimi i përkohshëm i Haradinajt do të ndikonte edhe më negativisht në rrethanat në të cilën dëshmitarët nuk ndiheshin të sigurtë për të dëshmuar.²⁵²³

14. Më 3 tetor 2007, Mbrojtja e Haradinajt kërkoi lirim të përkohshëm të ngutshëm për arsye njerëzore pas vdekjes së një të afërmi të Haradinajt.²⁵²⁴ Po atë ditë, Prokuroria kërkoi vendosjen e kushteve të rrepta për lirimin e përkohshëm.²⁵²⁵ Më 3 tetor 2007, Dhoma Gjyqësore miratoi lirimin e përkohshëm të Haradinajt nga 3 deri më 7 tetor 2007.²⁵²⁶ Me përjashtim të pjesëmarrjes në ceremoninë e varrimit, Haradinaj u urdhërua të qëndronte në shtëpinë e tij në Gllogjan dhe të shmangte çdo kontakt mediatik apo politik.²⁵²⁷

15. Më 7 dhjetor 2007, mbrojtja e Haradinajt kërkoi lirimin e përkohshëm të Haradinajt gjatë pushimit të dimrit të gjykatës.²⁵²⁸ Më 12 dhjetor 2007, Prokuroria e kundërshtoi këtë kërkesë.²⁵²⁹ Më 14 dhjetor 2007, Dhoma Gjyqësore miratoi lirimin e përkohshëm të Ramush Haradinajt nga 21

²⁵¹² Po aty.

²⁵¹³ Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt ku Kërkohej Rivlerësimi i Kushteve të Lirimit të Përkohshëm Miratuar më 6 qershor 2005, 12 tetor 2005.

²⁵¹⁴ Vendim mbi Lirimin e Përkohshëm të Ndryshuar të Ramush Haradinajt, 10 mars 2005 (2006), paragrafi 104.

²⁵¹⁵ Urdhër për Kthimin e Ramush Haradinajt nga lirimi i përkohshëm, 2 shkurt 2007.

²⁵¹⁶ Mocioni i Mbrojtjes në Emër të Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 10 tetor 2005.

²⁵¹⁷ Vendimi mbi Mocionin e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 3 nëntor 2005.

²⁵¹⁸ Vendim për Apelin e Ndërkohshëm të Lahi Brahimajt kundër Vendimit të Dhomës Gjyqësore për Refuzimin e Lirimit të tij të Përkohshëm, 9 Mars 2006, paragrafët 30-31.

²⁵¹⁹ Vendimi Tjetër mbi Mocionin e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 3 maj 2006, paragrafët 42-43.

²⁵²⁰ Mocioni në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 29 qershor 2007.

²⁵²¹ Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit në emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 11 korrik 2007, paragrafi 38.

²⁵²² Përgjigje në Emër të Ramush Haradinajt ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Mocionit të Mbrojtjes për Lirim të Përkohshëm, 16 korrik 2007.

²⁵²³ Vendimi mbi Mocionin në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 20 korrik 2007, paragrafët 24, 27, 29-30.

²⁵²⁴ Mocioni në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Ngutshëm të Përkohshëm, 3 tetor 2007.

²⁵²⁵ Përgjigje ndaj Mocionit të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 3 tetor 2007.

²⁵²⁶ Vendim në lidhje me Mocionin e Mbrojtjes në emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Ngutshëm të Përkohshëm, 3 tetor 2007.

²⁵²⁷ Po aty.

²⁵²⁸ Mocion në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 7 dhjetor 2007.

²⁵²⁹ Përgjigje e Prokurorisë që Kundërshton Mocionin e Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 12 dhjetor 2007.

dhjetor 2007 deri më 4 janar 2008.²⁵³⁰ Dhoma Gjyqësore e urdhëroi Haradinajn të qëndronte në shtëpinë e tij në Prishtinë nën mbikëqyrjen e përhershme të UNMIK-ut si dhe të mos angazhohej në asnjë veprimtari politike.²⁵³¹ Gjithashtu, Dhoma Gjyqësore i kërkoi UNMIK-ut të raportonte një herë në dy ditë për respektimin prej tij të kufizimeve dhe kushteve për lirimin e përkohshëm.²⁵³² Më 4 janar 2008, Haradinaj u kthye në paraburgimin e NJPKB-së në Hagë.

16. Më 7 dhjetor 2007, Mbrojtja e Brahimajt kërkoi lirimin e përkohshëm të Brahimajt për arsye humanitare gjatë pushimit të dimrit të Tribunalit.²⁵³³ Më 12 dhjetor 2007, Prokuroria e kundërshtoi këtë kërkesë.²⁵³⁴ Më 14 dhjetor 2007, Dhoma Gjyqësore miratoi lirimin e përkohshëm të Brahimajt nga 21 dhjetor 2007 deri më 4 janar 2008.²⁵³⁵ Më 4 janar 2008, Brahimaj u kthye në paraburgimin e NJPKB-së në Hagë.

17. *Marrëveshja për faktet dhe njoftimi gjyqësor.* Më 26 nëntor 2007, palët paraqitën faktet e pranua lidhur me gjetjen dhe identifikimin e kufomave, si dhe rezultatet e autopsive.²⁵³⁶ Më 30 nëntor 2007, palët paraqitën fakte shtesë të pranua në lidhje me linjën e dorëzimit të disa dokumentave.²⁵³⁷

18. *UNMIK.* Më 12 janar 2007, Mbrojtja e Balajt kërkoi që Dhoma Gjyqësore të urdhëronte UNMIK-un të shfuqizonte zbatimin e kufizimeve të Rregullës 70 për disa dokumenta.²⁵³⁸ Më 31 janar 2007, Prokuroria e kundërshtoi dhënien e urdhrit për hapjen e dosjeve pa pëlqimin e UNMIK-ut, siç parashikohet nga Rregulla 70.²⁵³⁹ Më 12 shkurt 2007, UNMIK-u u përgjigj se kishte dhënë tashmë pëlqimin për hapjen e afërsisht gjysmës së dosjeve të kërkuara nga Mbrojtja e Balajt dhe se ishte duke vlerësuar nëse mund të vihej në dispozicion material shtesë.²⁵⁴⁰ Më 5 prill 2007, Prokuroria informoi Dhomën Gjyqësore se kishte zbuluar tre dokumenta në dosjet në fjalë të cilat, sipas mendimit të saj, përmbanin “material të mundshëm shfajësues”.²⁵⁴¹ Prokuroria e informoi Dhomën Gjyqësore se UNMIK-u kishte refuzuar të jepte pëlqimin e vet për të vënë në dispozicion të Mbrojtjes, dosjet e kërkuara.²⁵⁴² Më 19 prill 2007, Dhoma Gjyqësore i kërkoi UNMIK-ut të caktonte një përfaqësues të mirinformuar që të paraqitej para saj.²⁵⁴³ Më 10 maj 2007, Dhoma

²⁵³⁰ Vendim mbi Mocionin në Emër të Ramush Haradinajt për Lirim të Përkohshëm, 14 dhjetor 2007.

²⁵³¹ Po aty.

²⁵³² Po aty., pf 8-9.

²⁵³³ Mocion i Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm gjatë Periudhës së Pushimit, 7 dhjetor 2007; Njoftim i Lahi Brahimajt për Shfuqizimin e Konfidencialitetit të Mocionit të tij të 7 dhjetorit 2007, 10 dhjetor 2007.

²⁵³⁴ Përgjigje e Prokurorisë që Kundërshton Mocionin e Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 12 dhjetor 2007.

²⁵³⁵ Vendimi mbi Mocionin në Emër të Lahi Brahimajt për Lirim të Përkohshëm, 14 dhjetor 2007, paragrafi 25.

²⁵³⁶ Mocion i Përbashkët për Faktet e Pranua, 26 nëntor 2007.

²⁵³⁷ Mocion i Përbashkët për Faktet Shtesë të Pranua, 30 nëntor 2007.

²⁵³⁸ Parashtrim nga Mbrojtja e Idriz Balajt ku i Kërkohet Dhomës Gjyqësore të Urdhërojë UNMIK-un për Heqjen e Kufizimeve të Rregullës 70 ndaj Disa Dokumenteve, 12 janar 2007.

²⁵³⁹ Përgjigje e Prokurorisë ndaj Mocionit nga Idriz Balaj për një Urdhër Për Publikimin e Materialit të Mbrojtura në Bazë të Rregullës 70, 31 janar 2007.

²⁵⁴⁰ Parashtrim i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ndaj Mocionit të të Akuzuarit Idriz Balaj ku i Kërkohet Dhomës Gjyqësore të Urdhërojë UNMIK-un për Shfuqizimin e Masave të Konfidencialitetit të Rregullës 70 (B), 12 shkurt 2007, paragrafët 6-7.

²⁵⁴¹ Raport i Prokurorisë për Materialin e UNMIK-ut të Rregullës 70 që i Nënshtrohet Rregullës 68, 5 prill 2007, paragrafi 3.

²⁵⁴² Po aty., paragrafi 4.

²⁵⁴³ Vendimi mbi Kërkesën e Prokurorisë së 5 prillit 2007 që Dhoma të Shqyrtojë Dosjet e UNMIK-ut të Rregullës 70 që me Gjasë Trajtohen prej Rregullës 68, 19 prill 2007, paragrafi 3.

Gjyqësore zhvilloi një seancë me palët dhe tre përfaqësues të UNMIK-ut ku u arrit një kompromis, sipas të cilit UNMIK-u do t'i jepte Mbrojtjes tre dokumenta në formë të redaktuar.²⁵⁴⁴ U ra gjithashtu dakord që në të ardhmen çdo kërkesë tjetër për UNMIK-un Mbrojtja do t'a dërgonte nëpërmjet personelit ligjor të Dhomës Gjyqësore dhe se Dhoma Gjyqësore nuk do t'a shqyrtonte këtë kërkesë.²⁵⁴⁵ Në fund të kësaj seance Mbrojtja për Balajn e tërhoqi mocionin e saj të paraqitur më 12 janar 2007.²⁵⁴⁶

19. *Incizimi i seancave përgatitore.* Pas disa incidenteve ku dukej se kishte mospërputhje midis deklaratave të një dëshmitar në gjykatë dhe deklaratave që po ky dëshmitar kishte bërë gjatë seancës përgatitore me Prokurorinë, të tre ekipet e Mbrojtjes kërkuan që Dhoma Gjyqësore të urdhëronte Prokurorinë të bënte incizim zanor të seancave të veta përgatitore.²⁵⁴⁷ Prokuroria u përgjigj më 22 mars 2007.²⁵⁴⁸ Më 23 maj 2007, Dhoma Gjyqësore vendosi të mos ushtronte kompetencën e saj për të urdhëruar Prokurorinë që të incizonte seancat e saj përgatitore. Në vend të kësaj, Dhoma Gjyqësore e udhëzoi Prokurorinë që në të ardhmen të paraqiste një deklaratë shtesë të nënshkruar nga dëshmitari ku të jepej çdo dëshmi e re, shtesë, apo e ndryshme e marrë nga dëshmitari, në rastet kur ishte e mundur.²⁵⁴⁹

20. *Çështja e shpërfilljes kundër Shefqet Kabashit.* Më 5 qershor 2007, Shefqet Kabashi u paraqit para Dhomës Gjyqësore si dëshmitar, por pasi bëri betimin solemn, ai refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve mbi thelbin e çështjes.²⁵⁵⁰ Po atë ditë, Dhoma Gjyqësore lëshoi një Urdhër në Vend të Aktakuzës, ku urdhërohej procedimi penal i Kabashit për shpërfillje të Tribunalit.²⁵⁵¹ Dhoma Gjyqësore vendosi t'a procedonte vetë çështjen dhe kërkoi që Kabashi të paraqitej para saj më 7 qershor 2007.²⁵⁵² Kabashi nuk u paraqit në datën e caktuar. Përkundrazi, pa autorizimin e Dhomës Gjyqësore, ai u kthye në Shtetet e Bashkuara, vendbanimin e tij. Më 20 nëntor 2007, Kabashit iu ofrua një mundësi tjetër për të dëshmuar në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë* dhe ai u paraqit para Dhomës Gjyqësore nëpërmjet vide-konferencës, por përsëri refuzoi t'u përgjigjej pyetjeve për thelbin e çështjes.²⁵⁵³ Kabashi nuk ishte i gatshëm të udhëtonte në selinë e Tribunalit dhe të paraqitej për çështjen e tij të shpërfilljes. Më 11 dhjetor 2007, Dhoma Gjyqësore ia përcolli çështjen Prokurorisë për hetim dhe procedim të mëtejshëm.²⁵⁵⁴ Dhoma Gjyqësore e udhëzoi gjithashtu Prokurorinë të hetonte sjelljen e Kabashit që nga 5 qershori 2007 dhe më vonë, pasi kishte arsye të

²⁵⁴⁴ T. 3923.

²⁵⁴⁵ T. 3907-3911.

²⁵⁴⁶ T. 3925.

²⁵⁴⁷ Parashtrimet e Mbrojtjes për Procedurën e Përgatitjes së Dëshmitarëve, 22 mars 2007, paragrafët 2-3.

²⁵⁴⁸ Parashtrimet me Shkrim të Prokurorisë Kundër Incizimit Zanor të Seancave "Parapërgatitore" me Dëshmitarët, 22 mars 2007.

²⁵⁴⁹ Vendim në Lidhje me Kërkesën e Mbrojtjes për Incizimin Zanor të Seancave Parapërgatitore të Dëshmitarëve të Prokurorisë, 23 maj 2007.

²⁵⁵⁰ T. 5414 et seq.

²⁵⁵¹ Urdhër në Vend të Aktakuzës për Shpërfillje në Lidhje me Shefqet Kabashin, 5 qershor 2007.

²⁵⁵² Po aty.

²⁵⁵³ T. 10939-10941.

²⁵⁵⁴ Vendimi për t'ia Referuar Çështjen Prokurorisë, 11 dhjetor 2007, paragrafi 7.

besonte se ai kishte kryer aktin e shpërfilljes më 20 nëntor 2007.²⁵⁵⁵ Dhoma Gjyqësore e informoi Prokurorinë se mund ta konsideronte Urdhrin në Vend të Aktakuzës si aktakuzë të konfirmuar dhe se mund ta ndryshonte apo tërhiqte atë sipas gjykimit të saj.²⁵⁵⁶ Më 13 dhjetor 2007, Prokuroria paraqiti një aktakuzë kundër Kabashit.²⁵⁵⁷ Prokuroria kërkoi që Dhoma Gjyqësore (i) të konfirmonte aktakuzën e re; (ii) të lëshonte një urdhëresë për arrestimin, paraburgimin, dhe transferimin e Kabashit në Tribunal; dhe (iii) të bënte aktakuzën publike pas konfirmimit.²⁵⁵⁸ Më 19 dhjetor 2007, Prokuroria paraqiti një shtojcë në të cilën shpjegonte se kërkonte leje për ndryshimin e Urdhrit në Vend të Aktakuzës.²⁵⁵⁹ Më 18 shkurt 2008, Dhoma Gjyqësore i dha leje Prokurorisë të ndryshonte aktakuzën kundër Kabashit dhe urdhëroi Prokurorinë të bënte aktakuzën publike.²⁵⁶⁰ Në kohën kur u dha ky vendim, Kabashi nuk ishte i paraburgosur prej Tribunalit.

21. *Çështja e shpërfilljes kundër Avni Krasniqit.* Më 17 tetor 2007, Prokuroria kërkoi urdhërparaqitje për Avni Krasniqin për dhënie dëshmie, dëshmitar që kishte refuzuar të paraqitej në Tribunal.²⁵⁶¹ Më 19 tetor 2007, Dhoma Gjyqësore urdhëroi Avni Krasniqin të paraqitej si dëshmitar në Tribunal më 29 tetor 2007.²⁵⁶² Krasniqi këmbënguli në refuzimin e tij për të dëshmuar, duke përmendur frikën për sigurinë e vetvetes dhe familjes së tij.²⁵⁶³ Më 30 tetor 2007, Prokuroria i kërkoi Dhomës Gjyqësore të udhëzonte Prokurorinë për të hetuar dëshmitarin për shpërfillje të mundshme të Tribunalit.²⁵⁶⁴ Më 31 tetor 2007, Dhoma Gjyqësore urdhëroi Prokurorinë të hetonte refuzimin e dëshmitarit për t'u paraqitur dhe dëshmuar, me qëllim që Prokuroria të përgatiste dhe të paraqiste një aktakuzë për shpërfillje.²⁵⁶⁵ Më 2 nëntor 2007, Prokuroria paraqiti një aktakuzë kundër Avni Krasniqit për shpërfillje të Tribunalit.²⁵⁶⁶ Dhoma Gjyqësore e konfirmoi aktakuzën më 5 nëntor 2007 dhe ajo u bë publike më 9 nëntor 2007.²⁵⁶⁷ Më 12 nëntor 2007, Prokuroria e korrigjoi aktakuzën.²⁵⁶⁸ Urdhri për arrestimin e Avni Krasniqit lëshuar më 5 nëntor 2007, u zbatua më 9 nëntor 2007, dhe Avni Krasniqi u transferua në selinë e Tribunalit më 10 nëntor 2007.²⁵⁶⁹ Pasi u këshillua me avokatin e tij, Avni Krasniqi vendosi të dëshmonte në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*, gjë që ai e bëri më 14 dhe 15 nëntor 2007.²⁵⁷⁰ Më 15 nëntor 2007, Prokuroria bëri kërkesë për tërheqjen e aktakuzës kundër tij.²⁵⁷¹ Në fund të dëshmisë së tij Avni Krasniqi u informua se kërkesa

²⁵⁵⁵ Po aty., paragrafi 7.

²⁵⁵⁶ Po aty., paragrafi 6.

²⁵⁵⁷ Paraqitja prej Prokurorisë e Aktakuzës kundër Shefqet Kabashit, 13 dhjetor 2007, Shtojca A.

²⁵⁵⁸ Po aty., paragrafi 11.

²⁵⁵⁹ Shtojca e Mocionit të Prokurorisë e 13 dhjetorit 2007 lidhur me Aktakuzën kundër Shefqet Kabashit, 19 dhjetor 2007.

²⁵⁶⁰ Vendim që Miraton Leje për Ndryshimin e Aktakuzës, 18 shkurt 2008.

²⁵⁶¹ Kërkesa e 22-të e Prokurorisë për Urdhërparaqitje për të Dëshmuar, 17 tetor 2007.

²⁵⁶² Urdhërparaqitje për të Dëshmuar, 19 tetor 2007.

²⁵⁶³ Fletëdorëzimi i Urdhërparaqitjes, 29 tetor 2007; Urdhër për Prokurorinë që të Hetojë me Synim Përgatitjen dhe Paraqitjen e një Aktakuze për Shpërfillje, 31 tetor 2007, paragrafi 3.

²⁵⁶⁴ Pranimi nga Prokuroria i Ftesës së Dhomës Gjyqësore për Shqyrtimin e Nisjes së Procedimit të Avni Krasniqit për Shpërfillje, 30 tetor 2007.

²⁵⁶⁵ Urdhër për Prokurorinë për Nisjen e Hetimit me Synim Përgatitjen dhe Paraqitjen e Aktakuzës për Shpërfillje, 31 tetor 2007.

²⁵⁶⁶ Paraqitja nga Prokuroria e një Aktakuzë kundër Avni Krasniqit për Shpërfillje, 5 nëntor 2007.

²⁵⁶⁷ Vendim në Lidhje me Shqyrtimin e Aktakuzës, 5 nëntor 2007; Shfuqizimi i Konfidencialitetit, 9 nëntor 2007.

²⁵⁶⁸ Paraqitja e Aktakuzës së Korrigjuar nga Prokuroria, 12 nëntor 2007.

²⁵⁶⁹ Urdhër për Mbajtjen në Paraburgim, 13 nëntor 2007.

²⁵⁷⁰ Vendim që Miraton Kërkesën e Prokurorisë për Tërheqjen e Aktakuzës për Shpërfillje Kundër Avni Krasniqit, 5 dhjetor 2007.

²⁵⁷¹ Kërkesa e Prokurorisë për Tërheqjen e Aktakuzës për Shpërfillje kundër Avni Krasniqit, 15 nëntor 2007.

e Prokurorisë ishte pranuar dhe se ai do të lirohej menjëherë, sapo të merreshin masat e nevojshme praktike nga Sekretaria.²⁵⁷² Ai u lirua menjëherë pas kësaj. Më 5 dhjetor 2007, Dhoma Gjyqësore konfirmoi me shkrim tërheqjen e aktakuzës.²⁵⁷³

22. *Çështja e shpërfilljes kundër Sadri Selcës.* Më 31 maj 2007, Prokuroria kërkoi urdhërparaqitje për dhënie dëshmie për Sadri Selcën, dëshmitar që kishte refuzuar të paraqitej në Tribunal.²⁵⁷⁴ Më 1 qershor 2007, Dhoma Gjyqësore lëshoi urdhërparaqitjen e kërkuar.²⁵⁷⁵ Selca këmbënguli në refuzimin e tij për të dëshmuar para Tribunalit, dhe tha se një nga arsyet e mosbindjes ndaj urdhërparaqitjes ishte gjendja e tij shëndetësore.²⁵⁷⁶ Më 28 qershor 2007, Dhoma Gjyqësore i kërkoi Selcës t'i dorëzonte një përfaqësuesi të UNMIK-ut të gjitha dokumentat e tij mjekësore për të vërtetuar pretendimin e tij.²⁵⁷⁷ Më 1 gusht 2007, UNMIK-u paraqiti një raport me një deklaratë të Selcës dhe dy dokumenta mjekësore të bashkëngjitura.²⁵⁷⁸ Më 23 gusht 2007, Dhoma Gjyqësore i kërkoi Prokurorisë të shqyrtonte të gjitha rrethanat lidhur me Selcën dhe të informonte Dhomën Gjyqësore nëse Prokuroria duhej të fillonte një hetim ndaj tij për shpërfillje.²⁵⁷⁹ Më 19 tetor 2007, Prokuroria i kërkoi Dhomës Gjyqësore të udhëzonte Prokurorinë që të hetonte dëshmitarin për shpërfillje të mundshme të Tribunalit.²⁵⁸⁰ Më 31 tetor 2007, Dhoma Gjyqësore udhëzoi Prokurorinë të hetonte refuzimin e dëshmitarit për t'u paraqitur dhe dëshmuar me qëllim që Prokuroria të përgatiste dhe të paraqiste një aktakuzë për shpërfillje.²⁵⁸¹ Më 7 nëntor 2007, Dhoma Gjyqësore konfirmoi aktakuzën për shpërfillje të Tribunalit kundër Sadri Selcës.²⁵⁸² Po atë ditë, Dhoma Gjyqësore lëshoi një urdhër për arrestimin e Selcës.²⁵⁸³ Aktakuza u bë publike më 13 nëntor 2007.²⁵⁸⁴ Urdhërarrestimi u zbatua po atë ditë dhe i Akuzuari u transferua për në Hagë.²⁵⁸⁵ Pasi u këshilua me avokatin e tij, Selca vendosi të dëshmojë në çështjen *Haradinaj dhe të tjerë*, gjë të cilën ai e bëri më 15 nëntor 2007. Po atë ditë, Prokuroria bëri kërkesë për tërheqjen e aktakuzës kundër Selcës.²⁵⁸⁶ Në fund të dëshmisë së tij më 15 nëntor 2007, Selca u informua se kërkesa e Prokurorisë ishte pranuar dhe se ai do të lirohej menjëherë, sapo të merreshin masat e nevojshme praktike nga Sekretaria.²⁵⁸⁷ Ai u lirua menjëherë pas kësaj. Më 5 dhjetor 2007, Dhoma Gjyqësore konfirmoi me shkrim tërheqjen e aktakuzës.²⁵⁸⁸

²⁵⁷² T. 10850.

²⁵⁷³ Vendimi që Miraton Kërkesën e Prokurorisë për Tërheqjen e Aktakuzës për Shpërfillje kundër Avni Krasniqit, 5 dhjetor 2007.

²⁵⁷⁴ Kërkesa e Prokurorisë për Lëshimin e një Urdhërparaqitjeje (Dëshmitari SST 7ë18), 31 maj 2007.

²⁵⁷⁵ Urdhërparaqitje për të Dëshmuar, 1 qershor 2007.

²⁵⁷⁶ Fletëdorëzim paraqitur nga Shërbimi Policor i Kosovës i UNMIK-ut, 15 qershor 2007.

²⁵⁷⁷ Kërkesë për Raporte Mjekësore të një dëshmitari, i Cili Ka Marrë Urdhërparaqitje dhe Kërkesë për Ndihmë Juridike, 28 qershor 2007.

²⁵⁷⁸ Dokument i UNMIK-ut, 1 gusht 2007.

²⁵⁷⁹ Ftesë Prokurorisë për Shqyrtimin e Mundësisë së Nisjes së Procedimit të Z. Sadri Selca për Shpërfillje, 23 gusht 2007.

²⁵⁸⁰ Përgjigje ndaj Ftesës lidhur me Sadri Selcën, 19 tetor 2007, paragrafi 7.

²⁵⁸¹ Urdhër sipas Rregullës 77(C)(i) në Lidhje me Dëshmitarin 18, 31 tetor 2007.

²⁵⁸² Vendim në Lidhje me Shqyrtimin e Aktakuzës, 7 nëntor 2007.

²⁵⁸³ Fletarrestim dhe Urdhër për Dorëzimin e Sadri Selcës, 7 nëntor 2007.

²⁵⁸⁴ Urdhër për Shfuqizimin e Konfidencialitetit, 13 nëntor 2007.

²⁵⁸⁵ Po aty.

²⁵⁸⁶ Kërkesë e Prokurorisë për Tërheqjen e Aktakuzës për Shpërfillje kundër Sadri Selcës, 15 nëntor 2007.

²⁵⁸⁷ T. 10891.

²⁵⁸⁸ Vendimi që Miraton Kërkesën e Prokurorisë për Tërheqjen e Aktakuzës për Shpërfillje kundër Sadri Selcës, 5 dhjetor 2007.

23. *Dëshmitari 8.* Më 5 prill 2007, Dhoma Gjyqësore pezulloi pyetjet prej pales kundërshtare për Dëshmitarin 8 dhe iu kërkoi palëve të paraqisnin parashtrimet e tyre nëse dëshmia e tij kishte vlerë provuese të mjaftueshme për të vazhduar.²⁵⁸⁹ Prokuroria argumentoi se dëshmia e Dëshmitarit 8 ishte përputhëse në lidhje me çështje kritike të mbuluara nga pikat përkatëse.²⁵⁹⁰ Mbrojtja argumentoi se dëshmia e Dëshmitarit 8 ishte qartësisht e pasaktë dhe e pabesueshme dhe se si e tillë duhej të përjashtohet si provë.²⁵⁹¹ Dhoma Gjyqësore konkludoi se saktësia dhe besueshmëria e dëshmisë së dëshmitarit linin kaq shumë për të dëshiruar sa kjo Dhomë nuk mund të mbështetej tek dëshmia e tij për nxjerrjen e konkluzioneve lidhur me faktet e pretenduara në Aktakuzë, dhe, për këtë arsye, ajo vendosi të mos i kërkonte Dëshmitarit 8 të kthehej për përfundimin e seancës së pyetjeve prej palës kundërshtare.²⁵⁹²

24. *Urdhërparaqitja dhe lidhja me video për Naser Likën.* Më 25 maj 2007, Prokuroria kërkoi urdhërparaqitje për dhënie dëshmie për Naser Likën, dëshmitar që kishte refuzuar të paraqitej në Tribunal.²⁵⁹³ Më 12 qershor 2007, Dhoma Gjyqësore lëshoi urdhërparaqitjen e kërkuar.²⁵⁹⁴ Lika këmbënguli në refuzimin e tij për të dëshmuar para Tribunalit.²⁵⁹⁵ Më 30 gusht 2007, Prokuroria kërkoi dëshminë e detyruar të Likës nëpërmjet lidhjes me video.²⁵⁹⁶ Më 14 shtator 2007, Dhoma Gjyqësore e pranoi mocionin pasi u bind se Lika nuk mund të udhëtonte për në Hagë për shkak të gjendje së tij shëndetësore.²⁵⁹⁷ Mirëpo më 13 nëntor 2007, datën e caktuar për dëshminë e tij, Lika përsëri nuk u paraqit.²⁵⁹⁸ Më 15 nëntor 2007, Lika u arrestua nga autoritetet kanadeze pasi nuk iu bind një urdhri kanadez për t'u paraqitur në vendin e caktuar për lidhjen me video. Dhoma Gjyqësore përsëri u përpoq të dëgjonte dëshminë e tij nëpërmjet lidhjes me video më 15 nëntor 2007. Megjithatë, Lika nuk u soll në kohë në vendin e caktuar për lidhje me video, kështu që seanca e caktuar për atë ditë nuk u zhvillua.²⁵⁹⁹ Më 20 nëntor 2007, Dhoma Gjyqësore pranoi një kërkesë tjetër të Prokurorisë për të dëgjuar dëshminë e Likës nëpërmjet lidhjes me video më 26 dhe 27 nëntor 2007.²⁶⁰⁰ Më 26 nëntor 2007, Prokuroria e informoi Dhomën Gjyqësore se Lika ishte shtruar në spital dhe nuk ishte në gjendje të dëshmonte.²⁶⁰¹ Dhoma Gjyqësore u informua se do të duheshin shtatë deri në dhjetë ditë të tjera përpara se të mund të bëhej vlerësimi se kur Lika do të ishte në

²⁵⁸⁹ T. 2594-2596.

²⁵⁹⁰ Parashtrim me Shkrim i Prokurorisë lidhur me Dëshmitarin 8 dhe Mocion për Dhomën Gjyqësore për Thirrjen e një Dëshmitari në Bazë të Rregullës 98, 23 prill 2007, paragrafi 5.

²⁵⁹¹ Parashtrime Konfidenciale në Emër të Ramush Haradinajt lidhur me Dëshminë e Dëshmitarit 8, 24 prill 2007, paragrafët 5, 21-25, 27, 30; Parashtrime Konfidenciale në Emër të Idriz Balajt lidhur me Dëshminë e Dëshmitarit 8, 25 Prill 2007, paragrafët 16-17; Parashtrime Konfidenciale në Emër të Lahi Brahimajt lidhur me Dëshminë e Dëshmitarit 8, 26 prill 2007, paragrafët 10, 17-19.

²⁵⁹² Vendim Nëse Duhet Rifilluar Dëgjimi i Dëshmisë së Dëshmitarit 8 dhe Thirrja e Dëshmitarit të Dhomës, 20 qershor 2007.

²⁵⁹³ Kërkesa e Prokurorisë për Lëshimin e Urdhërparaqitjes, 25 maj 2007.

²⁵⁹⁴ Urdhërparaqitje për të Dëshmuar, 12 qershor 2007.

²⁵⁹⁵ Fletëdorëzim i 16 qershorit 2007, 20 qershor 2007; T. 6171, 6390.

²⁵⁹⁶ Mocion i Prokurorisë për Urdhër për Dhënie Dëshmie të Detyruar nëpërmjet Videolidhjes, 30 gusht 2007.

²⁵⁹⁷ Vendimi mbi Mocionin për Komunikim me me Video (Dëshmitari 30), 14 shtator 2007.

²⁵⁹⁸ T. 10621-10624, 10628, 10635.

²⁵⁹⁹ T. 10631-10632, 10640-10646, 10762, 10876, 10892-10893.

²⁶⁰⁰ Kërkesë e Prokurorisë për të Dëgjuar Dëshminë e Dëshmitarit 30 nëpërmjet Lidhjes me Video të mërkurën 21 nëntor 2007, 16 nëntor 2007; T. 10954-10956.

²⁶⁰¹ T. 10975.

gjendje të dëshmonte. Kjo ishte tej afatit të dhënë Prokurorisë për paraqitjen e çështjes.²⁶⁰² Naser Lika nuk dëshmoi kurrë.²⁶⁰³

25. *Dosjet përfundimtare dhe argumentet përmbyllëse.* Më 30 nëntor 2007, duke marrë parasysh se Prokuroria kishte mbyllur çështjen e saj dhe pasi u informua nga të gjithë ekipet e Mbrojtjes se asnjë prej tyre nuk synonte të bënte parashtrime në bazë të Rregullës 98 *bis* të Rregullores, dhe as të thërriste dëshmitarë, Dhoma Gjyqësore lëshoi urdhëresën për caktimin e datave për dosjet përfundimtare dhe argumentat përmbyllëse.²⁶⁰⁴ Në urdhëresë përcaktoheshin kërkesat dhe afati për dosjet përfundimtare gjyqësore, të cilat u paraqiten më 14 janar 2008.²⁶⁰⁵ Argumentat përmbyllëse u paraqiten më 21, 22, dhe 23 janar 2008.²⁶⁰⁶ Më 28 mars 2008, Dhoma Gjyqësore lëshoi urdhëresën për caktimin e datës së shpalljes së aktgjyqimit më 3 prill 2008.²⁶⁰⁷

²⁶⁰² T. 10975.

²⁶⁰³ T. 10975.

²⁶⁰⁴ Urdhër për Caktimin e Datës për Dosjet Përfundimtare Gjyqësore dhe Argumentet Përmbyllëse, 30 nëntor 2007.

²⁶⁰⁵ Dosja Përfundimtare e Prokurorisë, 14 janar 2008; Dosja Përfundimtare në Emër të Ramush Haradinajt, 14 janar 2008; Dosja Përfundimtare në Emër të Lahi Brahimajt, 14 janar 2008; Dosja Përfundimtare e Idriz Balajt, 14 janar 2008.

²⁶⁰⁶ T. 11027-11262.

²⁶⁰⁷ Urdhër për Caktimin e Datës për Shqiptimin e Vendimit të Gjyqimit, 28 mars 2008.

B. Tabelë e çështjeve* me shkurtime

* Çështje të TPNJ-së, në rast se nuk shënohen ndryshe.

<i>Aleksovski</i>	Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Zlatko Aleksovski</i> , Judgement (on appeal), 24 March 2000 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Zlatko Aleksovskit</i> , Aktgjykim (për apelin), 24 mars 2000/
<i>Babiq</i>	Appeal Sentencing Judgement: <i>Prosecutor v. Milan Babić</i> , Judgement on Sentencing Appeal, 18 July 2005 /Aktgjykimi i Apelit për Dënimin: <i>Prokurori k. Milan Babiqit</i> , Aktgjykimi i Apelit për Dënimin, 18 korrik 2005/
<i>Banoviq</i>	Sentencing Judgement: <i>Prosecutor v. Predrag Banović</i> , Judgement, 28 October 2003 /Aktgjykimi për Dënimin: <i>Prokurori k. Predrag Banoviqit</i> , Aktgjykim, 28 tetor 2003/
<i>Bërgjanin</i>	Trial Judgement: <i>Prosecutor v. Radoslav Brdanin</i> , Judgement, 1 September 2004 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: <i>Prokurori k. Radoslav Bërgjaninit</i> , Aktgjykim, 1 shtator 2004/ Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Radoslav Brdanin</i> , Judgement (on appeal), 3 April 2007 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Radoslav Bërgjaninit</i> , Aktgjykimi (për apelin), 3 prill 2007/
<i>Blagojeviq dhe Jokiq</i>	Trial Judgement: <i>Prosecutor v. Vidoje Blagojević and Dragan Jokić</i> , Judgement, 17 January 2005 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: <i>Prokurori k. Vidoje Blagojeviqit dhe Dragan Jokiqit</i> , Aktgjykim, 17 janar 2005/ Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Vidoje Blagojević and Dragan Jokić</i> , Judgement (on appeal), 9 May 2007 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Vidoje Blagojeviqit dhe Dragan Jokiqit</i> , Aktgjykim (për apelin), 9 maj 2007/
<i>Blashkiq</i>	Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Tihomir Blaškić</i> , Judgement (on appeal), 29 July 2004 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Tihomir Blashkiqit</i> , Aktgjykimi (për apelin), 29 korrik 2004/
<i>Bralo</i>	Sentencing Judgement: <i>Prosecutor v. Miroslav Bralo</i> , Judgement, 7 December 2005 /Aktgjykimi për Dënimin: <i>Prokurori k. Miroslav Bralo</i> , Aktgjykim, 7 dhjetor 2005/
<i>Çelebiqi</i>	Trial Judgement: <i>Prosecutor v. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, Hazim Delić, and Esad Landžo</i> , Judgement, 16 November 1998 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: <i>Prokurori k. Zejnil Delaliqit, Zdravko Muciqit, Hazim Deliqit dhe Esad Lanxhos</i> , Aktgjykim, 16 nëntor 1998/ Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Zejnil Delalić, Zdravko Mucić, Hazim Delić, and Esad Landžo</i> , Judgement (on appeal), 20 February 2001 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokuroria k. Zejnil Delaliqit, Zdravko Muciqit, Hazim Deliqit, dhe Esad Lanxhos</i> , Aktgjykimi (për apelin), 20 shkurt 2001/
<i>Çeshiq</i>	Sentencing Judgement: <i>Prosecutor v. Ranko Češić</i> , Judgement, 11 March 2004 /Aktgjykimi për Dënimin: <i>Prokurori k. Ranko Çeshiqit</i> , Aktgjykim, 11 mars 2004/

- Deronjiq* Sentencing Judgement: *Prosecutor v. Miroslav Deronjić*, Judgement, 30 March 2004 /Aktgjykimi i Dënimit: *Prokurori k. Miroslav Deronjiqit*, Aktgjykim, 30 mars 2004/
Appeal Sentencing Judgement: *Prosecutor v. Miroslav Deronjić*, Judgement (on appeal), 20 July 2005 /Aktgjykim për Apelimin e Dënimit: *Prokurori k. Miroslav Deronjiqit*, Aktgjykimi (për apelin), 20 korrik 2005/
- Erdemoviq* Sentencing Judgement: *Prosecutor v. Dražen Erdemović*, Judgement, 29 November 1996 /Aktgjykimi për Dënimin: *Prokurori k. Drazhen Erdemoviqit*, Aktgjykim, 29 nëntor 1996/
- Furunxhija* Trial Judgement: *Prosecutor v. Anto Furundžija*, Judgement, 10 December 1998 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Anto Furunxhisë*, Aktgjykim, 10 dhjetor 1998/
Appeal Judgement: *Prosecutor v. Anto Furundžija*, Judgement (on appeal), 21 July 2000 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Anto Furunxhisë*, Aktgjykimi (për apelin), 21 korrik 2000/
- Galiq* Appeal Judgement: *Prosecutor v. Stanislav Galić*, Judgement (on appeal), 30 November 2006 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Stanislav Galiqit*, Aktgjykimi (për apelin), 30 nëntor 2006/
- Haxhihasanoviq dhe Kubura* Trial Judgement: *Prosecutor v. Enver Hadžihasanović and Amir Kubura*, Judgement, 15 March 2006 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Enver Haxhihasanoviqit dhe Amir Kuburës*, Aktgjykim, 15 mars 2006/
- Haliloviq* Trial Judgement: *Prosecutor v. Sefer Halilović*, Judgement, 16 November 2005 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Sefer Haliloviqit*, Aktgjykim, 16 nëntor 2005/
- Jelisiq* Trial Judgement: *Prosecutor v. Goran Jelisić*, Judgement, 14 December 1999 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Goran Jelisiqit*, Aktgjykim, 14 dhjetor 1999/
Appeal Judgement: *Prosecutor v. Goran Jelisić*, Judgement, 5 July 2001 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Goran Jelisiqit*, Aktgjykim, 5 korrik 2001/
- Jokiq* Trial Sentencing Judgement: *Prosecutor v. Miodrag Jokić*, Sentencing Judgement, 18 March 2004 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore për Dënimin: *Prokurori k. Miodrag Jokiqit*, Aktgjykimi për Dënimin, 18 mars 2004/
Appeal Sentencing Judgement: *Prosecutor v. Miodrag Jokić*, Judgement on Sentencing Appeal, 30 August 2005 /Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit: *Prokurori k. Miodrag Jokiqit*, Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit, 30 gusht 2005/
- Kamuhanda* Appeal Judgement: *Prosecutor v. Jean de Dieu Kamuhanda*, Judgement, 19 September 2005 (ICTR) /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Jean de Dieu Kamuhanda*, Aktgjykim, 19 shtator 2005 (TPNR)/
- Kayishema dhe Ruzindana* Appeal Judgement: *Prosecutor v. Clément Kayishema and Obed Ruzindana*, Judgement, 1 June 2001 (ICTR) /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Klement Kayishema dhe Obed Ruzindana*, Aktgjykim, 1 qershor 2001 (TPNR)/

- Kordiq dhe Çerkez* Appeal Judgement: *Prosecutor v. Dario Kordić and Mario Čerkez*, Judgement (on appeal), 17 December 2004 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Dario Kordiqit dhe Mario Çerkezit*, Aktgjykimi (për apelin), 17 dhjetor 2004/
- Krajishnik* Trial Judgement: *Prosecutor v. Momčilo Krajišnik*, Judgement, 27 September 2006 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Momçilo Krajishnikut*, Aktgjykim, 27 shtator 2006/
- Kërnojelac* Trial Judgement: *Prosecutor v. Milorad Krnojelac*, Judgement, 15 March 2002 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Milorad Krnojelacit*, Aktgjykim, 15 mars 2002/
- Appeal Judgement: *Prosecutor v. Milorad Krnojelac*, Judgement (on appeal), 17 September 2003 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Milorad Krnojelacit*, Aktgjykimi (për apelin), 17 shtator 2003/
- Krstiq* Appeal Judgement: *Prosecutor v. Radislav Krstić*, Judgement (on appeal), 19 April 2004 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Radislav Krstiqit*, Aktgjykimi (për apelin), 19 prill 2004/
- Kunarac dhe të tjerë* Appeal Judgement: *Prosecutor v. Dragoljub Kunarac, Radomir Kovač, Zoran Vuković*, Judgement (on appeal), 12 June 2002 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Dragoljub Kunaracit, Radomir Kovaçit, Zoran Vukoviqit*, Aktgjykimi (për apelin), 12 qershor 2002/
- Kupreshkiq dhe të tjerë* Appeal Judgement: *Prosecutor v. Zoran Kupreškić, Mirjan Kupreškić, Vlatko Kupreškić, Drago Josipović, and Vladimir Šantić*, Judgement (on appeal), 23 October 2001 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Zoran Kupreshkiqit, Mirjan Kupreshkiqit, Vlatko Kupreshkiqit, Drago Josipoviqit, dhe Vladimir Shantiqit*, Aktgjykimi (për apelin), 23 tetor 2001/
- Kvoçka dhe të tjerë* Trial Judgement: *Prosecutor v. Miroslav Kvočka, Milojica Kos, Mlado Radić, Zoran Žigić, and Dragoljub Prcać*, Judgement, 2 November 2001 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Miroslav Kvoçkës, Milojica Kosit, Mllago Radiqit, Zoran Zhigiqit, dhe Dragolub Prcaqit*, Aktgjykim, 2 nëntor 2001/
- Appeal Judgement: *Prosecutor v. Miroslav Kvočka, Mlado Radić, Zoran Žigić, and Dragoljub Prcać*, Judgement (on appeal), 28 February 2005 /Aktgjykimi i Apelit: *Prokurori k. Miroslav Kvoçkës, Mllago Radiqit, Zoran Zhigiqit, dhe Dragolub Prcaqit*, Aktgjykimi (për apelin), 28 shkurt 2005/
- Limaj dhe të tjerë* Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut*, Aktgjykim, 30 nëntor 2005
- Aktgjykimi i Apelit: *Prokuroria k. Fatmir Limajt, Haradin Balës dhe Isak Musliut*, Aktgjykim, 27 shtator 2007
- Slobodan Millosheviq* Rule 98 bis Decision: *Prosecutor v. Slobodan Milošević*, Decision on Motion for Judgement of Acquittal, 16 June 2004 /Vendimi i Rregullës 98 bis: *Prokurori k. Slobodan Millosheviqit*, Vendimi mbi Mocionin për Aktgjykimin e Lirimit, 16 qershor 2004/
- Martiq* Trial Judgement: *Prosecutor v. Milan Martić*, Judgement, 12 June 2007 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Milan Martiqit*, Aktgjykim, 12 qershor 2007/
- Mërgja* Sentencing Judgement: *Prosecutor v. Darko Mrda*, Judgement, 31 March 2004 /Aktgjykimi për Dënimin: *Prokurori k. Darko Mërgjës*, Aktgjykim, 31 mars 2004/

<i>Mërkshiq dhe të tjerë</i>	Trial Judgement: <i>Prosecutor v. Mile Mrkšić, Miroslav Radić, and Veselin Šljivančanin</i> , Judgement, 27 September 2007 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: <i>Prokurori k. Mile Mërkshiqit, Miroslav Radiqit, dhe Veselin Shljivančaninit</i> , Aktgjykim, 27 shtator 2007/
<i>Naletiliq dhe Martinoviq</i>	Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Mladen Naletilić and Vinko Martinović</i> , Judgement, 3 May 2006 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Mladen Naletiliqit dhe Vinko Martinoviqit</i> , Aktgjykim, 3 maj 2006/
<i>Dragan Nikoliq</i>	Appeal Sentencing Judgement: <i>Prosecutor v. Dragan Nikolić</i> , Judgement, 4 February 2005 /Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit: <i>Prokurori k. Dragan Nikoliqit</i> , Aktgjykim, 4 shkurt 2005/
<i>Momir Nikoliq</i>	Sentencing Judgement: <i>Prosecutor v. Momir Nikolić</i> , Judgement, 2 December 2003 /Aktgjykimi i Dënimit: <i>Prokurori k. Momir Nikoliqit</i> , Aktgjykim, 2 dhjetor 2003/ Appeal Sentencing Judgement: <i>Prosecutor v. Momir Nikolić</i> , Judgement, 8 March 2006 /Aktgjykimi për Apelimin e Dënimit: <i>Prokurori k. Momir Nikoliqit</i> , Aktgjykim, 8 mars 2006/
<i>Oriq</i>	Trial Judgement: <i>Prosecutor v. Naser Orić</i> , Judgement, 30 June 2006 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: <i>Prokurori k. Naser Oriqit</i> , Aktgjykim, 30 qershor 2006/
<i>Simiq dhe të tjerë</i>	Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Blagoje Simić, Miroslav Tadić, and Simo Zarić</i> , Judgement (on appeal), 28 November 2006 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Blagoje Simiqit, Miroslav Tadiqit, dhe Simo Zariqit</i> , Aktgjykimi (për apelin), 28 nëntor 2006/
<i>Stakiq</i>	Trial Judgement: <i>Prosecutor v. Milomir Stakić</i> , Judgement, 31 July 2003 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: <i>Prokurori k. Milomir Stakiqit</i> , Aktgjykim, 31 korrik 2003/ Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Milomir Stakić</i> , Judgement (on appeal), 22 March 2006 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Milomir Stakiqit</i> , Aktgjykimi (për apelin), 22 mars 2006/
<i>Strugar</i>	Trial Judgement: <i>Prosecutor v. Pavle Strugar</i> , Judgement, 31 January 2005 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: <i>Prokurori k. Pavle Strugarit</i> , Aktgjykim, 31 janar 2005/
<i>Tadić</i>	Jurisdiction Decision: <i>Prosecutor v. Duško Tadić</i> , “Decision on Defence Motion for Interlocutory Appeal on Jurisdiction” 2 October 1995 /Vendimi për Jurisdikcionin: <i>Prokurori k. Dushko Tadiqit</i> , “Vendimi për Mocionini e Mbrojtjes për Apelimin e Ndërkohshëm në lidhje me Jurisdikcionin” 2 tetor 1995/ Trial Judgement: <i>Prosecutor v. Duško Tadić</i> , Judgement, 7 May 1997 /Aktgjykim i Dhomës Gjyqësore: <i>Prokurori k. Dushko Tadiqit</i> , Aktgjykim, 7 maj 1997/ Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Duško Tadić</i> , Judgement (on appeal), 15 July 1999 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Dushko Tadiqit</i> , Aktgjykimi (për apelin), 15 korrik 1999/ Appeal Sentencing Judgement: <i>Prosecutor v. Duško Tadić</i> , Judgement, 26 January 2000 /Aktgjykimi i Apelit për Dënimin: <i>Prokurori k. Dushko Tadiqit</i> , Aktgjykim, 26 janar 2000/
<i>Vasiljeviq</i>	Appeal Judgement: <i>Prosecutor v. Mitar Vasiljević</i> , Judgement (on appeal), 25 February 2004 /Aktgjykimi i Apelit: <i>Prokurori k. Mitar Vasiljeviqit</i> , Aktgjykimi (për apelimin), 25 shkurt 2004/

Zelenović

Trial Sentencing Judgement: *Prosecutor v. Dragan Zelenović*,
Sentencing Judgement, 4 April 2007 /Aktgjykimi i Dënimit prej
Dhomës Gjyqësore: *Prokurori k. Dragan Zelenovićit*, Aktgjykimi
për Dënimin, 4 prill 2007/